

ENVER HOXHA

VEPRA


66

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPËRISË**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VELLIMI

66

PRILL 1978 — QERSHOR 1978

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1969

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 66-TË

Vëllimi i 66-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban shkrime që i përkasin periudhës prill-qershor 1978. Pjesa më e madhe e tyre botohen për herë të parë.

Tematika e materialeve që përfshihen në këtë vëllim është e gjerë dhe e larmishme. Vend qendror në to zënë problemet ekonomike, të cilat janë parë e trajtuar në tërë kompleksitetin e tyre. Duke vënë në dukje rëndësinë e kuptimit e të vlerësimit politik të problemit, autori nënvizon idenë që çështjet e zhvillimit të ekonomisë të shihen të lidhura ngushtë me situatat e brendshme dhe të jashtme, me forcimin e pandërprerë të pavarësisë e të mbrojtjes së vendit. Por, në vëllim tërhiqet vëmendja se rëndësi të madhe ka fakti që këto probleme duhet të konkretizohen çdo ditë nga gjithsecili në frontin e vet të punës.

Në disa shkrime të kësaj periudhe nënvizohet ideja që gjithë ekonomia e vendit është dhe duhet parë si një e tërë, që puna e një sektori të koordinohet me atë të sektorëve të tjerë sepse arritjet e mosrealizimet në një degë ndikojnë për mirë apo për keq edhe në degët e tjera. Prandaj nuk duhen parë vetëm interesat dikasteriale apo lokale, të kooperativës apo të rrethit, por t'u jepet përparësi interesave të përgjithshëm të tërë vendit.

Duke argumentuar në mënyrë bindëse domosdoshmërinë e realizimit të planit, të detyrave e të tërë treguesve ekonomiko-financiarë, në vëllim tregohen edhe rrugët konkrete që duhen ndjekur për ta arritur këtë. Theksi vihet te domosdoshmëria e rritjes së rendimentit të punës, sepse në këtë mënyrë shtohet prodhimi, mbulohet me mallrat e nevojshme fuqia blerëse e popullit, rriten të ardhurat kombëtare, realizohen investimet e parashikuara dhe rritet mirëqenia e masave.

Për stadin e arritur nga ekonomia jonë, rëndësi të posaçme merrte thellimi i mëtejshëm i revolucionit tekniko-shkencor. Në morinë e problemeve që lidhen me këtë, në materialet e këtij vëllimi autori shtjellon edhe idenë se drejtimi shkencor i punëve nuk mund të bëhet vetëm nga specialistët. Ai këshillon që të tërë duhet të dinë t'i trajtojnë në mënyrë shkencore çështjet dhe për këtë të mësojnë dhe t'i vihen drejtimin shkencor të ekonomisë. Koha kërkonte që problemet të zbërthehen jo në mënyrë të përgjithshme, por të jepen zgjidhje konkrete. Për këtë qëllim shtrohet detyra që ata të cilët shkojnë në bazë jo vetëm të jenë kompetentë, por edhe të zgjidhin në vend problemet që dalin, jo të mbushin bllokun me shënime e të zbrazen në ministri, por t'u hapin horizont njerëzve për ta çuar më tej punën në të gjitha degët e sektorët.

Trajtim shkencor dhe lidhje të ngushtë me jetën nuk kërkonte vetëm ekonomia, por edhe tërë frontet e tjera të punës së Partisë e të shtetit. Kështu, duke bërë fjalë për edukimin ideopolitik të punonjësve, vihet në dukje se nuk mjafton të njohësh doktrinën tonë marksiste-leniniste, por edhe ta lidhësh atë me jetën,

me problemet dhe me detyrat konkrete në fabrikë, në kantier, kudo ku punohet. Vetëm atëherë edukimi politik-ideologjik do të jetë me efekt të madh.

Në këtë prizëm përcaktohen detyra edhe për jetën e brendshme të Partisë, ku gjithashtu kërkohet mendim shkencor, pjekuri e thellim në problemet që dalin. Këtë e dikton nevoja e përsosjes gjithnjë e më shumë të drejtimit të organizatave-bazë të Partisë, gjë që është në radhë të parë një çështje ideologjike e politike. Edhe organizimi e zhvillimi i mbledhjeve të organizatave-bazë kanë rëndësinë e tyre, prandaj kërkohet punë cilësore që tema e rendit të ditës të zgjidhet drejt, duke kapur e trajtuar ato probleme që preokupojnë me të vërtetë ndërmarrjen apo institucionin, sepse kështu mbledhjet do të jenë lufstarake e do t'i çojnë punët përpara.

Ndër problemet e shumta që trajtohen në këtë vëllim, janë edhe ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Siç ka vënë në dukje vazhdimisht Partia, të gjitha detyrat janë të rëndësishme, por, në radhë të parë, detyrat e mbrojtjes e të ushtrisë, për arsye se, kur të vijë momenti i rrezikut, nga përgatitja e gjithanshme e vendit varet fati i ekzistencës së tij. Në shkrime të këtij vëllimi autori ndalet veçanërisht në stërvitjet jashtë Shkollës së Lirë Ushtarake, në të cilën njerëzit tanë të përgatiten jo vetëm ushtarakisht, por edhe të kaliten fizikisht, për të qenë sa më të fortë. Detyra të rëndësishme shtrohen sidomos për të rritur cilësinë e mësimin dhe të stërvitjes, sepse nga kjo varet shumë frytshmëria e saj.

Periudha kur janë shkruar materialet e këtij vë-

llimi përkon me 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo ngjarje e shënuar e historisë së laudshme të popullit tonë trajtohet jo vetëm në biseda e takime me kuadro e veteranë, por edhe në shënime të veçanta, ku spikatin sidomos ato për rilindësit, që janë një sintezë e fuqishme jo vetëm për këta bij të shquar të popullit tonë, por edhe për tërë ngjarjet që u frymëzuan e u udhëhoqën prej tyre. Kur njihesh me veprën e ndritur të rilindësve, vë në dukje shoku Enver Hoxha, aq më lart ngrihet në sytë tanë laudia e tyre e aq më shumë shtohet mirënjohja jonë për ta.

Në faqet e këtij vëllimi gjenden edhe analiza e refleksione për situatat ndërkombëtare. Krahas materialeve ku analizohet kriza e thellë që ka mbërthyer botën kapitalisto-revizioniste, në vëllim ka shënime të marra nga Ditari Politik, ku trajtohen revizionizmi kinez dhe ai jugosllav. Duke e krahasuar revizionizmin kinez me rrymat e tjera revizioniste, sidomos me atë hrushovian, në vëllim argumentohet me fakte bindëse se ç'i ndan e ç'i bashkon ata me njëri-tjetrin. Në analizën që i bëhet gjendjes në Jugosllavi e veçanërisht raportit të mbajtur nga Titoja në Kongresin e 11-të të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, pasqyrohet kriza e thellë ku është zhytur ky vend prej të ashtuquajturit socializëm specifik e vetadministrues jugosllav, pasojat e të cilit rëndojnë çdo ditë e më tepër në kurrizin e masave punonjëse. Në këto shënime e në të tjera, si në ato kushtuar shqiptarëve që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi, jepet një tablo e qartë e politikës shoviniste e diskriminuese që është ndjekur ndaj tyre nga udhëheqja titiste. Duke marrë shkas nga ky realitet,

bëhen përgjithësimet me vlerë për çështjen nacionale, duke u mbështetur në trajtimin që i kanë bërë këtij problemi klasikët e marksizëm-leninizmit.

Me analizat e thella që bëhen, me orientimet e porositë e çmuara që përmbajnë dhe me horizontet e gjera që hapin, materialet e këtij vëllimi do t'u vlejnjë shumë masave punonjëse në luftën e tyre të përditshme për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

EKSPOZE PSEUDOTEORIKE

Shënime

4 prill 1978

Një i njohuri ynë, gazetar, i cili vitin e kaluar ka botuar artikullin e «Zërit të popullit» të 7 korrikut 1977 në revistën «Cina contemporanea», dërgoi në ambasadën tonë në Romë një përmbledhje në gjuhën angleze të një fjalimi që ministri i Jashtëm i Kinës, Huan Hua, ka mbajtur përpara një audience të madhe të kuadrove në korrik të vitit 1977 në Pekin.

Në këtë material shohim një shënim të botuesit, të bërë më 10 korrik, në të cilin thotë se «Huan Huaja, ministër i Jashtëm kinez, ka mbajtur në Ministrinë e Jashtme një raport të gjatë për çështjet politike». Ky raport është një material shumë i rëndësishëm për të analizuar diplomacinë «komuniste» të Kinës dhe politikën e jashtme të saj. Sipas tij, materiali përmban 22 mijë hieroglife. Redaktori thotë se «ky raport nuk mund të botohet në një numër të vetëm të revistës së tij; ai do të përkthehet më parë në anglisht dhe pastaj do të botohet pjesë-pjesë, duke filluar nga numri i nëntorit». Mirëpo nëntori ka kaluar dhe ne akoma nuk e kemi në dorë këtë revistë. Botimi i këtij raporti në një revistë

publike na intereson shumë, për arsye se në fjalimin që ky pretendon se është i Huan Huasë, flitet gjerë edhe për qëndrimet e Kinës ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Sidoqoftë, duke lexuar këtë fjalim, qoftë ky i tij ose jo, ne mund të konstatojmë e të dalim me disa konkluzione që, edhe po të mos jetë i tij, ata që e kanë përgatitur atë për të na e dhënë neve, nuk i kanë të huaja qëndrimet politike të Kinës, por i kanë studiuar ato thellësisht. Mua më duket se ky material që po lexojmë, por që nuk është komplet, ka tiparet e kinezëve dhe duhet të jetë material i tyre, i marrë, sigurisht, nga agjencurat e huaja. Duhet të jetë një raport i Huan Huasë.

Ç'përmban ky raport? Në fillim lexojmë këshillat «e bukura» të Huan Huasë, që u thotë dëgjuesve që ka përpara se duhet ta mbajnë gojën të kyçur për të gjitha ato që ngjasin në Kinë, veçanërisht përpara korrespondentëve të huaj, sepse, thotë ai, disa prej tyre nuk kanë ide të qarta për gjendjen e punëve dhe u pëlqen të nxjerrin konkluzione arbitrare, me qëllim që opinioni publik të përpunohet nga ana e tyre në mënyrë të ndër-gjegjshme. Prandaj, vazhdon ai, duhet dhe është një gjë shumë e mirë që gazetarëve të huaj t'u buzëqeshet dhe t'u tregohen pak gjëra ose të mos u tregohet asgjë. Unë, thotë Huan Huaja, kur punoja në Nju-Jork dhe më pyetnin gazetarët, u përgjigjesha «no koment» dhe, kur më pyetnin përsëri se ç'do të thotë «no koment», u bëja dhjetë komente. Duket qartë se kinezët ndodhen ngushtë me politikën e tyre dhe nuk guxojnë të thonë

haptazi çka mendojnë, se e dinë që thënia haptazi e së vërtetës është e hidhur për ta. Atëherë ata, natyrisht, duhet të gënjejnë ose të heshtin, por ka qenë e pamundur të heshtnin për «grushtin që i dhanë katërshes» dhe për çka kanë shkruar për këtë problem.

Por ky problem është trajtuar prej tyre aq keq dhe në mënyrë aq të qelbur, saqë gazetarët e huaj, natyrisht, nuk kanë dhënë veçse deduksione të drejta për çka po ndodh në Kinë. Këto deduksione nuk u interesojnë kinezëve.

Në këtë material shohim që Huan Huaja trajton një varg problemesh të ndara në dhjetë pika. Në pikën e parë ai flet për Indokinën; në pikën e dytë për çështjen shqiptare, pastaj me radhë për qëndrimin e Kinës ndaj Jugosllavisë, për Lindjen e Mesme e për luftën e ardhshme botërore, për vizitën e Sajrus Vensit¹ në Kinën kontinentale, për çështje të lëvizjes nacional-çlirimtare, për të drejtat e njeriut, për politikën ndaj kinezëve të përtejdetit dhe, në fund, në pikën e dhjetë, për çështjen e Hong-Kongut dhe të Makaos.

Siç po e shohim, edhe Huan Huaja, ashtu si Mao Ce Duni, ka maninë e dekalogëve, por ky i Huan Huasë është më i qartë për vijën e Partisë Komuniste të Kinës, një vijë revizioniste e armiqësore kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste për problemet që preokupojnë botën dhe që ai i trajton në këtë material, si dhe kundër Vietnamit.

1. Në atë kohë, sekretar i Departamentit të Shtetit të SHEA.

Materiali që kemi në dorë përmban vetëm dy pikat e para, pikën mbi Vietnamin dhe pikën e marrëdhënieve me Shqipërinë. Lidhur me pikën e parë, botuesi, duke u mbështetur në fjalimin e Huan Huasë ka arritur në konkluzionin se «regjimi komunist kinez do të vazhdojë të mbështetë luftërat antiamerikane të zhvilluara nga Vietnami, Kamboxhia dhe Laosi, si edhe luftën antisocialimperialiste që zhvillohet nga Kamboxhia dhe Laosi kundër Bashkimit Sovjetik». Dhe, në fakt, në fjalim del se politika kineze bën një dallim sipas të cilit Vietnami ka zhvilluar luftë antiamerikane por nuk bën luftë antisocialimperialiste, kurse Kamboxhia dhe Laosi zhvillojnë një luftë antisocialimperialiste dhe antiamerikane.

Asgjë s'të çudit kur e lexon këtë fjalim dhe njihesh me këtë ekspozë pseudoteorike. Në fakt ky nuk është një fjalim teorik, por një grumbullim frazash pa themel, bile edhe të gënjeshtërt. Ministri i Jashtëm i Kinës nuk mungon ta fillojë fjalimin e tij me luftën kundër bandës së «të katërve». Kjo, natyrisht, është tema kryesore.

Këndeji ai del në çështjen se njeriu, sipas tij, «nuk mund të thotë se në një vend që është në kushtet e diktaturës së proletariatit nuk do të ketë borgjezi dhe elementë të të pesë kategorive të zeza». Pra, pas kaq vjetësh që pretendohet për socializëm, pas kaq vjetësh që pretendohet për zhvillimin e luftës së klaseve dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit, ministri i Jashtëm kinez aprovon se në Kinë ekziston borgjezia, ekzistojnë të pesë elementët e «kategorisë së zezë». Kjo ne nuk na cudit aspak, sepse e dimë që

e tillë është teoria e Mao Ce Dunit e zbatuar në praktikë.

Lajtmotivi tjetër i fjalimit të këtij «teoricieni» të Ministrisë së Jashtme të Kinës është lufta kundër Bashkimit Sovjetik socialimperialist. Sipas përcaktimit të tij, ky socialimperializëm është shumë i rrezikshëm, është një diktaturë e egër e borgjezisë, e veshur me «mbulesën e leckosur të të ashtuquajturit socializëm». Kjo mbulesë, pra, është mashtruese dhe, siç e shpjegon ai, paraqitet më e rrezikshme se ajo e imperializmit. Për ta përforcuar këtë ide, Huan Huaja thotë se duke u bazuar te Lenini, del që kjo mbulesë pseudo-socialiste e Bashkimit Sovjetik është socialiste në emër, por imperialiste në përmbajtje.

Revizionizmi i sotëm sovjetik është pikërisht i tillë. Ai përfaqësohet nga njerëzit e një klase të privilegjuar që manipulon partinë dhe aparatit qeveritar në Kremlin e që e ka kthyer diktaturën e proletariatit në diktaturë të borgjezisë. Ky është një përcaktim ekzakt që ka bërë ministri i Jashtëm i Kinës. Por, në të njëjtën kohë, ky përcaktim i përshtatet edhe klikës së Hua Kuo Fenit, që është një grup njerëzish të një klase të privilegjuar, që morën pushtetin me puç, manipuluan partinë dhe organet qeveritare dhe rrëzuan të ashtuquajturën diktaturë të proletariatit në Kinë. Pra, ashtu siç degjeneroi Bashkimi Sovjetik në socialimperializëm, ashtu po degjeneron edhe Kina në socialimperializëm.

Për sa i përket subversionit, Kina revizioniste bën të njëjtën gjë, ashtu si dhe Bashkimi Sovjetik, bile më me forcë. Për sa i përket ekspansionit territorial,

ajo akoma nuk ka filluar, se i ka thonjtë të prerë, por edhe kjo do të vijë. Për penetrimin e saj politik e për të përhapur influencën e vet në vendet e tjera, Kina bën përpjekje të mëdha. Shpejt do të vijë koha që atë që thotë ministri i Jashtëm i Kinës për Bashkimin Sovjetik, se ky kërkon të krijojë kolonitë e veta, do ta bëjë edhe vetë Kina, po të mundë dhe, natyrisht, po ta lënë.

Një çështje tjetër që afirmon ministri i Jashtëm i Kinës, është se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik janë vende ku sundon diktatura e borgjezisë. Ai vazhdon: «Lind pyetja: A janë Japonia, Franca, Britania e Madhe, Kanadaja dhe shumë vende të tjera, ku sundon borgjezia, diktatura të borgjezisë?». «Natyrisht», përgjigjet vetë Huan Huaja. «Por, — dhe këtu parashtron rezervën e tij, — në fazën e tanishme ka borgjezi të përparuar dhe borgjezi reaksionare». Kështu ai përgatit terrenin për të arsyetuar se gjoja në Japoni, në Francë, në Britaninë e Madhe, në Kanada dhe në shumë vende të tjera kapitaliste nuk është në fuqi borgjezia reaksionare, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Sovjetik. Borgjezia imperialiste franceze, japoneze, britanike dhe kanadeze na qenka, pra, e përparuar!

Kuptohet se politika kineze këtu bën një diferencim, me qëllim që të justifikojë aspiratat e saj të bashkëpunimit e të aleancave me këtë borgjezi «përparimtare». Zaten këtë e kanë deklaruar me kohë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, jo vetëm për këto borgjezi përparimtare të pretenduara, por bile edhe për borgjezinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, derisa udhëhe-

qja kineze nuk bashkëpunon më pak me këtë borgjezi që e quan «reaksionare», por që e preferon më shumë se ka «para».

Këtë afirmacion reaksionar të tij për të përlligjur politikën e bashkimit të Kinës me politikën e imperia-
lizmit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë, si të atyre francezë, japonezë, anglezë, të Republikës Fede-
rale të Gjermanisë, Huan Huaja e bazon gjoja në ana-
lizën e vjetër të Mao Ce Dunit, sipas të cilit, në kohën e luftës nacionalçlirimtare dhe pas çlirimit ekzistonin në Kinë borgjezia kombëtare, borgjezia burokratike dhe mikroborgjezia. Të gjitha këto borgjezi, që kanë qenë si parti në fazën e revolucionit, ekzistojnë edhe tash në Kinë.

Gjithashtu Huan Huaja thotë se pronarët e tokave klasifikoheshin në njerëz «të çiltër» e në reaksionarë dhe vazhdon të vërë në dukje që në fazat e reformës agrare pronarët e tokave ndaheshin në 11 kategori të ndryshme dhe trajtoheshin në mënyra të ndryshme. Nuk është vështirë të merret me mend se vetëm njëri grup pronarësh, çifligarësh shumë të mëdhenj, ishin jashtë këtyre kategorive, kurse gjithë të tjerët bënë pjesë si njerëz «të çiltër» në këtë vend «socialist», populli i të cilit luftoi dhe derdhi gjak për të vendosur diktaturën e proletariatit! Zbatimi i një politike të këtillë ndaj borgjezisë dhe çifligarëve shpjegon e vërteton të gjitha deduksionet që ka nxjerrë Partia jonë për çështjen e diktaturës së proletariatit në Kinë.

Pastaj Huan Huaja fillon me krahasimet. «Bandën e të katërve» e krahason me klikën e Lon Nolit dhe thotë se klika e Lon Nolit u mbështet nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, prandaj ajo pati një jetë më të gjatë se «katërshja» në Kinë, e cila u shtyp që në embrion «përpara se të zinte fronin». Por, në fakt, kjo, «banda e të katërve», nuk ishte vetëm në pushtet, se në pushtet bashkë me ta ishin Mao Ce Duni, Çu En Lai, Hua Kuo Fenit me gjithë të tjerët, me përjash-tim të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit dhe të bandës tjetër tradhtarë. Pra çfarë fronti synonin ata, siç pre-tendon ky ministër? Kjo vërteton të kundërtën, atë që klika e Lon Nolit është njësoj si klika e Hua Kuo Fenit; klika e Lon Nolit e mori fuqinë në Kamboxhia me puç; ajo e rrëzoi dhe e dëboi Sihanukun nga fronti, por edhe grupi i Huan Huasë, i Hua Kuo Fenit, i Ten Hsiao Pinit dhe i zagarëve të tjerë, po ashtu, e mori fronin me puç.

Një gjë interesante zbulon ky farë ministri: çësht-jen e marrëdhënieve të Çu En Lait me Sihanukun dhe të pikëpamjeve të tij antimarksiste. Sipas këtij ministri, Sihanuku i tha njëherë Çu En Lait se dëshironte të mos e mbante titullin e princit dhe Çuja i qenkësh përgji-gjur atij se nuk është titulli i princit që përcakton të mirën apo të keqen; çështja varet kryesisht në atë nëse njeriu është revolucionar ose kundërrevolucionar. Pran-daj mbaje titullin e princit, e këshilloi ai. Francezët kanë një fjalë të urtë që thotë «*L'habit ne fait pas le moine*», që do të thotë se nuk e bën rroba priftin. Kësh-tu prifti, edhe sikur të mos i ketë veshur rrobat e ki-shës, ai prapë prift është. Po kështu princi Sihanuk, megjithëse njihet për pikëpamjet e tij përparimtare, ai përsëri kurdoherë princ qëndronte dhe nuk mund të ishte revolucionar, siç e quante Çu En Lai. Vetë

princi Sihanuk na thoshte neve me të qeshur se kishte tescrën e partisë jo të kuqe, po «bojë trëndafili».

«Pse po e nxjerr unë sot papritur në pah princin Sihanuk?» bën pyetjen ministri i Jashtëm i Kinës, dhe përgjigjet: «Këtë e bëj për të shpjeguar se nga borgjezitë e vendeve të botës disa janë përparimtare, disa janë reaksionare». Por harroi të thotë se në praktikë princër, sheikë, mbretër dhe mbretëresha reaksionarë udhëheqësit aktualë kinezë i konsiderojnë e i trajtojnë si revolucionarë. Prandaj, ashtu siç kanë pasur marrëdhënie aq të ngushta e miqësore me Sihanukun përse të mos i kenë edhe me shahun e Iranit, me princeshat dhe mbretërit e të gjitha këtyre mbretërive «përparimtare»?

Pas kësaj ministri Huan Hua futet në çështjen e mosmarrëveshjeve kamboxhiano-vietnameze. Këto ai i quan vështirësi e shqetësime të lindura në mes dy fqinjëve. Po përse i quan «vështirësi e shqetësime» dhe nuk i quan luftë? I quan shqetësime vetëm ndaj Kinës dhe tjerr një histori të gjatë se, sipas tij, këto tri vende, Vietnami, Kamboxhia dhe Laosi, kanë luftuar kundër imperializmit amerikan etj., etj., dhe tani, që arritën në fitore, duhet të bashkëpunonin ngushtë me njëri-tjetrin. Mirëpo, në fakt, këto vende janë ndarë në dy grupe dhe kanë nisur luftën me njëri-tjetrin. Lufta, sipas këtij, është «në shkallë të vogël», ndërsa kamboxhianët dhe vietnamezët thonë se është «në shkallë të madhe».

«A do të bëhet një luftë e gjatë dhe e dëmshme?», pyet ministri kinez. «Do të bëhet», — pohon ai, — dhe pretendon se «kjo duhet të ndalet, sepse një gjë e

tillë është në interesin e të dyja palëve, po edhe në interesin e Kinës. Ekzistojnë probleme, por këto probleme duhet të zgjidhen. Trajtimi i tyre duhet të jetë i matur dhe jo si në rastin e luftërave të kaluara që janë bërë nga ana e këtyre dy vendeve kundër imperializmit amerikan».

Sipas tij, Kina nuk e dëshiron këtë luftë, por shikon se vietnamezët kanë pretendime mbi Kamboxhian dhe vetë bën sikur qëndron asnjëse në konfliktin midis tyre. Por në fakt Huan Huaja pohon padashur se Kina ka gisht në këtë luftë dhe, me gjithë pretendimet absurde dhe pa baza se gjoja nuk e ndihmon Kamboxhian me armë, me municione dhe me mjete të tjera të prapavijës, faktet lënë të kuptohet se ndihma, simpatia kineze dhe çdo gjë tjetër e saj janë nga ana e Kamboxhias. Kamboxhia ka luftuar kundër imperializmit amerikan, por Huan Huaja pretendon se ajo lufton, gjithashtu, edhe kundër socialimperializmit sovjetik, domethënë bën një luftë në dy krahë (Kina bën luftë vetëm në një krah), ndërsa Vietnami nuk bën luftë kundër socialimperializmit sovjetik, por ka luftuar vetëm kundër imperializmit amerikan, kurse tash, sipas tij, ndihmohet edhe nga socialimperializmi sovjetik, edhe nga imperializmi amerikan. Këtej del konkluzioni se kjo luftë që ka shpërthyer në mes këtyre dy fqinjëve, është një luftë e kurdisur nga socialimperializmi sovjetik dhe nga imperializmi amerikan, kurse Kina s'u përzieka fare në të! «Kamboxhia ka të drejtë, pse është në luftë kundër socialimperializmit sovjetik dhe imperializmit amerikan, kurse Vietnami nuk ka të drejtë, për arsye se mbështetet nga të dyja superfuqitë».

«Jemi akuzuar, — thotë ministri, — se ne mbajmë anën e Kamboxhias, për shkak se një grup studentësh gjoja vunë disa dacibao, të cilat vëzhgoheshin dhe u zmadhuan nga gazetarët e huaj. Prandaj ne morëm masa dhe i hoqëm. Për këtë faji është yni, prandaj ne në asnjë mënyrë nuk duhet të shfaqim mendim hap-tazi për këto probleme, sepse na ngatërrojnë gazetarët e huaj, të cilët bëjnë vlerësime të gabuara pa vetëdije, sepse nuk e njohin të vërtetën». Por, për fat të keq të Huan Huasë, të vërtetën atyre ua jep Kina dhe ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse shkruajnë ato që shohin dhe dëgjojnë.

Më poshtë, për sa i përket Shqipërisë, Huan Huaja thotë diçka të madhe: «Kur ne, kinezët, të kemi një mendim për të thënë, s'është nevoja ta shprehim drejtpërdrejt, por të lëmë ta thotë një shtet i tretë, që të mos na marrin ne nëpër gojë, që të mos jemi ne ata që atakojmë qoftë Shqipërinë, qoftë Vietnamin». Çfarë tregon kjo? Kjo tregon hipokrizinë e madhe të kinezëve, tregon politikën e tyre të ndyrë, frikën për të thënë hapur të vërtetën. Ministri kinez këshillon të gjithë dëgjuesit se është mirë që ata ta mbajnë gojën të kyçur dhe ndaj çdo pyetjeje të njerëzve të huaj të thonë kurdoherë tri fjalë: «Nuk di gjë».

Pra, sipas Huan Huasë, kinezët, qofshin brenda, qofshin jashtë, duke përfshirë edhe diplomatët, duhet vetëm të informohen, të organizojnë rrjetin e spiunazhit, të blejnë dhe asgjë të mos shesin. Këtë e pohon vetë kryetari i diplomacisë kineze dhe ja se ç'thotë: «Nganjëherë ne duhet të bëjmë të njohura të dhëna të tilla, siç është rasti aktual i bandës së të katërve. Ne

kemi disa gjëra, të cilat nuk mund të bëhen të njohura drejtpërdrejt nga ana jonë, por ato ne mund t'i paraqesim nëpërmjet palëve të treta, nëpërmjet disa gazetave që janë relativisht në pozita miqësore ndaj nesh, duke i lënë ato të flasin, në vend që ta bëjmë ne vetë këtë punë. Kryerja e veprimeve në një mënyrë të tillë bën të mundur që të krijohet një opinion publik i ndërgjegjshëm. Kjo rrugë, — thëkson ai, — është një reklamim i lirë pa shpenzime. Ç'të keqe ka kjo?».

Kjo ka këtë të keqe: Kina bën një lojë hipokrite. Politika kineze është një politikë me dy faqe, një politikë revizioniste, renegate, një politikë dinake, që nuk guxon të thotë të vërtetën dhe mendimet që ka për njërën ose për tjetrën çështje ndërkombëtare. Kështu veproi ajo për një kohë të gjatë duke lënë me kuptue sikur ne (shqiptarët) ishim zëdhënësit e Kinës.

Prandaj bota nuk i beson dhe nuk do t'i besojë pikëpamjet e Kinës. Është kjo arsyeja që gazetatat e veta, të brendshme dhe të jashtme, ajo i mbush me çka thotë njëri e çka thotë tjetri, për të përgatitur opinionin kinez kundër shqiptarëve ose kundër atyre personave ose partive marksiste-leniniste që nuk u binden direktivave antimarksiste të krerëve revizionistë kinezë. Kështu vepron Kina edhe për problemet e tjera të mëdha ndërkombëtare, siç është, për shembull, problemi i Indokinës. Deri tash ajo nuk ka folur për problemin e këtij gadishulli, por Huan Huaja në këtë raport thotë se ka kërkuar dhe ka këshilluar që «të tri vendet e Indokinës të shtrohen në tryezë, të bisedojnë dhe, po të duan, mund t'i ndihmojnë edhe Kina në këtë punë». A është e vërtetë kjo? Nuk dihet, se udhëheqësit

kinezë janë kurdoherë hipokritë. Fakt është se ata nuk janë shtruar në tryezë për të biseduar me këto vende dhe mosshtruarja në tryezë ka një arsye të madhe, një arsye të dyfishtë, se nuk dëshirojnë që kamboxhianët të bisedojnë me vietnamezët dhe vietnamezët nuk pranojnë të bisedojnë me kamboxhianët, për arsye, thonë kinezët, se nuk i lë Bashkimi Sovjetik.

Konfliktin në mes Vietnamit dhe Kamboxhias, lidhur me çështjet territoriale dhe të sovranitetit shtetëror, ministri kinez e nxjerr shumë të vjetër. Sipas tij, mosmarrëveshjet kanë lindur që në kohën e pushtimit francez të Indokinës.

Para se të vijë në thelbin e problemeve, ministri i Jashtëm kinez bën historinë se si Lon Noli me njerëzit e klikës së tij rrëzuan Sihanukun; se si u krijua ushtria nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Kieu Samfani, që u hodh në luftë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe fitoi, çliroi vendin etj., etj. Huan Huaja pohon, gjithashtu, se në kohën e luftës kinezët dërguan instruktorë ushtarakë për të stërvitur trupat kamboxhiane, si dhe një grup këshilltarësh ushtarakë për të drejtuar luftën. Pra, kinezët kanë marrë pjesë dhe kanë udhëhequr luftën në Kamboxhia. Ai nuk harroi, gjithashtu, të thoshte se edhe vietnamezët hodhën në Kamboxhia dy divizione nga trupat e tyre luftarake. Këtë, thotë ai, ata e bënë në fazën e fundit për çlirimin e Pnom-Penit dhe, si pasojë, kryeqyteti i Kamboxhias u çlirua përpara rënies së Sajgonit. Mirëpo, sipas Huan Huasë, Vietnami u fry, mori poza arrogante dhe ka vepruar si një vëlla i madh, duke dashur që Kamboxhia të veprojë sipas urdhrave të tij. Me fjalë të tjera, sipas

kinezit, Vietnami kërkon ta gllabërojë Kamboxhian, prandaj kjo është arsyeja, ky është fakti që tregon se fajin e ka Vietnami.

Me gjithë unitetin në luftë kundër imperializmit, sipas ministrit të Jashtëm kinez, në marrëdhëniet midis këtyre dy vendeve, Kamboxhias dhe Vietnamit, ndërhyri edhe makina revizioniste sovjetike, së cilës nuk i pëlqente një unitet i tillë, prandaj edhe lindën mosmarrëveshjet midis tyre. Këtu ai bën një manovër tjetër mashtruese duke thënë se konflikti në mes Vietnamit dhe Kamboxhias është një konflikt «ideologjik», për arsye se kamboxhianët janë antisocialimperialistë dhe antiimperialistë, kurse vietnamezët janë vetëm antiimperialistë dhe jo antisocialimperialistë. Këtej ai del me konkluzionin se që të mund të arrish fitoren, duhet të jesh edhe antirevizionist, edhe antiimperialist. Sipas vetë vietnamezëve, thotë ky ministër, «antiimperializmi nuk përfshin antirevizionizmin». Këtë pikëpamje, shton ai, e paska mbrojtur, kur paska qenë në Kinë Ngujen Van Xhiapi dhe personalitete të tjera vietnameze si Fam Van Dongu, por kinezët e paskan hedhur poshtë!

Duke i ngatërruar gjërat në këtë mënyrë, me dashje, renegati Huan Hua bën demagogji dhe paraqet, pra, si mendim kinez konkluzionin se që të mund të arrish fitoren kundër imperializmit, duhet të jesh edhe antirevizionist edhe antiimperialist. Kjo është me të vërtetë një gënjeshtër me brirë dhe një përpjekje e madhe demagogjike e udhëheqjes aktuale revizioniste kineze për të mashtruar opinionin kinez e atë ndërkombëtar e, në rastin konkret, për të mashtruar kua-

drot që dëgjonin ministrin e Jashtëm, sepse, as Huan Huaja, as krerët e tij Ten-Hua e kompani, apo paraardhësit e tyre Mao-Çu, nuk kanë qenë kurrë seriozisht e në baza parimore të drejta marksiste-leniniste anti-amerikane e në të njëjtën kohë antirevizionistë e anti-imperialistë.

Pra, arsyet e konfliktit midis Kamboxhias dhe Vietnamit sipas ministrit të Jashtëm kinez, janë «ideologjike» dhe jo kontradiktat për çështjet territoriale e kërkesat për toka ndaj njëri-tjetrit. Por Kamboxhia ka arritur deri atje sa Sajgonin nuk e thërret më as me emrin «Ho Shi Min», që i kanë vënë vietnamezët, as Sajgon, por e quan me një emër tjetër, me të cilin do të tregojë se Sajgoni dhe gjithë Vietnamit i Jugut kanë qenë pjesë e Kamboxhias në kohën e perandorisë së saj. Deri këtu kanë arritur lakmitë territoriale të kamboxhianëve ndaj Vietnamit. Dhe këto lakmi të tyre mbështeten nga kinezët.

Si konkluzion, ministri i Jashtëm i Kinës thotë:

Së pari, se kinezët ua kanë thënë vietnamezëve dhe kamboxhianëve pikëpamjet e tyre, të cilat konsistojnë në atë që të tri vendet e Indokinës duhet të ndalojnë gjithë konfliktin e armatosur dhe përfaqësuesit e tyre të kthehen në tryezën e konferencës.

Së dyti, ai thotë që popujt e Indokinës kanë aspirata të përbashkëta. Duke qenë fqinjë prej shekujsh dhe, duke mos pasur konflikte shtetërore, ata duhet të bashkohen së toku dhe Kina është e gatshme të veprojë si ndërmjetëse.

Së treti, në luftën për të kundërshtuar agresionin e Imperializmit amerikan dhe për shpëtimin kombëtar,

Kina do t'u japë gjoja përkrahjen e vet të tre popujve të Indokinës! Po ashtu, deklaroi ai, Kina është e gatshme t'u japë këtyre tri vendeve të gjithë ndihmën e mundshme në ndërtimin demokratik socialist në periudhën e pasluftës!

Së katërti, «ne përkrahim Kamboxhian dhe qëndrimin e popullit të saj në kundërshtimin që ata u bëjnë revizionistëve socialimperialistë sovjetikë, dhe nuk mund të tolerojmë ndonjë ndërhyrje në sovranitetin e saj ose një invazion të territorit të saj nga socialimperializmi». Socialimperializmi nuk po e sulmon Kamboxhian, por me socialimperializëm kinezët kuptojnë Vietnamin. Natyrisht, ata përdorin kurdoherë formula të tërthorta. Huan Huaja vazhdon të pretojë se «ne do ta përkrahim Kamboxhian dhe popullin e saj me gjithë ndihmën tonë të mundshme, në të gjitha fushat e luftës, për ruajtjen e integritetit të territorit të saj dhe kundër ndërhyrjes në sovranitetin e saj». Kjo është e qartë: Kina vihet në anën e Kamboxhias, i jep asaj ndihma kundër Vietnamit.

Pasi flet për gjendjen e Sihanukut, i cili ka dashur të vejë në Kinë, se është i sëmurë dhe kinezët kanë dërguar një grup mjekësh në Kamboxhia për ta parë e për ta shëruar etj., etj., ministri i Jashtëm kinez shtron një çështje tjetër «e cila ka shumë rëndësi», vë në dukje ai. Është fjala për problemin e juridiksionit të ishujve të Detit të Kinës Jugore. Këta ishuj Kina i rivendikon dhe deklarën se këta kanë qenë dhe janë territore të saj. Në qoftë se nuk gabohem, këtë numër të madh ishujsh e kanë disa shtete. Një pjesë prej tyre e kanë kinezët; disa i kanë pushtuar indonezianët,

kurse disa të tjerë Filipinet. Pra në të tërë këta ishuj, ku, natyrisht, ka edhe prodhime deti, edhe plehra natyrale, kryesisht plehra zogjsh, nuk mungon as nafta. Kina pretendon se, që në kohët e lashta të perandorëve kinezë, ata kanë qenë ishuj të saj. Të gjitha këto arqipelage, thotë ministri i Jashtëm kinez, kanë qenë territore kincze, qysh nga kohët më të vjetra, bile arrin të thotë se i kujtohet që ka lexuar për të gjithë këta, kur studionte librin e gjeografisë në fëmijërinë e tij. Juridiksioni i ishujve Hsisha dhe Nansha, pohon ai, ka qenë në diskutim qysh në kohën kur vendet arabe, eksportuese të naftës, pas luftës së katërt të Lindjes së Mesme, nisën luftën e naftës, e cila shkaktoi krizën energjetike në botën kapitaliste. «Në këtë kohë, — tregon ai, — flota qeveritare e Ngujen Van Thieut zhvilloi luftime me ne për ishujt Hsisha dhe hëngri një dru të mirë. Tani trupat e Çan Kai Shisë janë stacionuar në ishujt Nansha, pra është më e saktë të themi, — vë në dukje ministri, — se ushtria e Çao Çun Çiaos po pushton disa nga këta ishuj, sepse Çan Kai Shia ka vdekur».

Ai vë në dukje se edhe Filipinet kanë pushtuar ishuj kinczë. Kështu ka bërë edhe Vietnami, prandaj përfundon se «sa për ishujt Hsisha, këta janë nën kontrollin tonë dhe neve nuk na bëhet vonë se vietnamezët vazhdojnë të pretendojnë se janë të tyre. Në shumë raste vietnamezët kanë kërkuar që ne të zhvillojmë bisedime me ta për problemin e ishujve Hsisha, po kemi refuzuar ne».

Është e qartë se kinezët refuzojnë të bisedojnë për ishujt Hsisha, kurse rekomandojnë që kamboxhia-

nët dhe vietnamezët, që kanë pretendime tokësore ndaj njëri-tjetrit, të venë në tryezën e bisedimeve dhe të thërrsin si kadi Kinën që t'ua zgjidhë këto mosmarrëveshje!

Ministri i Jashtëm i Kinës vete deri atje sa të thotë: «Në qoftë se Vietnami, duke mos marrë parasysh faktet historike, kryen një invazion kundër ishujve Hsisha, gjë që do të përbënte një provokacion kundër sovranitetit të Kinës, trupat tona kufitare, sipas urdhrorit të autoriteteve qendrore, do të shkulin me vendosmëri dhe përfundimisht çfarëdo trupash të huaja që do të invadojnë ose do të shqetësojnë këta ishuj». Këtë pikë ai e përfundon me thënien: «Ishujt Hsisha janë të Kinës, se fundi i detit është yni dhe ne, kinezët, në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që ai të shfrytëzohet nga kurrkush. Kjo (domethënë çështja e juridiksionit të këtyre ishujve) është e vendosur nga historia dhe këta janë tanët», ngul këmbë me fodullëk ministri i Jashtëm kinez.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim 1 brendshëm), nr. 10, f. 265

TIRADË E NDYRË ANTISHQIPTARE

Shënime

5 prill 1978

Dje shkrova për pikën e parë të raportit të Huan Huasë. Tash të vijmë te pika e dytë, te problemi i Shqipërisë. Këtë çështje ministri i Jashtëm kinez e trajton në mënyrë revizioniste, por gjoja teorikisht. Sipas tij, baza e mosmarrëveshjeve në mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Kinës, ka lindur në vitin 1971-1972 dhe kjo për arsye se Kina mbështet teorinë «e famshme» të «tri botëve» të Mao Ce Dunit, kurse Shqipëria është kundër kësaj teorie. Pastaj ministri i Jashtëm i Kinës fillon të tjerë tezën e bukur ala kineze, duke shpjeguar se kjo teori e Mao Ce Dunit qenka një plotësim i marksizëm-leninizmit dhe Mao Ce Duni paska formuluar i pari çështjen se nuk mund të shkohet në socializëm dhe në komunizëm pa u bashkuar me popujt e tjerë. Kjo është teza e përgjithshme. Sipas këtij ministri, Marksi dhe Lenini nuk pasqëshin parashikuar shumë gjëra, kurse Mao Ce Duni i parashikoi, dhe Huan Huaja merr përsipër t'i radhitë më poshtë ato që parashikoi Mao Ce Duni.

Ministri i Jashtëm kinez thotë se kontradikta e tyre

me Shqipërinë filloi që kur ne botuam në «Zërin e popullit» të datës 7 korrik 1977 artikulli «Teoria dhe praktika e revolucionit». Por ai nuk bën fare fjalë, përpara kuadrove që po u flet, se para botimit të këtij artikulli Partia e Punës e Shqipërisë kishte bërë një kongres të tërë, Kongresin e 7-të, në të cilin i kishte shtruar pikëpamjet e saj politike dhe ideologjike, si për «botën e tretë», ashtu edhe për unitetin internacionalist të proletariatit dhe të komunistëve. Këtë të vërtetë Huan Huaja ua fsheh dëgjuesve të tij. Ai nuk u foli fare atyre se Partia Komuniste e Kinës i kishte dërguar një letër pa firmë Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi gjoja kjo kishte sulmuar teorinë «gjeniale» të Mao Ce Dunit mbi «tri botët». Ky ministër shton se «Zhenminzhibao» (dhe jo Komiteti Qendror) iu shmang polemikës dhe ribotimit të artikullit të «Zërit të popullit», por thotë se në njëfarë materiali referativ u ribotuan disa pjesë. Se ç'pjesë u botuan, këtë ne nuk e dimë. Ne dimë atë që revizionistët kinezë nxjerrin një gazetë të brendshme për kuadrot, ku botojnë gjithçka flitet në shtypin e huaj nga reaksioni botëror kundër Shqipërisë dhe pro Kinës. Ministri i Jashtëm i Republikës Popullore të Kinës shton se «Ne jemi përgatitur të ribotojmë në «Zhenminzhibao» dhe në «Guanminzhibao», në kohën e përshtatshme, artikuj që dalin në shtypin e huaj me qëllim që të bëjmë sqarimet e nevojshme, për disa probleme, në një mënyrë të tërthortë». Me fjalë të tjera, ai pohon se do të vihen të tjerët të shprehin mendimin e Kinës. Kjo do të thotë që Kina ka gramafonë, të cilët i vë në lëvizje dhe i paguan të flasin për të, ashtu siç bën edhe për qëmtimin e të

gjitha qelbësirave të agjencive imperialiste të lajmeve kundër Shqipërisë dhe i vë ato të tëra në atë material referativ të brendshëm që u jep kuadrove.

Huan Huaja thotë se kryetari Hua dhe zëvendës-kryetari Ten kanë shpallur dhe kanë këshilluar që «tani për tani të mos botojmë artikuj për të hedhur poshtë publikisht pikëpamjet e gabuara të Partisë së Punës të Shqipërisë». Përse vallë këta zotërinj nuk guxojnë të shprehin publikisht pikëpamjen e tyre? Ministri thotë se, «duke vepruar në këtë mënyrë, ne shpresojmë të evitojmë zgjerimin dhe nxjerrjen në publik të mosmarrëveshjeve midis partive, nga njëra anë, kurse, nga ana tjetër, vazhdon ai, këtë taktikë e kanë përdorur edhe Liu Shao Çia dhe Mao Ce Duni». Kjo tregon qartë se pikëpamjet e tyre, siç e ka vënë në dukje Partia jonë, për një kohë shumë të gjatë, janë revizioniste, liberale, pajtuese. Këto pikëpamje flasin për një bashkëzistencë paqësore, ideologjike dhe politike me armiqtë e marksizëm-leninizmit.

Në qoftë se revizionistët kinezë nuk flasin haptazi kundër nesh, kjo tregon se ata nuk kanë argumente për të na luftuar dhe këtë e mbulojnë me shpresën që të evitojnë zgjerimin dhe nxjerrjen në publik të mosmarrëveshjeve. E ç'fituan ata që nuk i nxorën publikisht mosmarrëveshjet me Bashkimin Sovjetik? S'fituan asgjë, veç që u shua iluzioni se ata do ta futnin në kurthin e tyre Bashkimin Sovjetik. Huan Huaja, diku në fjalimin e tij, e shtron përsëri këtë problem, kur thotë se shpresojnë që Shqipërinë ta kthejnë përsëri në rrugën e tyre!

Megjithatë, ministri i Jashtëm i Kinës nuk lë pa

theksuar se nga të gjitha këto që po ngjasin, e sidomos nga problemi i Shqipërisë, është brengosur populli kinez, i cili ka shprehur shqetësimet e tij për këto mosmarrëveshje. «Ç'po ngjet kështu?» thonë kuadrot në Kinë. «Pse Shqipëria, mikja jonë e madhe, të dalë kundër nesh?». Këto i pohon ministri i Jashtëm i Kinës. Këtë situatë, sipas Huan Huasë, kinezët e quajnë një «javë të zezë», se thonë që «një mik në Jug u burgos (është fjala për Zylfikar Ali Buton¹), një shok armësh në Perëndim u bë armik (Shqipëria) dhe një kodosh (Fan Yuan Yeni) kaloi në anën e kundërshtarëve tanë. Me Vietnamin u ftohëm». Atëherë, përse ngjasin këto? — pyesin ata. «Ka ardhur koha, thotë ministri i Jashtëm kinez, që pozita dhe pikëpamja e tyre, e ndër-gjegjshme apo e pandërgjegjshme, të peshohet me kujdes nga ana jonë». Vetëm se Huan Huaja i qorton dëgjuesit e të gjithë ata njerëz që habiten nga kjo politikë që ndjek Kina dhe thotë: «Përse nuk folën ata për situatat e shkëlqyera dhe për njoftimet inkurajuese, por flasin për ato demoralizuese, që ndodhën në korrrik?». Sipas Huan Huasë njerëzit duhet të flasin dhe publiku kinez duhet t'i ekzaltonte masat represive që mori diktatura borgjeze kapitaliste kineze e Hua Kuo Fenit kundër elementit përparimtar në Kinë.

Ministri i Jashtëm kinez pohon se në çështjen shqiptare punët kanë marrë një rrugë të tillë sa që një gazetë në Jugosllavi, në shtypin e së cilës bazohet Kina, ka botuar një artikull me të cilin bën të njohur se Shqipëria do të flakë tutje disa marrëveshje të bashkë-

1. Ish-kryeministër i Pakistanit.

punimit teknik midis Kinës e Shqipërisë dhe nuk do të vazhdojë zbatimin e marrëveshjeve lidhur me dërgimin e teknikëve kinezë për të ndihmuar në ndërtimin dhe në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Kështu duket dhe lihet të kuptohet se Shqipëria dëshiron që Kina të tërheqë nga vendi ynë teknikët që ka dërguar. Ja burimi i informatave «të sakta» të qeverisë kineze për mendimet e qëndrimet tona! Jugosllavia është bërë për Kinën e Hua Kuo Fenit informatori më i mirë për të nxitur kontradiktat midis Kinës dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë; ajo është vënë tamam në ato pozita që i përshtaten Titos për të intriguar dhe për ta bërë Kinën të bindet se Partia e Punës e Shqipërisë është në pozita oportuniste e armiqësore ndaj Kinës. Edhe gazeta të tjera të huaja, pohon Huan Huaja, kanë folur, por, sipas tij, nuk kanë arritur t'i grumbullojnë të gjitha këto materiale. Por ai gënjen, sepse Kina ka një divizion të tërë njerëzish në Ministrinë e Jashtme dhe në HSINHUA që jo vetëm i grumbullojnë këto të dhëna nga gazetat e ndryshme të botës, por edhe i klasifikojnë, dhe, ato që u nevojiten për vijën e tyre, ua servirin kuadrove t'i hanë. «Prandaj, — thotë Huan Huaja, — ka ardhur koha që ne të shmangim konfuzionin e panevojshëm». Kjo shprehje tregon se në opinionin kinez ka një konfuzion të thellë politik për këto çështje, veçanërisht për kontradiktat në mes Shqipërisë dhe Kinës.

Huan Huaja vë në gojë të njerëzve kinezë fjalët që gjoja ata thonë: «Përse i dhamë najlonin Koresë, përse bëmë strehime moderne në Shqipëri dhe topat e mortajat tona i dërguam në Vietnam dhe në Kamboxhia du-

ke thithur kështu gjakun dhe djersën e popullit tonë?» etj., etj.

E çfarë strehimesh moderne paskan ndërtuar kinezët në Shqipëri?! Asgjë, asnjë strehim! Strehimet në vendin tonë janë bërë me duart tona, me djersën tonë, prandaj ky revizionist vë në gojën e popullit kinez gjëra të paqena për të treguar pikërisht se këto ndihma që u janë dhënë qoftë Koresë, qoftë Vietnamit, qoftë edhe Shqipërisë, janë dhënë që ne t'u bindeshim kinezëve, të ndiqnim politikën antimarksiste dhe kundërrevolucionare të tyre. «Kështu thotë populli kinez», bërtet Huan Huaja. «Tash ne, — vazhdon ai, — mund të themi se kemi harxhuar gjakun dhe djersën e popullit tonë pa siguruar miqësinë e këtyre tri vendeve». Del qartë se ndihma e dhënë nga qeveria kineze dhe nga e ashtuquajtura Parti Komuniste e Kinës ka pasur qëllime të tjera dhe aspak internacionaliste.

Pasi i vë në dukje të gjitha këto gjëra, Huan Huaja bën pyetjen: «Përse Shqipëria është kthyer kundër nesh?». Dhe për ta shpjeguar këtë ai fillon të bëjë një «teori» të gjatë për revolucionin, për kundërrevolucionin, për nevojat e diskutimeve e të bisedimeve dypalëshe e shumëpalëshe, të cilat, në fakt, kinezët s'i kanë dashur kurrë. Ai thotë se «qysh nga Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Shqipëria, duke qëndruar më me vendosmëri në anën e leninizmit, është bashkuar me Kinën në fushatën kundër revizionizmit». Ky gabohet, se ne nuk e kemi kundërshtuar hrushovizmin pas Kongresit të 22-të. Partia jonë me fakte dhe me dokumente vërteton, se ajo ka mbajtur qëndrim kundër hrushovizmit shumë më shpejt

dhe lufta e hapët kundër hrushovianëve nuk ka filluar pas Kongresit të 22-të. Huan Huaja i konfondon qëndrimet tona me ato të Kinës, që janë dukur pas Kongresit të 22-të. Por edhe këto kundërshtime të udhëheqjes kineze nuk kanë qenë të vendosura, përkundrazi, ato kanë qenë vetëm presione që u bësheshin sovjetikëve e jo për të mbështetur Shqipërinë dhe marksizëm-leninizmin, por për qëllime të tjera.

Ky renegat revizionist u thotë kuadrove se Partia e Punës e Shqipërisë «mësoi shumë» nga Kina për revolucionin në arsim, për shpalljen e Revolucionit Kulturor etj. Në të vërtetë, masat që ka marrë Partia jonë për revolucionarizimin e jetës së vendit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të frymëzuara nga Partia Komuniste e Kinës. Ato ishin rrjedhim i natyrshëm i zhvillimit të shoqërisë socialiste në vendin tonë, i thellimit të teorisë marksiste-leniniste në kushtet e reja që krijoheshin te ne, ishin një proces i gjatë i veprimtarisë marksiste-leniniste të Partisë sonë që krijonte mundësi, shkallë-shkallë, për t'u marrë vendime dhe masa kurdoherë më të përparuara për konsolidimin e atdheut socialist dhe për kalitjen e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Të gjitha këto veprime të drejta të Partisë së Punës të Shqipërisë revizionistët kinezë duan t'i paraqesin sikur ne i kemi huajtur nga Partia Komuniste e Kinës. Kur ne marrim një eksperiencë të mirë nga partitë motra marksiste-leniniste, këtë nuk e mohojmë, por fakti është se nuk janë veprimet e Partisë Komuniste të Kinës që na kanë udhëhequr ne të merrnim vendime të drejta për vendin dhe për Partinë tonë. Dhe është

fakt se Partia Komuniste e Kinës, me masat që gjoja mori ajo në Revolucionin Kulturor, siç e kam shpjeguar gjerë e gjatë, nuk ka qenë në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Këtë e vërtetoi koha në periudhën e mëvonshme.

Huan Huaja, ky renegat antimarksist, pasi i lëshon këto gjëra, arrin të shpifë, gjithashtu, se pas këtyre masave Partia e Punës e Shqipërisë ka lënë në harresë ngritjen teorike marksiste-leniniste të komunistëve dhe të masave. Kjo, sipas tij, do të thotë që ne të pranojmë se gjithë kjo eksperiencë që gjoja paska marrë Shqipëria nga Kina nuk ishte zbatuar në bazë të teorisë marksiste-leniniste. Sipas këtij renegati, ne nuk ishim për forcimin e teorisë marksiste-leniniste, për arsye se paskemi lënë në harresë përgatitjen teorike marksiste-leniniste të kuadrove dhe të punonjësve tanë dhe nuk paskemi mundur të zgjidhim divergjencat ideologjike brenda në parti dhe të ndërmarrim fuqimisht një luftë ideologjike që të synonte të kuptuarit e thelbit të problemeve, si dhe të arritjes së një uniteti të ri kamcratesk nën marksizëm-leninizmin!

Më poshtë ky sharlatan thotë se ne gjoja nuk paskemi ditur që kontradiktat joantagoniste t'i trajtonim si të tilla, por i paskemi kthyer ato në kontradikta antagoniste, duke diskredituar në këtë mënyrë disa anëtarë partie, «komunistë të shquar», dhe duke i shkaktuar dëme Partisë. Me këtë revizionistët kinezë, në mënyrë të hapët marrin në mbrojtje tradhtarët B. Balluku, P. Dume e A. Këllezi. Për këtë të fundit theksojnë se ishte edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Kinë.

Në një vend të fjalës së tij ministri i Jashtëm kinez thotë se ne kemi studiuar, gjithashtu, materialin për Petrit Dumen (përmend edhe dy kuadro të mirë).

Po ç'janë këto materiale për të cilat ne nuk dimë gjë? Do të shohim. Me siguri Beqir Balluku dhe Petrit Dumja do t'u kenë dhënë gjë dhe me to jugosllavët përgatitin materiale të shumta kundër atyre që u leverdis t'i diskreditojnë dhe ua servirin kinezëve. Revizionistët kinezë, në miqësi të ngushtë me ata jugosllavë dhe duke pasur besim të plotë në gjithçka që u thonë këta të fundit, i marrin gënjeshtat për të vërteta.

Huan Huaja thotë: «Për të mbrojtur interesat e kauzës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare në tërësi, si dhe miqësinë vëllazërore midis Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë nga pozitat e kauzës së lëvizjes komuniste ndërkombëtare, mund t'u parashtrijmë shqiptarëve disa pikëpamje të ndryshme. Është çështje tjetër pastaj nëse ata i pranojnë mendimet tona apo jo, por ne do t'i paraqesim pikëpamjet tona lidhur me fjalimin e Haxhi Lleshit, bile edhe sikur kjo të minojë miqësinë kino-shqiptare».

Se ç'është ky fjalim i Haxhi Lleshit, unë nuk e kam parasysh, por Haxhi Lleshi s'ka folur kurrë haptazi kundër Kinës. Vetë kinezët në asnjë mënyrë dhe asnjëherë nuk kanë bërë më të voglën vërejtje për ndonjë fjalim të shokëve tanë. Ne e presim këtë parashtrim në lidhje me fjalimin e Haxhi Lleshit, por është e kuptueshme se ky parashtrim nuk do të vijë kurrë.

Pas kësaj tirade kundër nesh, Huan Huaja fillon pastaj të flasë «teorikisht». Në se konsiston kjo «teori»? Kjo konsiston në mburrjen e Mao Ce Dunit, i cili «e

çoi marksizmin përpara». Dhe përse e çoi përpara marksizmin? Sepse «zbuloi dhe demaskoi revizionistët sovjetikë». «Këtë gjë, — thotë ai, — nuk mund ta bënte as Marksi dhe as Lenini, për arsye se revizionistët sovjetikë nuk ekzistonin në kohën e tyre»! Një budallallëk të tillë kaq të madh sa Himalaja, vetëm kinezët mund ta lëshojnë. Kjo do të thotë se ky njeri mohon luftën e Marksit dhe të Leninit kundër revizionistëve. Nëse revizionistët e paskan emrin Hrushov, Malenkov, Brezhnjev, Mao Ce Dun, Kautsk apo Bernshtajn e të tjerë, për ta nuk ka rëndësi; rëndësi ka vetëm që veten e vet ta vënë mbi Marksit dhe mbi Leninit.

Pra, kinezët vazhdojnë të thonë se teoria e Marksit vërtet nuk është një dogmë, por ai që e paska zhvilluar më tej këtë teori na qenka Maoja! Huaja tregon se në Kinë paska një legjendë sipas së cilës një perëndeshë e qiellit, e quajtur Taoist, i dha dikujt një libër me përmbajtje të pakuptueshme. Me këtë ai do të tregojë rëndësinë e praktikës si burim i lindjes dhe i zhvillimit të teorisë dhe thotë: «Ne pohojmë se praktikat revolucionare të Marksit, Engelsit dhe Leninit krijojnë bazat themelore të marksizëm-leninizmit» (sikur na tregon me këtë ndonjë gjë të madhe!).

Ai do të thotë se tani që ka dalë në shesh revizionizmi hrushovian, kjo ishte një përvojë e madhe, nga e cila Mao Ce Duni gjoja ka nxjerrë mësim të vlefshme dhe zhvilloi më tej marksizëm-leninizmin. Maoja, sipas tij, ka nxjerrë një mësim historik të dhimbshëm nga kthesa sovjetike e revolucionit nën diktaturën e proletarietit.

Në mes këtyre thënieve të habitshme nxjerr më

së fundi kokën ajo që dëshiron ai të vërë në dukje dhe ta lidhë diçka me Shqipërinë, kur thotë se divergjencat midis Kinës dhe Shqipërisë aktualisht përqendrohen në nevojën për t'u bashkuar me «botën e tretë» dhe nëse «bota e tretë» duhet ndarë ose jo në tri kategori. Dhe pas kësaj fillon shpjegimin e mirënjohur nga ne për sa i përket kësaj teorie antimarksiste që nuk do të ndalem ta shpjegoj edhe një herë.

Për këtë çështje ministrit të Jashtëm të Kinës «i vjen keq» që Partia e Punës e Shqipërisë, meqë nuk mbron teorinë e «tri botëve» të Mao Ce Dunit, ka bërë «regres» dhe ka kaluar në «oportunizëm». Ai shton se «të nisur nga dëshira e mirë e partisë dhe e qeverisë sonë, ne shpresojmë se pa kaluar shumë kohë shqiptarët do të largohen nga ky qëndrim, do të rikthohen në parimet e drejta marksiste-leniniste dhe do të bashkohen e do të luftojnë së bashku me ne si edhe më parë».

Për ne është e ditur se nuk do të bashkohemi kurrë me këta revizionistë të poshtër dhe, në qoftë se kemi luftuar së bashku me kinezët për një kohë, këtë e kemi bërë për arsye se ata paraqiteshin kundër revizionizmit hrushovian. Kuptohet se kinezët hiqeshin sikur këtë kundërshtim e bënin duke u nisur nga pozitivat marksiste-leniniste, përndryshe ne do të kishim qenë në luftë me ta, sikurse jemi.

Te ky renegat nuk mungon të nxjerrë përpjetë veshët e gomarit edhe ndjenja e shtetit të madh, kur thekson se «populli shqiptar është i vogël, më pak se një e treta e popullsisë së Pekinit». Me këtë ai do të tregojë se s'ka ç'bën Shqipëria me kundërshtimin ndaj

një populli kaq të madh prej 800-900 milionësh. Ai s'mungon të thotë se «ne do të bëjmë përpjekje të mëdha ta fitojmë Shqipërinë në anën tonë dhe do të mundohemi të mos keqësojmë divergjencat në mes dy partive». Ministri kinez flet për një shtet të pavarur si për një lojë futbollit që mund të fitohet nga ana e tyre.

Duke vënë në dukje se divergjencat ndërmjet të dy palëve kanë filluar në vitet 1971 e 1972, Huan Huaja nxjerr çështjen e vizitës së Niksonit në Kinë dhe pretendon se për sa i përket kësaj vizite, ata na paskan vënë në korent me hollësi që përpara! Kuadrove që ka përpara, ai u lë të kuptojnë sikur për këto bisedime që kanë bërë me kreun e administratës amerikane ne paskemi qenë dakord me ta. Në të tilla pozita shpifarrake ndodhen këta revizionistë, por asgjë nuk na çudit. Ata i kanë gënjyer dhe do t'i gënjejnë vazhdimisht kuadrot dhe popullin kinez.

Ministri i Jashtëm kinez bën një tiradë të gjatë për t'u mbushur mendjen dëgjuesve sikur gjoja ne kërkojmë nga Kina që kjo të na informojë për çdo gjë. Një gjë e tillë s'është e vërtetë, përkundrazi, është një shpifje. Ne e kemi fjalën për atë që duhet thënë dhe që është shkruar në deklaratën e përbashkët që kemi nënshkruar me Çu En Lain, sipas së cilës për çështjet e mëdha politike ne duhet ta vëmë njëri-tjetrin në dijeni më përpara. Këtu qëndron ajo që ne duam të respektohet dhe çështja nuk qëndron tek ajo që pretendon Hua Kuo Feni ose Huan Huaja në raportin përpara kuadrove. Ky i fundit thotë: «Mos vallë ne duhet t'i vëmë shqiptarët më përpara në dijeni për çdo gjë? Mos donin shqiptarët që për hir të shkëmbi-

nit të informacionit të këshilloheshim me PPSH në përpara për kohën e saktë të arrestimit të bandës së katërve më 6 tetor 1976? Pse, — vazhdon ai, — nuk na vunë edhe ne në korent më përpara se t'i dërgonin në gjyq Beqir Ballukun, Abdyl Këllezin e të tjerë, po na informuan për këtë jugosllavët?». Ja, edhe këtu lalin përsëri revizionistët jugosllavë.

Por faktet nuk janë kështu. Ne në asnjë mënyrë nuk kemi kërkuar që Kina të na vinte në korent për peshtjet e saj të brendshme. Kinezët nuk na vunë hiç në korent për kundërshtimin që kishin me «bandën e katërve», bile ata na akuzojnë ne se gjoja kishim pasur gisht me këtë «bandë» që këta të merrnin fuqinë në Kinë. Kjo është një shpifje trashanike dhe një përvojë për të mbuluar planin komplotist të Çu En Lait dhe të Beqir Ballukut për të rrëzuar udhëheqjen shqiptare dhe për ta lidhur Shqipërinë me Jugosllavinë dhe me Rumaninë nëpërmjet traktateve «miqësore». Nuk është aspak e vërtetë që ne nuk i paskemi vënë në korent kinezët për tradhtinë e Beqir Ballukut, të Petrit Dumes e të tjerëve. Përkundrazi, ambasadorin kinez në Tiranë ne e kemi thirrur që përpara në Komitetin Qendror dhe shoku Hysni Kapo e ka vënë atë në dijeni, bile me hollësi, për punën armiqësore të Beqir Ballukut dhe të shokëve të tij. Gënjeshtër, pra, është në rend të ditës te revizionistët kinezë për të nashtruar kuadrot dhe popullin.

Për sa i përket kërkesës sonë për të dërguar në Kinë një delegacion të nivelit të lartë, udhëheqësit kinezë edhe për këtë me paturpësinë më të madhe shpillin sikur ata na paskan ftuar ne të dërgonim një de-

legacion në Pekin, por ne nuk paskemi dashur. Bile ata na paskëshin kërkuar shumë herë që të venin atje shokë me përgjegjësi të lartë partie e qeverie dhe të shpjegoheshin për mosmarrëveshjet që ekzistonin në mes dy vendeve e dy partive tona! Edhe kjo është, gjithashtu, një tjetër gënjeshtër me bisht. Ata shtojnë se që përpara vdekjes së Çu En Lait ky na paskësh thënë: «Meqenëse delegacioni qeveritar shqiptar nuk po vjen në Pekin, atëherë do të shkoj unë në Tiranë dhe do të bisedoj me shqiptarët për të sheshuar divergjencat». Deri këtu arrin mashtrimi i tyre!

Me pak fjalë, kur Huan Huaja, ky armik i Shqipërisë, i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit, flet për vendin tonë, përdor të gjitha njetet e trockistëve.

Mjeti kryesor për kinezët është mashtrimi dhe shtrembërimi i së vërtetës. Nga ana e kinezëve i bëhet një shtrembërim i hapët së vërtetës në çështjen e luftës së Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit modern. E kam fjalën për fillimin e kësaj lufte kundër revizionizmit hrushovian nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Kinezët e trajtojnë çështjen sikur janë ata të parët që e kanë zbuluar këtë plagë të madhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Por faktet qëndrojnë ndryshe. Nuk janë aspak kinezët që i kanë zbuluar e i kanë luftuar të parët hrushovianët, por ka qenë Partia e Punës e Shqipërisë ajo që është ndeshur e para me këta armiq. Ata as që mund t'i zbulonin hrushovianët, për arsye se ishin vetë kundër marksizëm-leninizmit, ishin kundër Leninit dhe kundër Stalinit, ishin pro renegatëve hrushovianë, të cilët i mbështetën. Ata u vunë në opozitë me hrushovianët vetëm

kur e panë se nuk mundën të përmbushnin qëllimet e tyre.

Çështja tjetër është se kinezët përpiqen «të vërtetojnë» që ne paskemi devijuar nga marksizëm-leninizmi dhe jemi në pozita oportuniste, për arsye se nuk pranojmë teorinë e «tri botëve» të «marksist-leninistit të madh», «timonierit të madh», Mao Ce Dunit. Këtë s'ka nevojë ta shpjegoj. Të gjitha këto janë nga kreu në fund gënjeshtër.

Udhëheqësit kinezë përpiqen ta paraqesin situatën në të kundërtën e saj, domethënë, kërkesën me shkrim të Komitetit tonë Qendror, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, që të dërgonim një delegacion partie dhe qeverie në Pekin për të shpjeguar me kinezët kontradiktat, të cilat kishin filluar të dilnin në shesh me kohë, e paraqesin sikur janë ata që e paskan bërë dhe paskan kërkuar të dërgonim në një delegacion në Kinë, por ne nuk paskëshim pranuar! Dokumentet që disponohen kundër kësaj shpifjeje nuk mund t'i rrëzojë dëshmia e rreme për dëshirat e Çu En Lait para vdekjes.

Një gjë tjetër me rëndësi që del këtu, është se revizionistët kinezë, tok me Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Abdyl Këllezin dhe tradhtarë të tjerë, kanë komplotuar kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kundër marksizëm-leninizmit në vendin tonë. Në krye të këtij komploti ka qenë Çu En Lai. Parashikimet tona i vërtetoi me gojën e tij ministri i Jashtëm i Kinës, kur thotë se këto kanë qenë kontradikta joantagoniste, por paskëshim qenë ne ata që i kthyer në kontradikta

antagoniste. Shpjegim të bukur u ka bërë ministri i Jashtëm kinez qindra kuadrove që ka pasur përpara!

Për sa i përket tjerrjes së teorisë së «tri botëve» e të revolucionit, edhe një herë tjetër ky renegat, ky shërbëtor i borgjezisë, e trajton problemin në mënyrë të atillë që në kohën aktuale na qenka e domosdoshme që proletariati botëror të bëjë aleancë të ngushtë me borgjezinë, për të luftuar gjoja imperializmin dhe hegjemonizmin. Dhe, në këtë luftë kundër dy imperialistëve, ai gënjen e mashtron. Në realitet këtë mashtrim e kuptojnë kuadrot kinezë, pse çdo ditë, çdo mëngjes «Zhenminzhibao» gërthet se ekziston vetëm një armik i rrezikshëm dhe ky është socialimperializmi sovjetik.

Veç kësaj, populli kinez e shikon vetë që Kina po bën allishverishe të mëdha politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake me imperializmin amerikan dhe me gjithë imperialistët dhe kapitalistët e botës, nga janë e nga s'janë. Ato që flet Hua Kuo Feni dhe praktika e sotme kineze vërtetojnë pikërisht çfarë pikëpamjesh teorike mbështet udhëheqja kineze. Kjo praktikë tregon se teoria kineze është teori revizioniste, është pjesë e ideologjisë së kapitalizmit, e cila po përhapet në Kinë për të sjellë në fuqi një diktaturë të egër ushtarake.

Këto përmban përmbledhja e fjalës së Huan Huasë. Por ka edhe 3 pjesë të tjera, të cilat nëse do t'i kemi, atëherë do të gjykojmë globalisht. Aktualisht, duke studiuar problemet e para të kompleksit të këtij dekalogu, mund të themi se këto pikëpamje janë të kinezëve dhe duhet t'i ketë shprehur Huan Huaja. Aty duken stili i tyre, mendimi i tyre, mënyra e tyre e të

trajtuarit të çështjeve. Kinezët përdorin atë mënyrë veprimi që mbrojti Huan Huaja në fjalën e tij. Ata nuk i botojnë në gazetatat e tyre pikëpamjet që kanë, por i shtrojnë me kuadrot, pastaj ua japin miqve të tyre borgjezë jashtë, sikur këto kanë dalë gjoja padashur, në mënyrë të fshehtë. Dhe borgjezia i shtyp në gazetatat e saj. Kinezët, pra, i bëjnë punët tërthorazi siç e përcakton Huan Huaja. Kështu vepron Partia Komuniste e Kinës.

Së pari, duhet thënë që për ne kjo taktikë që ndjekin kinezët ka edhe «një të mirë», për arsye se bota i mëson pikëpamjet e tyre dhe gjykon. Ne mendojmë se gjykimi i opinionit botëror do të jetë në favorin tonë, sepse pikëpamjet kineze janë të gënjeshtërtat, janë pa baza.

Së dyti, një metodë e tillë kineze na jep mundësi neve që jo tërthorazi, por drejtpërdrejt, të publikojmë materialet tona dhe atëherë kinezët do të gjenden me të vërtetë në fund të pusit dhe do të mbyten në llumin revizionist, në llumin e tradhtisë ku janë duke u zhytur çdo ditë e më thellë.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 283

STRATEGJI PA MASKA

Shënime

11 prill 1978

Nga të gjitha ngjarjet që kanë lidhje me politikën kineze dhe nga konstatimet që kam shkruar, në vija të përgjithshme, mund të bëjmë edhe një herë disa shënime për strategjinë kineze.

Në përgjithësi strategjia kineze është dominuar nga pikëpamjet eklektike, jomarksiste të Mao Ce Dunit. Këto pikëpamje politike të tij për problemet ndërkombëtare frymëzoheshin nga një ideologji e shkurtisur borgjezo-revolucionare, por jomarksiste-leniniste. Politika e Mao Ce Dunit ka qenë një politikë e lëkundshme. Ky personalitet kinez huazonte mjaft mendime nga teori të ndryshme dhe arriti të kombinonte një pikëpamje dhe një strategji të tij të veçantë që duhej t'i përshtatej një shteti të madh kinez. Ky shtet i madh, sipas tij, duhej të mos u ngjiste as demokracive perëndimore, as sovjetëve të themeluar nga Lenini, por të ruante traditat e tij kineze aziatike dhe të formonte një individualitet dhe autoritet të tillë që të paktën të influenconte, në mos të drejtonte gjithë politikën, në radhë të parë në Azi dhe pastaj në kontinente të tjera.

Pas krijimit të Bashkimit Sovjetik me Leninin dhe me Stalinin në krye, Partia Komuniste e Kinës, dhe më vonë shteti i «demokracisë së re kineze», siç e quan Mao Ce Duni, nuk dolën në mbështetje të plotë të shtetit të parë socialist në botë. Në themel të këtij shteti të ri kinez të «demokracisë së re» ose në formimin dhe në konsolidimin e Partisë Komuniste të Kinës nuk u panë të kristalizoheshin idetë e Leninit dhe të Stalinit. Gjatë kësaj periudhe shohim se Mao Ce Duni, që udhëhiqte Partinë Komuniste të Kinës dhe shtetin kinez, tok me grupet e tij (se nuk mund të themi që në Kinë ekzistonte vetëm një grup) mbanin një pozitë të tillë neutraliteti në të cilën dukej njëfarë «pavarësie» mikroborgjeze ndaj teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit dhe njëfarë përcmimi ndaj shtetit të parë socialist në botë, Bashkimit Sovjetik.

Maoja, për të mos u demaskuar, nuk mund të shkonte më tutje në qëndrime të hapëta kundër teorisë marksiste-leniniste dhe shtetit të sovjetëve. Vetëm se rruga që po merrte nuk i ngjiste aspak asaj të Leninit dhe të Stalinit dhe teoria që e udhëhiqte shtetin e ri kinez nuk bazohej në teorinë marksiste-leniniste mbi shtetin. Kjo ishte diçka «origjinale».

Ne shohim se gjatë kohës së aleancës së Partisë Komuniste të Kinës me Guomindanin, e më vonë pas prishjes me të, si dhe gjatë mosmarrëveshjeve me Kominternin, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, në radhë të parë, kishin një simpati të veçantë për demokracinë borgjeze amerikane dhe rreth e rrotull vetes mbanin të dërguar të Uashingtonit, të maskuar këta nën petkat e gazetarëve ose si emisarë të tjerë. Sipas mendimit tim,

ekzistonte, pra, një simpati e veçantë dhe më e theksuar e Maos dhe e Çusë për «demokracinë» amerikane, sesa për sovjetët.

Gjatë gjithë luftës nacionalçlirimtare të Kinës nuk u ndërpre në lidhjet e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait me imperializmin amerikan në ato forma që thashë më lart. Kështu në Uashington ekzistonte lobia pro Maos, siç ekzistonte edhe lobia pro Çan Kai Shisë. Kjo e fundit, natyrisht, ishte më e fuqishme. Në fund të fundit marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Maon dhe me Çunë në pragun e çlirimit dhe pas çlirimit nuk u manifestuan aq të gjalla e substanciale. Ato, si me thënë, mbetën në heshtje. Gjatë viteve të para të çlirimit u duk sikur Kina anonte më tepër nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse si Mao Ce Duni, edhe Çu En Lai, kishin kontradikta dhe pakënaqësi nga ai. Këto pakënaqësi ishin mbeturinat e pikëpamjeve të rrënjosura në kokën e tyre sikur Kominterni kishte gabuar dhe ishte përpjekur që Kina të zhvillohej nën drejtimin e Bashkimit Sovjetik.

Kur u çlirua Kina, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai menduan se kishin pasur mendime të drejta, për arsye se lufta u fitua. Ata e nënvleftësonin faktin se lufta u fitua jo vetëm me përpjekjet e popullit kinez. Në këtë fitore ka ndikuar edhe thyerja e Japonisë nga forcat e koalicionit sovjeto-amerikan. Këtë fakt kinezët nuk e injoronin dot, por ata mbivlerësonin luftën e tyre.

Pas çlirimit Mao Ce Duni dhe Çu En Lai, jashtë dëshirës së tyre dhe të detyruar nga rrethanat e fitores kolosale të Bashkimit Sovjetik në thyerjen e Gjermanisë naziste dhe të Japonisë militariste, sa që gjallë

Stalini, mendoj se mbajtlën një qëndrim të moderuar prosovjetik. Domethënë strategjia e re e Mao-Çusë orientohet nga Bashkimi Sovjetik. Ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kapitalizmit botëror ata, me dashje ose pa dashje, të detyruar nga rrethanat, i adaptoheshin strategjisë staliniane. **Kur vdiq Stalini, u dukën qartë te Mao-Çuja pikëpamjet shoviniste e antiso-vjetike dhe ndjenjat e shtetit të madh kinez.**

Mao-Çuja ishin kundër Stalinit e kundër Partisë Komuniste të Lenin-Stalinit; ata ishin kundër politikës, ideologjisë dhe organizimit të saj. Por këtë qëndrim nuk e manifestonin atëherë. Pas vdekjes së Stalinit dhe pas përgatitjes së terrenit për puçin e organizuar nga revizionistët hrushovianë, gjendja shpirtërore e Mao-Çusë ishte në hare. Ata shihnin një dobësim të theksuar që po i shkaktohej Bashkimit Sovjetik dhe shenjat se kishte ardhur në fuqi në këtë vend një grup, i cili do të ndiqte një politikë që u shkonte për shtat këtyre dy udhëheqësve kinezë. Sipas mendimit tim, ky është një moment kyç, që pikëpamjet revizioniste të Mao-Çusë u puçën me komplotin revizionist të përgatitur nga hrushovianët në Bashkimin Sovjetik. Faktet treguan që hrushovianët patën mbështetjen e Mao-Çusë në komplotin e tyre.

Këta të dy menduan se, me dobësimin e Bashkimit Sovjetik, kur hrushovianët hodhën në dorë pushtetin politik dhe deformuan ideologjinë marksiste-leniniste, revizionistët sovjetikë do të kërkonin mbështetjen e të gjitha shteteve të tjera socialiste e të partive marksiste-leniniste të botës, një nga të cilat, më kryesorja dhe më vendimtarja, siç mund të mendonin Mao-

-Çuja, ishte Partia Komuniste e Kinës dhe shteti i «demokracisë së re kineze».

Hrushovi diti të manovronte në këtë situatë. Ai diti të gënjente dhe të bashkonte pas vetes partitë komuniste të botës dhe Partinë Komuniste të Kinës, kurse me Partinë e Punës të Shqipërisë nuk pati sukses. Hrushovianët shihnin se te Partia jonë dhe tek udhëheqja e saj nuk do të gjenin atë mbështetje që gjetën që në fillim te partitë e tjera komuniste. Këtë gjë revizionistët sovjetikë e ndien shpejt, por e nënvlehtësuan. Për ta, duke menduar si revizionistë dhe si përfaqësues të një shteti të madh, nuk kishte rëndësi kundërshtimi, sado i vogël ose i madh që të bëhej, nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Republikës Popullore të Shqipërisë kundër veprimtarisë së tyre për transformimin e vendeve socialiste në vende kapitaliste.

Pra, Hrushovi, sa kishte nevojë që të afirmohej dhe të vendoste pushtetin e tij, diti të përkëdhelte Mao-Çunë për t'u ndihmuar prej tyre. Dhe këta e ndihmuan Hrushovin politikisht dhe ideologjikisht, se ekonomikisht nuk kishin ç't'i jepnin. Përkundrazi, ata dëshironin të merrnin ndihma nga Bashkimi Sovjetik; synonin të merrnin jo vetëm teknologjinë, ndihma materiale dhe financiare sikundër morën, por donin të merrnin sidomos bombën atomike. Mao-Çuja synonin që Bashkimin Sovjetik ta kishin një aleat, por një aleat të tillë, që nuk duhej të hidhte çape të rëndësishme pa u konsultuar me ta.

Pasi Hrushovi i forcoi mirë pozitat e veta, Maoja bëri përpjekje të mëdha që të mos përçahet «miqësia» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, se interesat e

Mao Ce Dunit e donin që të arriheshin rezultatet e strategjisë së tij.

Gjatë gjithë kësaj kohe vëmë re se të dyja palët manovrojnë njëra nga një anë, tjetra nga ana e kundërt. Hrushovi me fjalë dukej antiimperialist; ai i sulmonte Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga ana e tij edhe Mao Ce Duni e puqte strategjinë e vet me atë të Hrushovit: i sulmonte edhe ai Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por që të dy, qoftë njëri, qoftë tjetri, në brendinë e pikëpamjeve të tyre, e kishin qëllimin që, duke i kapërcyer hap pas hapi këto kontradikta, të binin në ujdi me imperializmin amerikan. Dhe, pavarësisht nga propaganda shurdhuese, kjo prirej u duk te Hrushovi. Avancat që ai bëri ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës me politikën e tij të «bashkekzistencës paqësore», të «botës pa armë, pa luftëra» etj., etj., çonin drejt një bashkëpunimi më të frytshëm me imperializmin amerikan, drejt një afrimi me të në marrëdhëniet ekonomiko-ushtarake, për të forcuar akoma më tepër pozitat e Bashkimit Sovjetik për t'u bërë superfuqi. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshironin që Bashkimin Sovjetik ta minonin dhe minimin mund të bëhej ose duke i deklaruar luftë, ose duke e skllavëruar me ideologjinë borgjeze, si dhe nëpërmjet investimeve të kapitalit.

Kur Mao Ce Duni pa se qëllimet e tij nuk u arritën dhe strategjia e tij nuk doli në pah, siç mendonte, atëherë shohim acarimin e marrëdhënieve ndërmjet Kinës së Mao Ce Dunit dhe Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga klika hrushoviane. Në këtë acarim Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore e Shqipë-

risë jo vetëm qenë të pranishme, por ishin të parat që e filluan luftën kundër hrushovianëve, për arsye se e panë me kohë dhe shumë më përpara djallëzinë e tyre në arenën ndërkombëtare, në strategjinë e tyre dhe veçanërisht në taktikën që përdorën ata kundër nesh. Hrushovi shihte te ne rezistencë kundër veprës së tij. Nga ana jonë rezistenca shtohet dhe gjeti terren të favorshëm. Partia e Punës e Shqipërisë diti ta shfrytëzonte këtë situatë dhe e sulmoi revizionizmin sovjetik haptazi në Bukuresht për vijën tradhtarë e renegate që kishte filluar të ndiqte, dhe mbrojti normat marksiste-leniniste në marrëdhëniet midis partive. Kina, e cila u sulmua nga hrushovianët, u përpoq ta shfrytëzojë këtë situatë për interesat e saj. Hrushovianët panë një rrezik që po ngrihej kundër strategjisë së tyre dhe ky rrezik ishte strategjia kineze, strategjia e këtij shteti tjetër të madh, i cili kërkonte të dominonte edhe mbi Bashkimin Sovjetik, të bëhej një fuqi e madhe botërore dhe t'i impononte pikëpamjet e tij politike dhe ideologjike edhe Bashkimit Sovjetik.

Këtu shohim se strategjia e Mao-Çusë mori një rrugë tjetër. Po ç'rrugë mori? PKK në atë kohë doli hapur kundër revizionizmit hrushovian me disa artikuj. Ashtu siç bënte Partia e Punës e Shqipërisë. Cila ishte strategjia jonë? Ishte lufta kundër imperializmit amerikan, kundër borgjezisë kapitaliste botërore dhe revizionizmit modern sovjetik. Kështu që, udhëheqja kineze filloi luftën në të dy krahët, ashtu siç e kishim bërë ne vazhdimisht, veçse këtë luftë ajo e bëri me shumë peripeci e me javashllëk. Më në fund ajo u fut thellë kundër Bashkimit Sovjetik revizionist. Ndërsa

ne vazhdonim të qëndronim si kurdoherë në pozita të drejta revolucionare në interes të socializmit dhe të revolucionit botëror, Kina javash-javash filloi të ndërronte kurs, të adaptonte një strategji të re, të vinte në pah edhe armiqësinë e vjetër që ushqente kundër Bashkimit Sovjetik që në kohën e Stalinit, bile të riorientuar me armiqësinë kundër periudhës hrushoviane, dhe të kthente fytyrën nga Perëndimi dhe nga SHBA; të ringjallte atë miqësi të vjetër të kohës së luftës, me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror. Brenda një periudhe disavjeçare ne shohim që të kristalizohet strategjia e re kineze, e cila tenton dhe arrin të pajtohet me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë kapitaliste botërore.

Në këtë ndryshim të strategjisë, që vendosën pas Revolucionit Kulturor dhe pas likuidimit të grupit të Lin Biaos, kur Mao Ce Duni dhe Çu En Lai qenë bërë të plotfuqishëm, pasi likuiduan çdo përpjekje për kundërshtim, udhëheqësit aktualë revizionistë kinezë marshuan gradualisht. Ata panë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin në favor të kësaj strategjie të tyre, por duheshin ruajtur edhe aparenat. Si «mollë sherri» në mes tyre gjoja qëndronte Tajvani. Ky ishte një pretekst, por edhe ky u zhduk.

Në fillim, për të realizuar një pjesë të strategjisë së re, u hoq pengesa e Tajvanit për sa u përket lidhjeve miqësore politike, më vonë edhe ideologjike e tregtare me shtetet kapitaliste të zhvilluara të botës. Pasi u hoq ky kusht, gjoja i pakapërcyeshëm, pse të tillë e kanë pasë reklamuar më parë Mao-Çuja, Kina lidhi marrëdhënie diplomatike me Anglinë, Gjermaninë Pe-

rëndimore e kështu me radhë edhe me vende të tjera kapitaliste. Ajo u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si anëtare e rregullt, mori vendin e saj në Këshillin e Sigurimit dhe Çan Kai Shia u qërua andej.

Natyrisht, ky ishte, si të thuash, një devijim treçerek që e çonte drejt afrimit me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror kundër Bashkimit Sovjetik revizionist dhe gjithë aleatëve të tij. Mirëpo qëndronin akoma të ftohta miqësia dhe marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, për ta ngrohur ca më tepër këtë miqësi e më vonë edhe për ta trashur, u gjet arsyeja, u gjetën bisedimet, u gjetën fjalët dhe çdo gjë u konkretizua. Mao-Çuja bënë takime të fshehta dhe të hapëta me emisarët e Niksonit, me Kisingerin, në radhë të parë, pastaj edhe me vetë Niksonin, i cili vajti në Pekin dhe hodhi urën e madhe që nga «Kalifornia deri në Pekin».

Kështu që strategjia e re e Mao-Çusë, për afrim me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror, po kristalizohej, po merrte forma konkrete. Pra autorët e kësaj strategjie janë në radhë të parë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Duhet thënë se Çu En Lai ishte më i egri dhe më i vendosuri për një kalim më të shpejtë në kapitalizëm, në unitet me kapitalizmin botëror, vetëm se politika centriste e Mao Ce Dunit e frenonte këtë, por nuk e pengonte për përgatitjen e kësaj rruge. Dhe këtë rrugë mori Kina.

Pas vdekjes së Çusë e të Maos, siç e dimë, e mori fuqinë me puç Hua Kuo Feni, i cili (pas disa peripeçive dhe pasi likuidoi pjesën tjetër të Byrosë Politike

me anë të ushtrisë, pse ushtria ka luajtur kurdoherë në Kinë rolin e armës së diktaturës së borgjezisë, armën e grupimeve të ndryshme dhe veçanërisht në duart e Mao-Çusë) solli në fuqi përsëri Ten Hsiao Pinin. Që të dy filluan punën për likuidimin e çdo rezistence në Kinë, për forcimin e ecjes së saj në drejtimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për përhapjen në shkallë të gjerë drejt miqësisë politiko-ideologjike me shtetet kapitaliste të të gjithë botës.

Në radhën e parë të strategjisë së Huo Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, natyrisht, janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto janë kyçi i kësaj strategjie. Ky kyç hapi të dyja dyert e sallorit dhe Kina u infiltrua brenda si miu që kërkon djathin. Aktualisht ne shohim që miqësia dhe tratativat politike, ekonomike dhe ushtarake me Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë, pse këto janë kryesoret. Tratativat vazhdojnë edhe drejtpërdrejt, edhe nëpërmjet partnerëve të mëdhenj kapitalistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këtu nuk duhet të harrojmë që imperializmi aktual botëror lufton, përpiqet të zërë vend kudo për të siguruar tregje nëpërmjet shoqërive shumëkombëshe. Kështu që Kina këtë krijesë të re të imperializmit botëror e përdor për t'u fshehur në sy të popujve, sikur ajo nuk është plotësisht e lidhur ekonomikisht dhe politikisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por merr ndihma, kredi, teknologji etj. nga Japonia, nga Republika Federale e Gjermanisë, nga Franca, nga Anglia etj., me fjalë të tjera nga të gjitha vendet e tjera imperialiste të radhës së dytë, që janë të pleksura si leshi i arapit edhe me kapitalet amerikane.

Në dukje pandehet sikur Kina afrohet më shumë me shtetet e «botës së dytë», se me imperializmin amerikan, për sa i përket marrjes së kredive, por realiteti nuk është kështu. Kina merr më tepër kredi dhe ka një tregti më të madhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet shoqërive shumëkombëshe. Por, pavarësisht nga strategjia e saj, politika e Kinës synon të gënjejë popujt dhe t'u thotë këtyre se ajo vazhdon të jetë një shtet socialist dhe se Partia Komuniste e saj vazhdon të jetë një parti marksiste-leniniste.

Në këtë manovër të madhe strategjike Kina ka huazuar nga imperializmi teorinë e «tri botëve» duke e modifikuar atë për interesat e saj dhe vetë u fut në «botën e tretë». Ne kemi shpjeguar qëllimet dhe taktikën e Kinës për këtë çështje, por duhet theksuar se kjo nuk ndryshon asgjë për të bërë të qartë në sytë e botës përparimtare se ajo ka qëllimin që të bëhet një superfuqi socialimperialiste për të dominuar dhe për të shfrytëzuar popujt e pazhvilluar, duke u dhënë gjoja një mbështetje. Kjo është një politikë e çoroditur. Revizionistët kinezë nuk bëjnë dhe nuk mund të bëjnë politikë realiste, sepse kjo nuk është e bazuar në vështrimin marksist-leninist të gjendjes në botë, të forcave në arenën ndërkombëtare dhe të taktikave të drejta që duhen zhvilluar.

Në strategjinë reaksionare dhe imperialiste të Mao-Çusë dhe të pasardhësve të tyre, Hua Kuo Fenit e Ten Hsiao Pinit, ne shohim qartë edhe qëndrimet e tyre ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe vijës marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipë-

risë. Edhe udhëheqësit kinezë, ashtu si hrushovianët, u përpoqën ta injorojnë vendin e popullin tonë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, dhe të krijojnë përshtypjen se për ta Shqipëria ishte një pikë gjeografike në hartë. Por politika e drejtë dhe ideologjia marksiste-leniniste, të cilave u qëndron besnike Partia jonë, bënë që ky vend i vogël, ky popull i vogël, kjo Parti e vogël të afirmoheshin në arenën ndërkombëtare dhe, sidomos, në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Të dyja palët, si revizionistët sovjetikë edhe ata kinezë, na shikonin nëpërmjet syzeve të shtetit të madh. Në një moment të caktuar, kur ndryshuan strategji sovjetikët, na bënë shantazhe dhe presione të shumta, kundër të cilave ne rezistim me sukses dhe ata dështuan. Kinezët, në momentet kur strategjia e tyre ishte në kundërshtim me atë të revizionistëve sovjetikë, u paraqitën si dashamirësit tanë dhe menduan se me anë kredish dhe investimesh do të na ëmbëlsonin e do të na kishin kurdoherë si mbështetës edhe atëherë kur do të ndryshonin strategjinë e tyre, dhe që ata e dinin se do ta ndryshonin. Por kjo nuk ngjau me ne. Në një moment, kur strategjia Mao-Çu u drejtua nga miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror, taktika e Mao-Çusë në këtë moment ishte që të influenconte ose edhe të na detyronte që ta përqafojmë këtë strategji të tyre. Në qoftë se ne nuk do të bindeshim, ata do të organizonin një puç ushtarak për të përmbysur udhëheqjen tonë. Kështu parashikonin që Shqipëria të bashkohej politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht me Jugosllavinë titiste dhe me Rumaninë revizioniste.

Synimet e Mao-Çusë ishin që Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë, që qëndronin në pozita të forta marksiste-leniniste, të adoptonin strategjinë kineze drejt miqësisë me imperializmin amerikan, me kapitalizmin botëror, si dhe me Jugosllavinë e me Rumaninë. Çu En Lai veproi aktivisht në këtë drejtim. Ky, me anën e Beqir Ballukut, e organizoi këtë puç, me qëllim që t'i kthente politikën dhe strategjinë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë në unitet me strategjinë kineze, në miqësi me titizmin dhe me Rumaninë. Mirëpo qëndrimet e Partisë sonë kishin rënë në kundërshtim me kohë, që më 1960, me pikëpamjet revizioniste akoma të pakristalizuara, por që dukeshin, të Partisë Komuniste të Kinës, pikëpamje të cilat çdo ditë e çdo vit merrnin forma gjithnjë e më të theksuara, derisa u arrit në zbulimin e plotë të puçit të Beqir Ballukut dhe të Abdyl Këllezit.

Kështu, si revizionistët sovjetikë ashtu edhe ata kinezë, e morën vesh se me kë kishin të bënin.

Aktualisht strategjia e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit nuk është më një strategji e maskuar drejt rivendosjes së kapitalizmit në Kinë, por një strategji krejt e hapur. Ky grupim revizionist kapitalist i ardhur në Kinë ka vendosur diktaturën e tij fashiste. Partia Komuniste e Kinës ekziston vetëm si emër, se në Kinë dominon fraksioni më i fortë ushtarak që drejtohet nga grupi që ka ardhur në fuqi dhe bën ligjin atje.

Politika e jashtme e Kinës është në unitet me atë të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror

për dy qëllime: për t'u forcuar Kina në pozitën kapitaliste, domethënë për t'u bërë një fuqi e madhe kapitaliste, dhe, në drejtimin tjetër, për të kundërshtuar socialimperializmin sovjetik. Domethënë nga një anë mbron imperializmin dhe borgjezinë kapitaliste, nga ana tjetër ajo lufton superfuqinë rivale, socialimperializmin.

Grupi në fuqi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit e di se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurdoherë kanë qëndruar pranë kapitalizmit evropian që dominon në Evropë dhe në shumë vende të tjera të botës. Prandaj Kina nën drejtimin e këtij grupi bën haptazi të gjitha përpjekjet që ta fuqizojë unitetin e «Evropës së Bashkuar» reaksionare dhe të Tregut të Përbashkët Evropian, të tregut të koncernëve dhe të monopoleve evropiane e të shoqërive shumëkombëshe. Ajo përpjet që ta fuqizojë në një mënyrë të tillë edhe NATO-n, këtë aleancë agresive politiko-ushtarake që udhëhiqet nga imperializmi amerikan kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Kina nxit që lufta imperialiste grabitqare në mes këtyre dy superfuqive të bëhet në Evropë. Për këtë qëllim, kurdoherë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës tentojnë (siç bënë këto kohët e fundit me anën e Karterit) që të mos i acarojnë aq shumë situatat me Bashkimin Sovjetik, Kina ngre zërin dhe atakon Kartërin se po bën gabime. Kjo tregon shumë qartë që Kina ka tradhtuar marksizëm-leninizmin, revolucionin dhe po bën një krim të madh të pafalshëm kundër njerëzimit, se nxit një luftë botërore imperialiste në kurriz të popujve të botës, të cilët, nga ana tjetër, në mënyrë

hipokrite (dhe kjo është një karakteristikë e revizionistëve kinezë), i merr gjoja në mbrojtje, në një kohë kur imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë në kontradikta të mëdha dhe konkretisht po luftojnë për t'i rimarrë njëri-tjetrit tregjet botërore, domethënë për të rindarë botën.

Kina hesht përpara veprimtarisë agresive të imperializmit amerikan, përpara manovrave agresive amerikane dhe flet vetëm kundër veprimeve agresive sovjetike. Këtu duket qartë njëanshmëria e strategjisë kineze, njëanshmëri drejt mbrojtjes së kapitalizmit botëror në kurriz të interesave të popujve të botës që kërkojnë liri, që kërkojnë pavarësi, që përgatiten e janë hedhur në sulm, në revolucion kundër shtypësve të huaj dhe të brendshëm, të cilët janë në aleancë me njëri-tjetrin.

Kjo është me pak fjalë strategjia e gjithë këtyre udhëheqësve e personaliteteve kryesore kineze, me Mao Ce Dunin në krye, dhe tash me Ten Hsiao Pinin. Kjo strategji do të vazhdojë dhe ka mundësi të sjellë acarimin e kontradiktave dhe rrezikun e shpërthimit të një lufte të re termobërthamore. Këtu qëndron përgjegjësia e rëndë e këtyre antimarksistëve, renegatëve dhe armiqve të popujve të botës.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 318

PARTIA MERR VENDIME DHE VEPRON PËR ZBATIMIN E TYRE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

17 prill 1978

Në këtë takim sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë biseduan rreth disa problemeve që parashtroi shoku Hekuran Isai, të dala nga mbledhjet e zhvilluara në organizata-bazë për dhënie llogari e zgjedhje. Duke marrë fjalën, shoku Enver Hoxha, ndër të tjera, tha:

Nga rastet që u përmendën këtu del se, për të drejtuar organizatën-bazë, janë zgjedhur edhe komunistë me nivel më të ulët se shumica e anëtarëve të saj dhe kjo bëhet gjoja për të sjellë në udhëheqje punëtorë. Një gjë e tillë nuk ka pse të ndodhë, sepse çdo anëtar i organizatës, qoftë ky mjek apo punëtor hidraulik, si anëtar partie s'ka ndryshim nga të tjerët. Në organizatë të tërë janë njëlloj, të tërë i kanë ato cilësi që duhet t'i karakterizojnë komunistët. Kjo do të thotë se edhe ai që është intelektual ose me origjinë intelektuale, kur futet në radhët e Partisë, bën pjesë në repartin luftarak të proletariatit, pra mbron dhe zbaton

vijën e Partisë si gjithë komunistët e tjerë, që janë punëtorë apo me origjinë punëtorë. Prandaj nuk ka si justifikohet fakti kur në këtë ose në atë organizatë janë zgjedhur si sekretarë partie shokë që nuk i takojnë profilit kryesor, ose, siç ka ndodhur në organizatën e dikasterit që përmendët, ku bëjnë pjesë specialistët e disa drejtorive, por e drejton shefja e kabinetit të ministrit!

Drejtimi i organizatës-bazë të Partisë nuk është një çështje e thjeshtë që ka të bëjë me organizimin e mbledhjeve, me formulimin e ndonjë karakteristike për kuadrin, por është një çështje ideologjike, politike, teknike dhe organizative. Prandaj komunistët që do të zgjidhen në udhëheqje të organizatës-bazë të Partisë, duhet të jenë njerëz që i kuptojnë këto probleme, që kanë eksperiencë, që dinë të mbajnë kontakte të mira me komunistët e tjerë, dinë të këshillojnë, të drejtojnë, të udhëzojnë, dinë të shtrojnë probleme në organizatën-bazë e t'i bëjnë të qarta ato për të gjithë, pavarësisht nga niveli që kanë anëtarët e saj.

Drejt e kenë ju, shoku Hysni [Kapo], që sekretari ose byroja duhet të shtrojë në organizatë ato probleme që preokupojnë me të vërtetë gjithë kolektivin dhe që për zgjidhjen e tyre duhet mobilizuar medoemos i gjithë kolektivi. Në mbledhjen e Partisë, në një organizatë, ku shumica janë mjekë e infermierë, nuk mund të jetë kryesore çështja e defekteve në instalimet hidraulike, por ka shumë probleme të tjera të rëndësishme, me të cilat duhet të merret organizata-bazë. Problemi kryesor për të është të ecë përpara ndërmarrja apo institucioni. Po ç'do të thotë të ecë përpara, për shembull, një spital? Do të thotë që të punojnë si du-

het mjekët, infermierët, të ndahen si duhet ilaçet, të ndiqet me kujdes gjendja e të sëmurëve etj., domethënë që i gjithë personeli i shërbimit të kryejë mirë e në kohë detyrat që i janë caktuar. Mirëpo kush do t'i shikojë se si e kryen secili detyrën, ajo që është sekretare e drejtorit, që rri mbyllur në zyrë?! Sigurisht që jo. Atje, ku në krye të organizatës zgjidhen shokë ose shoqe që janë më të ngeshëm, paçka se janë më larg problemeve të bazës a të prodhimit, veprohet gabim dhe kemi të bëjmë me një kuptim jo të drejtë të kësaj çështjeje.

Në mbledhjen e organizatës-bazë shtrohen problemet më të rëndësishme, rrihen mendime dhe dilet me konkluzione që i shërbejnë punës. Po çfarë mund të dalë nga një mbledhje organizate, në një dikaster qendror, si ajo që na tregoi Hekurani, ku nuk ngrihen të diskutojnë drejtorët, të cilët i kanë sytë mbi gjithë aktivitetin e këtij aparati, mbi gjithë aktivitetin ekonomik të vendit tonë, pra dinë se ku ecën e ku çalon puna? Pra, si është e mundur të mos diskutojnë këta drejtues në një dikaster? Duhet ndalur e thelluar një çikë në këto probleme. Sipas mendimit tim, kjo ndodh sepse, së pari, mbledhjes së organizatës-bazë të Partisë në institucion ka raste që pikërisht nga kuadrot kryesorë i vihet më pak rëndësi; së dyti, te disa drejtorë drejtorish të ministrive ngre krye njëfarë mendjemadhësie teknike. Ata mendojnë se është e tepërt të diskutojnë në një mbledhje të organizatës-bazë për problemet që e shqetësojnë atë, pavarësisht se i dinë ose nuk i dinë si duhet këto probleme. Pra, nuk i vënë rëndësinë e duhur mbledhjes së organizatës, nuk e kon-

siderojnë këtë si një vatër revolucionare ku shtrohen problemet më të rëndësishme; së treti, shokët kryesorë, mendoj unë, nuk diskutojnë, sepse e quajnë të panevojshme dhe humbje kohe të flasin në organizatën-bazë, sepse këto probleme i kanë shtruar në aparat, në drejtori ose në sektorë. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me një qëndrim mospërfillës e nënvleftësues ndaj mbledhjes së Partisë dhe anëtarëve të organizatës; së katërti, çështja është se me njëri-tjetrin këta drejtues nuk kanë fërkime për arsye se në diskutimet që bëhen mungon kritika e drejtpërdrejtë, pra ekziston një ujdi e heshtur dhe një punë rutinë. Unë, mendojnë të tillë njerëz, jam përgjegjës për punën time, ti je për tënden. Unë nuk do të të kritiko, po edhe ti mos më kritiko, pavarësisht se ti me punën tënde më pengon mua dhe unë të pengoj ty, por vetë kontrollojmë, jemi, siç i thonë një fjale, «vetë kadi vetë myfti», vetë vendosim dhe vetë vulosim. Prandaj ndodh që secili ecën në rrugën e vet. Por rruga e veçuar nuk është revolucionare, ajo nuk mund t'i çojë ata në mendime të thella për zhvillimin e mëtejshëm të detyrave, në zbatimin si duhet dhe në dhënien e ndihmës konkrete për zgjidhjen e problemeve.

Të tëra këto pasqyrojnë atë shfaqje negative që vihet re aty-këtu në praktikën e punës, që komunistët e zgjedhur për drejtimin e organizatës, nuk janë kurdoherë në gjendje të drejtojnë, të këshillojnë, të kontrollojnë dhe të ndihmojnë si duhet për forcimin e punës së Partisë. Kjo është shfaqje e një sëmundjeje që, po ta neglizhojmë, mund të bëhet mjaft serioze, prandaj duhet ndalur dhe duhet parë thellë jo vetëm çësh-

tja e vlerësimit të mbledhjes së organizatës, por edhe pjesëmarrja e gjallë në diskutime e komunistëve me përgjegjësi.

Shpeshherë nëpër organizata-bazë të Partisë shtrohen edhe probleme me karakter organizativ e teknik, por për zbatimin e tyre në praktikë, në disa raste, nuk ka një kontroll e koordinim të shëndoshë, prandaj në zgjidhjen e tyre ka rutinë, burokratizëm dhe indiferentizëm. Këtyre shfaqjeve të dëmshme, që pengojnë mbarrëvajtjen e punës, Partia duhet t'u vërë fre; ajo duhet të drejtojë, të vërë rregull e disiplinë kudo e për çdo gjë. Po si do t'i realizojë Partia këto? Në qoftë se një organizatë-bazë vetëm shtron probleme e merr vendime për to, por nuk i vë përpara përgjegjësisë të gjithë, në radhë të parë komunistët, që t'i zbatojnë këto vendime dhe nuk kontrollon zbatimin e tyre, brenda të gjitha normave që janë caktuar, atëherë në këtë organizatë partie punët nuk mund të ecin mirë. Zbatimi i detyrueshëm nga të gjithë i vendimeve që merr organizata, është një çështje e rëndësishme, që duhet kuptuar thellë. Pikërisht kjo gjë, mendoj unë, nuk kuptohet drejt. Komunisti, kushdo qoftë ai, duhet të zbatojë, në vendin ku punon, vendimin që merr organizata.

Është fakt se në shumicën e organizatave-bazë të Partisë problemet shtrohen drejt, në frymë luftarake, po pastaj shikon që në disa prej tyre detyrat, vendimet përkatëse që merren nuk realizohen, nuk zbatohen si duhet nga vetë komunistët. Por po s'iu futën punës për vënien në jetë dhe për zgjidhjen e çështjeve që ngrihen në organizatë të gjithë (që nga ministri e drejtori, se të tërë janë anëtarë të Partisë, të tërë janë një-

soj, me detyra e të drejta të njëjta), nuk mund të ecë përpara puna e Partisë. Në këto çështje me doemos duhet ngulur këmbë, që të kuptohen mirë. Kur merr vendim Partia, ky duhet të zbatohet nga organet e pushtetit e të ekonomisë, nga administratat, që janë leva me anë të të cilave konkretizohet drejtimi i Partisë. Partia merr vendim dhe vepron aktivisht me anë të komunistëve për zbatimin e vendimit, aty ku janë, në administratën shtetërore, në ndërmarrjen ekonomike, në shkollë, në kooperativën bujqësore e kudo. Dhe kjo është një pjesëmarrje në tërësi, politikisht, ideologjikisht, teknikisht, pra kudo dhe për çdo problem. Vetëm kështu kuptohet drejtimi nga ana e Partisë dhe vënia në zbatim e direktivës së saj.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Raporte e fjalime 1978-
-1979», f. 78*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime
1978-1979», f. 78*

NË DISA VENDE PO GJALLËROHEN FORCAT FASHISTE

Shënime

18 prill 1978

Kriza e madhe ekonomiko-politike e kapitalizmit botëror, e imperializmit dhe e socialimperializmit, ka shkaktuar varfërimin, mjerimin dhe shtypjen e masave të gjera punonjëse, shtypjen e proletariatit dhe shtimin e papunësisë, të inflacionit e të urisë. Por, nga ana tjetër kjo ka shkaktuar edhe rritjen e revoltës popullore kundër kësaj gjendjeje katastrofike, në të cilën po e çojnë njerëzimin kapitalizmi botëror, imperializmi dhe revizionizmi modern.

Kësaj revolte të madhe të popujve në vendet kapitaliste dhe revizioniste, borgjezia kapitaliste përpiqet t'i gjejë një ilaç. Por ilaçi i tyre është ai i përhershmi: ngritja në këmbë e diktaturës fashiste, e asaj force brutale, regressive, gjakatare që shtyp masat e punonjësve, që zhduk çdo liri demokratike, çdo formë pseudodemokratike parlamentare dhe zbaton ligjin e kapitalit të madh në kalbëzim.

Revizionizmi modern, titizmi, hrushovizmi, eurokomunizmi dhe revizionizmi kinez kanë ndihmuar e

po ndihmojnë në rimëkëmbjen e fashizmit. Kjo ngjet si në vendet ku sundojnë drejtpërdrejt kapitalistët e imperialistët, ashtu edhe në vendet revizioniste ku është zhdukur rendi socialist e është vendosur regjimi kapitalist dhe ku ka marrë frenat borgjezia e re revizioniste e mbështetur në aparatet e saj shtypëse.

Revizionizmi modern ishte ai variant i socialdemokracisë që u erdhi në ndihmë kapitalizmit botëror në kalbëzim dhe imperializmit amerikan pas Luftës së Dytë Botërore. Rrezikshmëria e tij fillestare qëndronte në atë se kjo ideologji, ose kjo rrymë e madhe regressive, fshihej nën maskën e marksizëm-leninizmit, hiqej sikur regjimet socialiste në ato vende ku sundonte proletariati vazhdonin të ishin në fuqi dhe se gjoja në to risundonte proletariati. Por, në fakt, në këto vende socializmi u shkatërrua, pushteti i diktaturës së proletariatit u përmbys dhe u rivendos pushteti i klasave të larta që u krijuan dhe që morën fuqinë në dorë.

Revizionistët modernë me pikëpamjet e tyre demagogjike, pavarësisht se ndërtojnë kapitalizmin, po bëhen konkurrentë të kapitalizmit të vjetër, dëshirojnë dhe luftojnë për rindarjen e botës, rindarjen e tregjeve e të zonave të influencës. Në vendet ku në fuqi është borgjezia kapitaliste, revizionistët modernë, me partitë e tyre pseudomarksiste, nëpërmjet reformave të strukturës, nëpërmjet kompromiseve dëshirojnë të infiltrohen në pushtetin e kapitalit dhe nëpërmjet kësaj të mund të nxjerrin fitime në dobi të një borgjezie të re, krahas borgjezisë së vjetër, dhe të shtypin kështu më mirë kërkesat e ligjshme politike, demokratike të vërteta dhe ekonomike të proletariatit dhe të masave të

popullit. Por si për kapitalizmin e vjetër dhe për kapitalizmin e ri revizionist, për vetë regjimet e tyre aktuale në fuqi, është krijuar një situatë shumë e rrezikshme. Pse? Sepse popujt, që sundohen e shtypen nga kapitalistët e vjetër e të rinj, shohin se po çohen drejt një mjerimi akoma edhe më të madh ekonomik, politik e moral. Prandaj ata janë ngritur në revolta, në greva e në demonstrata për ta penguar këtë shtypje. Kështu që në të gjitha këto vende borgjezia e vjetër dhe ajo e re po vendosin një diktaturë të fortë.

Në disa vende kapitaliste dhe imperialiste po gjallërohen forca fashiste me synim për të shtypur revoltën e popujve.

Në Itali lëvizja fashiste po merr forma kërcënuese, për arsye të dobësimit të borgjezisë italiane dhe të rrugës pa krye në të cilën është futur vendi. Qeveritë borgjezo-kapitaliste të demokristianëve, të socialdemokracisë dhe të partive të tjera, nuk janë në gjendje të dalin nga kjo rrugë. Fashizmi në Itali jo vetëm përfaqësohet nga disa parti si Lëvizja Shoqërore Italiane, e Djathta Nacionale, që kanë deputetë në parlament dhe që andej propagandojnë marrjen e pushtetit prej tyre, por ka organizuar, gjithashtu, grupe të mëdha të panumërta ilegale. Këto grupe veprojnë në drejtim të dobësimit të pushtetit të borgjezisë italiane, luftojnë për të tmerruar masat punonjëse dhe proletariatin, luftojnë po ashtu çdo përpjekje të borgjezisë revizioniste italiane që të infiltrohet në punët e kapitalit të madh italian. Këto grupime të panumërta bëjnë krime të çdo lloji, sulme me banda, rrëmbejnë persona të ndryshëm. rrëmbejnë personalitete politike si Aldo Moron, u kër-

kojnë haraç, i vrasin, sulmojnë bankat etj. Në të gjithë Italinë ata kanë krijuar një situatë shqetësimi dhe frike të madhe të jashtëzakonshme në masat e gjera të popullit. Kjo e keqe po rritet dita me ditë dhe revizionistët e të gjitha partitë e tjera pseudodemokratike italiane nuk kanë ç'bëjnë, nuk veprojnë dhe rrezikohen ta pësojnë, ashtu siç e pësuan në kohën e ardhjes së Musolinis në fuqi.

Ne konstatojmë se parti të ndryshme të borgjezisë kapitaliste, përveç Partisë Demokristiane që është në fuqi dhe tregon një pazotësi «shembullore», të gjitha të tjerat bëjnë një demagogji shurdhuese e pa emër kundër terrorizmit, nuk flasin aspak për fashizmin që po ringjallet dhe nuk u bëjnë thirrje masave të gjera të popullit që të ngrihen në këmbë dhe ta përballojnë me vendosmëri një situatë të tillë kërcënuese...

Në Gjermaninë Perëndimore janë krijuar shoqëri të ndryshme dhe të shumta me fashistë të vjetër dhe me të rinj që bëjnë haptazi propagandë naziste hitleriane. Ato kanë shtypin e tyre, botojnë «Majn Kampfin» e Hitlerit, kujtimet e Gëbelsit, të Göringut dhe të shefave historikë të nazizmit gjerman. Këto shoqëri bëjnë mbledhje çdo muaj, organizojnë darka dhe dreka, ku pihet birrë e këndohen këngë revanshiste përpara syve dhe nën hundën e policisë, nën hundën e ushtrisë dhe të policisë sekrete të Republikës Federale të Gjermanisë. Edhe në Gjermaninë Perëndimore nuk mungojnë aktet terroriste, vjedhjet, vrasjet. Edhe atje këto bëhen në shkallë të gjerë, por jo si në Itali, për arsye se forca e kapitalizmit gjerman është akoma në gjendje të dominojë situatën e brendshme të vendit

dhe të mos jetë përpara atyre krizave të mëdha ekonomike dhe politike që kanë pllakosur borgjezinë kapitaliste italiane. Në Gjermani pozitën e kapitalit janë më të fuqishme, bile më të fuqishme nga të gjitha vendet e tjera kapitaliste të Tregut të Përbashkët Evropian. Kapitali gjerman dominon mbi Tregun e Përbashkët Evropian, bile rrezaton forcën e tij ekonomike dhe jashtë Evropës.

Në këto kushte gjendja ekonomike në Gjermaninë Federale është shumë më e mirë se ajo e Italisë, prandaj mundësia e shpërthimit të revoltave të masave punonjëse italiane është më e madhe sesa në Republikën Federale të Gjermanisë.

Në Francë po ashtu shohim të ekzistojë akoma një situatë konfuze. Ekziston gjoja një luftë më demokratike në mes partive të ndryshme, por konstatojmë se borgjezia kapitaliste franceze në fuqi, në zgjedhjet e fundit, fitoi dhe nuk e la «të majtën», bashkimin e partisë komuniste me partinë socialiste, që të merrte fuqinë ose të infiltrohej, siç tenton partia revizioniste italiane të infiltrohet në pushtetin e kapitalit të madh.

Disfata e këtyre dy partive të borgjezisë, e partisë revizioniste franceze dhe e asaj socialiste, në këto zgjedhje bëri që tash ato të përçahen. Kjo është vepër e kapitalit të madh francez. . .

Po t'i hedhim një sy të përgjithshëm situatës botërore, shohim se edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ngjet e njëjta gjë. Shoqëritë fashiste atje po shumëzohen e po aktivizohen. Në këtë vend, si kudo në botën kapitaliste, ekziston po ashtu një krizë e madhe, ekonomike dhe politike, e cila reflekton dhe fuqizon

krizën ekonomike edhe në të gjitha vendet e tjera kapitaliste që janë të lidhura me kapitalizmin amerikan.

Në Afrikë po ashtu shohim racizmin e bardhë që të dominojë dhe të luftojë me ashpërsinë më të madhe për të ruajtur pozitat e tij sunduese mbi popujt e varfër të këtij kontinenti të madh. Ky racizëm ndihmohet, siç ndihmohet edhe brenda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër zezakëve dhe kundër elementëve demokratë përparimtarë, nga ana e imperializmit amerikan. Organizohen shumë mbledhje, fliten shumë fjalë, mbahen shumë diskure për çështjen e Rodezisë, për çështjen e pakicës së bardhë që dominon në Afrikën e Jugut etj., etj.; shkon atje Vensi apo Ovensi, por të gjitha këto janë demagogji për të gënjyer masat e gjera të popullit që ngrenë krye për çlirimin nga zgjedha e ncokolonializmit.

Marrë me ndonjë shkurtim nga libri: Enver Hoxha, «Ditari për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 353

EKSPERIENCA QË MERRET TË APLIKOHET NË KUSHTET E VENDIT TONË

Nga biseda me një grup specialistësh të naftës

19 prill 1978

Si jeni shokë, mirë? Ne ju ftuam këtu që t'ju dëgjojmë drejtpërdrejt, pra të na flitni për atë eksperiencë që morët në ato vende ku vajtët. Më duket se ju ishit në Algjeri dhe në Irak. Natyrisht, ne nuk dëshirojmë të na flitni nga ana turistike për vendet që vizituat, por dëshirojmë, dhe kjo na intereson, që ju të na flitni vetëm për anën tekniko-shkencore të problemeve të naftës që ju patët rastin të njiheshit atje, për eksperiencën e tyre në këtë fushë dhe se ç'mund të përfitojmë ne nga ato gjëra.

Pasi dëgjoi specialistët, që i folën për çka kishin parë në vendet që vizituan, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Eksperienca që ju morët në Algjeri dhe në Irak, sigurisht do të na shërbejë; veçse, për çdo eksperiencë që merret, sidomos për sa i përket naftës, nga ana e specialistëve duhet të bëhen përpjekje që ajo të aplikohet në kushtet e vendit tonë dhe të mos shkohet me

mendimin se duhet të zbatohet në atë mënyrë që e patë atje.

Metodat që përdornin ata në nxjerrjen e naftës, mund të jenë, dhe në fakt janë, metoda shkencore nga të cilat ne mund të përfitojmë. Ato nuk kanë të bëjnë as me çështjet politike, as me çështjet ideologjike, por, siç e dini ju, kanë lidhje me strukturën, me formacionet e ndërtimit gjeologjik, të cilat janë të ndryshme, për territore të ndryshme. Natyrisht që ka lidhje të përgjithshme midis ndërtimit strukturor të vendit tonë dhe të vendit të tyre, të paktën unë kështu e kuptoj; ju të më falni, në qoftë se bëj ndonjë gabim kur flas për probleme të kësaj fushe. Unë kompetent nuk jam për këto probleme, të cilat ju i dini mirë dhe na raportuat këtu, por, nga sa kam studiuar, di që përveç ligjeve të përgjithshme ka edhe përjashtime.

Nxjerrja e naftës dhe e gazit është një çështje me rëndësi të veçantë politike dhe ekonomike. Këta, nafta dhe gazi, janë dy objektivat kryesorë që u vihen përpara gjithë naftëtarëve të vendit. Në tërë punën dhe në studimin e tyre kompleks, qëllimi kryesor do të jetë pikërisht nxjerrja e naftës dhe e gazit. Pastaj, ka dhe probleme të tjera anësore që duhet të zgjidhen krahas tij, pra, është një punë me shumë detyra. Domethënë, derisa shpojmë në thellësi të tokës, atëherë, krahas analizave që u bëjmë kampionëve për naftë dhe gaz, në të njëjtën kohë bëjmë dhe analiza për minerale të tjera që mund të gjejmë në këto shtresa. Një gjë e tillë ndihmon shumë ekonominë tonë, por, për ju, kjo detyrë është në plan të dytë, pas detyrës suaj kryesore.

Zakonisht nafta gjendet në antiklinalet. Përveç kë-

saj, ju vetë keni konstatuar, literatura gjithashtu e njeh këtë, dhe atje ku ishit ju e patë se nafta mund të ekzistojë në shtresat ranore e gëlqerore, pra në formacione që janë të ngopura me naftë.

Duke marrë parasysh çështjen e strukturave, përshtypja ime është se ju, naftëtarët, e njihni ndërtimin gjeologjik të vendit tonë, veçanërisht në ato rajone ku kemi shpuar për naftë. Unë e kuptoj që ju nuk mund ta njihni gjithë ndërtimin gjeologjik të Shqipërisë me pëllëmbë. Por, megjithatë, një ide të përgjithshme të formacioneve, jo vetëm të njësive të mëdha, të periudhës së kretakut¹ etj., por më në hollësi ju duhet ta keni, dhe e keni, jam i bindur për këtë. Kurse, në veçanti, në rajonet ku keni shpuar, ju duhet ta njihni shumë mirë ndërtimin gjeologjik.

Mendimi im është se kjo çështje ka rëndësi të madhe. Në qoftë se ne nuk i njohim nga ana gjeologjike formacionet e pusit ku do të shpojme, atëherë shkojmë me sy mbyllur, kuturu, ose do të ecim duke hasur në shumë vështirësi gjatë punës. Mua më duket se jo vetëm aktualisht, por që në fillim, këto metoda, që patë atje, që dhe ne vetë i kemi, nuk janë bërë objekt i një studimi të thellë e kompleks. Kjo nuk është bërë për shumë arsye:

Së pari, puna armiqësore e specialistëve sovjetikë dhe e atyre kinezë, se të tillë janë dhe këta, si dhe ajo e armiqve sabotatorë të brendshëm të kohëve të fundit, i kanë penguar kuadrot tanë të zbatojnë një metodë me të vërtetë sistematike dhe shkencore në kërkimet

1. Periudhë gjeologjike e fundit të erës mesozoike.

dhe në shpimet për naftë. E them këtë të vërtetë sepse ju vetë e dini që shumë nga kuadrot tanë të naftës kanë mësuar në shkolla sovjetike. Ata kanë pasë mësuar mirë e i kanë përvetësuar ato që u janë dhënë dhe, kur kanë ardhur këtu, ato dijeni i kanë pasuruar me eksperiencën e madhe të vendit tonë. Por gjatë kësaj kohe ka pasur disa nga ata që kanë devijuar nga rruga e drejtë. Të tërë, jo vetëm ju, por edhe ne, kemi pasur besim tek ata dhe i pyetnim për shumë gjëra. Por, ata, të predispozuar për të ecur në rrugë antimarksiste, na i jepnin këto të dhëna në atë mënyrë si t'u dilte atyre më mirë. E shikonim ne këtë? Po mund ta shikonim dhe me vonesë. Me këto metoda ka mundësi që ata të na kenë çorientuar e të na kenë çuar në rrugë anti-shkencore në kërkimet e naftës jo përnjëherë se, në fakt, ne kemi vazhduar ta nxjerrim naftën; por, ata, me qëllim nuk na i jepnin këto metoda të përsosura.

Së dyti, ndoshta dhe sovjetikët nuk ishin aq të azhurnuar me metodat moderne të nxjerrjes së naftës. Ne mund të themi se ata nxirrnin naftë dhe në zona të tjera naftëmbajtëse, përveç Bakusë, që është qendër e vjetër naftë, ku kanë punuar dhe të huaj, prej të cilëve, sovjetikët, kanë marrë eksperiencë.

Po çështja kryesore është se nga ju, kuadrot e naftës, janë bërë përpjekje për t'i studiuar këto probleme në gjithë kompleksitetin e tyre. Megjithatë, unë mendoj se në gjithë këtë kompleksitet ka munguar ajo metodë pune shkencore deri në detaje, e mbështetur në projekte të studiuara mirë, për të arritur në terren, siç i shpjeguat ju. Ne e kuptojmë se ka një varg procesesh, të cilat duhet të zbatohen të gjitha një për një. Po e le

një proces punë në mes të rrugës, ai do të vështirësojë avancimin në procesin tjetër, ose duhet të jesh i sigurt që, procesi që le, nuk është nevoja të bëhet, për arsye se një proces tjetër e jep atë çka ti ke lënë mënjanë.

Ju na thatë se ata nuk i bëjnë punimet sizmike si ne, sepse një pjesë i zëvendësojnë me punimet gravimetrike. Por, në parim, siç e kuptoj nga ju, këto punime përbëjnë një proces kompleks, prandaj duhen bërë. Dhe, që të kryhet ky proces mirë, në radhë të parë, duhet që gjithë punonjësit e naftës, të cilët nuk duhen konsideruar si enciklopedistë, të njohin në përgjithësi problemet e naftës: specialisti i sizmikës duhet të jetë veçanërisht specialist për sizmikën dhe, çdo problemi që ka lidhje me sizmikën, ai duhet t'i vejë deri në fund. Ai duhet ta ndiejë këtë përgjegjësi të madhe për punimet sizmike që ato të bëhen sa më mirë. Për këtë ai medocmos duhet të jetë i specializuar. Përveç kulturës së përgjithshme që ka për problemet e naftës në tërësi e për sizmikën në veçanti, ai duhet të bëjë studime, të kualifikohet, të jetë, pra, i aftë për punën që i është ngarkuar.

Ai që punon në fabrikën e këpucëve, për shembull, është caktuar atje jo se di të qepë një shami në makinë, por sepse di të qepë këpucë dhe kjo i kërkohet atij. Kështu dhe në naftë: ai që është caktuar të merret me sizmikën dhe të nxjerrë të gjitha të dhënat e duhura në mënyrë shkencore, këtë punë që kërkohet prej tij, ai duhet ta bëjë sa më mirë. Gjeologu po kështu; tjetri që ka të bëjë me proceset e tjera në sektorin e naftës po kështu dhe gjithë specialistët e tjerë me radhë.

Natyrisht, një gjë e tillë bëhet te ne. Bëhet, por ju nuk munguat të thoni, dhe e thatë drejt këtu, kur folët për çështjen e specializimit të kuadrove, se atë që duhet të rrijë në krye të punës dhe të studiojë çështjen e formacioneve, të karotazhit etj., të mos e dërgojnë të marrë zarzavate për ekipin e pusit! Ose, ka ndodhur që, kur pusi është në momentin kritik, pra, në momentin kur duhet bërë kujdes i veçantë, naftëtari shkon e ia këput gjumit. Ndodh avaria! Por, avaria, ama, është çështja e fundit; ne duam jo vetëm analiza, por duam edhe të dhëna shkencore që të ecim përpara e të mos na ndodhë një gjë e tillë.

Për këtë unë mendoj që, së pari, nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave, dhe posaçërisht nga ju, shokë të bazës, nga Partia në bazë, dhe kur them Partia, të kuptojmë një gjë, shokë, që organet e Partisë dhe të pushtetit, komunistët dhe specialistët e naftës, të gjithë janë njerëz të Partisë, pra nga të gjithë duhet të kuptohet drejt e mirë vija e Partisë për naftën. Por, që t'i arrihet kësaj, do të thotë që problemën e naftës ta kuptosh më parë politikisht, të kuptosh ideologjikisht situatat dhe nevojën që ka vendi për naftë e gaz, të kuptosh që ky problem lidhet ngushtë me forcimin e pavarësisë e të mbrojtjes së republikës. E, kur i ke kuptuar të gjitha këto, duhet t'i konkretizosh në punë, në profesionin tënd. Në qoftë se punën nuk e bën si duhet dhe nuk punon që të perfeksionohesh, ose, në qoftë se nuk e organizon dhe nuk e kontrollon punën, atëherë, mund të të duket se e ke kuptuar vijën e Partisë në teori, por në praktikë je larg saj.

Së dyti, duhet të luftohet kundër mungesës së

përgjegjësisë për kryerjen e detyrave të caktuara nga të gjithë sektorët. Është çështje tjetër ajo nëse janë apo nuk janë të drejta ato ndarjet që ekzistojnë aktualisht në formën e organizimit, domethënë, nëse duhet të ekzistojë ky sektor apo jo, por përgjegjësia për moskryerjen si duhet e në kohën e duhur të detyrave kaq delikate bie mbi të gjithë, mbi drejtuesit dhe punëtorët. Indiferentizmi, moskryerja e detyrës ose he dhja e fajit njëri-tjetrit janë absolutisht të palejueshme. Të gjithë duhet të mbajnë përgjegjësi për mosrealizimet.

Ju thatë se në Algjeri dhe në Irak bëhej kujdes i veçantë për përgatitjen e kualifikimin e studentëve. Një gjë e tillë këtu te ne duhet pasur parasysh edhe për specialistët, megjithëse për specialistët besoj se organizohen kurse të veçanta tre-katër-mujore për të gjitha problemet e mëdha që ka në naftë dhe që përbëjnë një zinxhir të tërë. Ndërsa për studentët duhet përcaktuar një program kualifikimi. Ata të kualifikohen nga ana teorike se, natyrisht, nuk mund të ecet përpara pa teorinë, por dhe pa praktikë nuk mundet, prandaj duhet bërë një kombinim i drejtë i teorisë dhe i punës praktike konkrete.

Ne dëshirojmë që periudha e kualifikimit të studentit të jetë më e shkurtër, domethënë studenti jo të mbarojë universitetin dhe të vijë e të rrijë në ndërmarrje apo në kantier për nja 2-3 vjet pa futur duart në profesion, por, kur të vijë atje, brenda 3-4 muajve, të jetë në gjendje të marrë në duar proceset e punës. Prandaj mendimet tuaja për përgatitjen dhe kualifikimin e studentëve janë të drejta.

Dëshiroj t'ju flas pak dhe për studimet pasuniversitare, si për studentët, edhe për ju. Për këtë qëllim ju keni në dispozicion një material të madh studimi, por se sa është mbajtur parasysh ky material në metodikat shkencore, këtë unë nuk mund ta them. Kam përshtypjen, siç e thashë dhe më parë, se nuk ka ekzistuar një metodikë e përsosur shkencore dhe se nuk janë bërë hapa përpara në këtë metodikë. Për çfarë? Për atë që ne kemi shpuar shumë puse. Kjo do të thotë që ju të keni në dorë një material të madh studimi për rajone të ndryshme. Në çdo rajon ne kemi shpuar puse, distancat midis të cilëve nuk kanë qenë shumë të afërta. Distancat kanë qenë të vogla kur kemi vazhduar punën për shfrytëzim, po për kërkim ato kanë qenë të mëdha.

Me siguri ju gjendjen për secilin rajon e keni të qartë. Ja, të marrim për shembull rajonin e Patosit. Këtë rajon besoj se ju e njihni fare mirë, domethënë ju njihni të gjitha prerjet tektonike, shtresat, dini ku janë ranorët, flihet, argjilet, sinklinali, antiklinali, ka apo nuk ka naftë e të tjera, e të tjera. Kështu që, nga kjo anë, ju keni të dhëna të plota për këto studime. Këto përbëjnë një pjesë të rëndësishme të studimit shkencor për këtë rajon. Në këtë rajon, për shembull, ne kemi shpuar dhe kemi pasur rezultate; debitet kanë qenë të mëdha. Tani debitet janë ulur. Në qoftë se flasim si xhahilë, mund të themi që ky pus, ta zëmë, nuk dha, por kjo ndodh në të vërtetë se nuk është punuar mirë. Mund të jetë, por dhe mund të mos jetë ashtu. Kush e njeh mirë Patosin, atëherë ai di, afërsisht, se këtu kemi plan sinklinal. Këtu ne goditëm,

ose goditëm brenda në një kyvetë¹, që na dha një fontanë të madhe, e cila vazhdoi, për shembull, dy-tre muaj dhe më në fund u ul. Pse? Për arsye se nuk e ka më atë energji që kishte. Ose ranorët, këta janë si puna e sfungjerit, që shtrydh e shtrydh dhe jep naftë, edhe në flishet ndodh po ashtu. Të gjitha këto i kemi vërtetuar.

Pastaj, nga të dhënat që kemi për Patosin bëjmë lidhjet, ashtu siç i bëni ju, dhe kalojmë nga e njohura në të panjohurën. Në qoftë se ne vazhdojmë të bëjmë shpime në rajonin e Patosit, gjendjen e të cilit e njohim fare mirë, se na ka dhënë në një kohë, ose në një rajon tjetër, nafta mund të na vijë me çmim të lartë dhe të mos ketë debite të mëdha. Atëherë, ne duhet të gjejmë, natyrisht, këto ju i dini më mirë, disa metoda të dyta e të treta. Mundet që të mos arrijmë në debitin e parë të këtyre rajoneve, unë kështu mendoj, nuk di nëse e kam drejt, apo jo, por mund të arrijmë njëfarë aktivizimi të ri, më të mirë të disa puseve.

Shkojmë në rajone të tjera dhe shohim se puset na japin një debit. Të gjithë ju gjeologët, naftëtarët, që shpini puset, që merrni karotazhet, që merrni debitet etj., etj. arrini në një konkluzion së toku, ta zëmë, që ky rajon është afërsisht i ngopur me naftë në këtë shkallë, se jeni ju ata që mund ta llogaritni përafërsisht debitin dhe nëpërmjet debitit shikoni dhe sasinë e ujit. Natyrisht, ka metoda të drejta si të shfrytëzohen këto puse më mirë, por nuk mund të përjashtohet fakti që të mos ketë ujë, sepse ka ujë, ka naftë, ka edhe gaz.

1. Nga frëngjishtja — pellg.

Siç dihet, gazi rri sipër, nafta rri në mes dhe uji rri poshtë. Pra, kur ndodh dalja e ujit, do të thotë që nafta pakësohet. Sigurisht, atje naftë ka, por nuk ekziston ai presion i lartë që njihet. Prandaj, këto shtresa që i kemi në shfrytëzim t'i përdorim mirë, pavarësisht se mund të ndodhë që një pus të na japë naftë, një tjetër fare pak, ose një pus tjetër hiç fare. Pse nuk na jep naftë pusi? Këtë duhet ta gjykoni ju. Ky pus vazhdon të të japë ujë, për arsye se ti i ke marrë gazin dhe naftën që ishin sipër ujit, po dhe këtu ka naftë, aq sa ka. Puna është që ju duhet të arrini në konkluzione të drejta. Këto studime ju mund t'i bëni.

Çështjen e kam këtu që, duke i njohur këto shtresa, dhe këto nuk janë pak, ajo që ka thënë Komiteti Qendror i Partisë, që të shkojmë nga e njohura në të panjohurën, është një bazë ku ne duhet të mbështetemi dhe për probleme të tjera.

Ju na thatë se te ne ekzistojnë gjeosinklinali, zona kalimtare dhe platforma, domethënë, fusha që shkon drejt bregdetit, se këtu janë ato shtresat e komplikuarra, presionet anormale. Nga literatura mësojmë se në këto presione anormale ka edhe naftë, edhe gaz. Këtë do ta vërtetojnë kërkimet, por këto kërkime, natyrisht, duhet t'i vazhdojmë. Të shkojmë nga e njohura në të panjohurën nuk do të thotë të qëndrojmë në vend, ose të bëjmë vetëm konturime. Edhe konturime do të bëjmë, se do të zgjerojmë zonën, por çështja është se gjeologët kanë bërë shpime dhe lart, në Veri. Diku kam lexuar për naftën që kjo ndjek vargmalet. Kur thuhet vargmalet nuk është fjala për ato që janë në sipërfaqe, por për vargjet strukturore nën tokë.

Një nga synimet e sabotatorëve në fushën e naftës ishte të merrnin e të çonin një sondë këtu e një tjetër në Veri, ik këtej e ik andej. Edhe studimet e mira mund të jenë quajtur prej tyre si studime pa vlerë, por ato ne duhet t'i vlerësojmë dhe t'u futemi, ashtu siç i kemi. Gjeologët t'i futen kësaj pune, të njihen me ato të dhëna dhe të nxjerrin konkluzione. Nëse duhet të bëjmë në disa vende studime, ashtu të bëhet. Por, pas një studimi të rifillojmë të bëjmë kompleksin e metodave të gjeofizikës e të tjerat që thoni ju. Kështu duhet punuar, sepse ne kemi një strukturë që 85 përqind mund të jetë naftëmbajtëse. Kjo strukturë mund të jetë ranore, mund të jetë dhe gëlqerore. Kjo do të thotë të shkosh drejt së panjohurës.

Po edhe atje ku thuhet se nuk kemi naftë e gaz, edhe atje do të kërkojmë se mund të gjejmë. Vendi ynë ka pasuri të mëdha. Këtë na e thonë edhe miqtë tanë. Kur flitet për vendin tonë dhe për politikën e tij, e sidomos tani, shumë prej tyre shprehën: «Po mirë, me se do të rrojë Shqipëria tani?! Kina po i jep vetëm një përqindje të vogël të ndihmës së saj, pra, si do të bëjë kjo Shqipëri pa këtë ndihmë?». Të tjerë u përgjigjen: «Mund të bëjnë shqiptarët edhe pa ndihmën e Kinës, se kanë pasuri të mëdha nëntokësore». Kështu thonë miqtë tanë, por një gjë të tillë duhet ta vërtetojmë me punë.

Në kushtet e solme kërkesat për naftë e gaz janë të mëdha. Për këtë nga punonjësit e naftës duhet bërë një studim i përpiktë, i imët, këmbëngulës dhe shkencor. Gjithsecili të përparojë në specialitetin e tij, por specialiteti i tij, ashtu siç thatë dhe ju, është një spe-

cialitet i koordinuar, jo i pakoordinuar me të tjerët. Specialisti i sizmikës, fjala vjen, duhet të jetë i aftë, me njohuri të thella e njeri që të diskutojë me lehtësi me specialistët e tjerë, me ata të shpimit, të gjeologjisë, të gravimetrisë etj., se dhe ata kanë të dhëna që, të tëra, të marra së bashku, ndihmojnë në arritjen e konkluzioneve sa më të drejta shkencore. Në bazë të të dhënave që ka njëri ose tjetri, diskutohet, bëhen debate, kundërshtohet ose mbështetet një mendim dhe hapen horizonte më të gjera. Kur mbledhen specialistët e degëve të ndryshme për të studiuar një objekt, nëse do të shpohet apo nuk do të shpohet këtui, secili duhet patjetër që të zhvishet nga ajo ndjenja e sektorit dhe e superioritetit në lëndën e tij. Çështja është një për të gjithë. Të dhënat vërtetojnë që mendimi i njërit është i drejtë, kurse i një tjetri jo. Dhe, në qoftë se mendimi i këtij, për shembull, është i gabuar, ky nuk duhet të ngulë këmbë si mushka e të thotë se është i drejtë, se një gjë e tillë është në dëm të punës.

Eksperiencën që ju, shokë specialistë të naftës, morët në Algjeri dhe në Irak, duhet ta ballafaqoni me eksperiencën tuaj që është shumë e madhe dhe ta thelloni atë më tej. Mos harroni se ne kemi eksperiencë të pasur në naftë, se, me sa di unë, Algjeria ka filluar të nxjerrë naftë në vitet 40 të këtij shekulli, kurse ne kemi më shumë vite. Dhe me çfarë vështirësish e kemi nxjerrë ne naftën! Me thonj e kemi nxjerrë, kurse ata atje, që në fillim të kësaj pune, kanë pasur pajisje nga më të mirat. Ata kanë sonda, makineri e ordinatorë nga më modernët të Amerikës, të Francës dhe njerëz kompetentë në këtë fushë. Në qoftë se ai atje koefi-

cientin e puseve pozitive në kërkime e ka 5 me 1, edhe ne duhet të bëjmë përpjekje që ta përmirësojmë koeficientin, se tani kemi fituar eksperiencë dhe kemi mundësi që ta arrijmë këtë. Kjo është detyra jonë dhe këtë e kërkon interesi i atdheut tonë që ndërton socializmin në kushtet e rrethimit të egër kapitalisto-revizionist. Unë jam i bindur se edhe ju, punonjës të naftës, kështu mendoni, siç mendon Partia. Sigurisht, këto punë duhet të bëhen me sistem, me organizim dhe t'ju jepet ndihma e nevojshme, me literaturë e me gjithçka tjetër.

Vëmendje u duhet kushtuar dhe kuadrove të aftë që përgatiten për këtë ose atë specialitet. Unë di raste që tregojnë punën pa përgjegjësi të disa kuadrove drejtues, që nuk e shikojnë nëse i vlen çështjes lëvizja pa kriter e disa specialistëve të zotë apo jo, por veprojnë në mënyrë shabllone. Kështu, për shembull, di që një matematikan i shkëlqyer është dërguar mësues në një shkollë të një rrethi të vogël. Kështu nuk bëhet! Të dërgosh në shkollën e një rrethi të vogël një njeri që mbaron universitetin këtu në mënyrë të shkëlqyer, që e ke dërguar edhe jashtë shtetit për studime pasuniversitare, ku, gjithashtu, ka lënë përshtypje shumë të mira sa profesorët kanë thënë: «Ç'është ky universiteti juaj që ka nxjerrë njerëz të tillë kaq të zotë?», kjo nuk shkon. Pra, një matematikan kaq të zot e dërgojnë të japë mësim në shkollë, në një kohë kur në naftë e në degë të tjera të ekonomisë ndihet shumë nevoja e njerëzve të tillë! Në naftë kërkohet të bëhen llogaritë sa më të sakta.

Në këtë drejtim ndihmon shumë matematika e Bulit¹. Por matematikën e Bulit nuk e dinë shumë njerëz. Kësaj i është futur dhe e ka mësuar Fundoja, që është një matematikan i zoti. Matematika e Bulit nuk është me dhjetë shifra, po me dy. Në qoftë se nuk di matematikën e Bulit, nuk mund të ecin ordinatorët, sepse janë me miliona e me miliona operacione që bëhen më mirë me dy shifra. Kjo matematikë ishte hedhur në harresë, por e kapën amerikanët dhe nuk kanë shumë kohë që e kanë futur në punë.

E kam çështjen këtu që në gjetjen e këtyre kuadrove duhet të mos veprohet në mënyrë aritmetike, domethënë dy duhet të dërgohen atje e tre më tej. Mirë, kuadri do të shpërndalet, por të veprohet me mend, pra, ku duhet caktuar të punojë njëri e ku duhet tjetri, duke e parë secilin në të gjitha aspektet, që një gjë e tillë të ndihmojë e të mos dëmtojë aspak përparimin tonë. Ka punë e procese pune ku duhet të punojnë njerëzit më të aftë. Ja, proceset e naftës, për shembull, të mos konsiderohen procese shumë të thjeshta. Jo, ka procese matematike, probleme të koklavitura që duan njerëz të mësuar për t'u dhënë zgjidhje. Këta njerëz të përgatitur mirë të venë në bazë, të mësojnë nga praktika, të përfitojnë dhe prej specialistëve të dorës së dytë e të tretë, se dhe ata luajnë një rol të madh në punë. Në këtë drejtim, shokë, mua më duket se kemi material tonin për ta studiuar, por këtë duhet ta shfrytëzojmë si duhet.

1. Xhorxh Bul (1815-1864), matematikan e logjiklen anglez, një nga themeluesit e logjikës matematike.

Mendoj se nuk është nevoja të përmend rëndësinë e madhe që ka nafta, veçanërisht për ne. Prej këtej rrjedh domosdoshmëria në dhënien e konkluzioneve më të thelluara pas një pune që bëhet në këtë ose në atë rajon. Mundet që këto shtresa nga ana stratigrafike, tektonike e të tjera, të jenë dhe të komplikuar, por, megjithatë, prapë ka mundësi që konkluzionet të jepen të bazuara e të thelluara.

Për Sarandën, për shembull, sot për sot nuk kemi një situatë të qartë, kemi të bëjmë me shtresa gazi apo me shtresa nafte? Tani po del gazi, po mos do të dalë nafta më vonë? Këto e të tjera gjëra nuk na jepen të sakta, ashtu si duhen. Kjo shkakton perturbacione për çështjen e energjisë. Mjaft ndërmarrje tani punojnë me gaz, me naftë, si dhe me qymyr. Të gjitha këto janë planifikuar. Kur i mungon gazi një ndërmarrjeje, ajo ia merr tjetrës, por tjetra mbetet pa gjë.

Ç'duhet bërë që të mos ketë të tilla çrregullime? Ju, punonjësit e naftës, duhet t'i viheni punës më me forcë, të arrini të nxirrni konkluzione më të drejta e më shkencore dhe të keni kurajën ta thoni se tani nuk mundet më tepër, kaq mund të merret në këtë ose në atë rajon. Ju sot bëni përpjekje që ta shtoni këtë fond, këtë hapësirë, por unë nuk them që ne të tregohemi skeptikë, jo të themi edhe po, edhe jo, edhe ka, edhe nuk ka. Ja, doli një pus i ri në Lushnjë dhe na thonë se është kështu e ashtu, mirëpo tani mësoj që ka një debit prej 3 tonësh naftë. Mirë, ky pus kaq mund të japë, por çështja është që të jemi më ekzaktë në konkluzionet që japim, se ne në këto të dhëna bazojmë planet.

Unë do t'ju pyesja ju, shokë gjeologë: a bëni mbledhje të rregullta, domethënë mbledhje me bukë, për të diskutuar ato që u thanë këtu, situatën rajonale, por dhe atë jashtë rajonit?

Ka njerëz që punojnë me ekupe të ndryshme gjeologjike, por punojnë në mos për naftën, për minerale të tjera. Kam lexuar në literaturë se përdoret një metodë gjeofizike jo e thellë, por 10 metra për të parë prirjen. Një gjë të tillë nuk e bëjnë vetëm naftëtarët, por edhe të tjerët, për minerale të tjera. Kjo është një analizë.

Ka të tjerë që shkojnë dhe më thellë. Ata të bakrit na thonë neve se venë më në shtresë të bakrit. Po ju, gjeologët, a keni organizuar për këtë një diskutim pune e debati për t'i raportuar shoqi-shoqit, nën drejtimin e sektorëve, për këto çështje?

Cilat janë ato rajone ku ju keni parashikuar të punoni bashkë? Unë do të thosha dhe një gjë që pas-universitarët, pedagogët që japin mësim për problemet e gjeologjisë, të naftës, të shpimeve etj., nuk duhet t'u përmbahen vetëm librave. Ata duhet të venë në bazë e të marrin gjithë këto materiale që përmendëm, t'i përpunojnë dhe të hartojnë librin, që ky libër të na shërbejë neve dhe të tjerëve. Pra, të pasqyrojë jo vetëm eksperiencën e vendit tonë, por dhe atë të huajën.

Për naftën është porositur një sondë për shpim 6 000 metra? A keni menduar ju ç'do të bëni me të?

Çështja është që, më parë se të porositim një sondë të tillë, që kushton mbi 2-3 milionë e gjysmë e me gjithë pjesët shkon deri në 4-5 milionë, duhet të dimë se ku e si do ta përdorim. Se blihet sonda dhe rri nga-

njëherë dy vjet pa u përdorur. Ky është një kapital i vdekur, por, pastaj, edhe dëmtohet, prishet, në qoftë se nuk vihet në shfrytëzim. Ju, si naftëtarë, si gjeologë, duhet ta dini se në cilat shtresa shpohet zakonisht në 6 000 metra.

Naftëtarët tanë, në përgjithësi, janë njerëz të rinj, njerëz të punës, nga të cilët të gjithë duhet të përfitojmë.

Ju uroj suksese! Të fala shokëve naftëtarë!

*Botuar për herë të parë,
me ndonjë shkurtim në
librin: Enver Hoxha, «Për
shkencën» (Përmbledhje
veprash), vëll. II, f. 145*

*Botohet i plotë, sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

PUNË KRIJUESE DHE E ZGJUAR BËHET KUR NJHIET MIRË SITUATA

*Nga biseda me disa kuadro të Ministrisë
së Punëve të Brendshme*

20 prill 1978

Pasi i uroi të pranishmit dhe, nëpërmjet tyre, gjithë punonjësit e Organeve të Punëve të Brendshme me rastin e 35-vjetorit të krijimit të Armës së Sigurimit të Shtetit, shoku Enver Hoxha tha:

Organet e Sigurimit të Shtetit kryejnë, në radhë të parë, punë partie. Kjo kërkon që ato të karakterizohen kurdoherë nga vigjilenca revolucionare, nga metoda e stili revolucionar në punë. Kuptimi i thellë i detyrave nga ana e punonjësve të kësaj arme të fuqishme të diktaturës së proletariatit, që është në duart e Partisë dhe të klasës punëtore, ka rëndësi të veçantë.

Plotësimi i detyrave që u ka besuar Partia këtyre organeve, kushtëzohet nga ngritja ideopolitike e kuadrove të këtij sektori, nga kuptimi në një shkallë të lartë i ideologjisë marksiste-leniniste dhe nga zbatimi konsekuent i saj në praktikë. Të gjitha detyrat e sek-

torëve që mbulon Ministria e Punëve të Brendshme, duke përfshirë edhe ato të Sigurimit të Shtetit, janë të lidhura ngushtë në radhë të parë me kuptimin e vijës së Partisë.

Natyrisht, të gjithë këta sektorë kanë specifikat dhe teknikën e tyre, por ata kanë edhe anën e tyre të përgjithshme. Kur them që këta sektorë kanë teknikën e tyre, nuk e kam fjalën për anën materiale të çështjes, por për atë profesionale. Teknika dhe profesioni juaj janë të lidhur shumë ngushtë me kuptimin e thellë të vijës së Partisë në fushën e mbrojtjes së atdheut nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Ju jeni ai repart i diktaturës së proletariatit që duhet ta përvetësoni, ta zotëroni dhe ta zbatoni vijën e Partisë jo vetëm si punonjës të Organeve të Punëve të Brendshme, por, në radhë të parë, si njerëz partie. Mbrojtja e atdheut të konceptohet jo thjesht në kuptimin fizik, domethënë vetëm në ruajtjen e tërësisë së tokës sonë, por edhe në kuptimin ideor, pra si mbrojtje kundër ideologjisë së armiqve.

Aktualisht armiqtë na luftojnë me dy armë, por më e preferuar për ta është ajo e subversionit, arma ideologjike për të goditur pastërtinë e vijës së Partisë sonë, vijën e saj marksiste-leniniste, që orienton e drejton të gjithë sektorët e aktivitetit tonë: politik, ekonomik, shtetëror, organizativ, ushtarak, kulturor etj. Pikërisht këtë kërkojnë armiqtë: ta godasin, ta deformojnë dhe ta shpartallojnë Partinë tonë dhe vijën e saj. Punonjësit e Sigurimit të Shtetit janë përditë në kontakt e në luftë të drejtpërdrejtë me aktivitet armiqësor, të brendshëm dhe të jashtëm, prandaj duhet të

jenë në pararojë për kuptimin e thellë të situatave të brendshme.

Këto situata mos i shikoni kurrë në sipërfaqe, por t'i vështroni edhe në shtrirjen e tyre e sidomos të depërtoni në thellësinë e tyre. Për t'i parë situatat në thellësi duhet të kuptoni mirë, ashtu si deri tani, vijën e drejtë dhe vigjilencën e Partisë. Nuk ekskludohen raste kur ndonjë punëtor i sigurimit të ketë kryer edhe veprime sektare apo të jetë treguar oportunist. Shfaqje të tilla vërehen edhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë sonë shtetërore. Që të evitohen këto, duhet të asimilohet mirë vija e Partisë.

Fronti kryesor i punës së këtij sektori ka qenë dhe është lufta e ashpër me armiqtë. Asnjë lëshim të mos i bëhet armikut, përkundrazi t'i bihet në kokë. Ju, në punë e sipër, duhet të fitoni e të përvetësoni gjithnjë e më tepër eksperiencën e madhe të Partisë që në vlerësimin e armikut të kuptoni shkallën e rrezikshmërisë së tij dhe të njihni se njeriu nuk lind armik, por bëhet i tillë; se në këtë rrugë atë e çojnë mbeturinat e së kaluarës dhe ndikimi i veprimtarisë së armikut të jashtëm, domethënë presioni i rrethimit imperialisto-revizionist. Ky rrethim real asnjëherë nuk duhet të harrohet nga asnjëri, por veçanërisht nuk duhet të harrohet nga punonjësit e këtij sektori.

Armiqësia e elementëve të ndryshëm me pushtetin dhe Partinë lind këtu, brenda në vend. Në fillim një element i lëkundshëm mund të ketë disa keqkuptime për vijën tonë, ai mund të ndikohet nga pakënaqësitë apo meritë që ia ushqejnë mbeturinat mikroborgjeze dhe nga presionet apo ndikimet e armikut. Këto shka-

qe duhen njohur mirë dhe duhen klasifikuar nga Partia. Shkaqet duhet të dimë t'i dallojmë nga njëri-tjetri dhe t'i lidhim me njëri-tjetrin për të parashikuar pasojat e tyre, se jo rrallë nga një pakënaqësi e vogël mund të lindin edhe kontradikta që, gradualisht, po nuk u zgjidhën drejt, ka rrezik të kthehen nga joantagoniste në antagoniste. Në një rast të tillë, dashur padashur, njeriu futet në rrugë armiqësore dhe duhet goditur.

Ta kemi parasysh se kuptimi i situatave të brendshme nuk është një gjë e lehtë, por mjaft e koklavitur. Por po të njihet mirë e po të kuptohet si duhet vija e Partisë, atëherë cilido, komunisti dhe kuadri, janë në gjendje ta njohin e ta zotërojnë situatën. Elementët armiq të kategorive të ndryshme hasen në të gjithë sektorët e jetës dhe të punës, me virulenca të ndryshme. Ndërmjet tyre ekzistojnë dallime, të cilat duhen njohur. Në qoftë se punëtori i Sigurimit të Shtetit i ka parasysh këto dhe e zotëron mirë situatën, ai do të jetë në gjendje ta ndërtojë punën e tij në mënyrë krijuese, të shkathët e të zgjuar.

Që të zotërohet mirë situata përpara ngjarjeve, fenomeneve e proceseve të shumta që u dalin përpara, punonjësit e Sigurimit duhet të dinë ku të përqendrohen dhe, prej këtej, të nxjerrin konkluzione të përgjithshme dhe të veçanta. Konkluzionet e përgjithshme duhet të orientojnë për rastet e veçanta dhe, anasjelltas, nga rastet e veçanta të konkludohet për të përgjithshmen, e cila nuk është tjetër veçse një varg të veçantash të marra së toku. Pra, ja edhe një kërkesë tjetër: të njihet raporti dialektik midis të përgjithshmes e të veçantës.

Në praktikën e punës së sektorit duhen dalluar edhe nuancat e ngjarjeve, fenomeneve e proceseve të realitetit, se ndodh nganjëherë që një shfaqje vërtet në pamjen e parë duket anësore dhe e parëndësishme, por prej saj mund të zbulohen lidhje me rëndësi. Gjithashtu, në veprimtarinë keqbërëse të dallohet mirë se cilët faktorë janë të rrezikshëm dhe cilët janë shumë të rrezikshëm. Si njerëz partie, punonjësit e Organeve të Sigurimit duhet të procedojnë me pjekuri që të pastrojnë të gjithë ata që janë për t'u pastruar nga sëmundjet e ndërgjegjes dhe të punojnë me ngulm që tek elementët e lëkundshëm, tek të cilët nuk kanë hedhur akoma rrënjë pikëpamjet armiqësore, të konsolidohen pikëpamjet e drejta të Partisë. Ndërsa për ata që janë futur në rrugë armiqësore qëndrimet duhet të jenë rigorozë dhe të ashpra, pse këta e kanë mbushur kupën. Në këtë mënyrë mendoj se duhet të zotërohet situata dhe të veprohet duke u mbështetur në të.

Zotërimi i situatës nuk bëhet duke qëndruar të shkëputur nga Partia, nga organet e pushtetit, nga masat punonjëse etj., por në lidhje të shpeshta me ta. Kontaktet e organeve dhe të punonjësve të Armës së Sigurimit me komitetet e Partisë të rretheve, me komunistët, me organet e pushtetit dhe të administratës shtetërore, me anëtarët e këshillave popullorë, me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, me punëtorët dhe me fshatarët duhen të jenë të ngushta e të vazhdueshme. Ju e dini se Partia nuk janë vetëm komitetet e Partisë ose aparatet e tyre. Partia nuk duhet parë kështu. Me Partinë kuptojmë tërësinë e komunistëve që e përbëjnë atë në bazë, në rreth dhe në qendër.

Në komitetet dhe në aparatet e Partisë janë vetëm një përqindje e vogël e komunistëve. Të tjerët, shumica dërrmuese, punojnë në fabrika, në uzina, në hekurudha, në hidrocentrale, në kooperativa, në institucione, në zyra e kudo, prandaj fryma revolucionare e Partisë për ngritjen politike dhe ideologjike të masave, për forcimin e diktaturës së proletariatit dhe për kuptimin e situatës duhet të ndihet kudo.

Kur punonjësit e Sigurimit shkojnë në ndonjë fabrikë, të mos udhëhiqen nga mendimi për të parë vetëm cilët janë dhe ç'bëjnë elementët e dyshimtë. Natyrisht, kjo është një nga detyrat specifike, por kjo nuk pengon që atje të shkojnë, në radhë të parë, si njerëz të pjekur partie. Pra, ata duhet të punojnë në mënyrë të tillë që jo vetëm kolektivi punonjës ku shkojnë t'i konsiderojë si njerëz partie, por edhe ata ta ndiejnë veten si të tillë. Kjo do të thotë që atje ku venë të shohin si ecin punët, si është disiplina, a ka shfaqje të huaja, a ka dashuri dhe unitet ndërmjet njerëzve, a ka gjendje morale të shëndoshë në marrëdhëniet midis vajzave dhe djemve etj. Një punë të tillë e bëjnë edhe të deleguarit e komiteteve të Partisë, por këtë duhet ta bëjnë edhe punonjësit e Sigurimit. Po ta dinë këta mirë situatën e qendrës së punës ku shkojnë, do të dinë të venë mirë në vend edhe ata elementë që punojnë keq dhe do të shikojnë nëse puna e tyre e keqe ka bazë në atë kolektiv apo jo. Në qoftë se atje ekziston një situatë e sëmurë, kjo do të thotë se elementi i keq atje ka gjetur mbështetje e mund të bëjë për vete edhe të tjerë. Por, në qoftë se në një kolektiv të madh ka vetëm dy-tre njerëz të këqij dhe punohet për t'i

ndrequr ata, kjo do të thotë se atje situata është e shëndoshë.

Pra, punëtorët e Sigurimit të Shtetit duhet të jenë kurdoherë nga ata shokë që e zotërojnë mirë politikisht dhe ideologjikisht situatën e brendshme. Kështu do të mundin ata të bëhen sa më të afërt me masat e gjera të popullit. Duke vepruar në këtë mënyrë, punëtori i Sigurimit kur shkon në një qendër pune dhe interesohet si punëtor partie edhe për probleme të tjera të prodhimit, të kushteve të punës etj., ai do të gjejë te kolektivi punonjës dashuri dhe respekt për Organet e Sigurimit, kurse kolektivi do të ndiejë se punëtori i Sigurimit është pjesë e tij. Fjala vjen, kur ai shkon në mensë ose në fjetore dhe konstaton atje të meta e dobësi në ushqimet apo në fjetoret e punëtorëve dhe për këtë ngre probleme të drejtuesit e ndërmarrjes, atëherë edhe punëtorët do t'ia hapin zemrën; nëpërmjet bisedave të tyre të lira e të sinqerta, ai do të shohë më mirë si është gjendja në atë kolektiv dhe do të gjejë nëse ka aty ndonjë dobësi edhe nga ana e administratës apo nga drejtoria e ndërmarrjes. Në rast se po, përveç sinjalizimit në organet kompetente, ai mund t'u thotë punëtorëve: «Për ç'arsye, shokë punëtorë, nuk i kritikoni drejtuesit për këto dobësi e të meta?». Këtu s'ka asgjë të keqe. Me këtë mënyrë punëtorët e kësaj ndërmarrjeje do të shikojnë që punëtori i Sigurimit është edhe punëtor partie.

Në vendin tonë, përgjithësisht, situata është e fortë, revolucionare dhe për ne ka rëndësi që situatën e brendshme ta ruajmë kurdoherë të fortë, sikurse e kemi. Vështirësi në punë kemi, se krahas shumicës shumë

të mirë të njerëzve ka edhe disa të ligj, që veprojnë shtrembër në mënyrë të ndërjegjshme. Ka dhe njerëz të paqartë, që nuk e kuptojnë si duhet gjendjen. Megjithëse te disa njerëz mungon disiplina e fortë proletare, prapë kudo luftohet dhe ka suksese, të cilat janë të mëdha. Ka edhe të meta e gabime, që Partia i zbulon dhe i korrigjon. Kjo tregon forcën ideopolitike dhe organizative të Partisë, që do të thotë ngritje e nivelit ideopolitik të komunistëve dhe bashkë me ta edhe të popullit, do të thotë unitet mendimi e veprimi brenda radhëve të Partisë, por unitet mendimi e veprimi edhe në popull. Uniteti i mendimit e i veprimit në marrëdhëniet Parti-popull ruhet e konsolidohet me një punë të gjerë politike, nga Partia dhe gjithë institucionet shoqërore e shtetërore.

Çështja tjetër që doja të vija në dukje është ajo që punonjësit e Sigurimit të Shtetit të mos harrojnë se duhet të jenë mirë në dijeni edhe të situatave të jashtme. Ata bien në kontakt me veprimtarinë e armiqve të jashtëm, sidomos kur ajo drejtohet kundër vendit tonë. Armiqtë e jashtëm veprojnë në mënyrë të organizuar, duke shfrytëzuar mbeturinat e vjetra deri edhe lidhjet fisnore ose individuale, ata përpiqen si e si të futen brenda nesh. Kjo për ne është e qartë. Ne i njohim armiqtë se kush janë, njohim edhe tendencat e grumbullimit të tyre, por duhet të njohim edhe zhvillimin politik jashtë, të mësojmë edhe se ku vepron armiku atje. Përvoja tregon se armiqtë e jashtëm vënë në lëvizje edhe emigrantët politikë shqiptarë, prandaj ne ndjekim situatën sidomos në ato vende të huaja ku ekzistojnë grupimet e armiqve shqiptarë, si ballistë e

tradhtarë të tjerë, të organizuar në shoqëri me emra të ndryshëm. Po përveç veprimtarisë së armiqve shqiptarë, që veprojnë në vende të ndryshme, i duhet kush-tuar rëndësi edhe njohjes së situatës së jashtme në përgjithësi.

Pasi foli për disa probleme të gjendjes ndërkombëtare dhe për vendet fqinje, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Për pikëpamjet tona politike dhe ideologjike ne nuk e mbyllim gojën. Kjo nuk na pengon të bëjmë tregti, të jemi në miqësi me të tjerët, por me kusht që secili të mbetet zot në vendin e tij.

Presionet e imperialistëve amerikanë, të revizionistëve sovjetikë, jugosllavë dhe të revizionistëve kinezë, që janë shumë të rrezikshëm, do të jenë të mëdha. Ne e dimë që këto presione do të reflektohen edhe më tej. Ju e dëgjuat që, pas dhënies së shfaqjes së parë në vendin tonë të trupës së teatrit të Gjakovës, jugosllavët e tërhoqën atë arbitrarisht, duke ndërprerë shfaqjet e tjera, nën pretekstin se Enveri foli kundër titistëve! Po ne kundër ideologjisë së tyre reaksionare kemi folur kurdoherë.

Detyrat e Armës së Sigurimit të Shtetit kanë qenë dhe janë të një rëndësie të madhe për Partinë dhe për shtetin tonë të diktaturës së proletariatit. Ato sa vijnë e bëhen më të mëdha, për arsye të gjendjes ndërkombëtare që, siç e ka theksuar Partia, vërtet është revolucionare, por në të njëjtën kohë paraqitet edhe mjaft e turbullt për shkak të tradhtisë revizioniste. Për revolucionin aktualisht mungon një ndër kushtet subjektive, siç janë partitë e vërteta e të fuqishme marksiste-leniniste, të cilave u takon ta kanalizojnë këtë hov të

madh në ngritje të masave kundër pushtetit të paqëndrueshëm të borgjezisë. Tani ka ardhur ajo kohë që, sikurse thoshte Lenini, shtresat e ulëta, me proletaria-tin në krye, nuk e duan regjimin kapitalist dhe shtresat e larta nuk mund të sundojnë më si përpara. Këto dy kushte objektive për fitoren e revolucionit ekzistojnë, por faktori i tretë që është subjektiv, partia komuniste marksiste-leniniste e fortë, mungon. Në këto rrethana borgjezia manovron me partitë revizioniste dhe me sindikatat, që hiqen sikur janë në mbrojtje të interesave të punëtorëve. Në fakt këto janë nën drejtimin e patronatit dhe bëjnë një punë të poshtër armiqësore.

Edhe revizionistët kinezë, me nxitjen e luftës botërore po bëjnë krimin më të madh, që është dënuar nga Lenini dhe leninizmi. Lenini ka theksuar se luftërat grabitqare imperialiste duhet të kundërshtohen, se harxhet e saj i paguajnë me gjak klasa punëtore dhe popujt. Kurse kinezët, duke nxitur haptazi luftën, ndihmojnë borgjezinë kapitaliste, që është zhytur në një krizë të madhe.

Prandaj thashë që situatat bëhen mjaft të vështira. Por sa më të vështira që të bëhen ato, aq më të fortë duhet të jemi ne për t'i përballuar politikisht, ekonomikisht, ideologjikisht, ushtarakisht. Të forcojmë unitetin dhe vigjilencën për mbrojtjen e atdheut, të jemi trima dhe gjakftohtë, se trimi i mirë është kurdoherë i qetë. Me gjakftohtësi të madhe duhet t'i analizojmë ne ngjarjet që zhvillohen dhe të mbajmë vazhdimisht qëndrime të palëkundshme. Armikut t'i biem kokës, kurse atë që ka vepruar gabimisht, në mënyrë të pandërgjegj-

shme dhe që duhet shpëtuar, ta shpëtojmë. Koniunkturat janë koniunktura dhe si të tilla ne duhet të dimë t'i shfrytëzojmë. Ne sot i kemi marrëdhëniet normale me disa shtete, po nesër, siç thashë, mund të mos i kemi kështu, prandaj edhe pse atyre mund t'u buzëqeshim aktualisht, vigjilencën kurrë nuk duhet ta ulim.

Në përfundim, u uroj suksese punonjësve të Armës së Sigurimit të Shtetit. Dalshin kurdoherë faqebardhë, duke qenë kurdoherë në radhët e para të luftës që bën Partia për mbrojtjen e atdheut socialist, të vijës së saj, të gatshëm për goditjen pa mëshirë të çdo armiku, që do të përpiqet të prekë Partinë dhe diktaturën e proletariatit.

Me këtë rast, ju lutem t'u transmetoni të gjithë shokëve tuaj, bashkëpunëtorë të Organeve të Sigurimit, përshëndetjet më të përzemërta nga ana ime me rastin e 35-vjetorit të themelimit të Armës së Sigurimit të Shtetit!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

MASKAT PO BIEN

Shënime

22 prill 1978

Revizionizmi modern në të gjitha vendet ish-socialiste dhe në të gjitha partitë e vendeve kryesore kapitaliste po e nxjerr në shesh fytyrën e vërtetë. Ndërkohë Bashkimi Sovjetik bën përpjekje që të fshihet nën maskën e leninizmit. Këtë maskë ai përpiqet ta ruajë, ta përpunojë, por nuk bën përpjekje (ose këto kanë dështuar) që edhe partitë e tjera revizioniste ta ruajnë këtë maskë për të fshehur tradhtinë dhe devijimin e tyre nga marksizëm-leninizmi.

Vendet e ish-demokracisë popullore, shtetet e Lindjes, që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës dhe në KNER, deri diku (them deri diku dhe jo si Bashkimi Sovjetik) ruajnë disa tipare dhe, herë pas here, bëjnë aluzione se «i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit», por, në realitet, gati gjithë qëndrimet dhe veprimet e tyre janë revizioniste, kapitaliste.

Kur duan të ndërrojnë maskën, ato e bëjnë këtë me qëllim që të ushtrojnë presion mbi ato parti revizioniste-fashiste, që e kanë hedhur tej katërcipërisht Ideologjinë tonë të lavdishme, por veçanërisht përpiqen

të bëjnë presione ekonomike, ushtarake dhe politike ndaj dy vendeve: Jugosllavisë dhe Rumanisë, të cilat hiqen sikur mbajnë një qëndrim të pavarur nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse të gjithë e dinë se Rumania në këtë drejtim blufon, kurse Jugosllavia shalon në dy kuaj, edhe në kalin sovjetik, edhe në atë amerikan e të kapitalizmit botëror. Sidoqoftë, Jugosllavia ka doktrinën e vet anarkosindikaliste, antimarksiste në tërësi, në teori dhe në praktikë, kurse Rumania ruan akoma disi format organizative të të ashtuquajturës parti komuniste rumune; ruan disa forma të strukturës, por, në realitet, edhe ajo është krejtësisht në rrugën kapitaliste dhe e varur nga Bashkimi Sovjetik. Veprimet e saj të hapëta, gjoja të pavarura ndaj politikës së Bashkimit Sovjetik, janë një fasadë, një truk, ose një manovër e koordinuar sovjeto-rumune për të prurë e për të shpurë, për të lidhur dhe për të zgjidhur marrëveshje dhe mosmarrëveshje që ekzistojnë midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve kapitaliste, si dhe midis vendeve kapitaliste me njëri-tjetrin. Pra, rumunët janë bërë proksenetët e një kauze të turbullt të shitjes së klikave të njëri e të tjetri, janë bërë ndërmjetës për ujdë gjoja paqësore, në realitet ujdë të përkohshme e, në qoftë se mund të arrihen, të udhëhequra nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë mënyrë edhe Çausheku, i cili hiqet si një politikan dhe diplomat «i madh», është në të njëjtën kohë edhe me sovjetikët edhe me amerikanët.

Titistët më duket se po përgatitin kongresin e tyre të 11-të. Tezat e këtij kongresi nuk i kanë shpallur, po kanë publikuar një libër prej 380 faqesh të

Eduard Kardelit, në të cilin ai shtron vijën që duhet të ndjekë Jugosllavia pas këtij kongresi në forcimin e vet-administrimit. Ky libër, për të cilin në parathënie thuhet se është aprovuar nga mbledhja e fundit e Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, do të shërbejë për diskutimet që do të zhvillohen në këtë kongres.

Eduard Kardeli dhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë e kanë tradhtuar prej kohësh marksizëm-leninizmin. Ai, si me thënë, e ka «perfeksionuar» (të kuptohet: e ka kalbëzuar) Jugosllavinë me strukturën që ka shpikur ose që ka adaptuar në epokën aktuale, strukturën e vetëqeverisjes ose të vet-administrimit. Kjo është teoria e vjetër e anarkosindikalistëve, e diskredituar dhe e luftuar nga Marksi dhe nga Lenini. Por revizionistët jugosllavë në hyrjen e librit të Kardelit pretendojnë se tash nuk bëhet më fjalë për ekzistencë ose jo të kësaj strukture vet-administruese në Jugosllavi. Kjo strukturë, sipas Kardelit, është vendosur, ka marrë forma të mira, vetëm se vihen detyra (do t'i radhis më poshtë cilat janë këto «detyra speciale» të periudhës së ardhshme), për ta forcuar akoma më shumë këtë strukturë ekonomike.

Kjo strukturë ekonomike, siç e dimë, bazohet në individin gjoja të shoqërizuar, i cili nuk ka më nevojë për një shtet, as për një shtet socialist të centralizuar, as për një diktaturë të proletariatit dhe as për një parti marksiste-leniniste. Ky individ i shoqërizuar në komunë, e cila konsiderohet baza e kësaj strukture, mendon vetë për punën që kryen, për investimet që bën, për fitimet që ndan, për mbivlerën që krijon dhe për

drejtimet në të cilat do ta investojë këtë mbivlerë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë. Dhe ky është absolutisht i lirë të veprojë pa ndërhyrjen e kurrkujt dhe, si me thënë, pa shikuar rreth e rrotull ç'po bëhet. Çdo komunë e çdo ndërmarrje ka planin e vet. Nga ky plan, natyrisht, udhëheqja revizioniste e komunës, nxjerr edhe disa prerogativa që i duhen Federatës, domethënë qeverisë qendrore, kokës së diktaturës së borgjezisë së re. Kjo diktaturë, sundon, në fakt, në të gjithë Jugosllavinë në mënyrë fashiste, nëpërmjet një strukture ekonomiko-organizative dhe me mjetet e represionit të policisë, të sigurimit dhe të ushtrisë.

Në shoqërinë pseudosocialiste jugosllave individit ka rolin kryesor dhe vepron në këtë «komunë vetadministruese», ku puna është shoqërizuar. Por, këtij individ i duhet edhe një ngritje politike, për ta kuptuar si duhet këtë formë të re e të përshtatshme të «administrimit socialist» të pasurive të Jugosllavisë. Ngritjen e ndërgjegjes te individit, që ta kuptojë thellë politikisht këtë vetadministrim, duhet ta bëjë partia ose Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë.

Pra, dy çështje vihen në platformën e kongresit: çështja e forcimit të mëtejshëm të kësaj forme anarkosindikaliste të prodhimit në Jugosllavi, që quhet «socialiste» dhe çështja e rolit të partisë. Por ky rol vazhdon të jetë kurdoherë vetëm një rol edukues, edukues në drejtimin e kuptimit gjoja politiko-teorik të kësaj strukture pseudosocialiste, por, në realitet, të kuptimit e të veprimit organizativ për të grabitur djersën e popullit jugosllav në interes të klasës së re borgjezo-kapitaliste. Kjo klasë e re borgjezo-kapitaliste

formohet nga të deleguarit në komunë, të cilët gjoja janë të deleguar nga punëtorët. Këta bëjnë diskutime me punëtorët, të cilat i përpunojnë dhe pastaj problemet i trajtojnë me drejtorin dhe me shtabin e tij. Pra, është drejtori që merr vendime, sepse fjalën e fundit e ka ky dhe njerëzit e shtabit të tij. Drejtori, gjoja në emër të punëtorëve, vendos për çdo gjë: për planin, për fitimet, për falimentimet, për tregtinë, për shitjen, për blerjen etj. Natyrisht, këto transaksione bëhen në favorin e një klike, e cila ngjitet nga poshtë-lart derisa arrin në Federatë. Kështu që klasa punëtore, punonjësit dhe inteligjencia shfrytëzohen me formula pseudomarksiste, se gjoja kanë një liri të plotë të vendosin e të vetëqeverisin, por, në fakt, përveç fjalëve nuk kanë asnjë të drejtë, sepse vendimet merren nga një klasë e re kapitaliste e stratifikuar.

Aktualisht veprime të njëjlojta, siç po ndodhin në Jugosllavi, ne shohim të bëhen edhe në Kinë. Tash edhe atje është ngritur në parim që «i kuq» është edhe tekniku, domethënë për të qenë «i kuq» mjafton të jesh teknik. Fjalët teknik dhe «i kuq» nuk kanë asnjë ndryshim. Likuidohet kështu ekzistenca e klasave dhe vihet në radhë të parë tekniku, intelektual, ai që punon me mendje dhe që ka një dallim kulture nga masat e gjera qindramilionëshe të popullit kinez. Teknikët në Kinë konsiderohen si «mjeshtër të ndërtimit të socializmit» dhe kanë zyrtarisht përkrahjen e autoriteteve të partisë dhe të atyre shtetërore. Ata respektohen, nderohen, favorizohen në radhë të parë, sepse «ndërtojnë të mirat materiale», të cilat i shërbejnë socializmit ala Hua Kuo Fen e Ten Hsiao Pin, domethënë kapi-

talizmit. Prandaj është e natyrshme që këta teknikë të quhen «të kuq», dhe punëtorë të një shoqërie «të re» socialiste, e cila nuk flet më për njëfarë diktature të proletariatit. Kështu, për udhëheqjen aktuale kineze nuk ekziston më lufta e klasave, pse klasat janë shkrirë, derisa intelektualët janë shkrirë me klasën punëtoare, bile ata janë vënë mbi klasën punëtoare dhe mbi fshatarësinë. Prandaj, është e kuptueshme që në Kinë nuk mund të ketë një luftë klase të bazuar në teorinë marksiste-leniniste. Atje do të ketë një luftë klase, por në bazë të teorisë revizioniste, socialdemokrate, kapitaliste.

Këtej lind e njëjta gjë, krijimi në Kinë i një shtrese të re borgjezo-kapitaliste, e cila po merr në dorë fuqinë, po krijon, po ndihmon dhe po favorizon kuadrot e saj, të cilët i vë në drejtim për të shfrytëzuar klasën punëtoare, fshatarësinë dhe gjithë punonjësit. Bile teoria që zhvillohet aktualisht në Kinë shpreh hapur se këta teknikë, të cilët përbëjnë «krycin e ndërtimit të socializmit», duhet të mos ngarkohen dhe të mos shqetësohen me politikë dhe me teori, por të merren vetëm me shpikje e me racionalizime, të kryejnë një revolucion tekniko-shkencor pa një udhëheqje ideologjike.

Për të fshehur këtë tradhti të madhe, revizionistët kinezë nuk mungojnë të thonë që, kur të kenë kohë, njerëzit e kësaj shtrese të re, ose kjo klasë e re që po dominon aktualisht në Kinë, mund të merren një çikë edhe me politikë, të lexojnë edhe ndonjë libër teorik. Por teoria dhe politika për ta duhet të shkojnë në radhën e dytë dhe të tretë, se me këtë duhet të merren e të japin mendimin e tyre vetëm disa njerëz ose disa

shtresa, të cilat i cakton udhëheqja! Në këtë zallamahi, sigurisht jo pa qëllim, shkohet nga njëri ekstrem në tjetrin, shkohet deri atje saqë gazeta «Zhenminzhibao» thotë se të gjithë duhet të shkruajnë dhe të shprehin çdo gjë që kanë në zemër dhe të mos i dëgjojnë më fjalimet e sekretarëve të partisë, të cilat janë bërë të mërzitshme, pse ka arritur puna deri atje, saqë asnjë gazetë, qoftë edhe gazeta qendrore, «Zhenminzhibao» dhe të tjerat, nuk lexohen nga publiku kinez. Ky është gjoja rezultat i punës armiqësore të «të katërve», por kjo do të thotë që e gjithë «teoria» dhe «struktura» e ndërtuar në kohën e Mao Ce Dunit duhet të rrëzohet. Kështu, edhe në Kinë po restaurohet aktualisht një strukturë dhe një superstrukturë e re kapitaliste, nën udhëheqjen e Hua Kuo Fenit, Ten Hsiao Pinit e të bandës së tyre dhe maskat po bien, ose janë aq të holla, saqë nëpërmjet tyre duket fytyra e këtyre tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, e këtyre kapitalistëve të vjetër, që Maoja i kishte konservuar, i kishte përkëdhelur, i kishte sjellë në fuqi dhe i kishte edukuar gjoja me teorinë e tij. Tash ata kanë marrë fuqinë në dorë dhe po ndërtojnë kapitalizmin me forma strukturore gati të njëllojta me ato të revizionistëve jugosllavë.

Me kohë ne do të shohim më qartë edhe organizimin strukturor të ekonomisë kineze, po që tash duket se komunat popullore do të marrin atje formën e komunave vetadministruese jugosllave. Në Kinë, do të krijohet gjendja e vartësisë nga kapitalizmi botëror, veçanërisht nga ai amerikan, i cili është më i pasuri dhe më i predispozuar për të bërë investime në Kinë, për të shfrytëzuar pasuritë e mëdha të këtij vendi me

hapësira të gjera, për të shfrytëzuar krahët e shumtë të punës që ekzistojnë atje aq të lirë. Kështu fitimet e kapitalistëve kinezë do të bashkohen me fitimet e kapitalistëve të huaj dhe do të nxirren nga kurrizi, djersa dhe gjaku i klasës punëtore dhe i fshatarësisë kineze.

Kina aktualisht po bën një propagandë të madhe për ndryshimet që ndodhin atje në drejtim të zhvillimit politik, ideologjik, organizativ, ekonomik dhe ushtarak. Ajo përhap në botë shumë literaturë, e cila, sipas mendimit tonë, nuk ka efekt të madh. Përkundrazi, efekti i saj është i kundërt me atë që presin udhëheqësit kinezë, pse njerëzit përparimtarë dhe burrat e shtetit e kuptojnë brendinë e kësaj literature, kuptojnë qëllimet e vërteta të udhëheqjes kineze dhe reflektojnë se prapa këtij vandaku të madh me letra, që përhapen në shtetet e ndryshme të botës, nuk ekziston ajo çështje që propagandohet se gjoja në Kinë udhëheq mark-sizëm-leninizmi dhe ndërtohet socializmi.

Kina dërgon dhe pret nga të gjitha vendet kapitaliste e revizioniste, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik, me qindra delegacione. Sipas të thënave të një ambasadori francez del se vetëm në Francë kanë shkuar 400 delegacione. Një numër kaq i madh delegacionesh, në mos edhe më shumë, kanë shkuar edhe në Gjermani, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Japoni e kudo gjetkë, përveç numrit të madh të delegacioneve, të turistëve e të spiunëve që kanë mbuluar, gjithashtu, qytetet e Kinës. Të gjitha këto delegacione, të gjithë këta njerëz venë, natyrisht, në vendet e mëdha kapitaliste të botës për të kontraktuar mallra me kredi që dëshiron të marrë Kina nga këto shtete. Njëkohësisht

këta njerëz që dërgohen në këto vende përgatiten e njihen atje me jetën kapitaliste, me zhvillimin kapitalist e kthehen në Kinë «të armatosur» me ideologjinë borgjeze dhe me mënyrën borgjeze të jetesës, të cilën e përhapin në vendin e tyre, atje ku punojnë. Ky lumë njerëzish përbëhet kryesisht nga ata teknikë profesionistë që Ten Hsiao Pini i quan «të kuq», por që në fakt ata janë ajka e reaksionit kinez, e cila doli mbi ujë me ardhjen në fuqi të udhëheqjes aktuale revizioniste kineze.

Ne pamë se si precipituan ngjarjet në Kinë brenda një kohe të shkurtër. Prej rreth një viti atje u rehabilituan të gjithë armiqtë e socializmit që ishin dënuar nga Revolucioni Kulturor kinez. Këta njerëz nuk ishin dënuar dhe degraduar nga «katërshja», siç pretendojnë Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini, por ishte vija e Mao Ce Dunit, vija e tij centriste që kishte bërë dallimin në mes atyre që mund të qëndronin në pushtet e në parti dhe atyre që nuk duhej të qëndronin, për arsye se ishin reaksionarë me damkë. Këta reaksionarë me damkë Mao Ce Duni nuk i kishte likuiduar. Përkundrazi ata vazhdonin të punonin, por, natyrisht, nuk kishin më pozitë e mëparshme të rëndësishme, dhe, kur themi se këta ishin goditur nga Mao Ce Duni, këtë e mbështetim në vetë dokumentet që ka publikuar Hua Kuo Feni.

Kur ne lexojmë detyrat e Zyrës së Përgjithshme për të cilën kam shkruar edhe më përpara, konstatojmë se ishte ky organ që kishte shtënë në dorë gjithë drejtimin e Kinës dhe bënte vlerësimin e punëve dhe të njerëzve. Kjo zyrë i vlerësonte dhe i caktonte njerëzit

në punët që mendonte dhe asnjë anëtar i Komitetit Qendror, bile as i Byrosë Politike ose i Komitetit të Përhershëm të Byrosë Politike të Komitetit Qendror nuk mund të aprovonte një person në një funksion, sidomos të lartë, pa lejen e Mao Ce Dunit.

Pra, ishte Mao Ce Duni ai që kishte caktuar njerëzit në udhëheqje, në të gjithë piramidën, veçanërisht njerëzit kryesorë në stadet e ndryshme të piramidës së partisë dhe të shtetit. Mirëpo ardhja e Hua Kuo Fenit në fuqi i dha fund vijës së Mao Ce Dunit dhe solli në fuqi, në vendet e tyre të mëparshme, gjithë morinë e njerëzve të reaksionit më të zi, të cilët ishin skartuar nga punët e shtetit. Domethënë, gjithë teoria dhe praktika e Mao Ce Dunit u dënua. Ky dënim nuk thuhet haptazi, por praktikohet. Kjo do të thotë se teoria e Mao Ce Dunit nuk ekziston. Revolucioni Kulturor ka mbaruar dhe kjo u deklarua zyrtarisht në kongresin e fundit që bëri Hua Kuo Feni. Revolucioni Kulturor jo vetëm mbaroi, por u «korrigjuan» edhe gabimet që ishin bërë gjatë zhvillimit të tij, pse për Hua Kuo Fenin dhe për Ten Hsiao Pinin të gjitha ishin të gabuara. Kështu Mao Ce Duni mbeti në mauzole vetëm një kufomë, brenda në trupin e të cilit s'ka asnjë organ. Revizionistët kinezë vetëm nga ana e jashtme e ruajnë emrin e Mao Ce Dunit, pse brendia dhe «mendimi» i tij janë hedhur poshtë, siç janë hedhur poshtë zemra dhe të gjitha organet e tjera.

Ky emër, natyrisht, u duhet revizionistëve e kapitalistëve kinezë për të maskuar veprimtarinë e tyre keqbërëse kundër popullit kinez, për të shtypur elementin punëtor revolucionar, për të shtypur çdo re-

voltë brenda në Kinë dhe për të aktivizuar kthimin e saj, të strukturës dhe të superstrukturës së saj në një shtet dhe në një ideologji kapitaliste idealiste.

Nuk ka rëndësi nëse aktualisht Kina ka lidhje apo jo me partitë revizioniste italiane, spanjolle apo franceze. **Pikëpamjet e Partisë Komuniste të Kinës janë të njëjllotja me pikëpamjet e këtyre tri partive dhe me pikëpamjet e të gjitha partive të tjera revizioniste që janë dhe që nuk janë në fuqi.**

Në Itali Kina ka dërguar me qindra delegacione. Vetë funksionarë të ambasadës italiane në Pekin u thonë njerëzve tanë se Kina aktualisht ndien një hidhërim për situatat që ngjasin në Itali dhe dëshiron që qeverisë aktuale italiane t'i japë ndihmë, duke lidhur marrëveshje të mëdha me monopolet kryesore, siç janë FIAT-i, «Montecatini», ENI etj., etj. Kjo keqardhje nga ana e Kinës për dobësimin e pushtetit kapitalist italian, natyrisht, është një mbështetje që i bëhet edhe partisë revizioniste italiane, e cila prapa skenës është bërë një pjesëtare e kapitalit italian. Ajo ka arritur «kompromise historike» me demokristianët dhe deklaroi publikisht se nuk është më «në opozitë» me ta, domethënë me kapitalin italian. Edhe në veprimet e qeverisë italiane, partia revizioniste e Berlinguerit është pjesëtare, siç është pjesëtare në shtypjen e klasës punëtore italiane, në ringjalljen e fashizmit në Itali nën maskën e «brigadave të kuqe». Ajo është pjesëtare, gjithashtu, në frenimin e demonstratave të fuqishme të masave popullore që duhet të zhvilloheshin aktualisht në Itali me rastin e grabitjes së Aldo Moros.

Pra, politika kineze ndaj kapitalit italian është e

njëllojtë me politikën e partisë revizioniste italiane. Partia e Berlinguerit është kundër diktaturës së proletariatit dhe kundër luftës së klasave; ajo është një parti reformiste, një parti e kretinizmit¹ parlamentar. Prandaj të dyja partitë revizioniste, e Kinës dhe e Italisë, puqen në këtë rrugë të tradhtisë; të dyja këto parti e kanë braktisur rrugën revolucionare.

E njëjta gjë ngjet edhe me partinë revizioniste spanjolle. Siç e dimë, kjo parti mblodhi kongresin e saj të parë që pas mbarimit të luftës civile. Në këtë kongres, që nuk ishte kongres i një partie marksiste-leniniste, por i një partie fashiste, si me thënë, renegate, Karriljoja, sekretar i përgjithshëm i kësaj partie, në raportin që paraqiti, haptazi hodhi poshtë tezën që partia spanjolle të quhet leniniste. Ai shpjegoi se në periudhën e tanishme të zhvillimit të kapitalizmit, termi «leninist» dhe «ideologjia leniniste» janë anakronike. Nuk mund të shkohet në socializëm me pikëpamjet e vjetra leniniste, tha ky renegat në këtë kongres. Prandaj partia jonë, u shpreh Karriljoja, duhet të quhet vetëm parti marksiste-demokratike-revolucionare. Me pikëpamjen e Karriljos u bashkua shumica dërrmuese e delegatëve. Vetëm nja 200 veta nuk votuan për heqjen e termit marksist-leninist nga partia, por edhe ata që e kundërshtuan ishin elementë formalistë, pse në fakt qëndruan në parti dhe pranuan gjithë programin e saj.

Pra, programi i partisë revizioniste spanjolle është i qartë. Karriljoja deklaroi se «ne jemi një parti euro-

1. Nga frëngjishtja — budallallëk, trashësl.

komuniste si ajo e Italisë dhe e Francës; ne e pranojmë regjimin mbretëror, e konsiderojmë mbretin Huan Karlos një element përparimtar dhe e mbështetim. Ne bëjmë pjesë në parlament dhe nëpërmjet reformave dhe tok me partitë e tjera do të shkojmë drejt ndryshimeve akoma më të mëdha demokratike deri në socializëm*.

Kinezët janë dakord me vijën e partisë tradhtare spanjolle. Ata bile kanë qenë dakord që më parë me regjimin diktatorial të Frankos, të cilin e njohën me kohë dhe lidhën me të marrëdhënie diplomatike dhe tregtare. Më parë se të legalizohej tok me partinë e tij, Karriljoja vajti në Pekin, bisedoi me «shokët» kinezë dhe ra dakord me ta, dhe kjo gjë është deklaruar, që mbreti Huan Karlos i Spanjës, tok me mbretërcshën, do të vizitojnë Pekinin e do të priten atje me nderime të posaçme.

Pra edhe me partinë revizioniste spanjolle Partia Komuniste e Kinës është në një vijë. Është po ashtu në një vijë jo vetëm për të mbrojtur kapitalin spanjoll dhe bazat amerikane në Spanjë, por edhe për t'iu kundërvënë Bashkimit Sovjetik.

E njëjta gjë ngjet edhe me Partinë Komuniste revizioniste Franceze, që, siç e dimë dhe siç e kemi thënë, e ka hedhur tej diktaturën e proletariatit dhe teorinë e luftës së klasave. Kjo parti humbi në zgjedhjet parlamentare dhe shumë francezë, që përpara votonin për të, patën deziluzione të mëdha dhe votuan për partinë socialiste të Miteranit.

Aktualisht po ndodh një çarje e mëtejshme në partinë revizioniste të Marshesë, përçarje që e çon këtë parti drejt një tradhtie më të hapët, drejt një veprimi

më të gjerë në kthimin e tërë partisë, të bazës së saj nga e djathta, duke e zhveshur edhe nga ato pak ndjenja të «ideve proletare» që mund të ekzistojnë në bazë. Kjo luftë po ndërmerret nga ish-shokët e Marshesë, të cilët e akuzojnë këtë dhe komitetin qendror që ka dalë nga Kongresi i 22-të i partisë revizioniste franceze se nuk janë akoma sa duhet të djathtë, nuk janë sa duhet në mbështetje të kapitalizmit francez. Prandaj ata kërkojnë të zhvillohen diskutime të gjera dhe të lira në të gjithë partinë, në të gjitha forumet, deri edhe në komitetin e saj qendror që do të mblidhet nga fundi i muajit prill, pikërisht për të analizuar disfatën e kësaj partie.

Pra, Partia Komuniste e Kinës që mbështet kapitalin francez, kjo parti që ka dërguar në Francë afro 400 delegacione të ndryshme për të marrë eksperiencë dhe kredi nga ky vend, nuk mund të mos jetë dakord me rrugën e partisë revizioniste franceze që shkon drejt forcimit të pushtetit të kapitalit në Francë. Kjo i intereson Kinës, sepse është në një vijë politike me të.

Të njëjtën vijë ndjek Kina edhe me të gjitha partitë e tjera revizioniste në botë. Natyrisht, këto lidhje akoma nuk janë deklaruar, por i kanë kapërcyer deklaratat, derisa Kina mban lidhje miqësore dhe merr kredi të mëdha nga shtetet kapitaliste, ku vegjetojnë këto parti pseudomarksiste, që i shërbejnë pikërisht këtij kapitali, që ndihmon edhe në mëkëmbjen e kapitalit kinez.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 360

TEKSTET SHKOLLORE TË PËRMIRËSOHEN VAZIHDIMISHT E ME AFATE TË CAKTUARA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 prill 1978

Dëshiroj të njihem pak më shumë me gjendjen e teksteve, sidomos të lëndëve teknike.

Në përgatitjen e teksteve për shkollat e mesme bujqësore, për shembull, a është mbajtur parasysh që nxënësit, përmes tyre, ta njohin mirë agroteknikën e bimëve kryesore që kanë prioritet në bujqësinë tonë? Gjatë katër vjetëve që zgjatin shkollat profesionale, mësimet jepen sistematikisht, në mënyrë të tillë që, brenda kësaj periudhe, djemtë dhe vajzat që mbarojnë ato, të bëhen me të vërtetë specialistë të mesëm të kualifikuar dhe me një praktikë të shkurtër prej një viti, ata, të jenë në gjendje ta zotërojnë mirë shkencën agroteknike; apo lëndët nuk janë zbërthyer në mënyrë pro-

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi gjendjen e teksteve shkollore dhe disa probleme që dalin për ngritjen e nivelit ideopolitik e shkencor dhe për forcimin e tendenciozitetit klasor e revolucionar të tyre».

porcionale dhe, pjesë të ndryshme të tyre, u shtohen teksteve gjatë mësimdhënies, sipas kapacitetit të mësuesit apo të atij që merr pjesë në hartimin e këtij apo atij teksti? Po të veprohet kështu, s'ka dyshim që do të ketë subjektivizëm se njëri mund t'i japë rëndësi të madhe tokës, një tjetër, plehërimit etj. Kështu nuk ruhet dot proporcionaliteti i duhur, që nxënësve t'u jepen njohuri komplete për bujqësinë, meqenëse këtu po flasim për tekstet dhe të mësuarit dhe jo, fjala vjen, për përgatitjen ushtarake apo për kulturën fizike, sepse, siç dihet, çdo komponent ka rëndësinë e vet.

A bëhet me kujdes vlerësimi i teksteve që përgatiten për shkollat profesionale, nxënësit e të cilave, pas studimeve, shkojnë të punojnë në sektorët e ndryshëm të bujqësisë? Po më pas, ndiqet nga ana e shkollave se ç'përparime bëjnë ata në jetë? Bëhet kjo punë apo nuk bëhet? Unë nuk e kam fjalën që të ndiqet një nga një çdo ish-nxënës, por, nëpërmjet komiteteve të Partisë, komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, nëpërmjet instruktorëve të bujqësisë ose të industrisë, të ketë interesim për ta se ç'rezultate japin në praktikë. Mund të ndodhë, fjala vjen, që në ndonjë ndërmarrje punojnë 20-30 kuadro që kanë dalë nga një shkollë profesionale. Në këtë rast a interesohet njeri për gjendjen dhe për përparimin e tyre në profesion? Mund t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve?

Pasi shoqja Testa Cami, në atë kohë ministre e Arsimit dhe e Kulturës, iu përgjigj pyetjeve, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Nuk e kam pa baza pyetjen që bëra. Në rast se në një tekst, po marr si shembull atë të bujqësisë, vihen

njohuritë teorike më të domosdoshme, sidomos të kohës sonë, si dhe eksperiencia jonë dhe ajo e huaj, përmirësimi i tyre nuk mund të bëhet përnjëherë. Ne nuk mund ta ndryshojmë një tekst për çdo informacion të ri shkencor që shkruhet në revista të ndryshme. Jo, për çdo vit në asnjë mënyrë nuk mund të bëhen ndryshime. Prandaj, lind nevoja e përcaktimit të një periodizimi të këtyre çështjeve, sepse tekstet si rregull, nuk mund të ndryshohen çdo vit, bile as për 3-4 vjet.

Dikush foli këtu për eksperiencën e shkollës ku ka mësuar. Unë kam bërë një shkollë tjetër, shkollë franceze. Teksti i historisë, që mësohej në këtë shkollë, ishte rreth 350 faqe. Në këtë tekst historia shkruhej në bazë të programeve që ishin caktuar në Francë, të mbështetura në baza shkencore borgjeze. Aty, kur trajtoheshin disa periudha apo epoka të caktuara, vihej në thonjëza edhe pjesa e një historiani të shquar, i cili i shpjegonte çështjet sipas pikëpamjeve të tij. Kjo pjesë mund të ishte rreth gjysmë faqeje, por në gjithë tekstin prej 350 faqesh mund të kishte rreth 100 faqe të tilla. E them këtë se ai që ka mbaruar universitetin, kur jep historinë ose matematikën në shkollën e mesme, të ketë parasysh jo vetëm përvojën tonë, po edhe atë botërore.

Në tekstin tonë të bujqësisë, që mora si shembull, edhe ne duhet të përshkruajmë teorinë, agroteknikën e bimëve kryesore që nuk ndryshon; do të futim pastaj, siç u tha këtu, edhe eksperiencën e punonjësve tanë më të mirë të bujqësisë, duke vënë në dukje se si e merr ky ose ai një rendiment kaq të lartë në misër apo në panxhar; mund të flitet për përdorimin e një meka-

nizmi dhe se si ka arritur ta përdorë traktorin e vet, pa riparim të përgjithshëm, filan traktorist i dalluar etj.

Në shkollat, ku kam pasë mësuar unë, përveç tekstit të madh, si ky për agronominë, kishte edhe një tekst më të vogël, plotësues, me njohuri të tjera, bile, edhe formati i tij ishte më i vogël. Të marrim kiminë. Teksti i kësaj lënde, ku paraqiteshin tërë kapitujt e programit, mund të ishte, ta zëmë, rreth 350 faqe, ndërsa ky i vogli ishte një *aide mémoire*¹. Kështu, kur flitej, për shembull, për ligjin e Lavuaziesë² *aide mémoire* e jepte këtë ligj me formula bashkë me përkufizimin. Po kështu edhe në fizikë e në lëndë të tjera. Ky ishte me një fjalë *aide mémoire*.

Programi kishte dy pjesë. Duhet të mbaroje të parën, pastaj të filloje nga e dyta, që të realizohej komplet tërë programi i shkollës. Ky program ishte ndërtuar në mënyrë të atillë që formimi i nxënësit bëhej i plotë, por gradualisht dhe jo i ngarkuar jashtë mase. Programet kishin si qëllim, gjithashtu, që nxënësi të vinte i përgatitur në klasën më të lartë. Pra, gjithë kurset të kishin një vazhdimësi e lidhje të pandërprerë. Kështu kur nxënësit vinin në klasën e fundit, ta zëmë të matematikës apo të filozofisë, nuk kishin vështirësi për ta përfunduar krejt shkollën, pse për këtë ishin përgatitur, kishin marrë gradualisht një formim të plotë, me një fjalë ishin aftësuar e bërë të zotë. Specialist i ndonjë lënde unë nuk jam dhe nuk i kam parë

1. Frëngjisht — ndihmë për kujtesë.

2. Antuan Loran Lavuazie (1743-1794), kimist i shquar francez.

të gjitha tekstet me këtë sy, por e kam çështjen tek ajo që thuhet se nxënësit, sidomos ata të shkollave 8-vjeçare, të klasës së pestë, të gjashtë etj., janë të ngarkuar shumë. Kjo mund të ndodhë edhe për arsye të ngushtësisë së kohës. Ne kemi futur në shkollë tre komponentët. Pra, përveç njohurive teorike, janë përfshirë në program edhe puna prodhuese, edhe edukimi fizik e ushtarak. Mirëpo Arti Ushtarak i Luftës Popullore është shumë i gjerë dhe këtë ta kuptojmë drejt. Ai nuk mund të përvetësohet si duhet me një muaj në vit që shkon nxënësi apo studenti në stërvitje gjatë katër vjetëve të shkollës. Që të përvetësohet mirë Arti ynë Ushtarak, njeriu duhet ta studiojë atë e të stërvitet vazhdimisht; të vejë ushtar, të mësojë në shkollë, të vejë në stërvitje etj.

SHOKU RAMIZ ALIA: Fakti që një tekst ka shumë ushtrime, nuk ka rëndësi fare; rëndësi ka nëse njohuritë që jepen me ato ushtrime janë për nivelin e nxënësit apo jo, ky është problemi. Kur flasim për ngarkesë të shkollës, nuk është fjala për ngarkesë ushtrimesh, por për sasinë e dijeve që jepen, nëse këto i përshtaten moshës, klasës dhe nëse janë sipas rregullave didaktike.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Unë e theksoj mendimin që tekstet tona janë jashtëzakonisht të ngarkuara.

SHOKU ENVER HOXHA: (Duke iu drejtuar me shaka shokut Spiro.) Ti dhe unë mësuam kaq vjet, po urën e madhe që ndërtoam në Kukës dhe që është një vepër aq e ndërlikuar, sa që ti dhe inxhinier Gjadril¹ do

1. Gjovalin Gjadril (1899-1974), inxhinier konstruktor, i shquar në projektimin dhe ndërtimin e urave.

të viheshit në vështirësi, na e bënë ata që kanë mbaruar shkollë fillore dhe me këto mjete të thjeshta shkollore që po diskutojmë.

SHOKU SPIRO KOLEKA: Kam edhe një vërejtje për Ministrinë e Arsimit e të Kulturës. E kam fjalën për terminologjinë, pasi në tekste ka shumë fjalë të huaja.

SHOKU ENVER HOXHA: Po gjuhëtarët tanë kanë punuar për këtë dhe i kanë futur termat e përshtatshëm në gjuhën tonë?

SHOKU SPIRO KOLEKA: Në tekste nuk i kanë pasqyruar akoma.

SHOKU RAMIZ ALIA: Kjo punë do të bëhet gradualisht.

SHOKU ENVER HOXHA: Në disa programe unë nuk shoh një vazhdimësi, në mënyrë që nxënësit, kur të mbarojnë ciklin e një shkolle, të dalin me njohuri të plota, jo vetëm të përgjithshme, po edhe speciale, sidomos kur është fjala për ata që kryejnë shkolla teknike, veçanërisht në lëndët për të cilat janë të interesuar, si mekanika etj.

Kisha edhe një pyetje për universitetin. Dua të di se si e shfrytëzojnë literaturën e huaj studentët? Apo ata kufizohen vetëm me tekstet? Po vetë pedagogët si i pasurojnë leksionet që japin? A bëjnë përpjekje që t'i zgjerojnë vazhdimisht njohuritë? A e gjejnë ata kohën dhe metodikën e përshtatshme jo vetëm brenda orës së mësimit por edhe jashtë tij që të punojnë me studentët e të rrënjosin tek ata bindjen për domosdoshmërinë e zgjerimit të njohurive, për këtë apo për atë problem? Bëhet kjo apo nuk bëhet? Apo edhe kur bëhet, veprohet në mënyrë krejt mekanike, si për të

thënë: «Hajde ta mbaj edhe këtë leksion, pa nuk prish punë se kam dy vjet që e kam përgatitur; le të kënaqen me këtë, sido që është!», duke kujtuar se kështu e mbaroi detyrën.

Pasi u dha përgjigje e u diskutua edhe për çështjen e mësipërme, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në dikaster për tekstet, siç u tha këtu, interesohen drejtoritë përkatëse. Si e gjykoni ju kontrollin e teksteve nga ana e këtyre drejtorive, pse, secila nga këto drejtori ka disa sektorë të caktuar që mbulon. Në fakt, a merren këto si duhet me tekstet? Të kuptohemi, nuk them që t'i bëjnë ato vetë tekstet, se për këtë punë janë ngarkuar të tjerët, por këto drejtori të orientojnë, të kontrollojnë dhe të organizojnë diskutimin e tyre etj. Një njeri ose dy-tre njerëz, që mund të jenë në secilën nga këto drejtori, a kanë kohë të marrin vazhdimisht kontakt me ata që hartojnë tekstet? E them këtë se hartimi i teksteve është një problem i vështirë.

SHOQJA TEFTA CAMI: Këto drejtori në fakt janë të ngarkuara. Disa tekste ndiqen e kontrollohen me komisione, ku marrin pjesë kuadro të atij profili, specialistë të prodhimit e të tjerë. Disa tekste të tjera i kemi shqyrtuar në kolegjiun të ministrisë. Mendimi ynë ishte sikur të kishim një organizëm pranë ministrisë që të merrej drejtpërdrejt me tekstet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Për mendimin tim në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës ka një defekt nga pikëpamja organizative lidhur me këtë çështje. Jashtë ministrisë ka një shtëpi botuese të librit shkollor të pajisur me organikën përkatëse. Në këtë shtëpi botuese janë nja 30 veta, midis të cilëve ka edhe specialistë. Ku

është defekti tani? Këta specialistë që merren me tekstet, nuk kanë lidhje me shkollën. Kjo lidhje bëhet me anën e punonjësve të drejtorive që janë pranë ministrisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Studiojeni këtë çështje, se është një problem i rëndësishëm që duhet parë! Edhe sikur të krijohet një organizëm i posaçëm pranë ministrisë, ai nuk mund ta ndjekë vetëm tërë punën që bëhet për përgatitjen e teksteve. Për këtë mund të ngrihet një grup me kuadro kompetentë, të cilët të interesohen që tekstet për universitetin, fjala vjen, t'ia ngarkojnë një grupi profesorësh dhe ata t'i qëndrojnë mbi kokë kësaj pune. Kjo do të qe ndoshta njëra nga zgjidhjet e këtij problemi.

Çështjet u diskutuan shumë mirë, prandaj të kihen parasysh të gjitha vërejtjet e mendimet që u dhanë dhe të merren masa që tekstet të përmirësohen brenda afateve të caktuara. Të punohet sa më mirë që jo vetëm studentët që dalin nga shkollat tona të larta të jenë të kualifikuar, por Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të ketë kujdes që të dërgojë edhe në shkollat e mesme profesionale nxënës me të vërtetë të zotë, që të dalin kuadro sa më të përgatitur edhe nga këto shkolla. Ekonomia jonë ka nevojë të madhe edhe për teknikë të aftë e të përgatitur dhe jo të dërgojmë për të mësuar, qoftë edhe në këto shkolla, njerëz sidokudo.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PËR REALIZIMIN E DETYRAVE PËRGJIGJEMI TË GJITHË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

27 prill 1978

Në këtë takim shoku Hekuran Isai informoi lidhur me zbatimin e vendimit të Byrosë Politike për paxharin e sheqerit dhe pambukun, kryesisht në rrethin e Korçës, si dhe në rrethet Kolonjë e Pogradec.

SHOKU HEKURAN ISAI: Mendoj se për të gjitha këto probleme që dalin në këto rrethe, do të jetë mirë të shkojmë herë pas here me grupe pune dhe t'i ndjekim çështjet deri në fund, si për shembull, mbjelljet, me synim që të përgjithësojmë përvojën.

SHOKU ENVER HOXHA: Puna me ckiye është kurdoherë e frytshme, veçanërisht kur anëtarët e ekipit janë njerëz të aftë, që i kuptojnë problemet, dhe që janë në korent jo vetëm për gjendjen e rrethit ku shkojnë, por edhe të rretheve të tjera; gjithashtu, kur kanë edhe kompetenca për t'i zgjidhur në vend shumë gjëra që u dalin përpara. Kjo ka rëndësi të madhe. Ai punonjësi në Ministrinë e Industrisë, që ti e solle si

shembull, vërtet mund të jetë specialist, por mua më duket se nuk ka ndonjë vlerë të madhe puna e tij, dhe ai qëndron pasiv ndaj problemeve të rrethit, vetëm se mbush bllokun me shënime dhe vjen këtu në ministri. Në ministri nuk ka pse të vijë të gjitha ato gjëra. Unë mendoj se pjesa më e madhe e atyre çështjeve, me të cilat ai shoku mbushi bllokun, nuk janë nga ato që duhet t'i zgjidhë ministria, po rrethi. Ky specialist mund të jepte mendimin e tij, se ç'duhej bërë për to duke treguar konkretisht edhe mënyrën se si duhej vepruar. Ai mund të rekomandonte edhe disa masa me karakter ekonomik, brenda kompetencave të ministrisë, dhe pastaj të vinte e t'i thoshte ministrit për gjithë sa kishte bërë.

Është gjë e mirë që Partia në rreth preokupohet për problemet e jo vetëm komiteti, por edhe organizatat-bazë. Mund të ketë përmirësime, e nga këto që na the ti, del se ka, sepse nuk ka pasur kurdoherë një preokupim të tillë për punën. Kemi folur mirë për Komitetin e Partisë të Rrethit të Korçës dhe për komitetin ekzekutiv, sepse po i aktivizojnë të gjitha organizatat-bazë të Partisë dhe organet e pushtetit.

Po bëj një parantezë. Konstatojmë se në diskutime shokët e pushtetit, duke e shkarkuar veten nga përgjegjësia, shtrojnë pyetje të tilla si: «Ç'bën Partia në lidhje me këtë problem?», «Si mendon ta zgjidhë atë?» etj. Pra, duket sikur përgjegjësinë për çdo gjë që nuk ecën e ka Partia. Mendoj se, nga njëra anë, ta shtrosh çështjen kështu, është e natyrshme, por, nga ana tjetër, duhet kuptuar edhe kjo: vërtet Partia është në krye të të gjitha punëve, Partia është edhe në pushtet dhe, për

këtë duhet t'i bëjmë njerëzit të ndërgjegjshëm. Por ama të kemi parasysh se pushteti është ajo armë e Partisë që duhet t'i vërë njerëzit në lëvizje për zbatimin e direktivave të saj. Pra, puna e Partisë nuk mund të kuptohet e shkëputur nga ajo e pushtetit. Një kuadër që punon në organet e pushtetit mund të jetë anëtar partie dhe njeri i ndershëm, po, kur vjen puna për kryerjen e detyrës nga ana teknike, ai atë nuk e bën në rregull. Në këtë rast ai ka përgjegjësi si anëtar partie, por ka përgjegjësi të madhe edhe si punonjës i pushtetit. Komitetin e Partisë dhe Komitetin Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës i kemi lavdëruar për punë të mirë, por edhe i kemi kritikuar për mungesë të një preokupimi të thellë. Vjet i kemi kritikuar se nuk morën masa për ruajtjen e panxharit gjatë shkulljes, për vonesë në vjeljen e tij, për mospunimin e insekticideve etj., probleme këto që nuk ishin parë me seriozitetin e duhur.

SHOKU PROKOP MURRA: Edhe në Kombinatin e Sheqerit nuk ishin përgatitur mirë për të përballuar përpunimin e panxharit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, edhe në kombinat nuk ishin përgatitur mirë. Ne kënaqemi kur shikojmë që kritikën e ndryshojnë gjendjen, vetëm nuk duhet të lejojmë që këto të jenë formale e të bëhen me fushata, por të jenë të vazhdueshme e në kohën e duhur, sa herë që punët nuk shkojnë mirë.

Vajtja me ekipe, siç e the edhe ti, shoku Hekuran, është një gjë e mirë, por nuk mund të vemi edhe nesër përsëri në Korçë. Prandaj gjithë puna është të shihet si i kuptojnë shokët e Partisë e të pushtetit në rreth

direktivat e orientimet dhe sa i zbatojnë ato. Domethënë, vajtja e ekipeve të jetë një nxitje jo e përkohshme, por e vazhdueshme, mendoj unë. Për të gjitha problemet, pra, duhet të mendojnë vetë shokët e rrethit, po ata të organizojnë edhe punën për zbatimin e detyrave.

Lidhur me ndonjë mosmarrëveshje që mund të vihet re ndonjëherë në udhëheqje të Partisë e të pushtetit në rreth, ne duhet t'i evitojmë ato në rrugë të drejtë partie, sepse shpesh ato, më duket mua, shkaktohen nga mentaliteti mikroborgjez i njërit apo i tjetrit kuadër. Te disa persona dominojnë shfaqje mikroborgjeze, të cilat ndodh që herë nuk shikohen me sy kritik, e herë të tjera me zemërgjerësi nga komunistët. Kur them me zemërgjerësi, të kuptohemi drejt, nuk dua të them me oportunizëm, por, e kam fjalën që të mos merren çështjet majë më majë dhe të shfaqet menjëherë mendimi se ky kuadër nuk bën, por, sipas rastit, çështjet të zgjidhen edhe në frymë shoqërore. Kur thuhet që një kuadër nuk bën, kjo të jetë e argumentuar. Të arrish të ushqesh pikëpamje mikroborgjeze tek instruktorët, për sekretarin e komitetit të Partisë apo kryetarin e komitetit ekzekutiv pse ka bërë ndonjë gabim ose për ndonjë mendim të padrejtë, këto nuk janë veprime të pjekura dhe udhëheqja e rrethit nuk duhet t'i lejojë. Mosmarrëveshje të tilla shkaktohen edhe ngaqë disa shokë me përgjegjësi kanë një konsideratë të tepruar për veten e tyre dhe nënvleftësojnë kapacitetin e aftësitë e të tjerëve, që kanë më pak përgjegjësi. Kjo nuk është thjeshtësi kuadri.

Kuadrove kryesorë, kudo që janë, u vihet si detyrë e dorës së parë t'i ndihmojnë ata që kanë në krah dhe

jo të kërkojnë menjëherë transferimin ose pushimin e tyre, sapo që ata të bëjnë ndonjë gabim. Masa të tilla mund të kërkojnë kur kuadri është me të vërtetë politikisht i gabuar ose kur nuk punon mirë. Për këto raste ne kemi ligje e norma që veprojnë. Pra, një kuadër kryesor duhet të niset nga mendimi për ta ndihmuar këtë shok ose këtë shoqe që të ecë përpara, sepse, kur e kemi caktuar si sekretar apo si kryetar të komitetit ekzekutiv të një rrethi, kemi pasur parasysh jo vetëm qëndrimin politik e aktivitetin, por edhe perspektivën e tij. Dhe këtë perspektivë duhet t'ia hapë sekretari i parë i rrethit dhe ky jo të ndjekë rrugën më të shkurtër duke kërkuar një kuadër tjetër. Si u jepkan kuadrot kështu, sipas qejfit? Mos vallë Komiteti Qendror do ta shikojë lëvizjen e kuadrit në prizmin e interesave të ngushtë të ndonjë sekretari të parë të rrethit?! Përse e ka dërguar atje Komiteti Qendror sekretarin e parë? Pikërisht, që të shëndoshë situatat e kjo bëhet duke ndihmuar kuadrot për të ngritur nivelin dhe aftësitë e tyre.

Realiteti ynë tregon se punët në përgjithësi na ecin mbarë, mobilizim ka kudo. Te njerëzit tanë ekziston respekti dhe solidariteti ndaj njëri-tjetrit; uniteti i popullit rreth Partisë është i fortë e, natyrisht, edhe rezultate ka. Por këto rezultate nuk bien nga qielli. Ato janë pasojë e një pune të organizuar e të drejtuar mirë nga ana e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Qeverisë, si dhe nga ana e komiteteve të Partisë e të komiteteve ekzekutive të rretheve. Por, nuk duhet të harrojmë se kemi edhe dobësi, ja, si këto për të cilat folëm sot këtu, që po i konstatojmë herë pas here në

punë e sipër. Rëndësi ka që secili të jetë i ndërgjegjshëm për detyrën që i është caktuar dhe të mbajë përgjegjësi kur nuk e realizon atë. Po të veprohet kështu, siç thashë edhe më parë, nuk ka pse të vihet pyetja: «Ç'bën Partia?», kur punët nuk ecin mirë. Po komunistët që punojnë në organet e pushtetit, ç'bëjnë? Përgjegjësi kanë të gjithë njerëzit; ka përgjegjësi Partia, po njëkohësisht kanë përgjegjësi edhe organet e kuadrot e pushtetit.

SHOKU HYSNI KAPO: Si të mos ndiejnë përgjegjësi edhe shokët e pushtetit për mosrealizimin e detyrave? Të gjithë ne, duhet të ndiejmë përgjegjësi, kur nuk realizohen detyrat që kemi caktuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj nuk ka pse të thuhet «ç'bën Partia?! Për shembull, për zgjidhjen e një problemi duhen marrë masa. Kjo nuk është akoma plotësisht e saktë pa thënë konkretisht se ç'masa teknike e shtetërore të merren. Në rast se drejtori jep urdhër që automobili, fjala vjen, nuk duhet të shkojë në filan vend, mbaroi puna. Edhe drejtori është njeri i Partisë, prandaj edhe i janë dhënë kompetencat e duhura. Kur ai e gjykon se nuk është e drejtë kërkesa që i bëhet, të thotë se nuk jap automobil etj. Pra, këto punë nuk mund t'i ndjekë çdo ditë komiteti ekzekutiv ose komiteti i Partisë, sepse ne kemi një shtab të tërë në çdo ndërmarrje, shtab partie dhe shtab pushteti, që i kanë detyrat e kompetencat të përcaktuara e të ndara. Çështja është se nuk e kuptojnë të gjithë rëndësinë e madhe politike dhe ekonomike që ka problemi. Gjërat t'i shikojmë në sy, ashtu siç janë e jo të raportojmë sa për të bërë fraza, duke fshehur realitetin. Pran-

daj edhe unë po insistoj aq shumë në atë që përmenda se nuk mund të thuhet «ç'bën Partia?». Partia i shikon të gjitha këto probleme dhe punon për zgjidhjen e tyre. Mirëpo të mos harrojmë se ka edhe ligje, të cilat duhet të zbatohen, nga secili, pavarësisht nga puna që bën Partia.

SHOKU HYSNI KAPO: Ka njerëz të posaçëm, me organikë, që merren me këto punë, që nga magazinieri e deri te drejtuesit kryesorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, natyrisht që ka njerëz të posaçëm. Por, që të zbatohen ligjet duhet rigorozitet i madh nga ana shtetërore. Të mos na mbulojë euforia, ndryshe nuk njihen gabimet e nuk ndreqen kurrë nga ata që duhet t'i ndreqin, e pastaj na duhet të merremi edhe ne me ato punë që u takojnë të tjerëve për t'i kryer.

Dihet se Partia është në krye të të gjitha punëve. Atëherë, mund të lindë pyetja: pse ngjasin këto gjëra? Sepse edhe puna e Partisë, aty-këtu, ka të meta e dobësi. Por ama nuk mund të themi se nga ana shtetërore shkëlqejmë. Mund të mos jesh anëtar partie, por vijën e Partisë mund dhe duhet ta zbatosh me rigorozitet të madh.

Neglizhencën ndaj të metave e gabimeve që konstatohen e kemi kritikuar vazhdimisht. Po pse nuk ngrihet zëri për të gjitha ato mosrealizime që ngjasin? Natyrisht, nuk ngrihet zëri edhe për shkak të disa mendimeve e shfaqjeve mikroborgjeze, për shfaqje familjariteti e të tjera. Them vazhdimisht të eksportojmë këtë e të eksportojmë atë dhe kjo është gjë e mirë. Por ama, jo të sjellësh qymyrin koks nga jashtë me shpej-

tësi dhe pastaj ta lësh atë të të digjet. Kjo është e turpshme. Kush e ka fajin për këtë, mos vallë e ka fajin Partia?! Nuk mund ta themi një gjë të tillë. Pra, duhet thënë se kjo është një çështje që ka të bëjë me organizimin e punës. Vërtet këtu ke të bësh me ndër-gjegjen e shoferit, të drejtorit, të njërit ose të tjetrit se, në radhë të parë, qëndron ana politike e ideologjike e problemit, por kanë jo pak rëndësi masat tekniko-organizative. Për mbarëvajtjen e punëve duhet ndër-gjegjja, por shumë i domosdoshëm është edhe organizimi i fortë e i shëndoshë i punës, kërkesa e llogarisë, kontrolli dhe krahas tyre edhe masat shtrënguese. Natyrisht, ai drejtor që ka përgjegjësi për koksin, fjala vjen, e lë këtë pas dore se merret me probleme të tjera dhe kështu koksi nuk përfundon në destinacion. Kjo nuk duhet lejuar, pasi duket qartë që kemi të bëjmë me mungesë të theksuar organizimi.

Këto çështje që po diskutojmë, siç është edhe ajo e revolucionit tekniko-shkencor, i kemi shtruar vazhdimisht nga ana parimore e ideologjike. Por vetëm kjo nuk është e mjaftueshme se për zgjidhjen drejt e në kohë të tyre kërkohet që ato të trajtohen edhe nga ana teknike. Po kush do ta bëjë këtë? As drejtuesit e Partisë e të pushtetit nuk mund ta bëjnë, në qoftë se nuk janë specialistë. Kjo punë u takon atyre që kanë haber. Dhe kujt konkretisht? Inxhinierit, agronomit, arkitektit e të tjerëve që ne i kemi grumbulluar nëpër aparatet e Partisë e të shtetit. Për një problem të caktuar mund të bëhet një raport nga grupi i punës. Por ky grup, që të jetë në gjendje ta bëjë këtë raport, duhet medoemos të ketë punuar edhe në bazë. Shoku që është

ngarkuar për të ndjekur problemin, bashkë me grupin, ka shtruar, për shembull, katër probleme. Këto probleme mund t'ia paraqitin edhe ministrisë përkatëse, duke i thënë se që të realizohet, fjala vjen, detyra për të përcaktuar rrugët se si do të zhvillohet revolucioni tekniko-shkencor në një sektor prodhimi, është e nevojshme të bëhen disa studime. Për këtë, mund të shtojnë ata, ne bëjmë edhe këto propozime. Po qe se bien dakord me ministrinë, ata mund t'u japin një orientim specialistëve të atij sektori që të bëjnë një punë përgatitore për këto çështje. Pra, kur të jetë bërë tërë kjo punë e të jetë marrë edhe mendimi i bazës, atëherë sillet materiali në qendër dhe diskutohet. Duke vepruar në këtë mënyrë edhe shokët drejtues të Partisë apo të pushtetit në rreth, duke u shtruar veç e veç me çdo grup për secilën çështje, do të mund të nxjerrin me të vërtetë probleme të studiuara në thellësi dhe konkretisht dhe jo në përgjithësi. Pra, në këtë mënyrë, drejtuesi i Partisë dhe i pushtetit do të jetë në gjendje të shtrojë jo fjalë kot, por çështje konkrete deri edhe probleme teknike. Bile, kur të flasë, mund t'u thotë se këto mendime, sugjerime e zgjidhje kanë dalë nga ju, por që edhe ne, në udhëheqje e pamë e po shtojmë mendimet tona.

Ky do të qe vetëm fillimi. Më vonë ministria duhet ta zbërthejë këtë deri në fund dhe, për të realizuar objektivat e vënë, të japë ndihmë dhe të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm e periodik. Që të ndiqet me kujdes se ç'po bëhet, grupet e kontrollit do të shpërndahen në të gjithë vendin. Njëri, për shembull, në uzinën «Dinamo», tjetri në uzinën «Traktori»; një tjetër do

të drejtohet në kooperativën e tipit të lartë të Këmi-shtajt e kështu me radhë. Si do ta bëjë këtë kontroll ministria? Duhet menduar thellë këto gjëra. Për këtë mund të krijojmë edhe grupe, por jo t'i heqim njerëzit nga puna vend e pa vend. Mund të krijojmë disa grupe kompetente që të kenë, bie fjala, një fizikan apo një matematicien, me fjalë të tjera nga një specialist, që, herë pas here, kur ai shoku i ministrisë të vejë atje e të kontrollojë se çfarë është bërë, të jetë në gjendje të bëjë vërejtjet e duhura edhe nga ana teknike.

Pra, këtu çështja nuk është që të themi se «e kemi shtruar problemin», «kemi bërë këto», «i kemi caktuar ato», «jemi duke u përgatitur» etj. Dakord jam edhe me këto. Por unë përgatitjen dhe organizimin e punës për studimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve të mëdha e shikoj më thellë dhe më të komplikuar, në qoftë se duam me të vërtetë që të bëjmë diçka.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më fal që ju ndërpres, shoku Enver, por desha të thosha diçka: gjithë kjo punë e madhe që po bëhet në lidhje me revolucionin tekniko-shkencor, ka përfshirë uzina të ndryshme mekanike e ndërmarrje të tjera. «Çfarë studimi është bërë konkretisht për specializimin dhe kooperimin?», kjo është pyetja më elementare që del tani. Sepse këto grupe pune duhen drejtuar, ashtu si thatë ju, në këtë apo atë uzinë; ky motor do të bëhet në filan ndërmarrje, e kështu me radhë. Domethënë tani problemi është konkret e duhet parë nga aspekti teknik dhe nuk shtrohet më vetëm nga ana teorike.

SHOKU PROKOP MURRA: Këtë bazë mekanike që kemi sot e kemi të ngarkuar. Sigurisht që me pro-

jektet e reja që do të bëhen, kjo bazë do të përballojë edhe këto detyra kaq të mëdha, pra do të ngarkohet më shumë, por për këtë duhet të përgatitet.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështja është një herë për studimin e këtyre projekteve; pastaj është faza tjetër për zbatimin e tyre.

Revolucionin tekniko-shkencor e bëjnë masat. Kur themi që e bëjnë masat, kjo nuk do të thotë që me të mund të merret kushdo, por kemi parasysh specialistët, punëtorët e kualifikuar, kuadrot e inxhinierët, teknikët e të tjerë si këta që kanë ide, që zotërojnë shkencën, që kuptojnë novacionet e racionalizimet, që dinë të përdorin e të përmirësojnë teknologjinë dhe mjetet e punës. Njeriu krijon mjetin e ri për të rritur rendimentin, për të fituar kohën, për të ulur çmimet, për të ngritur mirëqenien e popullit.

Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga bliseda e incizuar që gjendet në AQP

AKUMULIMI SHPEJTON RITMET E ZHVILLIMIT TË EKONOMISË

Shënime

27 prill 1978

Edhe një herë dëshiroj të trajtoj çështjen e fuqisë blerëse të popullatës dhe si duhet mbuluar kjo fuqi blerëse me mallra e me shërbime. Kjo çështje, që e kam shtruar edhe herë të tjera e që u diskutua edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, ka një rëndësi të veçantë e lidhet edhe me qarkullimin monetar.

Kërkova nga shokët sekretarë të Komitetit Qendror të më informonin për këtë problem. Prej tyre mora vesh që kjo çështje nuk është përgatitur nga ana e Qeverisë për t'u shtruar në shkallë të gjerë në bazë. Një vonesë e tillë na dëmton, për arsye se mungesa e raportimeve për shumë nga këto probleme kapitale të ekonomisë sonë, mund të na shkaktojë të papritura. Konstatojmë se në këto vitet e fundit në ekonominë tonë është vënë re një dukuri jo e mirë: është shtuar fuqia blerëse e popullatës, kurse prodhimi shoqëror nuk është realizuar me ritmin e caktuar në plan, domethënë nuk janë realizuar prodhimi shoqëror dhe të ardhurat kombëtare, kështu që ne kemi emetuar në qarkullim

para, kemi paguar rrogat, por akumulimi është ulur.

Akumulimi është një çështje me rëndësi të madhe, sepse ky do të ndihmojë në shpejtimin e ritmeve të zhvillimit të ekonomisë sonë. Natyrisht vështirësi ka, por duhen bërë përpjekje për mbulimin e fuqisë blerëse, për të thithur paratë që disponon punonjësi, por këto nuk arrihen pa realizuar rendimentin e pa e plotësuar planin që caktohet, si në sasi, ashtu edhe në cilësi.

Në rast se ne nuk ruajmë përpjestimet në mes prodhimit industrial (duke mos realizuar planin), dhe treguesve të prodhimit e të rendimentit të punës, atëherë do të na krijohen situata të vështira dhe deficite në realizimin e prodhimit industrial e bujqësor. Vështirësi na krijon gjithashtu edhe ndërprerja e kredive nga ana e Kinës për ndërtimin e atyre objekteve që janë parashikuar në marrëveshjet midis dy vendeve. Nuk po plotësohet në masën e duhur edhe plani i eksportit e i importit. Të gjitha këto kanë një efekt negativ në ekonominë tonë, për të cilin duhet bërë një studim i plotë nga ana e udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit për të përcaktuar shkaqet kryesore të shpërpjesëtimeve që konstatojmë, sidomos në dy vjetët e parë të pesëvjeçarit.

Nuk duhen lejuar shfaqje liberale në mosplotësimin e detyrave të planit dhe të treguesve ekonomiko-financiarë. Ne shohim se në vitin 1977 ndërmarrjet ekonomike nuk realizuan planin e akumulimit, ndërsa humbjet ishin jo të vogla. Gjithashtu dëmtimet, mungesat dhe shkeljet e disiplinës financiare kapin një shumë të konsiderueshme. Këto shuma duhet të për-

bëjnë objektin e një studimi. Atë duhet të ndiqen me një kujdes jashtëzakonisht të madh nga ana e organeve kompetente që janë ngarkuar të drejtojnë ekonominë. Por këtë ekonomi ato ta drejtojnë në rrugë shkencore, në rrugën e planeve e të ligjeve të ekonomisë socialiste dhe jo në mënyrë liberale, kuturu, pa llogari, pa kontroll. Pra të merren masa të forta. Këtij problemi t'i kushtohet një vëmendje e madhe, sidomos në këto drejtime.

Krahas kësaj të bëjmë një luftë të vazhdueshme për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të prodhimit; të realizojmë me çdo kusht planin e eksportit dhe të importit e të çajmë në tregjet e jashtme. Për të gjitha këto që thashë ka vështirësi, por këto vështirësi ne duhet t'i njohim e të mobilizohemi dhe të organizojmë mirë punën për t'i kapërcyer.

Revolucioni tekniko-shkencor, po e theksoj përsëri, duhet kuptuar thellë e vlerësuar drejt. Të merren të gjitha masat që ai t'i shërbejë prodhimit. Të bëhet ç'është e mundur që të rritet rendimenti i punës, se pa rritur këtë, ne nuk mund t'i shpëtojmë mosrealizimit të planit dhe disbalancimeve që tregova më lart, të cilat bëjnë që fuqinë blerëse të madhe të mos e mbulojmë dot me mallra. Natyrisht që kështu edhe të ardhurat kombëtare mbeten pa u realizuar e bashkë me to edhe akumulimi dhe investimet e parashikuara.

Të luftojmë kundër prirjes për kërkesa pa vend që bëhen për shtimin e numrit të punëtorëve, kur kjo nuk është e nevojshme. Të përpiqemi me të gjitha forcat që të punohet kudo me norma, sa të jetë e mundur me norma teknike. Megjithëse këtyre problemeve u

është vënë theksi shumë herë nga Byroja Politike, prapëseprapë drejtuesit e ndërmarrjeve dhe ministritë nuk e kanë kurdoherë parasysh këtë çështje me kaq rëndësi. Por që të vendosen normat teknike duhet jo vetëm të ngrihet ndërgjegjja politike e punonjësve tanë, por të ngrihet edhe niveli arsimor e kulturor i tyre. Atestimi i punonjësve të mos jetë formal, thjesht sa për të marrë një kategori më të lartë, që t'u shtohet paga. Kjo të mos u jepet atyre pa shtuar diturinë, pa u perfeksionuar në zanat, në qoftë se nuk tejkalojnë normën dhe nuk rritin rendimentin në punë.

Për sa i përket fuqisë blerëse të popullatës, kjo disa herë mbulohet në global, në vleftë, por ka rëndësi edhe çështja e strukturës së mallrave që nuk u përgjigjen kërkesave. Për këtë arsye vazhdon fenomeni që disa mallra i kemi me tepricë, bile stoqe dhe disa mallra të tjera, shumë të nevojshme për popullin, nuk ekzistojnë në treg. Boshllëqe ka sidomos në artikujt ushqimorë, prandaj bujqësia duhet të punojë shumë për ta kapërcyer sa më parë një situatë të tillë.

E kemi theksuar dhe po e theksojmë prapë që asgjë të mos prodhohet pa destinacion. Lëndët e para, materialet, aftësitë prodhuese që kemi, t'i përdorim për të prodhuar ato mallra për të cilat ka nevojë populli, në sasi dhe në cilësi, në kohë dhe me kosto të lirë, pse çdo ditë ne konstatojmë që kemi mundësi dhe rezerva të shumta. Këto rezerva duhet t'i shfrytëzojmë medoemos. Për këtë, më parë t'i evidentojmë mirë ato, të bëjmë studime të plota e pastaj të organizojmë punën për t'i kthyer të tëra në të mira materiale e jo t'i lëmë të qëndrojnë të fjetura.

Prandaj të gjitha organet e pushtetit, ministritë, komitetet ekzekutive, ndërmarrjet, e veçanërisht sektori komunal, i cili nuk po e bën punën si duhet, të marrin masa më të thella organizative e të ushtrojnë një kontroll financiar edhe më të rreptë në të gjitha ato drejtime që e vënë në lëvizje dhe e zhvillojnë ekonominë tonë në rrugën socialiste, dhe që përmirësojnë jetën e popullit. Ndryshe, në qoftë se vazhdojmë të mos kemi kujdes qoftë edhe në njërin nga këto drejtime të ekonomisë sonë socialiste e nuk marrim masa për ta ndrequr gjendjen, atëherë do të na krijohen disbalancime të theksuara në të gjithë sektorët dhe, si rrjedhim, do të rrezikohemi nga një sërë të këqijash që vijnë prej tyre, e që janë me pasoja jo të mira për popullin.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ÇDO NEGLIZHENCË NË STËRVITJE KUSHTON SHUMË GJATË LUFTËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 prill 1978

Në pikën e parë të rendit të ditës kemi sot çështjen e përmirësimit të rolit udhëheqës të Partisë në shkollat e lira ushtarake.

Problemi i mbrojtjes është me rëndësi të madhe në çdo kohë, por, në situatat që ndodhet vendi ynë, ai bëhet akoma më me shumë rëndësi. Të gjithë jemi të gëzuar që punët në ushtri, në sajë të vijës së drejtë të Partisë dhe të ngritjes së përgjithshme të kuadrove, të masave të popullit e të rinisë që vijnë të shërbejnë në këtë sektor, na shkojnë përpara. Kjo është një siguri e madhe për atdheun tonë socialist, vetëm se nuk duhet të na zërë gjumi, po t'i zbatojmë mirë dhe si duhet të gjitha detyrat që na vihen për t'i kryer. Të

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit për punën e komiteteve të Partisë të rretheve lidhur me përmirësimin e inëtejshtëm të rolit udhëheqës të komiteteve të Partisë në shkollat e lira ushtarake.

gjitha detyrat janë të rëndësishme, por, në radhë të parë, detyrat e ushtrisë, për arsye se, kur të vijë momenti i rrezikut, nga përgatitja e mirë ose e dobët e saj varet fati i ekzistencës së atdheut tonë socialist.

Sot në këtë mbledhje shokët e ftuar mund të na japin përvojën dhe gjendjen e punëve në shkollat e lira ushtarake. Natyrisht, pa folur gjatë, le të na vënë në dukje karakteristikat e punës dhe të na thonë nëse vërtetohet plotësisht drejtësia e vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë për organizimin e shkollave të lira ushtarake. A gjeni ju¹ vështirësi në konsolidimin e këtyre shkollave dhe nëse po, çfarë vështirësish janë ato? Si i keni lidhjet me komitetet e Partisë të rretheve?

Ka ndonjë komandant njësie këtu?

SHOKU HYSNI KAPO: Po, është i ftuar komandanti i njësisë së Korçës.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të ketë ndonjë lavdërim ose edhe ndonjë kritikë, nga ana e këtyre shokëve, prandaj pyes, si për ju, drejtpërdrejt, ashtu edhe për komandantë e komisarë të njësive e reparteve të tjera. Edhe për ne mund të bëni kritika.

Tash kush dëshiron të marrë fjalën, se këtu nuk kemi radhë.

Çohet për të diskutuar shoku Mynyr Hoxha, në atë kohë sekretar i komitetit të Partisë të Shkollës së Lirë në Qytetin Stalin.

Mendoj se ti duhet t'i kesh të disiplinuar njerëzit që stërvit, se i ke punëtorë të mirë.

1. U drejtohet disa kuadrove ushtarakë, të pranishëm në këtë mbledhje.

SHOKU MYNYR HOXHA: Mësimet e Kongresit të 7-të të Partisë për forcimin e mbrojtjes së atdheut...

SHOKU ENVER HOXHA: Më fal që po të pres fjalën. Edhe unë e pata vështirë kur fola pa letër në mitingun e Gjirokastrës, sepse tash edhe mosha më shkoj, po mendova: përse të futem ta shkruaj fjalimin që do të mbaj? Le të flas më mirë pa kartë! Prandaj, edhe ti, më mirë lëre mënjanë tekstin që ke shkruar për ta kënduar këtu dhe na fol lirisht, ashtu si janë punët, se të jesh i bindur që kështu do të ketë më shumë interes.

SHOKU MYNYR HOXHA: Shkolla jonë e lirë, shoku Enver, ka dy vjet që është ngritur. Mbas punës së mirë që u bë për krijimin e shkollës, tani rëndësi të madhe merr konsolidimi i saj.

Pastaj ai foli për një sërë arritjesh konkrete në përgatitjen ushtarake të shkollës së lirë ku bënte pjesë.

SHOKU ALI DOÇI¹: Edhe ne, në rrethin e Kukësit, pas ngritjes së shkollave të lira ushtarake, vëmendjen e përqendruam në funksionimin e mirë të tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: U mbyt Kukësi i vjetër?

SHOKU ALI DOÇI: Jo, akoma nuk është mbytur. Uji ka arritur deri aty ku takohen të dy Drinat.

Për shkollat e lira ushtarake ne kemi akoma shumë për të bërë, por që tani mund të themi se ato po e kryejnë funksionin që u është ngarkuar sipas vendimit të Byrosë Politike. Komitetet e Partisë po

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit.

luftojnë për ta rritur përgjegjësinë e komunistëve dhe të gjithë punonjësve që marrin pjesë në to.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni asistuar ndonjëherë ju në stërvitjet që bëjnë apo në mësimet që zhvillojnë shokët oficerë dhe kuadrot në shkollat e lira?

SHOKU ALI DOÇI: Po, sidomos në stërvitjet e mëdha.

SHOKU ENVER HOXHA: Vetëm në stërvitjet e mëdha apo edhe në stërvitjet e vogla e në çetat vullnetare?

SHOKU ALI DOÇI: Kemi marrë pjesë edhe në stërvitjet e çetave vullnetare dhe në ato të shkollave të lira ushtarake.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jepen këto mësimet? Ndhimohen në teori dhe në praktikë kuadrot e shkollave të lira ushtarake nga oficerët e repartëve efektive? Çështja është se këta qahen për oficerët që, sipas tyre, nuk interesohen sa duhet e thonë që të ndërhyjë edhe komiteti i Partisë për këto probleme. Prandaj ta bëj unë këtë pyetje.

SHOKU ALI DOÇI: Ndhimohen edhe në teori, edhe në praktikë. Me rezervistët punohet teorikisht me miniaturat që kanë të ngritura aty dhe pastaj dalin edhe në terrenin praktik.

Një problem tjetër, që ne e konstatojmë pas ngritjes së shkollave të lira, ishte se komitetet e Partisë merreshin vetëm me aprovimin e programeve dhe me thirrjen në raport të komandave të ndryshme dhe, kur mbaronin stërvitjen, nuk merreshin sa duhej me analizën e kësaj stërvitjeje.

SHOKU ENVER HOXHA: Të të bëj edhe një pye-

tje. A interesoheni ju për stërvitjen edhe jashtë shkollës së lirë? Cili nga problemet duhet t'ju preokupojë ju më shumë?

SHOKU ALI DOÇI: Komitetet e Partisë merren më shumë me stërvitjet që janë të programuara, kurse me ato jashtë programit, nuk merren sa duhet.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, e kam çështjen jashtë shkollës së lirë. Për shembull, sekretari i komitetit të Partisë të rrethit e di se në shkollat e lira mësimet janë të programuara. Po, kur vete në organizatën e rinisë, në terren, a e këshillon rininë që të mësojë mirë, të stërvitet mirë etj. Këtë ai duhet t'ua bëjë edhe të moshuarve, edhe të rinjve. Po e ilustruj këtë me një shembull: Ushitari duhet të jetë i aftë, i shkathët, i fortë, prandaj duhet të merret edhe me fizkulturë. Domethënë, kooperativisti apo kooperativistja, duhet ta realizojë përgatitjen fizike gjatë gjithë vitit, edhe jashtë shkollës së lirë. Njerëzit tanë duhet të kaliten si spartanët, që të jenë të fortë, prandaj të merren vazhdimisht me ushtrimet fizike nga më të ndryshmet, me mundje, të ecin, të rëndin në shi e dëborë, me një fjalë, kur të marrin pushkën në dorë, të jenë me të vërtetë të shëndoshë, të kalitur dhe jo që sapo të hasin në vështirësinë më të vogël, të thonë: «E po dale, se më fryu era dhe u sëmura» etj. Ku të pyet lufta për erë e për shi?!

Kjo, pra, është një nga detyrat kryesore, jashtë detyrave të programuara. Këtë detyrë duhet ta kenë të gjithë vazhdimisht parasysh, kudo. Në shkollat e lira përgatitja fizike është e programuar dhe bëhet në mënyrë sistematike, por nuk duhet harruar edhe stërvitja jashtë këtyre programeve, si fjala vjen, veprimtari

të tilla si marshime, ekskursione me të rinjtë e të rejat, me punonjësit. Gjatë këtyre veprimtarive mund t'u thuash punonjësve: «Pa ngjijtuni ca këtij bregu, deri në majë, e të shohim kush do të vejë më parë!» ose, «pa hajdeni të bëjmë gara në këtë çair» apo «ejani t'i kapërcejmë këta hendeqet e të provojmë se kush i kalon më shpejt» e të tjerë. Bëni ju nga këto apo jo? Në shkolla të lira, me sa kam dijeni, nuk organizojnë të tilla gjëra. Atje bëjnë stërvitje, por i bëjnë, siç thashë, të programuara dhe sistematike. Prandaj as këtë aspekt të punës suaj mos e harroni si ju, si ata, që merren posaçërisht me këto punë. Njerëzit t'i kemi sa më të fortë fizikisht.

A është e qartë dhe a mbahet parasysh se çfarë roli të madh kanë forcat vullnetare? Ka raste që këtyre forcave nuk u vihet shumë rëndësi e nuk vlerësohet sa duhet roli i madh që do të luajnë ato në rast lufte. Me se mund t'i krahasojmë ne forcat vullnetare në kohën e luftës? Pikërisht me brigadat partizane. Ju duhet ta merrni me mend që armiku mund të na hedhë desantë për të çarë frontin tonë, të tillë që neve do të na duhet të bëjmë luftë partizane. Armiqtë po i stërvitin parashutistët për të bërë luftë gueriljesh kundër nesh, për të na shkatërruar prapavijat etj., pra, për të na dëmtuar sa më shumë. Mirëpo me kë do t'i përballojmë ne këto forca? Mos mendoni që për këtë qëllim do të heqim ushtarët nga fronti? Jo, në asnjë mënyrë! Prandaj forcat vullnetare të batalioneve, të çetave, të këtyre brigadave partizane, duhet të luajnë një rol të madh në kohë lufte. Çdo neglizhencë në përgatitjen e tyre tani, duke mos ua mësuar si duhet e me kualitet të

Iartë artin e luftës popullore, do të na kushtojë shumë gjatë luftës. Duhet të kemi parasysh se parashutistët që mund të hedhë armiku, do të jenë nga njerëzit më barbarë e më kriminelë; çdo gjë që ata do të gjejnë përpara do ta grijnë; ata qysh tash po mësojnë taktikën tonë partizane. Prandaj, edhe ne duhet t'u vëmë atyre përballë taktikën e luftës sonë partizane, por të një kualiteti të lartë, në mënyrë që këmba e armikut të mos zërë dot vend në tokën tonë. Në rast se ne do të neglizhojmë stërvitjen e forcave vullnetare sot, atëherë do të kemi rrezikuar krahët tanë.

Ma kuptoni këtë ide apo jo? Prandaj duhet t'i vini rëndësi të madhe kësaj çështjeje dhe, përveç detyrave të tjera, që pjesëtarët e çetave vullnetare të dinë të përdorin armët, të mësojnë teorinë e taktikën e luftës etj., nuk duhet harruar edhe kalitja e vazhdueshme fizike e tyre, në mënyrë që vajzat tona të hidhen si plumb përpara. Them vajzat, pse në forcat tona vullnetare ka më shumë vajza e gra, sidomos vajza të reja, të cilat duhet të jenë të zjarra, prandaj ato duhet t'i stërvitim me shumë kujdes. E ngrita këtë çështje, me qëllim që të vlerësohet si duhet stërvitja fizike e të gjithë efektivit, pse ata që do të mbrojnë frontin nuk do të rrinë brenda në tunele, por do të veprojnë kundër armikut me shpejtësi raketë.

SHOKU ALI DOÇI: Bashkëpunimin e komiteteve të Partisë të shkollave të lira me organizatat e Partisë të terrenit, na duket se nuk e kemi keq.

SHOKU ENVER HOXHA: I keni pyetur ju ndonjëherë rezervistët, jashtë kohës së stërvitjes, kur vijnë, fjala vjen, në shkollat e lira për të rifreskuar njohuritë

e tyre, për t'u marrë atyre mendimin nëse kanë qenë interesante mësimet që u janë dhënë dhe nëse e kanë ndier të nevojshëm këtë rifreskim? Në parim, ata sigurisht që e kanë ndier të nevojshëm, por, a ka qenë ky mësim jo vetëm një rifreskim i thjeshtë, por diçka më shumë, një plus në njohuritë që ata marrin, një plotësim në ushtrimet që bëjnë dhe a kanë ndjerë kënaqësi nga këto? A e keni bërë këtë apo nuk e keni bërë?

SHOKU ALI DOÇI: Në formë të organizuar, nuk e kemi bërë, por me persona të veçantë po.

SHOKU ENVER HOXHA: Po t'i bësh në mënyrë të organizuar këto pyetje, ata do t'ju flasin në mënyrë shabllone. Prandaj, në rast se doni të njihni mirë gjendjen, duhet të flisni kokë më kokë me ta, pse atëherë do t'ju thonë mendimin e vërtetë, si, fjala vjen, që komandanti i shkollës së lirë duhet të kishte bërë përpjekje më shumë, sepse ato që na tha dje ose sot, unë i di, kurse dëshira ime është të di më tepër. Ose do t'ju thotë që komisari, kur na i shtroi këto ose ato çështje, nuk na i sqaroi si duhet etj.

Ja, t'ju them një shembull: Në shkollat e lira tash vijnë njerëz që kanë mbaruar edhe shkollat e larta dhe e njohin mirë elektricitetin. Mirëpo, në një rast, oficeri, kur ka shpjeguar disa aparate, u ka thënë që pilat tona, me të cilat punojnë ata, janë shumë më të mira nga të jashtmet, për arsye se ato duke i prodhuar ne në vend, funksionojnë më mirë. «Pse, nuk janë të mira të jashtmet?», e pyet atë një inxhinier. «Të mira janë, përgjigjet oficeri, por duke qenë rruga e gjatë, pilat prishen gjatë udhëtimit». E po kush ia ha këtë oficeri këtë, kur dihet që shtetet kapitaliste sot janë

në gjendje të dërgojnë aeroplanë me shpejtësi të tillë të jashtëzakonshme, të ngarkuar me qindra mijë pila e t'i çojnë ato kudo brenda disa orëve? Pra, të tilla shpjegime nuk t'i hanë ata që vijnë sot në shkollat e lira.

Çështja është që oficeri ynë të dijë me kë ka të bëjë, prandaj ai duhet të bëjë përpjekje serioze që të zgjerojë njohuritë e tij. Për këtë po të pyes unë, që a studiojnë kuadrot ushtarakë?

SHOKU ALI DOÇI: Ka raste që oficerët ato që kanë shpjeguar vjet e parvjet i shpjegojnë përsëri sivjet, pa i pasuruar këto me të dhëna të reja të shkencës e të teknikës.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të na flasësh ti, shoku Andon, për disiplinën në këto shkolla? Së pari, për disiplinën në kuptimin e thjeshtë, pastaj edhe për disiplinën në stërvitje, në dhënien e mësimit nga ana e kuadrove dhe në përvetësimin e tij nga ana e pjesëmarrësve. A vijnë të gjithë në rregull, në kohën e duhur e të tjera, e të tjera.

SHOKU ANDON DOLLAKU¹: Direktiva e Partisë për Shkollën e Lirë Ushtarake po gjen zbatim të plotë. Tani rezervisti, vullnetari, ose studenti i shkollës, kur merr njoftimin për stërvitjen ushtarake, paraqitet në shkollën e lirë, ashtu si janë kërkesat e Artit Ushtarak të Luftës Popullore.

SHOKU ENVER HOXHA: Përçindjen e pjesëmarrësve si e keni?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Zbatohet plotësisht detyra që ka dhënë ministria. Vetëm kur ka probleme

1. Në atë kohë, komisar njësie në Fier.

të ekonomisë, mund që një rezervist të mos e bëjë stërvitjen në kohën e planifikuar, por në një periudhë tjetër. Problemi i pjesëmarrjes në stërvitje nuk është më një shqetësim, siç ka qenë më parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sekretarët e Partisë në shkollat e lira ushtarake e kanë mbaruar shërbimin ushtarak. Ata, pra, janë kuadro, domethënë oficerë. Si duket gjendja e tyre nga ana e njohurive ushtarake? I zotërojnë mësimet, i kanë të gjalla njohuritë ushtarake që kanë marrë dikur?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Niveli i tyre është rritur, sepse sekretarët e komiteteve të Partisë të shkollës së lirë janë nga njerëzit më të mirë, janë shokë të forumeve.

SHOKU ENVER HOXHA: Po anëtarët e tjerë të komitetit të Partisë të shkollës së lirë?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Edhe anëtarët e komitetit të Partisë janë shokë të ngritur.

SHOKU ENVER HOXHA: Pyes nga pikëpamja ushtarake?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Jo të gjithë këta shokë i kanë njohuritë e duhura ushtarake, ndaj ne, shokët e ushtrisë, duhet të ndihmojmë më shumë në këtë drejtim.

SHOKU GAFUR ÇUÇI¹: Të themi të drejtën, me sekretarët e komiteteve të Partisë të këtyre shkollave nuk merret shumë as rrethi, as njësiti e repartet ushtarake. Seminare për ngritjen teoriko-ushtarake të sho-

1. Në atë kohë, punonjës në aparatet e KQ të PPSH për problemet e mbrojtjes.

këve të këtyre shkollave ose nuk bëhen fare ose janë shumë të rralla.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtë pyes edhe unë.

Ju, shokë, a e keni një ide pak a shumë të përafërt se sa për qind do të jenë komandantë të njësive të ndryshme, nga këta që po stërvitim në shkollat e lira, në kohë lufte, kur të bëhet mobilizimi i përgjithshëm? Në qoftë se mund të keni një ide të përafërt, atëherë duhet të mendoni se si do ta përballojmë në këtë luftë të madhe e të tmerrshme që mund të na vijë, me komandantë të zotë, në qoftë se këta ne nuk i kemi stërvitur që sot mirë dhe si duhet ushtarakisht?! Kjo çështje duhet t'ju preokupojë ju, në radhë të parë dhe asnjë shfajësim nuk duhet të ketë për këtë problem kaq të madh. Nuk lejohet aspak që komandanti të interesohet kryesisht dhe vetëm për repartin aktiv e jo edhe për gjithë forcat e tjera. Kjo është një pikëpamje e vjetër. Oficeri ynë duhet me domosdo të interesohet për repartin aktiv. Por, ushtria jonë nuk është e gjitha në reparte aktive se janë edhe gjithë këto forca të tjera, si shkollat e lira, çetat vullnetare etj. Përse e kemi bërë në këtë organizim të ushtrisë?! E kemi bërë pikërisht që ushtria jonë të jetë një ushtri e madhe popullore, që gjithë populli të jetë ushtar në luftë; gjithë populli të jetë i organizuar; gjithë populli të ketë komandantët e komisarët e vet që do ta drejtojnë sa më mirë si sot në stërvitje ashtu edhe nesër në luftë, po ta dojë puna.

Është afër mendjes se as Partia, as komanda nuk mund ta neglizhojnë në asnjë mënyrë një çështje të tillë me kaq rëndësi. Komandanti i njësisë ose i repartit

duhet të ndiejë thellë përgjegjësinë e madhe që ka për Shkollën e Lirë Ushtarake e të mendojë se duhet të vejë medoemos atje. Bile, repartin e vet ai mund edhe ta lërë për ca ditë. Gjatë kësaj kohe, që puna të mos i ngelet mangët, e çdo gjë t'i kryhet në rregull, ai mund të ngarkojë zëvendësin e tij ose komisarin që për 10 ose 15 ditë ta luajë ai rolin e komandantit e të shkojë të vizitojë shkollat e lira. Po ja, gjatë luftës, ta zëmë se na u vra komandanti. Kush do ta marrë komandën? Menjëherë komisari dhe ai tjetri që është nën të, do të zërë menjëherë vendin e tij. Atëherë, ai si nuk mund ta lërë dot komisarin tani që ta zëvendësojë atë për 10 ditë, që të komandojë njësinë apo repartin? Mund ta lërë që ç'ke me të! Kështu duhet të bëhen këto punë, se edhe në repart, edhe në shkollën e lirë punohet për mbrojtjen e atdheut.

Ndryshe, nuk mund të bëhet. Duhet të keni edhe vetë më tepër iniciativë. Përgatitja e efektivit të shkollave të lira duhet të jetë një preokupacion i madh për të gjitha komandat në reparte e nënreparte dhe të mos prisni kurdoherë udhëzime për çdo gjë nga Ministria e Mbrojtjes apo nga Komanda e Përgjithshme.

Komandanti i njësisë apo i repartit në kohë lufte dhe në kohë paqeje ka mbi vete barrën që të stërvitë gjithë efektivin që ka në vartësi, të gjithë komandantët e repartit që komandon. Që ta kryejë mirë detyrën, ai duhet t'i ngrejë këta kuadro në një nivel të lartë. Për këtë qëllim atë të mos e zërë as gjumi, prandaj të mendojë që të gjejë mënyrat, format, metodat e kohën që, si e si ta ngrejë nivelin e tyre dhe ta shohë e ta ndjekë edhe konkretisht se si po realizohet kjo ngritje.

Pra, komandantin e njësisë apo të repartit, me gjithë shtabin e tij, me komisarën, sekretarin e Partisë e të tjerë, më parë se t'i jepet urdhri nga Komanda e Përgjithshme për të organizuar këtë ose atë kurs, nuk e ndalon as Komanda e Përgjithshme dhe as Ministria e Mbrojtjes që të gjejë kohën e përshtatshme e të organizojë një kurs vetë me 10-15 komandantë të njësisë jo efektive të shkollave të lira. Përkundrazi, Ministria e Mbrojtjes duhet dhe do t'i thotë «të lumtë»! dhe do ta marrë si shembull. Kur t'i vijë kontrolli nga lart, do të konstatojë se ai ka plotësuar jo vetëm detyrën që i është ngarkuar, por edhe një detyrë tjetër, plus. Pastaj, kur të vijë urdhri për të hapur një kurs, është tjetër punë, i kalon kuadrot edhe në kurs, ku mësimet jepen në një kohë të caktuar dhe me tema të caktuara. Pra, kur komandanti dhe shtabi i tij e ka syrin si duhet në këto shkolla, në repartet vullnetare etj. dhe vëren se atje ka këto apo ato dobësi, ai duhet të marrë masa që t'i zhdukë, se është efektiv i tij, se me ata do të luftojë ai nesër, prandaj duhet t'i ketë në lartësinë e duhur. Kështu duhet ta kuptojmë këtë çështje, që të zhduken dobësitë kudo ku ekzistojnë.

Është mirë që detyrat ushtarake t'i mësojnë edhe komisarët, por ata duhet të kryejnë në radhë të parë detyrat politike. Mos kujtoni se komisarët e dinë çdo gjë siç duhet. Komisari ka një rëndësi të madhe në ushtri. Ai duhet të jetë i ngritur politikisht dhe ideologjikisht, se vetëm atëherë do të kuptojë drejt ç'është Shkolla e Lirë Ushtarake në gjithë kompleksin e vet, domethënë, të vlerësojë rëndësinë e mësimin, të ngritjes politike e ushtarake të efektivit. Por, përgatitja

ushtarake ka një mijë gjëra, duke filluar që nga disiplina e thjeshtë dhe deri te disiplina shkencore. Komisari jo vetëm që duhet t'i dijë të gjitha këto ushtarakisht, por t'i kuptojë edhe politikisht, sepse, po nuk i kuptoi politikisht, nuk do ta bëjë mirë punën. Këto janë detyra që duhen kryer me domosdo!

Të gjitha materialet politike dhe ideologjike nuk duhet të mësohen sa për t'u mësuar, por për t'i zbatuar, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve kyç. Cili është problemi kyç për ushtrinë? Që ajo të jetë e aftë, e përgatitur si duhet për rast luftime. Por që të bëjmë luftë me sukses, duhet të jemi të stërvitur mirë ushtarakisht, të jemi fizikisht të fortë, të kuptojmë mirë taktikën e armikut. Në radhë të parë të kuptojmë taktikën tonë, pastaj edhe atë të armikut. Prandaj, komisari kur i mëson këto në teori, këtë teori duhet ta përdorë në praktikën e problemit kyç, në luftën e ardhshme që mund të na imponohet.

Dëshiroj të theksoj një çikë edhe rëndësinë e disiplinës shkencore për oficerët që drejtojnë shkollat e lira ushtarake. Këta duhet të bëjnë përpjekje të veçanta për të ngritur vazhdimisht nivelin e tyre, duke menduar se ato ditë stërvitje në vit që bëjnë njerëzit atje nuk janë gjithçka. Prandaj oficeri që zhvillon stërvitjen, të jetë në gjendje që brenda atyre ditëve të bëjë sinteza të atilla të problemeve që jo vetëm t'u rifreskojë rezervistëve njohuritë e mëparshme, por dhe t'u futë atyre në kokë diçka më tepër se ajo që ka mësuar deri më sot. Këtë kuptoj unë me disiplinë shkencore të veçantë për këta shokë dhe për ata që do të venë të kontrollojnë dhe t'i mësojnë këta oficerë.

Në njësi e reparte ku kemi ushtarët aktivë çdo gjë është e programuar, por aty kemi kohë më tepër, sepse ushtarët qëndrojnë në ushtri rreth dy vjet e, megjithatë, stërvitjet me ta bëhen me disiplinë shkencore, kurse me rezervistët, që bëjnë stërvitje vetëm disa ditë në vit, kërkohet që disiplina shkencore të jetë edhe më e fortë akoma.

SHOKU ANDON DOLLAKU: Për oficerët rezervistë të shkollave të lira, që drejtojnë stërvitjen, para fillimit të saj, bëhet përgatitje e veçantë e tyre, nën drejtimin e kuadrove aktivë.

SHOKU ENVER HOXHA: Si zhvillohet kjo stërvitje e vogël, mund të më flasësh më konkretisht?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Sipas llojit të mësimit. Për shembull, rregulloren e disiplinës e bëjmë edhe në klasë. Kur kemi taktikë, dalim në terren apo në poligon.

SHOKU ENVER HOXHA: Venë oficerët aktivë në këto stërvitje, asistojnë? Na e thuaj konkretisht apo është ajo që thashë unë: «Mbarova këto ditë stërvitjeje dhe mbeç me shëndet shoku komisar!»? Pra, venë vazhdimisht apo një herë në hënë?

SHOKU ANDON DOLLAKU: Venë, shoku Enver, ndihmojnë.

SHOKU MYNYR HOXHA: Të flasim hapur, shtabet e njësive e të reparteve duhet të lidhen më shumë me shkollat e lira. Ne e shikojmë në praktikë që, në disa raste, oficerët rezervistë janë shumë më të përgatitur se oficerët aktivë për lëndë të veçanta. Unë kam një rast aty, në shkollën tonë, që oficeri rezervist është fizikan. Kur bënte llogaritjet komandanti në dërrasën

e zezë, rezervisti i thoshte aty për aty se sa do të dilte përfundimi.

SHOKU ENVER HOXHA: Si në shkollë, për she-mbull, në matematikë. Për një problem, profesori shpjegon një zgjidhje, mirëpo një nxënës i zoti, që ka studiuar edhe vetë, jashtë programit mund t'i tregojë një variant tjetër të zgjidhjes. Profesori rri, e pasi mendohet një çikë, i thotë pastaj: «Ke të drejtë, mund të zgjidhet problemi edhe ashtu si thua ti!». Këtë she-mbull e lidh me atë që një rezervist mund të jetë më i zoti në një çështje sesa komandanti i shkollës së lirë dhe mund t'i thotë atij se ky problem mund të zgjidhet edhe kështu. Po komandanti nuk duhet t'i thotë: «Jo, ai duhet të zgjidhet vetëm kështu si them unë!», se mos i bie autoriteti. Jo, komandantit nuk i bie autoriteti, po t'i japë të drejtë kur zgjidhja është në rregull. Po çështjen e kam që oficerët tanë duhet t'i kemi njerëz të përgatitur.

Për këto gjëra unë jam në dijeni. Pyetjet po i bëj edhe për të mësuar nga ju, por edhe që t'i futni në xhep këto që po them.

Duhet të keni parasysh se lufta në ditët e sotme është një luftë moderne, prandaj që ta përballojmë atë duhen zgjeruar vazhdimisht njohuritë. Të zgjerosh njohuritë, do të thotë të aftësosh kuadrot në nivel me kërkesat e kësaj lufte moderne.

Çështja tjetër që duhet të kemi parasysh është se tash ne nuk kemi më si përpara ushtarë analfabetë, por njerëz të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, që ju i stërvitni ushtarakisht. Këto mësimë, që jepen në ushtri, ata janë në gjendje t'i përvetësojnë shumë mirë.

Prandaj u vihët për detyrë kuadrovc, domethënë gjithë oficerëve, në çdo detyrë që të jenë, t'i përgatitin në nivel sa më të lartë edhe ushtarët. Ne duam që në kohën e luftës t'i punojë koka edhe ushtarit dhe jo më të mos dijë komandanti. Pra, edhe ushtari duhet të njohë shumë gjëra të taktikës dhe të strategjisë. Pse e them këtë? Sepse ushtarët ne i kemi sot me shkollë të mesme, dhe, kur ti do t'i japësh një urdhër, ai vërtet do ta zbatojë atë urdhër, por duhet të jetë njëkohësisht edhe krijues dhe jo automat. Është fakt se ne sot të tillë i kemi ushtarët, të ngritur, prandaj duhet detyrimit që edhe oficerët t'i kemi të zotë. Dhe po t'i kemi oficerët me të vërtetë të zotë, ata patjetër që do të luftojnë për të vendosur kudo një disiplinë sa më të fortë në çdo drejtim. Ata duhet të kenë të qartë sidomos se pa stërvitjen e vogël nuk bëhet dot mirë as stërvitja e madhe.

Kuadro të aftë e të përgatitur kemi kudo, por duhet të dimë t'i aktivizojmë ato. Ne kurdoherë i kritikojmë organizatat e Partisë të terrenit se nuk i aktivizojnë si duhet shokët e komitetit të Partisë e anëtarët e plenumeve të tyre. Një anëtar i plenumit të komitetit të Partisë ka ardhur aty se është shok që ka një eksperiencë për problemet që do të ndjekë në rreth. Ai mund të jetë agronom ose kooperativist i dalluar, por në komitet rrihen një sërë problemesh të përgjithshme të rrethit. Për këtë anëtarët e komitetit duhet të jenë kompetentë që kur të venë në një kooperativë ose në një ndërmarrje për të ndihmuar dhe për të vënë rregull, të dinë se ç'të thonë. Dhe të tillë ka në rrethe, po nuk i aktivizojnë në çdo rast. Në këtë drejtim ne

kemi të meta. Të vijnë tash te komiteti i Partisë i një njësie apo reparti. Edhe shokët që drejtojnë aty nuk janë pa eksperiencë, sidomos për anën ushtarake. Ata mund të jenë kuadro me akademi, prandaj edhe këta duhet të shfrytëzohen racionalisht. Natyrisht, duarlidhur ata nuk rrinë se ata komandojnë e drejtojnë diçka. Por, puna është që këta të vënë edhe në këto shkolla që të ndihmojnë, se ata i kanë mundësitë për këtë ndihmë.

Ja, mund të them një shembull. Ne kemi në ushtri komisar dhe sekretar partie¹. Një nga këta të dy mund të shkëputet dhe të vejë në shkollat e lira ku mund të zhvillojë edhe një lëndë politike apo ushtarake. Në qoftë se sekretari i Partisë nuk ka haber nga çështjet ushtarake, ai nuk është gjë. Po kështu edhe në qoftë se komisari nuk ka haber nga çështjet ushtarake, edhe ky s'është gjë dhe politika që do të bëjë, do të jetë diçka në hava.

Këta janë me të vërtetë të ngarkuar dhe këtë ne e dimë. Por duhet organizuar puna më mirë e të gjenen mundësitë, që me një shfrytëzim sa më racional të kohës t'i kenë më mirë në dorë shkollat e lira, se këto janë të rëndësishme: atje përgatiten shumica e njerëzve që nesër do të bëjnë luftën. Këtë gjë ju duhet t'u a bëni të qartë komandantëve të njësive e repartëve. Por ata ta kenë edhe vetë kujdes e jo të presin që t'u thonë këto detyra. Ju mund t'u flisni atyre

1. Që nga viti 1983, në ushtri funksioni i komisarit u njësuar me atë të sekretarit të komitetit të Partisë të njësisë apo të repartit.

një herë, dy herë e shumta. Por duhet, siç thashë që edhe ata vetë të vrasin mendjen për këtë se edhe kjo është detyrë e tyre.

Punëtori i Partisë, pra, duhet të jetë i përgatitur edhe nga ana ushtarake. Ne duhet t'i japim më tepër kohë anës ushtarake për të edukuar oficerët rezervistë dhe të mos u hamë aq shumë kohë me çështje politike se këtë punë e bëjnë dhe duhet ta bëjnë edhe organizatat e terrenit. Kështu mendoj unë. Megjithatë, kur ta shohë të nevojshme, komiteti i Partisë mund t'i thërrisë oficerët rezervistë në kurse të shkurtra prej gjysmë dite ose edhe një ditë të tërë edhe jashtë kohës së stërvitjes, ku t'u zhvillojë tema të përgatitura sa më mirë që ata të kthehen të armatosur politikisht. Por, në stërvitjet që bëhen në shkollat e lira, duhet t'i vihet theksi sidomos përvetësimit të artit ushtarak nga ana e tyre. Shokët e Partisë në terren, që janë rezervistë, qofshin këta instruktorë partie etj. mund të thërriten nga komandantët apo komisarët e njërive a të repartëve që t'i mësojnë se si ta kuplojnë detyrën e përvetësimit të artit ushtarak etj. Gjithmonë të nisemi nga mendimi se për përgatitjen ushtarake, siç e thashë edhe më parë, nuk duhet të mjaftohemi me ato ditë në vit që janë programuar për stërvitje.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PIONIERËT JANË FILIZAT E SË ARDIIMES, JANË ATA QË DO TË MARRIN NË DORË STAFETËN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

28 prill 1978

Tani kemi në shqyrtim punën që bëhet me pionierët, me këto lule të bukura të atdheut. Ata janë në përgatitjet e fundit të festës së 1 Majit, por në festivalet, që u bënë para kësaj feste, kanë shkëlqyer. Njeriu ndien gëzim dhe kënaqësi të madhe kur shikon gjithë këto aktivitete të pionierëve. Nuk mund t'i barazosh kurrë këto me ato aktivitete fare të pakta të kohëve kur ishim ne në moshën e tyre. Pionierët e fëmijët sot ligjërojnë si bilbila, vajzat e djemtë këndojnë në grupe të mëdha korale, marrin pjesë edhe si instrumentistë në orkestra masive. Një punë shumë e madhe është bërë dhe bëhet me pionierët nga rinia dhe veçanërisht nga shkolla. Ja, për këto probleme do të diskutojmë sot.

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit të paraqitur nga Komiteti Qendror i BRPSH «Mbi punën e organizatës së rinisë e të shkollës për rritjen e rolit të organizatës së pionierit».

Për pionierët deri sot është vetëm revista «Pionieri», kurse revista «Fatosi» botohet për më të vegjlit. Por është vallë e mjaftueshme për nevojat e pionierëve tanë revista «Pionieri»? Një kjo.

E dyta, a interesohen shkrimtarët të përgatitin pjesë të përshtatshme për pionierët dhe jo vetëm pjesë patriotike, me tema, fjala vjen, si «Partizani në mal» etj.? Këtu u fol për prirjet që duhet t'u zhvillojnë këtyre fëmijëve, si për bujqësinë, industrinë, teknologjinë, fizikën etj. Romanin e kanë një çikë më të vështirë ta kuptojnë për horizontin e tyre, po për të shkruar tregime me përfytyrime e me fantazi, siç u pëlqejnë fëmijëve, ka tash te ne njerëz të tillë që janë në gjendje t'i përgatitin. Këta njerëz të talentuar ne duhet t'i nxjerrim vetë nga gjiri i rinisë. Mua më duket dhe kam përshtypjen se vetëm një revistë, siç është ajo «Pionieri», nuk është e mjaftueshme për të kënaqur interesat e shumanshëm të pionierëve. Puna për të duhet të përmirësohet, por duhet të ketë më tepër botime¹ për pionierë. Të shikohet mundësia, mendoj unë, se pionierët duan më shumë variacione.

Unë kam parë dhe kam kaluar nëpër duar mjaft libra për fëmijë, por, natyrisht, nuk i kam kënduar të gjithë. Megjithatë e di çfarë botohet, se shoku Haxhi Kroj m'i jep vazhdimisht. Çështja e paraqitjes së tyre duhet parë akoma më mirë, vizatimet të jenë më të bukura, me fantazi më të zhvilluar, të jenë sa më tërheqëse për fëmijët. Unë kam mbësën dhe nipërit në shtëpi që

1. Pas kësaj porosie të shokut Enver, në dhjetor të vitit 1979 filloi botimi i revistës shkencore për pionierë «Horizonti».

më kërkojnë vazhdimisht libra. Ata libra që u çoj unë janë të mirë, me figura dhe ngjyra nga më të ndryshmet. Me këta libra fëmijët kënaqen, por duhet të kemi parasysh edhe veçoritë e moshës së tyre. Botime kryesisht të bëjmë vetë, por disa gjëra duhet të shikohen, se ka nevojë edhe për përkthime. Kam parë, për shebull, libra të Zhyl Vernit që janë përkthyer. Libra të tillë duhet të bëjmë përpjekje t'i gjejmë, se ka. Ka edhe libra të autorëve të tjerë, por përkthimet të plotësojnë botimet tona. Mendja e shkrimtarëve tanë duhet të punojë më shumë dhe me fantazi në këtë drejtim. Të krijojmë më tepër për rininë dhe për pionierët tanë.

Po rrethe të ndryshme vetëm në shtëpitë e pionierit zhvillohen, apo organizohen edhe në vende të tjera, fjala vjen, në radhë të parë, në shkollë, apo edhe në fabrikë ku kanë mundësi, sipas profilit, pionierët të merren me ndonjë zanat, të mbërthejnë e të zbërthejnë? Ka gjëra të tilla apo jo? Se që të shkojnë në fabrika e uzina për të parë është tjetër gjë, dhe që të shkojnë për të punuar është tjetër, kjo do t'u shërbejë edhe si nxitje për t'u mësuar me punë.

Në shkollat e rretheve të ndryshme është mirë të bëhen albume me koleksione nga flora e secilit rreth. Nëpërmjet këtyre të njihen pionierët me bimët, insektet etj. që kanë në rrethin e tyre. Pra të ketë më shumë interesim për këto gjëra.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, siç u tha edhe këtu, e ka për detyrë të hartojë programe dhe të japë përvojë për rrethet jashtëshkollore, por nga shkollat dhe organizatat e rinisë e të pionierëve duhet të ketë iniciativë për të gjitha këto që u përmendën këtu. Për

përgatitjen e koleksioneve që thashë më lart, faktori kryesor është vetë mësuesi që jep lëndën e botanikës, për shembull. Ky duhet të ngjallë tek të rinjtë e të rejat shkollare atë pasion të madh dhe jo vetëm teorik, por të organizojë edhe punën praktike, pa pritur t'i venë udhëzime nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Vetë mësuesi i lëndës cakton, fjala vjen, ditën e diel që është pushim, për këtë qëllim. Atëherë nxënësit, në vend që të luajnë me top, ngrihen herët në mëngjes, shëtitin kodrave rreth e qark, mbledhin lule e insekte të ndryshme. Për këtë qëllim gjithsecili duhet të ketë nga një fletore, ku t'i vërë ato duke i ngjitur ose mbërthyer dhe nën to shkruan emrat përkatës. Në qoftë se nuk kanë emër shqip, le t'u vihet atyre edhe latinisht dhe këta emra ua thotë mësuesi. Kështu mund të krijohet një album komplet për lulet. Aktivitete të tilla të dobishme mund të bëhen nga më të ndryshmet. Në fillim mund të mos vijmë të gjithë, por, kur të shikojnë punën e bukur që do të bëhet nga ata që venë, atëherë do të ngjallet edhe te nxënësit e tjerë një kureshtje e madhe shkencore, një dëshirë e zjarrtë për të parë e për t'u njohur me bukuritë e vendit, me florën dhe me faunën tonë. Njëkohësisht do t'i organizojmë fëmijët në një punë të dobishme.

Një rol të tillë të madh, siç theksova edhe më lart, duhet ta luajë mësuesi. Ky të bëjë disa sakrifica nga ana e tij, por mendoj se këto janë të këndshme për atë që e do profesionin e mësuesit. E para, me këtë mënyrë ai largon rutinën nga programi mësimor; e dyta, për vete ndien kënaqësi, se tërë jeta e tij është e lidhur me ata nxënës. Duke i drejtuar nxënësit jashtë, në ha-

pësirë, në sektorë të ndryshëm dhe me këto forma të këndshme, ai zgjon tek ata kuriozitetin dhe nxit zhvillimin mendor të tyre. Këtë pasion për punën duhet ta kenë mësuesit e të gjitha lëndëve. Ja, dikush tha këtu që ka nga ata nxënës që mbledhin fjalë të rralla, mbledhin këngë, mbledhin përralla etj. Po kush ua ushqen këtë dëshirë atyre? Mësuesit e gjuhës e të letërsisë shqipe, mësuesit e historisë, të gjeografisë e të tjerë. Por duke lexuar këto përralla, këto fjalë e shprehje nga një punë koleksionuese, mund të përgatiten hartime me vlerë historike dhe shkencore, me fantazi të zhvilluar për vetë nxënësit, që nga pionierët e deri tek anëtarët e organizatës së rinisë. Ne kemi plot të rinj e të reja që shkruajnë shumë mirë. Nuk e kam fjalën këtu për shkrimtarët e afirmuar, po për djemtë e vajzat e shkollave që bëjnë hartime të mrekullueshme, prandaj të mos kufizohemi vetëm në caktimin e detyrave konkrete. Pionierëve e nxënësve u shpjegojmë në forma të tjera, që edhe mësimi të bëhet sa më konkret. Është më mirë që ne të fillojmë me pionierët, t'u mësojmë atyre çdo gjë që kemi përreth. Sigurisht, kështu ata do të shuajnë kuriozitetin dhe njëkohësisht do të mësojnë. Për shembull, nxënësi merr fletën e rrapit ose një lule dhe e ngjit në koleksion, atëherë mësuesi i botanikës i tregon pjesët përbërëse, rëndësinë dhe përdorimin që ka pema ose lulja dhe u tërheq vëmendjen. Kështu nxënësi futet në natyrën e sendeve, mëson edhe botanikë, zoologji etj. dhe kështu përgatitet në jetë.

Prandaj, kur flasim për iniciativën e pionierëve dhe të rinisë, duhet, në radhë të parë, të mbahet parasysh iniciativa e mësuesve dhe jo të pritët që të progra-

mohen të gjitha gjërat, jo të gjitha duhet të priten e të thuhën nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Kjo sigurisht do të japë udhëzime dhe do të kontrollojë e do të ndihmojë për zbatimin e tyre, por kërkohet edhe iniciativë dhe kjo është e pakufishme në këtë drejtim.

Thashë në fillim të diskutimit se gjithë populli ndien një kënaqësi të jashtëzakonshme kur shikon atë mori pionierësh që dalin në skenë. Çfarë entuziazmi krijon gjithë ky përparim në popull! «Të tërë u bënë artistë», thotë populli, dhe vërtet të tërë dinë të recitojnë, të hedhin valle, të këndojnë, e çfarë të kënduari! Duhet thënë se në këtë drejtim është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe dhe ke ku zgjedh. Në të gjitha degët e artit shquhen artistët e rinj: në teatër, në muzikë, në kinematografi etj. Ka nga ata që jo vetëm këndojnë, por edhe kompozojnë. Ka që edhe shkruajnë, por më vonë do të shkruajnë vepra të arritura dhe nuk janë një e dy, por në masë. Dëgjova tash së fundi vajzën e Avni Mulës që këndonte këngën e «Nënës». Më bëri shumë përshtypje. Të njëjtën këngë të bukur dhe shumë prekëse, fjalët dhe muzika e së cilës janë hartuar nga Avni Mula, që është një kompozitor i talentuar, e këndonte edhe një djalë¹. Pjesët e kompozuar nga Avni Mula janë të tilla që i këndojnë të gjithë, ato janë bërë masive. Rëndësi kanë edhe kompozimet në gjini të mëdha muzikore, por edhe këngët e lehta të kësaj natyre që thashë se ato i këndojnë të gjithë. Kënaqësi të sjell edhe zëri i ëmbël i atij që këndon, edhe teknika e përsosur e interpretimit. Si artistë të përgatitur in-

1. Ardit Gjebreja.

terpretojnë pionierët në skena dhe këtë ne e shikojmë në të gjithë vendin.

Para disa vjetësh ishin të paktë ata që shkruanin skenarë për filma. Kjo punë nënvleftësohej se krijuesit mendonin se ishte më mirë të shkruanin romane. Partia nguli këmbë në këtë çështje dhe tashti shkruhen skenarë e dalin filma të bukur, bile shumë të bukur. Natyrisht, në ta është bashkuar imagjinata e shkrimtarit, e skenaristit dhe e regjisorit, e atyre që e kanë vënë në skenë. Mora këtu si shembull kinematografinë, po kështu ka përparime në të gjitha gjinitë e artit. Pra tashti te ne shkruhen edhe librete për opera, ka edhe njerëz që i përgatitin ato, si edhe artistë që i interpretojnë.

Pse të shikojmë larg, ne kemi artistë të dalë nga organizata e pionierit dhe e rinisë. Ja, filmat «Lulëkuqet mbi mure», «Tomka dhe shokët e tij», «Beni ecën vetë» etj., etj. janë me një përmbajtje të lartë edukative, që i kanë pëlqyer jo vetëm publikut tonë, por edhe atij të huaj. Jashtë filmat tanë kanë bërë efekt të madh për arsye se në vendet kapitaliste dhe revizioniste masa e popullit shqetësohet jashtëzakonisht për të ardhmen e brezit të ri që i ka hyrë rrugës së degjenerimit.

Kam mendimin dhe bindjen që, në rast se tregohet një kujdes një çikë më i madh, për të vënë në rrugë një problem kaq të domosdoshëm dhe të frytshëm, nuk do të harxhojmë një kohë aq të gjatë sa kemi harxhuar përpara, se tash kemi eksperiencë dhe do të kemi rezultate më të mira e më të shpejta, prandaj t'i futemi punës për të bërë më shumë filma. Në qoftë se krijojmë mundësitë, dhe ne duhet t'i krijojmë këto mundësi,

të plotësojmë më mirë nevojat e kinostudios sonë edhe me disa aparatura më të mira, me kuadër më të përgatitur etj. Gjithashtu, janë botuar te ne novela aq të bukura të shkruara nga shkrimtarët tanë për pionierët dhe nga vetë pionierët, me të cilat mund të bëhen filma të bukur e me harxhime të pakta. Ne mund të përgatitim filma të mrekullueshëm në natyrën tonë të bukur, me këta djem e me këto vajza që janë kaq të talentuara. Apo nuk mund të luajnë në filma ato dy vajzat që pamë të paraqitnin programin në Festivalin e Këngës për Fatosë e Pionierë në Shkodër, dhe çfarë të paraqituri që i bënë programit! Sidomos njëra nga ato vajzat ishte shpuzë fare.

Po, po, vajza dhe djem si këta janë në gjendje të luajnë bukur filmat tanë të mrekullueshëm. Prandaj të rritet iniciativa, se në fund të fundit këto krijime kanë rëndësi të madhe, me to edukohet brezi ynë i ri, gjithë rinia jonë.

Zhvillimin e gjithë këtyre talenteve edhe në të ardhmen ne duhet ta ndjekim me kujdes. Ja se ku kemi arritur sot, por duhen shumëfishuar forcat që të punohet më shumë me këngët, vallet dhe me muzikën në masën e pionierëve. Këtë duhet ta bëjmë patjetër, por këtë frymë duhet ta futim edhe në sektorët e tjerë. Kemi mundësi t'i arrijmë ne këto caqe, po t'ia vëmë si detyrë vetes? Sigurisht që kemi mundësi. Të mos vëmë përpara pengesat, format e mënyrës së organizimit, të dhënies së urdhrave etj., rëndësi ka çështja që politikisht t'i përgatitim njerëzit që të kenë iniciativë dhe t'i organizojnë mirë të gjithë këta sektorë. Në këtë mënyrë ne do t'i bëjmë një shërbim të jashtëzakonshëm

atdheut për faktin se pionierët janë filizat e së ardhmes, janë ata që do të marrin më vonë në dorë stafetën.

Situata në vendin tonë është e tillë që në vijën e Partisë po përgatiten tash kuadro me bazë në sektorë të ndryshëm. Edhe në këtë drejtim shikojmë një përparim të madh. Shumë prej tyre mbarojnë shkolla dhe kalojnë në drejtim. Ja, për shembull, shokët që drejtojnë organizatën e rinisë. Por kështu si këta ka edhe me qindra të tjerë të reja e të rinj. Sa më shumë mësojnë, aq më të zotë do të jenë të rinjtë tanë, se duke kaluar nëpër shkolla e në universitet, duke u kalitur në organizatën e rinisë, kudo bëhet një punë e gjerë, plotësuese, e vazhdueshme, kështu që kur del kuadri i ri është në gjendje ta lidhë teorinë me jetën. Ne duhet t'i bashkojmë kurdoherë mësimet dhe punën e shkollës me jetën.

Në rrethet e ndryshme ku aktivizohen pionierët, si nëpër ato të teatrit, të muzikës, në rrethet tekniko-shkencore etj., të pasqyrohet lidhja e teorisë që merret në shkollë dhe në libra me praktikën. Por një gjë e tillë nuk duhet të kuptohet në mënyrë të thjeshtë.

Ne kur kemi qenë të rinj si ju, nuk i kishim gjithë këto mundësi që ka krijuar Partia për ju. Edhe këtu, në Sekretariat, kemi shokë që kanë kaluar nga organizata e rinisë, që kanë udhëhequr rininë, kanë kryer detyra të tjera me rëndësi dhe që mund të na ndihmojnë. Kemi shokë të tillë, si Ramizin, por edhe të tjerë si Leka Shkurtin, Gafur Çuçin e të tjerë.

Po t'ju dalin probleme dhe po të keni vështirësi, kërkoni ndihmë. Mua më duket se Partia duhet ta for-

cojë edhe më tej punën me rininë në masat e popullit dhe në çdo familje, sidomos në drejtim të shembullit të mirë nga ana e prindërve, nga ana e motrave, e vëllezërve më të mëdhenj ndaj më të vegjëlve, apo jo? Mua më duket se është e nevojshme. Dhe të mos mendohet se rolin kryesor për edukimin e rinisë e të pionierëve e ka vetëm shkolla. Shkolla, natyrisht, ka një detyrë të madhe, që duhet ta bëjë dhe e bën, por detyra për edukimin e brezit të ri kanë edhe të tjerët jashtë shkollës. Në këtë drejtim të përpiqemi t'i shtojmë të gjitha forcat dhe mundësitë. Familjet duhet ta kuptojnë drejt politikisht detyrën që kanë për edukimin e fëmijëve të tyre jo në mënyrë sentimentale. S'ka dyshim që të gjithë i duam fëmijët me gjithë shpirt, por t'i duam jo sa për t'i përkëdhelur, por edhe të punojmë me ta që të na bëhen njerëz të ndershëm, patriotë e të zgjuar që t'u shërbejnë popullit, atdheut dhe çështjes së socializmit. Këto kërkesa të gjithë t'i kenë të qarta dhe Partia t'ua futë në kokë prindërve që këta jo vetëm ta marrin thjesht këtë çështje, por secili të bëhet edhe edukator i mirë për fëmijët e vet. Çdo sjellje e çdo fjalë e të rriturve duhet të jetë e matur para fëmijëve. Vetëm kur është e domosdoshme t'u tërheqim vëmendjen, të sillemi me takt e t'i bindim se si duhet të veprojnë. Fëmijët, natyrisht, duhen këshilluar, por nuk u duhet ndenjtur vazhdimisht mbi kokë dhe t'u pritët çdo iniciativë. Natyrisht, t'i ruajmë se mos ftohen, t'i ruajmë edhe nga rreziqet, por edhe t'i kalitim.

Këto probleme me rëndësi të madhe, që kanë të bëjnë me edukimin e brezit të ri, së ardhmes së atdheut, t'ua themi njerëzve tanë. Ne u flasim vazhdimisht atyre

sidomos për çështje ekonomike, politike e probleme të tjera që janë shumë të rëndësishme, por, mua më duket se për kujdesin që duhet treguar për rininë, një edukatë të veçantë atyre nuk ua japim në kohën e duhur. U flasim vetëm në raste të veçanta kur ka ndodhur diçka e jashtëzakonshme dhe detyrohemi të mbledhim organizatën e Frontit, ku i themi prindit që fëmija jote ka marrë rrugë të keqe, mirëpo në këtë kohë e ka marrë ferra uratën. Ne duhet të punojmë me kohë që t'i edukojmë njerëzit tanë të kujdesen për fëmijët që këta të ecin në rrugë të drejtë, të respektojnë prindërit, mësuesit, të moshuarit, të duan organizatën e rinisë dhe të pionierit. Të mësohen me rregullat e organizatës, të jenë të kujdesshëm në zbatimin e këshillave që u jepen; të lexojnë shtypin, bile këtë t'ua lexojnë edhe prindërve; të marrin pjesë në rrethet që ka Pallati i Pionierëve dhe të bëjnë atje një punë konkrete, praktike etj., etj. Të ndiqet, me një fjalë, nga njerëzit tanë një metodë e shëndoshë pune për edukimin e fëmijëve dhe jo të nisen nga ndjenja sentimentale në punën me ta. Nëna dhe babai dashurinë e tyre për fëmijët ta shprehin me forma të atilla pune që këta ta shohin konkretisht kujdesin që tregohet për ta dhe t'u bëhet kjo një jetë e dytë, të kuptojnë se mëma dhe babai shqetësohen për probleme nga më të ndryshmet. Mbrëmjeve rreth tryezës diskutojnë edhe me fëmijët, dëgjojnë prej tyre, nganjëherë edhe i kritikojnë, por u hapin edhe horizont.

Në këtë drejtim ne kemi mjaft detyra për të kryer. Unë besoj se të tërë jemi dakord me këto probleme që po diskutojmë dhe që Partia duhet t'i ndjekë. Çështjet e Partisë nuk janë çështje të mbyllura, që u takojnë

vetëm disave. Edhe ju, shoqe dhe shokë të ftuar në këtë mbledhje, jeni militantë të Partisë dhe e kuptoni se këtë punë që kemi përpara do ta bëjmë së toku. Kjo është një punë e gjerë e Partisë, e Frontit, e Rinisë, e Gruas, e Bashkimeve Profesionale, e të gjitha organizatave të masave. Këto organizata të forcojnë lidhjet dhe bashkëpunimin me njëra-tjetrën.

Të gjitha këto që u thanë këtu të konkretizohen në bazë se orientimi i Partisë është ndërtimi i njeriut tonë të ri me moral dhe me sjellje proletare etj., etj. Atëherë kërkohet që të gjitha këto organizata të jenë të bashkuara dhe të bashkëpunojnë për problemet e përbashkëta. Secila ka specifikën e saj, por punët e tyre janë edhe të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Sigurisht, organizata e rinisë ka përgjegjësi kur punëtorët me moshë të re, anëtarë të kësaj organizate thyejnë disiplinën shkencore ose disiplinën e punës, por për këtë indisiplinim kanë përgjegjësi edhe bashkimet profesionale etj. Kur shikoni, fjala vjen, që djali i komshiut, i shokut etj., vazhdimisht thyen disiplinën duhet të mos rrini indiferentë. Kjo do të thotë të bëhet një punë e gjithanshme nga organizatat e masave, por edhe nga prindërit. Kjo kërkon të dimë t'i organizojmë ato. Unë nuk them se nuk punohet, ndryshe nuk do të ishin arritur gjithë këto suksese, por vazhdimisht bëjmë kritika për të ecur përpara, se pozitivja është karakteristika jonë më dalluese. Të luftojmë të metat jo vetëm me masa administrative, por të bëjmë punë këmbëngulëse dhe me durim në këtë drejtim që t'u dalim përpara të metave, t'i zgjidhin problemet me kohë. Juve nuk ju mungon eksperiencia në këtë drejtim.

Ju urojmë suksese në punë. Partinë do ta keni kurdoherë pranë dhe, kur të keni ndonjë nevojë, të vini të kërkonte ndihmë.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha,
«Për rininë» (Përmbledhje
veprash), vëll. II, f. 495*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për rininë»
(Përmbledhje veprash), vëll.
II, f. 495*

TË NJOHIM MË MIRË PËRMBAJTJEN DHE TEKNOLOGJINË E MINERALIT

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

9 maj 1978

Duke u bazuar në ato që kam lexuar për metalurgjinë, mendoj se zgjidhja e problemeve të saj nuk u takon dhe nuk mund të bëhet vetëm nga specialistët e mekanikës. Nuk e kam fjalën te projektimet, ndërtimet, montimet etj., që, natyrisht, kanë rëndësinë e tyre dhe bëhen në funksion të teknologjisë së shfrytëzimit të mineralit, po për vetë metalurgjinë. Kjo është një fushë e gjerë me probleme të vështira dhe këtë ne duhet ta kemi parasysh, që të nxjerrim dhe të specializojmë kuadro të aftë, për të bërë jo vetëm një skemë të ngushtë e të komplikuar, si ajo që na u paraqit, por që edhe të trajtojnë e të zgjidhin me kompetencë problemet e saj.

Problemet e metalurgjisë janë të vështira, por jo të pazgjidhshme. Të marrim, për shembull, problemin e heqjes së kromit nga çeliku, që e diskutuam me shokët e metalurgjisë atë ditë që erdhën në Byronë Poli-

tike¹. Ky nuk është një problem i parealizueshëm dhe në fakt te ne është arritur heqja e kromit në njëfarë përqindjeje, por tani na thuhet se nga çeliku ynë duhet hequr më tepër krom, sepse me këtë përqindje ai është i thyeshëm. Domethënë, për të prodhuar atë lloj çeliku, që do të jetë me cilësi më të mirë, duhet që sasia e kromit në të të zbresë më tej deri në përqindje të caktuar. Kjo është e drejtë. Ka një teknologji të veçantë që të orienton se çeliku duhet të ketë në vetvete një përqindje më të madhe ose më të vogël kromi, gjë që përcaktohet sipas llojit të çelikut.

Shokët e Kombinatit Metalurgjik e paraqesin këtë problem si të parealizueshëm për arsye se janë orientuar vetëm në një skemë, për të cilën ne shqiptarët, kur na thanë kinezët se do ta realizojmë, u hodhëm në qiell nga gëzimi. Menduam se do të zgjidhej një problem kolosal për ne dhe, në fakt, kështu është. Të arrijmë të kishim metalurgjinë tonë, ishte me të vërtetë një gjë madhështore dhe këtë nuk mund ta mohojmë, prandaj u gëzuam pa masë. Për realizimin e kësaj veprë kinezët morën përsipër disa detyra, të cilat patën evolucion. Në fillim këto detyra mund t'i shërbenin zgjidhjes së problemeve, prandaj nga ana jonë mund të shpresohet për një zhvillim të mëtejshëm të teknolo-

1. Është fjala për mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të 26 prillit 1978, e cila diskutoi edhe rreth raportit të paraqitur nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave «Mbi disa rezultate paraprake tekniko-ekonomike financiare të vënies në shfrytëzim të veprave të reja në sektorët e industrisë metalurgjike e asaj kimike dhe të përpunimit të naftës dhe mundësitë për zgjerimin e degëve dhe të llojeve të reja të prodhimit».

gjisë, domethënë, të nxirrnim, si i thonë fjalës, nga një vezë 120 pula. Kurse tani, me situatat që na krijuan, kinezët jo vetëm nuk avancojnë në zgjidhjen e problemeve, por përpiqen të na pengojnë. Ata na kanë dhënë neve një skemë, sipas së cilës mund të arrijmë në 0,5 apo 0,6 për qind krom në çelik, por dhe 0,6 për qind është shumë. Sigurisht, tani kinezët nuk heqin dorë nga kjo dhe thonë: «Ne s'dimë më tepër», prandaj specialistët tanë, duke ditur se për këtë ka një teknologji të veçantë, një shkencë të tërë, të njohur, duhet ta mësojnë atë. Asgjë nuk është e pamundur të bëhet. Unë, natyrisht, nuk e njoh si specialist fushën e metalurgjisë, por, nga sa kam studiuar për këtë problem, del se kjo është një shkencë e tërë me rëndësi të madhe që duhet njohur mirë. Nuk mund të ketë metalurgji e siderurgji pa njohur mirë të gjitha të fshehtat e metaleve, të nxehtësisë, të aliazheve e të kombinimeve, pa njohur mirë përbërjen e mineralit etj., etj.

Sovjetikët, çekët, hungarezët dhe kinezët na kanë thënë për hekurin tonë që është i pastër, që përmban nikel dhe kobalt. Të supozojmë se të tërë këta na kanë thënë gjysmën e së vërtetës, duke menduar se na kanë gënjyer edhe për problemet gjeologjike të mineraleve, të naftës etj. Atëherë ne vetë duhet të bëjmë më shumë përpjekje që të vërtetojmë sa janë të sakta thëniet e tyre. Duke lexuar literaturë për specifikat e mineraleve, mua më lind dyshimi se në hekurin tonë, veç kromit dhe nikelit, mund të ketë edhe minerale të tjera që thuhet se i përmban ky mineral. Ndoshta hekuri ynë nuk përmban gjë tjetër veç kromit dhe nikelit; por a e kemi vërtetuar ne këtë me analiza kimike të thella?

Këto gjer sot ua kemi lënë kryesisht të tjerëve të na i bëjnë dhe nuk kemi bërë sa duhet përpjekje për të ecur më tej nga të dhënat e tyre. Kjo ndodh edhe sepse nuk i kemi nxitur sa duhet specialistët tanë që të ecin përpara, duke u krijuar mundësi për t'u kualifikuar e duke u kërkuar pastaj llogari për zgjidhjen e këtij apo të atij problemi.

Po këtë dyshim unë e kam edhe për kromin. Ne i jemi qepur ujit të Vinjollit për metalurgjinë e ferro-kromit, të dhënave të kinezëve për këtë mineral, dhe s'bëjmë përpjekje për të shkuar më tutje. Kurse mjeku, për shembull, për të arritur në disa konkluzione, me një pikë gjaku bën disa analiza. Kështu dhe për specialistin e metalurgjisë, edhe shumë analiza mund të jenë të nevojshme për t'u bërë, derisa ai të arrijë në konkluzione të sakta shkencore për përbërjen e një minerali.

Mendimi im është që analizat tona për këto çështje të thellohen e të zgjerohen nga njerëzit më kompetentë, të cilët t'i vëmë në krye të punëve, duke u ngarkuar detyra konkrete që duhen realizuar brenda një afati të caktuar. Ne duhet të ndalemi më shumë te përmbajtja e mineralit, tek elementët që ka ai brenda dhe te ndarja e tyre. Kjo ka rëndësi të madhe dhe një gjë e tillë duhet të bëhet medoemos mirë, nga specialistët tanë. Paralelisht me këtë duhet të përgatitim edhe kuadro të rinj të specializuar për metalurgjinë, se kjo ka rëndësi të madhe për ne.

Metalurgjia dhe siderurgjia në vendin tonë janë degë me perspektivë, prandaj duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë nga ana jonë kualifikimit të kuadrove dhe të mos merret kaq lehtë ky problem. Përnga-

titja e kuadrit për metalurgjinë ka rëndësi të madhe. Disa kemi mundësi t'i mësojmë këtu në vend, por disa të tjerë, që duhet të jenë politikisht të ngritur dhe të zgjuar, do t'i dërgojmë edhe jashtë për studime e specializim, se specializimi është i domosdoshëm.

Tani është fjala për tre-katër minerale, metalurgjia dhe siderurgjia e të cilave duhen njohur mirë, por nesër do të na dalë e nevojshme të njohim edhe çështjen e polimetaleve që sot s'e dimë. Na thuhet se minerali ynë është i dobët, për arsye se ka 45 për qind hekur. Jo, nuk është kështu. Në një enciklopedi që kam lexuar thuhet se nga 30 për qind hekur e deri në 60 për qind minerali konsiderohet i pasur. Po kështu na është thënë neve nga specialistët, thonë disa shokë. Të tërë i kemi dëgjuar këto llafe, që minerali i hekurit tonë është i dobët, që ky s'bën etj. Por nuk është ashtu. Kemi dëgjuar të thuhet se çeku e ka hedhur mineralin tonë, sepse është me përqindje të ulët hekuri. Na u prish puna në rast se e ka hedhur! Në qoftë se e ka hedhur ai, nuk e hedhin të tjerët. Në fakt edhe çeku nuk e ka bërë këtë, sepse ai nxjerr dhjamë edhe nga pleshti, siç thotë populli, kurse neve na thotë se e ka hedhur hekurin tonë, sepse na qenka i dobët! Prandaj në këtë çështje të mos ecet duke pasur parasysh skema, por të shkohet përpara me studime të thella për të nxjerrë konkluzione të sakta, të bazuara në të dhëna shkencore.

Çështjet duhet të merren frontalisht, të kërkojmë ku janë mineralet e pazbuluara, të marrim masa për ngritjen e minierave dhe të punojmë për të mësuar njerëzit që të arrijnë të zbulojnë përbërjen e këtyre mineraleve. Pastaj, të gjithë këta inxhinierë mekanikë, tek-

nologë e të tjerë të punojnë, të bëjnë studime, të vrasin mendjen për zgjidhjen e një numri problemesh që do t'u dalin përpara.

Industria jonë e rëndë nuk konsiston vetëm në nxjerrjen e mineralit bruto, por, po të jetë e mundur, edhe në përpunimin e këtij minerali deri në fund. Ne kemi një numër mineralesh që duhet t'i përpunojmë në vend dhe, që të bëhet kjo, duhet të zhvillojmë metalurgjinë dhe siderurgjinë tonë. Te ne, natyrisht, nuk mund të kalohet përnjëherë në forxhimin e mineraleve dhe në krijimin e një industrie të përsosur metalurgjike. Vendi ynë është i vogël dhe mund të mjaftohet edhe me një industri metalurgjike jo shumë të madhe, por sa më të madhe ta bëjmë, aq më mirë do të jetë për ne, sidomos për përpunimin e kromit, të bakrit, të hekur-nikelit, të nikelit silikat etj. Në të ardhmen kjo do të jetë plotësisht e mundur, por ky zhvillim nuk mund të bëhet me pesë ose edhe me dyzet inxhinierë mekanikë. Edhe këta duhen në një kombinat metalurgjik, por çështja e metalurgjisë, e njohjes së përbërjes dhe specifikave të mineraleve, e aliasheve është një nga shkencat më të rëndësishme e më të ndërlikuara. Me rëndësi të veçantë është problemi i impianteve, të cilat kushtojnë, por para se të ngrihen këto, duhet të njohësh mirë mineralet, specifikat, vetitë dhe teknologjinë e tyre, domethënë teknologjinë e përpunimit të mineraleve.

Këto probleme, siç e vura në dukje, nuk janë të panjohura për shkencën sot, por duhet punuar, duhet studiuar që këto të njihen më mirë nga specialistët tanë, se ne duhet dhe mund t'i zgjidhim vetë shumë çështje.

Unë dhashë një mendim, ashtu siç e gjykova, për shtimin e kapacitetit të repartit të petëzimit të mesëm. Specialistët tanë të metalurgjisë hezitojnë, se, me sa duket, janë kapur te skema që na kanë dhënë dikur kinezët për këtë dhe nuk përpqen sa duhet për të ecur më tutje, ndërsa unë ngul këmbë që të shkohet edhe më tej në të gjitha problemet. Përderisa arritëm ta kemi teknologjinë deri në njëfarë pike, po të vrasin më shumë mendjen specialistët tanë, do t'i arrihet qëllimit.

Për t'iu futur më thellë zgjidhjes së problemeve të ndryshme nuk do të thotë të organizosh vetëm mbledhje, megjithëse edhe këto janë të nevojshme. Në Kombinatin Metalurgjik u bë një mbledhje me një grup specialistësh, por si përfundim ç'u arrit prej saj? U tha se me atë bazë mekanike që ka kombinati, mund të bëhet rikonstruksioni dhe prodhimi i pajisjeve të tij. Që në kombinat ka një uzinë mekanike që mund të bëjë shumë gjëra, këtë e dimë, por ne duhet të vrasim mendjen e të gjejmë atë që s'dimë. Për këtë duhet ulur e studiuar seriozisht, duhet vrarë mendja për të gjetur zgjidhjet më të mira e më të arsyeshme.

Uzina mekanike, në radhë të parë të marrë përsipër prodhimin e pajisjeve për kombinatin, pastaj për ndërmarrjet e tjera, me qëllim që të punohet edhe për perspektivën që kërkojmë ne. Të mos nisemi nga fakti se kjo uzinë ka kapacitet të madh dhe ta ngarkojmë që t'i bëjë ajo të tëra ato që na duhen. Jo, nuk duhet vepruar kështu, se ka edhe uzina të tjera mekanike që nuk kanë kapacitet të vogël. Uzina mekanike e kombinatit, e përsëris, duhet të prodhojë kryesisht për kombinatin. Po kështu edhe ndërmarrjet e tjera të pro-

dhojnë më parë për vete dhe kur kanë mundësi, edhe për të tjerët. E them këtë se ndodh që i qepemi vetëm kësaj uzine, duke thënë se është uzinë e madhe, prandaj mund t'i bëjë të tëra. Kjo nuk është e drejtë, nuk duhet të mendohet e të veprohet kështu. Nga kjo uzinë do të kërkohet që ta rritë kapacitetin, se nuk prodhon sa duhet, por ama ministria duhet të ngarkojë me punë edhe uzinat e tjera mekanike.

E theksoj edhe një herë se metalurgjia për atdheun dhe për ekonominë e vendit tonë ka rëndësi shumë të madhe. Në qoftë se mendohet që furnaltën e dytë ta bëjmë vetë, të fillojmë ta bëjmë, pra, së pari, të fillojmë ta projektojmë dhe të nisim që tani nga puna për këtë problem. Në qoftë se kinezët na i japin sipas kontratës pajisjet për repartin e tubave me tegel dhe pa tegel, atëherë mund të bëjmë edhe një furrë tjetër, sepse mineral kemi dhe kështu shkojmë përpara. Prandaj të flasim konkretisht dhe realisht për këtë problem. Në qoftë se kemi forca, puna duhet të fillojë sot që të përfundojë në vitin 1981¹, se një gjë e tillë nuk bëhet me një ditë. Po të presim, do të vijë viti 1985 dhe kjo punë s'do të ketë marrë rrugë, kurse unë mendoj se nuk ka asnjë arsye që të presim.

Problemi i metalurgjisë është një nga problemet më të ndërlikuara dhe më të rëndësishme, sepse industria e rëndë drejton gjithë zhvillimin ekonomik të ven-

1. Në sajë të punës vetëmohuese të punëtorëve e të specialistëve të kombinatit metalurgjik «Çeliku I Partisë», furnalta numër 2 u projektua, u ndërtua me forcat tona dhe u vu në shfrytëzim në muajin shtator 1981.

dit. Për këtë arsye këtij problemi t'i vihet rëndësi e jashtëzakonshme nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe nga Qeveria, të cilat duhet ta shikojnë këtë çështje më gjerë, më thellë dhe me seriozitetin më të madh.

Diçka tjetër që dua të vë në dukje është: E para, shokët që venë në mbledhjet e ndryshme që bëhen në bazë, të cilat mendoj se kanë rëndësi të veçantë, duhet të na sjellin këtu, në këto mbledhjet tona të vogla që bëjmë çdo ditë, përvojën e bazës, se, pa u njohur me të, ka rrezik të shterojmë. Po kështu, edhe kur shkoni në mbledhje të tjera, ku merren në diskutim probleme të rëndësishme nga organet kompetente, ne duhet të informohemi nga ju se ç'bëhet në to. Kjo që po them të kuptohet drejt. Këtu nuk është fjala se ne duam të kontrollojmë ç'bëhet atje, por dëshirojmë të dimë si u diskutua dhe çfarë vendimesh u morën për ato probleme që Qeveria na ka vënë në dijeni dhe për të cilat ne mund të kemi bërë edhe vërejtje. Pra, të dimë fatin e vendimeve që merren sepse në mbledhjen e Qeverisë diskutohen probleme e merren vazhdimisht edhe vendime.

E dyta, kurrë të mos mendojmë ne që metoda dhe stili i punës sonë këtu, në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, janë të përsosur. Jo, asnjëherë nuk duhet menduar në këtë mënyrë. Ne kemi nevojë të njohim dhe stilin dhe metodën e punës të të tjerëve. Natyrisht, të tërë nuk mund të asistojmë në mbledhjen e Qeverisë, por atje herë vete njëri e herë një shok tjetër, sipas problemeve që shqyrtohen, por këtu ama, duhet të na thuhet se ç'u diskutua e ç'u vendos që,

për këtë problem, për shembull, çështja u trajtua në këtë mënyrë; unë shikoj në të një diçka të re, pozitive, prandaj propozoj që këtë eksperiencë ta përhapim.

E treta, ne dimë që ka edhe suksese, ka edhe realizime të mira, ka disiplinë, ka edhe organizim të mirë, por ka edhe të meta, mungesë organizimi e mungesë discipline. Mirëpo, ç'qëndrim mbajnë shokët ministra e zëvendëskryeministra përpara këtyre problemeve që diskutohen në Qeveri, në forumin më të lartë të drejtimit administrativ dhe ekonomik të vendit? A qëndrojnë në pozita luftarake, kritike dhe autokritike? Të gjitha këto probleme, pra, nuk janë të thjeshta, ato bile janë të koklavitura. Ka dhe mungesa, ka dhe përparime, me të cilat duhet të njihemi që të nxjerrim mësimë për punën tonë.

Prandaj mendoj se një raportim i tillë, ose një vënie në korent nga ana e shokëve që marrin pjesë në të tilla mbledhje, është e domosdoshme për ne këtu. Përveç kësaj, një gjë e tillë duhet bërë edhe sepse problemet që shtrohen në Qeveri nuk janë vetëm thjesht ekonomike. Ato, në të njëjtën kohë janë edhe probleme politike, ideologjike, organizative, probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e normave të Partisë. Kështu që kur njëri apo tjetri do të na vërë në dijeni për zhvillimin e mbledhjes, atëherë ne këtu do të diskutojmë dhe do të dalim me konkluzione për punën tonë. Pra, të mos flasim në përgjithësi, por konkretisht, se, për shembull, në mbledhjen e Qeverisë u pa çështja e arsimit, e kinematografisë etj., etj., dhe nga analiza që u bë, doli se duhet punuar më shumë nga Partia në këtë

apo në atë drejtim. Ose Qeveria shqyrtoi këtë apo atë problem lidhur me detyrat e planit dhe u vunë re dobësi, prandaj duhen marrë masa; se në këtë ministri e në atë ndërmarrje nuk ekziston ajo frymë e lartë revolucionare që karakterizon ministrinë e ndërmarrjet e tjera. Diçka ka këtu, që nuk ecën puna etj., etj.

Vajtja në këto mbledhje, më duket mua, ka një rëndësi të madhe. As qenia juaj atje, por as edhe raportimi këtu nuk janë formalë. Kam mendimin se një gjë e tillë është e domosdoshme të bëhet. Natyrisht, këtë e them në përgjithësi.

Botuar për herë të parë me shkurtime në librin: Enver Hoxha, «Për shkencën» (Përmbledhje vep-rash), vëll. II, f. 157

Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP

Ç'TREGOJNË DISA DOKUMENTE PËR MAO CE DUNIN

Shënime

10 maj 1978

Për të përcaktuar më mirë ç'kam shkruar në Ditarin Politik për Çështje Ndërkombëtare, u hodha një sy disa shënimeve që janë mbajtur nga shokët tanë, kur janë takuar me Mao Ce Dunin. Po shënoj këtu disa fakte në lidhje me këto biseda dhe me ngjarje të tjera në Kinë.

Në radhë të parë, dy shokë shqiptarë, Vangjel Moisiu dhe Myfit Mushi, në qoftë se nuk gabohem, i pari kuadër në aparatën e Komitetit Qendror të PPSH, dhe i dyti përkthyes, që kishin shkuar në Kinë, kaluan nga Shanghai dhe, më 16 gusht 1967, pa kërkuar fare, u çuan të takohen me Maon. Ky i priti dhe bisedoi me ta një orë e gjysmë. Përkthyes ishte «i famshmi» Fan, i cili tash është këshilltar në ambasadën kineze në Tiranë dhe është bërë një nga armiqtë e betuar të Partisë së Punës të Shqipërisë, kurse në atë kohë ishte pasues i Revolucionit Kulturor dhe bile nga më të zellshmit.

Ç'u tha konkretisht Mao Ce Duni dy miqve shqiptarë? Ai u tha se «aktualisht ne jemi në revolucion dhe

ky revolucion ishte i domosdoshëm të bëhej. Ne kemi menduar dhe i kemi thënë shokut Hysni dhe një shoku tjetër që ishte në delegacion, se ky Revolucion Kulturor do të mbarojë brenda tre muajve, por u gabuam, sepse ky revolucion mund të vazhdojë edhe tre vjet akoma, për arsye se ekziston një armiqësi e thellë në Kinë dhe, që të spastrohet kjo armiqësi, duhet të bëhet një rrëmujë e madhe. Jashtë, — vazhdoi Maoja, — kanë frikë nga rrëmujja, kurse ne nuk kemi frikë» dhe u shpjegoi atyre që «ky Revolucion i Madh Kulturor bëhet nga hunveibinët, prandaj quhet «revolucion i hunveibinëve». Hunveibinët janë «gardistët e kuq», por veç tyre janë edhe të revoltuarit, me të cilët shumë herë hunveibinët nuk bien dakord dhe të dyja palët bëjnë sipas kokës së tyre». Këto janë fjalët e Maos. «Ne duhet t'i spastrojmë të gjithë njerëzit e këqij, — vazhdoi ai më tutje, — të cilët, ndahen në tri kategori: të këqijtë, të këqijtë e mesëm dhe të pafajshmit». Se ç'do të bënte me të këqijtë, Maoja nuk tha gjë; për të këqijtë e mesëm theksoi se duhet t'i edukojmë, kurse të pafajshmit duhet t'i vëmë në vendet e tyre. Kështu, spastrimi me këtë ka mbaruar, pas tij vjen organizimi dhe pastaj qetësia.

Maoja u foli shokëve tanë veçanërisht për Çen Jinë. Ai u tha se «Çen Jia është reaksionar dhe duhet të pushohet si ministër i Jashtëm, por hëpërhë nuk e pushojmë, se nuk kemi me cilin ta zëvendësojmë». Në këtë kohë Mao Ce Duni pyeti përkthyesin Fan: «Po ti, je me Çen Jinë apo jo?». «Jo, — iu përgjigj Fani, — unë jam kundër, bile e kam kritikuar» dhe i tregoi Maos: «Ne u mblodhëm në sallën e Asamblesë Popullore, ku ishin

me mijëra veta. Çen Jia doli dhe bëri autokritikë përpara gjithë popullit. Atje ishin edhe Çu En Lai, Lin Biaoja, Çian Çini e të tjerë. Çen Jia u përkul tri herë. Kur u përkul herën e parë, tha: «Shoku Mao Ce Dun, unë kam gabuar dhe kam tradhtuar», pastaj, kur u përkul të dytën herë përpara Çu En Lait, i tha këtij: «Shoku Çu En Lai, unë kam bërë gabime dhe kam tradhtuar». Të tretën herë u përkul dhe u tha shokëve të Revolucionit Kulturor: «Unë kam bërë gabime dhe kam tradhtuar». Mao Ce Duni porositi Fanin t'ua shpjegonte këtë shokëve tanë duke i pyetur: «E dini ju këtë?»

— Jo, nuk e dimë! — u përgjigjën shokët tanë.

«Atëherë duhet ta dini që Çen Jia ka tradhtuar, që Ho Luni ka tradhtuar, që Liu Shao Çia ka tradhtuar dhe Pen Çeni, gjithashtu, ka tradhtuar. Liu Shao Çia, — vazhdoi Maoja, — që më 1934 ka qenë një agjent i Guomindanit, ka nxjerrë nga burgu njerëz (dhe numëroi një varg emrash, të cilët kishin zënë poste të rëndësishme dhe ishin deri në Komitetin Qendror e në drejtimin e organizatave të partisë në qendër e në provinca), në mes të të cilëve Lo Zhui Çinin, Ho Lunin e të tjerë e të tjerë. Po këta i dini ju?» pyeti prapë Maoja.

— Jo, nuk i dimë! — iu përgjigjën shokët tanë, — se ne dimë vetëm ç'thotë «Zhenminzhibao».

Mao Ce Duni u tha se ««Zhenminzhibao» nuk i shkruan këto gjëra, por ju duhet të lexoni gazetat e hunveibinëve, sepse ata i kanë zbuluar këto, duke lexuar gazetat e asaj kohe. Pra, Liu Shao Çia dhe gjithë ata persona, që kanë qenë të lidhur me armikun, qenë rehabilituar dhe kishin zënë postet e tyre të vjetra».

Ai u tha po ashtu se këta njerëz dhe shumë të

tjerë kishin zënë pozita të forta në distrikte. «Ne, — u tha Maoja, — kemi 270 distrikte e secili nga këta ka komandën e vet ushtarake, pra komandojnë ushtarakët. Në drejtim, — vazhdoi ai, — ka shumë ushtarakë, prandaj këta ne duhet t'i fitojmë njerin pas tjetrit, se në ushtri ka vërtet njerëz të mirë, po ka edhe njerëz të këqij. Ushtria luan një rol të rëndësishëm, prandaj ne duhet ta bëjmë atë me vete».

Maoja vazhdoi t'u thoshte shokëve tanë se «në Kinë është vendosur revizionizmi modern. Këtë unë nuk e kisha parë, por e pashë më pas, prandaj kam ngritur tash në këmbë hunveibinët që janë një masë e gjerë demokratike për të shtypur revizionizmin modern, për të mos e lejuar këtë të përhapet dhe për ta spastruar, por për këtë na duhen tre vjet».

Maoja nuk mungoi t'u thoshte shokëve tanë, që kishin shkuar për të ndihmuar në përkthimin e civateve të tij edhe në gjuhën shqipe, se «këto civate nuk janë ndonjë gjëkafshë». Modesti e Maos! «Unë kam thënë shumë herë, — vazhdoi ai, — që të botohen civate e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, po këtë nuk ka kush e bën».

Me fjalë të tjera, Mao Ce Duni përpara shokëve tanë pranoi se në Kinë kishte hedhur rrënjë të thella me kohë revizionizmi modern dhe gjoja për ta zhdukur atë (por që në fakt ai ishte i prirë vetëm sa për të zhdukur klanin e Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit, të Pen Çenit, të Ho Lunit e të tjerë, që përmenden në këtë dokument) shpërtheu Revolucionin Kulturor me studentët dhe me nxënësit e shkollave. Maoja veproi kështu pse nuk i kishte mbetur gjë tjetër, se partinë s'e kishte

në dorë, organizatat e masave nuk i kishte në dorë, edhe ushtrinë nuk e kishte të tërë plotësisht në duart e tij, për arsye që kam thënë në shënime të tjera. Ushtria kineze, e dalë nga lufta, ruante ato karakteristika të vjetra të «zotërve të luftës» dhe udhëheqësi kryesor ushtarak në provinca e në distrikte ishte si mbret. Ky kishte atje njerëzit e tij, bënte siç mendonte; në qoftë se i pëlqenin urdhrat e Pekinit, i zbatonte, në qoftë se nuk i pëlqenin, nuk i zbatonte. Me një fjalë, çdo komandë ushtarake në provinca ishte një mbretëri më vete dhe këtë e vërteton Maoja me gojën e tij.

Thëniet e Maos tregojnë se në Kinë jo vetëm që ishte vendosur revizionizmi, por ato vërtetojnë çka kam konkluduar në Ditarin Politik, që marksizëm-leninizmi atje nuk mësohej. Maoja gjoja kishte ngulur këmbë për të shtypur veprat ose citatet e katër klasikëve, po këto nuk kishte kush t'i bënte! Kjo do të thotë se atje askush nuk ishte në rrugën marksiste-leniniste që të mund të botonte veprat ose citatet e udhëheqësve tanë të mëdhenj.

Edhe modestia e Maos, për sa u përket citateve të tij, është pa baza, se, po të ishte kështu, ai mund të jepte urdhër që të botoheshin më parë citatet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, pastaj të vetat. Por çështja qëndron që citatet e klasikëve s'kishin vend në Kinë, kurse citatet e Maos duhej të udhëhiqnin ecjen gjoja drejt socializmit.

Maoja u pohoï shokëve tanë se nga çlirimi e deri në kohën kur po fliste «ne kemi ruajtur të gjithë kapitalistët». Ruajtjen e kapitalistëve, dhënien e të drejtave politike, ideologjike dhe ekonomike atyre, unë e kam

trajtuar më parë. Tash këtë e pohon edhe vetë Maoja. «Kemi ruajtur, — pohon ai, — gjithë inteligjencien e vjetër borgjeze, sepse nuk kemi kush na shkruan një libër, kush na shkruan një dramë, nuk kemi profesorë dhe pedagogë të rinj, prandaj i kemi mbajtur pedagogët e vjetër në të gjitha shkollat dhe universitetet. Për këto arsye, në çdo punë në Kinë ekziston stili i vjetër. Edhe unë jam një njeri i vjetër, edhe stili im është i vjetër, edhe vjershat e mia janë vjersha të vjetra». Në këtë mënyrë Mao Ce Duni identifikon veten e tij me ruajtjen e kapitalistëve dhe të pedagogëve borgjezë.

Pra, që nga viti 1949, kur u çlirua Kina, dhe deri më 1967, domethënë pas 18 vjetëve, iu kujtua Mao Ce Dunit se Kina drejtohej nga kapitalistët, se struktura e vendit ishte në rrugën kapitaliste dhe drejtohej nga kapitalistët; po ashtu edhe superstruktura drejtohej nga elementët e borgjezisë dhe nga kapitalistë. Kështu, sipas Maos, Revolucioni Kulturor do ta bënte këtë spas-trim brenda tre muajve, «por u gabuani, — tha ai, — prandaj ky do të vazhdojë tre vjet». Në fakt ky «revolucion» vazhdoi shumë vjet dhe s'u bë gjë tjetër veçse kjo që rezulton aktualisht: gjithë kundërrevolucionarët, reaksionarët e kapitalistët, në sajë të Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të klikave të tyre, erdhën përsëri në fuqi në Kinë.

Në këtë bisedë të Maos me shokët tanë ndodhej edhe Jao Ven Juani. Kjo do të thoshte se Jao Ven Juani ishte njeriu i besuar i Mao Ce Dunit, bile ai bëri një ndërhyrje gjatë fjalës së Maos dhe tha që në Shangai ka deri në 9 për qind elementë që duhen spastruar.

Shënimet e kësaj bisede ndodhen të plota në arkhivin e Komitetit Qendror.

Fill pas takimit me Mao Ce Dunin në Shangai, të dy shokët u kthyen në Pekin, ku morën kontakt me Kan Shenin. Ky u habit kur mësoi se këta qenë takuar me Mao Ce Dunin dhe iu lut që t'i tregonin mbi përmbajtjen e bisedës që kishin bërë, për arsye se nuk e dinin ku ishte Maoja dhe nuk mund të merrnin kontakt me të. Shokët tanë u habitën nga një gjë e tillë dhe i treguan Kan Shenit thelbin e bisedës. Ky i falënderoi dhe u tha se «Mao Ce Dunin e kemi vënë në një vend që të mos e dijë kurrkush; ai ka lidhje vetëm me një ose me dy shokë, për arsye se mund t'i hedhin ndonjë bombë sovjetikët dhe të na e likuidojnë». E tërë kjo, pra, ka ngjarë më 16 gusht 1967.

Më 8 korrik 1966 Maoja i shkruan një letër Çian Çinit, përmbajtjen e së cilës e kam shtjelluar në Ditarin Politik¹ dhe nuk është nevoja ta përsëris këtu, vetëm se po përmend edhe një herë datën e letrës, që është shkruar më 8 korrik 1966. Edhe në këtë kohë Mao Ce Duni ka qenë i izoluar në Çansha. Atje ai ka ndenjur 10 ditë në një shpellë, krejt i izoluar, pa lajme. Lajme i kishte dërguar vetëm Çian Çini, së cilës ai i ishte përgjigjur me letër.

Më 13 shkurt 1971 u lajmërua vrasja e Lin Biaos në ato versione që kam trajtuar diku në këtë Ditar.

Kurse, sipas agjencive të lajmeve, Bob Haldeman, ndihmës i Niksonit, ka dhënë njoftim se më 1969 sovjetikët i kishin propozuar presidentit amerikan që së

1. Shih: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. 2, f. 48.

bashku të sulmonin Kinën dhe veçanërisht të bombardonin qendrën atomike kineze në Sinkiang. Presidenti Nikson gjoja nuk e kishte pranuar këtë propozim të sovjetikëve dhe më vonë, kur Bobi e deklaroi këtë në një artikull e në një intervistë dhënë televizionit, Kisingeri tha se nuk i kujtohej një gjë e tillë, domethënë ai as e mohoi, as e pohoi. Ky propozim nga sovjetikët, siç thashë, është bërë në vitin 1969.

Në maj 1973 ne kemi marrë nga Pekini një radiogram që na bën të ditur se më 16 prill 1973 Çu En Lai, i shoqëruar nga një nëpunës anglez dhe një amerikan që punonin për televizionin dhe radion kineze, kishte mbledhur gjithë specialistët e huaj të këtyre dy sektorëve të propagandës kineze, domethënë folësit e përkthyesit e gjuhëve të huaja, të cilëve u mbajti një fjalim, duke u thënë se «qëndrimet e kinezëve në kohën e Lin Biaos kanë qenë shumë të gabuara dhe të egra ndaj funksionarëve të huaj, që punonin në radiotelevizionin kinez». Ai u kërkoi ndjesë për çdo gjë që ishte bërë kundër tyre, për pakënaqësitë që u ishin shkaktuar, bile edhe për masat që qenë marrë kundër tyre. Çu En Lai u tha, gjithashtu, se u fliste në emër të Mao Ce Dunit, duke u vënë përpara citatin e Maos, sipas të cilit të huajt duhet të bashkohen me popullin kinez, të njihen me të, bile janë të lirë edhe të martohen me vajza kineze; ose edhe vajza të huaja mund të martohen me burra kinezë.

Po në këtë datë Çu En Lai i lajmëroi ata që asistonin në këtë mbledhje (të gjithë ishin të huaj), se «do t'ju lexojmë disa dokumente, të cilat vetëm sa do t'i dëgjoni dhe nuk do të mbani asnjë shënim, nuk do të

regjistroni gjë». Kështu, ai u lexoi letrën që Mao Ce Duni i shkruante Çian Çinit më 8 korrik 1966 dhe që e përmenda më sipër. Siç duket, këtë letër Çu En Lai dhe Çian Çini e kanë përdorur për të treguar se Maoja gjoja fliste kundër Lin Biaos, sepse ky kishte shkruar një artikull, ku shpjegonte se ç'është grushti i shtetit, dhe këtë e kishte shkruar aq bukur, thoshte Maoja, sa që s'kishte parë kurrë një artikull të tillë, por përmbajtja e artikullit e shqetësonte. Ai në këtë letër i jepte, gjithashtu, edhe disa këshilla të tjera Çian Çinit, për të cilat unë kam shkruar më parë në këtë Ditar.

Le të bëjmë tash një rikapitulacion. Më 8 korrik 1966, Maoja, i fshehur në një shpellë, i shkruan letër Çian Çinit. Më 1969 sovjetikët gjoja i propozojnë presidentit amerikan që të bashkohen të dy shtetet për të sulmuar Kinën dhe qendrën e saj atomike të Sinkiangut. Më 13 shkurt të vitit 1971 shpallet vrasja e Lin Biaos. Natyrisht, kur është vrarë ekzaktësisht Lin Biaoja, këtë e dinë kinezët që nuk e kanë thënë, prandaj nuk dihet se kur ka ndodhur, por në këtë datë është njoftuar zyrtarisht kjo vrasje.

16 prilli i vitit 1973 është data e bisedës së Çu En Lait me punonjësit e huaj të radiotelevizionit kinez. Nga të gjitha këto mund të konkludojmë se në Kinë pas çlirimit nuk ka ekzistuar një pushtet i afirmuar i diktaturës së proletariatit, as një pushtet i afirmuar i një demokracie përparimtare, por një pushtet kaotik, ku në të gjitha instancat, në superstrukturë dhe në strukturë, ndodheshin kapitalistët, fshatarët e pasur, çifligarët dhe inteligjencia e vjetër. Në këtë çështje kanë pasur akord të plotë në pikëpamjet politike, filozof-

fike dhe në veprimet praktike Liu, Maoja, Çuja, Teni, Peni, iksi dhe ipsiloni.

Në një moment, pas gjithë peripecive lidhur me vdekjen e Stalinit dhe më vonë, Mao Ce Duni konstatoi se fraksioni i Liu Shao Çisë po bëhej i rrezikshëm dhe kërkonte ta rrëzonte Maon. Në Kinë vazhdimisht kanë ekzistuar fraksionet e klanet dhe secila nga këto përipecqej të kishte fuqinë. Kështu, fuqinë në këtë kohë e kishte marrë Liu. Tash Maoja donte t'ia rimerrte, prandaj dhe u shpërthye Revolucioni Kulturor. Ky revolucion nuk kishte kurrfarë karakteri proletar, ishte, me fjalë të tjera, një grusht shteti i bazuar në autoritetin e Maos dhe në thirrjen që ai u bëri njerëzve të ekzaltuar, që ishin hunvebinët, dhe asaj pjese të ushtrisë, që i besonte Mao Ce Duni dhe tek e cila ky kishte influencë. Dhe Maoja ia arriti qëllimit përkohësisht.

Duket qartë se Mao Ce Duni ishte eliminuar jo pse ishte radikal dhe marksist-leninist, por se ishte kapogrupi, dhe këtë e vërtetojnë letra që ai i drejton Çian Çinit, biseda që ka bërë me shokët tanë në Shangai, mosditja se ku ndodhej Mao Ce Duni nga ana e Kan Shenit, njërit prej udhëheqësve më të mirë të Kinës. Pra, Mao Ce Duni nuk kishte besim tek askush, as te Kan Sheni, pra nuk ishte një marksist-leninist.

Mao Ce Duni, sipas të gjitha këtyre që përmenda dhe fakteve të tjera, ishte për turbullira. Ai ishte për anarki, pse kishte humbur nocionin e një organizimi, qoftë edhe borgjez kapitalist, pale nocionin marksist të diktaturës së proletariatit, që as nuk e mendonte fare. Vrasja e Lin Biaos u bë në kushte shumë misterioze. Me siguri Mao Ce Duni e ka mënjanuar Lin Biaon dhe

Çu En Lai me grupin e tij e kanë ekzekutuar në një formë ose në një formë tjetër.

Gjatë Revolucionit Kulturor, pra, grupi i Mao Ce Dunit mori fuqinë, u krijua një grup tjetër i ri me Çian Çinin, Jao Ven Juanin e të tjerë. Por atje ekzistonin edhe grupi i Çu En Lait, edhe revizionistët e tjerë; ekzistonin edhe grupi i Liu Shao Çisë dhe i Ten Hsiao Pinit. Ky i fundit në Revolucionin Kulturor u përkul, u thye dhe gjoja po riedukohej, por do të dukej përsëri në skenë më vonë, ashtu siç ndodhi.

Këto dalin nga ato pak dokumente që kemi dhe që janë shpjeguar në Ditarin tim.

Me fjalë të tjera, Kina e Mao Ce Dunit dhe populli kinez sundoheshin nëpërmjet klaneve të ndryshme shumë të fuqishme e nëpërmjet shefave të plotfuqishëm në provinca. Kjo Kinë vazhdonte dhe vazhdon të jetojë me apelacione të reja, por me forma organizimi të kohës së mesjetës dhe të dinastive perandorake. Pra, pas revolucionit kundër japonezëve dhe Çan Kai Shisë, në Kinë u krijua një republikë perandorake, perandori i parë i së cilës ishte Mao Ce Duni, që për një kohë Liu Shao Çia me shokë u përpoqën ta rrëzonin.

Pavarësisht se në Japoni ekzistonte perandor Mikadoja, atje u zhvillua një industri e fuqishme; lindën e u rritën shoqëri e koncerne të mëdha industriale, që krijuan një proletariat të madh, varrmihësin e perandorisë dhe të feudalizmit japonez, kurse në Kinë kjo nuk ngjau.

Në luftën nacionalçlirimtare kundër Japonisë dhe kundër Çan Kai Shisë shikojmë po atë organizim të vjetër të perandorisë kineze, e cila u rrëzua, me përja-

shtim të mbretërisë së Mançukuosë, që ishte okupuar nga Japonia. Por administrimi qëndroi gati i njëllajtë si në kohën e perandorisë, kurse në provinca sundonin «zotërit e luftës», ose përfaqësuesit e mëdhenj kapitalistë e latifondistë, të cilët ruanin prerogativa të mëdha dhe ishin gati mbretër në provincat e tyre. Ata as që e pyesnin Pekinin dhe perandoreshën, veçse paguanin taksat.

Në kohën e luftës nacionalçlirimtare në Kinë vazhdoi e njëjta gjendje. Natyrisht, u krijuan zonat e çliaruara, që ishin të okupuara nga Guomindani e Çan Kai Shia, dhe zona të okupuara nga japonezët. U krijuan, po ashtu, armata të ushtrisë nacionalçlirimtare, që gjoja komandoheshin nga Mao Ce Duni. Në fakt, të gjithë udhëheqësit kryesorë, si Lin Biaoja, Pin De Huaja, Çen Jia, Çu Deja, iksi dhe ipsiloni, ishin «zotër të luftës», por jo të njëllajtë me sundimtarët provincialë të kohës së perandorisë, megjithëse në fakt ata komandonin gjithë ushtrinë e provincave ku vepronin. Çdo provincë ishte nën drejtimin e një personi, i cili kishte njerëzit e vet në të gjitha repartet, divizionet, komandat dhe me këta që i kishte të afërmit e tij, vepronte lirisht pa pyetur kërrkënd.

Një organizim i tillë u trashëgua edhe pas çlirimit dhe ne pamë se në gjithë zhvillimin e situatës, që atëherë dhe deri tash, në Kinë sundojnë klane e grupime të shumta. Kjo vërteton atë që thotë Mao Ce Duni, se të gjithë këta nuk e pyesin Pekinin. Ata që drejtonin në provinca ishin të plotfuqishëm dhe në fakt as që pyetnin për qendrën.

Ne shohim kështu që grupi i Çu En Lait kishte

drejtimin e ekonomisë; ai i Pin De Huasë, që u likuidua dhe u zëvendësua nga Lin Biaoja, kishte ushtrinë; Çen Jia kishte politikën e jashtme, kurse Mao Ce Duni qëndronte në majën e piramidës, si lejleku me sqep të verdhë, dhe drejtonte nëpërmjet Zyrës së Përgjithshme. Megjithatë, klanet ekzistonin; edhe kontradiktat në mes gjithë këtyre grupimeve ekzistonin; në provincat, drejtuesit e tyre, që ishin ushtarakë, drejtonin me plot-fuqishmëri.

Është e qartë që grupi i Liu Shao Çisë ishte një grup tjetër i fortë, kurse ai i Ten Hsiao Pinit kishte në dorë partinë dhe influencë të madhe në ushtri. Liu Shao Çia, që kërkonte ta eliminonte Maon, tok me Ten Hsiao Pinin, Çu En Lain dhe grupime të tjera të ndryshme, në një moment të caktuar bënë një koalicion, por këtë ua prishi Maoja, duke u bashkuar me grupe të tjera si me atë të Lin Biaos, me grupin e Çian Çinit, të Çen Po Tasë etj.

Çu En Lait, që nuk ishte në një grup me Ten Hsiao Pinin, iu desh ta zëvendësonte Lin Biaon dhe të rehabilitonte Ten Hsiao Pinin, të cilin e rehabilitoi dhe e vuri pikërisht në ushtri si shef të Shtabit të Përgjithshëm, sepse Teni kishte mbështetjen kryesore në ushtri dhe në parti. Çu En Lai mendoi kështu se do të vazhonte të mbante në dorë ekonominë dhe Ten Hsiao Pini, si aleat i grupit të tij, do ta mbështeste me anë të ushtriës për të likuiduar «katërshen». Mirëpo Çu En Lai vdiq dhe Mao Ce Duni, për të balancuar këto grupime, ngriti «gjilpërën nga kashta», solli Hua Kuo Fenin, e emëroi këtë në vend të Çu En Lait dhe rrëzoi Ten Hsiao Pinin, se po bëhej i rrezikshëm. Mirëpo Hua Kuo Feni

nuk kishte mbështetje sa duhej dhe, për të dominuar katastrofën, u detyrua ta risillte Ten Hsiao Pinin përsëri në krye dhe ta rehabilitonte.

Tash nuk ekziston më një unitet në mes Ten Hsiao Pinit dhe Hua Kuo Fenit. Ky i fundit është më i dobët, nuk ka mbështetje aq të sigurt, kurse Ten Hsiao Pini ka mbështetje më të sigurt në ushtri. Ai ka njëkohësisht mbështetje në administratë dhe në ekonomi. Li Hsien Nieni ëndërron të luajë rolin e Çu En Lait si organizator, si drejtues ekonomik e, mundësisht, si moderator. Por ai nuk është ndonjë «kokë» dhe nuk është në gjendje ta zëvendësojë Çu En Lain. Sidoqoftë, aktualisht, Li Hsien Nieni anon nga Ten Hsiao Pini, grupi i të cilit tani dominon. Do ta mbajë Hua Kuo Fenin Ten Hsiao Pini apo do ta eliminojë, këtë do ta shikojmë më vonë.

E tillë është situata në Kinë. Kështu mund ta ripërcaktojmë ne edhe një herë këtë situatë, që natyrisht, do të bëjë që Kina të shkojë drejt një pushteti kapitalist, imperialist, drejt një diktature personale të një grupi ushtarakësh, me Ten Hsiao Pinin në krye ose me ndonjë tjetër që mund të vijë nesër në fuqi.

E gjithë historia e Kinës është histori e guvernatorëve të plotfuqishëm, e «zotërve të luftës», e mareshalëve dhe e kryetarëve të grupeve, që nga Mao Ce Duni, Liu Shao Çia, Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjerë. Kështu që atje s'ka asgjë marksiste-leniniste, s'ka asgjë socialiste.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 402

ËSHTE E DOMOSDOSHME QË EKONOMIA TË DREJTOHET NË MËNYRË SHKENCORE

Shënime

11 maj 1978

Diskutova sot në lidhje me tregtinë e jashtme. Duke u njohur me disa të dhëna theksova se duhet ngulur këmbë vazhdimisht me shokët e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, si edhe me shokun Qirjako Mihali¹, që marrëdhëniet tona tregtare me botën e jashtme, veçanërisht për eksportin, por edhe për importin, duhet t'i shikojnë të lidhura me situatat, domethënë në prizmin e interesave ekonomikë të vendit tonë dhe në kushtet që janë krijuar aktualisht. Me fjalë të tjera, për zhvillimin e tregtisë së vendit tonë me vende kapitaliste e revizioniste do të hasim edhe vështirësi të ndryshme, por këto ne duhet t'i kapërcejmë. Këto vështirësi vijnë nga presioni i jashtëm kundër nesh, i cili të mos konsiderohet si një slogan, por të zërthehet mirë dhe të punojmë që ta përballojmë. Mundësitë i kemi.

Në radhë të parë, politika dhe ideologjia jonë

1. Në atë kohë, zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSSH.

marksiste-leniniste duhet të jenë si kurdoherë të vendosura, të pamposhtura dhe të paprekshme. Në këto çështje ne nuk do të bëjmë kurrë lëshime. Po bëmë lëshime, atëherë do të na ngjasin të këqija. Prandaj punonjësit e tregtisë së jashtme duhet ta kenë kurdoherë parasysh këtë gjë.

Por importi dhe eksporti kanë edhe anën e tyre ekonomike, e cila, gjithashtu ka rëndësi për ne. Domethënë, ne duhet të eksportojmë sa më shumë mallra, sa më shpejt, me cilësi sa më të mirë dhe me çmime sa më të leverdishme. Por në situatat aktuale, kur është rritur presioni kapitalisto-revizionist, të luftojmë që t'i shesim mallrat tona jo vetëm në tregje të vendosura më parë, por edhe në të reja, që duhet t'i gjejmë. Këtë do ta bëjmë, natyrisht me leverdi, dhe jo siç kishin bërë për hekurin Kiço Ngjela me Abdyl Këllezin, duke favorizuar kontraktues të huaj, për t'u dhënë atyre me çmim të ulët hekur me cilësi të lartë dhe me përqindje të madhe nikeli. Hekur-nikel tani na duhet për metalurgjinë tonë. Edhe në qoftë se duhet të eksportojmë përsëri, të synohet leverdia jonë ekonomike. Kështu duhet menduar e duhet vepruar edhe për mallrat e tjera.

Ministria e Tregtisë së Jashtme të ketë parasysh edhe se me kë bëjmë ne tregti. Të bëjmë edhe diferencim ndërmjet tyre dhe të dimë të përfitojmë nga koniunkturat.

Ne kemi krijuar tregje me vendet e ish-demokracisë popullore. Por ne dimë se Bashkimi Sovjetik dhe vende të ish-demokracisë popullore, duke parë se marrëdhëniet tona politike dhe ekonomike me këtë ose atë

vend janë vështirësuar shumë, kanë thënë: «Të bëjmë përpjekje për ta afruar Shqipërinë; të mos pengojmë tregtinë me të, përkundrazi t'i bëjmë avanca». Me fjalë të tjera, kjo do të thotë: «Të përpiqemi ta ëmbëlsojmë Shqipërinë dhe ta futim nën sjetullën tonë». Kësaj ata nuk do t'ia arrijnë kurrë! Ne këtë e kemi dhe do ta kemi kurdoherë parasysh. Por, nga ana tjetër, nuk ka pse të mos e vazhdojmë traditën tregtare me vende revizioniste, me përjashtim të Bashkimit revizionist Sovjetik, t'u shesim dhe t'u blejmë atyre mallra. Natyrisht çmimet me to duhet t'i diskutojmë: të qëndrojmë në çmimet stop apo në çmimet ndërkombëtare, por e kam fjalën që në marrëdhëniet tregtare të mos jemi sektarë. Tregtia është më jep, të të jap. Ajo duhet të jetë *souple*¹, dhe në këtë çështje, të tillë duhet të jemi edhe ne, prandaj të përpiqemi të bëjmë tregti të zgjuar. Këto situata t'ua shpjegojmë punonjësve të tregtisë së jashtme dhe jo një herë, por vazhdimisht. Në këtë drejtim kërkohet mobilizim i madh i të gjithëve.

Nga të dhënat që po lexoj, pas mbledhjeve të shumta që kanë bërë organizatat-bazë të Partisë për dhënie llogari e zgjedhje të reja, në përgjithësi, konstatohet se nga ana e Partisë dhe e forumeve të saj ka interesim për të gjitha problemet, por e keqja është se këtyre problemeve nuk u shkohet deri në fund dhe nuk organizohet mirë puna për zgjidhjen e tyre. Organizimi i mirë i punës, siç e kam theksuar shumë herë,

1. Frëngjisht — i zhdërvjellët.

qëndron në atë që organizatat-bazë, byrotë dhe komitetet e Partisë të rretheve, së pari, ta njohin si duhet problemin, ta diskutojnë dhe pastaj të marrin masa për zgjidhjen e tij, duke mobilizuar për këtë gjithë punëtorët dhe organet e pushtetit në bazë, në ndërmarrje e në kooperativa. Kjo gjë nuk bëhet sa duhet dhe si duhet. Të marrim, për shembull, problemet ekonomike. Në organizatat-bazë dhe në byrotë e Partisë dolën mjaft të meta në këtë drejtim. Në Ballsh, për shembull, lihen me mijëra metra kub gaz të shkojnë kot. Po pse të lihet të na shkojë dëm kjo lëndë e parë kaq e vlefshme, për të cilën kemi aq shumë nevojë, kur ka mundësi që ajo të grumbullohet me mjetet e brendshme?!

Ose ndodh që nuk respektohen grafikët e ndërtimit, si në Hidrocentralin e Fierzës, në Kombinatin Metalurgjik e në objekte të tjera. Fakt është se këto probleme janë ngritur edhe më parë, por e keqja qëndron në atë që këto nuk zbërthehen siç duhet, nuk organizohet mirë puna për zgjidhjen e tyre deri në fund e, plus këtyre, mungon edhe kontrolli i nevojshëm.

Me këto nuk dua të them se organizatat-bazë të Partisë dhe pushteti nuk interesohen e nuk luftojnë për problemet e rendimentit, të kostos, të rentabilitetit, të fondeve të akumulimit e të konsumit, të normave e të tjera, por jo kudo luftohet me këmbëngulje për të zbatuar si duhet direktivat e Partisë. Ka shumë ndërmarrje ku këto çështje nuk trajtohen veç e veç dhe në unitet, por në mënyrë globale. Ata që merren me të dhënat e prodhimit, nuk i analizojnë këto dhe nuk nxjerrin prej tyre konkluzione, por sillen si teknokratë,

duke e justifikuar këtë qëndrim të tyre si «frymë shtë-tërore». Por një metodë pune të tillë teknokratike as pushteti, as organet e tij nuk e durojnë, sepse edhe këto luftojnë burokratizmin e teknokratizmin. Prandaj çështje të tilla duhet të shihen të lidhura ngushtë me faktorët politikë, ideologjikë e shoqërorë dhe në qoftë se nuk ndiqen me kujdesin më të madh e nëse nuk merren masa të menjëhershme për t'i luftuar atje ku shfaqen, atje ku ka dobësi e ku punët nuk ecin, kjo është me pasoja jo të mira.

Natyrisht, këtu ka edhe presion nga administrata, por çështja është që administratën ta vërë në rrugë Partia. Kjo ta komandojë administratën dhe jo administrata Partinë. Të mos e komandojnë specialistët organizatën-bazë, por organizata-bazë, domethënë komunistët, duke i njohur mirë problemet, t'i drejtojnë e t'u kërkojnë llogari specialistëve, sidomos atyre që tregohen edhe burokratë e teknokratë.

Është e domosdoshme që ekonomia të drejtohet në mënyrë shkencore. Këtë ta kuptojë mirë Partia, ndryshe me këto ndërmarrje kaq të mëdha, me gjithë këto investime, me këto kooperativa bujqësore të tipeve të ndryshme e me sipërfaqe të mëdha toke, pa një organizim të shëndoshë dhe pa një drejtim shkencor të tyre, punët nuk do të na ecin mirë. Drejtimi shkencor i punëve nuk mund të bëhet vetëm nga specialistët. Të tërë duhet të dinë t'i trajtojnë në mënyrë shkencore çështjet, të tërë të mësojnë dhe t'i vihen drejtimit shkencor të ekonomisë, pse atje ku mungon drejtimi shkencor shohim të meta e dobësi të theksuara në ekonomi. Për shembull, ka raste që vihen në plan gjëra që

nuk mund të bëhen, ose hiqen nga plani i importit disa mallra, por nuk merren masa për t'i zëvendësuar ato që nuk vijnë nga jashtë dhe organizata-bazë e Partisë nuk bën përpjekje të ngrihet në nivelin e duhur revolucionar e të marrë masa të menjëhershme kundër këtyre çrregullimeve, bile flagrante, që ekzistojnë. Për shembull, rrethi i Tepelenës ishte planifikuar të furnizonte me dru zjarri atë të Fierit, ndërsa vetë Tepelena drutë i merr nga rrethi i Vlorës. Planifikim është ky? Po Partia në rreth ç'bën në këtë mes?

Për zhvillimin e revolucionit tekniko-shkencor kam përshtypjen se bëhen mjaft gjëra, por të gjitha këto bëhen më tepër në sajë të iniciativës së disa njerëzve të përparuar, sepse, shpeshherë, kur shtrohet kjo çështje në organizatat-bazë, trajtohet në vija të përgjithshme; thuhet fjalë, po nuk studiohen probleme të veçanta që kërkojnë thellim të revolucionit tekniko-shkencor, nuk caktohen afate dhe nuk ngulet këmbë që ato që dalin me sukses të vihen menjëherë në zbatim.

Mendoj se në bazë, për thellimin dhe zgjerimin e revolucionit tekniko-shkencor, nuk është nevoja të bëhen më zbërthime të përgjithshme. Të tilla janë bërë dhe këto i kanë ndihmuar njerëzit për t'i kuptuar detyrat. Tani më shumë nevojitet të bëhen zbërthime konkrete. Në kushtet e tanishme ka rëndësi që secili t'i hyjë mirë punës, të përveshë llërët dhe të studiojë në pika të veçanta ku duhet përmirësuar teknologjia, ku duhet ulur kostoja e të tjera.

Në përgjithësi, në të tërë sektorët e ekonomisë sonë ka sukses, por ka akoma edhe mjaft të meta, të cilat duhen parë me sy serioz e kritik, ndryshe nuk ka

se si të realizohen e të tejkalohen planet, gjë që është e domosdoshme të bëhet.

Natyrisht, ka edhe mungesa organizative, por sa të jetë e mundur për këto mungesa, objektive ose subjektive qofshin, ne duhet të ndalemi dhe të bëjmë përpjekje t'i kapërcejmë me një kuptim të thellë politik dhe me një punë më të madhe, duke derdhur mund e djersë, ndryshe nuk mund t'ia dalim.

Organizata-bazë e Partisë, kudo, duhet të kuptojë mirë se pa një punë të thellë politike dhe ideologjike për edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të masave punonjëse, pa një asimilim të doktrinës sonë, objektivat që i kemi vënë vetes nuk mund të arrihen. Nuk mund të bëhet asgjë duke e shikuar këtë çështje nga ana formale ose globale, ose me një mësim shabllon, pa e lidhur ngushtë këtë edukim ideopolitik me jetën, me faktet, me gjendjen konkrete në fabrikë, në kantier, kudo ku punohet. Kur shihet se nuk realizohen detyrat, kur analizohen të metat, këto duhen trajtuar në prizmin ideologjik e politik. Në qoftë se bëhet kështu, zhduket formalizmi, zhduket mënyra e studimit libresk, i cili vërtet lë diçka në kokën e njerëzve, por duhet një kohë shumë e madhe dhe një praktikë e gjatë që secili të mund të zbatojë në jetë atë që ka mësuar në libër. Në qoftë se ato që shkruhen në libra do t'ua shpjegojmë komunistëve dhe punonjësve të lidhura ngushtë me anën praktike të luftës së Partisë, atëherë edukimi politik dhe ideologjik do të jetë me efekt të madh.

E kemi thënë dhe e themi vazhdimisht se që të ketë efekt puna politike dhe ideologjike duhet të punohet

gju më gju me masat, t'u flitet thjesht njerëzve dhe jo t'u qëndrohet strikt e të merren shabllon orientimet që jep komiteti i Partisë. Ky mund të japë orientime, por komunistët, organizata-bazë, duhet të njohin mirë gjendjen, të bisedojnë si duhet me masat e jo t'u flitet atyre njëjloj si nxënësve në shkollë.

Masat ngrenë shumë probleme. Natyrisht jo të gjithë i mendojnë këto njësoj, prandaj duhen bërë përpjekje për të njohur mentalitetin e njerëzve e bashkë me të edhe problemet që i preokupojnë ata, duke ua bërë të qartë gjithçka me argumente bindëse. Këto çështje duhen shtruar të lidhura ngushtë me politikën dhe me ideologjinë e Partisë. Dhe kjo të bëhet jo në mënyrë formale e shabllone, sepse kështu masat nuk i kuptojnë çështjet, por kur ua vë açik në dukje se cilat janë problemet, përse nuk zgjidhen ato, kush nuk i zgjidh dhe ç'duhet të bëhet, pra, po t'ua shtrosh mirë e konkretisht gjërat, atëherë masat do t'i vlerësojnë, pasi kështu ato njohin edhe më mirë vijën e Partisë. Në këtë mënyrë ne do të kemi tek ato një ndihmës të sigurt, një forcë që të na çojë përpara, që të kërkojë llogari pse nuk u kryen ato që u thanë në mbledhje etj. Pa vepruar në këtë mënyrë, nuk mund t'i kemi masat punonjëse nxitëse të veprimeve tona revolucionare, por do t'i shohim ato si një masë apatike, që vetëm dëgjon disa gjëra që i shtrojmë shumë herë me radhë dhe nuk tregojnë asnjë interesim për to.

Mjaft herë përmenden individë ose brigada të përparuara, por neve na intereson t'u tregojmë masave përse këta njerëz dhe këto brigada janë të përparuara, si e kanë organizuar punën dhe pse i kanë arritur këto

rezultate. Me fjalë të tjera, nuk mjafton që masat të njihen vetëm me njerëz e me brigada të pararojës, por duhet që ato të njohin, sidomos, metodat, format, stilin në punë, mundin dhe djersën që kanë derdhur këta njerëz e këto brigada, me qëllim që ato të mësojnë nga këta elementë të përparuar, të përfitojnë nga kjo eksperiencë e tyre dhe të mobilizohen më mirë që t'i zbatojnë edhe vetë në jetë.

Pavarësisht se gjendja moralo-politike e popullit tonë është e shëndoshë, niveli i propagandës së Partisë për edukimin e masave kurdoherë duhet të ngrihet. T'i vëmë rëndësi të posaçme çështjes që kjo propagandë t'i përgjigjet sa më mirë luftës që i bëjmë në presionit ideologjik të armiqve kapitalistë e revizionistë dhe jo vetëm presionit të jashtëm, por edhe elementëve armiq brenda vendit, të cilët nuk rrinë pa propaganduar, vesh më vesh, kundër rendit tonë ekonomiko-shoqëror.

E kam theksuar edhe herë të tjera se nuk duhen harruar ose nënvleftësuar mbeturinat mikroborgjeze dhe ato fetare në ndërgjegjen e njerëzve tanë, pse armiqtë bëjnë propagandë të madhe në këtë drejtim.

Në vendet revizioniste, si, për shembull, në Jugosllavinë titiste, po i jepet një shtytje e fortë zhvillimit të fesë. Bile në kufirin tonë verilindor, në Kosovë e në Maqedoni, jugosllavët po ngrenë xhami e faltore të reja. Përse i bëjnë ata këto? Së pari, për të mbajtur në errësirë shqiptarët e atjeshëm, por edhe për të mbajtur gjithashtu gjallë e për t'i aktivizuar mbeturinat fetare edhe në këtë anë të kufirit, në anën tonë. Të mos mendojmë se në rrethet e Dibrës e të Kukësit nuk ka njerëz

që besojnë dhe jo vetëm njerëz të moçëm, por edhe ndonjë të ri që ka paragjykime.

Puna për çrrënjosjen e këtyre mbeturinave është një nga aspektet e luftës së klasave. Lufta e klasave duhet të kuptohet në radhë të parë, si një luftë politiko-ideologjike, dhe jo si luftë vetëm kundër vjedhësve e keqbërësve të natyrave të ndryshme, të cilët vepronë në haptazi kundër pushtetit tonë popullor. Nxitja e mërive, e armiqësive, e grindjeve, e zënkave, e shkeljes së normave të moralit proletar (pa harruar nxitjen e ndjenjave dhe praktikave fetare dhe çdo gjë që është pleksur me to), janë veprime që ushqehen nga armiq. Të gjithë këta faktorë keqbërës ne duhet t'i luftojmë pse vetëm kështu do të konsolidojmë edhe më shumë unitetin në radhët e popullit. Duke ua bërë të qarta mirë masave të gjitha këto që përmenda ato do të bëhen të ndërgjegjshme për këtë luftë dhe nuk do të qëndrojnë pasive. Prandaj Partia në rrethe e në bazë asnjëherë të mos harrojë luftën e klasave në të gjitha drejtimet.

Duhet të kuptohet dhe të futet thellë në ndërgjegjen e njerëzve se zbatimi i vijës së Partisë kërkon që organizata-bazë, si një organizatë udhëheqëse, dhe komunistët, si pjesëtarë të kësaj organizate e si militantë të zjarrtë të Partisë në të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë, të luftojnë metodat administrative e shfaqjet formaliste, të largohen nga zyrtarizmi e të tregohen të afërt me popullin, me fjalë të tjera, të jenë popullorë, por pa bërë lëshime, pa qenë oportunistë. Ata duhet të mos lejojnë burokratizmin, jo vetëm në jetën e brendshme të Partisë, por kudo, sepse vetëm atëherë

çdo komunist, në jetë e në veprim, do të jetë me të vërtetë masovik, një njeri që do të dijë ta zbërthejë si duhet vijën e Partisë e të bëjë edhe të tjerët që ta ndjekin atë.

Këtu ndikojnë edhe tematikat e mbledhjet e organizatave-bazë, për të cilat kam shkruar edhe herë të tjera. Prandaj këto të mos jenë të varfra e të mos merren me probleme të vogla, me probleme rutinë e të përsëritura një mijë herë, që nuk i nxitin anëtarët e Partisë të diskutojnë e të japin mendime. Kjo ndodh pasi mjaft herë tema që caktohet për t'u diskutuar në organizatën-bazë rekomandohet nga byroja e organizatës ose nga komiteti i Partisë, ose ndonjë komunist propozon një temë të pamenduar mirë në fund të mbledhjes. Mua më duket se një përcaktim i tillë i temës që do të diskutohet në organizatën-bazë është jo i rregullt. Mbledhja e organizatës-bazë bëhet një herë në muaj dhe unë jam i mendimit që kështu të vazhdojë. Por mund të bëhen edhe dy mbledhje, edhe tri, në qoftë se në to me të vërtetë preken probleme preokupante që kërkojnë zgjidhje, që kërkojnë organizim dhe për të cilat duhet të merren masa. Në këtë mënyrë organizata bëhet me të vërtetë luftarake. Kurse metoda, që përmenda më lart dhe që e kam kritikuar edhe herë të tjera, nuk na e bën organizatën-bazë të Partisë luftarake e mobilizuese.

Çdo komunist, tok me masat që ka rreth e rrotull vetes, duhet të tregojë shkathtësi për zbatimin e detyrave dhe të vendimeve që diskutohen dhe që merren në organizatë. Po nuk u bë kështu, organizata nuk ecën përpara dhe nuk i zgjidh dot problemet. Atëherë

vjen vetvetiu mënyra e drejtimit burokratik, shtetëror, zyrtar, teknokrat. Duhet të kuptohet se pikërisht këtu e ka burimin kjo e keqe në metodën e drejtimit. Përpjekje për ta luftuar këtë të keqe të bëjë gjithë Partia, por veçanërisht në këtë drejtim është e domosdoshme të gjallërohet puna e byrove të Partisë dhe e sekretarëve të tyre në kooperativat bujqësore, sepse ka rrezik që këta të fundit të marrin me të vërtetë pamjen e një funksionari, si me thënë, që vetëm sa merr rrogën, kryen formalisht disa detyra dhe shkundet nga fryma revolucionare, nga ajo lidhje e ngushtë me anëtarët e Partisë dhe me të gjitha masat punonjëse. Ky sekretar funksionar në këtë mënyrë kryen vetëm rolin e një instruktori të komitetit të Partisë dhe mjafton që të jetë në rregull me këtë komitet, dhe nuk ndjek si duhet jetën dhe veprimtarinë e organizatave-bazë. Prandaj në këtë drejtim kërkohet një punë politike me sekretarët funksionarë; herë pas here atyre t'u kërkohet llogari veç e veç dhe të gjithëve së bashku; të bëhen me ta kurse e t'u vihen në dukje edhe të mirat, edhe të metat.

Sekretarët e byrove qofshin funksionarë ose jo të mos mendojnë në asnjë rast se janë zgjedhur që të komandojnë Partinë. Jo, ata nuk mund të qëndrojnë kurrsesi jashtë veprimtarisë e kontrollit të Partisë, jashtë punës së gjithë organizatës, jashtë unitetit të mendimit e të veprimit të jetës së saj. Këta shokë ta kuptojnë mirë se nuk janë ata që e bëjnë diellin dhe shiun, por është roli pararojë i të gjithë komunistëve, i gjithë organizatës-bazë ai që ka rëndësi dhe është vendimtar. Prandaj është e domosdoshme që ata të punojnë

në më mirë me organizatat e Partisë që këto të jenë kurdoherë në pozita revolucionare, të ngrihen në atë nivel që e kërkon Partia dhe të luajnë siç duhet rolin e tyre udhëheqës.

Kuadrot e Partisë, qofshin këta anëtarë të komiteteve të Partisë apo funksionarë në aparatet e tyre, si edhe njerëzit e pushtetit, anëtarët e këshillave popullorë që janë zgjedhur apo dhe nëpunësit e aparateve të tyre, duhet të shkunden nga zyrtarizmi, nga burokratizmi dhe të marrin kontakte sa më të ngushta e sa më të shpeshta me njerëzit e bazës, me masën e punonjësve. Ata të jenë kurdoherë në krye të punëve, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë. Mirëpo nuk ndodh kështu kudo e kurdoherë, sepse shumë nga ata rrinë nëpër zyra e merren me kartëra. Vërtet shkojnë nganjëherë në bazë, por këtë përgjithësisht e bëjnë kalimthi, prandaj nuk shohin gjë. Ata marrin edhe formularët nga baza e i lexojnë, por nuk i studiojnë si duhet nga ana politike dhe ekonomike që të nxjerrin konkluzione dhe, në bazë të tyre të fillojnë menjëherë nga puna për të rregulluar gjendjen atje ku ajo çalon, atje ku mungon disiplina, ku ka ngatërresa e të tjera probleme si këto dhe të marrin masa për t'i zgjidhur ato në vend e me kompetencë. Pra, ata të mos mjaftohen vetëm duke vajtur në bazë e duke konstatuar dobësitë e boshllëqet, por të bëjnë një punë të gjallë, një punë revolucionare në të gjithë sektorët. Vetëm kështu, më duket mua, duhet të veprojnë të gjithë punëtorët e Partisë.

Anëtarët e Partisë të mos presin mbledhjen e organizatës për të vepruar, por qysh gjatë punës, kur vënë re diçka që nuk ecën drejt, kur shohin se ndonjë

shok gabon, duhet të ndërhyjnë pa vonesë. Indiferentizmi është një sëmundje e keqe dhe, në qoftë se komunisti qëndron indiferent, kjo do të thotë se ai nuk është revolucionar. Një revolucionar nuk mund të presë një muaj për të shtruar në mbledhjen e organizatës një tog problemesh që e kanë shqetësuar gjatë gjithë kësaj kohe, por menjëherë, sa të konstatojë se diçka nuk ecën, ai duhet të kërkojë mbledhjen e organizatës, t'u flasë shokëve për këtë problem dhe pastaj organizata të diskutojë e të vendosë. Në qoftë se komunistët e një organizate-bazë të një reparti, për shembull, gjatë një muaji konstatojnë një numër veprimesh të palejueshme, nuk duhet kurrsesi të qëndrojnë indiferentë ndaj tyre dhe t'i lënë për t'i shtruar në mbledhjen e organizatës-bazë, se po të lihen të gjitha për atë mbledhje ato nuk do të shtrohen dot pasi nga njëra anë, edhe sikur të shtrohen, në mbledhje nuk do të ketë aq kohë sa të diskutohen një për një të tëra çështjet që kanë grumbulluar komunistët gjatë muajit dhe, nga ana tjetër, sepse për mbledhjen është caktuar që më parë rendi i ditës, për të cilin ndodh shumë herë që diskutohet në mënyrë formale. Prandaj për problemet e përditshme, që preokupojnë Partinë dhe që u bien në sy komunistëve, këta duhet të interesohen e të veprojnë aktivisht menjëherë e të mos presin mbledhjen e muajit, por të kërkojnë edhe mbledhje tjetër të organizatës.

Në mbledhjen e organizatës-bazë shtrohen çështjet më të rëndësishme, problemet më kryesore, të cilat, po të zbërthehen mirë, atëherë çdo komunist bëhet i qartë dhe kompetent për të vepruar në mënyrë revolucionare

dhe për të ndrequr vetë në punë e në jetë ndonjë gabim që mund të bëjë ai apo shoku i tij. Mirëpo, siç thashë, ka shumë shokë që rrinë indiferentë, gjë që është e pajueshme. Nuk është e rregullt, për shembull, që ka edhe komunistë, që, edhe pse janë shtruar qartë në organizatën-bazë, në aktive, në plenumë e në kongrese partie çështjet e disiplinës proletare në punë, e disiplinës shkencore, e edukimit ideopolitik etj., nuk punojnë për t'i zbatuar këto direktiva në jetën e përditshme, por presin sa të vijë dita e caktuar e leksioneve ose e seminareve për të folur. Që në punë kërkohet disiplinë e rreptë, cilido e ka të qartë. Por komunistët, sidomos, duhet që pa pritur të bëhet mbledhja e organizatës-bazë të veprojnë, të ndërhyjnë praktikisht e t'i pengojnë ata që thyejnë disiplinën dhe që dëmtojnë interesin e përgjithshëm, interesin e socializmit. Kjo nuk do të thotë që në organizatë ai të mos e shtrojë, bile me forcë, një problem të tillë, veçanërisht kur sheh se ky fenomen ekziston dhe merr përpjesëtime të dukshme në qendrën e tij të punës. Në këtë rast problemi është i asaj natyre që e vlen të rishikohet e të diskutohet në organizatën-bazë. Pra, në jetë komunistët duhet të luftojnë çdo ditë e çdo orë në këto drejtime, duke tërhequr rreth vetes masat e duke i bërë ato të ndërgjegjshme se duhet punuar çdo ditë që të ndreqen gabimet e që puna të ecë përpara. Ja, këtij i thonë qëndrim revolucionar. Komunisti nuk mund të shkojë vetëm në betejë, si në luftën me pushkë, ashtu edhe në luftën për ndërtimin e socializmit, por do të shkojë tok me masat. Për veprimet e gabuara të një komunisti apo kundër një «sëmundjeje» që shfaqet në një ndërmarrje,

do të jetë më mirë që të marrin dijeni dhe të veprojnë së toku të gjithë komunistët e punonjësit e ndërmarrjes. Kësaj i thonë punë revolucionare; kësaj i thonë jo vetëm të kuptohet si duhet vija e Partisë, por edhe të zbatohet e të kontrollohet si duhet ajo. Kështu duhet t'i mësojmë ne të gjithë shokët komunistë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në revistën
-Studime politiko-shoqëro-
re-, nr. 2, 1982, f. 7*

*Botohet i plotë, sipas origji-
nalit që gjendet në Arkivin
Qendror të Partisë*

KUADRI TË SHIHET SI QËNDRON NË PUNË DHE NË JETË

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë
të Partisë¹*

19 maj 1978

Jam dakord me raportin, si dhe me diskutimet që u bënë këtu. Në diskutimet e shokëve që morën fjalën pasqyrohen përpjekjet e punonjësve të aparatit të Komitetit Qendror që kanë shkuar nëpër rrethe për të ndihmuar bazën. Me këtë rast, në lidhje me raportin, që më duket i drejtë dhe i studiuar, dua të them edhe unë disa fjalë, pavarësisht se mund të bëj edhe ndonjë përsëritje, prandaj bëni durim t'i parashtroj.

Si duhet të punojnë kuadrot e aparatit të Komitetit Qendror me shokët e rretheve që merren me kuadrin? Nga shembujt që dhatë, del se në përgjithësi, veprohet mirë, por bëhen edhe gabime. Shokëve të rretheve që merren me kuadrin, në radhë të parë, duhet t'u kërko-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Duke përvetësuar gjithnjë e më mirë vijën e Partisë, të luftojmë shfaqjet e liberalizmit e të sektarizmit».

het që të kujdesen për karakteristikat e secilit kuadër si person, pastaj për origjinën e tij, për arsye se, po të mos shikohet në radhë të parë vetë personi, nuk ka pse të merret në studim origjina. Për origjinën është subjekti ai që na shtyn të merremi dhe të dimë, fjala vjen, se xhaxhai ose vëllai ka qenë xhandar, milic etj. Prandaj, para së gjithash, duhet të shikojmë karakteristikën e vetë kuadrit si person.

Pasi të shikojmë mirë personin, t'i vihemi punës për të njohur edhe origjinën e kuadrit. Po çfarë duhet të shikojmë në lidhje me origjinën? Nuk dua të përsëris këtu ato që kanë theksuar Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror se deri në sa breza duhet ta shohim origjinën. Në radhë të parë, duhen parë origjina dhe qëndrimi politik i prindërve. Megjithatë, nuk ekskludohet edhe qëndrimi politik i rrethit familjar. Ky studim, veçanërisht për qëndrimin politik të prindërve, po edhe të rrethit familjar, të mos bëhet në mënyrë të thjeshtë, por të shikohen edhe rrethanat shoqërore dhe politike të kohës kur kanë rrojtur prindërit dhe njerëzit e rrethit familjar të kuadrit. Në qoftë se do të bëhen drejt këto, atëherë arsyetimet për vlerësimin e kuadrit do të jenë objektive.

Për këto arsye punonjësit që merren me problemet e kuadrit, në përgjithësi, duhet të jenë nga rrethi. Për ç'arsye? Sepse ata duhet të njohin politikisht dhe organizativisht historinë e rrethit, bile, sa të jetë e mundur edhe të mëhallës e të çdo familjeje në veçanti; të njohin miqësitë midis njëra-tjetrës, krushqitë, zënkat, mëritë dhe deri te shkaqet e lindjes së tyre.

Pra, puna me kuadrin nuk duhet konsideruar si

diçka e thjeshtë, si një punë mekanike sa për të vënë e për të hequr njërin dhe tjetrin. Ajo, para se të jetë një problem organizativ, është një problem politik, filozofik, shoqëror e ekonomik. Si e tillë, kjo punë nuk mund t'i lihet në dorë vetëm punonjësve të kuadrit. Me këtë problem është e domosdoshme të merret në radhë të parë vetë udhëheqja e Partisë.

Plotësimi i kërkesave që përmenda më sipër ndihmon drejtpërdrejt në njohjen e personit që propozohet për t'u pranuar në Parti ose për vendosjen e tij në një detyrë me përgjegjësi. Njohja e personit e ndihmon Partinë për të bërë një punë individuale të veçantë, si me atë që mendohet të pranohet kandidat për anëtar partie, ashtu edhe me kuadrin që do të caktohet në një detyrë të re, me përgjegjësi; ajo ndihmon, gjithashtu, në vlerësimin sa më të drejtë të gabimeve që mund të bëjë në punë e sipër një kuadër dhe njëkohësisht lehtëson kuptimin më të saktë të motiveve që kanë influencuar tek ai për të mirë ose edhe për të keq.

Me pak fjalë, nëpunësi i ngarkuar me punët e kuadrit, veçanërisht në Parti, por edhe në pushtet, duke njohur mirë situatat e rrethit, lëvizjet shoqërore e historike që kanë ndodhur atje dhe njerëzit që kanë marrë pjesë në këto lëvizje të fshatit, të mëhallës e të tjera, ia bën më të lehtë punën Partisë, kur është rasti të studiohet ose të propozohet një kuadër. Ai nuk duhet të ketë parasysh vetëm anën organizative të problemit, por duhet ta shikojë atë në një prizëm më të gjerë e më të plotë. Një shikim të tillë të kuadrit në shoqëri, në familje etj. duhet ta kenë jo ve-

tëm personat e ngarkuar, po gjithë forumet që vendosin për këtë problem, ndryshe kjo çështje do t'i mbetet për ta zgjidhur disa personave të zyrave të kuadrit, të cilët nuk janë aspak të imunizuar nga subjektivizmi, nga mendimet e cekëta, të paramenduara, nga influencimet, nga puna rutinë dhe joshkencore, nga puna e vdekur e letrave në vend që të ndjekin e të njohin kuadrot në punën e gjallë dhe në jetën revolucionare që zhvillohet në vendin tonë.

Në përgjithësi, politika e Partisë me kuadrin është zbatuar drejt nga njerëzit tanë të ngarkuar me këtë punë, të cilët janë frymëzuar nga normat marksist-leniniste të Partisë. Por ka edhe të meta që në raport janë vënë drejt në dukje.

Në radhë të parë, në raport flitet për liberalizmin dhe për sektarizmin. Këto janë dy sëmundje të rrezikshme politike e ideologjike. Burimi i tyre është te mbeturinat e pikëpamjeve idealiste dhe konservatore të shoqërisë së vjetër. Tani jemi akoma larg nga koha kur ato t'i kemi zhdukur nga ndërgjegjja e njerëzve tanë. Këto shfaqen edhe në shoqërinë tonë të re, në marrëdhëniet e brendshme të familjes, në patriarkalizmin; shfaqen në besimet fetare, në familjaritetin e sëmurë, në indiferentizmin politik, në qëndrimin ndaj pronës private dhe pronës së përbashkët, në çështjet e moralit e të tjera. Të gjitha këto nuk janë ndodhi të rastit dhe pa botëkuptimin e tyre filozofik, prandaj edhe duhen trajtuar në këtë plan. Për t'i zhdukur ato, duhet punuar, duke u thelluar në ideologjinë tonë materialiste marksist-leniniste.

Kjo është një luftë e vazhdueshme dhe që të ketë

sukses, duhet të ndërmerret në të dy frontet: në planin e gjerë përmes edukimit me ideologjinë tonë, dhe në frontin e veçantë, kur këto mbeturina shfaqen konkretisht në jetë. Ne ua mësojmë njerëzve tanë filozofinë marksiste-leniniste jo si dogmë, por si një armë që hap perspektivë. Të mos mendojmë se në praktikën e dhënies dhe të marrjes së këtyre mësimëve, kudo që punohet, nuk ka njerëz që tregohen dogmatikë. Prandaj, kur mbahet, fjala vjen, një konferencë përpara një numri punonjësish dhe shikojmë që një ose disa prej tyre bëjnë gabime në veprimtarinë e tyre praktike, ne kemi të drejtë dhe detyrë t'i kapim ata dhe t'u themi: «Çfarë janë këto që po bëni? Gjërat ju i thatë mirë në mbledhje, por, në frontin e punës, po bëni gabime që bien në kundërshtim me ato që folët». Prandaj theksoj që luftën duhet ta bëjmë vazhdimisht në të dy frontet.

Jeta po na tregon se shfaqjet e oportunitetit dhe të sektarizmit nuk paraqiten në të gjithë njerëzit njësoj as nga natyra, as nga sasia, as nga intensiteti në kohë. Fakt është se të tilla shfaqje ka te njerëzit tanë dhe ato, herë pas here, manifestohen. Te disa mundet që tani për tani ato flenë dhe, më vonë, në rrethana konkrete që i krijohen individit, ato zgjohen dhe veprojnë, gjë që tregon se ky person nuk ka marrë një edukatë të thellë. Këto shfaqje, që deri në një kohë tek ai kanë qenë në gjumë, në rrethanat e krijuara ngrenë veshët. Prandaj e përsëris që lufta duhet bërë në të dy frontet. Vetëm një luftë e tillë i spastron të tilla shfaqje, i del punës përpara, frenon «epideminë», por, natyrisht, nuk mund t'i zhdukë ato të gjitha për-

njëherë dhe në një kohë, ndryshe nuk do të ekzistonin kontradikta joantagoniste dhe luftë klasash.

Nga një kuptim i tillë dialektik i këtyre gjërave ndërtohen edhe qëndrimet e drejta të njerëzve në shoqëri, qëndrimet e Partisë me anëtarët e saj dhe me gjithë punonjësit në përgjithësi, si dhe qëndrimet e forumeve me bazën. Ndriçimi dhe udhërrëfimi nga ideologjia jonë janë baza dhe burimi i këtij procesi përparimtar që po ndodh në jetën e njerëzve tanë që po bëjnë historinë, që po bëjnë revolucionin dhe që po e çojnë këtë përpara drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

E kundërta ngjet në vendet kapitaliste. Atje ideologjitë idealiste, mistike, racionaliste-idealiste jo marksiste ose fare pak materialiste, pozitiviste, ekzistencialiste etj. konvergojnë në mbrojtjen e rendit kapitalist borgjez dhe nxitin të gjitha veset e këqija të njerëzit për degjenerimin e shoqërisë dhe për ruajtjen e strukturës ekonomike të trusteve, të koncerneve e të oligarkisë financiare.

Burokratizmi dhe teknokratizmi janë, gjithashtu, sëmundje të rrezikshme për shoqërinë tonë socialiste. Këto janë jo vetëm probleme politiko-ideologjike, por edhe organizative. Po nuk u kuptua drejt e thellë njëri, as tjetri nuk zhduket, përkundrazi trashet. Por edhe po u kuptua drejt njëri, po nuk u zbatua dhe po nuk u kontrollua ky zbatim, atëherë përsëri do të na mbulojë burokratizmi dhe nuk do të na udhëheqë më ideologjia marksiste-leniniste, por teknokracia. Kuptimi i drejtë politiko-ideologjik i këtyre rreziqeve, lufta e gjallë revolucionare, kontakti i vazhdueshëm i

udhëheqjes me njerëzit e bazës, zgjidhja e drejtë, e shpejtë e problemeve dhe moszvarritja e tyre, marrja e menjëhershme e masave për të kryer detyrat e ngarkuara etj. janë të vetmet ilaçe të këtyre sëmundjeve.

Këto probleme ne i kemi trajtuar edhe herë tjetër. Tani po ndalemi përsëri jo se ato nuk kuptohen apo se nuk bëhet luftë ndaj tyre, si teorikisht edhe praktikisht. Në këtë drejtim, luftohet, bile kemi edhe rezultate të mira. Por, megjithatë, praktika e punës së përditshme na i nxjerr herë pas here mbi ujë këto «sëmundje», gjë që na bën të konkludojmë se edhe punën ideologjike për këto probleme nuk e kemi thelluar sa duhet dhe si duhet.

Duhet të kuptohet se pa punë në zyrë, pa raporte, pa disa të dhëna statistikore, pa studimin e tyre nuk mund të bëhet, ashtu siç nuk mund të bëhet pa ligje, pa urdhëresa e rregullore. Këto janë absolutisht të nevojshme e të domosdoshme edhe për shtetin e diktaturës së proletariatit e për drejtimin e ekonomisë sonë të centralizuar. Por, të kuptohemi, është absolutisht e dëmshme, gjithashtu, të mbulohe mi nga letrat, të qëndrojmë në zyra, se gjoja po studiojmë, kur, në fakt, nuk nxjerrim gjë në dritë, kur vetëm japim urdhra nga lart dhe nuk e njohim si duhet gjendjen në bazë. Këto të këqija shkaktohen nga përtacia, nga inkompetenca dhe nga frika e kontaktit dhe e ballafaqimit të disa kuadrove me masat. Kjo nxit dhënien e urdhrave, prepotencën, krenarinë e sëmurë, dëshirën për fron, gjë që çon edhe në teknokratizëm, në këtë rrymë filozofike reaksionare.

Një burokrat i do shumë teknokratët. Teknikët dhe teknologjinë ai nuk i do e nuk i vlerëson ashtu siç na mësojnë marksizëm-leninizmi dhe Partia. Burokrati i do teknokratët jo vetëm që të drejtojnë me ata, por edhe të fshihet pas tyre, në mos të errësojë apo edhe të harrojë fare të vërtetën e madhe se te ne mbi të gjitha udhëheq politika e drejtë e Partisë. Ajo na mëson se si duhet të drejtohen punët dhe si të zgjidhen problemet. Shteti ynë socialist përgatit specialistët dhe teknikët e vet të klasës, të cilët punojnë e drejtojnë, por në krye të çdo pune është Partia; kësaj i përket të udhëheqë tërë jetën e vendit, në të gjithë sektorët, në të gjitha hallkat, me të gjitha normat e vendosura në bazë të teorisë sonë marksiste-leniniste.

Kjo çështje të kuptohet drejt. Partia nuk është kundër specialistëve dhe teknikëve. Këta punojnë dhe duhet të punojnë mirë. Por, për ato punë që i përkasin Partisë, është kjo që do të vendosë. Në këto probleme të thellohemi vazhdimisht.

Zgjedhja e kuadrove, e specialistëve të përshtatshëm për vende të caktuara, është prapë një problem me rëndësi të madhe politike, ideologjike, organizative dhe teknike. Specialisti, pasi të vendoset në një vend pune, mirë është të mos lëvizë akoma pa marrë mirë punën në dorë. Lëvizja e tij të bëhet vetëm për arsye shumë të forta. Ai mund të ngrihet në përgjegjësi, po jo pa mbajtur parasysh rregullat dhe udhëzimet që ka dhënë Byroja Politike e Komitetit Qendror për këtë problem.

Specialistit është e domosdoshme t'i ruhet profili dhe jo të caktohet në çfarëdo vendi pune, pa kritere

të shëndosha ose se u ka zënë këmbët drejtuesve. Derisa specialisti është përgatitur në një profil të caktuar, ky profil atij nuk duhet t'i ndryshohet, edhe në rast se akoma nuk ekziston si vend. Para se të hapet vendi për këtë profil, duhet të ketë me siguri një sërë problemesh që i përkasin profilit që do të hapet e do të zhvillohet në të ardhmen e afërt. Prandaj specialisti të ngarkohet e të merret me punë të kësaj natyre.

I duhet dhënë fund praktikës së gabuar që ndiqet nga ana e disa komiteteve të Partisë të rretheve që për lëvizjet e kuadrove kryesorë nuk e marrin pëlqimin e dikasterit përkatës. E dënueshme është, gjithashtu, edhe lëvizja e tepruar e atyre kuadrove që janë në kompetencat e vetë komiteteve të Partisë të rretheve, prandaj të mos abuzohet nga ana e tyre.

Në këto drejtime, kudo në përgjithësi, kemi bërë një punë të mirë. Por, siç shihet, në praktikë kemi akoma të meta. Për ta njohur mirë kuadrin, duhet të shihet se si qëndron ai në punë dhe në jetë, ç'qëndrim mban ndaj vijës së Partisë. Me një fjalë, të ndiqet ai hap pas hapi si punon e si jeton. Ka ndër ta që bëjnë përparime, por ka edhe nga ata që ngecin në vend, që mbesin prapa ose që bëjnë edhe zigzage, si në politikë, ashtu edhe në zanat. Në të gjitha situatat që paraqiten, kuadri duhet të ndihmohet për t'u ndrequr, por edhe ai vetë e ka për detyrë ta «ndihmojë» veten. Të dyja këto ndihma duhet të shkojnë paralel. Partia vazhdimisht mendon se si t'i ndihmojë e t'i ngrejë kuadrot, si nga ana ideopolitike, ashtu edhe tekniko-profesionale. Për këtë u ka krijuar të gjitha ku-

shtet, duke i dërguar në shkolla ose duke u dhënë mundësi të studiojnë vetë.

Ata kuadro e specialistë, të cilët, me gjithë ndihmën që u jepet, bëhen pengesë në punë, natyrisht, duhen zëvendësuar me elementë të rinj. Partia e ka për detyrë t'u hapë horizont kuadrove të rinj që i kanë cilësitë që kërkohen: garancinë politike dhe aftësitë teknike. Po hezituam në këtë drejtim dhe po ramë në pozita të sëmura sentimentalizmi, familjariteti etj., atëherë Partia dhe shteti ynë do të sklerozohen.

Në përgjithësi, siç thashë edhe më parë, Partia jonë po e kryen mirë këtë detyrë dhe rezultatet janë të kënaqshme. Kuadro të rinj kanë dalë dhe po dalin vazhdimisht te ne dhe shumë prej tyre janë ngritur në vende me përgjegjësi. Në këtë drejtim kemi plot shembuj. Kjo është një domosdoshmëri, qoftë për zëvendësimin e atyre që dalin në pension, ashtu dhe për ata që na bëhen pengesë në punë. Ne nuk mund të lejojmë të na krijohen situata si ajo që është krijuar në Kinë, ku mosha më e vogël e kuadrove është 60-65 vjeç! Si është e mundur të ndodhë kjo, mund të pyesë ndonjë. Atje tash kanë nxjerrë në punë me përgjegjësi «pleh-rat» e vjetra, edhe njerëz me moshë deri në 90 vjeç, që edhe politikisht nuk janë të mirë! Jo, ne nuk do të lejojmë në asnjë mënyrë që Partia të plaket. Kuadrot e vjetër te ne e kanë për detyrë që të përgatitin kuadro të rinj. Kjo është në interesin e madh të Partisë. Kështu që kur vjen koha dhe të vjetrit e shohin vetë se nuk po japin dot më sa duhet, t'u hapin me mirëkuptim e dashamirësi rrugën të rinjve. Derisa të rrojnë, edhe sikur të mos jenë në detyrat që kanë pasur, Partia në

një mënyrë ose në një tjetër do ta kërkojë kurdoherë ndihmën e kuadrove të vjetër; por, kur të shohë se ata nuk mund të japin dot më si më parë, të vjetrit nuk duhet të bëhen barrikadë për të rinjtë.

Kuadrot të vlerësohen jo vetëm nga qëndrimet politike, por edhe nga rezultatet që arrijnë në punët konkrete. E para të mos fshehë të dytën se, mund të jesh i mirë politikisht, por njëkohësisht duhet të japësh atë që të kërkohet në punë. Për këto Partia dhe shteti u japin kuadrove edhe dekorata. Askush të mos vërë përpara të kaluarën e mirë, të cilën nuk ia mohon njeri; por, bashkë me të, kërkohet edhe realizimi me përpikëri i detyrave. Prandaj çdo kuadër të bëjë të gjitha përpjekjet që të ecë vazhdimisht përpara, ndryshe, ai që bëhet pengesë, duhet të zëvendësohet.

Në raport më tërhoqi vëmendjen çështja e një numri pranimesh në Parti me kritere jo të shëndosha dhe e përjashtimeve nga Partia gjatë vitit 1977. Duhet të jemi shumë vigjilentë në këtë çështje kardinale, shokë! T'i shkundim mirë organizatat-bazë, që të bëhen më të ndërgjegjshme për këtë problem që ka të bëjë me të sotmen dhe me të nesërmen e Partisë, pra, me fatet e socializmit në vendin tonë. Në qoftë se zgjedhim «fidanë» të shëndoshë, do të rriten me siguri edhe pemë të shëndosha nga «bahçevani», na mëson Stalini. Kur «fidani» është i dobët, «bahçevani» nuk ka ç'i bën. Prandaj ta zgjedhim me kujdes, ta njohim mirë subjektin. Natyrisht, nuk mund të pretendohet që një njeri t'i ketë të tëra kualitetet që kur lind. Por, kur ai ka disa të dhëna pozitive, është më shumë i prirë për t'u kalitur. Të pranojmë sot një njeri në Parti dhe

ta përjashtojmë atë pas një viti, kjo tregon një dobësi të madhe nga ana e organizatës-bazë të Partisë në këtë çështje kapitale.

Në radhë të parë koncentrimi i kujdesit të organizatës-bazë të Partisë duhet të drejtohet në cilësitë që kërkon Statuti për personin. Po nuk e bëmë mirë këtë, atëherë do të kemi ato pasoja që dimë: masa ndëshkimore, shumë vërejtje e përjashtime, krijimin e tarave, familjaritetin e sëmurë, intriga e të tjera të këqija në gjirin e organizatës-bazë, e cila, në vend që të preokupohet për problemet kardinale që nxjerr jeta përpara, i krijon telashe vetes nga pakujdesia dhe nga mungesa e vigjilencës, sidomos kur kjo kërkohet që në fillim.

Edhe një herë po e përsëris se raporti që na u dha më duket që është ndërtuar mirë, pse ai të jep mundësi të thellohesh në disa probleme. Edhe unë me këtë rast preka këtu disa çështje. Sidoqoftë, shokët e tjerë që do të diskutojnë do t'i mbushin boshllëqet dhe në këtë mënyrë do të plotësojmë njëri-tjetrin për këtë problem kaq të rëndësishëm për Partinë.

*Botohet për herë të parë, sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së organi-
zatës-bazë të Partisë,
që gjendet në AQP*

NDIEJ GËZIM TË MADH KUR SHOH ZHVILLIMIN E ARTIT TË NE

Shënime

20 maj 1978

Në mbrëmjen e ditës së sotme asistua me Nexhmijen në shfaqjen përfundimtare të koncerteve të majit, ku kishin ardhur edhe gjithë shokët e tjerë të udhëheqjes. Koncerti, që u dha në Teatrin e Operës dhe të Baletit, ishte me pjesë muzikore korale, instrumentale dhe valle popullore të ndryshme të zgjedhura nga shfaqjet e grupeve pjesëmarrëse në koncertet e majit të këtij viti. Ky manifestim i bukur muzikor-koreografik është bërë tashmë një traditë e mirë e kulturës sonë.

Ndiej gëzim të madh kur shoh një zhvillim të tillë të arteve: të muzikës, të këngëve, të valleve, të teatrove dhe të estradave në gjithë Shqipërinë. Çdo ditë e çdo vit që kalon konstatoj një përparim, një lulëzim të madh, një hov të papërshkruar, një pjesëmarrje çuditërisht të gjerë të punonjësve dhe një larmi kompozimesh të reja, të bukura dhe me përmbajtje të thellë patriotike e socialiste. Këto pjesë, të kompozuar me tinguj të harmonishëm, këndohen ose kërcëhen me shumë zell e mjeshtëri të madhe nga ekzekutues pro-

fesionistë e amatorë. Por në koncertet e majit më të shumtët e pjesëmarrësve janë amatorë. Në to të bie në sy sidomos pjesëmarrja e gjerë e vajzave. Është një kënaqësi e madhe për popullin tonë që vajzat dhe gratë, me shpirtin e tyre aq të pastër e aq të ndjeshëm, ashtu si në të gjitha punët e Partisë dhe të shtetit, kanë dalë në skenë edhe në këto gjini, që i pamë në koncert dhe mund të them me plot gojën se po shkëlqejnë. Në koncertet e majit të këtij viti konstatoam pjesëmarrjen edhe të një morie të madhe pionierësh që ta ka ënda t'i shikosh; bile është një kënaqësi shpirtërore t'i dëgjosh ata kur këndojnë me zë fëmënor aq të çiltër, të qartë, tingëllues, harmonik apo t'i shohësh kur kërcëjnë e kur luajnë në violinë me aq talent, saqë të bëhet zemra mal.

Në koncertet e majit sheh edhe artistë veteranë që kanë dalë në pension. Ata i kanë dhënë artit tonë shumë; e kanë mëkëmbur, e kanë ndihmuar dhe e kanë zhvilluar atë që në ditët e para të Çlirimit, duke krijuar kore, duke mësuar me dhjetëra e me qindra talente të reja. Me veprimtarinë e tyre, ata i kanë thënë popullit se kënga e tij do të dominojë në skenat tona, do të zhvillohet dhe do të zbukurohet edhe më shumë duke u ekzekutuar kurdoherë e më bukur.

Karakteristikave të këngës sonë popullore (dhe këto karakteristika të bukura ne do t'i zhvillojmë më tej) do t'u shtohet ajo brendi e shoqërisë sonë të re që të shprehë madhështinë e socializmit, forcën e perspektivën e tij, lumturinë që i sjell ai njeriut të ri të formuar në një shoqëri të re ekonomike e kulturore, të pasur, të pastër e të mrekullueshme.

Në këtë koncert dëgjuam pjesë të kompozuar nga muzikantët tanë me talent si Kujtim Laro e Nikolla Zoraqi; dëgjuam një poemë vokalo-simfonike të Feim Ibrahimit me temën «Tanë Shqipnia asht betue, pa gjak malet mos me i lëshue». Këtë pjesë ky kompozitor e ka përgatitur me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Qe një poemë e bukur simfonike vokalo-instrumentale. Më pëlqeu shumë recitimi burrëror i artistit tonë të njohur të kinematografisë Rikard Ljarja. Ishte e mallëngjyeshme si për mua, por besoj edhe për të gjithë të tjerët, kur doli në skenë pianistja e shquar veterane, Lola Gjoka, një nga pionieret e muzikës sonë dhe shoqe e Tefta Tashkos. Ajo ishte e emocionuar, megjithatë luajti për mrekulli. Goditjet në tastierën e pianos nga ana e saj tingëllonin shumë bukur, të shoqëruara nga orkestra e shkollës së mesme artistike «Jordan Misja». Po kush e dirigjonte këtë orkestër? Atë e dirigjonte Eno Koçoja, pikërisht i biri i shoqes së ngushtë të Lola Gjokës, djali i Tefta Tashkos. Lola Gjoka, kjo artiste e shquar, ka mësuar me dhjetëra e me qindra vajza dhe djem që aktualisht kompozojnë e luajnë në skenat e vendit tonë për kënaqësinë e popullit.

Nga kompozitori dhe këngëtari Avni Mula dëgjuam dy këngë. Avni Mula është për mua jo vetëm një këngëtar i mirë, por njëkohësisht edhe një kompozitor me talent. Këngët e Avni Mulës janë të bukura, shumë harmonioze dhe kanë një cilësi që këndohen me zell lirisht nga të gjithë, prandaj ato i dëgjon të kënduara edhe në popull. Disa mund të mendojnë se këngët e Avni Mulës janë krijime të rastit, të cilat, sipas tyre,

do të ngelin për t'u ekzekutuar vetëm në skena. Unë mendoj se nuk do të ngjasë kështu, se këngët e tij janë jo vetëm të harmonishme, por edhe të kompozuara në mënyrë të atillë që mund t'i përvetësojnë shpejt të gjithë. Pastaj edhe brendia e tyre është e prekshme, patriotike, socialiste. Ai i këndon luftës dhe jetës së re, gjë që nuk mund të mos lërë mbresa. Mbi të gjitha, krijimet e tij muzikore ai i bazon në artin popullor. Zaten, të gjitha pjesët muzikore, korale apo instrumentale që po dëgjojmë, të tilla janë. Kjo është edhe gjëja më e bukur e tyre, se janë kompozime që kanë në bazë artin muzikor të popullit, ndjenjat e tij të pastra dhe shijen e bukur të jetës së re socialiste. Për këtë arsye autorët e këtyre pjesëve janë artistë të dashur për masat. Pjesët muzikore të këtyre koncerteve i kam parë çdo natë në televizor. Por sonte, ndjeva një kënaqësi të veçantë kur i dëgjova në sallën e Teatrit të Operës dhe të Baletit. Veshjet e artistëve, kostumet e mrekullueshme të popullit tonë i jepnin shfaqjes një bukuri akoma më të madhe. Edhe kënga u përshtatej me mjeshhtëri këtyre veshjeve të bukura të popullit me ngjyra të shumëllojta e të mahnitshme.

Është e natyrshme dhe plotësisht e vërtetë ajo që na raportojnë se, kur venë ansamblet tona të këngëve dhe të valleve për të dhënë shfaqje në vende të ndryshme të Evropës, spektatorët e huaj i presin me një entuziazëm të papërshtatshëm, mahniten me to, i shoqërojnë artistët tanë nëpër rrugë dhe krijojnë për vendin tonë përshtypje nga më të pashlyeshmet.

Masiviteti në këto këngë e valle është një masivitet kaq i harmonishëm saqë i jep cilitdo të kuptojë

se si ka arritur një popull i vogël të zhvillojë artin e muzikën, këngët e vallet e tij popullore në këtë shkallë kaq të lartë. Pikërisht ky masivitet i mrekullueshëm të jep idenë e vërtetë të shtrirjes së gjerë të artit tonë. Kjo larmi e madhe vallesh e këngësh dhe ekzekutimi i tyre i lartë të japin të kuptosh se jeta jonë socialiste është jeta më e lumtur; se populli shqiptar punon, fiton dhe këndon me gjithë zemër; se ky popull që lufton sot për socializmin ka luftuar edhe më parë për lirinë e pavarësinë e atdheut, ka derdhur gjak, por edhe ka kënduar. Disa nga këto këngë të tij tash janë vënë aq bukur në skenë.

E pëlqeva shumë pjesën koreografike të Agron Aliajt me muzikë të Kujtim Laros që e ekzekutoi grupi i valleve i Ansamblit artistik të Ushtrisë Popullore me solistë valltarët Violeta Gjora e Norbert Krasniqi që i shoqëronte orkestra me dirigjent Alqi Lepurin. Ja, në këtë vepër koreografike shihen lufta e popullit tonë, kryengritjet e viteve 1837 dhe 1848 kundër Tanzimatit; aty shikon historinë e gjallë të trimave të Rrapo Hekalit dhe të të gjithë Shqipërisë, që me fustanella, me tirqe e me shpata zhveshur, luftonin kundër pushtuesve. Dukej sikur hidheshin në sulm Tafil Buzët e Gjolçkët, siç e tha pak më parë Avni Mula me pjesën që kishte kompozuar, të kënduar nga çupa e tij: «Ti më mburjte dhe më ngulite në kokë e në zemër dashurinë për Atdheun».

Po ashtu na la përshtypje shumë të madhe vallja e kënduar: «Jemi fëmijët më të lumtur». Kjo ishte një pjesë koreografike me muzikë të Nikolla Zoraqit, që e kishte vënë në skenë Agron Aliaj, Vallja me moti-

ve kosovare, muzika e së cilës qe përpunuar nga Agim Krajka dhe që ishte vënë në skenë nga koreografi Besim Zekthi, na bëri gjithashtu përshtypje të madhe për bukurinë e për harmoninë e saj, si dhe për kërcimin madhështor, për thjeshtësinë dhe burrërinë e vëllezërve dhe motrave tona kosovare që vuajnë në Jugosllavinë titiste e ku e kanë aq vështirë të zhvillojnë artin dhe muzikën shqiptare. Por Shqipëria socialiste i zhvillon motivet e Kosovës. Ato ne na prekin të gjithë dhe na bëjnë të mendojmë për ata vëllezër e motra që kanë luftuar për lirinë dhe pavarësinë e kombit tonë dhe vazhdojnë të luftojnë për të fituar të drejtat e tyre kundër komplotistëve, intrigantëve, shovinistëve serbë e titistëve jugosllavë.

Shumë bukur e këndoi Artistja e Popullit Vaçe Zela me atë zërin e saj të mrekullueshëm, këngën «Agimet tona», të kompozuar nga Nikolla Zoraqi, me tekstin e Dritëro Agollit. Në fund u ekzekutua në mënyrë të përsosur nga trupa e baletit të Teatrit të Operës dhe të Baletit vallja «Festa e dritës», me muzikë të përpunuar nga Çesk Zadeja dhe me koreografinë e Agron Aliajt.

I gjithë ky koncert ishte përgatitur në një nivel të lartë, me një mjeshtëri të madhe, si nga ana e kompozitorëve dhe e dirigjentëve, ashtu edhe nga interpretuesit e pjesëve. Ekzekutuesit e rinj, pionierët e pionieret, qofshin këngëtarë apo dhe instrumentistë, në orkestrat e tyre të mëdha, kanë bërë përparime të dukshme. Prandaj mendoj se të gjithë këta artistë, kudo që mund të shkojnë, do të korrin me siguri sukses të madh.

Ne pamë të ngjiteshin në skenë edhe fshatarë kooperativistë të rrethit të Tiranës, që u binin instrumenteve popullore dhe të kënaqnin. Pamë të rejat e fshatit të luanin në skenë, të kërcenin e të këndonin sikur të ishin profesioniste. Këtë mrekulli e ka krijuar Partia jonë me vijën e saj të drejtë. Në fushën e arteve do të vazhdojmë të përparojmë edhe në të ardhmen me ritme akoma më të larta, pse arti është frymëzues; ai e kënaq popullin, zbukuron ndjenjat e njerëzve dhe e frymëzon zemrën e tij për realizime akoma më të mëdha, për suksese të panumërta në ndërtimin e socializmit e në mbrojtjen e atdheut. Ai shërben gjithashtu edhe për ruajtjen e zhvillimin e traditave shumë të lashta artistike të popullit tonë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NË USHTRI NUK MUND TË ECET PA DISIPLINË

Shënime

21 maj 1978

Nga një relacion që mora për zhvillimin e mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje në Parti në njësitë dhe repartet e ushtrisë, mund të nxjerr konkluzionin që, në përgjithësi, ato janë zhvilluar në lartësinë e duhur; niveli i punës së tyre ishte i mirë. Nga diskutimi i problemeve ideologjike dhe organizative duket gjithashtu uniteti i plotë në mendime dhe në veprime.

Si në organizatat e terrenit, edhe në ato të ushtrisë, duhet të luftohen kurdoherë liberalizmi e burokratizmi. Duket që shokët e ushtrisë i preokupon kjo çështje, për arsye se shfaqjet e kësaj natyre janë bërë objekt diskutimi në mbledhjet e organizatave të Partisë për dhënie llogari dhe zgjedhje.

Në këto organizata objektivat janë më të qartë, më konkretë e, si të tillë ata janë edhe më të kontrollueshëm. Organizatat e Partisë në ushtri preokupohen mjaft edhe për përgatitjen politike e luftarake, gjë që kryhet gjithashtu në nivel të mirë. Tani Partia kërkon nga ushtria edhe një disiplinë më të fortë. Aktualisht, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 1977, sipas

relacionit që lexova, ka ulje në thyerjet disiplinore.

Ajo që të tërheq më shumë vëmendjen, si gjetskë edhe në ushtri, është se në mjaft raste nuk punohet si duhet për përgatitjen e mbledhjeve dhe për përpilimin me nivel të raporteve e të vendimeve që merren nga organizatat-bazë, gjë që, natyrisht, e vështirëson njohjen e detyrave, zbatimin dhe kontrollin e tyre. Kjo dikton nevojën që të ngrihet vazhdimisht interesimi i organeve dhe organizatave të Partisë në ushtri, të rritet më shumë ndjenja e përgjegjësisë në analizën me një frymë të shëndoshë kritike dhe autokritike të këtyre të metave e dobësive dhe të merren masat e nevojshme për eliminimin e tyre. Këto duhen vënë kurdoherë në dukje.

Marrja e mendimit të masave dhe dhënia llogari para tyre në shumë raste nuk është e plotë. Në këtë drejtim vërehen shfaqje formalizmi dhe rutine, nuk ka diskutime të gjalla e qëndrime autokritike. Nga ana e disa përgjegjësve nuk ndihet domosdoshmëria e dhënies llogari dhe e marrjes së mendimit të masave për problemet që shtrohen për zgjidhje. Këto janë gabime të mëdha që, po nuk u ndreqën, bëhen të rrezikshme, sidomos kur është fjala për anën tekniko-ushtarake të çështjes. Prandaj përmirësimi të punës në këto drejtime t'i kushtohet vëmendja e duhur, duke u thelluar në aspektin politik e ideologjik të çështjeve.

Shumë komisarë dhe sekretarë partie nëpër reparte dhe njësi, më duket mua, duhen shkundur, pse ata nuk janë aq sa duhet në korent të situatës së përgjithshme. Kjo do të thotë se ata nuk i njohin mirë pulsën dhe shpirtin e efektivit të repartit, ndjenjat dhe

shqetësimet e kuadrove e të ushtarëve. Kështu ata nuk janë në gjendje të nxjerrin si duhet konkluzione nga të metat që konstatohen dhe të marrin masa serioze për t'i ndrequr ato e për të mos mbetur në planin e përgjithshëm, për të mos rënë në vulgaritete.

Ka dobësi edhe në cilësinë dhe në rendimentin e stërvitjeve të të gjitha strukturave të mbrojtjes. Akoma nuk është arritur ai nivel pune dhe ajo shkathtësi që kërkohen në përdorimin e teknikës. Po kështu mangësi vihen re edhe në rezultatet konkrete në përvetësimin e elementeve të luftimit, gjë që ka një rëndësi të jashtëzakonshme, se, në fund të fundit, kjo është çështja kryesore. Prandaj, në këto drejtime duhet të bëjnë kujdes gjithë shokët drejtues të ushtrisë.

Ne nuk mund të kënaqemi me pak në çështjet ushtarake. Në fushën e mbrojtjes nuk mund të rendim pas sasisë, por duam kryesisht cilësi, që stërvitja luftarake të jetë sa më konkrete, sa më e gjallë, sa më dinamike, prandaj asnjëherë të mos na mbulojë vetëkënaqësia. Të mos e quajmë kurrë detyrën të kryer pa realizuar programin në një formë të përsosur dhe me një shpirt të lartë luftarak.

Po pse ndodhin këto gjëra? Këto ndodhin, sepse te mjaft kuadro ka liberalizëm, ka dëmbellëk, ka thjeshtësim të problemeve. Akoma nuk po zbatohet kudo një praktikë e shëndoshë në zbërthimin e mësimit; nuk bëhet kurdoherë një punë këmbëngulëse për përvetësimin dhe zgjerimin e njohurive; nuk luftohet nga të gjithë kuadrot për ta përmirësuar vazhdimisht stilin dhe metodën e dhënies së këtyre mësimeve e të zbatimit të tyre në praktikë dhe nuk organizohet kontroll i

vazhdueshëm për vënien e tyre në jetë. Të gjitha këto u duhen vënë mirë në dukje kuadrove, me qëllim që ata të ndërtojnë një punë të thellë shkencore për përvetësimin e kërkesave të artit ushtarak e të rregulloreve të luftimit nga ana e tyre, por edhe nga ushtarët, sepse vetëm kështu do të sigurojmë rritjen e cilësisë së stërvitjes dhe edukimin ushtarak të njerëzve tanë.

Veçanërisht dëshiroj të theksoj se në ushtri duhet të luftohen me rreptësi shfaqjet e liberalizmit në zbatimin e disiplinës ushtarake, sepse po u lejuan, këto shfaqje i futin efektivit frymën e çmobilizimit. Të mos abuzohet me demokracinë proletare, me të cilën edukohet ushtria jonë, për sa i përket kuptimit të drejtë të disiplinës ushtarake. Pikërisht, në këtë drejtim të ngulet shumë këmbë që të kuptohet thellë se në ushtri nuk mund të ecet pa disiplinë. Atje nuk mund të lejohet që urdhri i eprorit të zbatohet sipas qejfit ose të mos zbatohet fare; që mësimi të zhvillohet me një sërë të metash, të përvetësohet ai në mënyrë të përciptë dhe të bëhet stërvitja shkel e shko. Jo, këto nuk lejohen! Përkundrazi, në çdo detyrë ushtarake kërkohet disiplinë, bile e fortë dhe e rreptë.

Siç e kam theksuar edhe herë të tjera, edukata ushtarake, në përgjithësi, ka dy aspekte: aspektin e përgjithshëm, kur mësimi jepet në auditor për njohjen dhe përdorimin e armëve të ndryshme, si dhe aspektin e punës individuale që duhet të bëjë çdo kuadër me vartësit e tij, konkretisht me ushtarët. Kjo e dyta nuk bëhet sa duhet, megjithëse është e domosdoshme të bëhet. Mësimi i përgjithshëm të hap horizonte, por ai është i pamjaftueshëm, ndaj edhe në praktikë e në

zbatim vërehen shumë të meta, të cilat mund të ndreqen vetëm me punë këmbëngulëse dhe me interesim të veçantë, për t'ia shpjeguar si duhet atij që nuk e kupton mirë problemin, si dhe atij që nuk e zbaton si duhet urdhrin.

Të kihet parasysh se në ushtri çdo gjë duhet të shpjegohet me rrënjë që në fillim, për arsye se një herë do të të jepet rasti që ta japësh «provimin» në fushën e betejës. Ky «provim» do të jepet atëherë kur atdheu të jetë në rrezik. Pra, në qoftë se arti ushtarak nuk është përvetësuar si duhet, kur të vijë koha që ta vësh atë në zbatim, në momentin e rrezikut, do të gjendesh i hutuar, i çarmatosur për të përballuar një luftë të vështirë.

Prandaj puna politike dhe ideologjike në ushtri ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Kjo punë, në të gjitha aspektet e jetës së brendshme dhe të jashtme, duhet të lidhet ngushtë me problemet dhe me detyrat tekniko-luftarake. Asnjëherë të mos shkëputet puna ideopolitike nga detyrat e rëndësishme të mbrojtjes. Nuk lejohet të bëhet punë politike për punë politike, por kjo të lidhet me detyrat konkrete ushtarake, të cilat është e domosdoshme të kuptohen mirë nga oficeri e nga ushtari. Në qoftë se nuk përvetësohet mirë detyra tekniko-luftarake, kjo do të thotë se as detyra politiko-ideologjike nuk është kuptuar si duhet. Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera, ka thënë Klauzeviçi. Por, ne i shtojmë kësaj, se luftën do ta bëjmë jo vetëm me mjete të tjera, por kurdoherë të bashkuar dhe të pandarë me politikën dhe me ideologjinë tonë marksiste-leniniste. Pikërisht në këtë as-

pekt ndryshon lufta jonë nga lufta e predikuar nga Klauzeviçi, e cila është e një karakteri tjetër. Lufta jonë është një luftë çlirimtare, kurse Klauzeviçi ka shkruar për të në kohën kur carizmi rus dhe Frederiku i Prusisë bënin luftëra grabitqare në Evropë e gjetkë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MIRËQENIA RRRITET DUKE SHTUAR PRODIHMET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

23 maj 1978

Lidhur me çështjen që po diskutojmë, mua më duket se parimet janë të drejta dhe s'kemi pse të bëjmë ndryshime. Këto parime duhet të interpretohen drejt në praktikë dhe të mos krijojmë shqetësime te kooperativistët, për arsye të mungesave në organizim e në kontroll ose në përdorimin jo kurdoherë të rregullt të fondeve materiale e monetare. Këtu duhet të zbatohen me rigorozitet ligjet e vendimet e caktuara nga Partia e nga shteti, si dhe rregulloret e ndryshme të aprovuara nga vetë këta organizma shtetërorë.

Parimi ka qenë që ndërmarrjet bujqësore duhen konsideruar si ekonomi socialiste të nivelit më të lartë. Me një fjalë, ato të merren si shembull nga kooperativistët. Para disa vjetësh ne krijuam kooperativat e

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa përmirësime në sistemin e pagave dhe të shpërblimit të punës për punonjësit e bujqësisë.

tipit të lartë, për të cilat orientimi duhet të jetë: ecja graduale drejt ndërmarrjeve bujqësore, derisa të vijë koha që edhe ato të bëhen pronë e përbashkët e të gjithë popullit. Por, kur do të arrihet kjo? Kur do të bëhen ato pronë e përbashkët? Kjo lidhet me nivelin e ndërgjegjes së kooperativistëve, me rritjen e prodhimit dhe me zhvillimin e tyre ekonomik, financiar e shoqëror. Krahas tyre, edhe kooperativat e zakonshme duhet të ecin drejt rrugës që kanë nisur kooperativat e tipit të lartë.

Pa ekskluduar investimet dhe ndihmat në forma të tjera të shtetit për kooperativat e zakonshme, që janë dhënë e do të jepen edhe në të ardhmen, ne kemi përcaktuar, gjithashtu, ndihmën dhe pjesëmarrjen shtetërore për kooperativat e tipit të lartë. Këto jepen për të zhvilluar prodhimin. Por, në praktikë, rezulton që ekzistojnë ndërmarrje shtetërore që dalin me humbje; ka ndërmarrje të tjera që nuk marrin rendimente të larta në prodhimet bujqësore, ashtu sikurse ka edhe nga ato që marrin më shumë prodhime se kooperativat e tipit të lartë. Ka, bile, edhe kooperativa të zakonshme, që, siç thuhet në material, marrin rendimente më të larta nga ndërmarrjet bujqësore. Kjo është shumë pozitive dhe tregon se vija e Partisë sonë kuptohet drejt kudo. Megjithatë, nuk është e domosdoshme që në këtë rast ta quajmë kooperativën e zakonshme si kooperativë të tipit të lartë. Në këtë mes, ne konstatojmë me kënaqësi që, në këto kooperativa, anëtarët e tyre, i kuptojnë drejt politikisht dhe ideologjikisht problemet dhe i shfrytëzojnë si duhet mundësitë që u jep shteti. Ato e kanë rritur prodhimin, gjë që është

shumë pozitive, ashtu sikurse kërkohet medoemos që ndërmarrjet bujqësore të arrijnë rezultate të larta dhe të jenë shembull për kooperativat bujqësore.

Tani po kaloj te një parim tjetër që kemi aprovuar. Ne kemi caktuar që pagesat e anëtarëve të kooperativave të tipit të lartë nuk duhet t'i kalojnë ato të punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore. Mendoj se ne tani për tani duhet ta ruajmë këtë parim e të mos shkojmë me pikëpamjen që këto kooperativa të përparuara, meqë shtuan prodhimin, mund të marrin edhe më shumë. Ato të marrin mesatarisht sa ndërmarrjet shtetërore.

Ndërmarrjeve bujqësore ne u kemi dhënë dhe vazhdojmë t'u japim nga ana e shtetit ndihmën më të madhe, prandaj kërkohet që edhe ato të tregojnë epërsitë e tyre. Për sa u përket kooperativave të tipit të lartë ose kooperativave të tjera, ato nuk e kanë ndihmën materiale, monetare dhe në fusha të tjera në atë shkallë sa e kanë ndërmarrjet bujqësore.

Ne nuk duhet të bëjmë ndryshime koniunkturale. Disa kooperativa të zakonshme kanë ndarë për anëtarët të ardhura sa punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore. Po ashtu disa kooperativa të tipit të lartë kanë ndarë paga më të larta se ndërmarrjet bujqësore, bile, dhe pa oborrin; kurse, duke përfshirë edhe të ardhurat nga oborri, paga mesatare e anëtarëve të këtyre kooperativave tejkalohet mjaft. Ka ekonomi bujqësore që këto të ardhura i kanë marrë duke atakuar fondin e investimeve e të akumulimeve: kanë ulur shpenzimet e prodhimit ose kanë bërë makinacione të ndryshme në rrugë jo të drejta. Ka edhe nga ato ekonomi që me

investimet e shtetit kanë paguar ditët e punës. Të gjitha këto kanë krijuar një situatë që ne nuk duhej ta lejonim. Këto janë deformime në zbatimin e parimeve tona të drejta në zhvillimin e kooperativave. Lidhur me këto çështje ne dëgjuaam këtu edhe shoqet Lenka [Çuko] dhe Themije [Thomai], të cilat shtruan me të drejtë problemin që në kooperativat bujqësore të përcaktojmë mirë sasinë e akumulimit dhe të investimeve. Nuk është thënë që këto investime të japin të ardhurat qysh në vitet e para; efekti i tyre mund të ndihet edhe pas 5 ose 10 vjetësh. Rëndësi ka që ato të jenë sa më të dobishme.

Pra, siç u tha këtu, një vëmendje të veçantë kërkon çështja që fondet e akumulimeve dhe të investimeve të caktohen sa më drejt dhe të shikohet nëse i shtojmë apo i pakësojmë ato. Ne duhet të ecim kurdoherë duke i shtuar ato e jo duke i pakësuar. Fondi i akumulimit në disa kooperativa bujqësore është pakësuar padrejtësisht edhe nga pakujdesia që është treguar në trajtimin e tij. Pakësimi i këtij fondi, duke mbajtur të lartë vlerën e ditës së punës, ka nxitur përtacinë, mungesën e disiplinës dhe mjaft shfaqje të tjera negative në kooperativa, që ndikojnë për keq në zhvillimin e prodhimit. Kjo do të thotë se ne nuk kemi qenë kurdoherë rigorozë dhe nuk kemi bërë kurdoherë llogari me laps në dorë në përcaktimin e fondit të akumulimit, të fondit të pagave dhe të shpenzimeve të prodhimit. Atëherë, ç'duhet bërë? Të ushtrohet kontroll i rreptë në fondin e investimeve, në shpenzimet e prodhimit dhe në fondin e pagave dhe, së fundi, në shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit.

Një çështje tjetër me rëndësi të madhe është ajo

që përmendi shoqja Lenka, se nuk mjafton vetëm të bësh ditë pune si numër dhe të realizosh normën, por këto duhet të rishikohen herë pas here lidhur ngushtë me zbatimin e kodit agroteknik, në të cilin edhe duhet të bazohen. Nuk është normale ajo që ndodh që një pjesë e kooperativistëve venë në punë në orën shtatë ose tetë; u bëjnë bimëve shërbime shpejt e shpejt, pa cilësi dhe brigadieri pa bërë kontrollin e nevojshëm, me mendjehetësi, u shkruan ditën e punës dhe norma u quhet e realizuar. Në këtë mënyrë, ata të hollat i marrin, pavarësisht se cilësinë e punës e kanë lënë mangët. Si pasojë, në fund, prodhimi nuk realizohet. Prandaj, në punët e kooperativës a të ndërmmarrjes bujqësore kërkohen më shumë disiplinë, kontroll e organizim. Puna e punëtorit në uzinë, përgjithësisht, është më e kontrollueshme. Cilësia e punës që ai kryen ndiqet çdo ditë. Bile, çdo bulon që prodhon ai ne e kontrollojmë dhe duhet ta kontrollojmë. Kur nuk e ka bërë mirë, ia konsiderojmë skarco e nuk ia paguajmë. Sigurisht, në bujqësi nuk është e mundur të kontrollohet çdo shtatë që hidhet, veç ama, në fund të ditës, puna e bërë mund çhe duhet të kontrollohet. Mirëpo, në praktikë këtu ka shumë defekte. Duke mos zbatuar rregullat agroteknike, normat, rishikimin me rigorozitet të kohës së punës, investimet e të gjitha këto që thashë më sipër, në fakt, shkelen parimet që kemi caktuar vetë.

Për sa i përket propozimit që bëhet, në raportin që na është paraqitur, për masën e shpërblimit të kooperativistëve gjatë vitit, unë nuk kam kundërshtim që kjo të caktohet edhe 70 për qind; bile mund të shkojë

edhe deri në 80 për qind të vlerës së ditës së punës. Shpërblimet në këtë masë të jepen, por me kusht që kooperativat të krijojnë fondin rezervë për pagat (këtu qëndron edhe stimuli), pa prekur fondet e investimeve.

Këtu u tha, gjithashtu, që në tremujorin e parë mund të japim një pagë në një përqindje më të ulët e pastaj kjo të vijë duke u rritur. Mendoj se nuk ka arsye ta bëjmë këtë. Bile, diskutimi i çështjes në këtë mënyrë më duket një çikë akademik. Kudo të luftohet që planet e prodhimit dhe ato ekonomiko-financiare të realizohen 100 për qind. Mbi këtë bazë do të realizohet sasia e përgjithshme e të ardhurave. Edhe shpërblimi i punës do të bëhet në përputhje me realizimin e planit, domethënë kooperativistit apo punëtorit të bujqësisë, në fund të vitit, do t'i plotësohet paga e tij e punës. Këto çështje që po diskutojmë dhe po vendosim sot, në fakt, kanë rëndësi për zbatimin sa më të drejtë të parimit të shpërblimit sipas punës në fushën e bujqësisë. Ato në vetvete janë një konkretizim i këtij parimi. Rëndësi të madhe ka që format e shpërblimit të punës në bujqësi të mos lejojnë të ushqehen shfaqjet e huaja, vetëkënaqësia, dembelizmi, mungesa e rregullit dhe e disiplinës. Përkundrazi, ato të ndihmojnë për t'i luf-tuar këto të këqija dhe për të shëndoshur më tej gjendjen.

Gjithë sa fola më sipër, të mbahen mirë parasysh e të vihen plotësisht në jetë, se janë probleme e orientime bazë që kanë rëndësi, si për kooperativat e tipit të lartë e ato të zakonshmet, ashtu dhe për ndërmarrjet bujqësore.

Të zbatohet me rigorozitet agroteknika: Kjo është një çështje që duhet të mbahet parasysh në punën e përditshme. Zbatimi i agroteknikës të kërkohet e të kontrollohet akoma më mirë në praktikë. Rritja e prodhimit vjen mbi të gjitha si rrjedhim i zbatimit të agroteknikës.

Normat të jenë të drejta dhe të shtrënguara dhe të kontrollohet me rreptësi zbatimi i tyre.

Investimet të vazhdojnë të zgjerohen dhe të kihet parasysh që të jenë sa më rentable. Të mos ndodhë që të mbillen ullinj dhe ata të mos zënë ngaqë në disa raste punohet dobët nga punëtorë apo kooperativistë, të cilët vetëm sa paraqiten në punë, dhe pastaj më shumë rrinë në hije sesa punojnë, kurse dita e punës i shënohet dhe pastaj themi që investimet i bëjnë. Ky lloj investimi është jo i frytshëm, jorentabël.

Pagat të jenë të harmonizuara dhe të balancuara.

Të përmirësohet vazhdimisht jetesa e punonjësve të bujqësisë. Kjo ka një rëndësi të madhe, se për këtë luftojmë, që të rritet mirëqenia e fshatarësisë. Dhe po t'i bëjmë mirë llogaritë, jo vetëm në global, por edhe në tregues të veçantë, do të shohim se jetesa është përmirësuar. Ne duhet të synojmë rritjen sa më shumë të të ardhurave dhe të mos trembemi pse kooperativisti merr, për shembull, 5 500 ose 6 000 lekë në vit, kur realizon rendimente të larta, se për këto të holla që merr, ai jep prodhim, nuk i merr kot.

Të rritet rendimenti dhe të merren sa më shumë prodhime, gjë që duhet të çojë edhe në uljen e çmimeve të blerjes së tyre nga shteti pa ulur të ardhurat e kooperativave e të kooperativistëve. Kjo do të bëjë që të

ulen edhe çmimet e shitjes me pakicë të produkteve e të mallrave të ndryshme për popullatën. Ky është ligj. Në qoftë se kooperativa dhe kooperativisti prodhon më shumë, do të marrë edhe para më shumë, por jo jashtë normave dhe kritereve të drejta socialiste. Pra, ngritja e mirëqenies së punonjësve realizohet edhe duke ulur çmimet e blerjes së disa produkteve bujqësore nga shteti, gjë që do të çojë edhe në uljen e çmimeve të shitjes me pakicë.

Kooperativat e zakonshme të shkojnë drejt arritjes së nivelit të prodhimit të kooperativave të tipit të lartë dhe këto të fundit drejt ndërmarrjeve bujqësore.

Me traktoristët të ecet drejt trajtimit unik me sektorët e tjerë, por duke synuar që ata të lidhen sa më shumë me prodhimin. Kjo lidhje e tyre me prodhimin e kooperativave të mos reduktohet në ditët e punës. Të mos harrojmë se mënyra ekzistuese e pagesës së traktoristëve u vendos vite përpara, kur në SMT njerëzit vinin pa shumë dëshirë e punimi i tokës u qe besuar kryesisht atyre. Kurse tashti kemi mjaft agronomë, kooperativistë dhe mjaft punëtorë të tjerë të SMT-ve, që janë nga kooperativa, të cilët rrinë dhe duhet t'i rrinë mbi kokë kësaj çështjeje. Prandaj, në këtë drejtim ka ndryshime, të cilat diktojnë, gjithashtu, nevojën e disa përmirësimeve që duhen bërë në pagën e punës së traktoristëve të SMT-ve. Po kështu jam dakord që paga e punonjësve të administratës së kooperativave të lidhet me realizimin e detyrave të planit.

Kooperativat të ecin fuqimisht me forcat e veta, në mënyrë që shteti të mendojë dhe të financojë për problemet më të rëndësishme si, për shembull, në meka-

nizimin e madh, në sistemimin e përsosur të ujitjes, në shtimin e fabrikave të plehrave e në drejtime të tjera.

Grupet në të cilat ndahen kooperativat e tipit të lartë për efekte page, duhet të hiqen. Përse e kemi bërë ne një gjë të tillë të panevojshme dhe që nuk përmirëson asgjë?

Si konkluzion, mendoj që këto masa duhet të çojnë në forcimin e mëtejshëm të situatës, si në ndërmarrjet bujqësore, ashtu edhe në kooperativat, sepse ne mund të marrim vendime sa të duam, por në qoftë se kooperativa nuk siguron vetë fondin e pagave, banka nuk i jep para, ose do t'i japë një shumë të vogël. Këtu nuk ka llafë dhe duhet të jemi të shtrënguar. Por, në qoftë se kooperativa e krijon vetë fondin e pagave dhe zbaton edhe rregullat e tjera, atëherë ka të drejtë t'u ndajë anëtarëve jo më pak se deri në 80 për qind të vlerës së ditës së punës. Të gjitha këto e kanë bazën te realizimi i planit të prodhimit dhe ai ekonomik e financiar.

Kooperativistëve duhet t'u thuhet gjithashtu që, në rast se kooperativa nuk plotëson fondin e pagave dhe të gjitha ato kërkesa që theksova më sipër, atëherë ata jo vetëm nuk do të marrin mbi 70 për qind të vlerës së ditës së punës, por do të kthejnë edhe një pjesë të të hollave që kanë marrë.

Çështja e përqindjes nuk është parimore. Ajo ka të bëjë me përmirësimin e organizimit të punës dhe duhet të çojë në forcimin e disiplinës, në atë rrugë që kanë caktuar Partia dhe pushteti popullor.

Përmirësimet që bëhen në sistemin e pagave e të shpërblimit të punës për punonjësit e bujqësisë janë,

si në favor të punës, ashtu edhe të vetë punonjësve të bujqësisë. Këto përmirësime e garantojnë më mirë nivelin e jetesës së punonjësve të bujqësisë dhe duhet t'i japin një shtytje të mëtejshme zhvillimit e shtimit të prodhimit, forcimit të bujqësisë sonë socialiste. Ato nuk duhet të interpretohen si ndryshime në sistemin tonë të pagave dhe të ligjit të shpërblimit sipas punës. Këto kanë rëndësi të kuptohen drejt nga të gjithë, se mund të ketë edhe njerëz që të thonë: «Dale, se për këtë çështje u mor një vendim tjetër në Byronë Politike».

E kemi thënë edhe herë të tjera se problemet financiare kanë rëndësi shumë të madhe, prandaj ju, shoqja Themije, ta keni parasysh atë që ngriti këtu shoku Niko Gjyzari¹, se mund të ngjasë ndonjë rast që shpenzimet të jenë të mëdha dhe të mos harmonizohen me prodhimin. Kjo nuk mund të thuhet në mënyrë kategorike, por ka jo pak raste kur shpenzimet e prodhimit bëhen pa kriter. Prandaj, këtë mos e harro! Kjo është e para.

Çështja tjetër është që ju duhet të studioni me kujdes problemin e investimeve, që këto të mos bëhen në mënyrë globale, sepse mund të ndodhë që kooperative ka një territor të caktuar dhe nuk mund të bëjë dot aq investime sa i caktohen. Po ashtu të mos bëhen shpenzime për shpenzime. Atëherë, ç'do të bëhen fondet që teprojnë, t'ua ndajmë anëtarëve të kësaj kooperative dhe të krijojmë diferenca të mëdha me simotrat e saj e të ushqehet kështu ndjenja e interesit personal?

1. Në atë kohë zëvendësministër i Financave.

Jo, në këtë rast duhen gjetur mënyra të tjera se si të harxhohen këto fonde. Le të vijë kjo situatë, pa rruget se si të përdoren këto në favor të zhvillimit të kooperativave dhe të ngritjes së nivelit material e kulturor të kooperativistëve është më e lehtë të gjenden.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

BLLOKADA NUK VARET NGA NE, POR FITORJA MBI TË VARET PLOTËSISHT NGA NE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

23 maj 1978

Tregtia me jashtë na ka preokupuar vazhdimisht dhe vazhdimisht duhet të na preokupojë.

Kjo tregti varet nga dy faktorë: nga faktori i brendshëm dhe nga ai i jashtëmi. I pari është plotësisht në dorën dhe në vullnetin tonë; të dytin e influencën dhe mund ta influencojë deri në një shkallë i pari, por ky faktor nuk varet vetëm nga ne. Tregtia me jashtë mund të ketë stabilitet relativ, mund të ketë lëkundje të mëdha, mund të fitohen e të ruhen tregje të reja, por edhe të humbasin e të rifitohen tregje të vjetra. Tregtia jonë me vende kapitalisto-revizioniste, është kurdoherë koniunkturale: çmimet dhe transaksionet

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth studimit «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për shtimin e eksportit dhe përmirësimin e bilancit të të ardhurave e të shpenzimeve në valutë, veçanërisht në devizë të lirë dhe rritjen e leverdishmërisë në eksport».

varen nga oferta dhe kërkesa, nga politika dhe nga shumë probleme të tjera të ekonomisë sonë socialiste, që konfrontohen me ato të ekonomisë kapitaliste.

Prandaj, me aq sa kuptoj unë, u këshilloj shokëve të tregtisë së jashtme që nuk mund të jetë kurrë e mjaftueshme njohja e koniunkturave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Këto kanë rëndësi, por do të kuptohen dhe do të manipulohen në favorin tonë, në qoftë se njohin, dhe duhet t'i vihen punës për të njohur sa më mirë, ligjet e ekonomisë socialiste dhe të asaj kapitaliste. Kjo është detyrë e domosdoshme edhe për të gjithë njerëzit e ekonomisë sonë, të çdo dege dhe sektori. Kjo është një armë që cilido duhet të bëjë përpjekje ta zotërojë, pse nuk është vetëm për atë që blen e shet, por sidomos edhe për atë që prodhon.

Prandaj, problemet e tregtisë së jashtme, shtimi i eksportit dhe pakësimi i importit duhet të merren më mirë në dorë nga të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, nga ato të tregtisë dhe, mbi të gjitha, nga Partia në të tëra hallkat.

Është e domosdoshme të kuptohet thellë nga të gjithë se më parë duhet të shesësh që të bleësh mallrat e nevojshme për zhvillimin e ekonomisë sonë; duhet të prodhosh mallra të mira që të ecë si duhet shkëmbimi. Që të bleësh sa më shumë, është e domosdoshme të prodhosh sa më shumë, me cilësi sa më të lartë e me kosto sa më të lirë. Tregtia gjithashtu duhet të bëjë përpjekje që të blejë jashtë mallra sa më të mira dhe me çmime sa më të lira. Këto janë ligje të ekonomisë që, po s'i pate parasysh në prodhim dhe në marrëdhëniet e tregtisë, asgjë nuk mund të ecë si duhet.

Për çka shpreha më sipër, të gjithë duhet të mendojmë bllokadën. Në qoftë se bllokada nuk varet nga ne, çarja e saj dhe fitorja mbi të varen plotësisht nga ne. Prandaj, të gjithë, i madh e i vogël, në Parti dhe në shtet, duhet të thellohen mirë në situatat në të cilat zhvillohen ekonomia jonë socialiste dhe ekonomia botërore kapitalisto-revizioniste. Dihet mirë që kjo e fundit është në një krizë shumë të rëndë dhe po thellohet në kthcsën që ka bërë drejt një industrie lufte.

Të mos harrojmë asnjëherë, përkundrazi, vazhdimisht të bëjmë përpjekje për arritjen e balancimit me forcat tona të import-eksportit dhe të shihen rezultatet konkrete në këtë tregues. Ky është një problem imperativ në rrethanat aktuale. Po e nënvleftësuam atë, do të na ndodhin ngjarje të rënda në ekonomi dhe në politikë. Njerëzit e Partisë, ekonomistët, me tema të veçanta dhe konkrete, duhet t'u shpjegojnë punonjësve rrjedhimet e mosrealizimeve të planeve në sasi, në cilësi, në kosto dhe në kohën e caktuar. Shumë njerëz, deri edhe drejtues partie dhe ekonomie, ose nuk i shohin qartë ose nuk i vlerësojnë drejt këto probleme të ekonomisë, të cilat nuk zgjidhen vetëm duke bërë autokritikë. Ligjet e ekonomisë bëjnë të tyren: po nuk prodhove, s'ke të hash! Kritika e autokritika të shkundin, por prapë duhet të prodhosh që të hash.

Neve na duhet t'i shtojmë shumë mallrat që prodhojmë, qoftë ato industriale, ashtu edhe ato bujqësore e blegtorale, për plotësimin e nevojave të popullit. Por, situatat na detyrojnë të shtojmë njëkohësisht sa më shumë edhe eksportin. Në këtë shikim të kemi parasysh edhe sakrificat që duhet të bëjmë. Krijimi i bollëkut

i minimizon sakrificat dhe na jep mundësi të zhvillojmë forcat prodhuese, si me prodhimet e vendit, ashtu edhe me ato që duhet të importojmë.

Me këto që thashë kuptohet pra se ç'rëndësi të madhe ka për ne zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor për problemet e mëdha aktuale dhe ato të perspektivës. Por, në asnjë mënyrë të mos nënvleftësohet revolucioni tekniko-shkencor në fabrika, në uzina, në ara, kudo ku punohet dhe prodhohet çdo ditë. E theksoj këtë se nganjëherë na rrëmbejnë disa punë, rutina, kurse të tjerat i lëmë në harresë. Ekonomia jonë socialiste, aktualisht ka nevojë të madhe për transformime moderne të teknologjisë, që të arrijë të prodhojë më shumë, më mirë, më lirë, dhe me rendiment më të madh. Këto transformime mund të arrihen vetëm përmes revolucionit tekniko-shkencor masiv, me forcat dhe, kryesisht, me mjetet tona.

Unë jam dakord me raportin dhe mendoj se ne mund të bëjmë tregti me shumë vende, por duhet të shohim, të njohim dhe të vlerësojmë pengesat që i krijojmë vetë. Mallrat tona shpesh janë të dobëta për nga cilësia. Kjo sjell atë që këto mallra të mos u përgjigjen kurdoherë kërkesave të tregjeve botërore. Cilësia e dobët e mallrave për eksport vjen ngaqë bëhet shumë pak kujdes, nuk ngulet këmbë dhe nuk ushtrohet si duhet kontroll për të përmirësuar teknologjinë e prodhimit të mallrave dhe ambalazhimin e tyre. Prandaj për të rritur eksportin është e domosdoshme që, në radhë të parë, të përmirësohet cilësia e prodhimeve tona; në radhë të dytë të realizohet asortimenti i kërkuar dhe, në radhë të tretë, të përmirësohet në mënyrë të

ndjeshme ambalazhi. Ambalazhi ka rëndësi, dhe jo ashtu siç e paraqiste Kiço Ngjela, se ne nuk shesim ambalazh por mallra. Për shembull, ambalazhi i cigareve ka rëndësi, por kualiteti i tyre, sipas mendimit tim, ka akoma më shumë rëndësi, aq më tepër për vendin tonë që bën tregti korrekte.

Është e vërtetë se tregtia me vendet tradicionale na ka lënë prapa në kërkesat ndaj cilësisë së mallrave tona. Nga vendet revizioniste, mallrat ose na bliheshin me çmime të ulëta e me humbje për ne, ose na dukej sikur nuk kishim humbje, pse ata na jepnin disa kredi, me të cilat kërkonin të na lidhnin duart. Në ato vite, kur bënim tregti me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e ish-demokracive popullore, as na shkonte në mendje të bënim tregti me vende të tjera. Megjithëse ato na i merrnin të gjitha mallrat me çmime që i caktonin vetë, neve na dukej krim të bënim tregti me vende të tjera. Por, edhe ata s'na linin, se, meqë kishim detyrime ndaj tyre, na bënë presione e s'na furnizonin. Kufizimin e marrëdhënieve tregtare vetëm me këto vende ne e konsideronim si një çështje politike, mirëpo kjo na la prapa në përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të mallrave të eksportit dhe një prapambetje e tillë e theksuar vazhdon të na pengojë edhe sot. Në disa degë të prodhimit, teknologjia jonë është e vjetër dhe ne absolutisht duhet ta përmirësojmë, se ta përmbysim fare, s'kemi mundësi.

Lidhur me këto probleme duhet të mbahet mirë parasysh edhe rrethimi kapitalisto-revizionist, sepse ka raste që ai nuk vlerësohet si duhet dhe nuk kuptohet

se pikërisht me tregtinë e jashtme duhet të bëjmë që të çahet ky rrethim.

Aktualisht, që tregtia me shtetet e ndryshme të ecë mirë dhe të jetë rentable, është e domosdoshme që të prodhojmë mallra me kualitet të lartë dhe me standardet që kërkohen, ndryshe tregu kapitalist ose nuk gjendet, ose gjendet me zor, ose ai do të jetë i paqëndrueshëm. Këtu luan rol jo vetëm cilësia e mallit, çmimi i tij, por dhe politika e shteteve të tjera ndaj vendit tonë. Mallrat e mira t'i merr kushdo dhe ne mund t'i reklamojmë ato me çmime edhe më të larta nga çmimet ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, kur ke në dorë mallra për të qenë, ke prova të forta për diskutim me të huajt.

Ku qëndron pra, në radhë të parë, ilaçi i kapërcimit të kësaj gjendjeje? Ilaçi gjendet në vend, atë e kemi vetë në dorë. Prandaj vetë të mendojmë, të vrasim mendjen dhe të marrim masa urgjente, radikale që ta ndryshojmë krejt gjendjen aktuale. Por me frymë të shenjtë kjo nuk mund të ndryshojë; as vetëm duke thënë «duhet», por të veprohet konkretisht. Marrja e masave të jetë radikale; t'u vemi problemeve deri në fund dhe të kontrollojmë vazhdimisht zbatimin e detyrave. Vetëm kur të jenë realizuar të gjitha këto, mund të themi se është siguruar shitja e mallrave tona në tregjet botërore me lehtësi e me çmime ndërkombëtare të larta, krijimi i tregjeve stabil dhe përballimi i konkurrencës së huaj ndaj mallrave tona, domethënë zgjerimi i tregjeve.

Kjo duhet të jetë rruga jonë në tregtinë e jashtme; ky duhet të jetë synimi ynë. Këta objektiva nuk arri-

hen pa përpjekje të mëdha, domethënë pa marrje masash, pa bërë disa shpenzime paraprake. Por, po t'i vëmë në balancë shpenzimet dhe humbjet nga mosshitja e mallit, nga ngadalësimi i shitjes, nga qëndrimi në depo, nga prodhimi me cilësi të dobët, nga çmimet e ulëta të ofertës, nga vështirësitë që i krijohen ekonomisë etj., këto do të na dalin shumë e shumë më të mëdha.

Në raport thuhet se eksporti i kromit, për të cilin folën edhe shokët, zë një vend të rëndësishëm në krahësim me mineralet e tjera. Ç'masa kemi marrë ne për këtë mall me vlerë edhe si sasi, edhe si cilësi? Shumë pak. Kromi ynë shpesh është me cilësi të dobët, shitet me zor dhe mjaft lirë. Në këtë drejtim ka shumë luhatje. Po për fajin e kujt? Sigurisht për fajin tonë. Sipas raportit, që nga miniera deri në port, kromi pëson 4 për qind humbje të cilësisë, gjë që po të evitohet, çmimi i tij do të rritej 10 për qind. Masat për ta përmirësuar këtë gjendje janë plotësisht të mundshme për t'i realizuar, se nuk duhet asnjë teknologji e veçantë. Por me sa shoh nga raporti që lexova del se nuk u është shkuar problemeve deri në fund e se atyre nuk u është dhënë zgjidhja e plotë. Prandaj Qeveria duhet të marrë të gjitha masat, të gjejë përgjegjësitë dhe kjo plagë të shërohet sa më parë.

Hekur-nikelin, në rast se nuk gjendet treg gjetkë, të vazhdojmë ta shesim në tregjet që kishim, por, natyrisht, duke diskutuar çmimet. Hëpërhë, ekonomia jonë ka nevojë për eksportimin e këtij minerali, prandaj të mos e humbasim tregun.

Për bakrin ne nuk ndjekim këmba-këmbës kërke-

sat e tregut të jashtëm e, megjithëse kemi specialistë që e njohin edhe teknologjinë e telit të hollë, nuk luftojmë për zgjerimin e asortimenteve që kërkohen. Ecet si kali i arabasë; qëndrojmë në një teknologji, në disa asortimente me standard të vjetër dhe nuk çajmë, nuk vrasim mendjen. Kjo nuk na ndodh vetëm në uzinën e telave të bakrit, por në të gjitha fabrikat dhe kombinatet tona që prodhojnë mallra edhe për eksport. Ky është një problem i madh që lidhet me revolucionin tekniko-shkencor, që nga krijimi dhe vendosja e teknologjisë së përparuar në fabrikat e mëdha dhe deri tek ato të voglat që prodhojnë vegla ndërrimi.

Për kombinatin metalurgjik e për perspektivën e madhe të siderurgjisë sonë kam folur edhe herë tjetër, prandaj sot nuk do të zgjatem. Këtu do të them vetëm se ky problem është një nga më të rëndësishmit e ekonomisë sonë, por është edhe më i komplikuari dhe që lyp vazhdimisht studime krijuese serioze jo vetëm për hekur-nikelin, por edhe për mineralet e tjera. Nuk duhet të kënaqemi me teknologjinë ekzistuese. Mos-ecja përpara është shumë e rrezikshme, po aq sa është e rrezikshme edhe kur thuhet: «S'e bëjmë dot vetë», ose «ta sjellim nga jashtë», pa e vrarë një herë mendjen nëse i kemi apo jo mundësitë për ta bërë e për ta prodhuar vetë këtë apo atë gjë.

Për sa i përket duhanit dhe cigareve folën edhe shokët. U kemi krijuar shumë leverdi kooperativistëve me kualitetet e duhanit. Po kështu edhe për manipulimin e tij. Shitja e duhanit dhe e cigareve, jashtë dhe brenda, duhet të na nxjerrë me fitime për shtetin. Paketimi, më duket mua, nuk është i keq, por e keqe është

cilësia e duhanit brenda cigares dhe që s'ka stabilitet në gusto. Cigarja është helm, është tym, por ja që çdo hundë kërkon tymin e vet, si me thënë. Te ne ngjyra e paketave është e ndryshme, e bukur, kurse shpeshherë duhani brenda është me cilësi të dobët. Prandaj, në tregjet jashtë, këto lloj cigaresh ose blihen me zor, ose blihen lirë, ose nuk blihen fare. Prodhimi i duhanit dhe i cigareve kërkon mjeshtëri të madhe, prandaj nuk mund të shkohet duke thënë: «Bëjmë ç'të bëjmë dhe ti, tregti, duhet të na i shesësh».

Prodhimet bujqësore tërhiqen, se bota kapitaliste ka shumë nevojë për to. Por, edhe për këto duhet të ketë nga prodhuesit tanë më shumë ekzigjenca të cilat të kihen mirë parasysh, sidomos cilësia dhe ambalazhi, në qoftë se duam të eksportojmë.

Edhe mallrat që prodhojnë industria dhe artizanati ynë, duhet të jenë të kualitetit të lartë. Ne marrim vajza të reja në ndërmarrjet e prodhimit të veshjeve, se duhet t'i futim në punë. Por, po nuk u bënë konfeksionet të mira, s't'i blen tregtari i huaj dhe atëherë të mbeten në depo. Kështu mund të themi edhe për qilimat dhe për mallrat e tjera të artizanatit. Merr ndërmarrja artistike «Migjeni» punëtore, por depot, ama, na mbushen me mallra të cilave s'u gjejmë treg, kurse pagesat dhe shpenzimet bëhen. Ç'është kjo? Një fjalë e urtë thotë: «Nuk mund të kënaqim edhe dhinë, edhe lakrën». Mund të duken si gjëra të vogla, por po t'i mbledhësh të gjitha këto «të vogla», atëherë të del e madhja që po diskutojmë tani këtu, në Byronë Politike.

Njohja e tregut ndërkombëtar dhe e koniunkturës

së çmimeve është një domosdoshmëri imperative për tregtinë e jashtme. Asnjëherë të mos mendohet se kjo mund të arrihet lehtë dhe mirë, në çdo periudhë e për çdo vend veças. Pretendime të tilla nuk duhet të kemi, pse edhe mjetet i kemi të kufizuara. Por, për disa mallra me vlerë duhet të jemi shumë më të vëmendshëm. Mbi të gjitha, malli që ofrojmë duhet të jetë i mirë dhe, po qe kështu, ai hyn edhe në vrimën e gjilpërës.

Siç e thashë edhe më lart, disa herë ecim si kuajt e arabasë. Përse prodhojmë batanije e mallra të tjera me humbje, siç thuhet në raport, dhe nuk ndryshojmë drejtimin e prodhimit? Kjo është një rutinë e burokratizëm me shumë zarar. «Unë vazhdoj të prodhoj, të mbush depot me mallra, pavarësisht se këto nuk më shiten, ose më shiten me humbje. Për këtë mua aq më bën, planin për vete e realizova. Fajin këtu e ka tregtia që nuk gjen treg», thonë disa nga prodhuesit tanë. Kjo rutinë, shokë, duhet luftuar. Ky mentalitet i sëmurë dhe i dëmshëm duhet të shërohet me doemos. Dikasteret të bashkëpunojnë ngushtë midis tyre; prodhuesit të kenë lidhje me shitësit dhe me konsumatorët, të brendshëm dhe të jashtëm, nëpërmjet Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe asaj të Brendshme. Te ne prodhohet për të shitur dhe për të konsumuar.

Që duhet të hiqen nga importi shumë mallra, të cilat kemi mundësi t'i prodhojmë në vend, kjo është absolutisht e domosdoshme, ndryshe jo vetëm do të kemi humbje financiare dhe humbje kohe, por nuk do të zhvillohen as mjetet e prodhimit. Nuk është hera e parë që ne e shtrojmë këtë problem dhe duhet thënë se nuk kemi qëndruar në dëshirën e kërkuarve. Por

asnjë nga kërkuesit nuk e ka zbatuar heqjen dorë nga importi me dashje; atyre u është imponuar kjo gjë nga Qeveria. Kërkuesi mezi ka marrë masat që t'i zëvendësojë këto mallra duke i prodhuar ato në vend. Por masat në përgjithësi janë tepër të çala; nganjëherë ato s'janë marrë fare, kështu që ose janë ngrënë rezervat, ose nuk janë realizuar planet.

Kjo sëmundje e rrezikshme vazhdon. Ministritë, ndërmarrjet dhe shtabet e tyre nuk para mendojnë gjatë, nuk i dalin punës përpara, nuk parashikojnë nevojat dhe t'i thonë vetes «të organizojmë punën dhe t'i prodhojmë vetë me domosdo këto e ato gjëra!». Ja, këtu, në Byronë Politike jemi dhe unë vë pyetjen: «Do ta pranojmë ne këtë mënyrë veprimi apo jo?». Në rast se veprohet kështu, atëherë zbatohet si duhet vija e Partisë, në rastin e kundërt dëmtohet ekonomia dhe vija e Partisë nuk zbatohet.

Sipas tabelës që na jepet, del se kemi lidhje tregtare me mbi 40 vende. Nuk është keq, por nuk di si i trajtojmë këto vende në tregti! Ky është një problem që duhet studiuar thellë. Të mos kërkujmë kallëz në borë dhe të mos vazhdojmë të kërkujmë e të kërkujmë tregje, pa punuar për t'i thelluar dhe për t'i zgjeruar më tej këto tregje që kemi, të cilat, sipas mendimit tim, s'janë pak si numër. Megjithatë aspak nuk them që të mos i shtojmë.

Të gjithë të keni të qartë një gjë: vendet me të cilat zhvillojmë tregti janë të tëra kapitalisto-revizioniste prandaj në asnjë mënyrë nuk duhet të bëjmë lëshime. Ne do të bëjmë tregti reciproke të leverdishme, duke synuar në import çmimet më të ulëta, mali-

rat më të mira, distancat më të shkurtra, sigurinë e «seriozitetin» e shtetit borgjez dhe të ndër marrjeve dhe në eksport çmime të larta e korrektësi.

Në këto kushte duhet të ruajmë traditat e krijuara në tregtinë me disa shtete. Me sa po shoh në tabelë, këto vitet e fundit import-eksporti me disa nga këto vende është ulur. Unë mendoj se ai duhet të vijë në të kundërtën, duke u ngritur, natyrisht, duke kërkuar që edhe këto vende të jenë korrekte në tregtinë me ne; edhe ne, po ashtu, të jemi korrektë ndaj tyre. Ne, si kurdoherë, do të qëndrojmë të patundur në parime dhe nuk do ta ulim asnjë grimë luftën ideologjike kundër tyre. Me përjashtim të Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me të cilët nuk duhet të bëjmë asnjë tregti, me të gjitha shtetet e tjera, ne duhet të bëjmë dhe bile ta zgjerojmë atë.

Natyrisht, kliringu zë vendin kryesor në tregtinë tonë me jashtë, por duhet të luftojmë për shitje edhe me devizë të lirë.

Për sa i përket rezervës së devizës së lirë, atë ne duhet ta shtojmë çdo vit. Qeveria të jetë shumë, shumë e shtrënguar dhe të mbajë përgjegjësi të plotë për çdo lëshim të papeshuar mirë. Ne jemi një vend i vogël dhe s'dimë se ç'kohë të këqija mund të na vijnë. Prandaj të luftohet që sa më shumë blerje nga ana jonë të përballohen me kliring, kurse deviza të ruhet dhe të përdoret për ato mjete shumë të nevojshme për zhvillimin e forcave tona prodhuese që s'i blejmë dot me kliring dhe për ato raste kur kjo nuk është e mundur të bëhet.

Siç e dimë, kredi s'marrim as nga ndonjë anë.

Këtë e kemi të ndaluar me Kushtetutë. Unë mendoj se Kina nuk do t'i plotësojë angazhimet që ka ndaj nesh. Prandaj tani e në të ardhmen çdo gjë do ta bëjmë tërësisht me forcat tona. Kjo kërkon të mobilizohemi si në çdo sektor, edhe në tregti, sepse vetëm kështu do të kapërcejmë vështirësitë që na dalin dhe do të ecim përpara.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

TËRË PROCESI I PUNËS ME TË RINJTE ËSHTË KURDOHERË PROCES EDUKATIV

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 maj 1978

Problemet që diskutojmë kanë të bëjnë shumë edhe me rolin që luajnë dhe me punën edukative që bëjnë bashkimet profesionale dhe organizata e rinisë, si dhe nga marrëdhëniet që kanë këto organizata me organet shtetërore. Të marrim një çështje konkrete. Këtu u tha se ka raste që, kur drejtori pushon punëtorin nga puna dhe ai ankohet te shokët e bashkimeve profesionale ndodh që këta, t'i thonë: «Hidhe në gjyq drejtorin!». Kam mendimin që për t'u orientuar drejt të kemi parasysh mësimet e Leninit për rolin e bashkimeve profesionale.

Lenini thotë që bashkimet profesionale duhet të mbrojnë interesat e punëtorëve ndaj të metave të ad-

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën e organizatave-bazë të Partisë, të organeve shtetërore, ekonomike dhe të drejtësisë, në luftën preventive për uljen e shfaqjeve të kriminalitetit.

ministratës, ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, ndaj burokracisë. Po a keni hyrë ju¹ ndonjëherë në konflikte me administratat? Një gjë e tillë nuk do të thotë të bëni greva, jo, se te ne nuk ka bazë ekonomike dhe politike për të bërë greva. Por fjala është që ju të ngrini zërin atje ku duhet. Ja, këtu në aparatën e Komitetit Qendror konkretisht, me sa di unë, ju nuk keni ardhur ndonjëherë dhe të thoni, fjala vjen: «Ne jemi në kundërshtim me administratën e kombinatit të tekstileve «Stalin» për këtë apo atë arsye». E them këtë sepse duke mos ardhur ju te ne, konkluzioni që nxjerr unë, për shembull, është se, sipas jush, për konfliktet në ndërmarrje, ata të administratës nuk kanë asnjë faj, që nga drejtori deri te kryeinxhinieri; të gjithë, pra, janë në rregull me ligjet!

Unë kam bindjen se kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Prandaj ju pyes: «Sa është lexuar Lenini nga shokët e organizatës së bashkimeve profesionale dhe si zbatohen mësimet e tij në trajtimin e problemeve të ndryshme?». Mua më duket se drejtuesit e kësaj organizate nuk thellohen përherë sa duhet në ato çka thotë ai për rolin që duhet të luajnë bashkimet profesionale. Unë mund ta kem edhe gabim, por gjithë këto gjyqe dhe pafajësi që marrin punëtorët, a nuk tregojnë pikërisht mangësi në punën e tyre? Ndaj, këto gjëra duhen parë me kujdes! Shokët e bashkimeve profesionale duhet të thellohen më shumë në zgjidhjen e konflikteve, të punojnë me durim e pjekuri me punëtorët

1. U drejtohet shokëve të Këshillit Qendror të BPSII, të ftuar në këtë mbledhje.

dhe jo menjëherë t'u thonë: «Hidhe në gjyq drejtorin!», pavarësisht se ai e ka këtë të drejtë për ta hedhur në gjyq. Fakt është se në zgjidhjen e këtyre konflikteve ka edhe burokratizëm.

Por çështja shtrohet se si duhet ta kuptojmë këtë burokratizëm. Këtu e kam fjalën dhe unë. Ç'do të thotë burokratizëm? Një gjë e tillë nuk do të thotë gjithmonë që të mbulojnë letrat. Por burokratizëm ka edhe kur administrata e ndërmarrjes në aktivitetin e saj nuk është në rregull me materialet, me rrogat, me normat e me të gjitha. Në materialin që na paraqitet është theksuar se nga disa administrata ka imponim që të veprohet edhe jashtë ligjeve. Edhe kjo është burokratizëm.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI¹: Ka shumë raste pajtimi midis komiteve profesionale dhe drejtuesve e administratës të ndërmarrjeve.

SHOKU ENVER HOXHA: Pajtim në drejtësi, apo në padrejtësi?

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Ka pajtime edhe në padrejtësi, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, ka edhe të tillë që tërhiqen e nuk e ngrenë zërin, megjithëse vënë re padrejtësi nga ana e drejtorit. Se, siç the ti, Sotir, duan të ruajnë vendin e punës që kanë. Kjo është e dëmshme.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Ka dhe raste të tjera që nga mungesa e organizimit të brendshëm nuk realizohen normat. Ja një shembull: në Ndërmarrjen e Punimit të Sixhadeve në Tiranë, nga mungesa e lëndës së

1. Në atë kohë, sekretar i Këshillit Qendror të EPSH.

parë, për disa ditë me radhë, nga tre veta që duhet të punojnë në një avlëmend, futen gjashtë.

SHOKU RAMIZ ALIA: Përgjithësisht, ka shumë çrregullime që vijnë nga mungesa e lëndës së parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, një arsye është edhe mungesa e materialit, e lëndës së parë. Po nga ana juaj si Bashkime Profesionale a ngrihet zëri pse nuk i vjen leshi ndërmarrjes? Sido që të jetë, ju duhet ta ndiqni çështjen deri në fund.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Kemi vajtur deri në ministri, në drejtorinë përkatëse.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, more shok, pse nuk na bëni ju një raport të tillë, duke na i paraqitur dhe duke i trajtuar problemet kështu, siç po na i thoni tani, që ne të dimë si t'u kërkojmë llogari shokëve të Qeverisë, për këto gjëra, por na paraqitni një raport standard? A do t'i vëmë në vend këto? Ju thoni se keni vajtur te filan ministër e i keni thënë këtë e këtë, por gjendja përsëri vazhdon të jetë po ajo.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Ne e kemi çuar problemin edhe deri te ministrat.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju jeni munduar, po, kur ministri nuk ua vë veshin ligjeve të shtetit, atëherë, e bën Komiteti Qendror që t'ua vërë veshin atyre. Ndryshe, nuk mund të ecet. Që punëtori të punojë dhe ai i administratës të mos luftojë si duhet, për ta furnizuar atë me materialet e nevojshme etj. e për vete ta marrë rrogën tamam, kjo nuk është e drejtë.

Pra, e theksoj edhe një herë se për këto probleme ne duam raporte me analiza konkrete dhe jo raporte standarde.

Po të pyes ty, Sotir. A bëhen përgjithësisht nga shokët në rrethe e pastaj edhe nga ju në qendër për ato probleme që dalin nga ballafaqimi i organizatës së bashkimeve profesionale me aparatet e ndërmarrjeve? A bëhen problem ato konkluzione që nxirren dhe mbasandaj të merret mendimi se si duhet shtruar kjo ose ajo çështje? Partia, natyrisht, punon edhe vetë me aparatet e saj për zgjidhjen e drejtë të problemeve të shumta që dalin. Këtë ti e di mirë, se ke qenë sekretar komiteti partie. Por unë e kam fjalën për punën e bashkimeve profesionale. Pra, bëni ju, brenda kompetencave tuaja, gjëra të tilla?

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Po, bëjmë. Po flas vetëm për një rast. Në Elbasan ne kryem një studim të gjerë të këtyre çështjeve në muajin nëntor. Për këtë organizuam edhe një aktiv të gjerë, ku i ngritëm problemet që kishin dalë në atë rreth. Për këtë informuam edhe Presidiumin e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale. Pas dy javësh po për këtë çështje ne bëmë një mbledhje me të gjithë kryetarët e bashkimeve profesionale të rretheve të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Mund të më thuash vetëm nja dy probleme të rëndësishme që kanë qenë më shqetësuese për ju, për të parë karakterin e tyre.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Problem shumë të madh kemi pasur disiplinën.

SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë, meqenëse disiplina ka qenë një problem shqetësues për ju, mund të më thuash se cilat janë shkaqet e thyerjes së saj dhe deri në ç'shka të arrin kjo? Se, që të mos ketë thyerje disipline fare, tani për tani, kjo është e pa-

mundur. Ka raste që edhe anëtarë partie e thyejnë disiplinën. Ky nuk është një fenomen i përgjithshëm, por, kur ndodhin të tilla raste, pse shkaktohen ato?

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Në radhë të parë se nuk është në shkallën e duhur kontrolli për zbatimin e disiplinës. Ja një shembull konkret: vajtëm në Ndërmarrjen e Gomës në Durrës fiks në orën shtatë. Atë ditë rreth gjashtëdhjetë e ca veta erdhën me vonësë. Kontrolli që u bë atë ditë, siç na thanë shokët e ndërmarrjes, pati efekt të madh. Por, shtuan ata, ndodh që kalon një muaj e fillojnë përsëri vonesat. Prandaj kontrolli duhet të jetë i vazhdueshëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu duhet bërë, të ushtrohet kontroll vazhdimisht. Edhe Partia ta shikojë këtë punë. Një herë mund t'i ndodhë kujt do që të vonohet. Por, kur vonesa në punë përsëritet, atëherë duhet të merren masa, t'u pritët edhe rroga. Pse atij punëtorit që ikën nga puna ne ia presim rrogën dhe këtij jo? Në të dy rastet duhet vepruar njëjloj. Nuk është e ligjshme të veprohet ndryshe.

Po tjetër arsye, shoku Sotir, për mosplotësimin e normës ka?

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Arsye tjetër është mungesa e kualifikimit. Ka shumë raste që punëtori i kategorisë së parë punon në vend pune të kategorisë së tretë, të katërt, bile dhe të pestë. Me një ose dy vjet punë punëtori merr sa ai që ka 15 vjet në atë profesion.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne këtu, në Byronë Politike, kemi tre apo katër vjet që kemi marrë një vendim për atestimin e punëtorëve dhe të specialistëve

dhe për shpërblimin e tyre. Prandaj, pa merreni një çikë vendimin e Byrosë Politike dhe shikojeni! Në atë mbledhje ne kemi caktuar që brenda tre-katër vjetësh të përfundojë kjo punë. Atëherë pse nuk është zbatuar kjo? Kush do ta kontrollojë zbatimin e këtij apo të atij vendimi që merret këtu? Për këtë problem që po diskutojmë duhet punuar që të zgjidhet, se ky po na nxjerr kaq e kaq shqetësime jo vetëm në ekonomi, po edhe në ndërgjegjen e njerëzve. Veçse, edhe ju drejtuesit e Bashkimeve Profesionale nuk ju kemi parë të vini e të na thoni: «Vendimi që ka marrë Byroja Politike për atestimin e punëtorëve nuk po zbatohet siç duhet, prandaj të shikohet kjo çështje». Ndoshta duhet të formulohet një ligj për këtë. Patjetër duhet të bëhet kjo, se ne po shkojmë me mendje që problemi për të cilin kemi marrë vendim po ecën si duhet.

Kjo është një gjë me rëndësi, prandaj dhe e kemi ngritur. Atestimet duhet të merren si duhet, jo sa për t'u marrë, pa punuar, pa derdhur djersë, por vetëm kur ta meritojnë.

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Për sa i përket disiplinës, desha të shtoj edhe diçka. Te ne nuk është arritur akoma që të punohet një për një me secilin punëtor që thyen disiplinën, aq më tepër kur gati 85 për qind e të gjitha thyerjeve disiplinore janë nga punëtorët e rinj. Me këta nuk punohet me durim, megjithëse kemi organizuar edhe patronazh, duke i caktuar pranë punëtorëve më të vjetër, më të mirë e më të ndërgjegjshëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Organizimi i patronazhit në fabrika e në uzina, pra i caktimit të punëtorëve

më të mirë, me stazh të gjatë, me punëtorët e rinj, është e do të jetë një nga format kryesore të punës sonë nëse duam të bëjmë një politikë edukative të thelluar e të specifikuar me njerëzit. Unë mendoj se kjo jep dhe duhet të ketë dhënë rezultate. E konstatooni ju një gjë të tillë, atje ku janë ngritur këto patronazhe e që funksionojnë rregullisht? A keni shembuj të mirë që mund të na i vini në dukje?

SHOKU SOTIR KOÇOLLARI: Ja një shembull: Uzina Mekanike e Gjeologjisë e Tiranës ka pasur 35 punëtorë të ndarë në grupe patronazhi. Unë kam vajtur edhe vetë dhe i kam ndjekur një për një, me emra, se si ka ndikuar te punëtorët e rinj patronazhi i më të vjetërve.

SHOKU ENVER HOXHA: Mua më kënaq ti, Sotir, me mënyrën se si i shtron dhe se si i trajton problemet që preokupojnë organizatën e bashkimeve profesionale. Ti i njeh këto probleme, por, si djalë proletari që je, futju më me zjarr punës për zgjidhjen e tyre.

Jam dakord me ato që u thanë këtu në lidhje me punën që bëhet nëpërmjet patronazhit në uzinë. Sigurisht, për të pasur rezultate, rëndësi ka edhe takti i mjeshtrit, durimi e këmbëngulja e tij në punën me ndonjë punëtor të ri e të padisiplinuar. Mirë, në uzinë punohet, po jashtë ç'bëhet? Organizata e rinisë a e ndjek punën dhe aktivitetin e këtij të riu edhe jashtë pune, për shembull, në lagje? Pra ju e keni marrë në patronazh në uzinë, po kur i riu del nga uzina duhet ta marrë organizata e rinisë atje. Po a bëhet një punë e tillë? Këtë mund të na e thonë shokët, por të flasim një çikë konkretisht.

Mirë, ne e kemi parasysh punën e lavdërueshme të pensionistëve, por unë e kam merakun tek organizata e rinisë. Pra, pse të mos vejë, për shembull, një nga organizata e rinisë te prindërit e atij të riu që është bërë problem, po vete pensionisti?

Të rinjtë e qendrës së punës mund të shkojnë në shtëpitë e punëtorëve të rinj e të shikojnë se si aktivizohen e si sillen këta në lagje dhe, në përshtatje me këtë organizata e rinisë e qendrës së punës të ndërtojë punën. Na treguat një rast që prindi i një punëtori jo të disiplinuar thotë se në lagje djali i tij është lule. Atëherë del se ky i ri është me dy personalitete, domethënë, në uzinë sillet ndryshe dhe në lagje e në shtëpi ndryshe. Mirëpo kjo nuk është e lejueshme për të riun tonë.

Mua më shqetëson fakti se ç'do të bëjmë me ata të rinj që shkelin disiplinën, që dëmtojnë pronën socialiste etj., etj. Si duhet ta drejtojmë punën e organizatave të rinisë?

U tha se pjesa më e madhe e të rinjve me shfaqje negative janë nga ata që kanë mbaruar shkollën 8-vjeçare. Ky fakt, juve drejtuesve të organizatës së rinisë duhet t'ju tërheqë vëmendjen. Se në qoftë se duhet të ketë njerëz, me plot kuptimin e fjalës, të sjellshëm, të ndershëm, duhet të jenë pikërisht të rinjtë e kësaj moshë kaq të re, që sapo dalin nga shkolla, nga vendi ku edukohen me një psikologji me të vërtetë marksist-leniniste. Atëherë pse ka shfaqje të kriminalitetit në këtë kategori të rinjsh?

Nga mësuesit në shkollë duhet bërë një punë e kujdesshme e me plot përgjegjësi. Pse nuk bashkëpunoni

Ju shokë të Rinisë e të Bashkimeve Profesionale¹ me personelin mësimor-edukativ të shkollës? Këtë çështje ta mendoni mirë para se t'i futeni, se është një problem i përgjithshëm ky që preokupon të gjithë rininë shkollore. Roli i shkollës në edukimin e nxënësve është shumë i madh. Nga bankat e saj dalin të rinjtë që shkojnë në fronte të ndryshme të punës e të prodhimit. Prandaj ju, pasi të jeni thelluar në këtë çështje, të jeni të përgatitur mirë, të dërgoni përfaqësuesit e organizatës suaj në shkolla, në këshillin pedagogjik, të cilët të ngrenë problemet që dalin dhe të kërkojnë që mësuesit të bëjnë një punë më të mirë, plot durim e pasion për të nxjerrë nga shkolla njerëz të vlefshëm për shoqërinë tonë. Pra ju të shtroni çështjen për një punë më me përgjegjësi, që nga shkolla të mos na dalin të rinj të padisiplinuar.

Unë kam mendimin se mësuesit nuk e ndiejnë sa duhet përgjegjësinë që kanë për edukimin e nxënësve, të punëtorëve apo të kooperativistëve të ardhshëm. Ka prej tyre që mendojnë në mënyrë rutinë. Domethënë, një mësues jep matematikë, një tjetër histori e kështu me radhë të gjithë. Njëri u shpjegon si zgjidhet një ekuacion, tjetri se si kanë luftuar popujt e ndryshëm etj. Procesi i edukimit në shkollë nuk realizohet vetëm nëpërmjet mësimdhënies, por nëpërmjet gjithë punës dhe qëndrimit të mësuesit ndaj nxënësit. Mësuesi duhet, në radhë të parë, ta japë mësimin në nivel të lartë dhe në mënyrë aq të qartë, që nxënësi të fillojë dhe ta dojë atë. Së pari, ta dojë për mësimin që ia shpjegon qartë, së dyti, që ai interesohet dhe për ato çështje që

1. U drejtohet shokëve, që lshin ftuar në këtë mbledhje.

ndonjë nxënës nuk i kupton, po që ky mësues ia qartëson me një durim e ngrohtësi të atillë saqë nxënësit nuk i mërzitet as lënda, sado e vështirë të jetë, por as edhe mësuesi. Prandaj, edhe kur nxënësi gabon, kur nuk sillet mirë ose nuk përgatitet si duhet, mësuesi e qorton ashpër atë, por ai nuk ia merr për keq, përkundrazi skuqet nga turpi.

Kështu, për shembull, një i vogël që vjedh xhepat, është një fidan i ri. Është lehtë ta marrim e ta futim në shkollën e riedukimit, por e mira është që të mos arrijë puna deri atje. Të gjithë jemi të bindur që natyra e tij është e tillë që mund të ndreqet, prandaj duhet të punojmë me të duke u ndalur seriozisht në arsyet që e çojnë atë në rrugë të gabuar. Pse vjedh xhepat ai? Nuk vjedhin të tjerë, vetëm disa vjedhin. Pra, këta disa, kanë ca shkaqe, ca kërkesa, të cilat ne duhet t'i analizojmë me kujdes. Ai që vjedh mundet që ka kërkesa të tepruara për moshën e tij. Këto ne duhet t'i dimë, ndryshe nuk ia marrim dot krahët. Ai, për shembull, ka filluar të pijë cigare, por nuk ka para që të blejë. Të atit nuk i kërkon dot për një gjë të tillë. Pra, që të pijë cigare, ai diçka do të bëjë. Kështu që ne, në radhë të parë, duhet të punojmë me të për t'i mbushur mendjen të mos pijë duhan, sepse kjo e shtyn atë në veprime të tjerë të gabuara. Ose një tjetër do të vejë në kinema çdo ditë. Sigurisht, çdo ditë kush i jep atij para për qejf? Askush. Pra ai, për të plotësuar këtë kërkesë, gabon rëndë, merr rrugë të keqe.

Prandaj unë mendoj se, për t'u dalë përpara shfaqjeve të tilla, ju duhet të punoni me këta të rinj e të gjeni forma të përshtatshme pune që t'i tërhiqni nga

rruga e keqe. Nuk them se nuk e bëni këtë, por ta organizoni punën që i riu të merret me diçka, me aktivitet, me lojëra, me punë argëtuese edukative.

Në një orë mund të lozin me top; në një orë tjetër do të flasin, fjala vjen, për një libër; ndonjë ditë organizohet me ta një ekskursion në natyrë. Gjatë kësaj kohe mund të kapin edhe flutura, t'i vënë ato në kuti e të bëjnë koleksione, të cilat pastaj i çojnë në shkollë. Një herë tjetër mund të venë të mbledhin guaska etj., etj. Këto punë atyre u ngjallin interes e i bëjnë për vete.

Një ditë pashë një film që tregonte për një njeri që për 45 vjet rresht kishte mbledhur guaska deti. Po me to ai kishte bërë një muze të bukur e që është i vetmi i atij lloji në botë. Domethënë, duhet dalë nga klishtë, duhet vrarë një çikë mendja për të gjetur forma të larmishme pune për t'i edukuar dhe për t'i mësuar këta të rinj derisa të futen në punë, sepse atëherë ai është angazhuar. Puna e bën më të pjekur të riun. Veçse, kur ai vete në punë një çikë më i edukuar e më i sjellshëm, hyn edhe më lehtë në jetë. Kurse ata, të cilëve u lëshohet freri e me të cilët nuk punohet fare, bëhen problem për qendrën e punës. Janë pikërisht ata, për të cilët u fol edhe këtu, që kërcasin e ikin nga puna dy-tri ditë apo edhe pesë ditë të tëra.

Pra, me të rinjtë që mbarojnë shkollën 8-vjeçare e që nuk vazhdojnë më tej shkollën e mesme, duhet të punoni për t'i mbajtur, të lidhur me shkollën, sa të fillojnë punë.

Më kujtohet, kur isha në shkollë kishim një drejtor mjaft të mirë, që sillej me shumë takt me ne. Ai

kurrë nuk të fliste me të fortë, por edhe kur të qortonte, «të vriste si me pambuk». Prandaj kur gabonim nuk shkonim dot tek ai, jo se nuk e donim, përkundrazi e donim dhe e respektonim shumë, por kishim turp t'i dilnim përpara.

Jua tregova këtë për të theksuar se sa rëndësi ka qëndrimi dashamirës i mësuesit edhe ndaj atij nxënësi tek i cili vihen re të meta e dobësi. Është fare e lehtë t'u shpjegosh me fjalë, në lëndën e edukatës morale se ç'është sjellja e mirë, pse duhet të jesh i drejtë etj., etj., por është e vështirë t'i vësh ato në jetë.

Tërë procesi i punës me të rinjtë është kurdoherë proces edukativ. Asnjëherë nuk duhet të jetë proces shtrëngimi, administrimi, asnjëherë proces kërcënimi, por edukim me zgjuarsi, me dhembshuri.

Sot i kemi të gjitha mundësitë t'ua presim rrugën sjelljeve të pahijshme në shoqëri. Natyrisht, fenomene të tilla nuk janë të përgjithshme, po pse të na ndodhin, qofshin dhe pak raste?

Këtu u fol për grindje që kanë arritur deri në rrahje, qoftë edhe me shokë të këshillit në fshat. Por duhet parë edhe ana tjetër: mos ka prepotencë dhe arrogancë prej shokut të këshillit ndaj të tjerëve? Mos i thotë ai atij që vete të ankohet për një problem: «Hajde more, edepsëz, ik andej tutje?!» dhe, pastaj, fshatari, i prekur, i hidhet në fyt e ia kthen: «Kujt i thua edepsëz ti? Unë nuk jam i tillë. . .» Dhe puna zgjatet deri në rrahje. A ngjasin këto në popull? Po, ngjasin. Mirëpo ai tjetri dënohet dhe kështu ul figurën morale të tij. Por këtu duhet parë edhe puna e gjykatave. Ne e kemi shtruar edhe herë tjetër këtë problem. Është e domosdoshme

të shikohen dënimet që japin gjykatat e fshatrave dhe të lagjeve, se mund të ketë edhe ekzagjerime. Një gjë e tillë mund të na i ftohë njerëzit tanë me pushtetin. Gjykata, para se të japë dënimin, duhet ta studiojë mirë shkeljen që është bërë.

Tash kushtet kanë ndryshuar dhe kërkesat janë shtuar, po janë shtuar dhe mundësitë për t'i mënjanuar, për t'i larguar nga veset ata të rinj që kanë kërkesa të tepruara, jashtë mundësive të familjeve të tyre, të cilët, për t'i plotësuar ato, gabojnë rëndë.

Siç u tha këtu, nga organizata e rinisë kanë dalë të rinj vullnetarë për të punuar në fshat. Të gatshëm janë ata, por komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë në rrethe duhet të marrin masa organizative për t'u krijuar kushte sa më të mira të rinjve që lënë qytetin e shkojnë në fshat. Punën ta organizojnë si duhet, se ndryshe këta do të largohen nga fshati. Probleme, natyrisht ka, por ato të zgjidhen mirë dhe në kohë.

Këto probleme të ngrihen me forcë nga ana juaj, politikisht, ideologjikisht, shoqërisht dhe ekonomikisht. Shokëve të komiteteve ekzekutive dhe të komiteteve të Partisë të rretheve t'u thuhet që, në qoftë se nuk merrren masa nga ju për këto probleme, ne do t'i raportojmë Komitetit Qendror të Partisë. Edhe ne do të marrim masa, që të mos na vijnë e të na thonë këtu pse nuk ndërtohen apartamente në fshat. Apartamente do të ngrihen sa të ketë mundësi, por krahas kësaj të shikohet me kujdes edhe çështja tjetër, se në fshat ka plot shtëpi dhe nuk bëhet kiameti sikur fshatari, siç e thashë, t'i japë të riut ose të resë një dhomë të shtëpisë së tij për njëfarë kohe. Kjo mundësi ekziston, dhe kur

vepron kështu, fshatari i bën një të mirë shoqërisë. Pastaj kjo është traditë e shqiptarit brez pas brezi. Për këta që vijnë nga qyteti për të punuar e për të jetuar në fshat duhet bërë një sakrificë e tillë. Dhe e vërteta është se fshatarët tanë janë njerëz të sakrificës. Ata ka raste që bëjnë një orë e gjysmë apo dhe dy orë rrugë më këmbë për të vajtur në punë, kurse ka punonjës të qytetit të Vlorës, për shembull, siç u tha këtu, që nuk shkokan dot më këmbë deri në qendër të punës, por duan autobus! Për distanca të vogla, që nuk duhen më shumë se 20 minuta më këmbë për të vajtur në punë, mendoj se autobusi është një luks i madh. Autobusi ka gjithë ato shpenzime, do naftë, i duhet riparuar motori herë pas here etj., etj. Prandaj njerëzit le të ecin edhe më këmbë, se kjo u bën mirë edhe për shëndetin. Ndryshe është puna për punëtorët në ndërmarrjen bujqësore «Rinia» në Vlorë, këta po, duhen çuar me autobus.

Përmirësime kemi, dhe nuk duhet ta nxijmë gjendjen. T'i vëmë në dukje edhe anët e mira, se pozitivja është karakteristika jonë e përgjithshme. Çështja shtrohet që dhe ato shfaqje negative që kemi t'i luftojmë, se natyrisht, atëherë do të ecim edhe më mirë.

Këto ditë lexova një artikull në gazetën lokale të Vlorës, ku mësova se janë shumë prapa me mbjelljet. Kur them kështu kam parasysh Mokrën e Skraparin që i kanë realizuar dhe e kanë lënë në bisht këtë rreth. Po të krahasosh kushtet tokësore të Mokrës e të Skraparit me ato të Vlorës, del se ato i kanë më të këqija. Terreni i malësisë së Vlorës nuk është aq i egër si atje.

Megjithatë, ata i kanë realizuar njëqind për qind mbjelljet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar.

E kam fjalën për mbjelljen e misrit, pse pambukun vetëm Novosela e mbjell në këtë rreth. Mobilizim ka edhe atje, por të merren të gjitha masat që dhe mbjellja e misrit të mbarojë sa më shpejt.

Diskutimin sot e bëmë në formë debati.

SHOKU RAMIZ ALIA: Më mirë, kështu, në formë debati, shoku Enver, bile shumë mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë thua, ti Ramiz, por nuk dimë shokët që kemi ftuar në këtë mbledhje, si thonë. Mundet që ju, shokë, nuk doni që ta zhvillojmë bisedën kështu, me debat! Mirë, si ta doni mund ta bëjmë. Rëndësi ka që puna të bëhet mirë. Veçse, kur ka debat, ka «gunga» që të zënë këmbët. Pra nuk ke ç'të bësh, duhet t'u përgjigjesh edhe pyetjeve!

Punët mirë po na ecin, por ne diskutojmë që t'i bëjmë akoma më mirë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime në librin:
Enver Hoxha, «Për rininë»
(Përmbledhje veprash)
vëll. II, f. 505*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH. që gjendet
në AQP*

TE RUAJME SI SYTË E BALLIT THESARIN E KOMBIT DHE TA ZHVILLOJMË MË TEJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

25 maj 1978

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët!² Si do të fillojmë, shoku Ramiz?

SHOKU RAMIZ ALIA: Mbase fillojnë të na flasin pjesëmarrësit që janë ftuar në këtë mbledhje.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, këta të na flasin, ashtu siç i kemi parë çdo ditë në televizor, në skenën e teatrove, të estradave, të kinemasë e në libra.

Ç'mund të na thoni ndonjë gjë të mirë ju, shokë të artit e të kulturës, në diskutimet tuaja? Mos na vini në dukje vetëm të metat. Ne e dimë që edhe të meta ka, por duam që ju të na thoni diçka edhe për perspektivën. Pra, si mendoni ju, ç'mund të bëhet më shumë e

1. Në këtë mbledhje u diskutua për gjendjen dhe për disa probleme të rritjes së nivelit ideoartistik të krijimtarisë, të teatrove dhe të estradave profesioniste.

2. U drejtohet të ftuarve në këtë mbledhje.

ç'ndihmë duhet t'ju japim akoma që puna të ecë edhe më mirë në këtë fushë?

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Po ngrihem të flas unë, megjithëse kam edhe emocione, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: «E ke një çikë dorën të rëndë», thoshte ai postieri në film¹.

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Edhe fjalën e kam të rëndë (të qeshura).

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj jepi Violetë, fol ashtu siç flet edhe në skenën e teatrit!

SHOKU RAMIZ ALIA: Lëri ato që ke përgatitur me shkrim, Violetë, më mirë fol ashtu, pa letër.

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Po, po, do të flas pa letër.

Shkrimtarët dhe ne jemi të pandarë e, po të shprehem në mënyrë figurative, ata janë mielli, ne jemi buka. Pa ata ne nuk bëjmë dot.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa libër nuk ka teatër.

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Ne, shkrimtarë dhe artistë jemi të lidhur bashkë si mishi me thoin.

Pasi foli edhe për probleme të tjera të dramaturgisë, teatrit, estradës e filmit, shoqja Violeta Manushi vazhdoi:

Cili është shqetësimi tjetër që kemi ne? Mua më duket se akoma gruaja, në dramën tona, nuk përfaqëson realitetin shoqëror që ekziston, si një forcë e madhe në ndërtimin e shoqërisë socialiste.

SHOKU ENVER HOXHA: Në rregull! Të punohet

1. Është fjala për filmin «Zonja nga qyteti», ku Violeta Manushi luan rolin kryesor.

më shumë nga shkrimtarët dhe artistët tanë që figura e gruas shqiptare të zërë atë vend që meriton në veprat e artit.

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Mendoj se pak bëhet e pak flitet për punën që lidhet me trashëgiminë tonë artistike. Do të vijë një ditë që brezat do të duan të dinë se ç'është bërë. Ne kemi grumbulluar tashmë një përvojë të madhe, po, në fakt, arkivat tona të teatrit janë shumë të varfra.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, drejt e shtron këtë problem shoqja Violetë. Kudo kështu veprohet, siç thua ti. Ja, të marrim komeditë e Molierit, të cilat unë i njoh mirë. Ato, që kur janë shfaqur për herë të parë në skenë e deri në ditët e sotme, kanë historikun e tyre. Dihet se kush e ka luajtur këtë apo atë rol në komedinë «Tartufi», për shembull. Ose, kush e ka luajtur rolin e Harpagonit në komedinë «Kopraci» etj. Që në ato kohë tregohet kujdes, e jo më sot. Shumë drejt e ke shoqja Violetë! I mbajtet shënim, ju, shokë? T'i bëjmë mirë këto punë, sepse luajnë rol të rëndësishëm, për sot e për të ardhmen.

SHOKU RAMIZ ALIA: Teatri i Shkodrës i ka të gjitha, bile edhe pllakatet e ftesat.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Tano Banushi ka dhe ftesat që në vitin 1948.

SHOQJA VIOLETA MANUSHI: Edhe ne kemi një shok shumë të pasionuar për t'i ruajtur këto, Gjon Karma.

Ne tani kemi për të vënë në skenë një pjesë që flet për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Për këtë kërkua ndihmën e historianëve. Edhe shtypi na ka ndih-

muar shumë se gati çdo ditë ai jep material për ato personazhe që ne i kemi në dramë. Po shfrytëzojmë fotografitë, muzeumet e të gjitha. Kjo gjë është bërë për ne si detyrë, ka hyrë si një domosdoshmëri.

SHOKU ENVER HOXHA: Është bërë si një jetë e dylë.

Mirë, shoqja Violetë, shumë mendime të mira e të nevojshme na the. Edhe në skenë gjëra të mira na jep. Por, edhe këtu na ngrite probleme të arsyeshme dhe shtrove kërkesa të drejta që teatri ynë të përparojë. Këto ne duhet t'ia bëjmë të njohura Partisë, se janë çështje bazë për të gjitha trupat e teatrit e të estradës sonë. Këtu është fjala për çështje parimore për të pasur një teatër, një estradë dhe çdo degë tjetër të artit në një nivel sa më të lartë e të përsosur ideoartistik, lidhur kjo edhe me situatën aktuale.

SHOKU DRITËRO AGOLLI: Unë mendoj se drammat tona vuajnë shumë edhe nga gjuha, e cila disa herë teknizohet e ndrydhet. Për shembull, gratë, ndonjëherë i nxjerrin në dramë të zbehta apo tepër agjitative, që thërresin e grinden. Në vend që gruaja e vendit tonë të paraqitet e bukur e dinjitoze, ashtu siç është në të vërtetë, dramaturgu na e paraqet të tillë që s'të vjen të marlohesh me të.

SHOKU ENVER HOXHA: Në shtëpi kam nënën e Nexhmijes. Sa herë që shikon shfaqjet që jep televizionin ynë, e kur ka ndonjë pjesë të tillë me gra që bërtasin, siç thua ti, Dritëro, thotë: «Po pse bërtasin kështu, more Enver, ç'kanë që grinden xhanëm?».

Nuk kanë gjë, i them, mos e ka fajin mikrofoni (të qeshura).

SHOKU TANO BANUSHI: Më lejoni të shpreh një mendim, për kolegët e mi amatorë. Nuk e kam fjalën që të kërkojmë privilegje për ta, por për një administrim më të mirë të ndihmave që u jepen atyre. Konkretisht e kam fjalën për t'i lehtësuar ata nga turnet e dyta e të treta.

SHOKU ENVER HOXHA: Drejt e ka. Ashtu është. Nuk dëmtohet ekonomia jonë po të lehtësohen nga puna me turne disa njerëz të talentuar nga një ndërmarrje, si pjesëmarrës të grupeve amatore. Këto çështje duhen parë me sy politik, se fitojmë njëqind herë më shumë duke e mbajtur të gjallë lëvizjen artistike amatore në ndërmarrje, sesa t'i pengojmë ata dy-tre veta për të marrë pjesë në këto lëvizje.

Pasi diskutuan edhe shokët e tjerë, të pranishëm në këtë mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:

Përpara se të shfaq disa mendime dëshiroj të shpreh kënaqësinë e veçantë që ndiej për problemet e rëndësishme dhe me vlerë që shtruan shokët Dritëro Agolli, Violeta Manushi, Pirro Mani, Tano Banushi dhe Anastas Kondo për zhvillimin e zhanreve të ndryshme të artit tonë të skenës, që ka kontribuar dhe po kontribuon aq shumë në edukimin e punonjësve tanë në rrugën e ndërtimit socialist. Këto diskutime që bënë shokët e ftuar, nuk duhen konsideruar nga punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, të komiteteve të Partisë të rretheve dhe të bashkimeve profesionale vetëm si disa konstatime të thjeshta dhe t'i marrë era. Mendoj se në të gjitha ato që thanë shokët e ftuar nuk kërkuan asgjë të tepërt, dhe propozimet e tyre konkrete janë të tëra

të arsyeshme si për nevojat e sotme, ashtu edhe për perspektivën, prandaj ju duhet t'i shqyrtoni me kujdes e në kohë një nga një, të merrni masa që të zbatohen dhe më së fundi të na jepet një informacion se si po vihen në jetë kërkesat e tyre. Kërkesa e llogarisë, sidomos në drejtim të zbatimit të vendimeve që marrim për sektorin e artit, duhet të bëhet më e fortë dhe më me kujdes. Problemet e këtij sektori nuk duhet të konsiderohen si diçka të pakapshme.

Si konkluzion dua të them se raportet që na u paraqitën, po veçanërisht diskutimet që u bënë, të cilat ishin më të gjalla e më konkrete, na ndihmuan shumë.

Për këto çështje edhe unë dëshiroj të them diçka.

Mendoj, së pari, se duhet t'i vëmë rëndësi edukimit moralo-politik dhe ideologjik të kuadrove që punojnë në të gjithë këta sektorë, problem ky që ju e prekët shumë mirë.

Ngritja profesionale e artistëve, dhe kur themi e artistëve kuptojmë edhe regjisorët e gjithë artistët e skenës, ka gjithashtu rëndësi të veçantë, siç ka rëndësi puna që duhet të bëjnë autorët për përmirësimin në vazhdim të pjesëve që shkruajnë, duke pasur parasysh sidomos cilësinë.

Teatri ynë është një mjet edukues me shumë rëndësi, gjë që duhet ta kuptojnë mirë gjithë kuadrot e Partisë, të pushtetit e të tjerët. Ai duhet të shprehë në skenë virtytet më të mira të njeriut tonë socialist, virtyte jo në kuptimin idealist dhe metafizik, por virtyte këto të trashëguara nga e kaluara e mirë e popullit, edhe të lindura e të formuara në shoqërinë tonë socialiste. Këto virtyte nuk janë një stoli e vdekur, por janë

një e të pandara me mendimet, me veprimet, me dëshirat, me aspiratat, me punën dhe me krijimtarinë e njeriut në shoqëri dhe për shoqërinë.

Njeriu me virtyte të larta ka dëshirë dhe lufton për një shoqëri të mirë. Por në këtë drejtim duhet të ruhem nga «idealizimet». Heroi pozitiv në libër dhe në skenë të paraqitet me tërë thjeshtësinë e tij, sepse në thjeshtësinë spikatën të fuqishme virtytet e mira; nuk duhet të idealizohet, pse «hero» të përsosur nuk mund të ketë në jetë. Është jeta që na e vërteton këtë gjë, prandaj ta paraqesim jetën e vërtetë materiale dhe shpirtërore tonën, ashtu siç është, në dinamizëm, në zhvillim. Nuk është me vend dhe nuk është me efekt të mirë, mendoj unë, që të vësh në skenë heronj pozitivë të idealizuar, që duken sikur rrojnë në një botë tjetër dhe jo në një botë si kjo jona, që është në transformim të vazhdueshëm progresiv, ku edhe vetë heroit pozitiv transformohet dita-ditës tok me shoqërinë. Duhet mbajtur pastaj parasysh se heroit ynë pozitiv nuk është plotësisht i imunizuar nga ndonjë mbeturinë, por tek ai kurdoherë dominojnë anët e mira dhe këto janë në luftë të vazhdueshme me mbeturinat dhe reminishencat e tyre, qoftë në ndërgjegjen e tij, ashtu edhe në ndërgjegjen e njerëzve të tjerë, në mes të të cilëve rron e lufton edhe ai së bashku me ta për një jetë më të kulturuar në shoqërinë tonë socialiste. Heroi pozitiv e do këtë shoqëri dhe në mendimet dhe në veprimet e tij spikat si realiteti i sotëm, ashtu edhe perspektiva. Pra ky personazh shërben si shembull në vepër dhe në skenë dhe njëkohësisht si luftëtar, si revolucionar dhe si edukues i të tjerëve.

Këto tipare që duhet të karakterizojnë heroin pozitiv, formohen dhe brumosen me një edukatë dhe me një moral proletar, formohen me përvetësimin e ideologjisë sonë marksiste-leniniste, që është rrugërrëfyesja e Partisë sonë të Punës në çdo aksion. Pra, roli i teatrit, i estradës, i komedisë dhe i zhanreve të tjera është i rëndësishëm, pse ka të bëjë me edukimin masiv dhe individual të njerëzve tanë në përgjithësi.

Por, tok me rolin e tyre, po aq i rëndësishëm është edhe roli i pjesës që luhet, pa të cilën nuk mund të ketë teatër, nuk mund të ketë estradë dhe këtu del përgjegjësia e autorit. Pjesa pasqyron një ndodhi të jetës, ajo përfaqëson një episod të jetuar nga njerëzit me ndjenja, me shije, me aspirata, episod që zhvillohet në një kohë të caktuar, në një ambient të thjeshtë ose të komplikuar, me kontradikta antagonistë dhe joantagoniste, me momente dramatike, gazmore, komike etj.

Të gjitha këto duhen jetuar nga autori, ato duhen jetuar me popullin, në gjirin e tij, siç thatë edhe ju shumë mirë në diskutimin tuaj, shoqja Violeta Manushi. Prandaj shkrimtarët duhet të rrojnë me popullin dhe të mendojnë për të, para se të shkruajnë.

Artistët që i interpretojnë pjesët teatrale, dramat ose pjesët e përgatitura për estradë, komeditë, duhet t'i vënë detyrë vetes që në rolin e tyre të shërbejnë si profesorë, si mësues të publikut në këto institucione kulturore.

Mësues dhe profesor për çdo degë apo profesion nuk lind njeri, po ai bëhet. Mund të bëhesh i mirë, po mësove mirë, po kuptove rëndësinë e misionit ose të detyrës që të është ngarkuar dhe po u bërë i ndër-

gjegjshëm për këtë rol të madh edukativ. Për të për-
vetësuar mirë zanatin, duhet të dish edhe ku të oriento-
hesh për të mësuar, për të zgjeruar dijenitë dhe për t'u
thelluar në profesion.

Për çdo degë të artit, të shkencës, të kulturës ek-
zistojnë teoria dhe praktika. Kështu është edhe për ar-
tistët, për ta ekzistojnë edhe teoria që marrin në shko-
llë, edhe praktika që ata fitojnë në skenë, por sidomos
ajo praktikë e madhe që është kontakti i ngushtë i ty-
re me popullin.

Po marr një shembull tipik: E kam fjalën për ve-
prën «Zonja nga qyteti» që, personalisht, e quaj një
pjesë me shumë vlera, e cila luhet edhe në skenë, në
teatër, por është bërë edhe film. Në çdo gjë të mirë që
lidhet me të, përveç të tjerave, kam parasysh edhe
autorin Ruzhdi Pulaha, edhe aktoren e shquar Violeta
Manushi, edhe aktorin me shumë talent Pandi Rai-
dhi. Kur e shikoj këtë film ndiej një kënaqësi të ma-
dhe, rroj tok me këta artistë, pse në ekran apo në ske-
në është jeta reale ajo që na del përpara, është loja e
përsosur e aktorëve në fjalë. Asgjë nuk është artificiale
në lojën që bëjnë artistët që përmenda më lart kur in-
terpretojnë rolet e kësaj pjese. Çdo episod aty është aq
mirë i studiuar, për mendimin tim, sa është edhe i
thjeshtë, origjinal dhe i vërtetë, që të tërheq, të emocio-
non, të bën të qeshësh, të gëzohesh dhe të gjitha këto i
japin spektatorit një mësim dhe një edukatë të pashlye-
shme. E tillë është edhe loja aq e çlirët, aq e prekshme
e artistit me talent Stavri Shkurti, i cili e personifikon
sekretarin e Partisë aq të afërt, aq të dashur, aq të
pjekur dhe plot dinamizëm. «Ti m'u qepe si zamku

pas letrës, ti më theve», i thotë atij në film Violeta në rolin e zonjës nga qyteti. Është për këtë arsye që interpretuesit e kësaj vepre i quajmë artistë të mëdhenj dhe autorin e saj një shkrimtar me talent. Unë mora vetëm një shembull, pse ne kemi plot autorë dramash, komedish, tregimesh, romanesh e gjini të tjera, që janë me shumë talent.

Zhvillimi i artit skenik në vendin tonë është një nga veprat e shquara të Partisë, po këtë zhvillim ne duhet ta çojmë më tej, akoma më përpara. Nga ana tjetër, unë i gjej të drejta edhe disa kritika që bëhen në raportin që ka paraqitur shoqja ministre e Arsimit dhe e Kulturës, Tefta Cami, si dhe në materialin e shokut Dritëro Agolli. Njohja reale e disa mungesave dhe e të metave në këtë fushë, si në çdo sektor tjetër, është një shenjë e mirë dhe mjaft inkurajuese që ndihmon drejt përmirësimin e gjendjes. Përmirësime ka në këto drejtime, sepse autorët dhe artistët që interpretojnë pjesët e tyre në teatër apo në film kanë ku të mësojnë. Ata mund të mësojnë nga kolegët e tyre, që kanë vënë në skenë me sukses mjaft pjesë të autorëve tanë, por edhe për çështje të skenografisë mund të mësojnë në mënyrë të kënaqshme. Pra kemi edhe anë të mira, edhe të meta, por në këtë fushë pozitivja dominon, sipas mendimit tim, arti ynë socialist rritet, krahas tij rriten edhe artistët tanë. Ka rritje talentesh, ka afirmim autorësh të dramaturgjisë, por duhet punuar që të zgjerohet akoma rrethi i tyre dhe duhet ndihmuar nga ana e Partisë dhe e pushtetit që ai të zgjerohet. Për këtë qëllim duhen krijuar mundësitë dhe sot ne kemi ku ta hedhim dorën.

Unë jam optimist për zhvillimin e mëtejshëm të artit tonë. Me këtë mori vajzash, djemsh, pionieresh e pionierësh amatorë, pa përmendur këtu artistët e shkrimtarët profesionistë, që janë kuadro të talentuar, ne mund të përgatitim filma më shumë, të japim shfaqje, të japim koncerte që janë dhe duhet të jenë edhe në të ardhmen të një niveli të lartë. Partia ka bërë një mrekulli. Në zhvillimin e arteve tona, nën udhëheqjen e Partisë, janë arritur suksese të mrekullueshme, këtë e them me plot bindje dhe nuk lëviz nga ky mendim që kam, edhe sikur me top të më qëllojnë, siç thotë Dritëro Agolli në romanin «Njeriu me top», që është xhiruar në film, që edhe ky më ka pëlqyer shumë.

Tërë populli ynë rron i lumtur, te ne i madh e i vogël punon dhe në të njëjtën kohë këndon, kërcen, luan në një vegël muzikore, luan në teatër, luan në estradë etj. Sigurisht që duhet të luftojmë edhe për cilësi, por edhe për sasi, se kjo na lejon pastaj zgjedhjen e talenteve. Ne duhet të interesohemi në mënyrë të veçantë për talentet e reja, këtë të mos e harrojmë. Partia dhe udhëheqja e saj e kanë theksuar dhe vazhdimisht e theksojnë këtë porosi për çdo sektor, ku më të moshuarit e çdo profesioni t'i shtyjnë të rinjtë të ecin përpara, t'i ndihmojnë ata të marrin stafetën. Shumë bukur e thatë edhe ju kur diskutuat për këtë dhe shumë drejt keni vepruar, prandaj vazhdoni të merrni të rinj. Këtu nuk është çështje organike, se duhet një ose duhen dy apo tre njerëz. Kryesorja është të luftohet kundër burokratizmit, kundër shtimit pa vend të organikave, për të cilat Partia bën kujdes. Megjithatë, ka raste që bëjmë lëshime në këtë drejtim. Atëherë përse

të mos bëjmë lëshime për disa regjisorë ose për disa aktorë të tjerë kur janë të nevojshëm? Kursime mund të bëjmë dhe do të bëjmë gjetkë, atje ku duhet.

Edhe shkolla artistike kemi hapur, prandaj t'i perfeksionojmë ato, t'i zgjerojmë. Shoku Dritëro Agolli mori si shembull Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit, për të cilin bëri disa llogari të përafërta. Në këtë qytet ne kemi tani një teatër, mirëpo atje po ndërtohet një qytet i tërë me disa dhjetëra mijë veta, përveç atij që është. Atëherë në të ardhmen do të dalë problemi: do të mjaftojë atje teatri ekzistues, do të mjaftojë ajo estradë? E të tjera probleme me radhë. Prandaj si kudo, edhe në këtë drejtim, duhet të ecim tok me kohën, me nevojat e reja që lindin.

Ja, edhe në ekonomi, përpara kishim disa depo misri, tashti Qeveria ka marrë dhe po merr masa, ka dhënë edhe fonde për të ndërtuar depo të tjera. Kjo është një masë e domosdoshme, e diktuar nga kushtet e reja, sepse po ngrihen rendimentet e grurit dhe të misrit, këshu depot ekzistuese nuk mjaftojnë. Kjo nevojë lyp investime të reja. Po në sektorët që kanë të bëjnë me edukimin dhe argëtimin e punonjësve tanë? Shtohen te ne qendrat e punës, shtohet numri i njerëzve, por këta duan kulturë, kanë nevojë për shkolla, duan edhe teatër, edhe estradë, duan të dëfrenjë, të çlodhen e të edukohen nga këta teatro, nga këta «profesorë», siç janë artistët, regjisorët, autorët e dramave, të komedive, të skeçeve, të libreteve, të pjesëve muzikore etj. Prandaj duhet të ecim frontalisht dhe të mos i harrojmë disa drejtime që janë po aq të rëndësishme sa edhe të tjerat. Ne kemi vazhdimisht nevojë të spastrojmë mjegu-

llën e së kaluarës nga kokat e njerëzve tanë. Në të kaluarën lojën në teatër apo në estrada e konsideronin punë «karagjozësh». Por Partia nuk mendon ashtu, pse çështja është krejt ndryshe. Ne u kemi vënë rëndësi kurdoherë teatrit dhe estradës, por puna është t'i shohim çështjet më gjerë. Të tërë talente të mëdha nuk do të bëhen, por arti është një nevojë, kolektive dhe personale, ai është si një ushqim shumë i nevojshëm për jetën e njerëzve tanë, prandaj më gjerë duhet ta shohim problemin lidhur edhe me zhvillimin e nevojat në rritje të vendit. Të mos shkohet me mendimin se duhet të përgatitim në shkollën e lartë të muzikës tri pianiste, bie fjala, pse për aq kemi nevojë, për të plotësuar vendet vakante në shkolla ose në institucione artistike.

Partia nuk e ka parë gabim çështjen kur thotë të përulemi, të pimë dhe të rritemi nga gurra popullore, të shtojmë lëvizjen artistike të amatorëve, të shtojmë veglat muzikore, të ruajmë si sytë e ballit thesarin e kombit dhe ta zhvillojmë më tej. Shihni ç'është bërë! Spektatorët dhe populli jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende të tjera, si në Francë, në Greqi, në Turqi, në Itali, në Vendet Nordike, i kanë brohoritur ansamblet tona. Kudo ku shkojnë këta i habitin njerëzit me bukurinë e këngëve, valleve, instrumenteve, kostumeve, gjithë këta njerëz jo vetëm kënaqen, por u shtohet dashuria dhe respekti për kulturën shqiptare socialiste që nuk e njihnin deri më sot.

Motrat dhe vëllezërit tanë në Kosovë entuziazmohen, qajnë dhe mallëngjehen, kur dëgjojnë dhe shohin

në skenat e tyre artistët tanë që rrojnë në atdheun e lirë socialist.

Prandaj kam bindjen e plotë dhe të patundur se arti i vendit tonë socialist do të shkëlqejë vazhdimisht, do ta ngrejë gjithnjë e më lart kulturën tonë socialiste, do të jetë një nga mjetet që atdheun tonë, përpjekjet e popullit shqiptar, mençurinë e tij, ndjenjat e tij të holla dhe dinjitetin e tij do t'i bëjë akoma më shumë të njohur në opinionin botëror.

Këto kisha për të thënë, shokë, dhe, ju lutem, i përshëndetni nga ana ime të gjithë punonjësit e artit të vendit tonë, të cilët i falënderoj nga ana e Partisë për punën e madhe që bëjnë dhe për atë që do të bëjnë paskëtaj. Kam bindjen e plotë se, si kurdoherë, ata do të jenë në ballë të luftës për ndërtimin e plotë të socializmit.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në librin:
Enver Hoxha, «Raporte e
fjalime 1978-1979», f. 84*

*Botohet i plotë sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

PATRIOTËT TANË TË MËDHENJ LUFTUAN ME ARMË NË DORË PËR TË FITUAR LIRINË

*Fjala në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

27 maj 1978

Unë kam një propozim. Si pikë të parë të rendit të ditës të vëmë dekorimin e patriotëve Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi dhe Mic Sokoli. Këtë propozim e ka dërguar Komiteti Qendror i Partisë me rastin e 100-vjetorit të datës historike të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren, prandaj mendoj kjo mbledhje e Presidiumit të Kuvendit Popullor të figurojë si një mbledhje e posaçme, kushtuar këtij vendimi historik, në shenjë nderimi të veçantë për këta heronj të lidhjes.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, siç e dimë, është një nga ngjarjet më të shënuara e më të lavdishme të historisë së popullit tonë. 100 vjet më parë gjithë populli

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua propozimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH për dekorimin e tre patriotëve të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare: Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi dhe Mic Sokoli.

shqiptar, nga skaji më i largët i Kosovës, nga krahinat veriore e veriperëndimore të Grudës e të Hotit e deri në Jugun ekstrem, në Çamëri, u ngrit në këmbë për një çështje të madhe, për unitetin e kombit shqiptar. Bijtë e popullit tonë, jo vetëm në kohën e Skënderbeut, kur u shkrua epopeja e madhe e luftës së çlirimit kundër osmanëve, dhe para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si më 1830 e më 1847, por vazhdimisht edhe më vonë, i kanë mbushur gjithnjë me armë në dorë malet tona. Qindra e mijëra patriotë e luftëtarë rrëmbyen pushkët për të fituar lirinë kundër osmanëve, ata kishin hedhur idenë e një Shqipërie autonome, që me Rrapo Hekalin, Tafil Buzin e të tjerë. Ata nuk e kufizuan luftën e tyre vetëm kundër taksave e xhelepeve që u kishte vënë Porta e Lartë, por, siç e thashë, kishin hedhur edhe parullën e vetëqeverisjes.

Në kulmin e krizës lindore, komiteti qendror i Stambollit, ku ishin grumbulluar patriotët e shquar të Rilindjes sonë, si: Abdyl e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto e të tjerë, hodhën kushtrimin e luftës për autonomi, për çlirim, pavarësisht se thoshin «nën suazën e Perandorisë Osmane». Në ato kohë në Evropë ekzistonin situata të tilla që edhe kombe e shtete të tjera e kishin fituar autonominë nën suazën e perandorive të tjera, kështu që thirrja e patriotëve tanë pati një jehonë të jashtëzakonshme në gjithë Shqipërinë dhe, siç e dimë, 100 vjet më parë ajo u konkretizua në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Është, pra, e qartë se kjo lëvizje nuk u zhvillua në mënyrë spontane. Kuvendin e madh të përfaqësuesve shqiptarë të mbajtur në Prizren, në qershor të vitit 1878, që shënoi themelimin e

Lidhjes Shqiptare, e pasuan mbledhje të tjera të përfaqësuesve të popullit shqiptar.

Në rast se nuk gabohem, në korrik 1878 në Janinë u bë një mbledhje e madhe, ku u mor vendim t'i kërkohej Portës së Lartë që Shqipëria të ishte autonome, të kishte shkollat e saj etj. Natyrisht, Porta e Lartë e hodhi poshtë këtë kërkesë, por çështja shkoi edhe më tutje. Patriotët tanë të mëdhenj me armë në dorë luftuan për të realizuar qëllimet e tyre. Në kuvendin që u mbajt në Gjirokastër në korrik 1880 Abdyl Frashëri hodhi parullën për formimin e qeverisë shqiptare. Kjo platformë u pranua edhe nga Kuvendi i Dibrës në tetor 1880, që deklaroi se shqiptarët janë të vendosur të mos lëshojnë tokat e tyre, fushat e malet, njerëzit që jetojnë në viset shqiptare.

Stambolli u alarmua për këtë lëvizje të fuqishme patriotike, u alarmuan, gjithashtu, edhe kancelaritet evropiane; por u alarmuan, në mënyrë të veçantë, mbretëritë shoviniste serbe, malazeze, greke për këtë vendosmëri të popullit shqiptar, për organizimin e forcave të tij patriotike dhe ato të armatosura. Kjo bëri që të gjithë armiqtë të lidheshin në një koalicion kundër shqiptarëve, dhe Stambolli, për t'i thyer ata, dërgoi në Shqipëri Dervish Pashën me një ushtri të madhe. U zhvilluan kështu luftime të ashpra në Kosovë, në Dibër, në malësitë e Shkodrës etj. Dervish Pasha me forca të mëdha i theu luftëtarët shqiptarë të lirisë, por ai nuk i përkuli dot ata.

Shqiptarët luftuan, siç kanë luftuar kurdoherë, me trimëri, me abnegacion kundër copëtimit të atdheut,

për unitetin e mbarë popullit tonë, që mohohej nga kancelaritë evropiane. Por në këtë kohë kombi ynë ishte formuar, ai nuk ishte një komb që mund të trajtohej me përçmim si një entitet njerëzish primitivë që banonin në kasolle prej kashte. Populli ynë kishte krijuar tashmë individualitetin e tij si komb dhe këtë ai e tregoi shumë qartë në këtë periudhë. Por fuqitë e huaja i mbytën me gjak përpjekjet e shqiptarëve që vendosën të luftojnë për sigurimin e të drejtave të tyre, kësh-tu që serbët, malazestë dhe grekët arritën ta copëtojnë Shqipërinë me ndihmën e Fuqive të Mëdha.

Ky është fakt. Por është, gjithashtu, fakt se populli shqiptar, kudo ku ndodhet, në Shqipërinë e lirë socialiste, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi e gjetkë, asnjëherë nuk e ka shuar patriotizmin e tij të zjarrtë, dufin e tij të pashuar për atdheun, përkundrazi, ky patriotizëm ka ardhur vazhdimisht duke u rritur.

Shqipëria u çlirua nga okupatorët e huaj në sajë të luftës heroike të popullit të vet, të Luftës Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia jonë e lavdishme, që aktualisht udhëheq vendin tonë në rrugën e ndërtimit me sukses të socializmit. Populli ynë u ka bërë ballë me sukses vështirësive, presioneve, shantazheve të të gjithë atyre që nuk na e duan të mirën, vendeve imperialiste e socialimperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik, vendeve revizioniste, gjithë reaksionarëve të tjerë. Tani doli në skenë edhe një shtet tjetër revizionist, socialimperializmi kinez. Por, si deri më sot, historia ka treguar, vazhdon të tregojë e do të tregojë edhe në të ardhmen vitalitetin e

madh të popullit tonë, pjekurinë, rezistencën dhe trimërinë e tij në luftën për mbrojtjen e atdheut, të të drejtave të tij, të lirisë dhe sovranitetit, duke fituar zemrat e njerëzve të ndershëm në botë, që përbëjnë shumicën dërrmuese të njerëzimit, ndjenjat e popullit të çdo vendi dhe të proletariatit të tij kudo që ky shtypet e shfrytëzohet. Pikërisht janë këto virtyte të larta të popullit tonë që kanë bërë të flitet me respekt të madh për Shqipërinë socialiste kudo në botë, që zëri i saj i fuqishëm, sukseset e saj të jenë njëkohësisht një inkurajim për vëllezërit tanë të një gjaku që vazhdojnë të rrojnë nën zgjedhën e të huajve, serbëve, malazezve e të tjerëve të maskuar me pseudoteori marksiste-leniniste. Shembulli i Shqipërisë bën që edhe ata vëllezër e motra të tjera që Kongresi i Berlinit i la jashtë tokës amtare, të ruajnë e të forcojnë, ashtu si dhe populli ynë, ndjenjën e patriotizmit, ndjenjën e qenies së tyre si komb, të ruajtjes së gjuhës, të zakoneve dhe të shprehsave për të ardhmen.

Prandaj në këtë mbledhje historike, duke aprovuar e vendosur këtu në Presidium, propozimin e Komitetit Qendror për dekorimin me urdhrin e lartë të Heroit të Popullit tre nga udhëheqësit më të shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ne kemi vlerësuar lart përpjekjet e mëdha të të gjithë atyre burrave trima dhe grave trimëresha të Shqipërisë që luftuan për unitetin e kombit tonë, për unitetin e tokave tona. Këta janë Abdyl Frashëri nga Frashëri i Përmetit, Sulcjan Vokshi nga Gjakova, komandant i përgjithshëm i ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit, dhe Mic Sokoli nga Tropoja, për të

cilët me këtë rast propozoj të ngrihemi në këmbë dhe të nderojmë me respekt kujtimin e tyre. (Mbahet një minutë heshtje.)

*Botuar për herë të parë në
revistën: «Studime politi-
ko-shoqërore», nr. 13, 1987,
f. 7*

*Botohet sipas revistës «Studi-
me politiko-shoqërore»,
nr. 13, 1987, f. 7*

DISA MENDIME E VËREJTJE PËR METODËN DHE STILIN E PUNËS SË PRESIDUMIT TË KUVENDIT POPULLOR DHE TË APARATIT TË TIJ

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSSH*

27 maj 1978

Dëshiroj të shpreh disa mendime e të bëj disa vërejtje për punën e Presidiumit dhe të aparatit të tij.

Konstatoj se në mbledhjet e Presidiumit ka pak diskutime. Ju, shoku Haxhi [Lleshi]¹, bëni konkluzionet dhe kjo punë është e nevojshme, por vë re se këtu diskutojnë zakonisht vetëm disa shokë. Por, edhe diskutimet e tyre disa herë alternohen, kur flet njëri, nuk flet tjetri. Rrallë e për mall diskuton ndonjë nga shokët e tjerë.

Vihet pyetja: Kush i ndalon shokët të diskutojnë këtu? Askush. Atëherë ne duhet të mendojmë për të gjetur arsyet e kësaj mungese, pse edhe të tjerët që s'flasin kanë ide. Puna është se shpeshherë ne shqetë-

1. Në atë kohë, kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH.

sohemi për të gjetur çështjet për të cilat mund të diskutojmë.

Rendi i ditës i mbledhjeve tona, sidomos pika e parë, shpesh është standard. Ajo zakonisht trajton rolin e këshillave popullorë, të këshilltarëve, të komiteteve të tyre ekzekutive e të seksioneve. Vërtet Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka në kompetencën e vet të drejtë dhe të kontrollojë veprimtarinë e këshillave popullorë, por, disa herë, në materialet që na paraqiten për shqyrtim, hyhet deri në hollësi që janë fare të panevojshme për këtu, në Presidium, siç është, fjala vjen, «realizimi i planit të leshit» etj.

Po për çfarë problemesh duhet të interesohet ai konkretisht? Këtu mendoj që duhet vrarë mendja; ndryshe, kur çështjet përsëriten, bëhen monotone e diskutimi i tyre nuk ngjall interes. Jo vetëm që na paraqiten të njëjtat probleme, por edhe trajtimi i tyre bëhet njësoj, veçse një herë flitet, ta zëmë, për Librazhdin, një herë tjetër për Kolonjën e kështu me radhë për rrethe të tjera. Disa herë, duke dashur të analizohet funksionimi i organeve të pushtetit, sillen të dhëna ekonomike të çala e të përcipta.

Mua më duket se duhet ta ndryshojmë këtë metodë pune, sepse kështu siç veprohet nuk hap horizonte e nuk ngjall debate. Prandaj s'ka edhe diskutime në mbledhjet e Presidiumit, sipas mendimit tim. Problemet që na shtrohen dhe ashtu si na shtrohen nuk janë përherë të nivelit të këtij forumi të lartë.

Presidiumit, mendoj unë, i duhen paraqitur për shqyrtim probleme të rëndësishme e të thella, me karakter teorik, politik, ekonomik dhe organizativ, që

rrjedhin nga detyrat kushtetuese, nga ligjet më kryesore ekonomike e shtetërore. Këtu duhet të na flitet konkretisht për kuptimin politik të këtyre ligjeve dhe për efektet e tyre në masat punonjëse. E vërteta është se disa herë nga aparati i Presidiumit të Kuvendit Popullor, si dhe nga shokët që drejtojnë këtë aparat, na paraqiten çështje korente të trajtuara në mënyrë rutine.

Ka edhe çështje korente që, në bazë të Kushtetutës, duhet medocmos t'i shqyrtojmë dhe t'i vendosim ne, siç janë, për shembull, problemet që kanë të bëjnë me organizimin e organeve të pushtetit, me nxjerrjen e dëkreteve dhe të vendimeve, me interpretimin e ligjeve, me dhënien e dekoratave, me faljen e dënimeve, me dhënien ose heqjen e nënshtetësisë shqiptare etj. Për të gjitha këto probleme dhe për të tjera mund të ketë diskutime nga ne, por edhe mund të mos ketë. Vetëm duhet thënë se duke qëndruar në problemet që përmenda, nuk na janë paraqitur kurrë studime të thella me karakter politik, ideologjik, juridik e organizativ, nga të cilat të mund të nxirreshin konkluzione.

Janë të tjera organe ato që zbatojnë vendimet. Por, edhe ne e kemi për detyrë që, në vija të përgjithshme (dhe këtu konsiston studimi) të na raportohet herë pas here për një problem, që të dimë kështu edhe fatin e çështjeve që shqyrtojmë.

Të marrim, për shembull, çështjen e dhënies së dekoratave e të titujve të nderit. Ne kemi shumë lloje dekoratash e titujsh nderi. Ato ne i akordojmë pasi na i propozojnë të tjerët. Ne vazhdimisht, çdo muaj shqyrtojmë e vendosim për propozimet që na bëhen. Por, sa ndikojmë ne te njerëzit me akordimin e këtyre llo-

jeve të ndryshme të dekoratave e të titujve të nderit këtë është mirë ta dimë, që të orientohemi për të ardhmen. Kam përshtypjen që asnjëri nuk ka menduar për këtë problem që përbën një stimul moral me rëndësi.

Le të flasim për problemin e ndarjes së njësive administrative-tokësore. Ne herë pas here rrahim mendime edhe në këtë drejtim, por është e nevojshme që një herë në vit, ne duhet të bëjmë përgjithësime serioze për efektet politiko-ekonomike dhe organizative të këtij problemi.

Mund të shohim edhe problemin e rëndësishëm të faljes së dënimeve. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për dënimet e rënda, por për të gjitha llojet e tyre.

Duke marrë në shqyrtim probleme të kësaj natyre një herë në vit, ne vetë do të ndihmohemi e do të orientohemi për politikën që duhet të ndjekim, si dhe do të jemi në korent të gjendjes.

Pra, një herë në vit, në Presidium, mund të na paraqitet një raport jo vetëm statistikor, por me shpjegime të argumentuara, edhe për efektet pozitive ose negative të problemeve që diskutojmë e të vendimeve që marrim, dhe këtej të nxirren konkluzione për luftën e klasave e për një sërë problemesh të tjera. Kjo është një punë që i përket ta bëjë pikërisht aparati i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe jo organet shtetërore që thirren të raportojnë para nesh.

Unë mora një numër shembujsh që kanë të bëjnë me disa nga problemet që na paraqiten çdo muaj. Por ne duhet të vrasim akoma më tej mendjen se ka e duhet të ketë edhe shumë probleme të tjera kapitale që lypset t'i shqyrtojë Presidiumi.

Presidiumi i Kuvendit Popullor ka prerogativa e kompetenca, por ai ka edhe detyra. Këto të drejta e detyra s'duhën lënë pas dore. Në diktaturën e proletariatit, që është shteti më i përparuar dhe më demokratik, çdo organ shtetëror ka funksionet dhe kompetencat e veta, që nuk janë aspak të njëjlojta as në natyrë, as në përmbajtje, me ato të shtetit borgjez. Te ne, në shtetin e diktaturës së proletariatit, duhet të luftohen rutina, burokratizmi dhe sklerozimi i aparateve. Puna jonë këtu, në Presidium, duhet të jetë revolucionare, e zhdërvjellët dhe jo e fjetur. Prandaj propozoj që në ndonjë nga mbledhjet e ardhshme ta diskutojmë këtë problem për të përmirësuar stilin dhe metodën e punës sonë. Por më parë duhet të reflektojmë, ta rishikojmë e ta studiojmë mirë ne vetë, dhe pastaj të vijmë këtu me propozime konkrete.

Punonjësit e aparatit të Presidiumit duhet të na ndihmojnë ne, që të mund t'i ndihmojmë edhe ne ata. Por, që të bëhet kjo, punonjësit e këtij aparati duhet të studiojnë dhe të ngrihen mbi nivelin e funksionarëve të zakonshëm të organeve lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore. Edhe ne të gjithë duhet të mendojmë e të përpiqemi që ta ngremë punën e Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të aparatit të tij në një nivel sa më të lartë.

Si pikë e dytë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të Kolonjës dhe të Pukës, për punën e bërë nga ana e tyre për rritjen e rolit dhe të veprimtarisë së këshillave popullorë të bazës. Duke folur për këtë, shoku Suat Leka, në atë kohë

kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Kolonjës, në mes të tjerash, tha se «Për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë, në disa fshatra, me iniciativën e vetë anëtarëve të kooperativave, një pjesë e kopshtit personal të secilit është kolektivizuar, ashtu siç është kolektivizuar edhe bagëtia».

SHOKU ENVER HOXHA: Përsërite edhe një herë se nuk e kuptova qartë këtë që the për kopshtin personal.

SHOKU SUAT LEKA: Me iniciativën e kooperativistëve, shoku Enver, 300-400 metra sipërfaqe të kopshtit personal te ne i kanë kolektivizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush jua ka dhënë juve këtë direktivë?

SHOKU SUAT LEKA: Për këtë nuk ka ndonjë direktivë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po atëherë, si i shkelni direktivat e Komitetit Qendror?

Ç'do me thënë kjo? Ç'janë këto gjëra që bëni ju, more shok!? Ç'do me thënë t'i kolektivizojmë? Komiteti Qendror s'ka dhënë asnjë orientim të tillë që të kolektivizohet kopshti personal! Ai ka dhënë vetëm direktivën që të tufëzohen bagëtitë e oborreve, por edhe tufëzimi të bëhet kur të duan fshatarët dhe pasi të binden ata.

Anulojeni përnjëherë këtë shkelje që keni bërë dhe çdo anëtar i kooperativës t'i kthehet sipërfaqja e kolektivizuar!

SHOKU SUAT LEKA: Termi tufëzim nuk qe në rregull.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, kjo nuk është çështje

termi; puna është te brendia e çështjes dhe kjo ka rëndësi të madhe. Nuk lejohet në asnjë formë të kolektivizohet toka e oborrit! Prandaj, merrni masa përnjëherë dhe e vini në vend këtë situatë. Ç'janë këto iniciativa të rrezikshme që po merrni? Për herë të parë nga ju po e dëgjoj këtë çështje që të kolektivizohen sipërfaqet e oborreve.

Të tilla gjëra të mos bëhen më!

Për sa i përket propozimit që u bë këtu që mbledhjet e këshillit popullor mund të bëhen dy-tri herë në javë, unë mendoj se kjo nuk është e drejtë dhe e nevojshme. Në qoftë se anëtarët e këshillit do të mblidhen 2-3 herë në javë, kjo do të thotë që ata të largohen nga punët dhe kështu të mbeten prapa. Tri herë në javë, më duket mua, nuk ka ç'duhet mbledhja e këshillit, kudo që të jetë, fshat apo qytet, njëlloj është. Unë nuk dëgjova që të flisnit për periudha të veçanta! Një mendim i tillë, sipas pikëpamjes sime, nuk duhet të jetë i rekomandueshëm.

Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverballi i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH, që gjendet në AQP

STRATEGJI E PËRBASHKËT KINO-AMERIKANE

Shënime

28 maj 1978

Sido që është e zorshme dhe e lodhshme për mua, e kam për detyrë që, në interes të marksizëm-leninizimit, të revolucionit e të mbrojtjes së atdheut tonë socialist, të ndjek dita-ditës të rejat e radiove dhe të agjencive të lajmeve; të lexoj me kujdes shtypin e huaj, sidomos atë evropian, sepse këto flasin për të gjitha problemet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe problemin e Kinës e politikën e saj.

Nga gjithë ky lexim, natyrisht, duhen nxjerrë konkluzione pak a shumë të sakta, sepse, në mënyrën e shtruarjes së çështjeve, jo vetëm nga forma, por sidomos nga përmbajtja, tek të gjitha agjencitë e lajmeve të shteteve kapitaliste ose në gazetatat e tyre ekzistojnë tendenca të ndryshme, të cilat, në rast se nuk njihen si duhet, të pengojnë të nxjerrësh të vërtetën për një problem ose për një tjetër.

Sidoqoftë, këto që lexoj jam përpjekur t'i shoh me syrin marksist-leninist. Ne i ndjekim me vëmendje dhe i shohim ngjarjet në prizmin e Kongresit të 7-të të Partisë e të studimeve që ka bërë Komiteti ynë Qendror,

sidomos në lidhje me Kinën, dhe konstatojmë se parashikimet e Partisë sonë vërtetohen në jetë. Praktika tregon rrugën antimarksiste të Kinës, rrugë që po e çon atë me shpejtësi drejt shndërrimit në një shtet social-imperialist, në aleancë të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllim që edhe ajo të krijojë kolonitë e saj në prizmin e neokolonializmit dhe për të kundërshtuar fuqinë tjetër socialimperialiste, Bashkimin Sovjetik. Kina ka hyrë kështu thellë në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të zaptuar botën së toku me to, për të ruajtur sferat e tyre të shfrytëzimit, për të krijuar edhe Kina sferat e veta e për t'ia ngushtuar zonat e influencës socialimperializmit sovjetik. E gjithë kjo veprimtari bëhet në kurriz të popujve, kundër luftës së tyre të çlirimit dhe kundër revolucioneve proletare. Pra Kina ka hyrë në ndeshje me marksizëm-leninizmin.

Vizita e Brzezinskiut në Kinë vërteton atë që ka thënë Partia jonë në Kongresin e 7-të dhe që është pasqyruar në të gjitha qëndrimet e saj politike, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë aspak në tërheqje e në difensivë, përkundrazi, janë në ofensivë në të gjitha anët e botës. Baza dhe thelbi i bisedimeve të Brzezinskiut me udhëheqësit kinezë kanë qenë shqyrtimi i strategjisë së dy vendeve ndaj Bashkimit Sovjetik, pra, se si ta kundërshtojnë këto dy fuqi imperialiste Bashkimin Sovjetik në veprimtarinë e tij imperialiste.

Të dy këto shtete, Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet bisedimeve të Brzezinskiut me udhëheqjen kineze, kanë arritur në marrëveshje për një strategji të përbashkët, për koordinim veprimesh, ndar-

je pune e dhënie ndihme reciproke, për të eliminuar ose për të kufizuar në maksimum depërtimin dhe influencën e Bashkimit Sovjetik sidomos në Afrikë dhe në Azi, në radhë të parë, por edhe në kontinente të tjera.

Sipas lajmeve që kemi lexuar dhe nga informacioni që kemi, ndër të tjera del se Kina përpiket të marrë drejtimin e luftës nacionalçlirimtare në Rodezi dhe në Namibi për të çuar në një zgjidhje paqësore në binarët e tezave amerikane, por pa dalë vetë në skenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllim që në këto vende t'u pritet rruga Bashkimit Sovjetik dhe Kubës.

Me fjalë të tjera, Kina, për t'u bërë edhe ajo superfuqi, po kthehet në një shtet mercenar. Ajo po bën të njëjtën gjë, si Bashkimi Sovjetik, del me të njëjtat parulla. Edhe Bashkimi Sovjetik, flet për çlirimin nacional, për luftën nacionalçlirimtare, për ecjen drejt socializmit. Edhe Kina po ashtu flet e do të flasë për luftën nacionalçlirimtare, për çlirim dhe për socializëm në të gjitha ato vende, ku përpiket të futë hundët e për këtë ka mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ne shohim, pra, që Kina të futet në Somali dhe në Etiopi, të përkëdhelë Angolën, të dërgojë ministrin e saj të Jashtëm në Zaire te presidenti kriminel dhe i falimentuar Mobutu, dhe tash, sipas konkluzioneve që nxjerrim nga këto informata, merr përsipër edhe luftën në Namibi e në vende të tjera të Afrikës.

Kina do të depërtojë në këto vende, natyrisht me dhënien e armëve, duke i shitur ose duke i falur ato. Aktualisht Kina nuk bën ndonjë shpenzim të madh për këto armë, për arsye se është në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto të fundit arma-

timet e veta ua japin këtyre popujve, që luftojnë jo vetëm kundër Bashkimit Sovjetik, por edhe kundër vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës nëpërmjet Kinës. Këtu çështja është të mbështeten krerët e këtyre vendeve për të kundërshtuar ndërhyrjen sovjetiko-kubane, për të pranuar ndërhyrjen amerikano-kineze, për të ruajtur statukuonë mbi kurrizin e popujve. Natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk rrinë krejt prapa skene. Vërtet ato nuk dërgojnë ushtarë të tyre në këto vende, por dërgojnë ndihma të tjera. Aktualisht edhe Kina përpiqet të ndihmojë me armë dhe me materiale. Hëpërhë ajo nuk dërgon ushtarë, po kontingjente punëtorësh e sipërmarrës ndërmarrjesh.

Është e qartë pikëpamja e drejtë e Partisë sonë, e cila prej kohësh ka thënë se teoria e «tri botëve» e Mao Ce Dunit nuk është një teori marksiste, por një teori kolonialiste, që i hap Kinës perspektivën e zaptimit të tregjeve në botë për t'u bërë superfuqi nën maskën e socializmit dhe të ideve të marksizëm-leninizmit. Pra, siç po del, Kina ka marrë përsipër të luajë një rol kolonizues në Afrikë. Pikërisht me këtë rol mund të shpjegohen të gjitha vajtjet e ardhjet e krerëve të këtyre vendeve gjysmëkoloniale.

Brzezinski, sipas informacioneve, duhet të ketë theksuar se disa njerëz gabojnë kur thonë se amerikanët janë në tërheqje dhe në difensivë, ose se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dobësuar përpara Bashkimit Sovjetik, ose që po e ndalojnë ekspansionin e tyre. Përkundrazi, paska thënë ai, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të forta; ato nuk i braktisin miqtë dhe janë në gjendje t'i bëjnë ballë çdo sfide të Bashkimit

Sovjetik, se ato janë e kurdoherë do të jenë superiorë ndaj Bashkimit Sovjetik në çdo fushë dhe garantojnë miqtë e tyre në çdo pikë të globit, edhe ata në Evropë, ku Bashkimi Sovjetik nuk guxon dot të sulmojë, se e pret disfata.

Natyrisht, këto pikëpamje të Brzezinskiut janë pranuar nga Kina, pse kjo të gjitha çka thotë për luftën iminente, për sulmin kundër Evropës nga ana e Bashkimit Sovjetik, që as ajo nuk e beson, të gjitha këto, siç i kemi shpjeguar edhe herë të tjera, kanë për qëllim të shuajnë revolucionin në Evropë, të ngjallin frikën në radhët e revolucionarëve evropianë. Përpjekjet e Kinës synojnë që në botë të mos krijohen parti marksiste-leniniste, të cilat ta tërheqin proletariatin në luftë kundër borgjezisë, por ky proletariat dhe gjithë popujt e Evropës t'u nënshtrohen NATO-s, Shteteve të Bashkuara të Evropës dhe Tregut të Përbashkët Evropian; pra, të bëhen shërbëtorë dhe mish për top i këtyre shteteve që luftojnë të dalin nga kriza dhe të kenë mundësi ta ndihmojnë Kinën për t'u bërë superfuqi. Ato synojnë, gjithashtu, që t'i krijojnë Bashkimit Sovjetik një psikozë se në Evropë gjoja po përgatitet lufta dhe të heqë vëmendjen nga Azia. Ky është plani i çmendur i fashistëve kinezë.

Brzezinski ka vënë në dukje në Pekin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës evitojnë për çdo rast ballafaqimin dhe komprometimin e drejtpërdrejtë, por në shumë raste veprojnë përmes miqve të tyre, si në ngjarjet e fundit në Zaire, ku vepruan përmes elementëve francezë dhe belgë. Këtë kërkojnë Brzezinski dhe Shtetet

e Bashkuara të Amerikës që të bëjë edhe Kina në intere të tyre.

Duke analizuar ngjarjet që po zhvillohen në Azi, Brzezinski ka paraqitur një tablo të politikës sovjetike dhe ka folur kundër Bashkimit Sovjetik në mënyrë të hapët. Ai ka folur për rrethimin që Bashkimi Sovjetik përpiqet t'i bëjë Kinës, prandaj Kina të mbështetet te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kuadrin e kufizimit të Bashkimit Sovjetik në Azi ai ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë kundër traktatit të Kinës me Japoninë, duke përfshirë në të edhe dispozitat antihegemoniste. Siç duket, ai e ka këshilluar Kinën të zhvillojë marrëdhënie edhe me Indinë, ka shpjeguar shqetësimin për gjendjen në Pakistan etj.

Për çështjen koreane Brzezinski, sipas këtyre të dhënave, ka ritheksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk bisedojnë me Kim Ir Senin pa praninë e Pak Çen Jisë, kurse kinezët u janë referuar fjalimeve të Hua Kuo Fenit në Kore. Me një fjalë, mirëkuptim reciprok, pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës e dinë se Kina është për qëndrimin e amerikanëve në Korenë e Jugut.

Siç shihet, pra, po luhen letrat Kinë-Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të dyja palët janë të kënaqura për këtë zhvillim. Për mosrealizimin e plotë të dëshirave të tyre, Kina i kupton vështirësitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, megjithatë këto janë dashamirëse ndaj saj dhe ndaj politikës që ndjek ajo.

Për sa i përket çështjes së Tajvanit, kjo është mjaft e komplikuar, por jo e pazgjidhur. Të dyja pa-

lët, sipas informatave që kemi, thëksuan nevojën që të zhvillojnë me të shpejtë shkëmbimet tregtare. Brzezinski paska thënë se Hua Kuo Feni e ka situatën në dorë, pse ai i zotëronte problemet, se, kur fliste, shpesh largohej nga teksti i përgatitur dhe ngrinte probleme të reja, pa pyetur Ten Hsiao Pinin ose ministrin e Jashtëm kinez, që ishin të pranishëm, kurse Ten Hsiao Pini mbetet, ka thënë Brzezinski, kompetent *en brevet*¹.

Nga informacioni dhe gazetat që lexojmë kuptohet se të dyja palët kanë vendosur që bisedimet e zhvilluara të mbahen të fshehta. Por, sado të fshehta që të mbahen, ato prapë po dalin jo vetëm nëpërmjet informacionit dhe shtypit por edhe me veprimet në jetë të Kinës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Planet e kompletet e thurura do të vërtetohen, gjithashtu, në Afrikë, në vendet arabe, në Gjirin Persik e në shtetet rreth e rrotull dhe sidomos në Azi, ku edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Kina tok me Japoninë, në solidaritet të plotë midis tyre dhe pavarësisht se nuk kanë një traktat marrëveshjeje, po veprojnë për interesat e tyre, megjithëse gjejnë vështirësi të mëdha.

Kina është armiqësuar gati me të gjitha vendet e Azisë që ka rreth e qark saj. Edhe ajo pseudomiqësi që ekziston midis tyre, është pa kurrfarë baze, e gënjeshtërt. Shumë herë kjo pseudomiqësi është kthyer në armiqësi në mes Kinës dhe shteteve të tjera. Ja, për shembull, si mund të jetë Kina në miqësi me Af-

1. Frëngjisht — këtu, në kuptimin kompetent në formulime, në teori.

ganistanin, udhëheqja e të cilit është nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe absolut të sovjetikëve? Si mund të jetë tash Kina mike me Pakistanin, kur mikun e saj Ali Buton ia ka dënuar me vdekje Zia ul Haku? India, e cila është një kontinent i tërë, në unitet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Sovjetik e në kundërshtim të përhershëm me synimet kineze për dominim në botë dhe veçanërisht për Tibetin, mund të jetë vallë një mike e Kinës? Jo, nuk mund të jetë, për të mos folur më tej për Indonezinë, si dhe për shtetet e Indokinës, përveç Kamboxhias, që aktualisht janë në armiqësi të hapët me Kinën.

Edhe Vietnami gjendet në pozita, si me thënë, të shkallës së fundit të marrëdhënieve pseudomiqësore me Kinën, bile është në konflikt me të për çështje territoriale dhe për arsye të nënshtetasve kinezë që banojnë në Vietnam.

Kinezët thonë se në këtë çështje është dora e sovjetikëve. S'ka asnjë dyshim që sovjetikëve u pëlqen një situatë e tillë, që Vietnami të bëhet një bastion kundër Kinës, por Kinës nuk i intereson që Vietnami të futet nën influencën e sovjetikëve. Kinezë e sovjetikë po ndërhyjnë në çështjet e brendshme të popujve të Indokinës, pra, jo vetëm në Vietnam, por edhe në Laos, në Kamboxhia, në Tajlandë e gjetkë.

Kjo është tabloja që mund të nxjerrësh aktualisht nga vizita e Brzezinskiut në Pekin, nga situata e sotme botërore në përgjithësi dhe nga politika në zhvillim e Kinës në këtë botë të turbullt me greva të mëdha, me kriza të fuqishme politike, ekonomike dhe ushtarake. Në këto situata duket qartë qëndrimi reaksionar i

Kinës. Prandaj popujt e botës dhe revolucionarët e demokratët e vërtetë shohin se ajo është bërë me të vërtetë një fuqi, e cila nuk lufton për socializmin, për revolucionin, por lufton për t'u bërë një fuqi e madhe. Kina tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpiqen të rindajnë më mirë me njëra-tjetrën tregjet botërore dhe të shfrytëzojnë për një kohë akoma më të gjatë popujt e botës që kërkojnë liri dhe pavarësi.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 461

KUR I DËGJON MASAT, RRRIT BESIMIN E TYRE TE PARTIA

Shënime

29 maj 1978

Sot në orën dhjetë e gjysmë, si zakonisht, në sekretarët e Komitetit Qendror u takuam dhe shoku Simon Stefani, sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, na informoi për punën që po bëhet për prodhimin e disa pajisjeve elektroshtëpiake, me kooperim të dy-tri uzinave të Tiranës. Po bëhen të gjitha përpjekjet që ato të prodhohen të mira, një-lloj si të jashtmet dhe me çmime sa më të lira.

Me këtë rast edhe shoku Prokop Murra na vuri në dijeni për inaugurimin e Uzinës së Lëndëve Plastike në Lushnjë, që, siç tha ai, është një uzinë e re dhe e pastër. Ai na tregoi edhe një numër artikujsh të ndryshëm që prodhohen atje, si çanta, portofole, mushama për kalamanët, përparëse etj., etj. Por, në përgjithësi, prodhimin kryesor në atë uzinë aktualisht e përbëjnë thasët për plehurat azotike dhe tubat për ujitje. Prodhimet e saj duhet të zgjerohen me mallra të tjera të konsumit të gjerë e të përditshëm, me artikuj për nevoja hidrosanitare etj.

Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë një kthesë të vërtetë e të mos qëndrojmë, për shembull, vetëm në prodhimin e një numri të kufizuar të artikujve të konsumit të gjerë, si pelerina, futa, çanta, portofola e nuk e di se çfarë tjetër dhe me këto të kënaqemi. Ne duhet të nxjerrim nga kjo uzinë me qindra lloj artikujsh, me bojra e me madhësi të ndryshme, që nga këllëfi i kreherit dhe deri te këpucët. Dhe të gjitha këto të mos i prodhojmë standard, por me lloj-lloj formash e dimensionesh, që kështu të plotësojmë më mirë nevojat dhe kërkesat e popullit. Kjo arrihet kur ne të prodhojmë pikërisht ato mallra që dëshiron ai. Për këtë duhet të ndryshojë pikëpamja stanjante, burokratike dhe rutinë që ekziston nëpër ndërmarrjet tona, që mbërthehen në planifikime të palëvizshme e pa perspektivë, prirën nga globali etj. Të gjitha këto ne i kemi thënë edhe herë të tjera, por përsëri ato nuk po kapërcehen. Këtu ndikojnë disa faktorë, si psikologjikë edhe teknikë, çështje mentaliteti e botëkuptimi. Pengesat që rrjedhin prej tyre ne duhet t'i luftojmë, ndryshe nuk mund të zhvillohet prodhimi e nuk mund të tërhiqet paraja nga populli. Në qoftë se në treg nuk hedhim llojshmëri mallrash dhe në sasi të madhe, qofshin këto prodhime industriale apo bujqësore, në qoftë se nuk shtojmë shërbimet etj., etj., punonjësit nuk nxiten të shpenzojnë e të blejnë.

Një çështje tjetër që duhet të kemi parasysh jo vetëm për veprat e reja, por edhe për ato ekzistueset, është caktimi i afatit të amortizimit të çdo objekti. Kjo ka rëndësi të madhe, pse mund të caktosh afate të shkurtra, ashtu siç mund të caktosh afate edhe më të

gjata nga ç'duhet. Në qoftë se caktojme afate më të shkurtra, kjo do të rëndojë në kosto dhe për pasojë edhe në çmimet e shitjes së mallrave. Prandaj për afatet e amortizimit duhet të caktohet koha më optimale. Në qoftë se shtojmë numrin e punëtorëve dhe nuk do të realizojmë normat e rendimentet e parashikuara, përsëri këta faktorë rëndojnë në koston e mallit. Në këtë mënyrë ne nuk shkojmë drejt uljes së koston dhe pastaj edhe të çmimeve. Me këto dua të them se përcaktimi i fondit dhe i afatit të amortizimit ka një rëndësi të madhe, ndaj kjo punë duhet bërë në mënyrë të studiuar mirë. Të mbahet parasysh jo vetëm ana teknike e leverdia ekonomike, por të shikohet edhe fuqia blerëse e popullit. Kjo varet nga bilancet e shitblerjes në tregun e brendshëm dhe matet fare lehtë me monedhën që ndodhet në duart e popullit.

Puna është që ne të mos shesim as me humbje, por as me çmime të larta; të mos prodhojmë të atilla mallra që të na mbeten nëpër depo e të na prishen, por edhe të mos ecim me hapin e breshkës për të lëvizur disa çmime, të cilat caktohen pa llogari të shëndosha e janë të shtrenjta, për arsye se dalin për herë të parë. Një punonjës mund ta blejë një mall të ri të dalë për herë të parë, qoftë edhe me çmim pak të lartë, por më vonë ai mund të mos e blejë dot përsëri atë mall në treg. Sigurisht kjo është punë e secilit, por që të shiten sa më shumë artikuj është jo vetëm në interesin e shtetit, por edhe të blerësve e të konsumatorëve, pse kënaq nevojat dhe shijet e tyre me mallra të cilësisë së mirë.

Për sa u përket çmimeve të artikujve të uzinës së plastmasit mendoj se rabatet që u vihen mallrave të

prodhuara janë shumë të mëdha, në një kohë kur kostoja e tyre është e ulët. Shpreha mendimin që ky problem të studiohet mirë. Gjatë kohës që do të punohet për ta vënë uzinën në punë me ngarkesë të plotë, të merren masa që punëtorët e saj të perfeksionohen çdo ditë e më shumë nga ana tekniko-profesionale, sepse ata janë të rinj në këtë zana, pra nuk kanë eksperiencë. Si të tillë ata punojnë pa norma ose me norma të ulëta, por paguhen me kategori të larta. Duke pasur parasysh faktin që ata akoma nuk e njohin mirë procesin e punës në këtë objekt, mendoj se hëpërhë, nuk duhet të shtohet numri i tyre, por të bëhen përpjekje të ngrihet rendimenti i punës përmes kualifikimit dhe vendosjes së normave teknike. Kështu do të arrijmë që pas disa muajsh ta vëmë në shfrytëzim me kapacitet të plotë këtë vepër me këtë numër punëtorësh që ka tani dhe jo duke i shtuar ata.

Duke marrë shkas nga këto probleme, shfaq disa mendime se si duhet organizuar më mirë drejtimi i punëve në komitetet e Partisë të rretheve, sidomos në atë të Tiranës, dhe theksova që problemet që kanë dalë lidhur me revolucionin tekniko-shkencor, të zgjidhen nga organet e pushtetit në rreth. Gjithashtu, edhe kuadrot specialistë, që do të merren me studimin e temave që janë caktuar nga Qeveria, të ngulen mirë në punë e të veprojnë, por këto punë duhen bërë me kujdes shumë të madh që problemet të zgjidhen drejt, në kohën e caktuar dhe me minimumin e specialistëve. Kjo do të thotë që këta të punojnë në mënyrë racionale dhe jo sa kohë të duan dhe pa kontroll.

Që të arrihet kjo, i thashë shokut Simon, mund të

procedosh duke grumbulluar rreth vetes një grup inxhinierësh dhe teknikësh që kuptojnë nga problemet që i janë caktuar rrethit të Tiranës. Mbasi të njihen me problemet në fjalë, atyre mund t'u marrësh mendimin për afatin që është caktuar, si dhe për numrin e specialitetin e kuadrove që do të merren me to. Kjo ka rëndësi të madhe, për dy arsye:

E para, që të mos angazhohmë për të zgjidhur këto probleme specialistë të zotë më tepër nga ç'duhet, sepse, duke u marrë me këto punë, ata do të lënë bosh drejtimin nëpër fabrika e institute të tjera.

E dyta, të mos harrohet se revolucioni tekniko-shkencor nuk konsiston vetëm në studimin e këtyre çështjeve, por sidomos në përmirësimin e teknologjisë, në ngritjen e rendimentit, në rritjen e mekanizimit të punimeve dhe në racionalizime të ndryshme nëpër fabrikat dhe ndërmarrjet ekzistuese, që prodhojnë çdo ditë. Ky është një problem kapital që e kam shtruar edhe në Byronë Politike e në Sekretariatit e Komitetit Qendror, prandaj i porosita shokët që ta kenë vazhdimisht në kujdes.

Punimi me grupe, jo vetëm për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, por për të gjitha problemet, ka një rëndësi të veçantë. Dhashë mendimin që kurdoherë, për çështjet kapitale që do t'i dalin Tiranës (dhe të tilla ajo ka mjaft, sepse ka shumë sektorë pune dhe të komplikuar), të thirren vazhdimisht njerëz kompetentë, t'u shtrohen ato një nga një, të diskutohet me ta e t'u merret mendimi që kanë për të gjitha anët: teknike, materiale, financiare etj. Kështu do të studiohen nga të gjitha anët çështjet që mund të shtrohen, qoftë

në Komitetin Qendror, qoftë në dikastere, qoftë në Komisionin e Planit të Shtetit. Kjo mund të bëhet jo vetëm për çështje ekonomike, por edhe për ato të kulturës, të arsimit etj., etj.

Këto konsulta e diskutime duhen organizuar mirë, sepse problemet për të cilat ato bëhen, janë të rëndësishme, por që duan edhe një afat për t'u zgjidhur. Ndaj edhe koha duhet të jetë e llogaritur saktë për secilin. Puna është që në këto takime secili të vijë sa më i përgatitur, me qëllim që në to tjetri jo të flasë sa të dojë e të të harxhojë kohën. Shokët që do të të vijnë për të tilla probleme, i theksova shokut Simon, duhet të dinë se ti je i zënë edhe me një tog punësh të tjera: ke kuadro që duan të konsultohen, ke organizata, ku duhet të shkosh për t'u sqaruar ndonjë çështje apo për t'u dhënë ndonjë këshillë; ke persona të veçantë, të cilëve u ke lënë takim në orë të caktuara e kështu me radhë. Pra, çdo pune duhet t'i planifikosh kohën e nevojshme. Ata që do të bashkëpunojnë me sekretarin e parë të rrethit, duhet të vijnë të përgatitur mirë, të informojnë drejt, realisht, shkurt, qartë dhe ta shohin problemin në kompleks. Në qoftë se ndonjëri nuk është përgatitur si duhet, të rikthehet e t'i thuhet të vijë një ditë tjetër, veçse të jetë i përgatitur plotësisht. Kjo e ndihmon sekretarin e parë jo vetëm për ta organizuar mirë punën, por në këtë mënyrë futet një stil dhe një metodë e perfeksionuar në punën e Partisë dhe të sekretarëve të tjerë të komitetit. Pa një organizim të tillë pune nuk mund të ndiqen e të zgjidhen të gjitha problemet, sidomos në Tiranë.

Por kjo ka rëndësi të madhe edhe për një arsye

tjetër. Një metodë pune e tillë krijon besim të madh te njerëzit, të cilët thonë se Partia na pyet, konsultohet e diskuton me ne. Mendimet, propozimet e këshillat tona, ajo nuk i hedh në shportë, nuk i lë t'i marrë era, por i vë në zbatim. Në këtë mënyrë Partia lidhet ngushtë me punëtorët e me specialistët dhe sigurohet uniteti i mendimit dhe i veprimit të masave të gjera punonjëse. Në qoftë se bëhet një punë e tillë, siç parashtrova më lart, atëherë del më konkrete edhe puna e instruktorit, roli dhe detyrat e tij. E them këtë se komiteti i Partisë do ta dërgojë instruktorin me detyra të veçanta në organizata-bazë, për të dhënë udhëzime, për të kontrolluar zbatimin e ndonjë vendimi, porosie, orientimi etj., dhe ai do të vijë të raportojë se ç'po bëhet për to.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

EMANCIPIMI I GRUAS SHQIPTARE — NJË NGA VEPRAT MË TË RËNDËSISHME TË PARTISË SONË

Përsëritje drejtuar Kongresit të 8-të të BGSII¹

1 qershor 1978

Të dashura shoqe delegate,

Mbarë Shqipëria ndjek me vëmendje e gëzim Kongresin e 8-të të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, këtë ngjarje me rëndësi për jetën e vendit. Flamujt e fitoreve, me të cilët ju vini në Kongresin tuaj, janë fryt i përpjekjeve të të gjitha grave të Shqipërisë, të të gjithë popullit tonë për të realizuar programin e Partisë për emancipimin e plotë të gruas dhe të gjithë shoqërisë sonë socialiste.

Është një kënaqësi e veçantë për mua që, në emër të Komitetit Qendror, të të gjithë Partisë dhe timin personal, t'ju përsërites ju shoqe, gjithë gratë heroike të Shqipërisë socialiste, dhe t'ju uroj punë të mbarë e sukses në punimet e Kongresit. Le të buçasë në Kon-

1. Kongresi i 8-të i BGSII i zhvilloi punimet nga 1-3 qershor 1978.

gresin tuaj zëri i grave dhe i vajzave tona luftëtare, le të shprehen fuqishëm mendimi dhe vendosmëria e tyre për të çuar përpara çështjen e revolucionit dhe të ndërtimit tonë socialist!

Kongresi juaj është një dëshmi e gjallë e atij revolucionit të thellë e të gjerë që ka ndodhur në jetën e gruas shqiptare. Vetë ju që keni ardhur nga kantieret e veprave të reja, nga fushat e lulëzuara, nga zonat malore ose qytetet e mëdha, pasqyroni realitetin madhështor të vendit tonë, gruan e re të çliruar nga shtypja e shfrytëzimi, gruan punëtore e luftëtare, të edukuar, të arsimuar e të kulturuar, që merr pjesë jo vetëm në prodhim, por edhe në drejtimin e shtetit e të Partisë, ju pasqyroni atë barazi të plotë e dinjitet të lartë që i dha gruas socializmi.

Partia ndien një gëzim të veçantë kur shikon te gratë e Shqipërisë atë shkallë të lartë emancipimi për të cilën ajo ka punuar e ka luftuar qysh në ditët e para të themelimit të saj. Te gratë Partia gjeti atë shpirt të pamposhtur të popullit tonë që u rezistoi në shekuj me radhë shtypjes dhe shfrytëzimit, gjeti ato virtyete të larta që do t'i bënte luftëtare të paepura në luftë; te gratë Partia gjeti dhe atë forcë që i duhej atdheut për ndërtimin e Shqipërisë së re. Gratë e vendit tonë kanë treguar kurdoherë me vepra të shumta dashurinë e madhe dhe devocionin e pakufishëm që kanë për Partinë, sepse te Partia ato panë udhëheqësen e vërtetë që do të realizonte ëndrrën e madhe të tyre, që do t'i bënte të lira e të barabarta, të nderuara e të respektuara në shoqëri. Prandaj, me thirrjen e Partisë, gruaja shqiptare u ngrit me guxim në Luftën Antifashiste

Nacionalçlirimtare, në luftën për të shkatërruar pushtetin e vjetër, për të shkallmuar ligjet e kanunet e tij, për të zhvilluar me konsekuencë luftën e klasave, për të ndërtuar shoqërinë socialiste dhe për të afirmuar normat e zakonet e reja të moralit proletar.

Fitoret e arritura në këto luftëra u çimentuan edhe me gjakun e kulluar të bijave më të mira të popullit tonë. Për Partinë, për popullin dhe për atdheun janë dhe do të mbeten kurdoherë të shtrenjta e të paharruara heroinat e lavdishme Mine Peza e Qeriba Derri, Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima, Marta e Prena Tarazhi dhe të gjitha ato gra e vajza që historia i ka vënë përkrah trimave të shquar të këtij vendi.

Nga lartësitë e arritura duket qartë rruga e lavdishme në të cilën ka ecur gruaja shqiptare, rruga e luftës për revolucionin socialist, pa të cilin nuk mund të kishte çlirim dhe emancipim të vërtetë të shoqërisë, pra edhe të gruas në vendin tonë. Kjo rrugë ka qenë e mbetet një shkollë me vlerë të pallogaritshme për gratë e sotme të Shqipërisë socialiste dhe për të gjithë brezat që do të vijnë. Ajo tregon se ç'është në gjendje të bëjë revolucionin proletar për gruan dhe vetë gruaja për revolucionin, kur udhëhiqet nga partia marksiste-leniniste.

Emancipimi i gruas shqiptare, një nga fitoret më të mëdha të revolucionit socialist dhe një nga veprat më të rëndësishme të Partisë sonë, madhështohet edhe më tepër kur shohim gjendjen e gruas në botën kapitaliste e revizioniste. Edhe atje flitet për emancipim të gruas, por kjo është vetëm një parullë propagandistike, sepse në realitet në atë shoqëri të padrejtë e çnje-

rëzore, gruaja, më shumë se kushdo, përdoret si plaçkë tregu dhe është objekt shfrytëzimi të pamëshirshëm. Gratë janë ndër të parat viktime të pasojave të rënda të krizës ekonomiko-financiare; ato hidhen në mes të katër rrugëve; ato janë shtresa më e shtypur e më e papërfillur e shoqërisë.

Në sukseset e arritura Partia vlerëson rolin e madh që ka luajtur organizata luftarake e Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Gjatë 35 vjetëve të ekzistencës së saj ajo i ka kryer me devotshmëri detyrat që i ka besuar Partia për edukimin e mobilizimin e grave. Prandaj, të dashura shoqe, forcojeni edhe më shumë organizatën tuaj të madhe, rritni rolin e saj, për t'i mbrojtur e për t'i çuar përpara fitoret e arritura, për ta konsoliduar e për ta ngjitur më lart emancipimin e gruas.

Shoqe delegate,

Kongresi i 7-të i Partisë shtroi një program të madh pune e lufte për zhvillimin e gjithanshëm të vendit në rrugën e socializmit, duke u mbështetur, si gjithnjë, në forcat e veta. Ky program nuk mund të realizohet me sukses pa pjesëmarrjen aktive të grave, pa luftën e tyre revolucionare. Partia e thërret gruan në punë, sepse pa të nuk ecën dot prodhimi; e thërret në jetë me armë në dorë, sepse pa të nuk mbrohet atdheu; e thërret të ngrejë nivelin e saj marksist-leninist, arsimor e kulturor dhe tekniko-profesional, sepse pa të nuk mund të lartësohet personaliteti i gruas; e thërret në qeverisjen e vendit, sepse pa pjesëmarrjen e saj nuk

mund të ketë zhvillim të demokracisë socialiste. Partia ka besim të patundur se gruaja shqiptare, si kurdoherë, do të qëndrojë në lartësinë e detyrave të saj, do të jetë, si gjithnjë, në radhët e para të luftës për socializëm.

Gjithë shoqëria jonë — punëtori e kooperativisti, inxhinieri e tekniku, oficeri dhe ushtari — janë të interesuar për problemet që do të diskutoni në Kongresin tuaj dhe për detyrat që do të merrni përsipër, sepse krah për krah me shoqet e tyre ata ndërtojnë e lulëzojnë vendin, çajnë rrethimin imperialisto-revizionist, mposhtin bllokatat ekonomike e presionin ideologjik të tij, çojnë përpara revolucionin socialist.

Shoqëria është e interesuar shumë edhe për misionin fisnik të gruas si nënë, për rolin e madh që luan ajo në rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Vendi ynë ka një brez të ri të mrekullueshëm, besnik ndaj Partisë e popullit. Për këtë kanë meritë të madhe edhe nënat shqiptare, të cilat i rritin e i edukojnë fëmijët t'u ngjajnë për nga trimëria, guximi e patriotizmi dhe t'ua kalojnë për nga dituria e për nga hapat më të mëdhenj që do të hedhin në rrugën e ndritur të socializmit. Gratë e vendit tonë kanë ngulitur në zemrat e rinisë dashurinë për Partinë e për atdheun socialist, ato luftojnë për t'i bërë familjet çerdhe ku rriten shqiponja, ku djemtë e vajzat të frymëzohen për t'i shërbyer socializmit në fusha e në male, në fabrika e kantiere, në shkolla e laboratorë, kudo ku ka më shumë nevojë atdheu. Kjo është një çështje jetike për të sotmen dhe të ardhmen e Shqipërisë socialiste.

Populli dhe Partia janë të ndërgjegjshëm se për emancipimin e pandërprerë të gruas duhen bërë për-

pjekje edhe më të mëdha nga gjithë shoqëria që ajo të vihet plotësisht në rolin që i takon, si forcë e madhe revolucionare e ndërtimit të socializmit dhe e mbrojtjes së atdheut, që të çrrënjosen si te burrat, ashtu edhe te gratë mbeturinat, mentalitetet dhe paragjykimet e vjetra, që të luftohen shfaqjet liberale e konservatore, ndikimet borgjezo-revizioniste, që e frenojnë gruan të tregojë kurdoherë tërë vlerat e aftësitë e saj. Partia është e bindur se organizatat e Partisë dhe ato të masave, organet shtetërore dhe ekonomike, institucionet arsimore e kulturore, mbarë punonjësit do të luftojnë të gjithë së bashku për ta çuar përpara nga fitorja në fitore emancipimin e gruas.

Të dashura shoqe delegate,

Situatat sot në botë janë të turbullta e të rënduara me rreziqe e kërcënime të mëdha për lirinë e pavarësinë e popujve. Borgjezia, imperializmi, sidomos ai amerikan e sovjetik, revizionistët e oportunistët e të gjitha ngjyrave orvaten me çdo mënyrë të shtypin revoltën e masave dhe të mbytin revolucionin, të minojnë luftën çlirimtare dhe të skllavërojnë të gjitha vendet. Superfuqitë dhe ata që i ndjekin nga pas zhvillojnë garën e shfrenuar të armatimeve dhe përgatiten ta hedhin njerëzimin në një luftë të re. Ata nxitin konflikte midis popujve dhe kombeve të ndryshme, ndërhyjnë brutalisht në punët e brendshme të tyre, thurin komplete kundër lirisë dhe sovranitetit të popujve.

Këto situata, që zhvillohen në botë e që ndryshoj-

në vazhdimisht, duhen ndjekur me vëmendje nga të gjithë, për të qenë kurdoherë të gatshëm e të përgatitur për të përballuar çdo rrezik që mund t'i kanoset atdheut tonë. Ato e bëjnë të domosdoshme që të ngremë më lart vigjilencën revolucionare, të çelikosim edhe më shumë unitetin e popullit rreth Partisë, të forcojmë pareshtur mbrojtjen e atdheut. Të punojmë të gjithë, burra e gra, pa u lodhur, për zhvillimin dhe fuqizimin e ekonomisë sonë socialiste, për t'i plotësuar deri në një detyrat e planit të gjashtë pesëvjeçar, për ta bërë jetën e popullit dhe të fëmijëve tanë më të bukur e më të begatshme.

Duke luftuar e duke punuar për ndërtimin e socializmit, gratë e Shqipërisë së re do ta ruajnë e do ta zhvillojnë frymën e internacionalizmit proletar që i karakterizon, do të jenë përkrah grave përparimtare të botës që luftojnë për emancipimin e të drejtat e tyre, do të jenë përkrah popujve që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror.

Qyteti i bukur i Durrësit, ku po zhvillohet Kongresi juaj, është një qytet me tradita të njohura patriotike e revolucionare, me një klasë punëtore të talentuar, me kulturë të lashtë e të zhvilluar. Le të jenë këto tradita dhe atmosfera entuziaste e popullit të Durrësit një frymëzim tjetër për punimet me sukses të Kongresit tuaj!

Nën udhëheqjen e Partisë, me idealet e saj në mendje e në zemër, hidhuni, shoqe, me hov të ri në beteja për të plotësuar detyrat e Kongresit të 7-të të Partisë, luftoni si revolucionare të vendosura për të ngritur edhe më lart lavdinë e atdheut socialist!

Rrofshin gratë heroike të Shqipërisë!

Rroftë organizata luftarake e Bashkimit të Grave të Shqipërisë!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Lavdi marksizëm-leninizmit fitimtar!

Për Komitetin Qendror të Partisë
së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popu-
llit», nr. 131 (9304), 2 qer-
shor 1978*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Për gruan»
(Përmbledhje veprash), f. 603*

DJEMTË E TU JANË GJALLË SE LUFTUAN E DIHANË JETËN PËR POPULLIN

Nga biseda me nënë Pashako Rexhepin

1 qershor 1978

Në një nga pushimet midis seancave të Kongresit të 8-të të BGSH-së, shoku Enver Hoxha u takua e zhvilloi një bisedë të ngrohtë e të përzemërt, me Pashako Rexhepin, nga Pirgu i Korçës, e njohur te ne më tepër me emrin «nënë Pashako».

SHOKU ENVER HOXHA: Si je nënë Pashako? Si të ka djali, mirë?

NËNË PASHAKOJA: Shumë mirë është nëna, kur të ka ty mirë, o bir i nënës.

SHOKU ENVER HOXHA: U gëzova shumë kur më thanë që doje të më takoje.

NËNË PASHAKOJA: Nëna të do shumë, si birin e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Djemtë e tu, nënë, janë të gjallë. Ata rrojnë në zemrat e gjithë popullit, i cili do t'i kujtojë tërë jetën, se ata për popullin luftuan dhe dhanë jetën.

NËNË PASHAKOJA: Gjallë janë, të keqen nëna, gjallë. Rrofsh e qofsh!

SHOKU ENVER HOXHA: Për këto ditë të bukura që kemi sot, luftuan djemtë e popullit, luftuan edhe djemtë e tu.

NËNË PASHAKOJA: T'i rrosh Partisë, o bir, se ti na e bërë dritë Shqipërinë, prandaj janë të gjallë ata!

SHOKU ENVER HOXHA: E bëri Partia! Të rrosh ti, nënë!

(*Duke iu drejtuar shoqëruesve*). Ku rron nëna tani? («Në Përg», përgjigjen ata.) Të vijnë shokët gjithmonë atje, të të shohin? Të vijnë doktorët?

NËNË PASHAKOJA: Vijnë, vijnë, të keqen nëna.

SHOKU ENVER HOXHA: Të venë gjithnjë; edhe mjekët të venë ta shohin nënë Pashakon!

NËNË PASHAKOJA: E ndrite botën, e mësove botën. Rrofsh e qofsh të keqen nëna!

SHOKU ENVER HOXHA: Na mësoi Partia, nënë. E ke parë filmin që flet për familjen tuaj?¹

NËNË PASHAKOJA: E kam parë.

SHOKU ENVER HOXHA: Filmi i ka bërë të pavdekshëm edhe zotërinë tënde, edhe bijtë e tu. E shoh vazhdimisht atë film, që është aq i bukur.

Më tha Liri Kolaneci që kishe vajtur për përvjetorin e Tekiut. «Ishte edhe nënë Pashakoja e donte të piquej me ty», më tregoi ajo. «Pse nuk më njoftuat

1. Është fjala për filmin «Yjet e netëve të gjata», që tregon për heroizmin e nënë Pashakos e të djemve të saj gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

që të veja unë tek ajo e ta takoja, u thashë, se ajo është plakë, është nëna ime, kurse unë jam djall i saj».

NËNË PASHAKOJA: Më kishte zënë malli e doja të të takoja.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë bëre! Shikoni se mos ka ndonjë hall tjetër nëna?

NËNË PASHAKOJA: Rrofsh e qofsh sa të jetë jeta!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit! Hajde të dalim në fotografi. Të dalim kështu, pranë njëri-tjetrit.

(Shoku Enver i hedh duart në qafë dhe ashtu dalin që të dy në fotografi, të përqaftuar.)

Do të të vij në shtëpi, kur të shkoj në Korçë.

Mirë u pafshim nënë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

NUK MUND TË ECË BLEGTORIA PA BUJQËSINË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

5 qershor 1978

Problemi që më shqetëson për Tepelenën, meqenëse po diskutojmë për të, është shtimi relativisht i paktë i radhëve të Partisë në këtë rreth. Ky problem duhet parë një çikë më thellë, se ka disa shkaqe që e frenojnë këtë gjë. Një nga këto mendoj se është pikëpamja e gabuar që, me sa duket, ekziston te disa atje, që njerëz me vlerë në parti konsiderohen vetëm ata të cilët kanë bërë luftën, kurse ata që ndërtojnë socializmin janë të dorës së dytë! Kjo është edhe një nga shkaqet kryesore të shfaqjes së sektarizmit në Tepelenë.

Por edhe në zona të tjera ka mbeturina të tilla në ndërgjegjen e njerëzve, sidomos të atyre që kanë luftuar dhe që manifestohen tani në një mënyrë ose në një tjetër, kurse mund të them si shembull në Gjirokastrë nuk ekzistojnë këto pikëpamje. Atje respektohen ata që kanë bërë luftën, por vihen në dukje edhe ata njerëz që punojnë sot me mish e shpirt për të marrë

rendimente të larta në punë; përmenden ata të rinj e të reja që tregohen të zellshëm, aktivë, pra ata njerëz që shquhen në këtë luftë të madhe siç është ndërtimi i socializmit.

Këto gjëra duhet të na bëjnë neve të mendojmë se në ato rrethe e krahina ku manifestohen mbeturina të tilla nuk është kuptuar si duhet që lufta për ndërtimin e socializmit nuk është më e lehtë dhe më pak e vështirë se Lufta Nacionalçlirimtare. Pra, në vlerësimin e njerëzve nuk duhet marrë për bazë vetëm Lufta Nacionalçlirimtare. Kjo s'do të thotë që të mos i vlerësojmë e të mos i respektojmë njerëzit që kanë luftuar për çlirimin e vendit. Por, i themi këto se te disa prej tyre ekziston ai mentalitet i gabuar i përçmimit ndaj njerëzve të moshave të reja, që po dalin, që po ngrihen në punë e sipër sot, dhe disa nga të vjetrit u bëhen barrikadë. Kjo barrikadë s'është një mur i pakapërcyeshëm dhe nuk është çështja se atje, që nga koha e luftës, nuk janë pranuar anëtarë partie të rinj. Jo, atje janë pranuar edhe elementë të rinj në Parti, por në një numër fare të vogël, sepse janë dukur prirje sektarizmi. Kjo, si thashë edhe më parë, ndodh për shkak se të vjetrit nuk pranojnë që të rinjtë t'u dalin përpara, të shfaqin mendimin e vet e t'u thonë: «Daleni more shokë, se do të bëhet kështu, siç mendojmë ne, sepse kështu është më e arsyeshme!». Këtë nuk e pranojnë kollaj këta të vjetrit. Bile ndonjëri prej këtyre mund të thotë: «Mua të më kundërshtojë fjalën ai djalë ose ajo vajzë?! Jo, nuk e lë!». Ky është një qëndrim i gabuar, i cili luftohet me një punë intensive propagandistike e politike.

Konservatorizmi shfaqet edhe për shkak të shumë mentaliteteve e zakoneve të vjetra që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve të këtij rrethi. Dikush mund të mendojë, fjala vjen: «Unë jam 60 vjeç dhe e kam mendjen top, kurse ti që je 20 vjeç i ke buzët akoma me qumësht, pra unë do të drejtoj, ti puno; unë do të të kem ty me sy të mirë dhe do të të fut në Parti, por jo tashti».

Në Tepelenë mendoj se ka barrikadë veçanërisht për gratë dhe vajzat, sepse te disa shokë ekziston një konservatorizëm i madh ndaj tyre, që ka arritur deri edhe në akte të shëmtuara. Këtë nuk e them kot sepse atje ka pasur dhe raste flagrante. Të tilla gjëra kanë ndodhur e po ndodhin edhe aktualisht në këtë rreth. Pra, kam mendimin se nënvleftësimi i gruas është i theksuar në rrethin e Tepelenës.

Këto shkaqe që përmenda janë pengesa kryesore që e bëjnë organizatën e Partisë të rrethit të Tepelenës të qëndrojë në vend, bile edhe të pakësohet efektiviteti i saj. Jo vetëm kaq, por po nuk u ndryshua gjendja, ka rrezik që organizata e Partisë atje të sklerozohet e të plakët. Këto konkluzione duhet të ishin nxjerrë me kohë e të ishin marrë edhe masa për likuidimin e këtyre gabimeve. Natyrisht, kjo nuk mund të arrihet me një punë politiko-ideologjike rutinë, siç po bëhet tash në disa raste. Ne duhet të nxjerrim konkluzione se deri tash puna politiko-edukative kundër këtyre mbeturinave nuk ka qenë në nivelin e duhur, gjë që ka ndikuar për keq në gjallërimin dhe në përtëritjen e Partisë. Në këtë drejtim kërkohet të bëhet një punë sistematike politike dhe ideologjike.

Po të përmirësohet puna e Partisë në ato drejtime që vura në dukje më lart, atëherë do të kemi një përmirësim të madh e të ndjeshëm në rrethin e Tepelenës. Pse do ta kemi këtë përmirësim atje? Për arsye se Partia në këtë rreth ka përbërje të mirë, pavarësisht se vërehen akoma të meta të theksuara. Tepelenasit janë njerëz të guximshëm; ata e duan Partinë, janë patriotë, milkpritës, pra kanë gjithë ato virtyte të larta. Por, fakt është që te shumë prej tyre ekzistojnë edhe mbeturina të patriarkalizmit.

SHOKU HYSNI KAPO: Edhe feja ka pasur ndikim të madh atje.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, feja ka luajtur rol të madh negativ në Tepelenë. Nuk duhet neglizhuar ky fakt, se çështja e teqeve atje ka qenë problem. Edhe sot ndihet ndikimi i fesë, pavarësisht se baballarët tanë, që janë një brez para nesh, kanë vdekur. Por gjurmët e saj duken në zakonet e mentalitetet e vjetra që ekzistojnë akoma. Mendime apo qëndrime të tilla janë me pasoja, prandaj duhen pasur mirë parasysh nga Partia. Me dashje apo pa dashje, fakt është se ky nënvleftësim ndaj brezit të ri në këtë rreth po vërtetohet, përderisa nuk po pranohen në Parti elementë të rinj, energjikë, të zotë në punë, me shkollë e me origjinë punëtore, siç është shumica e të rinjve në Tepelenë, ku nuk ka shumë intelektualë, por kryesisht barinj, bujq dhe minatorë.

Mua më duket se këto gjëra janë karakteristike për Tepelenën, prandaj duhen pasur parasysh në punën që do të bëhet për përtëritjen e Partisë në atë rreth. Për këtë çështje të mos e organizojmë punën me fu-

shata, por ta mbajmë zjarrin të ndezur vazhdimisht. Për të zgjidhur probleme të tilla, në radhë të parë duhet të punohet kundër koncepteve të gabuara që kanë në kokë vetë anëtarët e Partisë në këtë ose atë organizatë.

Në organizatat e Partisë të krahinave të tilla mund të çohen edhe shokë komunistë nga rrethet e tjera. Me këtë rast atje mund të vëmë re dy fenomene: ose ata do të jenë të zotë (dhe pikërisht kuadro të tillë duhet të dërgojmë atje), pra të aftë që të bëjnë kthesë në organizatë dhe të thyejnë ato koncepte të vjetra që ekzistojnë, ose ata do të izoloohen. Në qoftë se ata do të vijnë e do të thonë që atje nuk mund të punohet se është një situatë e tillë që nuk çahet dot, atëherë ne duhet të mendojmë për të marrë masa të tjera për ta shëndoshur gjendjen. Por, edhe sikur të mos ta bëjmë këtë gjë, pra të mos çojmë atje komunistë nga rrethe të tjera, unë mendoj se Komiteti i Partisë i Rrethit të Tepelenës duhet ta shikojë këtë çështje më nga afër me organizatat-bazë. Ç'dua të them me këtë? Me këtë dua të them që komiteti i Partisë t'i njohë vetë njerëzit e dalluar, atje ku punojnë e jetojnë, në Progonat, në Buz, në Memaliaj e gjetkë. Pra, të njohë situatën dhe njerëzit e mirë, punëtorët e dalluar, të shikojë ç'origjinë kanë këta, të mësojë për jetën, qëndrimin e veprimtarinë e tyre. Pastaj instruktori i komitetit të Partisë të vejë në organizatë e të thotë: «Çfarë po bëni ju, shokë të Progonatit apo të Memaliajt, pse nuk pranoni elementë të rinj në Parti?». «Po ja, nuk pranojmë se kështu e kështu është puna», do të thonë ata. «Po gjithë këta njerëz të dalluar këtu,

rreth jush, çfarë janë?» mund t'ua kthejë ai atyre. Në këtë mënyrë duhet të flasë ai me ta. Përveç kësaj, instruktori të takohet e të bisedojë dhe me vajzat e djemtë e mirë në Progonat, bie fjala, dhe t'u thotë: «Pse nuk bëni ju kërkesë për të hyrë në Parti?». Dhe, kur të merren në shqyrtim kërkesat e tyre, atëherë ai të shikojë pse nuk pranoheshin në Parti këta. Të tillë njerëz duhet të pranohen në Parti. Prandaj ai të punojë që në organizatë të diskutohet për këtë, duke vënë në dukje karakteristikat e atyre të rinjve dhe të rejave që kanë bërë kërkesë për të hyrë në Parti, që të krijohet bindja tek të gjithë se ata e meritojnë të jenë anëtarë partie. Pra, e kam fjalën këtu që komiteti i Partisë në Tepelenë, duke pasur parasysh gjendjen, të marrë disa iniciativa e masa të efektshme që situata të përmirësohet.

SHOKU HYSNI KAPO: Atje, në organizatë, duhet të punohet edhe me shokët e vjetër, të cilët janë bërë barrikadë, pse ata përbëjnë shumicën dhe i japin tonin organizatës.

SHOKU PETRO DODE¹: Edhe propozimi juaj, shoku Enver, që të dërgohen njerëz nga rrethe të tjera, mendoj se është i drejtë, gjë që atje do të ndikojë pozitivisht.

SHOKU ENVER HOXHIA: Po, por të mos e bëjmë rrugë këtë, se krijojmë shqetësime; vetëm atëherë kur duhet, kur shohim se diku ekziston një rreth i mbyllur

1. Në këtë takim merrte pjesë edhe shoku Petro Dode, në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

në organizatë. Në këto raste të dërgojmë komunistë nga një rreth apo nga një krahinë ose fshat tjetër.

SHOKU PETRO DODE: Kjo gjë ka pasur efekt më parë. Andej ka punuar një kryetar kooperative, që ishte nga Myzeqeja, të cilin populli e donte shumë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, e duan, po qe se punon e sillet mirë. Por, ai që dërgohet mund të mos vihet kryetar apo sekretar partie, por, duke punuar për të revolucionarizuar organizatën-bazë të këtij apo të atij fshati, një njeri i tillë mund të bëhet edhe sekretar partie ose kryetar kooperative, por nuk është ky qëllimi i vajtjes së tij atje.

Për këtë arsye, kur studiohen përbërja e Partisë, pranimet në Parti, ndodhitë në Parti, zbatimi i vijës e i normave të saj etj. në një rreth apo fshat, shokët që venë në bazë, veçanërisht, të mos harrojmë karakteristikat dhe historikun e vendit, sepse Partia jonë është e re, në vitin 1941 u formua. Pra, kemi të bëjmë me një kohë shumë të shkurtër. Por ndërgjegjja dhe zakonet e njerëzve nuk ndryshojnë shpejt e shpejt, brenda një periudhe kaq të vogël. Prandaj t'i kemi parasysh kurdoherë këto gjëra kur studiojmë problemet e Partisë. Tjetër është Gjirokastra e tjetër është Tepelena; tjetër Zagoria e tjetër Pogoni. Drejtuesit e Partisë duhet t'i njohin e t'i dinë mirë veçoritë dalluese të çdo rrethi e krahine dhe t'i kenë parasysh në punën e tyre. Nuk e kam fjalën për një njohje në përgjithësi, por me hollësi që, kur ndodh diçka jo e mirë në një zonë, përnjëherë kjo t'i zgjojë atij rrethanat materiale e shpirtërore historike të atij vendi ku ndodhi ajo ngjarje. «Po pse ndodhi kjo?», mund të pyesin njerëzit. «A... po,

— thotë sekretari, — se fshati i atij me fshatin e atij tjetrit, nuk kanë shkuar mirë. . .». Dhe, po të ngjitet më lart, del se gjyshërit e tyre mund të kenë pasur edhe grindje që kanë çuar deri në konflikte të rënda. Prandaj këto gjëra duhen parë mirë. Në këtë mënyrë drejtuesi i Partisë do të jetë në gjendje të gjykojë drejt e të marrë masat e nevojshme. Në qoftë se nuk punon kështu, atëherë ai do të merret me gjëra të vogla, si jo ky më tha kështu e ai më tha ashtu dhe nuk do të zgjidhë gjë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Vajta edhe në zonën e Progonatit dhe të Sinanajt. Në Progonat të ardhurat vjetore nga sektori i bujqësisë asnjëherë nuk i kanë realizuar. Në fakt ata marrin 70 për qind të të ardhurave nga blegtoria dhe vetëm 30 për qind nga bujqësia.

SHOKU ENVER HOXHA: Është e kundërta e asaj që na ngjet në përgjithësi në zonat e tjera. Njerëzit e këtyre anëve kanë dashuri të madhe për blegtorinë.

SHOKU HEKURAN ISAI: I njëjti fenomen ngjet edhe në zonën e Sinanajt. Bagëtitë ata i mbajnë shumë mirë. Atje të gjithë duan të bëhen barinj.

Në Sinanaj kishin bërë një studim për bagëtitë e imëta dhe u dilte se kooperativa atje mund të mbajë pa u shqetësuar, duke i pasur kullotat ashtu siç janë natyrale, gjithsej 27 000 kokë dhen nga 10 500 që kishin, dhe të mos i çojnë më jashtë kooperativës për dimërim. Nga ky studim kishin arritur në konkluzionin se kanë një tokë të mjaftueshme, me mikroklimë të përshtatshme që u krijon mundësi për të siguruar kullota edhe verore, edhe dimërore.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, të gjitha mundësitë i kanë, por pse nuk i bëjnë këto? Ç'presin?

SHOKU HEKURAN ISAI: Këtu mund të ketë influencuar edhe fakti që ne u kërkojmë atyre edhe drithërat e bukës për një sipërfaqe prej 6000 hektarë tokë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, ne u kërkojmë e do t'u kërkojmë medocmos edhe drithërat e bukës, por u kërkojmë edhe qumësht, edhe djathë etj., dhe të gjitha këto bëhen me llogari. Pra, në qoftë se llogaria u del që ata të realizojnë 60 për qind të të ardhurave nga blegtoria dhe 40 për qind nga bujqësia, mirë, por llogaritë ama të bëhen me laps në dorë për çdo gjë. Ata atje kanë toka për kullota, por kanë edhe toka buke, prandaj as bukën të mos e lënë pa e prodhuar.

SHOKU HYSNI KAPO: Po, ata kanë toka, por mund të hapin akoma të tjera për prodhimin e drithërave të bukës.

SHOKU ENVER HOXHA: Mua më duket se çështja qëndron këtu, që ne kudo kemi mundësi të mendojmë, të studiojmë dhe të bëjmë edhe plane sa më reale. Gjithmonë themi se planet hartohen nga baza, por, kur mësojmë për këto gjëra që po thua ti, Hekuran, del se një gjë e tillë atje në bazë nuk bëhet sa duhet. Ne sot u themi të gjitha kooperativave të prodhojnë bukën. Mirë, kjo na intereson, që ato ta bëjnë bukën. Mirëpo ka edhe zona, si ato që u përmendën këtu, që nuk e bëjnë dot bukën, në qoftë se këto i japin shtetit më shumë sesa duhet prodhime blegtorale. Kjo është një gjë me shumë interes, që duhet parë. Tani atyre u kërkohet që edhe bukën ta bëjnë, edhe këto prodhime t'i shtojnë, por mbase masat, normat që u janë vënë i pengojnë

ata që t'i realizojnë këta objektiva. Këtu duhet të ndalemi mirë dhe të gjejmë shkaqet që i pengojnë.

SHOKU HEKURAN ISAI: Unë e bisedova këtë çështje, për zonën e Progonatit, se çfarë i pengon konkretisht. Ne, thanë ata, më parë kemi shtegtuar qind për qind me bagëtinë. Kurse çështja e shtegtimit nuk shtrohet për Dukajn e Sinanajn. Shtegtimi për ta ka mbaruar. Për ta shtrohet problemi i rregullimit të raportit bujqësi-blegtori.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, të marrin masa e të rregullojnë raportet bujqësi-blegtori, por jo të llogaritin shtegtimin për bagëtinë.

SHOKU PROKOP MURRA: Në Shkodër kemi zonën e Vermoshit, ku njerëzit denbabaden janë marrë me blegtori. Natyrisht, edhe këta më parë e shtegtonin bagëtinë. Meqenëse kjo zonë ndodhet në një nivel shumë të lartë, një vit merrnin prodhim nga misri dhe katër vjet nuk merrnin, sepse ua zinte bryma. Për këtë arsye ne vendosëm që kësaj kooperative t'i hiqnim një pjesë të misrit dhe i dhamë bimë të tjera, si patate etj.; shtuam diçka edhe për bazën ushqimore të bagëtisë. Pas kësaj ne pamë që kjo masë ishte me të vërtetë më e racionale dhe bëri që ata të Vermoshit të mos e shtegtonin më bagëtinë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk mund të veprohet në këtë mënyrë kudo, se nuk mund të ecë blegtoria pa bujqësinë, as bujqësia pa blegtorinë. Të dyja këto degë të ekonomisë sonë bujqësore duhen harmonizuar. Ka zona që prodhojnë drithëra buke, në radhë të parë, sa për vete të tyre e mund të mos japin dot teprica. Por, ama, doemos, duke i dhënë shtetit më shumë prodhime

blegtorale. Por për këto duhen bërë studime që të harmonizohen sa më drejt raportet bujqësi-blegtori.

SHOKU HYSNI KAPO: Unë mendoj se në Tepele në kanë mundësi që edhe blegtorinë ta zhvillojnë, por edhe detyrat në sektorin e bujqësisë të mos i neglizhojnë. Këtu është çështja e studimit se si të harmonizohen sa më drejt raportet bujqësi-blegtori. Por këtë punë e pengojnë nganjëherë disa njerëz që blegtorinë dhe bujqësinë i shikojnë në mënyrë të njëanshme dhe të shkëputura njëra nga tjetra.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu është, këto duhen parë në unitet. Ne nuk mund të ndjekim rrugën e fermave kapitaliste. Në Francë, për shembull, ka ferma ku syri të shikon vetëm vreshta. Diku gjatë shikon vetëm grurë, grurë dhe asnjë bimë tjetër. Ose në një fermë tjetër shikon vetëm lopë që kanë mbushur livadhet që, për arsye të lagështirës së madhe, janë vazhdimisht plot me bar të njomë. Kështu lopët atje japin sasi të mëdha qumështi etj., etj.

Tash te ne ekzistojnë mundësitë që komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve çdo vit e çdo pesëvjeçar ta studiojnë mirë zhvillimin e rrethit të tyre në përgjithësi dhe në veçanti; të studiojnë e të kontrollojnë vazhdimisht realizimin e planit, por jo thjesht në kuptimin që u realizua apo nuk u realizua ai. Jo, unë e kam fjalën që këto komitete të studiojnë mundësitë e një realizimi më të madh, mundësitë e një kombinimi sa më të harmonishëm të bimëve bujqësore, të bujqësisë e të blegtorisë, nga ai që bëme, për shembull, vjet, të një alternimi të përqindjeve të ndryshme nga ai i vitit të ka-

luar, me qëllim që, kur të përfundojë pesëvjeçari, të bëjmë një studim të veçantë, kooperativë më kooperativë dhe të arrijmë në një konkluzion si rreth se ç'na dha kjo eksperiencë.

Mirëpo, një studim dhe një ndjekje e tillë nga komitetet ekzekutive, veçanërisht nga specialistët e bujqësisë, nuk bëhet. Vijnë të dhëna nga kooperativat në seksionet e bujqësisë të komiteteve ekzekutive; lexohen ato esber dhe specialistët nuk ndalen në to që të reflektojnë përse na ngjet kështu apo ashtu; nuk e vrasin mendjen e të gjykojnë se sikur të kombinohet kjo përqindje në këtë apo në atë mënyrë, atëherë si do të bëhej, ç'rendimente do të kishim etj. Një gjë e tillë nuk bëhet. Po të bëhet, kjo do të jetë një bazë e shëndoshë për planifikimin nga fronti i prodhimit. Natyrisht, në qoftë se këto studime në bazë rrethi nuk bëhen seriozisht, pra, duke mbajtur parasysh edhe nevojat e vendit, këtu ne mund të gjejmë gjëra të padrejta dhe atëherë jemi të detyruar t'i imponojmë këtij apo atij rrethi se ç'duhet të bëjë për bujqësinë, për blegtorinë etj. Pra, në qoftë se një kooperativë e redukton bujqësinë vetëm në 30 për qind dhe nuk e ngre përqindjen e prodhimeve të blegtorisë në një shkallë akoma më të madhe, që të kompensojë atë çka lë mangut në bujqësi, atëherë qendra mund t'i thotë konkretisht se ç'raport do të ketë për bujqësinë e blegtorinë kjo kooperativë. E mira është që vetë kooperativa të bëjë studime e të caktojë objektiva realë si për bujqësinë, dhe për blegtorinë.

SHOKU HYSNI KAPO: Ndryshe, si do t'i plotësojmë këto nevoja që kemi përpara?

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është, nuk kemi se si t'i plotësojmë ndryshe nevojat. Buka llogaritet me kalori, por me kalori llogariten edhe gjalpi, edhe djathi e të gjitha prodhimet e tjera blegtorale. Prandaj, në qoftë se ai rreth apo ajo zonë e ka planifikuar që nga blegtoria të marrë 70 për qind të të ardhurave dhe qëndron në vend e nuk jep prodhime të larta blegtorale, megjithëse në shërbim të saj ka vënë të gjitha tokat e bukës, një gjë të tillë ne nuk mund ta pranojmë.

Hartimi i një plani me të vërtetë real në rreth mund të bëhet vetëm i studiuar në këtë mënyrë e në vazhdimësi, duke bërë edhe eksperimente. Pra, jo sa për të qenë brenda e për t'u lehtësuar nga puna, por për të marrë rendimente sa më të larta e të ardhura sa më të mëdha, për shtetin dhe për kooperativën. Kjo punë bëhet nga baza, nuk them që s'bëhet, por çështja shtrohet për ta bërë më mirë.

SHOKU HYSNI KAPO: Ne e biseduam dhe u thamë shokëve të rretheve që merren me këto punë se mund të hapen shumë më tepër toka të reja nga ajo që është planifikuar, kur vetë themi se kemi akoma me dhjetëra e me qindra mijë hektarë tokë për të hapur. Përse nuk kërkojmë që këto sipërfaqe t'i kthejmë në kullota dhe toka buke, por detyrohemi të marrim për blegtorinë nga tokat bujqësore që kemi.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjatë rrugës për në Pogradec, për në Vlorë e gjetkë kam parë se ka akoma sa të duash toka të mira për të hapur. Unë flas vetëm për këto që kam parë në rrugë e sipër, pa lëre pastaj po të futesh më në brendësi të vendit.

Diçka tjetër që dua të theksoj është se komitetet ekzekutive e veçanërisht seksionet e bujqësisë duhet të kontrollojnë më mirë se si po zbatohen vendimet që ata vetë marrin për kooperativat. E theksoj këtë gjë se para ca ditësh më erdhi një letër nga disa kooperativistë, kryesisht të sektorit të blegtorisë, nga Zharrëza e Fierit. Ata shkruanin se vitin e kaluar u është mbajtur një përqindje e shpërblimit për ditë-punë dhe nuk ua kishin dhënë as në tremujorin e parë të këtij viti, siç u kishin premtuar.

Nga kjo letër del se komitetet ekzekutive, seksionet e bujqësisë dhe seksionet e financave nuk e kanë sa duhet syrin te kooperativat, në zbatimin rigoroz të orientimeve dhe të vendimeve të Qeverisë për këto probleme dhe për ato që vendosin vetë. Për këtë letër bisedova edhe me ministren e Bujqësisë, shoqen Themije, kur u takova me të. «Më thuaj si është kooperative e Zharrëzës në Fier?», i thashë. «Është kooperative e mirë», m'u përgjigj ajo. «Po mirë, pa hajde këtu të të lexoj një letër që më kanë dërguar disa kooperativistë të kësaj kooperative», i thashë. Ajo e dëgjoji e më tha se do ta ndiqte çështjen.

SHOKU HEKURAN ISAI: Për sa i përket blegtorisë, konstatoam, gjithashtu, se problem ishte edhe moszbatimi i ndërzimit artificial. Megjithëse janë porositur vazhdimisht për këtë punë, prapëseprapë nuk po e zbatojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe ky problem ka të bëjë me konceptet e vjetra që ekzistojnë te barinjtu tepelenas. Prandaj duhet të luftojmë kundër këtyre koncepteve, duke ua bërë mirë të qarta barinjve avan-

tazhet e ndërzimit artificial. Ka një gjë të mirë se baringjtë tepelenas, edhe po të jenë të rinj, e njohin mirë bagëtinë, dinë si mbarset delja etj. sepse ua kanë mësuar prindët. Mirëpo çështja shtrohet që ata të dinë më shumë, të dinë si të ushqehet dashi, si të kujdesen për të, të mësojnë e të bëjnë edhe ndërzimin artificial etj., sepse këto ndikojnë në krijimin e racës së re.

SHOKU HYSNI KAPO: Ne duam të përmirësojmë racën që të marrim më shumë mish, qumësht e lesh dhe kjo realizohet më mirë me ndërzimin artificial.

SHOKU ENVER HOXHA: Por bariu i Kurveleshit, siç thashë, ka mendimin se e njeh mirë këtë punë dhe i duket se metoda natyrale që përdoret është më e mira, kurse në realitet nuk është aspak ashtu.

SHOKU HEKURAN ISAI: Isha edhe në Minierën e Memaliajt, ku kemi qymyrin më të mirë të vendit, por që nuk vlerësohet si duhet. Siç thoshin edhe vetë shokët atje, qymyri nuk trajtohet mirë. Ata kanë shumë ankesa për konsumatorët.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, është e vërtetë se Miniera e Memaliajt është miniera që ka qymyrin me kalori më të lartë në vendin tonë. Për sa i përket trajtimit të qymyrit ti ke të drejtë, por edhe vetë drejtuesit e minierës nuk e trajtojnë mirë, se ka raste që qymyri digjet qysh atje. Natyrisht, fajin për këtë nuk e kanë vetëm ata, por edhe transporti dhe gjithë të tjerët që lidhen me të. Sidoqoftë është fakt që qymyri nuk trajtohet mirë dhe për këtë humbet kalori. Kjo është një sëmundje e vjetër.

SHOKU HEKURAN ISAI: Niveli ekonomik i punëtorëve të minierës është i kënaqshëm. Partia u ka

krijuar kushte të mira jetese. Edhe kushtet e punës janë përmirësuar kudo në minierat tona.

SHOKU ENVER HOXHA: Për shëndetin e minatorëve duhet bërë kujdes i madh e duhen marrë masa shumë të rrepta në këtë drejtim. Pluhuri i qymyrit dhe ai i çimentos, në qoftë se nuk merren masa me kohë, c dëmton rëndë shëndetin e punëtorëve.

SHOKU HYSNI KAPO: Të parashikojmë edhe efektet e mëvonshme të pluhurit.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është. Dëmi që shkakton pluhuri i qymyrit për shëndetin e minatorit mund të mos duket përnjëherë. Pasojat negative të tij të studiohen me aparaturat përkatëse mjekësore. Prandaj, për sa u përket kushteve brenda në minierë, të merren gjithmonë masat e nevojshme. Ai që punon nën tokë, të jetë i pajisur me maska e me veshje të posaçme. Por, nuk mjaftojnë vetëm këto. Brenda në minierë duhet të funksionojnë vazhdimisht mirë edhe aspiratorët. Pra, për shëndetin e minatorëve të bëhet kujdes i veçantë.

Përderisa ekzistojnë gjithë këto kushte të mira për punën dhe jetesën e minatorëve atëherë nga ne kërkohet të jemi më ekzigjentë ndaj tyre edhe për realizimin e tejkalimit e planeve, për disiplinën, për normat etj. Problemin ta shtrojmë në këtë mënyrë, që këto kërkesa të larta për punën duhen për të krijuar kushte sa më të mira jetese, por edhe për të realizuar planin, për të shtuar rezervat në çdo kohë. Ata i kanë të gjitha mundësitë për realizimin e tejkalimit e planit, prandaj nuk duhen lejuar boshllëqe dhe mosmbajtje mirë e asaj që prodhohet. Natyrisht, ata me punën

që bëjnë rrisin prodhimin dhe përmirësojnë jetesën e tyre, por të mos harrojnë se ka edhe objekte e prodhime që subvencionohen nga shteti.

SHOKU HYSNI KAPO: Ka punëtorë që vetëkënaqen me të ardhurat që marrin dhe nuk shikojnë se sa i japin shtetit.

Kur isha në Vlorë, më bëri përshtypje ullishta. Ndërmarrjes bujqësore «Rinia» çdo kuinal ullinj i kushton 190 lekë, ndërsa asaj të Vlorës 400 lekë. Pra, shteti për një kuinal ullinj këtu subvencionon më shumë, ndërsa punëtorët pagën e marrin njëlloj.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore rrogën e marrin, jetojnë me gjithë të mirat, me shtëpi të reja, me radio e shumë prej tyre mund të kenë edhe televizorë, po ama, ndodh që i paguan shteti mosrealizimet e tyre. Në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të ligjit ekonomik. Kjo gjë duhet kuptuar mirë, pasi në qoftë se vazhdohet kështu, pra, në qoftë se nuk do të ecet përpara, ulet niveli i jetesës së punonjësve tanë. Pastaj një gjë e tillë jo vetëm ndikon negativisht në nivelin e jetesës, por çon edhe në frenimin e shtimit të rezervave të shtetit për kohë rreziku. Prandaj të ecim me llogari.

Dotohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP

TE ARDIURAT SHITOHEN DUKE PUNUAR ME SHUME

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

10 qershor 1978

SHOKU PROKOP MURRA: Sipas programit, organizuam në Lushnjë një seminar me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve që merren me problemet ekonomike. Në këtë seminar u zbërthyen dy vendimet e fundit të Byrosë Politike: «Mbi shpërblimin në kooperativat bujqësore» dhe «Mbi levat ekonomike».

Referatet ishin përgatitur mirë dhe u dëgjuan me kujdes. Fillimisht, para seminarit, për këto çështje, qenë bërë edhe biseda nga shokët.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht, nga këto biseda merret vesh më mirë se ç'mendohet, se brenda në mbledhje ndodh që njerëzit druhen dhe nuk i thonë të gjitha ato që mendojnë.

SHOKU PROKOP MURRA: Para dy muajsh kisha marrë vesh që kooperativistëve të rrethit të Lushnjës, nga këto masa, u uleshin tre lekë për ditë-punë. Diskutohej se mos i merreshin fshatarit më shumë nga çdo të

fitonte. Kjo vjen ngaqë drejtuesit nuk e studiojnë problemin me laps në dorë. Atje thoshin, për shembull, se po ulet çmimi i grurit, por, kur e panë problemin më thellë, në detaje dhe, kur bënë llogaritë, konstatuan se çështja nuk qëndronte ashtu siç flitej.

SHOKU ENVER HOXHA: Pse të thuhet që u ulën tre lekë për ditë-punë, kur mundësitë janë që ta rritin atë, fjala vjen, me 6 lekë? Sikur vetëm një kuintal grurë më shumë për hektar të marrin ata, arrihet ky objektiv, pa le sikur të marrin 5 kuintalë më shumë për hektar, të ardhurat do të rriten akoma më shumë.

SHOKU HYSNI KAPO: Këtu është puna e konceptit, sipas të cilit nuk duhet të bëjmë ndryshim çmimesh, qoftë edhe për një prodhim bujqësor të caktuar, sepse ulen të ardhurat.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështja qëndron në të kuptuarit thellë politikisht të gjendjes së përgjithshme, në të cilën lufton Shqipëria. Njerëzit të kenë kurdoherë parasysh dhe të preokupohen se kur marrin një vendim Byroja Politike, Komiteti Qendror dhe Qeveria, vendimi është i lidhur me gjithë faktorët që ndikojnë në situatën e vendit tonë si pasojë e gjendjes aktuale të turbullt në botë. Në qoftë se njihet realisht rrethimi imperialisto-revizionist, jo vetëm që duhet të kuptohet se është i domosdoshëm realizimi, bile edhe tejkalimi i planit (dhe në këtë drejtim të bëhen të gjitha përpjekjet), por edhe të krijohet bindja se Byroja Politike bëri shumë mirë që e uli, për shembull, çmimin e grurit. Natyrisht, pas marrjes së vendimeve, duhen bërë edhe shpjegimet e nevojshme. Në rastin konkret shpjegimi bën që të mos kuptohet se ulet vlera e ditës

së punës, por në të kundërtën, vlera e ditës së punës ngrihet, sepse rriten rendimentet. Prandaj, në këto kushte, nuk lejohet që kooperativisti të qëndrojë në vend dhe ca më keq të ulë rendimentin, siç ndodh në ndonjë kooperativë, që merr 11 kuintalë grurë për hektar, kur të tjerat marrin 23. Shteti nuk mund t'ia paguajë kësaj kooperative çdo kilogram grurë me çmime të atilla që me paratë e marra të arrijë të shpërndajë lekë për ditë-punë njëlloj si kooperativa fqinjë që merr, ta zëmë, 10 kuintalë grurë më shumë për hektar. Ndryshe ky fenomen bëhet i përgjithshëm e i rrezikshëm nga ana ekonomike.

Siç thashë edhe më parë, të kihet parasysh situata në të cilën jetojmë dhe njerëzit të thellohen në orientimet e Partisë, në kushtet e bllokadës dhe të luftës që bëhet te ne për ndërtimin e socializmit duke u mbështetur në forcat tona. Të kuptohet konkretisht se masat që merren janë në interes të vendit dhe të çdo individi, prandaj duhen bërë përpjekje e sakrifica dhe këto bëhen vetëm po u kuptua drejt situata. Prandaj, nuk e kanë drejt ata që thonë «me këto masa humbëm»! Interesant është! Nga cilat kooperativa ishin këta njerëz që mendojnë se paskan humbur?

SHOKU PROKOP MURRA: Nga zona fushore, pse në këto zona çmimi i grurit pëson ndryshime, kurse në zonat kodrinore e malore nuk lëviz.

SHOKU ENVER HOXHA: Në seminar a kishte financierë nga kooperativat bujqësore?

SHOKU PROKOP MURRA: Jo, në të merrnin pjesë vetëm sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve që merren me çështjet ekonomike. Por, të nesërmen,

nga ana e degës së Bankës së Shtetit në rrethin e Lushnjës u bë një mbledhje me shefat e financave të kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore të këtij rrethi.

SHOKU ENVER HIXHA: Mirë, po siç kam marrë vesh, ka sekretarë të komiteteve të Partisë që merren me çështjet ekonomike, që nuk e kanë aq të qartë rëndësinë e levave ekonomike. Për këtë duhen kritikuar, për arsye se, siç e kemi thënë edhe herë të tjera, për ta, çështjet financiare janë vrima e fundit e kavallit. Ata mund të merren më shumë me propagandë e agjitacion, po cili është, në fund të fundit, rezultati i këtij agjitacioni dhe i kësaj propagande, përdërisa kooperativistët ankohen se po na ulen të ardhurat? Po financierët, që merren drejtpërdrejt me këto gjëra, pse nuk thërriten në seminar? Pse u dashka parë problemi vetëm në anën politike? Po ana ekonomike, ku lihet? Kjo gjë duhet pasur mirë parasysh. Unë nuk them që të thirrreshin të gjithë financierët përnjëherë, por, ama, nga kooperativat kryesore mund të ishin thirrur disa prej tyre derisa del që nga kuadrot e Partisë këto gjëra nuk kuptohen mirë. Banka e Shtetit e rrethit të Lushnjës mund ta kishte organizuar mbledhjen e financierëve më përpara, që këta të merrnin udhëzimet e duhura. Edhe sekretari i komitetit të Partisë që merret me bujqësinë dhe shefi i seksionit të financës të vinin aty dhe të kërkonin prej pjesëmarrësve se ç'pyetje kishin dhe t'u përgjigjeshin vetë e t'i sqaronin financierët e kooperativave dhe pastaj të shkonin në fshat, të mblidhnin sekretarët e organizatave-bazë dhe kryetarët e kooperativave bujqësore për t'ua bërë sa më të qartë vendi-

min e Byrosë Politike e të Qeverisë. Ata, me kalem në dorë, duhet ta bëjnë edhe tani një gjë të tillë, se kjo është e domosdoshme. Pra, kështu duhet të ishte vepruar.

Në radhë të parë, u duhej mbushur mendja me kohë vetë sekretarëve të komiteteve të Partisë. Ne duam që këta t'i futen edhe trajtimit ekonomik të problemeve. Të kemi parasysh kurdoherë se, kur është fjala për çështje të tilla, në qoftë se ato trajtohen drejt nga ana ekonomike, rrjedhimisht janë parë edhe me syrin politik.

SHOKU PROKOP MURRA: Ne pamë edhe raportin prodhim-fuqi punëtorë, fuqi punëtorë-normë, normë-para, probleme të cilat, në fakt, po na shqetësojnë tani. Ne këto i trajtuam edhe për sektorin kooperativist. Na del se për 4-mujorin janar-prill të këtij viti, 128 ndërmarrje ekonomike kanë mbajtur fuqi punëtorë të tepërt.

SHOKU ENVER HOXHA: Më fal, po unë e kam fjalën për ndërmarrjet bujqësore. Ne, shokë, duhet të përqendrohemi mirë në vendimet që marrim, sepse në plan të parë kemi çështjen e bujqësisë, kjo na preokupon shumë, prandaj e morëm vendimin. Në qoftë se flasim nëpër mbledhje për njëzet probleme, atje njerëzit s'kanë për të marrë vesh asgjë. Ose, po të futemi në hallet e të gjitha ndërmarrjeve, njerëzve u bëhet koka daulle.

SHOKU PROKOP MURRA: Kjo është e drejtë, shoku Enver, por ne vepruam kështu pikërisht për t'ua bërë sa më të qartë çështjen, se kishim bindjen që shokët janë më të dobët në njohjen e problemeve të kooperativave. Të marrim konkretisht rrethin e Lushnjës.

Në këtë rreth, ndërsa të ardhurat, si total, nuk janë realizuar plotësisht, pagat janë tejkaluar. Kjo do të thotë që kanë ngrënë nga akumulimi.

SHOKU ENVER HOXHA: Sigurisht që kanë ngrënë nga akumulimi derisa ndodh kështu. Atëherë, ata s'kanë pse ta marrin paradhënien në masën 70 për qind.

SHOKU HYSNI KAPO: Tani që u mor vendimi, u vu kufiri, se 70 për qindshi ishte edhe më përpara, ndërsa kooperativat e tipit të lartë u jepnin kooperativistëve edhe më shumë, 80 për qind.

SHOKU ENVER HOXHA: Mendoj se problemi duhet arsyetuar kështu: «Dëshiron të marrësh më shumë të ardhura, atëherë prodho më shumë; por, që të prodhosh më tepër, është e domosdoshme edhe të punosh më shumë». Kështu u duhet shtruar problemi. Çekani duhet të bjerë këtu: të punojmë dhe të punojmë shumë e t'i kontrollojmë mirë ato që bëjmë, për të marrë rendimente sa më të larta. Vetëm kështu do të marrim edhe prodhime më shumë, edhe përqindja e paradhënies mund të jetë më e madhe.

Orientimi kryesor duhet të jetë sigurimi e shtimi i prodhimit. Paradhënia në masën 70 e 80 për qind, që mund të përcaktojmë ne, varet kurdoherë nga prodhimi. Te ne shkohet nga parimi «kush punon ha», dhe «sa punon, aq do të marrësh». Në fund të vitit kooperativisti e merr restin, po ai ka edhe rezervë, sepse s'ka njeri që të mos vërë diçka mënjanë; të rrallë janë njerëzit që nuk kanë rezerva. Bile, vëmë re se në arkat e kursimit janë depozituar sasi të mëdha të hollash edhe nga fshatarësia. Prandaj, këtu nuk duhet shtruar problemi pse s'më jep më shumë ose pse më dhe më

pak, sepse, në fund të fundit, i thua: «të tuat i ke; do t'i marrësh në fund të vitit!».

Me fjalë të tjera, të gjitha këto vendime të mos gjykohen të shkëputura dhe si problem në vetvete. Kryesorja është të vihet theksi kudo e kurdoherë te prodhimi, te rritja e tij.

Mirë, Prokop, vazhdo! Unë dua të di më shumë se ç'thotë baza për këto probleme. Si diskutuan shokët e bazës në seminar për to? Shpenzimet e prodhimit, për shembull, në vend që të na pakësohen po na shtohen. Pse del prodhimi me kosto të lartë? Këtë duam ta dimë, ç'thonë pikërisht ata që me të vërtetë i krijojnë këto diferencime. Na intereson të dimë rreth kuptimit, qëndrimit dhe veprimtarisë së tyre ndaj këtyre çështjeve.

SHOKU PROKOP MURRA: Është i drejtë shqetësimi juaj, shoku Enver, por konstatojmë që ka edhe sekretarë të komiteteve të Partisë dhe të organizatave-bazë që akoma nuk i kuptojnë si duhet këto çështje.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu ka rëndësi edhe metoda e stili i punës që përdoret me ta. Ju veni atje dhe i shtroni këto probleme. Por, duhet të kërkonit që edhe ata të bazës të flasin rreth tyre dhe të flasin konkretisht se çfarë është bërë e si është bërë; cilat janë anët e mira dhe cilat janë dobësitë; çfarë duhet të bëjnë pas kësaj dhe pse nuk është bërë ashtu siç janë dhënë udhëzimet etj., etj. Mua më duket se kështu duhet të veprohet. Sepse mund të mbahen referate të kualifikuara që bëjnë efekt, por, të mos harrojmë se efekti mund të jetë vetëm një dush gjatë atyre dy ditëve të mbledhjes dhe pastaj, sa kthehen në fshat, vazhdojnë

përsëri me metodën rutinë të punës. Ne nuk mund të themi që kuadrot e bazës nuk bëjnë asnjë hap përpara. Po kështu edhe për mënyrën se si punohet me ta, nuk mund të mohojmë përparimet që janë bërë, sepse të mendosh kështu, do të qe e gabuar. Por rutina, burokratizmi vazhdojnë. Referatet që mbahen ca i kuptojnë mirë, po ca nuk i kuptojnë si duhet. Ndodh që kur bëhet seminari mund të flitet mirë e bukur, me fakte e me shembuj konkretë. Mirëpo, disa prej tyre mbajnë shënime, kurse disa të tjerë nuk mbajnë e, mbase, edhe mendjen s'e kanë atje. Në fakt në këto seminare duhet të zhvillohen debate të forta që të shkunden njerëzit mirë.

Tani, pas seminarit që bëtë, ju duhet ta kontrolloni se si është programuar puna në rrethe, me qëllim që të mos mbetet puna zvarrë. Të interesoheni dhe se çfarë forme, çfarë stili dhe çfarë metode pune do të përdorin shokët që ishin në seminar, por jo t'u imponohet atyre stili dhe metoda e punës. Ju do të kontrolloni çmimin e prodhimit dhe do të shikoni edhe anën ekonomike të problemit, por drejtuesit në bazë duhen porositur që ta shohin problemin edhe politikisht, që prej këtej të dalim me konkluzione e të marrim edhe masat e nevojshme. Rëndësi ka që ata ta kenë të qartë vetë në radhë të parë, por të sqarojnë edhe kooperativistët se, së pari, ky vendim është marrë pasi në mjaft kooperativa nuk është punuar mirë dhe, së dyti, për të forcuar ekonominë e vendit. A flasim ne për mbrojtjen? A themi ne çdo ditë se do ta ndërtojmë socializmin me forcat tona? Sigurisht që flasim, aq më tepër që edhe Kina prishi në mënyrë të njëanshme marrëveshjet.

Atëherë, a do të bëjmë ne që edhe në këto kushte të reja të ecë përpara prodhimi? Po si do të ecë ky prodhim? Vetëm duke punuar më shumë, duke rritur rendimentet, duke shtuar akumulimin. Mund t'u thuhet, gjithashtu, se nga kanë dalë gjithë këto fonde për bonifikimet e për gjithë këto vepra të shumta ujitjeje, për plehrat, për mekanizimet e bujqësisë etj. Këto para, me të cilat janë realizuar të gjitha këto, u siguruan me punën e njerëzve tanë. Partia i administroi ato në dobi të ekonomisë sonë, të perspektivave të saj. Një administrim i tillë i mirë nga Partia tani është i domosdoshëm, si nga ana financiare, ashtu edhe nga ana politike, sepse duhet menduar edhe për shtimin e rezervave.

Pra, duhet parë me kujdes se si do t'i shtrojnë shokët të gjitha këto probleme që fjala e tyre të jetë mobilizuese. Dhe këtu, në bazë të kapjes e të trajtimit të problemeve të rëndësishme duhet të vihet politika e drejtë e Partisë sonë, që ka bërë të merren këto rendimente të larta sot. Ne e shtrojmë problemin e rritjes së akumulimit e të krijimit të rezervave në momente të favorshme nga ana ekonomike dhe politike, pasi marrim rendimente të larta në drithëra, sepse po të vazhdohej të merreshin 10 kuintalë grurë për hektar, vështirësitë do t'i kishim më të mëdha. Bile, më parë, kur merrnim rendimente të ulta ne i kemi shtuar çmimet e prodhimit për të favorizuar fshatarët, kurse tani, që në disa brigada merren deri 40-45 kuintalë grurë për hektar, dhe që ka mundësi të arrihet mesatarisht 36 kuintalë për hektar në çdo kooperativë, as që mund të mendohet që shteti të paguajë të njëjtin

çmim prodhimi dhe të lërë pa bonifikuar fushën e Hoxharës, pa ndërtuar hidrocentralin e Komanit, pa ndërtuar këtë apo atë objekt të rëndësishëm. Tani çdo njeri gjykon vetë se sa të drejtë ka Partia për gjithë këto gjëra. Duhet të përmirësojmë vazhdimisht metodën e stilit në punë, t'i bëjmë njerëzit që të mendojnë si thotë Partia, domethënë të shtrojnë mirë dhe t'i diskutojnë në mënyrë të gjithanshme problemet, sepse kështu mbrohet vija e Partisë.

Mbrojtja e vijës së Partisë bëhet nëpërmjet debateve. Kështu, për shembull, nuk është e lejueshme që vetëm pse thotë, fjala vjen, shefi i kuadrit në një ndërmarrje në Fier, dhe të përjashtohet një shoqe nga Partia se «nuk duhet të shkelim statutin» siç e «argumentonte» ai. Dhe, më e keqja është se një anëtar i byrosë së Partisë, i cili kishte mendimin që ajo të mos përjashtohet, nuk guxon ta thotë këtë! Po pse nuk guxon ta thotë? Se mos e akuzojnë që «është kundër statutit». More, si qenka ai kundër statutit?! Ai do të bëjë mirë të flasë dhe ta ngrejë zërin e të diskutojë dhe, në fund të fundit, të ngulë këmbë për këtë e të kërkojë që për një çështje të tillë të pyetet edhe Komiteti Qendror i Partisë. Duke vepruar kështu nuk bëjmë ndonjë gabim, sepse kjo është një shoqe e mirë, e ndershme, punëtore. Por, këtu del përsëri ajo që thashë më parë, që njerëzit duhen bindur me argumente e me fakte, se ka edhe nga ata që flasin përçart. Megjithatë, kur ndonjëri shprehet për diçka jo në mënyrë të drejtë kjo nuk do të thotë se ky njeri është kundër vijës së Partisë. Por, është e domosdoshme të sqarohet ky person. Pra të bëjmë që kuadrot të kuptojnë që

Partia kërkon prej tyre të mbrohet vija e saj në mënyrë revolucionare. Ata të jenë të bindur se vendimet që merr udhëheqja janë në dobi të të gjithë popullit e atdheut. Ndodh që për një rreth apo kooperativë rrethanat, kushtet për zbatimin e një vendimi, të mos jenë aq të përshtatshme, por ky është një përjashtim. Për një rreth ose për një kooperativë nuk mund të ndryshojmë një ligj ose një vendim të drejtë me interes të përgjithshëm. Në raste të veçanta mund të marrim edhe masa plotësuese, për shembull, mund të japim edhe kredi një çikë më shumë në ndonjë rast. Në qoftë se kërkohet nga ndonjëri kredi, pa pasur të drejtë, atëherë kërkuesve t'u shpjegojmë se nuk e kanë drejt këtë kërkesë, sepse i kanë mundësitë të bëjnë edhe pa kredi dhe këto mundësi t'ia sqarojmë një e nga një. Këto, natyrisht, do të bëhen në qoftë se hyjmë në një debat të tillë dhe Partia këtë kërkon.

Edhe këtu që po bisedojmë, këtë punë po kryejmë, debate po zhvillojmë me njëri-tjetrin, në mënyrë që t'i bëjmë sa më të kuptueshme problemet, se ka edhe vështirësi, ka edhe moskuptim, ka edhe paqartësi.

*Dotohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga biseda
e incizuar që gjendet në AQP*

FORCA JONË ESIHTË TE PARTIA

*Nga biseda¹ me një delegacion të Partisë
Komuniste të Spanjës (m-l)²*

10 qershor 1978

Gëzohemi që ju kemi midis nesh, në këto ditë të shënuara për popullin dhe për vendin tonë. Sigurisht, shokët ju kanë folur për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për këtë ngjarje të madhe historike të popullit shqiptar. Kjo ngjarje dëshmon për unitetin e gjithë popullit në përpjekjet që ai ka bërë për mbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit, që kërcënohej nga fuqitë imperialiste e shoviniste, të cilat kanë ndihmuar reaksionin të vendoste në vendin tonë shtypjen dhe shfrytëzimin e tij barbar. Por rëndësi ka se kundër armiqve të shumtë populli ynë u bë grusht, organizoi luftën e tij në mënyrë të mrekullueshme në të gjitha platformat, politike e ideologjike, kulturore, ushtarake e diplomatike. Kjo luftë kishte karakter popullor. Ju e

1. Kjo bisedë u zhvillua pas konferencës solemne që u organizua me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, para se të fillonte koncerti që u dha me këtë rast.

2. Delegacioni kryesohej nga Raul Marko.

dëgjuat këtu fjalën e shokut Ramiz për 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nesër do të organizohet një manifestim i madh, ku do të marrin pjesë populli i kryeqytetit dhe patriotë të ardhur nga të katër anët e vendit dhe të ftuar nga vende të tjera, për varrimin e eshtrave të Abdyl Frashërit, udhëheqës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që kohët e fundit i sollëm nga Turqia.

Shkëmbimi i mendimeve tona në luftën e përbashkët ka rëndësi të madhe për ne. Këtë ne e ndiejmë si diçka të nevojshme, por edhe për shokët spanjollë ka rëndësi. Në një vend ku pushteti është në duart e popullit dhe udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, siç është Partia jonë, miqtë marksistë-leninistë duhet ta ndiejnë veten si në shtëpinë e tyre.

Ju me shëndet jeni mirë? Po shokët andej, mirë janë të gjithë?

SHOKU RAUL MARKO: Mirë janë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është gjë shumë e mirë, sepse kështu edhe partia është gjithmonë e fortë. Lufta dhe përpjekjet që po bëjmë, sidomos lufta me armiqtë imperialistë e revizionistë, nuk na lënë të plogështohemi, por na gjallërojnë. Marksistë-leninistët janë kundër ujit të fjetur, janë për ujin në lëvizje, për ujin e rrjedhshëm. Edhe ne, vetëm kështu, duke qenë në lëvizje, në aktivitet do të përballojmë me sukses luftën e borgjezisë e të revizionistëve dhe do t'i dërrmojmë ata për të mirën dhe fitoren e marksizëm-leninizmit.

SHOKU RAUL MARKO: Momentet aktuale janë interesante, sidomos në fushën ideologjike. Oportunistët

e rinj janë demaskuar përpara popujve shumë më shpejt se revizionistët e tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është e vërtetë dhe përbën një nga karakteristikat e tyre. Revizionistët sovjetikë mundohen të maskohen, kurse ata i kanë hedhur fare maskat.

Ju, shoku Raul, i keni folur shokut Ramiz në detaje për parimet në bazë të të cilave është ndërtuar partia marksiste-leniniste në Spanjë, për taktikat e luftës dhe për bashkimin e elementëve përparimtarë e demokratë, për republikën, për Ibarrurin e renegatë të tjerë që e kanë flakur tej çështjen e republikës. Veprimtaria e tyre, duke e parë thjesht në këtë drejtim, është anakronike, pa folur pastaj për anën ideologjike të çështjes.

Tradhtia revizioniste ka rrjedhimet e veta në rradhët e komunistëve. Komunistët e vërtetë të kohës së luftës civile të Spanjës është e pamundur të tulanen, po kështu edhe elementët republikanë nuk do të tulanen.

Me luftën dhe punën tuaj, ju mbroini popullin dhe ruani individualitetin e tij. Ne, kur themeluan Partinë, e bëmë më se të qartë se Partia Komuniste e Shqipërisë nuk do të tundej kurrë nga parimet e marksizëm-leninizmit. Prandaj çështja e Partisë ka rëndësi të madhe. Këtu qëndron forca jonë. Nuk duhet me qenë as sektarë, as oportunistë. Sektarizmi dhe oportunizmi janë të huaj për Partinë tonë, prandaj të gjithë ata, të cilëve u vlojnë në zemër ndjenjat patriotike, e respektojnë, kur shikojnë qëndrimet e saj të drejta.

Vetëm ekzistenca e një partie të vërtetë marksiste-leniniste forcon besimin e popullit në forcat e veta.

Atij i duhet një udhëheqëse e sigurt, një forcë ku të mbështetet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Të shkojmë, se do të fillojë koncerti dhe shokët po na presin.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë, shkojmë. Gëzohem shumë që këtu u njoha edhe me shokë të rinj. Ata i duam se i gjallërojnë radhët tona. Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

NGJARJE E SHËNUAR E HISTORISË SË LAVDISHME TË POPULLIT TONË HEROIK

Shënime

10 qershor 1978

Datë e shënuar e historisë së popullit tonë heroik. Është dita kur njëqind vjet më parë u mblodh në Prizren Lidhja e Shqiptarëve. Kjo ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike për fatet e kombit tonë, se bëhej në kohën kur fuqia e madhe e Portës së Lartë, e Perandorisë Osmane, në bashkëpunim me carizmin rus dhe me perandoritë e tjera të Evropës, kërkonin ta copëtonin dhe e copëtuan atdheun tonë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte ai moment crucial gjatë të cilit të gjitha energjitë e popullit tonë, patriotizmi i tij i pashoq, dashuria për atdheun, për tokën, për gjuhën, përpjekjet e tij politike dhe diplomatike e bashkuan atë si një grusht të vetëm për t'u bërë ballë turqve, serbëve, malazezve, gjermanëve, austro-hungarezëve e grekëve, sepse që të gjithë këta së toku ishin bashkuar kundër popullit shqiptar.

Për ne kjo datë kujtohet kurdoherë me admirim dhe vënderim të jashtëzakonshëm, se ka qenë frymëzu-

ese për luftërat e mëvonshme të popullit shqiptar deri në ditët tona. Lufta e të parëve tanë rilindës me pushkë dhe me penë për truallin arbëror, na ka lënë mbresa të pashlyeshme që prej gati tre-katër brezash vloi e vlon në gjakun dhe në zemrën e çdo shqiptari. Në Luftën tonë Nacionalçlirimtare i kishim kurdoherë parasysh ato qëllime të larta për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit, për sovranitetin e atdheut, për çlirimin e plotë të tij nga okupimet e imperialistëve të ndryshëm dhe nga feudalët e borgjezia e shitur tek të huajt.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ishte vetëm një mbledhje krerësh. Ajo përfaqësonte vullnetin e gjithë kombit shqiptar, që nga skaji i Jugut deri në Mitrovicë e Kaçanik, në Plavë, në Guci e Tivar. Krerët e saj ishin bij të popullit, me mendje të madhe dhe me një kurajë të hekurt, që kishin një qartësi të madhe ideologjike, politike dhe ushtarake për kompaktësinë e kombit shqiptar e të trojeve të tij që rrezikoheshin të copëtoheshin nga armiqtë e huaj shovinistë.

Ata nuk u kufizuan në memorandume shterpë drejtuar Kongresit të Berlinit ose fuqive të mëdha, por këto memorandume i shoqëruan me një mobilizim të madh e të gjithanshëm të masave të popullit shqiptar në Kosovë, në Maqedoni, në Grudë dhe Hot, në Tivar, në Jug e kudo. Po kështu, edhe aksionet diplomatike të Lidhjes u shoqëruan me aksione luftarake, me një propagandë e me një agjitacion të thellë e të zjarrtë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u bë epiqendra e luftës çlirimtare, ajo vuri në dukje lakmitë e serbomëdhenjve, të shovinistëve malazez e grekë. Të gjithë këta, sidomos sllavët, i ndihmonte carizmi rus që luf-

tonte për pansllavizmin, për bashkimin e gjithë sllavëve, për të dalë në Mesdhe dhe në Adriatik. Dhe carizmi rus u favorizua nga perandoria e Vilhelmit të parë dhe e Bismarkut.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta patriotike që frymëzoi ajo, ishte një nga pikat nevralgjike të çështjes së Orientit. Çështjen e Orientit historianët e borgjezisë e kanë shkruar sipas qejfit të tyre dhe Shqipërinë e kanë paraqitur në këtë çështje si një monedhë tregu për të plotësuar dëshirat e carit rus, të carit serb, të car Nikollës së Malit të Zi dhe të mbretërve të Greqisë, kurse popullin shqiptar, që ishte një popull i gjallë, me kulturë, me gjuhën dhe me shkollat e tij, një popull që kishte luftuar në shekuj dhe vazhdonte të luftonte, ata e harruan dhe nuk e përmendin në librat e tyre. Por populli shqiptar e shkroi vetë historinë me armë në dorë. Ai derdhi gjak, por edhe armiqtë nuk i la të qetë e u shkaktoi atyre dëme të rënda. Për fat të keq, forcat e armiqtë tanë, të bashkuar së toku, i thyen përpjekjet e popullit shqiptar, por këto luftëra dhe Lidhja Shqiptare që u mbajt në Prizren dhe që u përhap e pati degët e saj në gjithë Shqipërinë, lanë mbresa aq të mëdha e të thella në mbarë popullin tonë. Ato shërbyen e do të shërbejnë edhe më vonë për forcimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Shovinistët, cilëndo qofshin këta, me çfarëdo petku që të vishen dhe me çfarëdo ideologjie që të mbulohen, çështjen e madhe të popullit shqiptar nuk do të mund ta shuajnë dot kurrë; ajo çdo ditë që kalon po forcohet dhe rrënjohet në zemrat e shqiptarëve, kudo që janë. Sidomos patriotizmi i vëllezërve tanë të Kosovës, të

Dibrës, të Gostivarit, të Tivarit, të Ulqinit, të Plavës e të Gucisë, do të qëndrojë kurdoherë i ndezur për lirinë, për demokracinë, për kombin e tyre shqiptar.

Në Prizren këto ditë jugosllavët bënë një mbledhje përkujtimore qesharake, sa për të thënë se u kujtua kjo ngjarje. Ne dërguam atje delegacionin e shkencëtarëve tanë, me Stefanaq Pollon në krye, për të marrë pjesë në të ashtuquajturin sesion shkencor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që do të mbahej në Prishtinë. Por shokëve tanë iu kërkua të ndryshonin referatet, titujt dhe konkluzionet e kumtesave të tyre, sepse kështu dëshironin serbët, të cilëve kjo datë kaq e shënuar u kishte zënë këmbët. Shokët tanë refuzuan dhe u bënë gati të largoheshin. Por, pas pak, sigurisht pasi u mor urdhër nga Beogradi, u thanë shokëve tanë se hiqnin dorë nga kërkesat e tyre dhe mund t'i mbanin referatet ashtu siç i kishin. Kështu që studiuesit tanë i mbajtën ato ashtu siç i kishin përgatitur. Megjithatë, është fakt se TANJUG-u nuk dha asgjë për këtë sesion shkencor, ku kishin thirrur për bujë rreth 100 «shkencëtarë» borgjezë, se po të flitej për kumtesat e tyre, ishin të detyruar të flisnin dhe për kumtesat e shokëve tanë. Ndërsa ne nuk do t'i lëmë pa transmetuar në radio kumtesat e historianëve tanë, që shqiptarët, kudo që janë, t'i dinë pikëpamjet tona shkencore për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Disa tradhtarë me gjithë TANJUG-un, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit e kanë katandisur në një luftë gjoja për alfabetin shqip, për shkollat e për pedagogjinë. Kjo është fare për të qeshur. Këta përpiqen të deformatojnë historinë. Por ne nuk mund të presim

ndonjë gjë të mirë nga armiqtë tanë, veçse të defor-
mojnë faktet, konkluzionet, rrjedhimet e kësaj lufte të
madhe të popullit heroik të Kosovës dhe të të gjithë
Shqipërisë.

Kurse te ne Lidhja Shqiptare e Prizrenit u trajtua
si një ngjarje me të vërtetë e lavdishme e mbarë popu-
llit. Ka muaj me radhë që po mbahen konferenca,
shkruhen artikuj, vihen në dukje luftimet, njerëzit e
shquar dhe idetë e mëdha që frymëzonin popullin në
këto momente. I madh e i vogël te ne tash e ka të qartë
këtë periudhë të lavdishme të historisë së tij.

Përveç kësaj, propaganda jonë po shkon kreshendo
dhe sot, më 10 qershor, në orën 18, në Teatrin e Operës
e të Baletit, u mbajt një mbledhje solemne, ku foli
shoku Ramiz Alia për rëndësinë e Lidhjes Shqiptare
të Prizrenit. Në të ishin ftuar edhe pleq patriotë nga të
gjitha anët e Shqipërisë.

Nesër, në datën 11 qershor, do të bëhet një miting
i madh solemn në sheshin «Skënderbej», ku përpara
eshtrave të Abdyl e Naim Frashërit, të vëna në një
shtrat topi dhe të mbuluara me flamurin kombëtar,
do të parakalojë populli i Tiranës. Do të vemi edhe
ne të bëjmë homazhe. Aty pastaj do të mbahet edhe
një fjalim i rëndësishëm për rëndësinë historike të
Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe për udhëheqësit e saj
të shquar.

Pas mitingut, në mënyrë solemne, jo si në një cere-
moni funebre, por në mes entuziazmit dhe duke kënd-
duar këngë patriotike, do t'i çojmë eshtrat e Abdylit e të
Naimit në varrezat e reja që janë ndërtuar në Parkun
e Madh të Tiranës. Tok me varret e dy njerëzve të

mëdhenj të Rilindjes sonë ne kemi përgatitur edhe varrin e Sami Frashërit, eshtrat e të cilit ndodhen në Slamboll, sepse qeveria turke nuk ka vendosur akoma të na i japë. Mendoj se ajo nuk duhet të na i ndajë vëllezërit Frashëri, të cilët për popullin tonë janë vërtet tre, po një e të pandarë, janë simboli i diturisë, i patriotizmit e i lirisë, i luftës së popullit shqiptar për pavarësi dhe sovranitet.

Në vendin tonë ka muaj që po zhvillohet një fushatë e gjerë për t'i bërë të njohur popullit në mënyrë shkencore rëndësinë e madhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, luftërat e të parëve tanë me armë dhe me penë, me dituri e me diplomaci, për lirinë e pavarësinë e vendit të tyre, rezistencën e pashoqe që kanë bërë ata kundër gjithë botës, që kërkonte t'u shkëlte të drejtat e t'i copëlonte, siç i copëtoi. Janë bërë dhe po bëhen nga të katër anët konferenca shkencore. Pas konferencës së madhe shkencore që do të fillojë në datën 12 qershor në Tiranë, do të bëhen konferenca shkencore edhe në disa qytete të tjera kryesore të Lidhjes, si në Shkodër, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Dibër e Kukës.

Kështu ne forcojmë e kalitim më tej patriotizmin e popullit tonë dhe ngremë lart atë krenari të ligjshme dhe të frytshme në të gjithë vëllezërit tanë të Kosovës, të Malit të Zi e të Maqedonisë, që vuajnë nën regjimin e serbomëdhenjve.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VËLLEZËRIT FRASHËRI JANË SHIUME TË SITRENJTË PËR NE

*Nga biseda me disa patriotë e veteranë
në sheshin «Skënderbej»*

11 qershor 1978

Pas mitingut madhështor në sheshin «Skënderbej», për të nderuar kujtimin dhe veprën e Abdyl e Naim Frashërit, me rastin e varrimit të eshtrave të tyre, shoku Enver Hoxha u takua me patriotë e veteranë dhe zhvilloi me ta biseda të shkurtra e të përzemërta.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je me shëndet, Avdi Bajrami?

SHOKU AVDI BAJRAMI: Besa mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: I kemi si kurdoherë të forta bjeshkët tona? Më ka marrë malli shumë për to.

SHOKU AVDI BAJRAMI: Të forta e të patundura janë bjeshkët, ashtu si edhe ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam dashur të vij andej.

SHOKU AVDI BAJRAMI: Edhe ne duam të na vish, shoku Enver, se sa më shumë të na vish, aq më shumë zemër na jep.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të vij t'i shikoj prapë

ato vende, të shikoj Valbonën e bukur! Vajzës së djalit tim Valbona ia kam vënë emrin.

Pastaj shoku Enver i drejtohet patriotet Bijë Vokshi. Si je Bijë?

SHOQJA BIJE VOKSHI: Mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Kurdoherë në front të parë jemi.

Na udhëhiq Bijë! Miting madhështor në kujtim të këtyre bijve të shquar të popullit tonë.

Shiko, Avdi, si është bërë Shqipëria! E kanë bërë djemtë dhe vajzat tona. Kudo shkëlqen drita elektrike, drita që solli Partia. Elektrifikimi është gjë e madhe. Sa të mbarojë hidrocentrali i Fierzës do të fillojmë të ndërtojmë atë të Komanit.

SHOKU AVDI BAJRAMI: Ju lumshin duart! Dritë është bërë Shqipëria. Po a di çfarë, shoku Enver? Të ndërtohet edhe rruga, të mos lejnë pa e ba!

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet ta bëjmë dhe do ta bëjmë, se shkurtohet shumë rruga andej dhe fitohet kohë.

Pastaj, shoku Enver takohet e përqafohet me nënën patriotet Shote Puka.

Ka ndryshuar shumë Puka, nënë Shote. Tregojnë se një pukjan, kur erdhi në Pukë pas një kohe që qe larguar, tha: «Jo bre, kjo nuk është Puka!». Por, kur pa një shtëpi të vjetër, që kishte mbetur në qendër, tha: «O, po, po, kjo qenka!».

Ja, këtë kanë bërë populli e Partia, nënë Shote. U kanë ndërruar fytyrë qyteteve e fshatrave tona. I kanë lulëzuar.

Pastaj, shoku Enver takohet me nipin e Sami Fra-

shërit, Emin Erer dhe menjëherë i drejtohet Avdi Bajramit.

Avdi, ky është nipi i Sami Frashërit, djali i çupës së Samiut.

SHOKU AVDI BAJRAMI: (Duke u përshëndetur me të) Qofsh shëndoshë! Gëzohem shumë!

SHOKU ENVER HOXHA: (Duke iu drejtuar Emin Ererit, frëngjisht.) Qeveria turke ka bërë një veprim të drejtë duke na dhënë eshtrat e Abdylit. Por ne dëshirojmë që t'i kemi këtu, në atdhe, eshtrat e të tre vëllezërve Frashëri, pse atje ku janë dy, duhet të jetë edhe i treti. Ne kemi shpresa se qeveria turke do të na i japë edhe ato të Samiut.

SHOKU EMIN ERER: Ne si familje nuk kemi kundërshtim.

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj, ju lutemi që, për këtë, të bëni sa të jetë e mundur, se ato janë eshtra shumë të shtrenjta për vendin dhe për popullin tonë. Ata janë gjyshërit e baballarët e kombit tonë. Abdylit, Naimi dhe Samiu kanë punuar e kanë luftuar me penën e tyre të artë për vendin e tyre dhe tonin dhe na kanë lënë një thesar të vlefshëm me ide të mëdha.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këto takime që gjenden në AQP

PATRIOTËT E MËDIENJ TË RILINDJES SHKRINË TËRË JETËN E TYRE PËR MËMËDIENË

Nga biseda me shokun Aleks Buda

12 qershor 1978

Biseda u zhvillua në pushim midis seancave të Konferencës shkencore për kremtimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pas referatit të shokut Aleks Buda. Në bisedë merrnin pjesë anëtarët e Byrosë Politike që ishin të pranishëm në këtë konferencë shkencore.

SHOKU ENVER HOXHA: Trajtimi i problemeve kaq të rëndësishme historike të popullit tonë, me një çartësi marksiste-leniniste, me një dialektikë materialiste, si të kësaj konference, te çdo njeri krijon me të vërtetë një moment emocionant, një përfytyrim të gjallë të atyre kohëve të lavdishme të historisë së popullit tonë. Ne ndoqëm me kujdes analizat që i bëni ju kësaj çështjeje. Çdo problem ju e shtroni drejt, nga kreu deri në fund, duke i trajtuar me shumë objektivitet ngjarjet e këtyre etapave të mëdha të popullit shqiptar. Prandaj ndiejmë me të vërtetë një kënaqësi të madhe, të cilën dëshirojmë ta shprehim përpara jush, gjë që nuk

e bëjmë për kompliment, pse, kjo që them, është një e vërtetë, është një realitet.

Ne jemi të lumtur që rreth vetes, për këtë çështje jetike të popullit tonë, ju keni krijuar një grup historianësh. Kështu, të udhëhequr nga Partia, ju po i jepni popullit tonë materiale të shëndetshme, në formë e në përmbajtje, për të cilat ndihet shumë nevoja, sepse ekzistojnë akoma armiq që përpiqen të mohojnë të kaluarën tonë të lavdishme.

SHOKU ALEKS BUDA: Shoku Enver, në qoftë se ne kemi bërë diçka të mirë, e them me bindje të plotë se kjo ka qenë mendimi jo i njërit ose i tjetrit, por bindja e mendimit kolektiv. Pra, ne kemi arritur të shkrijmë mendimet e secilit në një të vetëm, të realizojmë mendimin kolektiv. Unë, edhe në qoftë se kam mundur të jap ndonjë gjë, kjo është vetëm diçka, kurse gjithë kjo punë është fryt i mendimit kolektiv. Është Partia ajo që na bëri të arrijmë këto rezultate. Pa të ne nuk do të bënim asgjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjithë ne pa Partinë nuk do të kishim bërë asgjë.

SHOKU ALEKS BUDA: Tani që jemi në këtë moshë, kur kthejmë kokën pas dhe shikojmë nga e kaluara, themi: në ç'kohë kemi jetuar përpara, ku jemi tani dhe sa mirë jemi! Me të vërtetë Shqipëria ishte hallemadhe, por si është bërë ajo sot! Prandaj edhe na dhimbset më shumë, ashtu siç i dhimbset nënës më tepër një fëmijë i dobët që ajo e rrit me shumë mundime, pikërisht ashtu e duam edhe ne Shqipërinë, më shumë sesa po të kishim arritur në këto nivele duke e gjetur shesh me lule.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjitha sukseset janë arritur në sajë të forcës së madhe të popullit. Kjo forcë e ka burimin në mendimin aq të zjarrtë e aq përparimtar që frymëzoi Partia brezat njërin pas tjetrit, Partia e ka mbrytur, e ka konsoliduar dhe po e kalit vazhdimisht këtë situatë. Ne kemi njohur e njohim edhe njerëz të tjerë të shtresave të borgjezisë përparimtare, që kërkojnë të luftojnë e të shembin të vjetrën, që e kanë kuptuar gjuhën komuniste. Ata, kur shikojnë se si lart i vlerëson Partia jonë këta njerëz të mëdhenj të mendimit e të veprimit si Naimi, Abdyli, Samiu e të tjerë, ushqejnë një respekt të madh për të.

Luftëtarët e palodhur të penës të popullit tonë kanë vuajtur tërë jetën, siç vuajti mëmëdheu ynë. Është një meritë e madhe që Partia jonë të gjitha këto vlera të mëdha që na kanë lënë brez pas brezi bijtë e saj të shquar, i bëri një pasuri shpirtërore dhe nxitje veprimi për të gjithë brezat e tashëm dhe të ardhshëm, që Shqipëria të jetë e pamposhtur. Ajo ka hequr e ka vuajtur, prandaj aq më e fortë dhe aq më e çeliktë do të bëhet. Partia na mëson që të mos kemi frikë nga shantazhet. Aspiratat e atyre që u ngritën e thanë t'i përmbysin shfrytëzuesit, t'i zhdukim, të luftojmë për Shqipërinë, i bëri realitet Partia. Nën shembullin e tyre, — tha Ramizi, — ne nuk kemi frikë nga kurrkush. Ne nuk kërcënojmë njeri, por edhe frikë nuk kemi nga kurrkush.

E ndiejmë veten shumë të lumtur që kemi një Parti të tillë dhe që jemi si kurdoherë ushtarë të thjeshtë të saj. Ajo i ngriti Shqipërinë dhe popullin në nivele kaq të larta, sa krijoi tek ai besimin në forcat e

veta, ngjalli patriotizmin, zhvilloi mendimin e pastër, mendimin krijues. Vetëm Partia i bëri këto, uniteti i saj me popullin. Ne kurdoherë kemi qenë modestë, por fjalën e kemi thënë pa u druajtur. Kjo fjalë aktualisht dëgjohet fort, sepse epoka e tanishme është epoka e revolucionit. Kapitalizmi dhe fuqitë e mëdha imperialiste janë në kalbëzim, popujt aspirojnë e luftojnë për çlirim nga shtypja e shfrytëzimi kapitalist.

SHOKU ALEKS BUDA: Në të njëjtën llogore janë edhe Skënderbeu e Naimi, dhe na duket sikur edhe ata po luftojnë sot bashkë me ne.

Nuk e di në i kujtohet shokut Ramiz, që ishte atëherë nxënës, por, kur dëgjova dje bataret që u zbrazën, në kohën e vendosjes së arkivoleve të vëllezërve Frashëri që përbënin kulmin e ceremonisë, mua m'u kujtua demonstrata e 28 Nëntorit 1939 në Tiranë. E kujtuam dje këtë me Minella Karajanin. Ne, nxënës e mësues, kishim vendosur të mbledheshim të gjithë për të shkuar te varri i Naimit dhe kështu u bë. Ishte atëherë një palaço fashist, njëfarë Llazar Shantoja, i cili do të mban-te fjalimin zyrtar para të gjithë nxënësve dhe arsimtarëve që ishin mbledhur përpara bashkisë. Por ne ikëm, e lamë sheshin bosh, kaluam Lanën dhe dolëm në vendin e caktuar. Tirana atëherë mbaronte në rrugën «All Demi». Kërkonim flamur, por kishte vetëm nga ata që ishin me sëpatën e liktorit. Andej nga kalonim, u futëm në disa shtëpi të vogla, gjetëm dhe morëm atje një flamur, të cilin e vendosëm në varrin e Naimit. E puthëm flamurin dhe atëherë shpërtheu në çast urrejtja për armiqtë. Kjo ishte demonstrata e parë. U drejtuam për në qytet duke kaluar Lanën, ku donin të na ndalnin.

E kam fjalën aty që Naimi që në atë kohë ka qenë i dashur për të gjithë ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Që kur kemi qenë në djep të gjithë jemi ushqyer me ndjenjën e dashurisë për Naimin dhe për veprat e tij, prandaj kudo ne këndonim me zell të madh vjershat e tij. Ne, stërnipërit e tyre, jemi krenarë për gjyshërit tanë heroikë.

SHOKU ALEKS BUDA: Me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit akademia jonë pati edhe mysafirët e saj që morën pjesë në përvjetorin e kësaj ngjarjeje të lavdishme të historisë së popullit tonë. Mua m'u duk si një gjest shumë simbolik që eshtrat e bijve të shquar të popullit shqiptar tashmë janë kthyer në atdhe. S'ka gjë që ato u kthyen pas 80 vjetësh, rëndësi ka që u kthyen.

SHOKU ENVER HOXHA: Plejada e patriotëve të mëdhenj të Rilindjes, që shkrinë tërë jetën e tyre për mëmëdhenë, po kthehen një nga një në atdhe. Ne i thamë me këtë rast edhe nipit të Samiut në frëngjisht: «Aty ku janë dy, duhet të jetë dhe i treti, nuk «rrojnë» dot ata pa Samiun». I fola pastaj se çfarë është Samiu për ne e se pikërisht për këtë ai duhet të jetë në këtë tokë, në atdheun e tij, që e donte aq shumë. Po, m'u përgjigj edhe ai, e drejta kështu është.

SHOKU ALEKS BUDA: Shpresojmë se turqit do të na lejojnë t'i marrim eshtrat e Samiut.

SHOKU ENVER HOXHA: Duhet t'i marrim, sepse nuk është arsye ajo që thonë ata, se Sami Frashëri qenka i tyri. Jo. Veprat e tij janë me përmbajtje filozofike të përshkuara nga një patriotizëm i thellë për çlirimin e Shqipërisë e të popullit shqiptar, po kështu

edhe për zgjimin e popullit turk. Por ai ishte shqiptar dhe vepra e tij është bërë krejt nga pozita shqiptare. Mendoj se pikërisht zjarri që kishte në zemër për Shqipërinë, dëshira për ta parë mëmëdhenë të lirë, të kulturuar e të përparuar, e bëri që të ngrihet në këtë lartësi.

SHOKU ALEKS BUDA: Po të ishte nisur vetëm nga pozita si turk nuk do të ishte bërë 100 vjet përpara ajo që u bë te ne.

SHOKU ENVER HOXHA: Partia jonë duke njohur mirë meritat e këtyre bijve të shquar të popullit shqiptar, i kujton ata me respekt e dashuri. Shenjë e këtij respekti është edhe organizimi i gjithë këtij aktiviteti për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Komiteti Qendror i Partisë, Qeveria, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe ju personalisht, e tok me ju gjithë punonjësit e Akademisë së Shkencave, kanë bërë të gjitha përpjekjet e ju keni vënë tërë zotësitë tuaja që i gjithë ky organizim të dalë me sukses.

Prandaj, shoku Aleks, në emër të të gjithë shokëve dhe në emrin tim personal, ju përgëzoj dhe ju lutem t'u transmetoni edhe shokëve të tjerë të Akademisë së Shkencave, veçanërisht shokëve që kontribuan aq shumë në njohjen e kësaj epoke historike të shkëlqyer të popullit tonë, falënderimet më të zjarra të Komitetit Qendror, të Qeverisë dhe personalisht ju të jeni i sigurt se do të keni kurdoherë mbështetjen e Komitetit Qendror të Partisë në të gjitha veprimet tuaja, që kontribuojnë thellësisht në zhvillimin e mendimit shpirtëror, në zhvillimin shkencor dhe ekonomik që ndihmon në ndërtimin socialist të vendit tonë. Të jeni të bindur se ne çdo pengesë do ta kalojmë.

SHOKU ALEKS BUDA: Me këto fjalë të ngrohta, që vlerësojnë kaq lart punën tonë, ju na prekni thellë zemrën të gjithëve, shoku Enver. Të gjithë shokëve unë do t'ua transmetoj falënderimet tuaja. Por unë dëshiroj të them se në këtë punë kanë kontribuar te ne që nga më të vegjlit e deri te ne që qëndrojmë pas kra-hëve të tyre. Të jeni të sigurt se fjalët që na thoni ju dhe gjithë Partia, janë për ne frymëzim që na nxitin për të kryer sa më mirë detyrat që na vihen edhe për të ardhmen.

SHOKU ENVER HOXHIA: Në mënyrë incizive, the-rëse, ju, kur folët për programin, për qëllimet e lidhjes dhe si trajtohet ky problem nga të huajt, e vutë çësht-jen mirë kundër veprimtarive të titistëve.

Punimet e kësaj konference dhe të gjitha këtyre aktiviteleve do ta ngrenë lart moralin e vëllezërve tanë në Kosovë, pavarësisht se atje ka disa që nuk e pëlqejnë këtë të vërtetë që shprehim. Por ne të katër të vërtetat i themi hapur. Titoja i dërgoi kosovarët me dhjetëra e qindra mijë në Turqi e gjithandej nëpër botë, kurse la-kenjtë kosovarë thonë që ju po na dobësoni me këto që po bëni.

Mirë, Aleks, mirupafshim! Edhe një herë ju uroj suksese në punën tuaj.

Botuar për herë të parë në revistën: «Studime politi-ko-shoqërore», nr. 13, 1987, f. 10

Botohet sipas revistës «Studi-me politiko-shoqërore», nr. 13, 1987, f. 10

DISA MENDIME PËR RILINDËSIT

Shënime

12 qershor 1978

Ata janë një plejadë e tërë njerëzish të shquar të mendimit përparimtar shqiptar dhe të aksionit, njerëz me aftësi të një organizimi të përsosur luftarak, politik, propagandistik, ideologjik dhe diplomatik. Kur thellohem në mendimet, në veprimet dhe në shkrimet e tyre, ne shohim atë potencial të madh krijues përparimtar që trashëgojmë nga kjo plejadë e madhe njerëzish të mëdhenj të popullit shqiptar.

Këta njerëz të mëdhenj janë frymëzuar, në radhë të parë, nga aspiratat e popullit tonë për çlirim, për pavarësi kombëtare, për demokraci, ata janë të frymëzuar nga dëshira e zjarhtë që kulturën tonë të lashtë ta vinin si duhej në dukje, të bënin që ajo të përhapej kudo në të gjitha vendet ku banonin shqiptarë, ta lëvrojnë këtë kulturë, ta pasuronin, të hapnin shkolla dhe t'i shkollonin bashkatdhetarët e tyre. Këta dijetarë të mëdhenj, filozofë, mendimtarë dhe njerëz të aksionit, domethënë elementë revolucionarë të vendit tonë, ishin iluministë dhe kanë qenë frymëzuar nga Revolucioni klasik Demokratiko-Borgjez i Francës, të cilin, siç duket

qartë në shkrimet e tyre, ata e kanë pasë studiuar. Për këta dijetarë dhe njerëz të aksionit të popullit shqiptar filozofët dhe mendimtarët që përgatitën revolucionin borgjez, si Didëroi, D'Alamberi, Volteri, Rusoi e të tjerë, ishin të njohur, po të njohur jo në mënyrë të përciptë. Ishin, gjithashtu, të njohura prej tyre veprimet dhe rrjedha e veprimeve të këtij revolucioni, etapat e ndryshme të tij, që nga kryengritjet fshatare kundër feudalizmit dhe deri në kulmin e Revolucionit Demokratiko-Borgjez Francez, deri te prerja e kokës së Robespierit dhe të Sen-Zhystit¹, pas së cilës filloi kundër-revolucioni i borgjezisë.

Por, pavarësisht se ishin të frymëzuar nga ky revolucion, si dhe nga revolucionet e tjera që u zhvilluan më vonë, më 1848, në gjithë Evropën, nga rrjedhimi i tyre në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në gjirin e Fuqive të Mëdha, si dhe në gjirin e popujve që vuanin shtypjen më të rëndë nacionale, ekonomike e politike nga këto Fuqi të Mëdha borgjeze, kapitaliste dhe imperialiste, mendimtarët e mëdhenj të popullit shqiptar ishin më të përparuar. Kjo shpjegohet me faktin se koha, zhvillimi dialektik materialist i historisë, i bëri këta ta shikonin situatën e kombit shqiptar, të atdheut të tyre dhe zhvillimin e politikën e Fuqive të Mëdha, me një sy tjetër nga sa e kishin parë revolucionarët francezë të revolucionit demokratiko-borgjez dhe të revolucioneve të tjera të vitit 1848 e më vonë, që u zhvilluan në shumë shtete të Evropës.

1. Lui Antuan Sen-Zhyst (1767-1794), anëtar i Komitetit për shpëtimin publik, përkrahës i Robespierit.

Pra, dijetarët tanë shikonin me kujdesin më të madh dhe analizonin gjendjen politike, ekonomike dhe diplomatike të Portës së Lartë, luftërat që ajo bënte dhe i bënin, zhvillimet e tyre, zhvillimin diplomatik që bëhej në kurrizin e popullit shqiptar.

Përfundimi logjik i luftërave të Fuqive të Mëdha evropiane, perandorisë cariste, asaj austro-hungareze, prusiane dhe Portës të Lartë, në luftërat që bënin njëra pas tjetrës, në koalicione të ndryshme, ishte copëtimi i atyre shteteve, i atyre kombeve të vogla, që formonin perandoritë e tyre, një nga të cilët ishte edhe kombi shqiptar. Në traktatet e imperialistëve evropianë, Shqipëria konsiderohej si monedhë tregu për lakmitë e njërës dhe të tjetrës fuqi të madhe ose satelit të saj. Haraçi jepej nga Porta e Lartë në kurrizin e Shqipërisë.

Çështja e Lindjes bëhej në kurrizin e Portës së Lartë, veçanërisht në kurrizin e popullit shqiptar, i cili nuk kishte asnjë mbrojtje, veç vetes së tij. Atij vetë i kishte ngarkuar historia të mbrohej, të mbrohej kundër Fuqive të Mëdha, të mbrohej edhe kundër satelitëve të këtyre Fuqive të Mëdha, që ishin shovinistët fqinj, serbë, malazez dhe grekë.

Pra, Shqipëria, populli shqiptar, mbarë kombi shqiptar bënte një luftë në dy fronte, në frontin kundër imperialistëve dhe në frontin kundër satelitëve të tyre imediatë që kërkonin ta copëtonin. Në përballimin e kësaj situatë kaq të vështirë dhe kaq të komplikuar duket madhështia e unitetit të kombit shqiptar, të formuar në shekuj, në beteja, me të gjitha karakteristikat e një kombi me kulturë, të një kombi me një

gjuhë të vetën të kultivuar, të një kombi që kishte trojet e tij dhe që kishte derdhur gjak për të jetuar i lirë, për të qenë i pavarur dhe i unifikuar. Kombi shqiptar ishte një komb i përparuar, të cilin asnjë komb tjetër, dhe këta kanë qenë të shumtë dhe e kanë pasë pushtuar e copëtuar, nuk ka mundur as ta zhdukë, as ta shuajë, as ta detyrojë të ulte kurrizin dhe as t'i zhdukte kulturën. Shumë popuj të tjerë kanë pësuar nga një dhunë të tillë, shqiptarët jo. Pushtimi dhe copëtimi nga ana e fuqive të ndryshme grabitqare asnjëherë nuk e përlënë popullin shqiptar. Kjo tregon atë vendosmëri, atë trimëri, atë zgjuarsis, atë koncept të drejtë revolucionar të këtij populli që, përpara çdo rrebeshi, qëndronte i patundur dhe i bënte ballë, siç i ka pas thënë një malësor në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit Abdyl Frashërit: «Ashtu si Gjajlica nuk rrëzohet me një shkop, dhe Shqipëria nuk përunjet përpara rrebesheve». Edhe në këtë rast u treguan zotësia e madhështia e popullit tonë dhe e udhëheqjes së tij demokratike, revolucionare dhe iluministe. Iluministët shqiptarë, që udhëhoqën Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, që udhëhoqën atë epope legjendare, gjatë gjithë Çështjes së Lindjes, kundër gjithë intrigave të kurdisura nga armiqtë e popullit tonë, treguan një zotësi të madhe në mendime, në organizim, treguan një vendosmëri të madhe në luftë, pse lufta që ata mendonin ishte e ashpër dhe e shumanshme, me armë, me propagandë, me dituri, me mbrojtjen e kulturës, me hapjen e shkollave dhe me ngulitjen në kokën e shqiptarëve se uniteti i trojeve të veta dhe mbarë kombit vetëm me armë do të fitohej.

«Ju e bëtë punën tuaj, — u tha Abdyl Frashëri pjesëmarrësve në Kongresin e Berlinit¹, — tash fillon puna jonë». A ka mendim më të madh revolucionar se ky? A ka veprim më luftarak se ky? A ka vendosmëri më të madhe se kjo? Të tillë ishin ata burra që ne aktualisht i vëmë në pedestal, historinë e të cilëve, këtë histori të madhe të popullit tonë, regjimet e kaluara, satrapi Ahmet Zogu dhe okupatorët, jo vetëm ushtarakët, por edhe ideologët e historianët e tyre, e kanë shtrembëruar. Fuqitë e Mëdha imperialiste dhe miqtë e satelitët e tyre, monarkistë shovinistë fqinj, që ta copëtonin më mirë Shqipërinë, e konsideronin këtë si një nocion gjeografik, se ata nuk mund të luftonin dhe të mbronin njerëz që rronin të humbur nëpër bjeshkë e në kasolle, ata i konsideronin myslimanët shqiptarë si turq, shqiptarët e krishterë si grekë dhe unitetin e kombit të hallakatur në fise.

Por populli shqiptar dhe udhëheqja e tij u treguan atyre se hallkat e zinxhirit shqiptar nuk ishin të shkëputura dhe të shpërndara andej-këtej, por qenë të lidhura si çeliku njëra me tjetrën. Këto hallka, lufta, politika, diplomacia, shkolla, kultura zhvilloheshin frontalisht përpara armiqve që kërkonin të bënin copë-copë këtë zinxhir të çeliktë.

Kur ne lexojmë e thellohemi në shkrimet e gjyshërve tanë, në ato kushte aq të vështira të Perandorisë Osmane dhe të intrigave të fuqive të huaja, aq më tepër ngrihen lavdia e tyre dhe mirënjohja jonë, aq

1. Kongresi i Berlinit (1878) u thirr pas luftës ruso-turke për rishikimin e kushteve të paqes së Shën-Stefanit.

më tepër zien në gjakun tonë patriotizmi shekullor. Është për këtë arsye që populli ynë i shumëvujtur ka këtë kapacitet të qartë mendimi, ka këtë hov e këtë guxim revolucionar të çështjeve përpara, të shpartallojë çdo armik, të zhdukë mjegullën, të zhdukë errësirën e të dalë në dritë.

Tërë historia e popullit shqiptar është një epope e shkëlqyeshme, e pafund, por Partia, që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, që e ka kuptuar si duhet rrjedhën e historisë nga pikëpamja e materializmit dialektik, gjithë këtë veprimtari të madhe e ka bërë të sajën, e vë në dukje, që të bëhet ushqim i masave të gjera të popullit, i cili të edukohet me zjarr të madh atdhedashurie dhe t'i kuptojë këto situata, pse kjo veprimtari është ai gur i fortë si stralli që ka ngritur këtë kala, që quhet Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, këtë kala që e ka ngritur populli me luftë të vazhdueshme deri në ditët tona, luftë me armë, luftë me penë, luftë ekonomike, luftë politike, luftë diplomatike. Në gjakun tonë dhe në atë të brezave të ardhshëm qarkullon kjo veprimtari e madhe e pafund përparimtare e revolucionare e mendimit popullor.

Iluministët tanë ishin njerëz të popullit, ata ishin të lidhur me të, ia ndienin pulsën, të rrahurat e zemrës së tij, ata dinin ku ishin të mirat dhe të metat e tij, për të mirat luftuan dhe i zmadhuan, i shumëzuan, të metat e tij u përpoqën me të gjitha forcat që t'ia zhduknin.

Ky është thesari i kombit, i cili mbruhet si një bukë e shëndetshme nga teoria marksiste-leniniste, që udhëheq Partinë tonë. Dhe, si rrjedhim, ne shohim këto rezultate të mrekullueshme që ka arritur Shqipëria so-

cialiste nën udhëheqjen e Partisë, shohim sot vendin tonë të lulëzuar, shohim njeriun e ri të mësuar, të edukuar, të ndershëm, patriot, e shohim atë të mësojë e të mësojë me pasion të madh diturinë dhe këtë ta vërë në shërbim të popullit, për ta bërë republikën tonë gjithnjë e më të fortë, më të begatshme. Ne shohim këtë Shqipëri socialiste, që doli nga zjarri i luftës, nga gryka e pushkës partizane, që është rrjedhimi i luftërave heroike të të parëve tanë. Me këtë luftë heroike shohim që ai t'u bëjë ballë stuhive të shumta të kohës sonë, stuhi të egra, furtuna të tmerrshme të imperialistëve amerikanë, të socialimperialistëve sovjetikë, të kapitalizmit botëror dhe të fqinjëve tanë shovinistë.

Kur krahason mendimin, vendimin dhe veprimin përparimtar të rilindësve tanë, të udhëheqësve të shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të udhëheqësve të kryengritjeve të vitit 1848, konstaton se banditët hrushovianë dhe revizionistët kënczë, si Çu En Lai me shokët e tij, janë 150 vjet prapa mendimit revolucionar të asaj plejade të madhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këta revizionistë të çdo ngjyre janë të lidhur me imperialistët më të egër se ata të parët dhe së toku përpiqen të mbajnë popujt nën zgjedhë, në robëri. Ata përpiqen të denigrojnë Shqipërinë socialiste, që lëshon dritë, dhe që u tregon popujve të botës se edhe një popull i vogël është në gjendje të rrojë i lirë e sovran, në mes të ujqve, t'u bëjë ballë këtyre ujqve, mund të merrret e duhet të merret si shembull dhe të mbrohet nga popujt përparimtarë të të gjithë botës.

Sot ne shohim se jo vetëm imperialistët, por edhe revizionistët sovjetikë, caristët e rinj, mbajnë nën zgje-

dhë, veç popujve të Bashkimit Sovjetik, të cilin e kanë kthyer në një burg popujsh, edhe popujt e Evropës Lindore dhe prapë kërkojnë ta zgjerojnë perandorinë e tyre edhe më tutje.

Ne shohim imperializmin amerikan të mbajë nën thundrën e kapitalit dhe të armëve të tij, nën kërcënimin e bombave atomike, popujt që kërkojnë liri.

Ne shohim, gjithashtu, Kinën aktuale revizioniste të ecë në rrugën e një fuqie imperialiste, fuqi imperialiste kjo me maskë socialiste, që përpiqet të dëmtojë Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ne shohim së fundi titistët serbomëdhenj, shovinistët maqedonas e të tjerë, të shtypin vëllezërit tanë kosovarë, ata të Maqedonisë e të Malit të Zi dhe të na akuzojnë ne si shovinistë, si irredentistë. Ata paskan të drejtë t'i shtypin bashkatdhetarët tanë, kurse ne nuk paskemi të drejtë të themi dhe të shkruajmë historinë, ashtu si ka qenë, ashtu si është e vërteta. Por ne nuk na trembin dot ata dhe nuk do të na trembë kurrë asnjë forcë reaksionare në botë, cilado qoftë ajo.

Këto thesare të mëdha të popullit me një mjeshtëri të rrallë, me një organizim të përsosur, me një qartësi mendimi, Partia duhet t'i shpërndajë në popull, t'i bëjë mishin dhe gjakun e tij, t'i thithin e t'i përvetësojnë komunistët shqiptarë këto mësimë të mëdha të popullit tonë në dritën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste sepse vetëm kjo i sqaron, i fuqizon anët përparimtare, anët luftarake e patriotike të këtyre veprimeve të mëdha të popullit tonë.

Ka jashtë komunistë akoma të paformuar, që nuk e kuplojnë këtë çështje kaq të madhe, të kaluarën pro-

gresiste e revolucionare të popullit tonë. Një komunist dhe udhëheqës partie i një vendi të huaj, kur vajti në Krujë dhe pa monumentin madhështor të Skënderbeut tha: «Po fundi ky ishte një princ, ishte një mbret i Shqipërisë dhe komunistët nuk mund të ngrenë në këtë mënyrë mbretërit dhe monarkinë». Kuptohet që ky nuk ishte një komunist i formuar, ose nuk ishte fare një komunist i mirë, vetëm se kishte një maskë. Sigurisht që ne komunistët jemi kundër monarkisë, jemi kundër mbretërve. Po, Skënderbeu ka qenë princ e mbret, por një princ e një mbret popullor, një princ çlirimtar, një princ i lidhur ngushtë si mishi me thoin me popullin e vet dhe historia e tij bëri epokë, pse luftonte kundër perandorisë më të fuqishme të kohës që kërcënonte gjithë Evropën. Ai, tok me popullin shqiptar, u vuri gjoksin sulmeve barbare të otomanëve dhe i mundi ata për 22 vjet me radhë. Si mundet që komunistët shqiptarë të mos e vënë në dukje këtë njeri të dalë nga populli, që luftoi për popullin, që u bë shembull lufte për liri, shembull heroizmi e vendosmërie për gjithë popujt e botës? Pra, kështu qëndron çështja edhe për demokratët revolucionarë të popullit tonë të çdo epoke, që kanë luftuar për këtë truall, për këtë liri, për këtë demokraci, për këtë kulturë, për këtë alfabet, që janë djegur nga armiqtë dhe shovinistët në zjarr, që janë pushkatuar, që kanë lënguar dhe që kanë vdekur nëpër burgje.

Kjo është historia e popullit, prandaj kjo nuk mund të shlyhet dhe as të shtrembërohet, përkundrazi, ajo duhet vënë në dukje si duhet dhe të bëhet një frymëzim i madh për njerëzit tanë brez pas brezi. Le të shër-

bejë për këtë qëllim edhe kjo fushatë e madhe dhe e thellë shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kështu duhet të bëhet me të gjitha periudhat e historisë së lavdishme të popullit tonë, kështu duhet të ngrihet në pedestal çdo ditë Lufta heroike Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia dhe që realizoi më në fund ëndrrat e popullit tonë, të të gjithë brezave, të të gjithë luftëtarëve, mendimtarëve e kordhëtarëve të popullit shqiptar.

Aktualisht Shqipëria realizoi në sajë të Partisë ëndrrën e të parëve tanë. Neve na bie detyra e madhe që ta kalitim, ta forcojmë më tej Shqipërinë tonë socialiste, ta bëjmë atë më të bukur, t'ia bëjmë popullit jetën më të lumtur, më të gëzuar, të ecim përpara drejt përparimit, drejt shkencës, drejt begatisë, ta shtyjmë revolucionin gjithnjë përpara, ta zgjerojmë, ta zhvillojmë dhe të bëhemi flamur për të. Ne fodullë nuk jemi, por ecim në rrugën e vërtetë të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit dhe kjo ne na bën të themi se jemi pjesëtarë të revolucionit të madh botëror. Ne kurrë nuk do ta tradhetojmë këtë revolucion, pse kush i tradhton këtë revolucion dhe marksizëm-leninizmin, ai ka tradhtuar popullin e vet, ka tradhtuar atdheun. Për ne komunistët shqiptarë atdheu, populli e marksizëm-leninizmi janë tri gjërat më të shtrenjta e më të vlefshme në jetë.

Botuar për herë të parë në revistën: «Studime politiko-shoqërore», nr. 2, 1982,

f. 12

Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Për shkencën» (Përmbledhje veprash), vëll.

II, f. 163

PROBLEMI I POPULLSISË SHQIPTARE QË BANON NË TROJET E VETA NË JUGOSLLAVI

Shënime

13 qershor 1978

Deri tash problemin e vëllezërve tanë shqiptarë që jetojnë në trojet e veta shekullore në Jugosllavi, problemin e tokave shqiptare që u ndanë nga mëmëdheu dhe iu dhanë haraç Serbisë dhe Malit të Zi, ne, komunistët shqiptarë, e kemi trajtuar kurdoherë në rrugë marksiste-leniniste dhe kështu do ta trajtojmë edhe në të ardhmen.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ne nuk e shtruum çështjen nacionale në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi të Jugosllavisë së vjetër, të kralit serb. Këtë për arsye se të dy popujt tanë qenë ngritur në luftë kundër të njëjtit armik, u rreshtuan në koalicionin e madh antifashist dhe u mbështetën te Bashkimi Sovjetik dhe te Stalini. Prandaj në atë kohë nuk vihej aspak problemi i çështjes së popullsisë dhe i tokave shqiptare në Jugosllavi. Atëherë shtrohej problemi që të ngriheshin në luftë tok me ne kosovarët dhe shqiptarët e viseve tona në Jugosllavi. Pastaj, në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe të

zgjdhjes së drejtë të çështjes nacionale në shtetin jugosllav, i cili përbëhej nga shumë kombe, e drejta e vetëvendosjes duhej t'u jepej të gjitha kombeve e kombësive, në mes të të cilave edhe asaj shqiptare që përfshihej në shtetin jugosllav. Kështu vepruam në atë kohë dhe kjo ishte një rrugë e drejtë.

Gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare në bashkëpunim me komunistët e me partizanët jugosllavë dhe, pasi çliruam atdheun tonë, Shqipërinë, nga nazifashistët, në marrëveshje me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë e të ushtrisë partizane jugosllave u dhamë urdhër divizioneve tona që të kalonin në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi për t'i çliruar këto vende, në bashkëpunim me partizanët jugosllavë.

Forcat tona nacionalçlirimtare arritën tej Vishegradit, deri në Bosnjë dhe në Hercegovinë. Ne shkuam atje me mendime të pastra dhe të qarta komuniste e marksiste-leniniste, kurse jugosllavët, edhe pse e quanin veten komunistë, dhe në atë kohë ne besonim se ishin të tillë, nën pretekstin se gjoja luftonin elementët ballistë, morën masa dhe vranë mjaft njerëz nga popullsia shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, po kështu edhe në Mal të Zi.

Gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, Italia fashiste, pas sulmit hitlerian mbi Jugosllavinë, shpalli «Shqipërinë e madhe», domethënë gjithë trojet shqiptare, të banuara nga shqiptarë, ajo i bashkoi me Shqipërinë. Ne e luftuam këtë veprim me karakter imperialist, antishqiptar, shtypës, skllavërues; e luftuam, gjithashtu, demagogjinë nacionaliste dhe fashiste të re-

gjimit musolinian të Mustafa Krujës, të Shefqet Vërlacit dhe të të gjithë kuislingëve të tjerë që erdhën më vonë e që bashkëpunuan me italianët dhe me gjermanët. Kjo çështje s'kishte të bënte aspak me qëndrimet politike dhe ideologjike të Partisë sonë. Lufta jonë ndoqi në këtë drejtim rrugën e vërtetë të çlirimit në bazë të aspiratave të popullit shqiptar, të ndjenjave të thella antifashiste çlirimtare dhe internacionaliste në bashkëpunim me popujt e Jugosllavisë dhe me popullin grek që luftonin, si dhe me aleatët sovjeto-anglo-amerikanë.

Pas Çlirimit të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, prapë qëndrimi i Partisë sonë ishte i drejtë, marksist-leninist. Ne i tërhoqëm forcat tona ushtarake nga Kosova, nga Dibra dhe nga Mali i Zi, nga Bosnja e Hercegovina. Gjithë partizanët shqiptarë u kthyen në Shqipëri dhe bashkëpunimi ynë i sinqertë me jugosllavët, flas nga ana jonë, filloi të futej në një rrugë pak a shumë të drejtë, megjithëse shikonim qëndrime e veprime që nuk na dukeshin shumë të drejta, por këto ua vinim moskuptimit ose sjelljeve jokorrekte të individëve të ndryshëm dhe jo udhëheqjes jugosllave. Në të vërtetë doli se çështja nuk ishte kështu. Më vonë, gjatë viteve 1947-1948, pikëpamjet antimarksiste, shoviniste, imperialiste dhe fashiste të titistëve do të dilnin më qartë në dritë. Kështu deri atëherë, sidomos ne nga ana jonë përpiqeshim që marrëdhëniet tona me Jugosllavinë të ishin miqësore.

Kur unë shkova për herë të parë në Jugosllavi, siç e kam shënuar edhe në shkrime të tjera, në bisedën që pata me Titon, u ngrit edhe çështja e Kosovës dhe

e të gjitha vëseve shqiptare që i janë atashuar Jugosllavisë. Ai më pyeti mua se cili ishte mendimi ynë për këtë problem. Iu përgjigja Titos se Kosova e viset e tjera me popullsi shqiptare që i janë aneksuar Jugosllavisë (Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi), janë toka shqiptare, të banuara nga shqiptarë, prandaj i përkasin Shqipërisë dhe tani që ne jemi dy vende socialiste, janë kushtet që ky problem të zgjidhet drejt. Titoja, natyrisht, për të fshehur lodrën e tij të djallëzuar e antishqiptare, pohoi se kjo është e vërtetë; se nuk mund të mohohej një gjë e tillë; se në kohët e mëparshme janë bërë padrejtësi ndaj Shqipërisë, prandaj këto toka dhe kjo popullsi i përkasin Republikës Popullore të Shqipërisë, por ju duhet të na kuptoni, tha ai, se jemi akoma në fillim të punës për konsolidimin e pushtetit tonë, prandaj, në rast se ne do të bëjmë një gjë të tillë, domethënë në rast se do t'ia kthejmë këto territore Shqipërisë, atëherë reaksioni serb do të ngrejë krye dhe do të na dëmtojë në konsolidimin e pushtetit tonë popullor. Dhe Titoja shtoi se kur ky pushtet të fuqizohet, atëherë puna do të zgjidhet dhe këto toka do t'i kthehen Shqipërisë dhe më pyeti nëse isha dakord kështu. Iu përgjigja se isha dakord, se kjo është një zgjidhje e drejtë; ju njihni se këto janë toka shqiptare, i thashë, dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë dhe për këtë qëllim momentin duhet ta krijojmë. Ky ishte bisedimi që bëra unë për këtë çështje në këtë takim të parë me Titon.

Mirëpo më vonë u kuptua se ai ishte një shovinist, një element antimarksist dhe antishqiptar. Qëllimi i tij nuk ishte t'i jepte Shqipërisë tokat e grabitura nga

Serbia, nga Maqedonia e Mali i Zi, po ta fuste edhe vetë Shqipërinë në Federatën Jugosllave si një republikë të saj të shtatë.

I tillë ishte qëndrimi ynë pas Çlirimit për këtë problem dhe jam i bindur se ky qëndrim nga ana jonë ishte i drejtë. Edhe Bashkimi Sovjetik dhe Stalini, që nuk i njihnin akoma në atë kohë se ç'ishin Titoja dhe titistët, dhe që pak e njihnin edhe Shqipërinë, si u duk, nuk mendonin ndryshe, se nuk bënë asnjë vërejtje, asnjë sugjerim.

Pas demaskimit të titizmit situata ndryshoi krejtësisht. Ndryshuan, duke u sqaruar çdo ditë e më mirë, pikëpamjet tona politike për Federatën Jugosllave në përgjithësi, si dhe për udhëheqjen e Partisë Komuniste Jugosllave dhe për çështjen e shqiptarëve në Federatën Jugosllave.

Natyrisht, gjithë qëndrimi ynë, që nga ajo kohë dhe deri më sot, vazhdon të jetë i njëjtë.

Cili është ky qëndrim? Qëndrimi ynë ka qenë dhe është që vëllezërit tanë që jetojnë në Jugosllavi, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni janë në vatrën e tyre, në toka shqiptare. Këto toka janë grabitur nga serbomëdhenjtë, nga malazeztë me ndihmën e fuqive të mëdha imperialiste të asaj kohe.

Por, ne nuk kemi dashur të hyjmë dhe nuk do të hyjmë në konflikt të armatosur për çështjen e bashkimit me mëmëdheun të trojeve shqiptare nën Federatën Jugosllave. Në luftën tonë kundër titizmit ne i kemi mbrojtur me vendosmëri të drejtat kombëtare, gjuhën, zakonet dhe doket e vëllezërve tanë që jetojnë në Jugosllavi, pse këta po merreshin nëpër këmbë njëllor

dhe po në atë mënyrë që kanë qenë marrë edhe nga serbomëdhenjtë, nga stërnipërit e knjaz Nikollës dhe të shovinistëve maqedonas.

Titoja, Rankoviçi, Tempoja, Dushani dhe gjithë banda e revizionistëve jugosllavë e kuptonte qartë se çështja shqiptare në Jugosllavi nuk mund të shlyhej. Nuk mund të mbulohej drita e diellit me shoshë, nuk mund të errësohej kjo dritë, nuk mund të shuheshin ndjenjat e patriotizmit kosovar. Prandaj titistët, duke u përpjekur që të ruanin maskën e një regjimi socialist dhe të partisë së tyre si një parti gjoja marksiste-leniniste, vepronin me dy faqe. Nga njëra anë, gjoja u jepnin shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi të gjitha «të drejtat», dhe, nga ana tjetër, realizonin planin e serbomëdhenjve që konsistonte në zbatimin e gjenocidit kundër shqiptarëve. Ata filluan sistematikisht vrasjet, burgosjet e internimet e shqiptarëve në Goli Otok e gjetskë, si edhe shpërnguljen e tyre në masë për në Turqi.

Plani i serbomëdhenjve ishte që këtë etni shqiptare ta likuidonin, pse qëndronte si pykë në mbretërinë e tyre serbokroate. Dhe titistët, që ndiqnin po këto qëllime, për interesat e tyre shovinistë, këtë etni shqiptare, të lidhur ngushtë nga gjaku, nga traditat dhe nga gjuha, e ndanë në mes. Me një pjesë krijuan një krahinë gjoja autonome të Kosovës, kurse pjesën tjetër ia dhanë Maqedonisë për të krijuar kështu gjoja një shtet maqedonas. Me këtë ndarje titistët ndiqnin dy qëllime: e para, të dobësonin forcën e unitetit dhe të patriotizmit të shqiptarëve dhe rivendikimet e tyre ligjore për më shumë të drejta brenda Federatës, dhe, e dyta, për të

krijuar një shtet hibrid me shqiptarë, maqedonas dhe turq, gjoja si një pjesë e pandarë e Federatës Jugosllave, por, në fakt, për të neutralizuar tendencat probullgare të maqedonasve.

Krçerët e Beogradit, duke i ndarë shqiptarët dhe duke ndjekur politikën grabitqare imperialiste të krallëve serbë, shpresonin që më vonë të bënin, siç po bëjnë, rivendikime tokësore në drejtim të Maqedonisë së Egjeut deri në Selanik dhe të Maqedonisë Pirine dhe kështu të zmadhonin Republikën Federative të Jugosllavisë në kurrizin e të tjerëve. Pra, tërë plani i titistëve ishte që Shqipërinë ta gllabëronin plotësisht në Republikën Federative të Jugosllavisë. Në të njëjtën kohë ata kishin rivendikime edhe ndaj Greqisë, në Maqedoninë e Egjeut, kishin rivendikime edhe ndaj Bullgarisë, bile synonin të kalonin edhe më tej deri në Trieste dhe në Istria në kufirin me Italinë.

Të tilla ishin synimet ekspansioniste dhe imperialiste të këtij shteti pseudosocialist jugosllav. Këto ne i kuptuam që kur filloi prishja jonë me Jugosllavinë, që kur pamë se pikëpamjet e Titos dhe të shokëve të tij ishin pikëpamje shoviniste, fashiste.

Qëndrimi ynë në këto situata jo vetëm ka qenë i drejtë, pse e demaskuam këtë bandë renegatësh, por morëm haptazi në mbrojtje edhe vëllezërit tanë shqiptarë që jetonin në Jugosllavi. Ne ngritëm fuqimisht zërin tonë kundër persekutimit, kundër gjenocidit, kërkuam që shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi të kishin shkollat e tyre, të kishin të drejtë të ruanin zakonet, këngët, kulturën shqiptare dhe unitetin e tyre etnik. Këto të drejta ne i mbrojtëm politi-

kisht, pa bërë ndërhyrje të ndonjë lloji tjetër në këtë çështje. Pra, politikisht dhe në bazë të ideologjisë sonë marksiste-leniniste bëmë vetëm mbrojtjen e të drejtave të vëllezërve tanë të një gjaku. Dhe mund të themi me siguri se mbrojtja që u bëmë në vëllezërve tanë shqiptarë në Jugosllavi pati efektet e saj.

Ne pamë se Titoja, duke ndjekur një politikë aventurore, duke e hedhur poshtë maskën socialiste, duke e shndërruar Partinë Komuniste Jugosllave në Lidhje të Komunistëve të Jugosllavisë, me një fjalë në një parti pa kockë, hyri në luftë me Bashkimin Sovjetik dhe me ne. Nën pretekstin e frikës nga Bashkimi Sovjetik ai u mbështet plotësisht tek imperializmi amerikan dhe te kapitalizmi botëror, të cilët e ndihmuan Jugosllavinë fuqimisht dhe me të gjitha mjetet: ekonomike, ushtarake, politike dhe Titoja u bë kështu vasali i tyre. Në këto metamorfoza prej kameleoni që vareshin nga dëshirat e imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror, Titoja ra në kontradikta dhe në kundërshtime të ashpra me elementët ultrashovinistë, si me Rankoviçin, me Tempon dhe me shumë të tjerë si këta.

Në këto situata grupi i Tito-Kardelit, pasi likuidoi grupin e kryesuar nga Rankoviçi, likuidim në kuptimin që e shtyri atë në errësirë dhe jo me burgim dhe ndëshkim, atij i duhej të fuqizonte elementët e forcat antiserbe, pse vetë ishin prokroatë, prosllovenë. Një nga këto forca antiserbe ishin shqiptarët. Përveç asaj, duke u përpjekur që të fshihte krimet e bëra prej vetë Titos dhe prej Rankoviçit, si edhe për të gënjyer shqiptarët se me likuidimin e grupit të Rankoviçit po krijohej në

Jugosllavi «një situatë e ndryshme në krahasim me përpara», grupi i Tito-Kardelit filloi gjoja t'i përkëdhelte veçanërisht shqiptarët e Kosovës, duke lëshuar pak frerin e tmerrshëm, litarin që u kishte lidhur për fyti, gjeti disa bashkëpunëtorë shqiptarë, i vuri këta në krye dhe u detyrua të hapte edhe disa shkolla, të botonte edhe disa gazeta për popullsinë shqiptare, etj., etj.

E gjithë kjo ishte një politikë dinake, me të cilën ishim të bindur se nuk do të mund të gënjenin dot shqiptarët që janë përfshirë në shtetin jugosllav. Shqiptarët e dinin mirë se ishte pikërisht ky grup, me Titon në krye, duke pasur në krahun e vet qoftë Rankoviçin, qoftë xhelatë të tjerë si ky, që e kishin vrarë e burgosur, që i kishin rrëmbyer tokat dhe nderin popullsisë shqiptare. Prandaj politika false dhe demagogjike e Beogradit asgjë nuk mund të ndryshonte në ndjenjat e shqiptarëve. Kjo ishte qartë një politikë shoviniste. Ne vazhduam ta demaskonim me të madhe këtë politikë shoviniste. Në Kosovë e në viset shqiptare në Jugosllavi u rrit rezistenca për ruajtjen e kompaktësisë së shqiptarëve. Grupi i Titos, kundër vullnetit të tij, u detyrua të bënte disa lëshime. Vitet e fundit mundëm të vendosnim edhe kontakte tregtare dhe kulturore me Kosovën si një krahinë autonome.

Për sa u përket marrëdhënieve tona me shqiptarët që jetojnë në tokat e tyre në Mal të Zi dhe në Maqedoni, mund të themi se titistët i kishin ngritur barrierat dhe vazhdonin t'i mbanin ato të ngritura kundër nesh, kundër kontakteve tona me vëllezërit shqiptarë në këto dy republika. Veçanërisht shqiptarët e Malit të Zi nuk

kishin asnjë të drejtë as nga ato që gjoja fituan koso-
varët në bazë të kushtetutës. Deri në vitet e fundit në
Mal të Zi nuk kishte as shkolla për shqiptarët, kurse
në Maqedoni popullsia shqiptare kishte disa të drejta,
vetëm se rronte nën terrorin e egër të shovinistëve
maqedonas. Edhe aktualisht ekziston një ndryshim i
dukshëm në qëndrimin ndaj popullsisë shqiptare të
Kosovës dhe asaj të Dibrës, të Strugës, të Gostivarit,
të Tetovës etj., me një fjalë të të gjithë shqiptarëve në
Maqedoni. Këta të fundit jo vetëm persekutohen, por
edhe shpronësohen dhe në vendet e lëna bosh nga shqip-
tarët për shkak të këtyre shpronësimeve, sillen nga zona
e Egjeut elementë maqedonas. Për të realizuar këtë
politikë shpronësimi të shqiptarëve, autoritetet maqed-
donase financohen nga Beogradi, u jepen para maqed-
donasve që t'ua blejnë tokat shqiptarëve, u ndërtojnë
shtëpi dhe u krijojnë komoditete të veçanta, me qëllim
që të forcojnë, arbitrarisht e artificialisht në dëm të
shqiptarëve, pozitat e maqedonasve në mënyrë të alam-
bikuar në këtë republikë hibride dhe të krijuar në for-
mat, në mënyrat dhe në bazë të ideve imperialiste të
kohëve të kralëve serbë e malazez.

Jugosllavët e shohin se sa ditë që kalojnë, aq më
tepër po zgjohet popullsia shqiptare që banon në to-
kat e veta në Jugosllavi. Kjo popullsi shqiptare, sidomos
rinia që ruan traditat e vjetra të gjyshërve e të stër-
gjyshërve të saj, që ruan dashurinë e zjarrtë për mëmë-
dheun, për gjuhën e vet amtare, për të drejta të bara-
barta si komb, po zgjohet politikisht, po zgjohet ideolo-
gjikisht dhe shikon gjithnjë e më qartë greminën ku
po shkon Jugosllavia e ku kërkon t'i tërheqë edhe shqip-

tarët. Prandaj te shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi në forma të ndryshme rezistenca ka filluar të rritet, ashtu siç ka filluar të shtohet kundër tyre edhe shtrëngimi i litarit në fyt, siç kanë filluar të shtohen zinxhirët e Beogradit, presionet dhe kërcënimet e fashistëve jugosllavë dhe të veglave të tyre shqiptare që sundojnë në Kosovë.

Aktualisht është krijuar një situatë që pavarësisht nga lufta ideologjike, të cilën ne nuk e kemi shuar kurrë, në mes republikës sonë dhe Jugosllavisë janë vendosur marrëdhënie normale tregtare dhe kulturore, që janë në interesin e përbashkët. Për sa u përket marrëdhënieve kulturore, që kanë një rëndësi të madhe, ato po i zhvillojmë veçanërisht me popullsinë shqiptare të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi gjë që revizionistëve titistë nuk u intereson. Sigurisht zhvillimin e këtyre marrëdhënieve, plotësisht ata nuk mund ta pengojnë por nxjerrin gjithfarë pengesash, gjejnë mënyra dhe marifete që masat e gjera punonjëse të popullsisë shqiptare të mos bien në kontakt me kulturën e zhvilluar, me artin, me muzikën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Megjithatë ata janë të detyruar të pranojnë diçka dhe ne kemi dërguar në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi grupet tona teatrale, muzikore, ansamble popullore me valltarë etj. Përveç këtyre, me vetë kërkesën e autoriteteve shqiptare të Kosovës dhe me aprovimin e Beogradit që s'ka ç'bën, kemi disa vjet që dërgojmë vazhdimisht profesorë të Universitetit të Tiranës për të dhënë leksione në Universitetin e Prishtinës. Titistët janë të detyruar ta bëj-

në këtë lëshim nga vetë ekzistenca e një Shqipërie socialiste të fortë dhe nga zgjimi e nga forcimi i ndjenjave të unitetit të shqiptarëve, i ndjenjave të tyre patriotike, politike dhe ideologjike të shqiptarizmit, në Kosovë dhe në të gjitha viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Janë këto ndjenja që i detyrojnë autoritetet titiste që këto lidhje kulturore dhe artistike me vendin tonë të mos i pengojnë plotësisht.

Me efekt të madh janë edhe radioja e televizioni ynë, që dëgjohen e shikohen me etje të madhe nga të gjithë ata shqiptarë, në qytete bile edhe në fshatra që kanë radio e televizorë. Me gjithë mjetet moderne që përdorin jugosllavët, dhe ata përdorin mjete të shumta, për të penguar emisionet e televizionit dhe të radios sonë, nuk ia arrijnë dot plotësisht qëllimit të tyre. Kjo është tash një nga luftërat kryesore që po bëjmë dhe që do të vazhdojmë të bëjmë ne, luftë politike, luftë ideologjike, luftë kulturore për të mbajtur gjallë ndjenjat e patriotizmit dhe për të ndihmuar vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi që të zhvillohen në fushën e kulturës, të ruajnë ndjenjat e dashurisë së zjarrtë për atdheun. . .

Ne, në pozitat aktuale të Ballkanit, e veçanërisht të Jugosllavisë, duhet të jemi shumë vigjilentë e të zgjuar dhe asnjëherë të mos kemi besim në asnjë buzëqeshje false të revizionistëve jugosllavë. Nuk duhet të kemi besim tek ata për arsye se vazhdimisht kanë dashur dhe duan shkatërrimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duan dobësimin dhe likuidimin e entitetit të madh shqiptar në Jugosllavi, duan, gjithashtu, që Republika Popullore Socialiste e Shqi-

përisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë të shkatërrohen. Ata duan pra, dhe për këtë edhe kanë punuar e punojnë, që të shkatërrohet shteti i diktaturës së proletariatit në Shqipëri dhe Shqipëria të bëhet preja e imperialistëve të rinj, në mes të të cilëve janë edhe vetë revizionistët shovinistë jugosllavë. Ata, në mënyrë të fshehtë por shumë herë edhe të hapët, përpiqen që të përsëritet, në një shkallë akoma edhe më të madhe, historia e Traktatit të Paqes së Shën-Stefanit dhe e Kongresit të Berlinit. Por këtë herë do të jetë jo vetëm e vështirë, por e pamundur që ata të realizojnë planet e tyre të urryera për të copëtuar Shqipërinë. Sot Shqipëria nuk është më ajo e kohëve të kaluara. Sot ata kanë përballë një shtet të diktaturës së proletariaut, të forcuar ekonomikisht, politikisht, ideologjikisht dhe ushtarakisht, pra një shtet të pathyeshëm e të pakapërcyeshëm. Përveç kësaj, politika e drejtë e Partisë dhe e shtetit tonë socialist ka krijuar një situatë shumë të favorshme në masat e gjera përparimtare të të gjithë botës dhe Shqipëria e shqiptarët nuk gjenden më në ato pozita që u ndodhën në kohën e luftës turko-greke që çoi në Traktatin e Paqes së Shën-Stefanit dhe në Kongresin e Berlinit. Situatat sot kanë ndryshuar dhe janë në favorin tonë, megjithëse ambiciet dhe qëllimet grabitqare e likuidatore të fqinjëve tanë dhe të fuqive të mëdha ndaj Shqipërisë nuk kanë ndryshuar. Kanë ndryshuar vetëm mënyrat dhe metodat e realizimit të kompleteve të tyre, prandaj këto mënyra dhe këto metoda ne duhet vazhdimisht t'i ndjekim, t'i njohim dhe në kohën e duhur të marrim masa që t'i demaskojmë dhe t'i shkatërrojmë deri në fund.

Aktualisht revizionistët kinezë janë në unitet të plotë me ata jugosllavë, për arsye se si jugosllavët, edhe kinezët, kanë një padron, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitalin botëror. Të dy këto shtete aktualisht paraqiten sikur janë kundër Bashkimit Sovjetik imperialist. Por në lodrën e imperializmit ndërkombëtar dhe kapitalizmit botëror, me atë amerikan në krye, çështja shqiptare është në rendin e ditës të këtyre dy miqve të rinj revizionistë, që deri dje shaheshin e griheshin me njëri-tjetrin, por tash janë bashkuar dhe sidomos janë bashkuar në qëllimet e tyre komplotuese kundër vendit tonë, Shqipërisë. Armiqtë kapitalistë e revizionistë nuk mund ta honepsin që Shqipëria të jetojë e lirë, e pavarur, sovrane, nën një pushtet të diktaturës së proletariatit dhe e udhëhequr nga një Parti marksiste-leniniste.

Prandaj Kina, nga ana e saj ka filluar të ndërmarrë masa për bllokadë ekonomike dhe politike ndaj Shqipërisë socialiste. Jugosllavët, nga ana e tyre, u lejojnë sovjetikëve të bëjnë edhe ata investime në Kosovë, siç lejojnë edhe firma amerikane, franceze, gjermane e të tjera që të investojnë atje me miliona dollarë. Revizionistët jugosllavë përpiqen të futin te populli shqiptar që jeton në tokat e veta në Jugosllavi degjenerimin përrëndimor, të përhapin ryshfetin, amoralitetin etj. Në këtë çështje titistët do të ndihmohen edhe nga kinezët, të cilët e filluan këtë punë që kur dërguan në Jugosllavi «të deleguarin» e tyre Sajfudinin, që, siç e dimë, durtrokiti politikën nacionale të renegatit Tito duke thënë se «Çështja nacionale në Jugosllavi është zgjidhur më së miri, në rrugën marksiste-leniniste».

As Jugosllavia e Titos, as Bashkimi Sovjetik i Brezhnjevitet dhe i Hrushovit, as Kina e Mao Ce Dunit, e Çu En Lait dhe e Ten Hsiao Pinit nuk e kanë zgjidhur çështjen nacionale. Pas vdekjes së Stalinit në Bashkimin Sovjetik dominojnë rusomëdhenjtë; në Kinë dominojnë hanët; në Jugosllavi dominojnë serbomëdhenjtë e kështu me radhë. Prandaj Kina dhe Jugosllavia punojnë jo vetëm legalisht në këtë drejtim, por edhe ilegalisht. Për këtë arsye ne duhet të jemi shumë vigjilentë në këtë çështje. Propaganda jonë duhet të jetë intensive në drejtim të të gjithë botës për të vënë në dukje vijën e drejtë të Partisë dhe të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit, për të vënë në dukje fitoret e arritura në fushën e kulturës e në çdo fushë tjetër, zhvillimin socialist të vendit tonë, por sidomos të bëjmë që realiteti ynë të reflektojë dhe të futet thellë në zemrat dhe në mendjen e vëllezërve tanë shqiptarë në Jugosllavi. Të mos lëmë, gjithashtu, që ata të merren nëpër këmbë politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht nga serbomëdhenjtë, rusët, bullgarët, kinezët dhe amerikanët.

Ne duhet të parashikojmë se, pas vdekjes së Titos, në Jugosllavi do të lindin e do të zhvillohen probleme kapitale. Përse? Sepse Jugosllavia është një burg popujsh. Klikat revizioniste jugosllave duan dhe do të përpiqen ta ruajnë unitetin aktual të Federatës, por çështja do të shtrohet se nën drejtimin e kujt do të jetë kjo Federatë, nën drejtimin e serbëve, apo të kroatëve. Për sa u përket elementëve shovinistë brenda vendit, këta janë dy forca në rivalitet me njëra-tjetrën, pse janë forca kapitaliste, fashiste, që edhe ato duan

të ruhet Federata dhe politika grabitqare e carëve serbë dhe e borgjezisë kroate. Por, edhe për këta, çështja shtrohet se kush do të dominojë, serbët apo kroatët. Këta do të përpiqen të përdorin si vegla të tyre të tjerët. Kroacia mund të bashkohet me Slloveninë, mundet edhe me Bosnjë-Hercegovinën, e cila do të jetë një qendër e diskutueshme në mes tyre dhe serbëve. Mali i Zi mund të bashkohet ose të mbajë anën e Serbisë, kurse serbët do të përpiqen të vënë nën zgjedhje e nën kërbaç shqiptarët e Kosovës. Edhe Maqedonia ka, po ashtu, mundësi të bëhet ose një vegël e serbëve, ose të bëhet preja e Bullgarisë së madhe e nxitur nga sovjetikët.

Pas vdekjes së Titos, këto situata të brendshme në Jugosllavi, do të shfaqen, por çfarë shfaqjesh, në ç'forma dhe me ç'intensitet do të jenë, për këtë duhet të jemi vigjilentë dhe jo vetëm për të ndjekur rrjedhën e tyre, por sidomos pasojat e tyre. Këto pasoja ne duhet t'i parashikojmë, pse tendencat e ndryshme rivale brenda Jugosllavisë që të fitojnë mbi njëra-tjetrën do të mbështeten patjetër në forcat e jashtme si imperiaлизmi amerikan dhe NATO-ja, ashtu dhe Bashkimi Sovjetik e Traktati i Varshavës, që veprojnë intensivisht që tani. Për të dyja palët Jugosllavia paraqet interes shumë të madh, strategjik dhe ekonomik, pse në këtë vend janë investuar kapitale të mëdha, qoftë nga ana e imperializmit amerikan dhe e kapitalizmit botëror perëndimor, qoftë nga ana e kapitalizmit rus. Kështu që secila nga këto grupe kapitalistësh do të kërkojë t'i ruajë dhe t'i forcojë pozitat që ka fituar në këtë vend.

Imperializmi rus në planet e tij grabitqare kurdo-

herë ka synuar të dalë në Mesdhe e në Adriatik. Mesdheu ka qenë ëndrra e carizmit sipas së cilës Stambolli duhej të ishte i Ruisë, domethënë Dardanelet dhe Bosfori, Marmaraja, tërë Thesalia dhe Thraka. Po kështu Perandoria Serbe duhej të ishte ajo perandori e sllavëve të Jugut që tok me Rusinë të pushtonin gjithë Ballkanin dhe t'u qëndronin përballë fuqive perëndimore.

Edhe tani synimi i revizionistëve sovjetikë është që të dalin në Ballkan. Por dalja e tyre në Ballkan ndesh në vështirësi, për arsye se NATO-ja, imperializmi amerikan dhe satelitët e tij duhet të nënshkruajnë vdekjen e vet, në rast se lejojnë, në mënyrë paqësore ose me ndonjë sulm ushtarak, që Jugosllavia të futet nën suazën e perandorisë cariste, e perandorisë së ruse. Në këto situata vendi ynë vihet në rrezik sulmi si nga njëra palë, ashtu edhe nga tjetra, dhe jo vetëm një herë veças nga njëra palë dhe pastaj nga tjetra, por edhe nga të dyja palët së bashku. Në qoftë se përpara katastrofës që mund të shkaktojë Bashkimi Sovjetik, duke pushtuar me sulm Jugosllavinë, imperializmi amerikan lidh duart, ne do të gjendemi përballë armikut imperialist rus, të cilin duhet ta përballojmë dhe do ta përballojmë me forcat tona të unifikuara edhe me ato të vëllezërve tanë shqiptarë që jetojnë në Kosovë, në Mal të Zi e në Maqedoni. Ne sigurisht do të kemi në këtë rast edhe ndihmën e asaj pjese të popujve luftëtarë jugosllavë që nuk do të pranojnë robërinë e rusëve, domethënë ndihmën e partizanëve jugosllavë. Në rast të një lufte në mes Ruisë brezhneviane dhe Jugosllavisë, me Titon ose pa Titon, unë mendoj se do të ketë me mijëra e mijëra jugosllavë që do

të luftojnë. Kjo do të jetë një forcë që do të vihet në aleancë me ne për të rezistuar kundër pushtimit rusomadh. Në qoftë se Bashkimi Sovjetik do të futet në Jugosllavi me mënyra të tjera, domethënë duke ushtruar influencën e tij, nëpërmjet forcave të brendshme, pra jo me anë të luftës, atëherë metamorfoza që do të ngjasë do të jetë më e ngadalshme. Këtë metamorfozë në Jugosllavi ne duhet ta ndjekim, sepse do të ketë rreziqe të mëdha jo vetëm për pavarësinë dhe për sovranitetin e vendit tonë, por do të ketë pasoja të rënda edhe për vëllezërit tanë në Jugosllavi.

Pra, infiltrimi paqësor i imperializmit rus dhe vendosja e influencës së tij në Jugosllavi, që do të jetë një influencë robëruese për popujt e Jugosllavisë, do të krijojë një moment special jo vetëm sepse do të nxitë shovinizmin serb, që ka shtypur, vazhdon të shtypë e do të shtypë vëllezërit tanë kosovarë dhe shqiptarët që rrojnë në viset e tjera shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi, por do të bëhet një kërcënim serioz edhe për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Prandaj të gjitha këto ngjarje që mund të ngjasin, ne duhet t'i parashikojmë që tash dhe që tash të jemi të përgatitur. Për të përballuar këto ngjarje si brenda dhe jashtë, ne duhet ta sqarojmë opinionin në favorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në favorin e revolucionit, sepse një përgatitje e tillë përbën një barrikadë të fuqishme kundër lakmive të fqinjëve shovinistë dhe imperialistëve, që qëndrojnë prapa krahëve të tyre.

Mësimi i madh i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, patriotizmi dhe zgjuarsia e udhëheqësve të saj, e prin-

dërve dhe e gjyshërve tanë, nuk do të shkojë kot. Shqipëria nuk do të gjendet kurrë më në ato pozita që u gjendën gjyshërit tanë. Megjithatë, edhe pse ishin në pozita të vështira e të rënda, ata luftuan me guxim e me vetëmohim për mbrojtjen e tërësisë së truallit e të kombit shqiptar, kundër cungimit të kufijve të Shqipërisë. Sot ne nxjerrim mësimë jashtëzakonisht të vlefshme nga lufta, nga vuajtjet, nga përpjekjet, nga zgjuarsia e tyre, nga organizimi i tyre për luftë, nga sinkronizimi i përpjekjeve të tyre në një front të përbashkët, në një luftë frontale për të përballuar situata të ndërlikuara, vështirësi të mëdha dhe armiq të fortë. Edhe kundër nesh armiqtë do të jenë të shumtë, do të jenë dinakë, do të jenë më të armatosur, por aktualisht ekziston një Shqipëri e lirë, një Shqipëri e pavarur dhe sovraane, ekziston diktatura e proletariatit, ekziston një Parti marksiste-leniniste e çeliktë, që, në unitet me popullin, ecën përpara dhe mund e do t'i rezistojë çdo orvatjeje, çdo komploti e çdo sulmi nga ana e armiqve dhe do të dalë fitimtare kundër tyre.

Këtë situatë, këto mendime, këto pikëpamje, këtë pjekuri të Partisë sonë, ne duhet ta bëjmë mish e gjak të mbarë popullit tonë, që nga më i madhi dhe deri te më i vogli; duhet t'ua bëjmë të njohur, gjithashtu, edhe vëllezërve tanë shqiptarë në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni dhe të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë në botë. Përveç këtyre, këtë politikë të drejtë, këto pikëpamje të drejta e të qarta ne duhet t'ua bëjmë po ashtu të qarta të gjithë miqve tanë të panumërt që kemi në të gjitha kontinentet e botës.

Politika dhe qëndrimet tona ndaj vëllezërve shqip-

tarë në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi duhet të jenë vëllazërore e të matura dhe të mos mendojmë se këto çështje të mëdha politike, ideologjike dhe etnike i kuptojnë njësoj të gjithë vëllezërit tanë në Jugosllavi. Duhet të kemi parasysh, në radhë të parë, se ata rrojnë atje nën shtypjen e regjimit titist, se në të kaluarën kanë vuajtur të zita e ullirit, kanë provuar gjenocidin në kurrizin e tyre, kanë qenë të detyruar të shpërnguleshin në Turqi dhe të flinin në hajartet e xhamive. Tash mijëra prej tyre po bredhin rrugëve të Evropës, ku bëjnë punë nga më të rëndat nëpër fabrikat e kapitalistëve për të nxjerrë një krodhë bukë. Shumë prej tyre që janë pa punë, kthehen përsëri në Jugosllavi ku jetojnë në mjerim të madh.

Zhvillimi dhe zgjimi i tyre politik dhe kulturor me gjithë arritjet e deritanishme është akoma prapa. Prandaj ne, shqiptarët e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duhet të kemi durim me ta dhe të mos i gyykojmë vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi me atë masë që gyykojmë mendimet, veprimet dhe sjelljet e njerëzve tanë në Shqipëri. Populli shqiptar që jeton në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë është shumë përpara. Ai ka avancuar në çdo pikëpamje. Tek ai është rrënjësuar thellë ideja e unitetit dhe e besimit ndaj Partisë së tij të lavdishme të Punës. Populli shqiptar luftoi e derdhi gjak për lirinë që gëzon sot, derdhi djersën për jetën e lumtur që gëzon sot, kurse vëllezërit tanë të Kosovës është e vërtetë se kanë luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë, por mbi ta ekziston kërbaci shovinist sllav. Burgjet, qoftë në Kosovë, qoftë në Serbi janë plot me shqiptarë, kundër të cilëve, sipas

lajmeve të gazetave të huaja, përdoren torturat. Është për këto arsye që në këto burgje ka revolta. Por revolta më e madhe ekziston në gjirin e popullit kosovar dhe të shqiptarëve në Mal të Zi ose në Maqedoni. Rinia e sotme e kësaj popullsie shqiptare në këto vise e ka të theksuar ndjenjën e demokracisë së vërtetë, që do të thotë urrejtje kundër pseudodemokracisë shoviniste serbomadhe. Studentët me kombësi shqiptare në Universitetin e Prishtinës dhe në përgjithësi gjithë rinia dhe nxënësit shqiptarë, kudo ku janë në Jugosllavi, qofshin në shkolla, qofshin në punë, ushqejnë dashuri të zjarrtë për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, e manifestojnë këtë dashuri dhe rezistojnë kundër masave shtypëse të autoriteleve serbe dhe të shërbëtorëve të tyre shqiptarë në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Serbët, ashtu si përpara në kohën e mbretërisë së Karagjorgjeviçëve, edhe tash nën regjimin e Titos nxitin në popullsinë shqiptare fënë myslimane, përpiqen për të gjetur libra, gazeta e broshura fetare që t'i shpërndajnë në Kosovë e në Maqedoni. Me këtë rrugë ata duan të shuajnë ndjenjat patriotike të kosovarët dhe tek të gjithë shqiptarët në Jugosllavi. Shovinizmi serb i ka dhënë një rëndësi të madhe zhvillimit të ndjenjave fetare të shqiptarët. Për këtë qëllim janë hapur mejtepet dhe nxiten fëmijët e vegjël të venë të mësojnë elifbenë, të venë nëpër xhami etj. Po ashtu shovinizmi serb për të shpartalluar unitetin e shqiptarëve në Jugosllavi përdor edhe mjete të tjera si vëllavrasjen për hakmarrje, e cila nxitet me qëllim për të përçarë shqiptarët.

Këto janë probleme që ekzistojnë te vëllezërit tanë shqiptarë në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Këto janë probleme me të vërtetë shqetësuese që shqiptarët duhet t'i luftojnë si të këqija që i nxit armiku i përhershëm, shovinizmi serb.

Natyrisht ne duhet të kuptojmë se një rol të rëndësishëm do të luajë këtu brezi i ri i shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Por edhe brezi i vjetër duhet të bëjë atje përpjekje të mëdha që bijtë dhe bijat e tij t'i mësojë që të ecin në rrugën e shqiptarisë, në rrugën e nderit, të mësojnë në shkolla, qofshin këto të hapura edhe nga Jugosllavia, por me ndjenjën e tyre të patriotizmit të dinë t'i spastrojnë nga mësimet, sidomos nga politika agresive dhe shfarosëse që zbaton klika e Beogradit ndaj shqiptarëve, tendencat antishqiptare, të dinë të ndajnë grurin nga egjri, të ndajnë të mirën nga e liga, ta shkelmojnë të ligën dhe të pajisen me virtytet e mira të kombit tonë.

Në këtë përkrahje që ne duhet t'u japim vëllezërve dhe motrave tona shqiptare në Jugosllavi, të kemi parasysh që të jemi të durueshëm, t'i shohim çështjet ashtu siç janë, të vështira, për vëllezërit dhe për motrat tona të matanëkufirit, por të vështira dhe të zorshme edhe për anën tonë, sepse ekziston një kufi, ekzistojnë tela me gjemba që i pengojnë seriozisht përpjekjet tona të shëndosha për të forcuar marrëdhëniet me ta. Prandaj duhen gjetur mënyrat, format, mjetet dhe të kihet shumë durim. Vetë kosovarët, vetë dibranët, gostivarasit, telovarët e të tjerë, vetë shqiptarët në Mal të Zi ta ndiejnë nevojën e edukimit patriotik dhe të gjejnë mjetet, mënyrat dhe format se si ta mbajnë gjallë, ta

shumëzojnë dhe ta kalitin këtë sa më drejt. Ata vetë, duke u bazuar në atë pseudokushtetutë jugosllave, të mbrojnë e të kërkojnë që t'u plotësohen të drejtat që u takojnë, sepse, siç ka vërtetuar jeta, udhëheqja titiste edhe ligjet i shkel, kur vjen çështja për të drejtat e shqiptarëve.

Në popull ka një fjalë të urtë që thotë: «Ndhimmo më parë veten, që të të ndihmojë zoti» që është kundër shprehjes: «Ndhimomë, o zot!». Këtë shprehje e këtë thirrje pesimiste e ka lëshuar një person që natyrisht nuk e kishte të qartë nga ana filozofike çështjen e forcës së vetvetes dhe në një moment mjerimi. Por, shoku që kishte afër, që pa dyshim do të ketë qenë njeri përparimtar, që kuptonte kotësinë e besimeve fetare, iu përgjigj zjarr për zjarr, atë që thashë: «Ndhimmo më parë veten, pastaj të të ndihmojë zoti». Prandaj edhe kosovarët dhe gjithë shqiptarët në Jugosllavi kështu duhet ta kuptojnë këtë çështje. Shqipëria, Republika jonë Popullore Socialiste, i përkrah dhe do t'i përkrahë kurdoherë vëllezërit tanë të përtejkuqirit për të drejtat e tyre të ligjshme. Kjo përkrahje nuk u ka munguar dhe nuk do t'u mungojë kurrë vëllezërve dhe motrave shqiptare në Jugosllavi, por, në radhë të parë, ata, vetë me forcat e tyre, duhet të ngrenë lart ndërgjegjen, të ngrihen politikisht dhe ideologjikisht për momentet oportune që do të sjellë rrjedha e historisë, pse kjo rrjedhë do të marrë vazhdimisht në të ardhmen rrugën e materializmit dialektik dhe do të fshijë, do të spastrojë e do të rrëzojë përtokë gjithë kalbësirën e shoqërisë së vjetër borgjezo-kapitaliste titiste që sundon në Jugosllavi dhe në të gjithë botën.

Kaloi ajo kohë që Fuqitë e Mëdha dhe serbomëdhenjtë, malazcztë, ustashët e revizionistët sovjetikë mund të luanin me fatet e popullit tonë, mund të preknin si të donin dhe të ndanin në mes tyre tokat e Shqipërisë. Jo, ajo kohë nuk do të vijë kurrë më.

Kohë të tjera më të bukura do të vijnë për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, por kohë të bukura do të vijnë edhe për vëllezërit tanë që jetojnë në trojet e tyre shekullore...

*Marrë, me ndonjë shkurtim,
nga libri: Enver Hoxha «Ditar
për çështje ndërkombëtare»
(botim i brendshëm), nr. 10,
f. 524*

PËR ZHVILLIMIN E SHKENCËS DHE PËRGATITJEN E KUADRIT LLOGARITË T'I BËJMË MIRË DHE ME KOHË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve
të KQ të PPSH*

15 qershor 1978

Në të gjithë vendin tonë u ndie kudo puna për festimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të kësaj ngjarjeje të shënuar në historinë e popullit shqiptar. Për sa i përket konferencës¹, edhe unë jam i një mendimi me ju që kjo pati sukses të madh dhe e ngriti në një shkallë më të lartë emrin e Shqipërisë, të të parëve tanë. Punonjësit tanë të historisë kanë zhvilluar një punë të mirë e të lavdërueshme, që e bëri këtë ngjarje akoma më të qartë për mbarë popullin tonë këtu e në Kosovë dhe për dijetarët e huaj. Ne të gjithë pamë interesimin e madh të popullit për këtë konferencë, në materialet e së cilës ai shikon të pasqyruara jelën e vet, përpjekjet e veta. Në përgjithë-

1. Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, që u hap në Tiranë më 12 qershor 1978.

si studiuesit kanë punuar mirë, ata janë interesuar, kanë konkretizuar mjaft probleme, kanë nxjerrë konkluzione të drejta, natyrisht kush i ka bërë më të gjalla e më bindëse, kush jo, por kjo varet edhe nga niveli kulturor e shkencor i secilit studiues.

Një e metë, më duket mua, e studimeve që iu paraqitën konferencës, ishte se ato duhej të mbështeteshin më shumë në studimet e Marksit e të Engelsit për Çështjen e Lindjes. Të dy këta mësues të mëdhenj e kanë trajtuar këtë problem në të gjitha aspektet. Natyrisht, analizat që kanë bërë ata rreth këtij problemi janë të thella. Në disa shkrime Marksit, me sa më kujtohet, zë në gojë edhe Shqipërinë. Prandaj do t'i shikoj edhe një herë vëllimet e tij për këtë çështje. Sidoqoftë, kryesorja në to nuk është çështja e Shqipërisë, por Çështja e Lindjes, ku përplaseshin interesat e imperialistëve të ndryshëm, që luanin me hartat e vendeve dhe me aspiratat e popujve.

Unë nuk i dëgjova referatat e tjera, por ai që mbajti Aleks Buda më duket se mbështetej në analizat e Marksit e të Engelsit për Çështjen e Lindjes. Natyrisht, në referat Aleksit do të përqendrohej në problemet tona, se nuk e studiojmë Çështjen e Lindjes, të krizës lindore të viteve 70-të të shekullit të 19-të, si një qëllim më vete, por e shikojmë në raport me Shqipërinë. Kur lexon korrespondencën e Marksit me Engelsin, njihesh me të gjitha çështjet politike dhe ideologjike të asaj kohe, njihesh me çështjet strategjike dhe taktike të luftës etj., të cilat veçanërisht Engelsi i njihte aq mirë, sa që Marksit e quante «gjeneral». Pikërisht në studimet e Marksit dhe të Engelsit ne do të gjenim një mbësh-

tetje teorike materialiste për të kuptuar në mënyrë racionale pikëpamjet e udhëheqësve të kësaj veprimtarie të madhe luftarako-politike, shtetërore etj., siç është Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Mbështetja te studimet e tyre, mendoj unë, do të shpërndante mjegullën e përhapur rreth pikëpamjeve të udhëheqësve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga disa teori mistike, idealiste etj. Këta udhëheqës të shquar të lëvizjes sonë kombëtare vërtet kanë qenë idealistë, por ç'idealiste kanë qenë? Kanë qenë romantikë, po ç'romantikë kanë qenë? Kanë qenë fetarë, po ç'fetarë kanë qenë? Si u bë e mundur që ata e bashkuan gjithë popullin dhe kaluan në një platformë tjetër? Të gjitha këtyre pyetjeve u duhet dhënë përgjigjja nga historianët tanë, duke i shpjeguar mirë e në mënyrë bindëse për çështjet që ngrihen në to.

Ne duhet t'i orientojmë historianët tanë që evenimentet, qofshin ato para Marksit, qofshin pas Marksit, i cili ka krijuar e konkretizuar teorinë e materializmit dialektik e historik, duke analizuar epokat dhe lëvizjet revolucionare të popujve në momente të ndryshme, t'i marrim të lidhura, jo të shkëputura. Edhe përpara Marksit ka pasur mendime të përparuara racionale gjysmë-materialiste, çerekmaterialiste, pozitiviste, idealiste etj., por sidoqoftë mendimi filozofik ka pasur një përparim. Kështu që shikimi i problemeve në këtë rrjedhë ka rëndësi të madhe.

Në mënyrë të veçantë historianët tanë duhet të mbajnë kurdoherë parasysh dhe të mos i trajtojnë asnjëherë problemet të shkëputura nga analizat që kanë bërë Marksi dhe Engelsi. Ata jo vetëm duhet të mbë-

shteten në këto analiza, por edhe t'u referohen disa mendimeve të shprehura nga klasikët. Dhe referimi nuk është diçka formale, ai tregon se ku duhet të drejtohen shkencëtarët për të gjetur arsyetimin e drejtë për problemet e ndryshme që trajtojnë. Referatin e shokut Aleks e lexova edhe në shtëpi. Ishte një punë shumë e shëndoshë shkencore dhe bindëse ajo që kishte bërë. Ai, në bazë të analizës që i bëjnë Marksii dhe Engelsii këtij problemi, e shpjegonte mirë Çështjen e Lindjes, por mund t'u ishte referuar në punimin e tij edhe drejtpërdrejt filozofëve dhe dijetarëve tanë të mëdhenj.

Siç theksova edhe në fillim, historianët tanë e kanë trajtuar drejt dhe në mënyrë të gjithanshme Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, këtë ngjarje të madhe të popullit tonë. Jo vetëm referati kryesor, por edhe studimet e tjera që u paraqitën në këtë konferencë, kanë qenë, më duket, në lartësinë e duhur. Lexova edhe referatin e Arben Pulos, që trajtonte veprimtarinë e Lidhjes në fushën e diplomacisë së jashtme. Pashë edhe librin për Shpalljen e Pavarësisë sonë që botoi ky para pak kohësh. E lexova të gjithë. Lexova me shumë vëmendje një gjë që më interesonte: çfarë dokumentesh ka përdorur ai për çështjen e Beqir Grebenesë, domethënë për të ashtuquajturin komplot të këtij dhe për idenë e Qeverisë së Vlorës për një aleancë me Bullgarinë dhe me xhonturqit, gjë që disa e kanë konsideruar si një veprim jo të drejtë të Ismail Qemalit. Kur kam shkruar për këtë problem, kam vënë në dukje se ajo ide nuk ka qenë e gabuar për situatat që i ishin krijuar Qeverisë së Vlorës në atë kohë.

Në këtë libër del qartë se «komploti» i Beqir Gre-

benesë është një çështje e paqenë. Ai është paraqitur si i tillë nga Austro-Hungaria e të tjerë, sepse prishte planet e tyre. Beqir Grebeneja, në fakt, mori kontakt me Ismail Qemalin dhe bisedimet e tyre diktoheshin nga interesi i përbashkët që i impononin rrethanat historike vendit, megjithëse për këtë nuk disponojmë dokumente të drejtpërdrejta. Por kuptohet se zhurma që bënë për këtë çështje gjithë Fuqitë e Mëdha, kishte për qëllim likuidimin e Qeverisë së Vlorës dhe zëvendësimin e saj me qeverinë e Princ Vedit.

Në përgjithësi, në këtë material janë shfrytëzuar dokumente të shumta për çështjen e pavarësisë shqiptare. Këto janë dokumente të kancelarive, të cilat duhet pranuar që nuk janë realiste në trajtimin e problemeve. Ja, po të shikonim, për shembull, se çfarë shkruan për ne ambasadori kinez në telegramet e tij ose ato që njofton ambasadori jugosllav, atëherë do të mendonin se «këtu, në Shqipëri po bëhen vrasje, mizorira» etj., etj. Pra, kancelaritë i trajtojnë problemet e politikës së një shteti tjetër dhe i interpretojnë faktet sipas qejfit të tyre. Po ka edhe raste kur dokumentet e tyre mund ta pasqyrojnë saktë gjendjen reale. Kështu, për shembull, në një moment, tek Austro-Hungaria u vu re një tendencë për mbrojtjen e Shqipërisë. Këtë ajo e bënte për interesat e saj, për ta pasur Shqipërinë një bazë të vetën për luftën që po përgatitej. Ky qëllim u duk qartë, sidomos, në qëndrimin e saj ndaj Qeverisë së Vlorës, të cilën në fillim e përkrahu, më vonë, kur Ismail Qemali nuk bëri lojën e Vjenës, kjo e mënjanoi, për të përgatitur truallin për ardhjen e Princ Vedit. Ishte e qartë përse Ismail Qemali nuk afrohej për

këtë plan. Ismail Qemali e kishte të zhvilluar sensin e një politikani të shquar dhe të një patrioti të vendosur, që kishte qeder të madh për të ardhmen e Shqipërisë. Në këto kushte Austro-Hungaria tërhoqi bile një Esat Toptan, duke e futur në qeverinë e Vidit.

Dokumentet e kancelarive duhen gjetur e duhen shfrytëzuar me kujdes. Ato kanë shumë vlerë kur trajtohen e kuptohen në dritën e marksizmit dhe të historisë sonë, të përpjekjeve tona reale, konkrete. Kur shkruhet për një problem të tillë, si ai i pavarësisë, nuk duhet bazuar as vetëm tek informatat e konsujve, as edhe vetëm te studimet e dijetarëve të ndryshëm, sepse edhe këta të fundit janë influencuar nga materialet ekzistuese. Në qoftë se një personalitet serb, siç ka qenë Tucoviq¹ ose ndonjë tjetër, ka folur «diçka pozitive» për Shqipërinë, këtë e ka bërë duke u nisur nga platforma e socialdemokracisë. Vepra e tij është ribotuar kaq herë. Tani atë e përdorin si një fasadë për t'u maskuar, por për ne nuk pi ujë një gjë e tillë, se kundër shqiptarëve jo vetëm kralët, por edhe titistët kanë bërë kërdira dhe këtë e di fare mirë opinioni bollëror.

Mirëpo, me kaq çështja nuk është shterur, prandaj nuk është e drejtë të mendohet që, meqenëse është trajtuar një herë problemi i diplomacisë së Fuqive të Mëdha në lidhje me Shqipërinë, pse të punojnë dhe ta trajtojnë edhe një, dy ose më shumë punonjës të tjerë të historisë. Jo, një gjë e tillë nuk duhet menduar. Duke

1. Dimitrije Tucoviq (1881-1914), autor i librit «Serbia e Shqipëria» (1914).

marrë dokumentet që përmenden në këtë libër ose duke gërmuar vetë, historiografë të tjerë do të gjejnë dokumente të tjera që i japin problemit interpretime më të gjera e më të thella.

E kam drejt këtë mendim, apo jo, shokë?

SHOKU HYSNI KAPO: Shumë drejt e keni, shoku Enver. Në këtë konferencë u mbajtën 4 kumtesa dhe 4 referate. Të gjitha këto prekin probleme të ndryshme. Kështu që historianët tanë tashti mund të merren me këto probleme, ashtu siç thoni ju. Studimit të tyre, si dhe problemeve të tjera të reja duhet t'u futen tani shumë njerëz.

SHOKU RAMIZ ALIA: Një gjë kisha unë, shoku Enver, lidhur me këtë ide shumë të drejtë që dhatë ju.

Sabri Godoja, në librin që shkroi për Ali pashë Tepelenën, vetëm sa e skiconte një personazh të tillë, siç është arkitekt Petro Korçari. Por, këto ditë, doli një libër i Dhimitër Shuteriqit¹. E lexova të tërë atë dhe vura re se, ndërsa Sabriu vetëm sa e skiconte këtë personazh, Dhimitri thellohej dhe ka mundësi që një i tretë apo i katërt të nxjerrë në dritë dokumente të tjera, të cilat mund ta japin akoma më të plotë figurën e këtij personazhi historik.

Këtu është fjala për një personazh, por, po ta trajtojmë këtë ngjarje të madhe historike, ashtu siç thoni ju, me siguri që do të shohim se ka shumë aspekte të veprimtarisë së Lidhjes që mund të trajtohen e të thellohen më tej.

1. Dh. S. Shuteriqi, «Petro Korçari, kryearkitekt i Ali pashë Tepelenës», Tiranë 1978.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, kështu është, ka aspckte të ngjarjeve e të problemeve që mund dhe duhet të thellohen. Nuk mjafton vetëm ajo që është thënë, për shembull, për arkitekt Sinanin. Të gjithë e njohin emrin e këtij arkitekti, por fjala është që për të të gërmosh dhe të studiosh akoma më shumë, me qëllim që të nxjerrësh të dhëna sa më të plota për jetën dhe punën e tij. Pra, cilat xhami ka bërë ky dhe çfarë veprash të tjera ka ndërtuar, përveç këtyre që njihen etj., etj.? Për këtë, ka libra që duhen marrë e lexuar që të kemi në dorë një material komplet për arkitekt Sinanin.

Nga leximi i një libri të ilustruar për Konstandinopolin, kam mësuar se ky inxhinier ka qenë me origjinë shqiptare, kurse një libër tjetër nuk e zë fare në gojë këtë fakt. Çështja këtu nuk është vetëm që të vërtetojmë nëse arkitekt Sinani ishte ose jo me origjinë shqiptare, megjithëse edhe kjo duhet bërë. Por, në radhë të parë, duhen gjetur fakte e dokumente për të treguar vlerën e madhe të punës së tij arkitekturore. Natyrisht, kjo gjë lidhet me të gjitha rrethanat, ku ka jetuar e ku ka studiuar ai që figura e tij të dalë siç ka qenë në realitet.

Për festimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u bë një punë e mirë, e cila duhet të shërbejë për pasurimin e mëtejshëm të historiografisë sonë. Natyrisht, në këtë rast nuk ishte fjala për një diçka thjesht për përgatitjen e një fjalimi që do të mbahej, për shembull, në një banket me rastin e përvjetorit të ndonjë ngjarjeje historike, që nuk do të ishte më shumë se dy apo tri faqe material, por për një punë të madhe

e të thellë, e cila të pasqyronte një histori të tërë të një periudhe kulminante. Për këtë arsye historianët tanë duhet të thellohen akoma më shumë në këto probleme, duke u larguar nga kuadratet dhe nga skemat.

Po të marrim dhe të lexojmë «Historinë e Shqipërisë», aktualisht, do të shohim se atje ka shumë skema. Ndonjëri mund të thotë: «Epo, ky tekst është dhe nuk mund të futen e të trajtohen në të në mënyrë të thelluar të gjitha problemet e historisë së Shqipërisë». Po këtu nuk është fjala për këtë, por te çështja e konceptimit të përgjithshëm të historisë së Shqipërisë, te deduksionet politike, ideologjike, organizative, ekonomike, luftarake, taktike e strategjike, që duhen nxjerrë në lidhje me ngjarjet historike. Kështu duhet bërë dhe kjo gjë arrihet duke u larguar në shumë momente nga skicimet e ngjarjeve dhe nga kronologjia.

Ja, të marrim një shembull, «Histoire de la Révolution française» të Mishlesë të shkruar në dy vëllime. Mund të shkruhet gjithë kjo histori në dy vëllime? Po, Mishleja e ka bërë këtë. Ai ka pasqyruar kronologjinë e ngjarjeve të këtij revolucionit dhe ka ditur, në të njëjtën kohë, pavarësisht nga pikëpamjet e tij idealiste, që evenimenteve kyç të revolucionit t'u japë me të vërtetë frymëzimin politik-ideologjik dhe aspektin ekonomik, pa e harruar as njërin dhe as tjetrën. Ose të marrim librin «Historia e revolucionit francez» të Zhoresit. Edhe ky, me dy vëllime, ka dhënë një tablo të revolucionit francez. Në këtë vepër ai trajton një aspekt tjetër të revolucionit, rolin e masave dhe anën sociale të të gjitha evenimenteve të tij. Kronologjinë Zhoresi nuk e harron, por ai nuk futet në të. Kurse Matiezi, që është

edhe ai një nga historianët më të mëdhenj të këtij revolucioni, sipas mendimit tim, nuk i ka karakteristikat e këtyre të dyve. Matiezi thellohet në rrënjët ekonomiko-shoqërore që shkaktuan revolucionin francez, ndonëse anën kronologjike të ngjarjeve ai e jep më në detaje se këta, në mënyrë më të hollësishme se Mishleja dhe Zhoresi.

Prandaj, unë mendoj se nuk ka vend të kënaqemi me këtë tekst të «Historisë së Shqipërisë», që është hartuar. Ky tekst ishte shumë i nevojshëm për ne, dhe është shkruar drejt, por historianët tanë duhet të thellohen në evenimentet kyç të historisë së vendit tonë. Se ja, po të lexosh në «Historinë e Shqipërisë» pjesën ku flitet për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, do të shikosh se aty jepet një tablo shumë e shkurtër për një epokë kaq të madhe si kjo. Dhe jo vetëm kaq, por kjo tablo nuk është as e saktë. Këtë e them duke pasur parasysh pikëpamjet që kanë ekzistuar lidhur me këtë ngjarje. Po të bazohemi në historiografinë e të tjerëve ose të disa historianëve shqiptarë që e kanë interpretuar atë, do të shohim që nuk është folur saktësisht për Lidhjen, për këtë organizatë politike me karakter militant revolucionar. Kjo është paraqitur si diçka e vogël, kurse tash kjo ngjarje e bazuar në shkencë, në dokumente, po na del diçka kolosale. Në qoftë se do të shprehesh në mënyrë figurative, do të thosha se ashtu si krehri, që kalon nëpër flokët fije më fije, kështu edhe kjo konferencë, duke u ndalur dhe duke analizuar një nga një aspektet e veprimtarisë së Lidhjes, e pasqyroi gjerësisht dhe në mënyrë të thellë këtë ngjarje me rëndësi të madhe në historinë e popullit shqiptar. Por, siç tha

Ramizi [Alia], kjo nuk do të thotë se i kemi gjetur fundin kësaj pune. Historianët dhe akademikët tanë të gjitha këtyre çështjeve duhet t'u futen në mënyrë monografike, në mënyrë të specializuar. Megjithëse është fakt që, në krahasim me atë që ishte bërë deri tash për këtë çështje, me këtë konferencë ne ecëm shumë, shumë më përpara, përsëri nuk duhet t'i vëmë kyçin kësaj pune. Po vepruam kështu, nuk do të kemi asnjë prodhim, asnjë studim shkencor të mëtejshëm rreth problemit që na intereson kaq shumë. Prandaj, problemi është kapur mirë, ta vazhdojmë, ta zgjerojmë, ta thellojmë e ta qartësojmë punën për këtë ngjarje të rëndësishme historike.

Në këtë konferencë pati edhe studiues të rinj të historisë nga radhët e shkencëtarëve tanë, që mbajlën kumtesa për disa probleme të veçanta. Natyrisht, në punimet e tyre këto probleme janë të trajtuara akoma në mënyrë rudimentare, në pesë apo në gjashtë faqe, megjithatë, sado rudimentare që të jetë, kjo punë i vlen çështjes sonë, sepse secili ka mendimet e tij rreth problemit, ai punon, kërkon, gërmon dhe gjen mbase më tepër dokumente sesa një historian i afirmuar, të cilave u jep interpretime të reja, të gjera dhe në këtë mënyrë pasurohet e plotësohet tërë materiali bazë. Pra, ka shumë rëndësi fakti që këta u janë futur çështjeve dhe ne duhet t'i orientojmë e t'i nxitim të punojnë për atë temë që kanë zgjedhur, e cila nuk ka mbarim.

Nuk mjafton që me një problem të merret vetëm një njeri. Një gjë e tillë të çon edhe në dogmatizëm dhe ne, si marksistë-leninistë, nuk dëshirojmë në asnjë mënyrë që mendimet tona historike, sociologjike e të tjera

të çoroditen. Marksizëm-leninizmi na mëson se duhet të thellohemi në studimin e problemeve dhe thellimi në çdo fushë, e veçanërisht në këtë fushë, është një pasurim i madh i shkencës dhe i historiografisë sonë.

Më parë ne nuk e kishim një mundësi të tillë, sepse nuk kishim kuadro të shumtë dhe të aftë, kurse tani po. Aktualisht kemi mjaft kuadro që zotërojnë dialektikën materialiste, marksizëm-leninizmin, njohin rëndësinë e materialeve që studiojnë, bëjnë interpretime, lidhin ngjarjet me njëra-tjetrën, gjë që nxit kërkimet dhe zhvillon mendimin e tyre. Te ne janë përgatitur shumë kuadro dhe në të ardhmen do të kemi edhe më shumë. Ne nuk nxjerrim kuadro për të thënë pastaj që ka organikë apo nuk ka organikë për ta. Çështja nuk duhet kuptuar kështu. Instituti i Historisë ka në organikë, fjala vjen, dhjetë veta, por ai mund të ketë edhe më shumë punonjës shkencorë. Planet për degët e ndryshme të universitetit nuk mund të hartohen në mënyrë simpliste, burokratike, se kjo nuk është vetëm çështje shifrash. Po kështu duhen parë me shumë seriozitet edhe organikat e institucioneve shkencore. Kërkohet, pra, nga Instituti i Historisë që të thellohet më tej në çështjet e historisë, por, kur vjen puna për të rishikuar organikën e këtij instituti, ngurrohet ose shtohet ajo vetëm me një punonjës. Mirëpo zgjidhet ky problem duke shtuar një njeri në organikë? Jo. Që problemeve të historisë t'u futemi thellë, në institut duhet të punojnë edhe më shumë njerëz. Por shtrohet çështja: Me se do t'i mbajmë këta? Me djersën e popullit do t'i mbajmë. Këtyre njerëzve do t'u caktojmë detyra, zbatimin e të cilave do ta kontrollojmë. Dhe të jemi të

sigurt se puna e tyre do të bëjë efekt në edukimin patriotik revolucionar të popullit. Çdo njeri, kur të njihet me studimet e tyre, do të thotë: Kjo pasuri shpirtërore kulturore e popullit tonë është aq e madhe, saqë e ndiej se duhet të punoj që ta kryej si duhet detyrën që më është ngarkuar. Ku? Atje ku është secili, duke realizuar dhe duke tejkaluar normat për të shpejtuar ndërtimin e socializmit, për ta bërë Shqipërinë të pamposhtur.

Para ca kohësh më shkruante letër një mjek, të cilit, me gjithë dëshirën e tij të madhe për të punuar, e kishin nxjerrë në pension. Unë iu përgjigja letrës, duke e vlerësuar lart punën e tij. Tash ai thotë se është gati të punojë edhe 30 vjet të tjerë në fushën e mjekësisë. Sikur është rilindur ai njeri që filloi të punojë përsëri! A duhet ta nxjerrim në pension shkencëtarin kur ai është në gjendje të mirë pune dhe duhet të punojë? Si është e mundur, të konceptohet nxjerrja në pension për një shkencëtar me kapacitet që është 55 apo 60 vjeç, i cili mund të rrojë e të punojë edhe shumë vjet të tjerë? Unë mendoj se puna e tij gjatë kësaj periudhe do të jetë akoma më e frytshme, si rezultat i përvojës së madhe, por edhe sepse ai do të punojë që t'i shtojë më shumë dituritë që ka, kurse, duke vepruar në këtë mënyrë, ne e pengojmë atë të ushtrojë profesionin, sepse, edhe po të vazhdojë ta ushtrojë këtë, do të thonë që është bërë spekulant, merret me punë private. Jua përmenda këtë rast, shokë, për të theksuar se një kuptim i tillë i ngushtë i problemeve shkencore është shumë i dëmshëm, pra edhe i dënueshëm.

Ka disa njerëz që thonë se nuk na duhen më fizikanët, nuk na duhen arkitektët, pianistët e të tjerë e të

tjerë, sepse «nuk kemi vende në organika», konsiderohen si quadro joprodhues. Po si është e mundur, si është e mundur të mos vlerësohet puna e tyre? Ata nuk prodhojnë direkt, por puna e tyre ka vlerë të madhe për zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit, me synim të afërt dhe të largët. Njerëzit që mendojnë se nuk na duhen më fizikanët, arkitektët, pianistët, janë dritëshkurtër, kanë parasysh vetëm një skemë të ngushtë të pamjes së zhvillimit shoqëror, kulturor, arsimor e ekonomik të vendit tonë. Fejzi Alizoti, po, ai mendonte në këtë mënyrë, pse ishte një element obskurantist dhe antipopullor. Mirëpo pas Çlirimit situatat në vendin tonë ndryshuan si nata me ditën.

Më kujtohet si sot diskutimi që u bë për hapjen e institutit të kulturës fizike «Vojo Kushi»¹. Shumë mendime jepnin atëherë për këtë, ta ngremë, apo të mos e ngremë, sikur ne kishim plot institute të tilla në vendin tonë! Një institut i lartë fizikulture është për ne më se i nevojshëm, përderisa shtrojmë detyrën që i gjithë populli duhet të stërvitet fizikisht. Mirëpo, pa pasur instruktorë, mësues për këtë degë, kjo detyrë nuk mund të realizohej dhe fëmijët tanë do të mbeteshin të dobët fizikisht.

Kështu ndodh edhe kur diskutohet për disa probleme të tjera. Në këto raste llogaritë bëhen në mënyrë të tillë që punonjësit e Komisionit të Planit të Shtetit të jenë «në rregull» me shifrat, paçka se pengohet puna në një institucion ose ndërmarrje të rëndësishme.

Tash Partia po shtron përsëri çështjen e zhvillimit

1. Ky institut u hap më 1960.

të mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor. Për këtë do të duhet të punojnë grupe inxhinierësh të aftë e me përvojë. Këta do të punojnë derisa të plaken, por çështja është që edhe kur të plaken, ne t'i mbajmë pranë, se na duhen, ata të mbeten si këshilltarë në këto punë, se janë e do të jenë shumë të nevojshëm.

Me përparimin e vendit shumë fushave të shkencës u hapet një perspektivë e mirë. Një gjë të tillë duhet ta kenë të qartë të gjithë, veçanërisht punonjësit e Komisionit të Planit të Shtetit. Për zhvillimin e shkencës dhe përgatitjen e kuadrit llogaritë t'i bëjmë mirë, me mend dhe me kohë. Të marrim, për shembull, problemin e elektronikës. Ç'janë ata pak inxhinierë që punojnë për këtë degë? Janë shumë pak, sepse elektronika është përhapur dhe do të përhapet akoma më shumë, prandaj duhen forca për të studiuar e për të thelluar problemet në këtë fushë. Pastaj, edhe ata pak veta që janë, asnjëherë s'ulen të gjithë të punojnë, sepse një shkon me shërbim në Korçë, një në Fier e një tjetër diku gjetkë, jo në zanatin e tij. Prandaj nuk duhet konsideruar se këto çështje janë të parakohshme.

Ne, në punën tonë, duhet të nisemi nga ky parim: kritikë ndaj atyre njerëzve që nuk krijojnë, që kërkojnë të ngulen nëpër karrige dhe të marrin e të japin vetëm raporte pa kripë e pa brendi. Natyrisht, edhe raportet na duhen, por të dimë të ngremë në to, shkurt dhe qartë, problemet më të nevojshme dhe t'i zgjidhim ato hap pas hapi.

Ka fusha studimore që kërkojnë njerëz të mësuar, të cilët do të futen patjetër në organikë, se do të paguhen. Këtyre njerëzve do t'u ngarkojmë detyra, por

këto nuk kryhen brenda dy muajve ose brenda një viti. Në qoftë se ndonjëri nga këta do të bëjë studime, atij do t'i duhen disa vjet. Por si ky do të ketë edhe njerëz të tjerë, atëherë ku do të futen këta? Kam dëgjuar se disa shkodranë, të cilët unë i konsideroj studiues të mirë, janë mësues. Po pse duhet t'i lëmë të tillë njerëz mësues, kur ne kemi sa të duash kuadro të rinj, që janë diplomuar për mësues? Ne duhet t'i vëmë rëndësi punës shkencore të këtyre njerëzve. Këta ose t'i dublojmë, ose t'i futim në organikë, për shembull, si anëtarë korrespondentë të Institutit të Historisë. Po pse vallë, të gjithë ata që punojnë në Institutin e Historisë janë më të zotë se këta që kanë mbetur mësues? Jo, nuk janë të gjithë më të zotë. Po përse ndodhin atëherë këto gjëra? Këto ndodhin për shkak të kriterëve të ngushta nga të cilat nisen ata njerëz që përgjigjen për të tilla probleme. Nuk e kuptojnë ata se kur e lë mësues të thjeshtë një studiues me kapacitet, atij nuk i mbetet kohë të merret me studime, sepse do të bëjë normën mësimore prej 28 orësh në javë, do të korrigjojë detyrat e nxënësve, do të bëjë punë shoqërore e të tjera e të tjera?! Ç'do të presësh tjetër nga ky njeri, që është në moshën 50 vjeç, fjala vjen? Do t'i shfrytëzojmë aftësitë e këtyre njerëzve apo nuk do t'i shfrytëzojmë?

Në këtë drejtim, unë mendoj se duhet të thellohem, të thellohem më shumë, se ndiejmë një kënaqësi të madhe kur shikojmë që kuadrot e përgatitur nga Partia nxjerrin nga duart e tyre punë me vlera shkencore. Të tillë kuadro ne duhet t'i orientojmë, të mos i futim në kallëpe dhe të mos ua presim hovin në fushën e shkencës.

Tani kam edhe një problem tjetër, të cilin duhet ta bisedojmë edhe me shokët e shtypit.

Mua më duket se ka ardhur koha që për politikën e jashtme të botojmë një artikull¹ me anën e të cilit t'i bëjmë një demaskim «botës së paangazhuar» të Titos, si dhe teorisë së «botës së tretë». Kështu që ato demaskohen të dyja së bashku si dy teori antimarksiste, në unitet me njëra-tjetrën.

Për të shkruar këtë artikull mendoj se mund të bazohemi edhe te libri «Imperializmi dhe revolucioni», sepse atje flitet për «botën e tretë», por jo në atë platformë siç duam ta trajtojmë në këtë rast.

Demaskimin e këtyre dy «teorive» antimarksiste, antipopullore ta bëjmë duke iu referuar shembujve konkretë që zbulojnë falsitetin e tyre, si të njerës, ashtu edhe të tjetrës «teori». Të marrim, për shembull, Afrikën, ku superfuqitë, të vjetrat dhe të rejat, kolonialistët e vjetër dhe neokolonialistët, po luajnë të gjithë me fatet e popujve të këtij kontinenti, po pengojnë zhvillimin e pavarur ekonomik, politik e shoqëror të këtyre popujve dhe po mbysin aspiratat e tyre për përparim e për demokraci të vërtetë. Në krye të shteteve të këtyre vendeve ka edhe njerëz përparimtarë, që ia duan të mirën popullit të vet dhe që përpigën për ta nxjerrë vendin e tyre në rrugën e përparimit. Por mbi ta ushtrohen presione nga njerëz që janë të lidhur ngushtë e të pleksur me shumë fije, të vjetra ose të reja, me imperialistët, të cilët u imponojnë këtyre pikëpamjet e tyre kolonialiste, shfrytëzuese, nën maskën e

1. Shih: «Zëri i popullit», nr. 156 (9329), 30 qershor 1978.

kësaj apo të asaj teorie, si të «botës së paangazhuar», apo të «botës së tretë», «teori» që gjoja janë për çlirim e popujve të shtypur e të shfrytëzuar nga imperializmi, socialimperializmi e lakënjtë e tyre. Ka edhe udhëheqës të tjerë, që janë xhelatë e kriminelë të popujve, si Mobutu¹ e Bokasa². Unë përmenda vetëm këta të dy, por ka edhe sa e sa të tjerë, të cilët luajnë plotësisht rolin e agjentëve të shitur në shërbim të kolonizatorëve të vendit të vet.

Kolonizatorët e vjetër në mënyrë të maskuar kanë ngulur kthetrat në këto vende, duke përfshirë të gjitha sferat, ekonomike, politike dhe ushtarake. Të tjerë, imperialistë e neokolonialistë, nën maskën e dërgimit të specialistëve të çfarëdo lloji, nxitin tek këta popuj ndjenjën e urrejtjes midis njëri-tjetrit, gjë që shprehet me luftërat lokale që bëhen për shkaqe fisnore, raciale etj. Këtë kolonizatorët e bëjnë për të zaptuar tregje e për të shtrirë influencën e tyre në Afrikë.

I tillë është imperializmi sovjetik, i tillë është edhe imperializmi amerikan; të tillë janë të gjithë imperialistët e tjerë që kanë futur atje kthetrat e veta grabitqare, nën pretekstin se janë duke përgatitur legjionet në mbrojtje të këtyre popujve. Qëllimi i vërtetë i tyre është që t'i mbajnë nën sundimin e vet popujt e këtij kontinenti të madh.

Aktualisht popujt e shteteve të ndryshme të Afrikës, kanë shumë probleme për të zgjidhur brendapër-

1. President i Republikës së Zairesë.

2. Ish-president i Afrikës Qendrore. Më vonë u rrëzua me grusht shteti.

brenda vendeve të tyre, si probleme etnike, kulture, kombësie etj., të cilat deri sot janë trajtuar sipas intereseve të ish-kolonizatorëve. Por, tash, që në këta popuj të Afrikës ka një zgjim të madh të aspiratave kombëtare, ndërhyrja ideologjia e gjoja të paangazhuarve, që në realitet është diçka false, si edhe teoria e «botës së tretë» që është po aq false, po aq antipopullore, sa edhe e para. Si njëra, ashtu edhe tjetra synojnë për të ruajtur statukuonë. Dhe që të ruash statukuonë do të thotë të ruash këtë situatë kaq të turbullt dhe shtypëse nga ana e kolonizatorëve, të vjetër e të rinj, duke i gënjyer këta popuj se gjoja janë të paangazhuar.

Në artikullin tonë, midis të tjerash, mund të thuhet që ne shikojmë se në krye të disa shteteve afrikane ka udhëheqës realistë, që flasin drejt të nisur nga dëshira për forcimin e unitetit në mes tyre dhe nga pozitat e luftës për të mos lejuar ndërhyrjen e të huajve në punët e tyre të brendshme. Gjithashtu, këtu mund të vihet në dukje se të tillë udhëheqës përbuzen e luftohen si nga imperialistët, ashtu edhe nga ata që predikojnë «teorinë» e «botës së paangazhuar» ose të «tri botëve». Ne nuk mund të ndërhyjmë e nuk mund të themi se si duhet të veprojnë ata ose se çfarë anë pozitive dhe çfarë anë negative kanë në qëllimet e veta, por duhet të bëjmë të qartë se ne jemi për atë që qëllimet e mira të tyre duhet të mbrohen. Si për qëllimet e tyre të mira, ashtu edhe për të këqijat ata duhet t'i gjykojë populli i vet pa ndërhyrjen e të tjerëve.

Pastaj, në artikull mund të dalim te teza e teorisë së Partisë sonë: po nuk u luftuan me vendosmëri imperialistët e çdo ngjyre, të rinj e të vjetër, dhe, në ra-

dhë të parë, imperialistët amerikanë e socialimperialistët sovjetikë; po nuk u luftuan me konsekuencë ato klika në këto vende afrikane që janë plotësisht në shërbim të padronëve imperialistë e neokolonialistë; po nuk u demaskuan teoritë e ndryshme oportuniste e revizioniste, në këto shtete të Afrikës nuk mund të ketë pavarësi dhe sovranitet, as edhe një zhvillim të drejtë shoqëror, ekonomik, qoftë edhe borgjez-demokratik. Ne jemi të mendimit që popujt e Afrikës dhe të të gjitha kontinenteve të tjera, ku sundojnë imperializmi e lakenjtë e tyre, duhet të ngrihen në një rezistencë të ashpër e të organizuar kundër këtyre ndërhyrjeve politike, ekonomike dhe ushtarake, kundër kompleteve, ideologjive mashtruese dhe demagogjisë së fuqive të huaja.

Në këtë artikull të demaskohet kryesisht «teoria» titiste e «botës së paangazhuar», se për «botën e tretë» kemi folur. Pas mbledhjes që «vendet e paangazhuara» bënë në Beograd, Miniçi¹ ishte shumë i mërzitur. Vetë jeta po tregon se «mosangazhimi» i tyre po demaskohet dhe, sigurisht, po vërtetohet teza e Partisë sonë, që «teoria» e «vendeve të paangazhuara» është krijim i amerikanëve. Amerikanët, më duket se Karteri, këto kohët e fundit tha diku që ««vendet e paangazhuara» duhen mbrojtur». Këtu ka ndikuar jo presioni i amerikanëve te jugosllavët, por presioni i jugosllavëve tek amerikanët. Tashti, këta të fundit u thonë: do ta zbatojmë këtë bluf, që kemi kurdisur tok, apo nuk do ta

1. Millosh Miniç, në atë kohë, sekretar federativ i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë.

zbatojmë? Në qoftë se do ta zbatojmë, duhet të tregohemi të matur se me këto që po thoni, ju po na prishni planet, ky bluf do të dështojë. Duhet gjetur mënyra e vendi që edhe kjo ide të dalë në këtë artikull. Domethënë, të lihet të kuptohet se aktualisht ne shohim se te udhëheqës të ndryshëm titistë po shfaqet, bile haptazi, një dëshpërim i madh, se teoria e tyre, që është gjoja në interes të popujve, po dështon. Por, që kjo pseudo-teori e krijuar nga imperialistët amerikanë të mos dështojë, Karteri formalisht u vjen në ndihmë, duke thënë se «vendet e paangazhuara» duhen ndihmuar. Kurse nga ana tjetër merr vendime që të krijohen legjione të huaja gjoja për të mbrojtur pasuritë e tyre në këto koloni e neokoloni.

Në këtë artikull, gjithashtu, mund të themi se dhe revizionistët e tjerë të rinj po bëhen lakenj të imperializmit amerikan dhe po propagandojnë mbrojtjen e Mobutus dhe të atyre elementëve në udhëheqje të shteteve të vendeve të ndryshme të Afrikës, të cilët e kanë treguar açik se janë me atë që u jep më shumë. Kështu, për shembull, dikush nga ata ka qenë më parë me sovjetikët e tashti është kthyer me amerikanët; dikush tjetër ka qenë me amerikanët e tashti është bërë me sovjetikët, por nesër ai nuk e ka për gjë që të shkojë prapë me amerikanët; kuptohet, me kë t'i leverdisë më mirë. Pra, është e nevojshme të bëhet një diferencim i tillë.

SHOKU HYSNI KAPO: Sot nga imperialistët, nga socialimperialistët dhe reaksionarët e të gjitha ngjyrave po përdoren metoda të reja për të ruajtur pozitat e interesat e tyre në këto vende, prandaj ne duhet t'i

demaskojmë ata që kështu t'u vijmë në ndihmë popujve afrikanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po. Ne, po në këtë material mund të ndalemi edhe te ndonjë shtet konkret e të thellohemi në ndonjë problem të veçantë, si, për shembull: Vallë, e tërë Zaireja përbën një shtet, ashtu siç e ka përcaktuar imperializmi belg dhe e ka pranuar imperializmi amerikan, francez e të tjerë? A ka aty probleme etnike, kombësie, midis Katangës dhe pjesëve të tjera të Zairesë? A janë zgjidhur këto probleme si duhet dhe kush duhet t'i zgjidhë ato? Kuptohet se këto probleme duhet t'i zgjidhë vetë populli i Zaires dhe askush tjetër nuk duhet të ndërhyjë për këtë punë atje.

SHOKU HYSNI KAPO: Po, mund të marrim këtë shembull dhe të tjerët do të shikojnë se zgjidhjet që u propagandohen atyre tash, janë të frymëzuara vetëm nga pozitat e imperializmit.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, kështu është.

Mua më duket, shokë, se një artikull i tillë mund të bëhet.

SHOKU RAMIZ ALIA: Dakord! Demaskimi i teorisë së «botës së paangazhuar» dhe i teorisë së «botës së tretë» ka rëndësi të bëhet edhe për çështjen e Afrikës.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ka rëndësi për çështjen e Afrikës. Ky problem është aktual. Kështu që duke mbajtur parasysh materialin që kemi lexuar, telegramet që na kanë dërguar, si dhe orientimet që kemi në librin «Imperializmi dhe revolucioni», mund t'i demaskojmë teoritë e «të paangazhuarve» dhe të «tri botëve». Rëndësi ka të mbrohet çështja e popujve që po

ngatërrohen nga të huajt. Duket sheshit që imperialistët po përpiqen t'i mbajnë ata nën zgjedhën e tyre.

Unë mendoj që ky artikull të mos jetë propagandistik, por kryesisht teorik. Idetë të formulohen qartë në mënyrë që njerëzit të reflektojnë. Ai mund të dalë i shkurtër, por i ngjeshur. Pra, duke demaskuar imperialistët, socialimperialistët e shërbëtorët e tyre, me gjithë «teoritë» reaksionare që predikojnë, të cilat janë jo për të mbrojtur popujt, por koncesionet e kolonizatorëve, të vjetër dhe të rinj, të tregojmë të vetmen rrugë që duhet të ndjekin popujt e Afrikës për çlirimin e tyre të plotë dhe të vërtetë.

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në revistën
«Studime politiko-shoqë-
rore», nr. 1, 1981, f. 13*

*Botohet i plotë, sipas tekstit
të nxjerrë nga biseda e inci-
zuar që gjendet në AQP*

PANORAMË E SHKURTËR E «DIPLOMACISË BOTËRORE» KINEZE

Shënime

16 qershor 1978

Diplomacia kineze, me ardhjen në fuqi të ekipit Hua Kuo Fen-Ten Hsiao Pin, karakterizohet nga një histori luftënxitëse. Ajo është një diplomaci e shpejtuar, e marrë dhe pa kurrfarë arsytimi dhe principialiteti. Në gjithë veprimtarinë e këtij ekipi, që erdhi me puç në Kinë dhe likuidoi edhe ato mbeturina të njëfarë demokracie borgjeze revolucionare që ekzistonin, tash s'ohim një shpejtim jashtëzakonisht të madh me një inkoherencë dhe marrëzi të papërshekruar. Kjo sigurisht vjen nga ideologjia, nga strategjia që ndjekin kinezët, strategji e cila u dikton udhëheqësve të tyre aktualë revizionistë që të restaurojnë sa më parë kapitalizmin në vend dhe ta bëjnë këtë një superfuqi imperialiste.

Kjo politikë e Kinës është e tillë, për arsye se kësh-tu paraqitet edhe gjendja e brendshme e këtij vendi, konfuze dhe e paprincipitë, sepse edhe para se të vinte në fuqi ekipi aktual, pra, edhe nën drejtimin e Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, siç e kam shpjeguar shumë herë të tjera më parë, politika e tyre nuk ishte një politikë

konsekuente, qoftë edhe e një demokracie borgjeze. Në politikën e Maos dhe të Çu En Lait ne shihnim një paqëndrueshmëri, një lëkundje sa djathtas, majtas, një mungesë kriteri dhe principialiteti. Nuk njihej mirë dhe nuk përcaktohej qartë objektivi që kërkonte të arrinte politika e Mao Ce Dunit. Kjo politikë edhe në arenën ndërkombëtare ishte një politikë eklektike, por eklektike e kufizuar, sektare, pa principe të caktuara si duhet. Ne konstatojmë se strategjia kineze një herë anonte nga e majta, një herë tjetër nga e djathta, por shumë herë ajo ishte centriste. Një politikë e tillë ishte koniunkturale dhe kishte një objektiv, por ky ishte i lidhur me dobësinë ekonomike të vendit dhe me mungesën e kapacitetit politik të ekipit që jetoi e veproi nën drejtimin e Mao Ce Dunit. Ka rëndësi të kuptohet se mbështetja te Bashkimi Sovjetik, pra, strategjia e aleancës me të kundër imperializmit amerikan, bëhej jo nga qëllime parimore, por nga synimi që Kina të fuqizohej ekonomikisht dhe ushtarakisht, duke u mbështetur te Bashkimi Sovjetik.

Kur Kina pa se kjo rrugë ishte pa krye për strategjinë e saj, atëherë mori një drejtim centrist, gjoja agresiv, kundër dy superfuqive, edhe kundër Bashkimit Sovjetik, edhe kundër imperializmit amerikan, pse të dyja këto superfuqi, respektivisht me Hrushovin dhe me presidentin Lindon Xhonsn në krye, po binin në marrëveshje me aq sa binin. Këto marrëveshje Kina i konsideronte jo në interesin e saj. Gjatë kësaj kohe ajo, duke mos pasur një politikë stabël dhe parimore marksiste-leniniste, përgatitej të anonte dhe anoi nga strategjia proamerikane për të prishur aleancën në mes

Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik dhe për të anuar balancën drejt një miqësie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Bashkimit Sovjetik.

Kjo ishte pika e parë e strategjisë bazë të Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait. Mirëpo gjatë kësaj kohe kjo politikë mbetej një politikë e mbyllur, një politikë, si me thënë, e izoluar vetëm në dy drejtime. Hapja e Kinës në botë varej pra nga këto dy drejtime. Kur ishte në alcancë me Bashkimin Sovjetik, hapja e Kinës ishte shumë e ngushtë, vetëm drejt vendeve pro Bashkimit Sovjetik, kurse, kur ndryshoi strategjinë dhe mbajti pozitë centriste, Mao Ce Duni e ngushtoi akoma më tepër hapjen e Kinës në botë. Kina filloi një detantë dhe një hapje më të gjerë në politikën botërore kur u vu të ecte drejt një miqësie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtë e filluan, natyrisht, Mao Ce Duni me Çu En Lain, por, pas vdekjes së tyre, Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini morën frenat ndër dhëmbë dhe, duke bërë puçin, duke likuiduar «katërshen», siç e quajnë ata, e cila i kishte penguar dhe do t'i pengonte në një veprimtari të tillë *aberrante*, të marrë, siç po zhvillohet aktualisht, zgjeruan rrugën drejt restaurimit kapitalist dhe tash po bëjnë përpjekje të mëdha për të fituar kohën e humbur.

Në se konsiston kjo kohë e humbur? Kjo konsiston në atë që qoftë socialimperializmi sovjetik, qoftë imperializmi amerikan kanë livadhisur sipas interesave të tyre. Si njëri, ashtu edhe tjetri, gjatë këtyre momenteve politike në të cilat ka kaluar Kina, kanë vepruar në botë për rrethimin dhe për izolimin e saj. Izolimi i Kinës ishte i dyfishtë, izolim nga ana e sovjetikëve dhe izolim

nga ana e amerikanëve. Politika e të dyja superfuqive në këtë drejtim zhvillohej drejt zgjerimit të sferave të influencës së tyre, drejt zgjerimit të tregjeve, për fuqizimin dhe për hegjemoninë e njërës dhe të tjetrës. Njëkohësisht kjo politikë zhvillohej edhe për ta detyruar Kinën që të qëndronte e izoluar, ose njëri apo tjetri t'i impononte kësaj vullnetin e vet, të bënte që strategjia kineze të kthehej në drejtimin e njërit apo të tjetrit. Kështu që gjatë kësaj politike të marrë, antimarksiste të Mao Ce Dunit, Bashkimi Sovjetik arriti deri diku që të kishte një influencë të madhe rreth vendeve aziatike si, për shembull, në Afganistan, në Indi, deri diku edhe në Pakistan, për të mos folur për influencën amerikane, angleze ose franceze, e cila ushtrohej drejtpërdrejt dhe në mënyrë të fuqishme në Indonezi, në Filipine, në Japoni, në Korenë e Jugut. Në Azi mbeteshin Vietnam, Laosi dhe Kamboxhia, që ishin në luftë me imperializmin amerikan.

Lufta e imperializmit amerikan me Vietnamin e detyronte Kinën ta mbronte Vietnamin sa për sy e faqe, sepse më vonë politika e saj tregoi se ajo anonte nga imperializmi amerikan dhe përpiqej që Vietnam të pajtohej me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kur Vietnam u çlirua, Kina u mundua që këtë vend ta fuste nën shtetullën e saj, pra nën influencën e vet, ose ta nxiste drejt nënshtrimit përpara imperializmit amerikan që Vietnam të hynte përsëri në një zgjedhë të re, por në formë të tjera «paqësore», nën sundimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe jo të Bashkimit Sovjetik. Kina veproji kështu, sepse në këto kohë ajo, pas vajtjes së Kisingerit në Pekin dhe me manovrat e tij e

të Niksonit, e kishte ndryshuar strategjinë nga pro Bashkimit Sovjetik në proamerikane. Pra, për sa i përket Azisë, në këto situata ndodhej Kina kur erdhi në fuqi ekipi i Hua Kuo Fenit dhe i Ten Hsiao Pinit.

Për sa u përket lidhjeve të saj me Evropën, këto ishin pothuajse zero. Kina, derisa rronte Mao Ce Duni, në marrëdhëniet e saj me vendet e ndryshme të botës, në përgjithësi, kishte vënë si kusht çështjen e Tajvanit, domethënë kush propozonte të vendoste marrëdhënie me të, duhej të sqaronte nëse ishte me Tajvanin apo me Kinën. Një shtet që mbante lidhje diplomatike me Tajvanin, nuk mund të hynte as në marrëdhënie diplomatike, as tregtare dhe as ekonomike me Kinën.

Aktualisht Kina ndodhet në situata të vështira.

E para, për të realizuar synimet e saj strategjike për t'u bërë superfuqi, synime që u përcaktuan që në Kongresin e 10-të të Partisë Komuniste të Kinës¹, kur ishin gjallë Maoja dhe Çu En Lai, Kina duhej të mbështetej fuqimisht tek imperializmi amerikan dhe në vendet e tjera kapitaliste të zhvilluara të botës. Një mbështetje e tillë i nevojitej Kinës për të fuqizuar ekonominë e saj dhe për t'u armatosur deri në dhëmbë me teknologji moderne. Ky, pra, ishte objektivi i madh i strategjisë kineze. Mirëpo ai nuk mund të realizohej në rast se Kina s'do të ndihmohej nga fuqitë imperialiste perëndimore, meqenëse nuk mund të merrte më ndihma nga imperializmi tjetër, ai sovjetik.

E dyta, Kinës i duhej të çante rrethimin diplomatik. Prandaj ajo kaloi nga faza e izolimit të saj, e një politike

1. Ky kongres u zhvillua nga 24-28 gusht 1973.

të mbyllur dhe të ngurtë, në fazën e marrëdhënieve diplomatike, në fillim me disa shtete kapitaliste të Azisë, që mendonte se do të pranonin hegjemoninë e saj, dhe pastaj me të gjitha shtetet kapitaliste, revizioniste e fashiste, duke u futur kështu në xhironin e gjithë politikës imperialisto-kapitaliste të botës perëndimore.

Çështja e tretë lidhet me gjendjen e saj të brendshme, që ka shumë rëndësi për Kinën. Kjo gjendje duhej stabilizuar, pasi, pavarësisht se Huaja me Tenin morën pushtetin, kundërshtarët e kësaj klike puçiste nuk ishin vetëm katër veta, siç deklaronte propaganda zyrtare kineze, por ishin me miliona. Vetëm gjatë Revolucionit Kulturor, derisa u bë puçi i Hua Kuo Fenit, në parti kishin hyrë 18 milionë njerëz të rinj, të cilët ishin të frymëzuar nga ky revolucion. Gjithë këta njerëz nuk mund të pranonin përrallat e Hua Kuo Fenit dhe agresivitetin e papërmbajtur të Ten Hsiao Pinit, prandaj do t'i nxirrnin klikës puçiste, siç po i nxjerrin dhe do t'i nxjerrin edhe më vonë, vështirësi në drejtim, në ekonomi, në stabilizimin e saj.

Kësaj çështjeje grupi i Hua Kuo Fenit përpiqet t'i gjejë zgjidhje, por zgjidhja nuk mund të jetë as radikale, as e shpejtë. Ajo do të jetë një zgjidhje e përkohshme dhe kaotike, për arsye se forcat e brendshme politike dhe ekonomike në Kinë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Njerëzit e grupit, që akoma ka besim te vija e Mao Ce Dunit (që nuk është marksist-leninist), mendojnë se kjo është një vijë marksiste-leniniste. Pra vija centriste e Mao Ce Dunit ka adeptë të shumtë në Kinë. Këtë vijë deri në njëfarë shkalle e ka adoptuar Hua Kuo Feni, i cili përpiqet të realizojë një alean-

cë centriste me majtistët për të frenuar grupin djathtist që udhëhiqet nga Ten Hsiao Pini. Pasuesit e Tenit pa asnjë parim, duke i hedhur të gjitha poshtë, që nga Mao Ce Duni, nga Revolucioni Kulturor dhe frenimet e Hua Kuo Fenit, dëshirojnë që kalimi i Kinës në kapitalizëm, në socialimperializëm, të bëhet me shpejtësi të madhe. Por pavarësisht se përplasen mendime, pikëpamje, klasa dhe shtresa të ndryshme, duhet theksuar se në gjithë aktivitetin e jetës në Kinë, qoftë në industri, qoftë në bujqësi, qoftë në arsim, në kulturë e në çdo fushë tjetër, në vija të përgjithshme, Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin për sa u përket modernizimit të vendit dhe forcimit të ushtrisë janë në një vijë. Mirëpo mënyra e arritjes së këtij objekti midis këtyre të dyve ka diferenca.

Pavarësisht se grupi i Hua Kuo Fenit, domethënë aleanca centristo-majtiste, është më i fuqishëm nga ai i Tenit, ky i fundit vihet re që ecën më me guxim dhe më me shpejtësi përpara në rrugën e tij. Tashmë në Kinë jo vetëm që është bërë rehabilitimi i elementëve borgjezë e kapitalistë të deklaruar, monarkistë dhe agentë të fuqive të huaja, por këta janë duke marrë postet e vjetra dhe janë përcaktuar të atilla masa që kundërshtarët, domethënë të gjithë ata që e quajnë veten majtistë, të eliminohen dhe janë duke u eliminuar me shumicë nga funksionet e tyre shtetërore dhe të partisë. Kjo e frikëson shumë grupin e Hua Kuo Fenit, por ky nuk ka çfarë të bëjë. Gjendja në ushtrinë kineze ka të njëjtat karakteristika. Kjo ushtri, ashtu si dhe populli dhe partia, është e përcarë, gjë që duket në masat që po merren në bazë kundër kuadrove të ashtuquajtur të

majtë. Këto masa ndeshin në një rezistencë të madhe, prandaj në krye të ushtrisë ato merren me ngurrim, për arsye se nuk është stabilizuar akoma forca më reaksionare e djathtë e Ten Hsiao Pinit.

Në këto situata në politikën dhe në diplomacinë kineze shohim një histori të paparë ndonjëherë jo vetëm në historinë e Kinës, por as në historinë e Bashkimit Sovjetik revizionist, kur grupi i Nikita Hrushovit erdhi në fuqi. Një histori të tillë ne e kemi parë vetëm në regjimin titist. Me qindra delegacione ushtarake kineze shohim të bredhin tash nga të katër anët e botës nëpër vendet e ndryshme kapitaliste, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë, në Japoni, në Angli, në Gjermaninë Perëndimore, në Belgjikë, në Rumani, në Jugosllavi e kudo. Kjo tregon që Kina është në ethe. Po ç'janë këto ethe?

E para, këto ethe janë për të siguruar armatime moderne, për të siguruar kredi, për të marrë teknologji të re ushtarake dhe për të armatosur forcat e mëdha njerëzore kineze.

E dyta, për të nxitur psikozën e luftës imperialiste, domethënë për të kërcënuar Bashkimin Sovjetik gjoja me një aleancë kino-amerikane dhe me të gjitha shtetet kapitaliste perëndimore të zhvilluara. Ekipet e panumërta të specialistëve ushtarakë që shkojnë jashtë Kinës, marrin kontakte me shtabet kapitaliste botërore për të siguruar armë, për të siguruar një aleancë të ardhshme kundër Bashkimit Sovjetik, për të nxitur luftën ndër imperialiste, duke menduar që të tjerët t'ia nxjerrin Kinës gështenjat nga zjarri. Kështu udhëheqja kineze vrapon të fitojë besimin tek imperializmi ameri-

kan dhe te të tjerët se te Kina ata kanë një mike të besës, që është e gatshme dhe që po e vërteton me vepra se ndjek dhe zbaton udhëzimet dhe propozimet e Uashingtonit.

Në të njëjtën kohë Kina, duke vijuar politikën e saj të shfrenuar, tok me ekipet e panumërta të oficerëve të shtatmadhorisë së ushtrisë së saj, dërgon edhe qindra delegacione për çështje ekonomike dhe tregtare, të përbëra jo nga një, po nga 20-30 veta. Kina kërkon të zhvillojë ekonominë. Por për ta arritur këtë, në të njëjtën kohë me forcimin e ushtrisë, asaj i duhen kredi kolosale. Këto kredi Kina përpiqet t'i sigurojë nga të gjitha shtetet imperialiste që përmenda, të vjetra dhe të reja. Me kreditë e tyre ajo kërkon të marrë teknologji të re që të zhvillojë ekonominë e saj si ekonomi e një shteti të madh kapitalist.

Drejtimi tjetër i strategjisë kineze është aktualisht infiltrimi i saj, kudo ku ka mundësi, në të gjitha vendet e së ashtuquajturës botë e tretë, nën ngjyrën e aleates së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës, Anglisë, Japonisë etj. Duke u hequr si përkrahëse e «botës së tretë», Kina jep aktualisht një ndihmë shumë të vogël, pse është larg t'i ndihmojë të tretët, të konkurrojë në këtë drejtim imperializmin amerikan dhe imperialistët e tjerë. Ajo bën një politikë demagogjike, me të cilën nuk i gënjen dot popujt e Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine se gjoja është për çlirimin e tyre nga superfuqitë.

Të gjithë tash e shohin qartë se Kina nuk është më një shtet socialist, se ajo e ka braktisur revolucionin dhe është bërë aleate e gjakpirësve të popujve, jo vetëm e

imperialistëve, por edhe e klikave grabitqare borgjezo-kapitaliste-fashiste që sundojnë mbi popujt e ndryshëm ku orvatet të infiltrojë.

Ne shohim që Kina, me këtë kurs që ndjek, përpiqet të krijojë rezervën e vet politike, më vonë edhe ekonomike, domethënë të krijojë zonën e saj të influencës, tregjet e saj. Por aktualisht, duke pasur iluzionin se politika titiste në shërbim të amerikanëve me pseudoteorinë e «botës së paangazhuar» është një politikë fitimprurëse, udhëheqja kineze përpiqet të vihet në aleancë me klikën e Titos, të përfitojë kohë për të dalë në krye të vendeve gjoja të paangazhuara, që gjoja ndjekin këtë teori titiste. Ky është një iluzion, por kinezët përpiqen që ta bëjnë realitet, domethënë të ndihmojnë edhe këta, ashtu siç ndihmon Titoja, imperializmin amerikan dhe të marrin po ato kredi nga amerikanët, bile më shumë nga sa ka marrë ai si shpërblim për këtë politikë që ka ndjekur.

Nga ana tjetër, Kina ndjek vijën e propagandimit absurd për të ndihmuar që vendet e NATO-s dhe të Tregut të Përbashkët Evropian të forcohen, të forcojnë, gjithashtu, unitetin e tyre politik, ideologjik dhe ekonomik kundër Bashkimit Sovjetik, pse rrezikohen nga ai me një luftë të tretë botërore. Tërthorazi Kina u thotë këtyre shteteve që të konsolidojnë miqësinë ushtarako-politike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po dhe miqësinë ushtarako-politike dhe ekonomike me Kinën, duke u hapur këtyre tregun e saj të madh që të investojnë në këtë vend kapitale të mëdha për ta financuar, por njëkohësisht edhe për të fituar të ardhura të mëdha për veten e tyre.

Çështja tjetër është se Kina ka intensifikuar propagandën e saj në vende të veçanta, si, për shembull, siç duket tash, në Ballkan. Ajo ka marrëdhënie të mira me dy shtete të Ballkanit, me Jugosllavinë dhe me Rumaninë, dhe mendon që këto dy shtete të bëhen një bariere në shërbim të NATO-s kundër Bashkimit Sovjetik.

Përveç kësaj, Kina bën presione ekonomike, politike dhe ideologjike te ne që të thyhemi dhe të zbatojmë strategjinë e saj. Por këtij qëllimi revizionistët kinezë nuk ia arrijnë dot me ne. Sa për Jugosllavinë dhe Rumaninë duhet thënë se si Titoja, ashtu edhe Çausheku përfitojnë në të dy tablotë, hanë në të dy grazhdet, ose më mirë të themi, në shumë grazhde.

Kina zhvillon demarshe politike edhe drejt Turqisë e Greqisë, të cilave u jep mend që të kenë kujdes ndaj socialimperializmit sovjetik, i cili i rrezikon etj., etj., sikur këto dy shtete duhej të pritnin Kinën e Hua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit që ta mësonin rrezikun e socialimperializmit sovjetik. Por kjo për Kinën do të thotë që ti, Turqi, dhe ti, Greqi, mbahuni fort tek imperializmi amerikan. Të njëjtën gjë bën Kina edhe me Italinë dhe me Spanjën.

Në Azi shohim, gjithashtu, një aktivitet të etshëm të Kinës në drejtim të Kamboxhias. Mund të themi se Kamboxhian Kina e ka nën thundër. Partia e Kamboxhias nuk është një parti komuniste, ajo është një satelite e Partisë Komuniste të Kinës dhe nuk rron veçse në sajë të Kinës. Nga ana tjetër, Kina bën avanca të njëpasnjëshme në drejtim të Indisë, marrëdhëniet me të cilën, siç dihet, i ka pasur shumë të acaruara, por tash

përpiqet që t'i përmirësojë. Mirëpo këto marrëdhënie nuk ecin ashtu si dëshiron Kina. Kjo po përpiqet ta harrojë Ali Buton dhe të lidhet me kundërshtarin e tij në Pakistan, gjë që hyn në strategjinë e saj të prishjes së rrethimit.

Strategjia e Kinës synon, gjithashtu, që të ndihmojë dhe të inkurajojë shahun e Iranit dhe të gjithë sheikët e gjirit të Omanit. Të tëra vendet e këtij gjiri, tok me Arabinë Saudite, janë objektiva aktualë të politikës dhe të diplomacisë kineze, e cila, me influencën e saj, përpiqet që këto vende t'u qëndrojnë besnike aleancave me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ato të forcojnë unitetin në mes tyre për t'u bërë ballë sovjetikëve.

Ndaj Japonisë Kina bën një politikë nxitëse për të konkluduar traktatin e miqësisë, por do që në këtë traktat të figurojë termi «kundër hegjemonizmit». Me fjalë të tjera Kina dëshiron që ta lidhë Japoninë me një traktat kundër Bashkimit Sovjetik. Mirëpo Japonia, e cila është në një vijë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse ka përfitime të mëdha nga afrimi me Kinën e sotme, e sheh fare qartë politikën që ndjek kjo dhe nevojat që e shtyjnë të bëjë një politikë të tillë. Ajo i njeh mirë, gjithashtu, psikologjinë kineze dhe atë të udhëheqjes aktuale kineze dhe nuk bie në ato kurthe që kërkon t'i imponojë kjo. Natyrisht, Japonia nuk është kundër një bashkëpunimi të ngushtë, sidomos ekonomik, me Kinën, e cila ka lëndë të para të çdo lloji që asaj i nevojiten shumë, prandaj nuk është në kundërshtim me një *modus vivendi* miqësor me Kinën. Por në të njëjtën kohë Japonia u ruhet tendencave ekspansioniste të Kinës ndaj Bashkimit Sovjetik, i cili përbën

një rrezik për Japoninë, në rast se kjo pranon kushtet e Kinës për nënshkrimin e një traktati të miqësisë ose të mossulmimit me të.

Për sa i përket Koresë, Kina nuk është shumë e ngrohtë me Kim Ir Senin. Kim Ir Seni ka shumë borxhe dhe këto borxhe i kërkojnë. Kimi kërkon t'i lajë borxhet me ndihmën e Kinës, por edhe të Bashkimit Sovjetik. Kështu që edhe ai ka një politikë të balancës, lëkundet herë nga njëri, herë nga tjetri, që të përfitojë sa më shumë.

Në drejtim të Filipineve, të cilat janë një koloni ose si të thuash gjysmëkoloni, nën influencën e imperializmit amerikan, shohim që Kina të dërgojë njërin pas tjetrit udhëheqësit e saj kryesorë për të biseduar me Markosin. Ajo dërgon, gjithashtu, në Birmani, në Bangladesh, në Tajlandë, udhëheqës të kalibrit të lartë, që nga Li Hsien Nicni e deri tek Ten Hsiao Pini. Gjithë këto vajtje-ardhje, gjithë kjo politikë dhe kjo diplomaci synojnë që të çajnë rrethimin e krijuar më parë kundër Kinës, t'i bëjnë këto vende dashamirëse ndaj «Kinës së re» dhe t'i japin mundësi kësaj të fillojë të bëjë tregti me to dhe të vendosë marrëdhënie kulturore. Kina përpiket të krijojë një pakt në mes këtyre vendeve, i cili t'i bëjë ballë eventualisht një sulmi sovjetik, pse, sipas saj, edhe Vietnami është bërë tash një bazë e sovjetikëve, prandaj me Vietnamin Kina është në thikë e në pikë. Sovjetikët me flotën e tyre vijnë vërdallë në Dedin e Kinës e në Oqeanin Indian dhe përpiqen jo vetëm ta mbajnë, por edhe ta forcojnë rrethimin e Kinës.

Ekziston kështu një garë e egër në mes këtyre dy superfuqive. Imperializmi amerikan ka mashat e veta

që e aktivizojnë këtë kundërshtim dhe dëshiron e përpiqet që Kina të bëhet plotësisht e varur nga politika e tij dhe nga politika e aleatëve të tij perëndimorë.

Prandaj në këto momente konstatojmë që aktiviteti më i madh politik, ideologjik, ushtarak dhe ekonomik i Kinës zhvillohet në Evropë; nuk mbetet pas edhe në Amerikë; pastaj në një shkallë më të dobët në vendet e Azisë.

Për ndërhyrjen në Afrikë revizionistët kinezë ndjekin pikërisht atë politikë që bënte dikur Titoja në kohën e lulëzimit të tij si agjent amerikan. Kina del në mbrojtje të politikës amerikane në Afrikë; ajo propagandon statukuonë, domethënë mbështet me këtë interesat e kapitalizmit amerikan, francez, anglez, të racistëve të Afrikës së Jugut etj. Kjo gjë ka nxitur urrejtjen jo vetëm të popujve të Afrikës, të cilët humbën çdo iluzion mbi politikën gjoja socialiste të Kinës. Por dhe ata udhëheqës, që kanë marrë ndihmë nga Kina, tash flasin hapur se Kina është bërë një zëdhënëse dhe shërbëtoare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kina është pro krijimit të «legjioneve të huaja» në Afrikë, për të mbrojtur klikat afrikane të shitura tek imperializmi amerikan dhe tek imperialistët e tjerë. Kina po e mbështet këtë politikë në Afrikë duke dërguar atje emisarët e saj kryesorë, si ministrin e Jashtëm Huan Hua, i cili zhvillon haptazi bisedime me Mobutun, atakon që nga Zairja sovjetikët dhe kubanezët, mban lidhje me Etiopinë, ku nuk ka interesa të mëdhenj dhe ku janë futur sovjetikët, nxit Somalinë etj., etj. Politika e Kinës në Afrikë është e shpëlarë dhe demaskuese për të, pse i shërben politikës skllavëruese të imperializ-

mit amerikan dhe të imperialistëve të tjerë të vjetër, që nuk janë zhdukur nga Afrika dhe vazhdojnë edhe sot, njëlloj si më parë, t'u pinë gjakun popujve afrikanë.

Kjo është me pak fjalë strategjia e Kinës.

Por, duke e analizuar këtë politikë të vazhdueshme eklettike dhe koniunkturale, imperialistët amerikanë dhe ata perëndimorë që tash po u përgjigjen avancave kineze, për arsye se kanë interesa të mëdhenj ekonomikë dhe politikë. Kështu ata vënë përpara Bashkimit Sovjetik një fuqi tjetër të madhe, Kinën, së cilës i japin armatime dhe teknologji të re. Në të njëjtën kohë imperialistët ndjekin me kureshtje dhe me dyshim politikën e Kinës, pse ajo në një moment, kur ta shikojë veten pak a shumë të fortë, mund të bëjë një gjysmë kthese për të arritur në një kthesë tjetër të re dhe të bëhet përsëri aleate e Bashkimit Sovjetik.

Këtë politikë të Kinës e ndjek edhe Bashkimi Sovjetik, pavarësisht nga lufta e sipërfaqshme dhe kontraktat që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Bashkimi Sovjetik vazhdon të ngulë këmbë që ta kthejë Kinën nga ana e tij. Por edhe imperializmi amerikan dhe imperialistët e tjerë këtë eventualitet e ndjekin me kujdes të madh, nuk janë budallenj që të futen në luftë për interesat e Kinës. Kinën, po, ata mund ta futin në luftë me Bashkimin Sovjetik për interesat e tyre, dhe pikërisht këtu shohim që Karteri të zbatojë një politikë, si me thënë, me dy krerë, njëra e Vensit, «pëllumbit» dhe tjetra e Brzezinski, «skifterit». Vensi, si sekretar i Departamentit të Shtetit të SHBA-së, është për një politikë jo shumë të ashpër; ai nuk është për një politikë të luftës së ftohtë me Bashkimin Sovjetik,

por për një politikë të bashkekzistencës paqësore, kurdoherë në interesin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kurse Brzezinski, si këshilltar i presidentit amerikan, është për një politikë shumë më të shpejtuar në afrimin me Kinën dhe për një ashpërsim korrespondues me Bashkimin Sovjetik nga ana tjetër.

Karteri përpiqet të qëndrojë në dy karrige dhe të gjejë një rrugë të mesme, të kënaqë edhe dhinë edhe lakrën. Kjo mundet që e shkakton atë mosinvadim të Kinës me shpejtësi më të madhe nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të cilën ato i kanë mundësitë. Kjo nuk do të thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë lidhur duart. Jo, ato veprojnë fuqimisht, edhe sot i japin Kinës teknologji dhe armatime, influencojnë në shtetet borgjeze kapitaliste të zhvilluara të Evropës dhe tek anëtarët e NATO-s që të zhvillojnë tratativa me Kinën. Tratativat, natyrisht, janë të koordinuara me amerikanët, fitimet ekonomike, politike dhe ushtarake që do të rrjedhin prej tyre janë në interesin jo vetëm të Gjermanisë Perëndimore, të Francës, të Anglisë ose të Belgjikës, por edhe në interesin e amerikanëve, për arsye se interesat e «Evropës së Bashkuar» dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë të pleksura ngushtë ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht. Prandaj palët nuk veprojnë në mënyrë të veçuar. Në sipërfaqe duket sikur ky është një veprim që kryhet në mënyrë të veçuar, por në strategji interesat e të gjithëve janë të përbashkët.

Në vija të përgjithshme kjo mund të jetë, sipas mendimit tim, panorama e politikës dhe e diplomacisë absurde, reaksionare, luftënxitëse dhe kapitaliste të Ki-

nës aktuale. Kjo është një politikë e paprincipitë, e paprincipitë në platformën e një shteti borgjezo-kapitalist, pse për Kinën s'mund të flitet më për çështjen e principeve marksiste-leniniste, që nuk ekzistojnë gjëkund. Politika aktuale e demaskoi dhe po e demaskon këtë vend çdo ditë e më shumë. Kina po e humbet besimin në botë. Shtetet me të cilat ajo bën alishverishe, e kuptojnë fare mirë politikën e saj të paqëndrueshme, të dyshimtë kapitaliste e që u intereson. Ato nuk janë të bindura në qëndrueshmërinë e politikës kineze, kurse popujt e kanë humbur krejt besimin ndaj Kinës dhe po binden se ajo s'ka qenë kurrë një shtet socialist dhe se Partia Komuniste e Kinës s'ka qenë kurrë një parti marksiste-leniniste. Çdo ditë Kina demaskohet dhe kështu vërtetohet qëndrimi i drejtë dhe parimor i Partisë sonë, i cili përqafohet dhe propagandohet nga popujt dhe nga njerëzit përparimtarë të vendeve të ndryshme të botës. Them njerëzit përparimtarë, pa përmendur këtu, në radhë të parë, komunistët, revolucionarët, të cilët shohin te vija e Partisë sonë një politikë konsekuente për çlirimin nga robëria e kapitalit, e imperializmit dhe e socialimperializmit.

Marrë nga libri:

Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 10, f. 554

TREGUESIT

TREGUESI I LENDES

A

Afrika, lëvizjet dhe luftërat e popujve afrikanë për liri e pavarësi — 62, 419-422, 423, 424-425.

Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 78-79, 304-305.

Ambasada e RP të Kinës në Tiranë — 31, 172.

Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 65-66, 73, 81-82, 83, 87-88, 134, 194, 392, 397.

Arsimi në Shqipërinë e paraçlirimit — 107, 108.

Arsimi në RPSSH — politika dhe roli udhëheqës i Partisë në fushën e arsimit; tre komponentët; arsimi i mesëm profesional, shkollat e mesme bujqësore — 105-106, 112;

— programet, tekstet shkollore; rrethet jashtëshkollore — 105-109, 110-111, 112, 150-152, 156;

— nxënësit, mësuesit, studentët, pedagogët; kualifi-

fikimi pasuniversitar — 69-70, 78, 110;

— roli i shkollës në edukimin e brezit të ri, metodat e edukimit; bashkëpunimi i saj me organizatat e masave — 157, 259-262, 263.

Arti Ushtarak i Luftës Popullore; përvetësimi i tij, strategjia dhe taktikat e luftës popullore — 109, 134-135, 147, 225.

B

Bashkimet Profesionale të Shqipërisë; organet udhëheqëse, kuadrot; detyrat e tyre — 251-253, 254-256, 257-260;

— lidhjet me administratën — 251-253, 254-255.

Bashkimi Sovjetik (1917-1953) — 383, 386.

Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik. Kongresi i 22-të i PKBS — 5, 24, 25;

— politika e jashtme eks-

pansioniste, lidhjet me ShBA; ndërhyrjet në Azi — 41, 301, 394-395, 428-429, 440;

— qëndrimi ndaj lëvizjes komuniste; qëndrimi ndaj PPSH dhe RPSSH; demagogjia e tij për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit — 40, 47, 65-66, 91.

Blegtoria, rritja e prodhimeve blegtorale; punonjësit e blegtorisë — 292, 333-335.

Borgjezia, partitë borgjeze; borgjezia e re në vendet revizioniste — 57, 58-59, 60, 61, 89, 315, 364.

Bujqësia në RPSSH; harmonizimi i saj me blegtorinë; kuadrot dhe specialistët e bujqësisë — 329-334;

— punimet e stinës në bujqësi; kodi agroteknik — 231, 233, 265-266, 333.

Burokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 195-193, 207-208, 247, 253, 277, 291.

Ç

Çmimet — politika e Partisë në fushën e çmimeve; çmimet e produkteve bujqësore — 233-234, 305-306, 339-340.

D

Dëshmorët — 312, 318.

Diktatura e proletariatit, sistemi politik i diktaturës së proletariatit dhe roli udhëheqës i Partisë në të — 209, 291.

Disiplina proletare — forcimi i pandërprerë dhe lufta kundër qëndrimeve të huaja ndaj zbatimit të saj — 200, 255-256.

Dituritë, përvetësimi i tyre — 127, 275.

E

Edukimi komunist, edukimi ideopolitik e moral; rrugët, format dhe mjetet e edukimit komunist — 157-153, 159, 192-193, 206-208.

Ekonomia popullore — organizimi dhe drejtimi shkencor i saj; shfrytëzimi i rezervave të brendshme; ekonomistët — 126, 127, 183-192, 240.

Engels, Fridrih — 37, 176, 378, 404-405, 406.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 64, 72, 78, 107, 108, 131, 149-150, 165, 214, 218-219, 262-263, 270, 319-320, 359-360, 381-382, 404, 410, 416.

F

Familja, roli i saj në edukimin e fëmijëve — 157, 158.

Fashizmi, neofashizmi — 57-61.

Financat, kontrolli financiar; lufta kundër abuzimeve dhe shkeljeve financiare; dëgët dhe prodhimet që subvencionohen nga shteti — 128, 230-231, 232, 235, 236, 337, 341.

Forcat prodhuese, zhvillimi i pandërprerë i tyre — 123, 241.

Fshatarësia; fshatarësia kooperativiste, cilësitë e saj — 220, 233-234, 265.

Fuqia punëtore, kualifikimi, kategorizimi (atestimi) i saj — 126-127, 256-257.

G

Gruaja dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë; Kongresi i 8-të i BGS-h — 215, 269, 310-317.

Gruaja në vendet kapitaliste — 312-313.

Grupet armiqësore dhe lufta kundër tyre; grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes etj. në ushtri — 26-27, 31, 33, 48;

— grupi armiqësor sabotu-

es i A. Këllezit, K. Ngjëlës etj. në ekonomi — 26, 48, 187.

GJ

Gjeologjia, gjeologët; detyrat e tyre — 71, 73, 78.

H

Historia e Shqipërisë

— luftërat e popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror. Qëndrimet armiqësore të fuqive imperialiste dhe të shteteve fqinje ndaj popullit shqiptar dhe luftërave të tij — 218, 281-285, 349-350, 353-355, 370-373, 374, 375, 377, 397, 407-408;

— Rilindja Kombëtare Shqiptare, rilindësit — 291, 282-283, 350, 357-358, 361, 364, 366-367, 369-378, 396-397, 405;

— Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878—1881), rëndësia historike e saj. Roli i saj në formimin e kombit shqiptar — 216, 281-283, 349-350, 353-358, 362, 367, 368, 372, 375, 378,

- 396-397, 403-404, 405, 406, 410, 412, 413;
- shkrimet, studimet për historinë e Shqipërisë; trajtimi materialist-dialektik i saj; historianët. Teksti i historisë së Shqipërisë — 356, 362-363, 370-371, 374-378, 403-409, 410-414;
 - historianë dhe dijetarë të huaj për historinë e Shqipërisë. Kritikë kundër shtrembërimeve e falsifikimeve të historiografisë borgjeze për historinë e Shqipërisë — 355, 356-357, 408.

Shih edhe: Kombi dhe çështja kombëtare... — kombi shqiptar...

I

- Imperializmi, natyra dhe tipare të tij; strategjia dhe taktikat; lufta e popujve kundër imperializmit* — 45, 59-62, 420, 421-422, 440.
- Industria e rëndë në RPSSH — vendi dhe roli i saj në ekonominë popullore* — 168-169;
- industria metalurgjike; siderurgjia; metalurgjia e bakrit — 161-169, 187, 244-245;

- industria minerale (e kromit, e hekurnikelit); studimet shkencore për përmbajtjen dhe teknologjinë e mineralit; specialistët — 163-167, 244, 245, 335, 336-337;
- industria mekanike — 167-168.

Iniciativa dhe vetëveprimi — 152-153, 155, 191.

Investimet, përdorimi me efektivitet i tyre — 233, 236, 278.

J

Jetesa në shoqërinë tonë socialiste — 233, 236.

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, Kongresi i 11-të i saj — 92-93, 94;

- politika e jashtme, lidhjet me imperializmin dhe me Kinën; synimet shoviniste — 22-23, 27, 92, 385, 386, 394-396, 422-423, 436;
- gjendja e brendshme; lufta e grupeve për pushtet, konfliktet nacionale. Klasat në Jugosllavi — 94-95, 194, 386-387, 393-394;
- vetadministrimi jugosllav, thelbi anarkosindi-

kalist i tij; mohimi i diktaturës së proletariatit dhe i rolit të partisë — 93-95;

- qëndrimi armiqësor ndaj Kosovës dhe popullsisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 219, 356-357, 368, 382-383, 384-385, 386-388, 392, 398-400;
- qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSSH — 22-23, 27, 88, 356, 381-383, 390-392.

K

Kapitalizmi, tipare, karakteristika të përgjithshme; kriza e përgjithshme ekonomiko-politike, pashmangësia e zhdukjes së tij — 57, 59-62, 207, 240, 365.

Kërkesa dhe oferta në socializëm — 127, 304, 305.

Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive të rretheve; seksionet, detyrat e tyre — 106, 117, 128, 264, 293, 331, 332, 334, 341-342;

- Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës — 114, 115;
- këshillat popullorë të fshatrave — 263-264.

Këshilli i Ministrave (Qeveria) — 124, 169, 170-171, 248, 249, 278, 306, 342, 367.

Kina, revizionizmi kinez; Partia Komuniste e Kinës, vija e saj. Strategjia e Kinës për t'u bërë superfuqi — 1-4, 7-8, 11-

-12, 14-15, 20, 21, 23, 26, 32-33, 34-35, 36-50, 100, 295-300, 301-302, 426-442;

— politika e jashtme demagogjike, hegjemoniste dhe luftënxitëse. Rivendikimet territoriale — 1-4, 5-6, 11-12, 16-18, 43-44, 48-50, 89, 98-99, 298, 426, 433-434, 441-442;

— gjendja e brendshme, lufta e grupeve për pushtet, qëndrimi ndaj «katërshes»; Revolucioni Kulturor. Zyra e Përgjithshme — 4, 7-8, 22, 44-45, 97, 99-101, 172-185, 211, 426, 428, 431-433;

— klasat dhe lufta e klasave në Kinë; klasa e re borgjeze, qëndrimi ndaj borgjezisë — 4-5, 6-7, 9, 95-97, 176-177;

— qëndrimi ndaj marksizëm-leninizmit, pretendimi i tyre për zhvillimin krijues të tij. Vija e saj për ndërtimin e socializmit, degjenerimi i bazës dhe i superstrukturës, ka-

- limi në kapitalizëm — 5-6, 19, 27-28, 36-37, 45-46, 48, 96-101, 172-185, 295, 432, 434;
- qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik (1917—1953) dhe ndaj Kominternit — 36-37, 38-39;
 - qëndrimi ndaj vendeve fqinje dhe ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez; qëndrimi, kontradiktat me Vietnamin — 3-4, 7-11, 12-18, 301, 429, 434, 438;
 - lidhjet e bashkëpunimi me ShBA dhe me shtetet e tjera kapitaliste; marrëdhëniet, kontradiktat me BS — 5, 6-7, 21, 25, 32-33, 34, 37-38, 39-46, 47, 48-49, 89, 97-98, 101-102, 103, 104, 295-300, 427-428, 429-431, 433-434, 435, 436, 437, 439;
 - qëndrimi ndaj çështjes së Tajvanit — 299-300, 430;
 - qëndrimi ndaj lëvizjes komuniste dhe partive komuniste; roli sabotues në revolucion dhe në luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 46, 49-50, 296, 298, 434-435;
 - bashkëpunimi me klikat reaksionare, marrëdhëniet me partitë dhe me vendet revizioniste; marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë — 22-23, 27, 97, 101, 103, 104, 296, 297, 392, 435, 436, 437, 439-440;
 - qëndrimi ndaj vendeve të tjera të Azisë (Japonisë, Koresë, Filipineve); ndërhyrjet në Afrikë — 300-301, 436-438, 439-440;
 - marrëdhëniet, qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSSH — 3-4, 11, 12, 19-21, 24, 25-27, 29-34, 46-48, 65, 125, 162-163, 168, 172-178, 250, 345, 375, 392, 436.
- Kinematografia, filmi në RPSSH — 154-155.*
- Klasa punëtore në RPSSH; roli i saj në ndërtimin e socializmit; edukimi tekniko-profesional dhe kulturor i saj — 127, 246, 306.*
- Klasa punëtore në vendet borgjezo-revizioniste, shfrytëzimi kapitalist i saj — 57, 58-59, 182.*
- Kolonializmi, neokolonializmi — 62, 419-422.*
- Kombi dhe çështja kombëtare; përpjekjet e fuqive të mëdha, të borgjezisë dhe të revizionistëve për t'u mohuar popujve lirinë — 375-376, 391-392;*

— kombi shqiptar dhe çështja kombëtare shqiptare; qëndrimi armiqësor dhe përpjekjet e fuqive të huaja dhe të Jugosllavisë për mohimin e identitetit kombëtar të popullit shqiptar. Vija e PPSH për këtë problem dhe qëndrimi i saj ndaj popullsisë shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 219, 231-236, 349, 353-358, 370-378, 379-402.

Komunisti, cilësitë; roli i tij militant — 51-52, 55-56, 115, 118, 190, 193, 195-196, 198-201.

Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë — 120, 256, 272.

Kooperativat bujqësore — politika e Partisë dhe ndihma e shtetit për forcimin e gjithanshëm të tyre. Kooperativat e tipit të lartë — 227-237;

— të ardhurat në kooperativat bujqësore, fondet, shpërblimi i punës — 229-237, 339-344.

Kosova dhe popullsia tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi; traditat patriotike, luftërat e tyre për liri, pavarësi dhe për të drejta kombëtare — 194, 219, 279-280, 282, 283, 284, 354, 355-356, 357, 358, 379-389, 395-402, 403.

Kostoja e prodhimit, përcaktimi i saj — 303, 344.

Kritika dhe autokritika — 54, 115, 119, 222, 240.

Kuadrot, specialistët — politika e Partisë me kuadrin; roli dhe detyrat e tyre — 75-76, 113-114, 116-117, 120-121, 123, 202-213, 306-308, 417-418;

— përgatitja, zgjedhja, vendosja dhe shpërndarja e kuadrove — 69, 76, 156, 164, 204-205, 209-210, 414-415, 417-418;

— kuadrot e Partisë — 116-117, 198, 211-212.

L

Lenin, Vladimir Iliç — 5, 19, 29, 32, 36, 37, 39, 89, 93, 176, 251, 252, 378.

Letërsia dhe artet në RPSSH — roli udhëheqës dhe kujdesi i Partisë për letërsinë dhe artet — 154-155, 220, 271-272, 276-280;

— zhvillimi, masivizimi; roli i tyre në edukimin komunist të masave — 214-215, 217-218, 220, 272-273, 276-280, 360;

— shkrimtarët, artistët, punonjësit e artit; talentet e reja — 149, 153-156, 215, 216-217, 267-268, 271, 272, 274-276, 277;

- metoda e realizmit socialist; mbështetja në tabanin kombëtar. Heroi pozitiv në letërsi dhe në arte — 216-217, 272-274, 279;
- veprimtaritë artistike; lëvizja artistike amatore — 214-220, 271, 279.
- Letrat e popullit* — 334, 415.
- Ligjet, zbatimet e tyre, lufta kundër shkelësve të ligjeve* — 119, 227.
- Liberalizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij* — 205-207.
- Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar; qëllimi, objektivat, rëndësia e saj* — 284, 354, 378;
- solidariteti dhe bashkëpunimi i popullit shqiptar me popujt fqinjë — 379-380.
- Lufta, kuptimi i saj; rreziku i luftës* — 89, 225-226.
- Lufta e klasave në shoqërinë tonë; lufta e klasave në frontin ideologjik* — 82-84, 87, 89-90, 195.
- M**
- Marks, Karl* — 19, 28, 37, 93, 176, 378, 404-405, 406.
- Marksizëm-leninizmi* — busull dhe udhëheqje për veprim; njohja, përvetësimi dhe zbatimi krijues i tij — 206, 207, 274, 404-405, 414.
- Materializmi historik* — trajtimi materialist dialektik i fenomeneve të shoqërisë — 82-84, 272-275, 350.
- Mbështetja në forcat e veta* — 245, 250.
- Mbrojtja e atdheut, forcimi i gatishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të gjithë vendit për mbrojtje* — 89, 129, 139, 223.
- Ministritë dhe kuadrot e tyre; detyrat, metoda dhe stili në punë* — 114, 121-122, 127, 128, 170, 247, 248, 254, 308;
- Ministria e Punëve të Brendshme — 81;
- Ministria e Mbrojtjes Popullore — 140, 141;
- Komisioni i Planit të Shtetit — 308, 416, 417;
- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 68, 113, 114, 168, 169;
- Ministria e Tregtisë së Brendshme — 247;
- Ministria e Tregtisë së Jashtme — 186, 187, 247;
- Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 111, 112, 150-151, 153, 271-272, 367.
- Mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste; rrugët dhe treguesit e rritjes së saj* — 233-234, 235-236, 337.

Morali socialist, virtytet — 272-274.

Muzika dhe koreografia (këngët dhe vallet popullore) — 215, 216-217, 218-219.

N

Nafta dhe gazi; studimet, metodat shkencore në kërkimet dhe në shpimet për naftë e gaz, rëndësia e tyre. Aplikimi i përvojës botërore në kushtet e vendit tonë — 63-64, 65-66, 67, 68, 69, 70-73, 74-75, 77, 78;

— kuadrot, specialistët, punonjësit; kualifikimi i tyre — 63-69, 71-72, 73-75, 77, 79.

Ndërgjegjja, veprimtaria e ndërgjegjshme — 274-275.

Ndërmarrjet bujqësore — organizimi dhe drejtimi i punës në to — 228-230, 342.

Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — parime, karakteristikat të ndërtimit socialist; zhvillimi i pandërprerë dhe konsolidimi i shoqërisë socialiste — 25, 159, 215, 313-314, 340, 345, 360, 374-375, 378, 391, 392.

O

Organet e Punëve të Brendshme; Sigurimi i Shtetit, pu-

nonjësit; roli dhe detyrat e tyre për zbatimin e vijës së Partisë dhe për mbrojtjen e vendit — 80-90.

Organizata-bazë e Partisë, byroja dhe sekretari; detyrat e tyre — 51-56, 188-189, 192, 195, 196-197, 198-201, 213, 222-223;

— organizata-bazë e Partisë në dikastere dhe në institucione — 52, 53-54.

Organizatat e masave, forclimi i lidhjeve dhe i bashkëpunimit ndërmjet tyre — 159.

Organizimi dhe drejtimi — 120-122, 127-128, 188-189, 208.

P

Paga, sistemi i pagës; parimi i shpërbllimit sipas punës — 231-234, 235-236.

Paraja dhe qarkullimi monetar — fuqia blerëse e popullsisë dhe mbulimi i saj me mallra — 124-128, 305.

Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe feta e brendshme

— vija e saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 25, 374-375, 376, 377-378, 379-380;

- vija, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 46-47, 56, 81-82, 115, 119, 189, 195-196, 201, 256-257, 292, 339, 341-342, 345-346, 347-348, 351;
 - roli udhëheqës i Partisë — 114-115, 119, 190, 209, 284, 364-365;
 - përbërja e Partisë; uniteti në Parti — 84-85, 87;
 - pranimet në Parti, kriteret e pranimet; masat ndëshkimore, përjashtimet nga Partia — 204, 212-213, 321-326;
 - puna e Partisë, metoda dhe stili i punës së saj; trajtimi konkret historik — 87, 115, 116-117, 119, 169-170, 308-309, 327-328, 344-348;
 - puna e Partisë me njerëzit, lufta kundër të metaeve e gabimeve — 119, 325, 347-348;
 - vija e masave, lidhjet e Partisë me popullin, ndihma dhe kontrolli për bazën, informimi në Parti — 114, 115-116, 169-171, 192-193, 196, 198, 200, 202, 222, 308, 326-327, 344-348;
 - zgjedhjet në Parti, mbledhjet për dhënie llogari dhe zgjedhje — 188, 221;
 - materialet, studimet për organet udhëheqëse — 254.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe.
 - Kongresi i VII i PPSH (1—7 nëntor 1976) — 20, 294, 295, 313;
 - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 33, 72, 117, 124, 127, 130, 156, 161-162, 203, 209, 248, 254, 256, 257, 292, 294, 303, 308, 339, 342, 367;
 - aparati i KQ — 169, 202, 252, 271-272;
 - organizatat, komitetet dhe byrotë e Partisë në rrethe; sekretari i parë, aparati dhe instruktorët, detyrat e tyre — 84, 85, 106, 116, 117, 121, 130, 133, 145, 189, 202-203, 204, 210, 255, 264, 271-272, 306, 308, 309, 331, 341-342;
 - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës; Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tepelenës — 114-115, 321-326;
 - Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 303, 306-308;
 - organet dhe organizatat e Partisë në ushtri. Ko-

- mitetet e Partisë të një-sive dhe të repartëve ushtarake — 146-147, 221-222;
- organet dhe organizatat e Partisë në naftë — 68;
 - byrotë dhe sekretarët e Partisë në kooperativat bujqësore — 197-198;
 - komitetet dhe sekretarët e Partisë në ShLU — 138.
- Partia e Punës e Shqipërisë, lufta e klasave në Parti — lufta kundër sektarizmit, konservatorizmit, burokratizmit dhe indiferentizmit — 196-199, 221, 321-326, 351.*
- Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme*
- analiza marksiste-leniniste; qëndrimi ndaj imperializmit, borgjezisë dhe revizionizmit; përkrahja për popujt; marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste — 350, 351-352, 419-425;
 - qëndrimi dhe lufta për demaskimin e revizionizmit sovjetik dhe kinez — 19-20, 24-26, 29-34, 35, 40, 41-43, 48, 172, 174, 175, 177-178, 295.
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Spanjës — 350-351.*
- Partia Komuniste (revizioniste) e Spanjës, e Francës, dhe e Italisë — 61, 101, 102-104.*
- Patriotizmi, patriotët; edukimi patriotik — 285-286, 359-360, 374.*
- Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj — 107-108, 193-194, 265-266.*
- Pionierët, Organizata e Pionierit; fëmijët, kujdesi i Partisë për ta — 148-160, 215, 219.*
- Planifikimi i ekonomisë popullore; realizimi i planeve. Lufta kundër të metave në planifikim — 124-125, 190-191, 304, 331-333, 336-337;*
- hartimi i planeve dhe detyrat për realizimin e tyre në bujqësi e blegtori — 329-333, 337.
- Politika e jashtme e RPSSH — parimet themelore të saj — 88, 90, 421;*
- rritja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSSH në botë; të huajt, miqtë për Shqipërinë — 73, 217, 279, 285, 442;
 - marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor ndaj Jugosllavisë — 356, 381-383;
 - qëndrimi parimor ndaj Kosovës dhe popullsisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 356, 383, 385-386,

387-390, 397-398, 400-402.
Politika dhe ekonomia — 342,
345-346.

Politika dhe ideologjia — kuptimi ideopolitik i problemeve — 68, 80-87, 141-142, 192, 193, 340, 345-347.

Populli shqiptar — cilësitë, virtytet moralo-politike; traditat e tij patriotike e revolucionare — 218, 277, 280, 284-285, 353, 355, 372, 374, 398.
Presidhumi i Kuvendit Popullor, aparati i tij — 285, 287-291.

Prodhimi material, rritja e përdërprerë e tij; prodhimi i mallrave të konsumit të gjerë — 303-305, 343-344, 346;
— cilësia, asortimenti — 231, 241-242, 343, 345, 346.

Prona në RPSSH; prona e grupit, shndërrimi i saj në pronë të të gjithë popullit. Oborri kooperativist — 228, 292-293.

Propaganda, agjitacioni; përmbajtja, format, mjetet. Propaganda për botën e jashtme — 194, 357, 390, 393.

Propaganda dhe shtypi borçjezo-revizionist — 12, 20-21, 22-23, 34-35, 97, 98, 294.

Puna — kuptimi dhe rëndësia e saj; qëndrimi socialist ndaj punës — 68, 262.

Pushteti popullor — kuadrot, punonjësit e organeve të pu-

shtetit; kompetencat, përgjegjësitë, detyrat; lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe burokratizmit — 50, 114-115, 118, 120-121, 128, 189-190, 198, 306.

R

Revizionizmi modern, thelbi dhe strategjia e tij — 57-59, 89, 91.

Revolucioni socialist proletar; faktorët objektivë dhe subjektivë për shpërthimin e tij — 88-89, 312-313.

Revolucioni tekniko-shkencor; kuptimi, vlerësimi, zhvillimi dhe thellimi i tij — 126, 191, 241, 245, 307, 416-417;

— grupet e punës, organizimi i punës në to; roli dhe pjesëmarrja e masave — 120, 123, 306-308.

Rinia dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; udhëheqja dhe kujdesi i Partisë; roli dhe detyrat e tyre — 156, 157-159, 258-263, 264-265, 277.

RR

Rrethimi, bllokada imperialisto-revizioniste dhe lufta për çarjen e tyre — 82, 88, 180, 187, 194, 240, 242-243, 339, 340.

S

Sektarizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 205-207.

Specialistët e huaj në Shqipëri — 65, 162-163.

Stalin, Josif Visarionoviç — 32, 37, 39, 43, 176, 181, 212, 378, 379, 383, 393.

Stimujt moralë; dekorimet, dekoratat, titujt e nderit; kriteret për dhënien e tyre — 281, 285, 299-290.

Superfuqitë, politika e luftës dhe e agresionit; kontradiktat dhe rivaliteti ndërmjet tyre; përpjekjet për zgjerimin e zoneve të influencës — 50, 315, 428-429, 438-439.

SH

Shfaqjet e huaja, lufta kundër tyre — 116, 119, 263, 265.

Shkenca botërore, zbulimet shkencore — 76, 411-412.

Shkenca në RPSSH — politika dhe kujdesi i Partisë për shkencën — 367, 413-417;

— institucionet shkencore; veprimtaritë shkencore, shkencëtarët — 110, 357, 358, 362, 367, 368, 378, 403-404, 410-411, 413-414, 415-416, 418.

Shkollat e Lira Ushtarake — roli udhëheqës i Partisë; do-

mosdoshmëria e forcimit dhe e organizimit të tyre — 129-147;

— stërvitja dhe përgatitja ushtarake, programet e stërvitjes. Koordinimi i stërvitjes së programuar me atë jashtë shkollës së lirë — 132-134, 136-137, 139-143;

— kuadrot ushtarakë, përgatitja, aftësimi i tyre — 136-137, 142-143, 144;

— zbatimi i disiplinës ushtarake dhe i asaj shkencore — 137, 142-143.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — gjendja e brendshme; kriza e përgjithshme ekonomiko-politike; politika e jashtme demagogjike dhe e luftës — 61-62, 376, 422-423;

— strategjia globale e imperializmit amerikan në marrëdhëniet dhe qëndrimin ndaj Kinës dhe BS — 38, 41, 43, 295-296, 298, 299-300, 440-441;

— ndërhyrjet në Azi dhe në Afrikë — 296-297, 298, 299.

Shtypi botëror — 1-2, 3, 4, 294, 300.

Shtypi dhe botimet në RPSSH; përmbajtja dhe roli i tij edukativ. Organet e shtypit — 20, 149, 155, 419;

— botimet për fëmijë, tematika e tyre — 149-150.

T

Teatri, estrada — 270, 272-273, 274, 279.

Teknokratizmi, lufta kundër shfaqjeve të tij — 189-190, 207-208.

Teoria dhe praktika, uniteti dialektik i tyre — 69, 142, 156, 275.

Teoritë dhe pikëpamjet bor-gjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre

— teoria kineze e «tri bo-tëve» — 19, 29, 33, 46, 297, 419-420, 421, 422, 424-425;

— teoria jugosllave e «ven-deve të paangazhuara» — 419-420, 421, 422-423, 424-425.

Të ardhurat kombëtare; aku-mulimi, rëndësia e tij për zhvillimin e ekonomisë — 124-128.

Tregtia e jashtme — parimet themelore në fushën e tregtisë së jashtme. Organet e tregtisë, punonjësit e tyre — 186-188, 238-239, 248-250;

— eksporti, njohja e tregut ndërkombëtar dhe e ko-niunkturës së çmimeve; tregtia me klering dhe me devizë të lirë; zgjerimi dhe gjetja e tregjeve të reja — 125, 187-188, 238-239, 240, 241-248, 249;

— importi, zëvendësimi i mallrave të importit me ato të vendit — 247-248.

U

Uniteti Parti—popull — 87, 89, 117, 364-365.

Ushtria popullore — edukimi ideopolitik dhe përgatitja ushtarake; detyrat e saj për mbrojtjen e vendit. Forcimi i lidhjeve ushtri-terren — 141-142, 143, 146-147, 224-225;

— kuadrot politikë dhe ushtarake; ushtarët, përgatitja dhe aftësimi i tyre — 139-142, 144-145, 146, 147, 222-223;

— stërvitja ushtarake, disiplina në ushtri; lufta kundër shfaqjeve të huaja — 221-224;

— Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë — 140, 141;

— Forcat Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore; rezervistët — 134-136, 147.

Ushtria në vendet revizioniste — 176, 432-433.

V

Vendet revizioniste, qëndrimi ndaj Shqipërisë — 58, 91-92, 187-188, 242.

Vështirësitë, lufta për kapërcimin e tyre — 124-128, 186.

Vigjilenca revolucionare — 82, 89, 90, 316, 390, 393, 394.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 109, 110, 111-
-112, 122, 156, 254, 266, 267,
268, 269, 350, 351, 352, 357,
364, 409, 413, 424.
Agolli, Dritëro — 219, 269,
270, 271, 276, 277, 278.
Aliaj, Agron — 218, 219.
Alizoti, Fejzi — 416.
Arkitekt Sinani — 410.

B

- Bajrami, Avdi — 359, 360, 361.
Balluku, Beqir — 26, 27, 31,
33, 48.
Banushi, Tano — 271.
Berlinguer, Enriko — 101, 102.
Bernshtajn, Eduard — 28.
Bismark, Oto — 355.
Bokasa, Zhan-Bedel — 420.
Brezhnjev, Leonid — 28, 393.
Brzezinski, Zbignjev — 295,
297, 298, 299, 300, 301, 440,
441.
Buda, Aleks — 362, 363 365,
366, 367, 368, 404, 406.

- Bul, Xhorxh — 76.
Buto, Zylfikar Ali — 22, 301,
437.
Buzi, Tafil — 218, 282.

C

- Cami, Tefta — 106, 111, 276.

Ç

- Çuko, Lenka — 230, 231.
Çan Kai Shi — 38, 44, 182,
183.
Çausheku, Nikolae — 92, 436.
Çen Ji — 173, 183, 184.
Çen Po Ta — 184.
Çian Çin — 178, 180, 181, 182,
184.
Çuçi, Gafur — 138-139, 156.
Çu De — 183.
Çu En Lai — 6, 8, 15, 30, 31,
32, 33, 37, 38-40, 42, 43, 44,
45, 47, 48, 177, 179-180, 181,
182, 183, 184, 185, 375, 393,
426, 427, 428, 430.

D

- D'Alamber, Zhan lë Rond — 370.
 Derri, Qerlba — 312.
 Didëro, Deni — 370.
 Doçi, Ali — 131-132, 133, 135, 136, 137.
 Dode, Petro — 326, 327.
 Dollaku, Andon — 137-138, 143.
 Dume, Petrit — 26, 27, 31, 33.

E

- Erer, Emin — 360-361, 366.

F

- Fam Van Dong — 14.
 Fan Çen Cuo — 172, 173-174.
 Fan Yuan Yen — 22.
 Franko, Françisko — 103.
 Frashëri, Abdyl — 281, 282, 283, 285-286, 350, 357-358, 359, 361, 364, 372, 373.
 Frashëri, Naim — 357-358, 359, 361, 364, 366.
 Frashëri, Sami — 282, 358, 360-361, 364, 366-367.
 Fridrih Vilhelmi III [Frederik Gijomi III] — 226.
 Fundo, Kristaq — 76.

G

- Gëbels, Paul — 60.

- Gëring, Herman — 60.
 Grebenea, Beqir — 406-407.

GJ

- Gjadri, Gjovalin — 109.
 Gjebreja, Ardit — 153.
 Gjoka, Lola — 216.
 Gjoleka, Zenel — 218.
 Gjora, Violeta — 218.
 Gjyzari, Niko — 236.

H

- Hoxha, Nexhmije — 214.
 Hak, Zia ul — 301.
 Haldeman, Bob — 178, 179.
 Hekall, Rrapo — 218, 282.
 Hitler, Adolf — 60.
 Ho Lun — 175.
 Hoxha, Mynyr — 130, 131, 143-144.
 Hoxha, Valbona — 360.
 Hrushov, Nikita — 28, 40, 41, 42, 393, 427, 433.
 Hua Kuo Fen — 5, 8, 15, 21, 22, 23, 30, 34, 44-45, 46, 48, 49, 95, 97, 99, 100, 184-185, 299, 300, 426, 428, 430, 431-432, 436.
 Huan Hua — 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7-8, 9-10, 11-12, 13-14, 15, 16, 17, 18, 19-20, 21-22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29-31, 32, 33-35, 439.

I

- Isai, Hekuran — 51, 53, 113,
115, 328, 329, 330, 334, 335-
-336.
Ibarruri, Dolores — 351.
Ibrahimi, Feim — 216.

J

- Jao Ven Juan — 177, 182.

K

- Kapo, Hysni — 31, 52, 118, 119,
130, 173, 324, 326, 329, 331,
332, 333, 335, 336, 337, 339,
343, 409, 423-424.
Koleka, Spiro — 109, 110.
Kan Shen — 178, 181.
Kardel, Eduard — 93, 386-387.
Karlos, Huan — 103.
Karter, Xhimi — 49, 422, 423,
440, 441.
Karriljo, Santiago — 102-103.
Kautski, Karl — 28.
Këllezi, Abdyl — 23, 33, 48, 187.
Kieu Samfan — 13.
Kim Ir Sen — 299, 438.
Kisinger, Henri — 44, 179, 429.
Klauzeviç, Karl fon — 225, 226.
Koço, Eno — 216.
Koçollari, Sotir — 253-254, 255,
256, 257, 258.

- Kokëdhima, Persefoni — 312.
Kolaneci, Liri — 319.
Kolaneci, Teki — 319.
Kondo, Anastas — 271.
Krajka, Agim — 219.
Krasniqi, Norbert — 218.
Krol, Haxhi — 149.
Kruja, Mustafa — 381.

L

- Laro, Kujtim — 216, 218.
Lavuazie, Antuan Loran — 108.
Leka, Suat — 291-292.
Lepuri, Alqi — 218.
Li Hsien Nien — 185, 438.
Lin Blao — 43, 178, 180, 181,
183, 184.
Liu Shao Çi — 8, 175, 181, 182,
184, 185.
Ljarja, Rikard — 216.
Lon Nol — 7-8, 13.

LL

- Lleshi, Haxhi — 27, 287.

M

- Mihali, Qirjako — 186.
Murra, Prokop — 115, 122-123,
303, 330, 338-339, 340-341, 342-
-343, 344.
Malenkov, Georgi — 23.

Mani, Pirro — 271.
 Manushi, Violeta — 268, 269-
 -270, 271, 274, 275, 276.
 Mao Ce Dun — 3, 5, 6, 7, 8, 15,
 19, 20, 27-28, 29, 33, 36, 37,
 38-41, 42, 43, 44, 45, 46, 47,
 48, 50, 97, 99, 100, 172-173,
 174-177, 178, 179, 180, 181, 182,
 183, 184, 185, 297, 393, 426,
 427, 428, 429, 430, 431, 432.
 Marko, Raul — 349, 350-351.
 Markos, Ferdinand — 438.
 Marshe, Zhorzh — 103, 104.
 Matiez, Albert — 411-412.
 Miniç, Millosh — 422.
 Mishële, Zhyl — 411.
 Miteran, Fransua — 103.
 Mobutu. Sese Seko — 296, 420,
 423, 439.
 Moisiu, Vangjel — 172.
 Molier (Zhan-Baptist Pokëlen)
 — 269.
 Moro, Aldo — 59, 101.
 Mugosha, Dushan — 384.
 Mula, Avni — 153, 216-217, 218.
 Musolini, Benito — 60.
 Mushi, Myfit — 172.

N

Naipi, Bule — 312.
 Ngjela, Kiço — 187, 242.
 Nikolla (knjaz) — 355, 384.
 Nikson, Riçard — 30, 44, 178,
 179, 430.
 Nguyen Van Xhiap — 14.

O

Ovens, David — 62.

P

Pahlevi, Muhamed Reza — 437.
 Pak Çen Hi — 299.
 Pasha, Dervish — 283.
 Pen Çen — 175, 181.
 Peza, Mine — 312.
 Pin De Hua — 183, 184.
 Pollo, Stefanaq — 356.
 Puka, Shote — 360.
 Pulaha, Ruzhdi — 275, 276.
 Puto, Arben — 406.

Q

Qemali, Ismail — 406, 407-408.

R

Raidhi, Pandi — 275.
 Rankoviç, Aleksandër — 384,
 386, 387.
 Rexhepi, Pashako — 318, 319,
 320.
 Robespier, Maksimilian — 370.
 Ruso, Zhan Zhak — 370.

S

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
 — 282, 377.
 Stefani, Simon — 303, 306, 308.
 Sajfudin — 392.

Sen-Zhyst (Lui Antuan) — 370.
 Sihanuk, Norodom — 8-9, 13,
 16.
 Sokoli, Mic — 281, 285-286.

SH

Shkurti, Leka — 156.
 Shkurti, Stavri — 275.
 Shuteriqi, Dhimitër — 409.

T

Tarazhi, Marta — 312.
 Tarazhi, Prenda — 312.
 Tashko, Tefta — 216.
 Ten Hsiao Pin — 8, 15, 21, 45,
 46, 48, 49, 50, 95, 97, 99, 100,
 175, 181, 182, 184, 185, 300,
 393, 426, 428, 430, 431, 432,
 433, 436, 438.
 Tito, Josip Broz — 23, 368, 381,
 382, 383, 384, 385, 386-387,
 392, 393, 394, 395, 399, 419,
 435, 436, 439.
 Toptani, Esat pashë — 408.
 Tucoviq, Dimitrije — 408.

TH

Thomai, Themie — 230, 236,
 334.

V

Vasa, Pashko — 282.
 Vens, Sajrus — 3, 62, 440.
 Vern, Zhyl — 150.
 Vërlaci, Shefqet — 381.
 Vid, Vilhelm — 407, 408.
 Vilhelmi I [Gijomi I] — 355.
 Vokshi, Bije — 360.
 Vokshi, Sulejman — 281, 285-
 -286.
 Volter (Fransua Mari Arué) —
 370.
 Vreto, Jani — 282.
 Vukmanoviç, Svetozar (Tempo)
 — 384, 386.

XH

Xhonson, Lindon — 427.
 Xhuglini, Naxhie — 270.

Z

Zadeja, Çesk — 219.
 Zekthi, Besim — 219.
 Zela, Vaçe — 219.
 Zogu, Ahmet — 373.
 Zoraqi, Nikolla — 216, 218, 219.

ZH

Zhores, Zhan — 411.

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Adriatik (deti ~) — 355, 395.
Afganistan — 300-301, 429.
Afrika e Jugut — 62, 439.
Afrikë — 296, 300, 434.
«Agimet tona» (kënga ~) — 219.
Akademia e Shkencave e RPSSH — 367.
Algjeri — 63, 69, 74.
Amerika Latine — 434.
Angolë — 296.
Ansamblë Artistik i Ushtrisë Popullore — 218.
Arabia Saudite — 437.
Azi — 36, 296, 298, 299, 431, 434.

B

- Baku (Bashkimi Sovjetik) — 66.
Ballkan (zona ~) — 390, 395, 436.
Bangladesh — 438.
Banka e Shtetit, Lushnjë — 341.
Belgjikë — 433, 441.

- «Beni ecën vetë» (filmi ~) — 154.
Beograd — 422.
Birmani [Mjanma] — 438.
Bosfor (ngushtica ~) — 395.
Bosnjë-Hercegovinë — 380, 381, 394.
Britania e Madhe — 6, 43, 45, 433, 434, 441.
Bullgari — 385, 394, 406.
Buz (Tepelenë) — 325.

C

- «Cina contemporanea» (revista ~) — 1.

Ç

- Çamëri — 232.
Çansha (Kinë) — 178.

D

- Dardanele (ngushtica ~) — 395.
Deti i Kinës Jugore (ishujt ~) — 16-17.
Dibër — 194-195, 283, 358.

Dibër (Jugosllavi) — 355-356,
381, 388.
Durrës — 316.

E

Egje (zona ~) — 388.
Elbasan — 358.
ENI (monopoli ~) — 101.
Etiopl — 296, 439.
Evropë — 49, 61, 217, 226, 298,
353, 376, 377, 398, 430, 439,
441.

F

«Fatosi» (revista ~) — 149.
«Festa e dritës» (vallja ~) —
219.
Festivali i Këngës për Fatosë
e Pionierë (Shkodër, 1978) —
155.
FIAT (monopoli ~) — 101.
Fier — 191.
Filipine — 17, 429, 438.
Francë — 6, 45, 61, 74, 98, 104,
107, 279, 331, 433, 434, 441.
Frashër (Përmet) — 285.

G

Goli Otok (Jugosllavi) — 384.
Gostivar — 388.
Greqi — 279, 355, 385, 436.
Grudë — 282, 354.
Guci — 354, 355-356.

Guomindan (Partia Nacionaliste,
Kinë) — 37, 183.

GJ

Gjakovë — 285.
Gjermani — 38.
Gjermania Perëndimore (RF e
Gjermanisë) — 7, 43-44, 45, 60-
61, 98, 433, 441.
Gjiri i Omanit — 437
Gjiri Persik — 300.
Gjirokastër — 131, 321, 327,
358.

H

Hidrocentrali i Fierzës [Hidro-
centrali «Drita e Partisë»] —
189, 360.
Hidrocentrali i Komanit [Hi-
drocentrali «Enver Hoxha»] —
— 347, 360.
«Histoire de la Revolution
Française» (libri ~, Zh. Mi-
shëlë) — 411.
«Historia e revolucionit fran-
cez» (libri ~, Zh. Zhores) —
411.
Hot (krahina ~) — 282, 354.
Hoxharë (fusha ~, Fier) —
347.
HSINHUA (Agjencia Kina e
Re) — 23.
Hsisha (ishulli ~) — 17.
Hong-Kong — 3.

I

- «Imperializmi dhe revolucioni» (E. Hoxha, vepra ~) — 419, 424.
 Indi — 299, 301, 429, 436.
 Indokinë — 3, 12, 13, 16, 301.
 Indonezi — 301, 429.
 Instituti i Historisë, Tiranë — 414, 418.
 Instituti i kulturës fizike «Vojko Kushi», Tiranë — 416.
 Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni) — 38.
 Irak — 63, 69, 74.
 Istria (Jugosllavi) — 385.
 Itali — 59-60, 101, 102, 279, 385, 436.

J

- Janinë — 283.
 Japoni — 6, 38, 45, 98, 182, 299, 300, 429, 433, 434, 437-438.
 «Jemi fëmijët më të lumtur» (vallja ~) — 218.

K

- Kaçanik — 354.
 Kamboxhia — 4, 9, 10, 13, 14, 15, 16, 301, 429.
 Kanada — 6.
 Katangë (Zaire) — 424.
 Kinostudioja «Shqipëria e re» — 155.
 KNER (Këshilli i Ndhmës

- Ekonomike Reciproke) — 91.
 Kombinati i sheqerit «8 Nëntori», Maliq — 115.
 Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë-], Elbasan — 162, 167, 189, 245, 278.
 Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare [Komiteti i Stambollit] — 282.
 Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (12-14 qershor 1978) — 403.
 Kongresi i Berlinit (qershor 1878) — 285, 354, 373, 391.
 Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Novoselës, Vlorë — 266.
 Kooperativa bujqësore e tipit të lartë «Enver Hoxha» e Zharëzëz, Fier — 334.
 «Kopraci» (komedia ~, Moliere) — 269.
 Korçë — 358.
 Koreja e Jugut — 299, 429.
 Koreja e Veriut (RDP e Koresë) — 24, 299, 438.
 Kroaci — 394.
 Krujë — 377.
 Kubë — 296.
 Kukës — 131, 194-195, 358.
 Kuvendi i Dibrës (tetor 1880) — 283.
 Kuvendi i Gjirokastrës (korrik 1880) — 283.

L

- Laos — 4, 9, 301, 429.
 Lindja e Mesme — 3, 17.
 Lufta e Spanjës (1936—1939) — 351.
 «Lulëkuqet mbi mure» (filmi ~) — 154.
 Lushnjë — 77.

M

- «Majn Kampf» (libri ~, A. Hitler) — 60.
 Makao — 3.
 Mali i Zi — 284, 285, 355, 358, 376, 379, 380, 381, 382-383, 387, 388, 389, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400.
 Mançukuo (mbretëria ~, Kinë) — 183.
 Maqedoni — 194, 284, 354, 358, 376, 379, 380, 382-383, 385, 387, 388, 389, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400.
 Marmara (deti ~) — 395.
 Mbledhja e partive komuniste e punëtores në Bukuresht (qershor 1960) — 42.
 Memaliaj (Tepelenë) — 325.
 Mesdhe (deti ~) — 355, 395.
 Miniera e Qymyrgurit e Memaliajt, Tepelenë — 335.
 Mitrovicë — 354.
 Mokër (krahina ~, Pogradec—Korçë) — 265-268.

- «Montekatini» (monopoli ~) — 101.
 Monumenti i Skënderbeut, Krujë — 377.

N

- Namibi — 296.
 Nansha (ishulli ~) — 17.
 NATO (Organizatë e Traktatit të Atlantikut Verior) — 44, 298, 394, 395, 435, 436, 441.
 Ndërmarrja artistike «Migjeni», Tiranë — 246.
 Ndërmarrja bujqësore «Rinia», Vlorë — 265.
 Ndërmarrja e Punimit të Slxhadeve, Tiranë — 254.

NJ

- «Njeriu me top» (romani ~, D. Agoll) — 277.

O

- Oqeani Indian — 438.
 Organizata e Kombeve të Bashkuara — 44.

P

- Pakistan — 299, 301, 437.
 Parku i Madh i Tiranës — 357.

Patos (rajoni naftëmbajtës ~, Fier) — 70, 71.

«Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha» (libri ~, A. Puto) — 406-407, 409.

Pekin — 1, 103, 298, 301.

Perandoria Austro-Hungareze — 371, 407-408.

Perandoria Osmane — 353, 371, 373.

Perandoria Ruse — 371, 395.

«Pionieri» (revista ~) — 149.

Plavë — 354, 355-356.

Pnom-Pen — 13.

Pogon (Gjirokastër) — 327.

Pogradec — 333.

Prishtinë — 356.

Prizren — 281, 353, 355, 356.

Progonat (Tepelenë) — 325, 326.

Pukë — 360.

R

Revolucioni Demokratiko-Borgjez Francez (1789-1794) — 369-370.

Rodezi — 62, 296.

Rumani — 31, 47, 48, 92, 433, 436.

S

Sajgon [«Ho Shi Min»] — 13, 15.

Sarandë — 77.

Selanik (Greqi) — 385.

Serbi — 285, 379, 382-383, 394, 393.

Sinkiang (Kinë) — 178, 180.

Skrapar — 265-266.

Sloveni — 394.

Somali — 296, 439.

Spanjë — 103, 351, 436.

Stamboll [Kostandinopojë] — 358, 395, 410.

Strugë — 388.

SH

Shangai (Kinë) — 172, 177, 178, 181.

Sheshi «Skënderbej» (Tiranë) — 357.

Shkodër — 283, 358.

Shkolla e mesme artistike «Jordan Misja», Tiranë — 216.

Shqipëria e Jugut — 282, 354.

Shqipëria e Veriut — 72.

T

Tajlandë — 301.

Tajvan — 43, 299, 430.

«Tanë Shqipnia asht betue, pa gjak malet mos me i lëshue» (poema vokalo-simfonike ~, F. Ibrahim) — 216.

TANJUG (Agjencia Telegrafike e Jugosllavisë së Re) — 356.

«Tartufi» (komedia ~, Mo-
lier) — 269.

Teatri i Operës dhe i Baletit,
Tiranë — 214, 217, 219, 357.

«Teoria dhe praktika e revo-
lucionit» (artikulli ~, «Zëri
i popullit», 7 korrik 1977) —
20.

Tepelenë — 191, 321, 323, 324,
327.

Tetovë — 388.

Tibet (Kinë) — 301.

Tiranë — 220, 303, 308, 357, 358.

Tivar — 354, 355-356.

«Tomka dhe shokët e tij» (fil-
mi ~) — 154.

Traktati i Shën-Stefanit (mars
1878) — 391.

Traktati i Varshavës — 91, 394.

Tregu i Përbashkët Evropian
— 49, 61, 298, 435.

Trieste — 385.

Tropojë — 285.

Trupa e Teatrit të Gjakovës —
88.

Turqi — 279, 350, 368, 384,
398, 436.

TH

Thesali (Greqi) — 395.

Thrakë (Greqi) — 395.

U

Universiteti i Prishtinës — 389,
399.

Universiteti i Tiranës [Uni-
versiteti i Tiranës «Enver
Hoxha»] — 389, 414.

Uzina e Lëndëve Plastike, Lu-
shnjë — 303, 305.

Uzina e Përpunimit të Thellë
të Naftës, Ballsh — 189.

Uzina e Telave dhe e Kabllo-
ve Elektrike, Shkodër — 245.

Uzina Mekanike e Gjeologjisë,
Tiranë — 258.

V

Valbonë (lumi ~, Tropojë)
— 360.

Vietnam — 3, 4, 9, 10, 13-14,
15, 16, 24, 301, 429, 438.

Vinjoll (Mat) — 164.

Vishegrad (Jugosllavi) — 380.

Vlorë — 191, 265-266, 333.

Y

«Yjet e netëve të gjata» (fil-
mi ~) — 319.

Z

Zagori (zona ~, Gjirokastrë)
— 327.

Zaire — 296, 298, 424, 439.

«Zëri i popullit» (gazeta ~)
— 1, 20.

«Zëri i Vlorës» (gazeta ~) —
265.

«Zonja nga qyteti» (filmi ~)
— 268, 275-276.

«Zonja nga qyteti» (komedia
~, R. Pulaha) — 275-276.

ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~)
— 20, 34, 97, 174.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 66-TË	V—IX
EKSPOZE PSEUDOTEORIKE — Shënime (4 prill 1978)	1—18
TIRADË E NDYRË ANTISHQIPTARE — Shënime (5 prill 1978)	19—35
STRATEGJI PA MASKA — Shënime (11 prill 1978)	36—50
PARTIA MERR VENDIME DHE VEPRON PËR ZBATIMIN E TYRE — Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (17 prill 1978)	51—56
NË DISA VENDE PO GJALLËROHEN FORCAT FASHISTE — Shënime (18 prill 1978)	57—62
EKSPERIENCA QË MERRET TË APLIKOHET NË KUSHTET E VENDIT TONË — Nga biseda me një grup specialistësh të naftës (19 prill 1978)	63—79
PUNË KRIJUESE DHE E ZGJUAR BËHET KUR NJIHET MIRË SITUATA — Nga biseda me disa kuadro të Ministrisë së Punëve të Brendshme (20 prill 1978)	80—90
MASKAT PO BIEN — Shënime (22 prill 1978)	91—104
TEKSTET SHKOLLORE TË PËRMIRËSOHEN VAZHDIMISHT E ME AFATE TË CAKTUARA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 prill 1978)	105—112

PËR REALIZIMIN E DETYRAVE PËRGGJIGJEMI TË GJITHË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (27 prill 1978)	113—123
AKUMULIMI SHPEJTON RITMET E ZHVILLIMIT TË EKONOMISË — Shënime (27 prill 1978)	124—129
ÇDO NEGLIZHENCË NË STËRVITJE KUSHTON SHUMË GJATË LUFTËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 prill 1978)	129—147
PIONIERËT JANË FILIZAT E SË ARDHMES, JANË ATA QË DO TË MARRIN NË DORË STAFETËN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 prill 1978)	148—160
TË NJOHIM MË MIRË PËRMBAJTJEN DHE TEKNOLOGJINË E MINERALIT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (9 maj 1978)	161—171
ÇTREGOJNË DISA DOKUMENTE PËR MAO CE DUNIN — Shënime (10 maj 1978)	172—185
ËSHTË E DOMOSDOSHME QË EKONOMIA TË DREJTOHET NË MËNYRË SHKENCORE — Shënime (11 maj 1978)	186—201
KUADRI TË SHIHET SI QËNDRON NË PUNË DHE NË JETË — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (19 maj 1978)	202—213
NDIEJ GËZIM TË MADH KUR SHOH ZHVILLIMIN E ARTIT TË NE — Shënime (20 maj 1978)	214—220
NË USHTRI NUK MUND TË ECET PA DISIPLINË — Shënime (21 maj 1978)	221—226

MIRËQENIA RRITET DUKE SHTUAR PRODHIMET — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 maj 1978)	227—237
BLLOKADA NUK VARET NGA NE, POR FITORJA MBI TË VARET PLOTËSISHT NGA NE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 maj 1978)	238—250
TËRË PROCESI I PUNËS ME TË RINJTË ËSHTË KURDOHERË PROCES EDUKATIV — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 maj 1978)	251—266
TË RUAJMË SI SYTË E BALLIT THESARIN E KOM- BIT DHE TA ZHVILLOJMË MË TEJ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (25 maj 1978)	267—280
PATRIOTËT TANË TË MËDHENJ LUFTUAN ME ARMË NË DORË PËR TË FITUAR LIRINË — Fjala në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (27 maj 1978)	281—286
DISA MENDIME E VËREJTJE PËR METODËN DHE STILIN E PUNËS SË PRESIDUMIT TË KUVENDIT POPULLOR DHE TË APARATIT TË TIJ — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (27 maj 1978)	287—293
STRATEGJI E PËRBASHKËT KINO-AMERIKANE — Shënime (28 maj 1978)	294—302
KUR I DËGJON MASAT, RRIT BESIMIN E TYRE TE PARTIA — Shënime (29 maj 1978)	303—309
EMANCIPIMI I GRUAS SHQIPTARE — NJË NGA VEPRAT MË TË RËNDËSISHME TË PARTISË SONË — Përshëndetje drejtuar Kongresit të 8-të të BGSB (1 qershor 1978)	310—317

- DJENTË E TU JANË GJALLË SE LUFTUAN E DHANË
 NË JETËN PËR POPULLIN — Nga biseda me nënë
 Pashako Rexhepin (1 qershor 1978) 318—320
- NUK MUND TË ECË BLEGTORIA PA BUJQËSINË
 — Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve të KQ
 të PPSH (5 qershor 1978) 321—337
- TË ARDIHURAT SHTOHEN DUKE PUNUAR MË
 SHUMË — Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve
 të KQ të PPSH (10 qershor 1978) 338—348
- FORCA JONË ËSHTË TE PARTIA — Nga biseda
 me një delegacion të Partisë Komuniste të Spanjës
 (m-1) (10 qershor 1978) 349—352
- NGJARJE E SHËNUAR E HISTORISË SË LAVDISH-
 ME TË POPULLIT TONË HEROIK — Shënime
 (10 qershor 1978) 353—358
- VËLLEZËRIT FRASHËRI JANË SHUMË TË SHITRE-
 NJTË PËR NE — Nga biseda me disa patriotë e ve-
 teranë në sheshin «Skënderbej» — (11 qershor 1978) 359—361
- PATRIOTËT E MËDHENJ TË RILINDJES SHKRI-
 NË TËRË JETËN E TYRE PËR MËMËDIENË —
 Nga biseda me shokun Aleks Buda (12 qershor 1978) 362—368
- DISA MENDIME PËR RILINDËSIT — Shënime (12
 qershor 1978) 369—378
- PROBLEMI I POPULLSISË SHQIPTARE QË BA-
 NON NË TROJET E VETA NË JUGOSLLAVI —
 Shënime (13 qershor 1978) 379—402

PËR ZHVILLIMIN E SHKENCËS DHE PËRGATITJEN E KUADRIT LLOGARITË TË BËJME MIRË DHE ME KOHË — Nga biseda në takim in ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (15 qershor 1978)	403—425
PANORAMË E SHKURTËR E «DIPLOMACISË BOTËRORE» KINEZE — Shënime (16 qershor 1978)	426—442
Treguesi i lëndës	445
Treguesi i emrave	459
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	465